

BAZAT E BIBLËS

**Bible Basics by Duncan Heaster- Albanian
Version**

www.carelinks.net email: info@carelinks.net

1.1 Egzistenca e Zotit

"Ai që i afrohet Perëndisë duhet të besojë se Perëndia është dhe se është shpërblyesi i atyre që e kërkojnë Atë me zell" (Heb.11:6). Qëllimi i këtij studimi është të ndihmojë ata që duan të vijnë te Zoti, duke besuar së pari që "Ai është"; prandaj ne nuk do të merremi me fakte që konfirmojnë besimin në qenien e Zotit. Duke shqyrtuar strukturën komplekse të trupave tanë (krah. Ps.139:14), përbërjen evidente në një lule, duke vështruar lart në madhësinë e hapësirës në një natë të kthjellët, këto dhe pasqyrime të kujdesëshme të tjera të panumërta në jetë me siguri e bëjnë ateizmin të pabesueshëm. Të besosh që nuk ka Zot sigurisht kërkon më tepër besim se të besosh që Ai egziston. Pa Zot nuk ka rregull, qëllim ose shpjegim themelor në univers dhe prandaj kjo do të pasqyrohet në jetën e ateistit. Duke menduar këtë, nuk është çudi që shumica e qenieve njerëzore bie dakort me një shkallë të caktuar besimi në një Zot – edhe në shoqëritë ku materializmi është 'zoti' më i përhapur në jetët e njerëzve.

Por ka një ndryshim të madh ndërmjet të pasurit një nocion të turbullt që ka një fuqi më të lartë dhe, në fakt, të qenurit i sigurt ndaj asaj që Ai ofron për shërbim besnik ndaj Tij. Heb.11:6 e bën të qartë; ne

"duhet të besojmë që (Zoti) është

DHE

Që Ai është shpërblyes i atyre që e kërkojnë Atë me zell"

Shumica e Biblës është një përshkrim i historisë së popullit të Zotit, Izrael; është bërë e qartë që pranimi i egzistencës së Zotit prej tyre nuk përkonte me besimin e tyre në premtimet e Tij. Moisiu u tha atyre "mëso, pra...dhe mbaje në zemrën tënde, që Zoti është Perëndi atje lart në qiejt dhe këtu poshtë në tokë: nuk ka asnjë tjetër. Respekto, *pra*, statutet e tij dhe urdhërimet e tij" (LiP.4:39,40).

Kështu bëhet e qartë e njëjta gjë– pranimi në vetvete që ka një Zot nuk do me thënë që ne automatikisht e pranojmë Zotin. Nëse ne biem dakort seriozisht që vërtet kemi një krijues, ne duhet "të mbajmë *pra* urdhërimet ... e tij". Qëllimi i serive të këtyre studimeve është që të shpjegojë çfarë janë

këto urdhërime dhe si t'i mbajmë ato. Me kërkimin e Shkrimeve për të bërë këtë, ne do të kuptojmë që besimi ynë në qenien e Zotit është forcuar:

"Besimi vjen nga dëgjimi dhe dëgjimi vjen nga fjala e Zotit" (Rom.10:17). Siç, Isaia 43:9-12 tregon se si të kuptuarit e profecive të Zotit për të ardhmen na bën të dimë "që unë jam ai" (Is.43:13) - d.m.th. që Emri i Zotit 'unë jam ai që jam' është krejt i vërtetë (Ex.3:14). Apostulli Pal erdhi në një qytet i quajtur Berea, sot në Greqinë Veriore. Si zakonisht, ai predikoi ungjillin ('lajmin e mirë') e Zotit; por në vend që njerëzit të pranonin fjalën e Palit për të, "ata e pranuan fjalën (e Zotit, jo të Palit) me gatishmëri të madhe, duke i shqyrtuar çdo ditë shkrimet për të parë nëse këto gjëra ishin ashtu. Prandaj shumë prej tyre besuan" (Veprat 17:11,12). Besimi i tyre ishte në saj të zemrave të tyre të hapura, studim i rregullt ("ditor") dhe sistematik ("ato gjëra") i Biblës. Prandaj përfitimi i besimit të vërtetë nuk ishte se Zoti papritur i bëri ta fitojnë nga ndonjë lloj operimi shpirtëror të zemrës, i pa lidhur me fjalën e Perëndisë. Pra si mundën njerëzit e kësaj bote që futen në një fushatë të Billy Graham ose mbledhje ringjalljeje të Pentakostit dalin prapë si 'besimtarë'? Sa studim ditore i Shkrimeve ka vazhduar në këto raste? Kjo mungesë besimi me bazë të vërtetë Biblike pa dyshim është përgjegjëse për boshllëkun që hasin këta 'të shndërruar' gjatë përvojës së tyre të mëvonshme kristiane dhe pse kaq shumë i kthejnë shpinën lëvizjes evangeliste.

Qëllimi i këtij kursi studimi është të japë një skelet pune për studimin tuaj sistematik të Shkrimeve, në mënyrë që edhe ju "pra" të besoni. Lidhja midis dëgjimit të ungjillit të vërtetë dhe pasjes besim të vërtetë theksohet shpesh në historinë e predikimit të Ungjillit:

- "Shumë prej Korintasve besuan duke dëgjuar dhe u pagëzuan" (Veprat18:8)
- Njerëzit "dëgjojnë fjalën e Ungjillit dhe besojnë" (Vep 15:7)
- "Pra ne predikojmë dhe kështu ju besuat" (1 Kor.15:11)
- "Fara" në shëmbëlltyrën e mbjellësit është fjala e Zotit (Lk.8:11); ndërsa në atë të sinapit është besimi (Lk.17:6), duke parë se besimi vjen nga pranimi i "fjalës së besimit" (Rom.10:8), "fjalës së besimit dhe doktrinës së mirë" (1 Tim.4:6), në një zemër që është e hapur ndaj besimit në Zotin dhe fjalën e Tij (Gal.2:2 kra. Heb.4:2)
- Apostulli Gjon thotë për historinë e shkruar të jetës së Zotit tonë se "ai thotë e vërtetë (d.m.th. të vërtetën) që ju të besoni"

(Gjon19:35). Dhe kështu fjala e Zotit është quajtur “e vërteta” (Gjon.17:17) – që ne të besojmë.

1.2 Personaliteti i Zotit

Është një temë magjike, e lavdishme e Biblës që Zoti është zbuluar si një person i vërtetë i prekshëm me qenie trupore. Është gjithashtu një parim themelor i Kristianizmit që jezusi është Bir i Perëndisë. Në qoftë se Zoti nuk është një qenie trupore, atëherë është e pamundur që Ai të ketë një Bir që ishte “shëmbëlltyra e *personit* të Tij”. (Heb.1:3). Për më tepër, bëhet e vështirë të zhvillosh një marrëdhënie vetjake të gjallë me ‘Zotin’ në qoftë se ‘Zoti’ është vetëm një koncept në mendjen tonë, një tufë e shpirtit diku lart në zbrazëtinë e hapësirës. Është tragjike që shumica e feve kanë këtë koncept ireal, të paprekshëm të Zotit.

Zoti duke qenë kaq pafundësisht më madhështor se ne, është e kuptueshme që besimi i shumë njerëzve frenohet në premtimet e qarta që ne do të shikojmë Zotin si përfundim. Izraelit i mungoi besimi për të parë “formën” e Zotit. (Gjon. 5:37), duke tregur qartë që Ai ka një formë të vërtetë. Besim i tillë vjen nga njohja e Zotit dhe besimi në fjalën e Tij:

"Lum ata që janë të pastër në zemër: sepse ata do ta shohin Perëndinë (Mat.5:8).

"Shërbetorët e Tij (e Zotit) do t'i shërbejnë: dhe ata do të shohin fytyrën e tij; dhe emri i tij (emri i Zotit - Zbu.3:12) do të jetë mbi ballin e tyre (Zbu. 22:3,4).

Shpresë kaq e mrekullueshme, në qoftë se ne vërtet e besojmë, do të ketë një ndikim të thellë praktik mbi jetët tona:

"Kërkoni paqe me të gjithë dhe shenjtërim, pa të cilin askush nuk do ta shohë Perëndinë" (Heb.12:14).

Ne nuk duhet të betohemi, sepse "ai që betohet për qiellin, betohet për fronin e Perëndisë dhe për atë që është ulur mbi të" (Mat. 23:22). Kjo nuk ka kuptim nëse Zoti nuk është një qenie trupore.

"Ne do ta shohim atë siç është (manifesti në Krisht). Dhe kushdo që e ka këtë shpresë në vete, le ta pastrojë veten siç është i pastër ai" (1 Gjon.3:2,3).

Në këtë jetë kuptimi ynë mbi Atin Hyjnor është shumë i paplotë, por ne mund të shikojmë përpara, përmes errësirës së mbytur të kësaj jete, për të takuar Atë më në fund. Të parit Atë fizikisht pa dyshim do të përkojë me kuptimin tonë më të madh për Të. Kështu nga thellësitë absolute të vuajtjeve njerëzore, Jobi mundi të gjente gëzim në marrëdhënien krejtësisht vetjake me Perëndinë, të cilën ai do ta përjetonte tërësisht në ditën e fundit:

"Megjithëse pasi krimbat e lëkurës sime (d.m.th. vdekja) të shkatërrojnë këtë trup, në mishin tim do të shoh Perëndinë: të cilin do ta shoh vetë, sytë e mi do ta sodisin dhe asnjë tjetër" (Job 19:26,27).

Dhe apostulli Pal e thirri nga një jetë tjetër me dhimbje dhe trazirë:
"Tani ne shihemi përmes një xhami të errët; por atëhere ballë për ballë"
(1Kor.13:12).

Një kuptim i drejtë i Zotit është çelësi i hapjes së shumë zonave të tjera jetësore të doktrinës Biblike. Por ashtu si një gënjeshtër të çon në një gënjeshtër tjetër, ashtu edhe kuptimi falso mbi Zotin errëson tërësinë e së vërtetës që ofrojnë Shkrimet. Nëse ju mendoni që kjo pjesë është bindëse, ose pjesërisht bindëse, ngrihet pyetja: 'E njeh vërtet Zotin ti?' tani do të zbulojmë më tej mësimet e Biblës rreth Tij.

1.3 Emri dhe karakteri i Perëndisë

Në qoftë se ka Zot, është e arsyeshme të mendosh që Ai do të ketë përgatitur mënyrën për të na treguar për veten e Tij. Ne besojmë që Bibla është zbulimi i Zotit ndaj njeriut dhe se në të ne shikojmë karakterin e Perëndisë të shpalosur. Ja pse fjala e Zotit është përshkruar si "fara" e Tij, 1 Pje.1:23) sepse nëse bashkëvepron me mendjen tonë, brenda nesh krijohet një krijesë e re që ka karakteristikat e Zotit (Jak 1:18; 2 Kor.5:17). Prandaj sa më shumë të zbatojmë fjalën e Zotit dhe të përvetësojmë mësimet aq më tepër ne do të bëhemi "të ngjashëm me shëmbëlltyrën e birit të Tij" (Rom.8:29) që ishte në karakter shëmbëlltyra e përkryer e Zotit (Kol.1:15). Në këtë shtrihet vlera e studimit të pjesëve historike të Biblës; ato janë plot me shembuj të veprimit të Zotit me njerëzit dhe kombet, gjithmonë duke shpalosur të njëjtat veti bazë.

Në Hebraisht shpesh emri i një personi pasqyron karakteret e tyre dhe/ose të dhëna për ta. Disa shembuj të qartë:

'Jezus'='Shpëtimtar' - sepse "ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre" (Mat.1:21).

'Abraham'='Atë i një shumice të madhe' - "se Unë të kam bërë atin e shumë kombeve" (Zan.17:5)

Prandaj pritet që emri dhe titujt e Zotit të na japin sa më shumë të dhëna për veten e Tij. Meqënëse ka shumë anë të karakterit dhe qëllimit të Perëndisë, Ai, në fakt, ka më tepër se një Emër. Studimi i emrit të Zotit është i këshillueshëm pas pagëzimit; admirimi i mëtejshëm i vetive të Zotit të shprehura në emrin e Tij është diçka që duhet të vazhdojë gjithë jetën tonë në Zotin. Ajo që pason është pra më tepër një parathënie.

Kur Moisiu donte një njohje më të thellë të Zotit për të forcuar besimin e tij gjatë një pjese shumë tronditëse të jetës së tij, një Ëngjell "shpalli emrin e Zotit: Zoti, Zoti, i mëshirshëm dhe i dhembshur, i ngadalshëm në zemërim, i pasur në besnikëri dhe mirësi, që përdor mëshirën për mijëra njerëz, që fal padrejtësinë, shkeljet dhe mëkatin dhe që nuk e lë të pandëshkuar fajtorin" (Ex.34:5-7).

Kjo është provë e qartë se emrat e Zotit pasqyrojnë vetitë e Tij. Zotërimi i tyre prej Tij vërteton që Zoti është një qenie vetore – s'ka kuptim të arsyetosh që një frymë e shpirtit të ketë këto veti të karakterit që gjithashtu mund të zhvillohen te ne njerëzit.

Zoti ka zgjedhur një emër të veçantë, sipas të cilit Ai dëshiron të njihet dhe mbahet mend prej popullit të tij; është një përmbledhje, një konspekt i qëllimit të tij me njerëzit.

Izraelitët ishin skllevër në Egjipt dhe kishin nevojë t'u kujtohej qëllimi i Zotit për ta. Moisiut iu tha t'u thoshte atyre Emrin e Zotit që kjo t'ë ndihmonte për t'i shtytur të largoheshin nga Egjipti dhe të fillonin udhëtimin drejt tokës së premtuar (krah. 1 Kor.10:1). Edhe ne duhet të kuptojmë parimet bazë në lidhje me Emrin e Zotit para se të pagëzohemi dhe të fillojmë udhëtimin tonë drejt Mbretërisë së Zotit.

Zoti i tha Izraelit që Emri i Tij është YAHWEH, që do me thënë "unë jam ai që jam" ose, e përkthyer më saktësisht, 'unë do të jem ai që do të jem' (Eks.3:13-15). Pastaj ky emër u shtri më tepër: "Zoti i tha akoma (d.m.th. më tej) Moisiut, Do t'u thuash kështu bijve të Izraelit, ZOTI (Yahweh) Perëndia i etërve tuaj, Perëndia i Abrahamit, Perëndia i Isakut dhe Perëndia i

Jakobit...ky është emri im përjetë dhe kujtimi im nga të gjithë brezat. (Eks.3:15).

Prandaj emri i plotë i Zotit është "ZOTI Perëndi".

Dhjata e Vjetër është shkruar kryesisht në Hebraisht dhe përkthimit tonë në Anglisht i mungojnë pashmangshmërisht shumë hollësira kur është fjala për përkthimin e fjalëve hebraishte për 'Zot'. Një nga fjalët e zakonshme hebraisht e përkthyer 'Zot' është 'Elohim', që do me thënë 'të plotfuqishmit'. "Kujtimi" i Zotit, Emri, sipas të cilit, Ai do që ta kujtojmë, është pra

YAHWEH ELOHIM

që do me thënë

AI QË DO TË SHPALOSET NË NJË GRUP TË PLOTFUQISHMISH.

Prandaj është qëllimi i Zotit të zbulojë karakterin e Tij dhe thelbin e Tij si një grup të madh njerëzish. Duke iu bindur fjalës së Tij ne mund të zhvillojmë disa nga vetitë e Zotit në veten tonë tani, që në një kuptim shumë të kufizuar Zoti të shpalosë vetveten e Tij në besimtarët e vërtetë në këtë jetë. Por Emri i Zotit është një profeci e kohërave të ardhshme kur toka do të mbushet me njerëz që janë si Ai, si në karakter ashtu edhe në natyrë (krah. 2 Pj.1:4). Në qoftë se ne duam të bashkëngjitemi me qëllimin e Zotit dhe të bëhemi si Zoti të mos vdesim më, duke jetuar përjetë në përkryerje të plotë morale, atëherë ne duhet ta bashkëngjitem veten tonë me Emrin e Tij. Për të bërë këtë ne duhet të pagëzohemi në Emër - d.m.th. Yahweh Elohim (Mat.28:19). Kjo gjithashtu na bën neve pasardhësit ("fara") e Abrahamit (Gal.3:27-29), të cilëve u ishte premtuar trashëgimia e përjetshme e tokës (Gen.17:8; Rom.4:13) - grupi i 'të plotfuqishmëve' ('Elohim') në të cilët profecia e Emrit të Zotit do të përmbushet. Kjo është shpjeguar më me hollësi në mësimin 3.4.

1.4 Ëngjëjt

Gjithçka që kemi shqyrtuar deri tani në këtë mësim është hartuar duke marrë parasysh Ëngjëjt:

- qenie vetjake, fizike
- mbartës të Emrit të Zotit

- rrugë, nëpërmjet të cilave Fryma e Zotit vepron për të zbatuar vullnetin e Tij
- në përputhje me karakterin dhe qëllimin e Tij
- dhe prandaj manifestojnë Atë.

Ne përmendëm në mësimin 1.3 se një nga fjalët hebraishte më të përhapura e përkthyer 'Zot' është 'Elohim', i cili në të vërtetë ka kuptimin 'të plotfuqishmit'; këta 'të plotfuqishëm', që mbartin Emrin e Zotit mund të quhen me efikasitet 'Zot', për shkak të bashkëngjitjes me Të. Keto qenie janë Ëngjëjt.

Historia e krijimit të botës te Zanafilla 1 na tregon që Zoti dha urdhëra të caktuara në lidhje me krijimin, "dhe u bë". Ëngjëjt ishin ata që i zbatuan këto urdhëra:

"Ëngjëjt, që shquhen në forcë, që bëjnë urdhërimet e Tij, duke iu bindur zërit të fjalës së Tij" (Psa.103:20).

Prandaj është e arsyeshmë të pranojmë se kur lexojmë që 'Zoti' krijoi botën, kjo vepër në fakt u krye nga Ëngjëjt. Edhe Jobi 38:4-7 të lë ta kuptosh këtë. Tani është koha të përmbledhim ngjarjet e krijimit si të thëna në Zan.1:

Dita 1 "Zoti tha, U bëftë drita: dhe drita u bë" (v.3)

Dita 2 "Zoti tha, Le të jetë një kupë qiellore (qielli, hapësira) mes ujrave që të ndajë ujrat (në tokë) nga ujrat (në retë)... dhe kështu u bë" (v.6,7)

Dita 3 "Zoti tha, ujrat që janë nën qiellin të mblidhen bashkë (duke formuar detet dhe oqeanet)...dhe të shfaqet toka; dhe kështu u bë" (v.9)

Dita 4 "Zoti tha, të ketë ndriçues ...në qiell...dhe kështu u bë (v.14,15)

Dita 5 "Zoti tha, të mbushen ujrat nga një numër i madh qeniesh të gjalla ...dhe të fluturojnë zogjtë...dhe Zoti krijoi çdo qenie të gjallë" (v.20,21) - d.m.th. "kështu u bë"

Dita 6 "Zoti tha, të prodhojë toka qenie të gjalla...gjitaret dhe zvarranikët...dhe kështu u bë" (v.24).

Njeriu u krijua në po atë ditë. "Zoti tha, ta bëjmë njeriun sipas shëmbëlltyrës sonë dhe në ngjasim me ne" (Gen.1:26). Ne e komentuar këtë varg në

mësimin 1.2. Tani ne duam të theksojmë që “Zoti” këtu nuk flet vetëm për Vetveten - "Ta bëjmë njeriun" tregon se Zoti flet për më tepër se një person. Fjala Hebraishte e përkthyer ‘Zot’ këtu është 'Elohim', me kuptimin 'Të plotfuqishmit', që flet për Ëngjëjt. Fakti që Ëngjëjt na krijuan neve sipas shëmbëlltyrës së tyre tregon që ata kanë të njëjtën pamje trupore si ne. Prandaj ata janë shumë të vërtetë, të prekshëm, qenie trupore, me të njëjtën natyrë si Zoti.

'Natyre' në këtë rast do të thotë diçka që dikush i ngjan thelbësisht për arsye të strukturës së tyre fizike. Ka dy ‘natyra’ në Bibël; nga vetë kuptimi i fjalës nuk është e mundur të kesh të dyja këto natyra në të njëjtën kohë.

Natyra e Zotit ('Natyra e Perëndisë')

Nuk mund të mëkatojë (e përkryer) (Rom.9:14;
6:23 kra. Psa.90:2; Mt.5:48; Jak 1:13)
Nuk mund të vdesë, d.m.th. i pavdekshëm (1
Tim.6:16)
Plot me fuqi dhe energji (Isa.40:28).

Kjo është natyra e Zotit dhe e Ëngjëjve dhe që iu dha Jezusit pas ringjalljes së tij (Vep.13:34; Zbu.1:18; Heb.1:3). Kjo është natyra që na është premtuar (Lk.20:35,36; 2 Pje.1:4; Isa.40:28 kra. v 31).

Natyra njerëzore

E tunduar të mëkatojë (Jak 1:13-15) nga një
mendje natyrale e korruptuar (Jer.17:9; Mr.7:21-
23)
I destinuar të vdesë d.m.th. i vdekshëm
(Rom.5:12,17;
1 Kor.15:22)
Me forcë shumë të kufizuar, të dyja, fizikisht
(Isa.40:30) dhe mendërisht (Jer.10:23).

Kjo është natyra që zotërojnë të gjithë njerëzit, të mirë dhe të këqij. Fundi i kësaj natyre është vdekje (Rom.6:23). Ishte natyra që Jezusi kishte gjatë jetës së tij të vdekshme (Heb.2:14-18; Rom.8:3; Gjo.2:25; Mr.10:18).

Fatkeqsisht fjala anglishte ‘natyrë’ është e turbullt: ne mund ta përdorim në një fjali si ‘Gjoni ka natyrë bujare – thjesht nuk është në natyrën e tij të jetë i

keq; po edhe mburret për makinën e tij që është në natyrën njerëzore, me sa duket'. Nuk do ta përdorim kështu fjalën 'natyrë' gjatë këtyre studimeve.

PARAQITJET ËNGJËLLORE

Ëngjëjt, duke qenë të natyrës së Zotit, duhet të jenë pa mëkate dhe rrjedhimisht, të paafte për të vdekur – duke qenë se mëkati sjell vdekje (Rom.6:23). Ata duhet të kenë një formë të drejtëpërdrejtë egzistence fizike. Për këtë arsye kur Ëngjëjt janë shfaqur në tokë ata janë dukur si njerëz të zakonshëm:

- Ëngjëjt erdhën te Abrahami për t'i folur fjalët e Perëndisë; ata janë përshkruar si "tre burra", të cilët në fillim Abrahami i trajtoi si qenie njerëzore, meqë kjo ishte pamja e tyre: "Oh, lini që të sjellin pak ujë që të mund të lani këmbët tuaja dhe çlodhuni nën këtë pemë" (Gen.18:4)

- Dy prej atyre Ëngjëjve shkuan te Loti në qytetin e Sodomës. Përsëri, ata u njohën si njerëz nga Loti dhe njerëzit e Sodomës. "Erdhën dy ëngjëj në Sodomë", të cilët Loti i ftoi të kalonin natën me të. Por njerëzit e Sodomës erdhën në shtëpinë e tij duke pyetur në mënyrë kërcënuese "Ku janë burrat që erdhën te ty sonte?" Loti iu lut, " mos u bëni asgjë atyre burrave". Shkrimi i frymëzuar gjithashtu i quan ata "burra": "Burrat (Ëngjëjt) zgjatën dorën" dhe e shpëtuan Lotin; "Dhe burrat i thanë Lotit... Zoti na ka dërguar ta shkatërrojmë" Sodom (Gen.19:1,5,8, 10,12, 13).

- Komenti i Dhjatës së Re mbi këto ngjarje vërteton që Ëngjëjt janë në formë njerëzish:"Mos harro të mikpresësh të huajin; se disa (p.sh. Abrahami dhe Loti) kanë mikpritur Ëngjëjt pa e ditur" (Heb.13:2).

- Jakobi u mund tërë natën me një të panjohur (Zan.32:24), i cili, na është thënë më vonë ishte një Ëngjëll (Ose.12:4).

- Dy burra me rroba të bardha ndriçuese ishin të pranishëm në ringjalljen (Lk.24:4) dhe shpërfytyrimin (Vep 1:10) e Jezusit. Këta ishin Ëngjëj pa dyshim.

- Shqyrto vështirësimin e "me masën e njeriut, që po përdorte Ëngjëlli" (Zbu.21:17).

ËNGJËJT NUK MËKATOJNË

Ëngjëjt duke qenë të natyrës së Zotit nuk mund të vdesin. Duke qenë se mëkati sjell vdekje, rrjedh që ata nuk mund të mëkatojnë. Fjalët fillestare në Greqisht dhe në Hebraisht të përkthyer 'Ëngjëll' do të thotë 'lajmëtar'; Ëngjëjt janë lajmëtarët ose shërbyesit e Zotit, të bindur ndaj Tij, prandaj është e pamundur të mendohet për ta të jenë mëkatarë. Kështu fjala greke 'aggelos', e cila përkthehet 'Ëngjëll' gjithashtu përkthehet 'lajmëtar', kur është fjala për qenie njerëzore - p.sh. Gjon pagëzori (Mt.11:10) dhe lajmëtarët e tij (Lk.7:24); lajmëtarët e Jezusit (Lk.9:52) dhe burrat që përgjuan në Jeriko (James 2:25). Sigurisht, është e mundur që 'ëngjëjt' në kuptimin e lajmëtarëve *njerëzorë* mund të mëkatojnë.

Pjesët e mëposhtme tregojnë qartë se të gjithë ëngjëjt (jo vetëm disa syresh!) janë nga natyra të bindur ndaj Zotit, dhe prandaj nuk mund të mëkatojnë:

"Zoti ka përgatitur fronin e Tij në qiejt; dhe mbretëria e Tij sundon mbi të gjithë (d.m.th. nuk mund të ketë kryengritje kundër Zotit në qiell). Bekoni Zotin, ju Ëngjëj, që shquheni në forcë, që bëni atë që thotë Ai, duke iu bindur zërit të fjalës së Tij. Bekoni ju Zotin, *të gjithë* ju ushtritë e Tij; ju ministrat e Tij, që zbatoni vullnetin e tij" (Psa103:19-21).

"Lavdëroni Atë, *të gjithë*, Ëngjëjt e Tij... ushtritë e Tij" (Psa148:2)

"Ëngjëjt... a nuk janë *të gjithë* shpirta shërbyes, të dërguar për të shërbyer për ta (besimtarët) që do të jenë trashëgimtarë të shpëtimit? (Heb. 1:13,14).

Përsëritja e fjalës " të gjithë" tregon se Ëngjëjt nuk janë të ndarë në dy grupe, një të mirë dhe një mëkatar. Rëndësia e të kuptuarit qartë natyrën e Ëngjëjve është se shpërblimi i besnikut është të ndajë natyrën e tyre: Ata që do të gjenden të denjë ... as martohen... as nuk mund të vdesin më: sepse ata janë si Ëngjëjt" (Lk.20:35,36). Ky është një kuptim i gjallë për t'u kapur. Ëngjëjt nuk mund të vdesin: "Vdekja... nuk i kap dot Ëngjëjt"(Heb 2:16 shënimet anësore) Në qoftë se Ëngjëjt mund të mëkatonin, atëherë ata që gjenden të denjë për shpërblim me kthimin e Krishtit, po ashtu do të jenë prapë në gjendje të mëkatojnë. Dhe duke qenë se mëkati sjell vdekje (Rom.6:23), ata, pra, nuk do të kenë jetë të përjetshme; në qoftë se ne kemi mundësi mëkatimi, ne kemi aftësinë të vdesim. Kështu të thuash që Ëngjëjt mund të mëkatojnë e bën premtimin e Zotit për jetë të përjetshme pa kuptim, duke qenë se shpërblimi ynë është të ndajmë natyrën e Ëngjëjve. Adresimi

ndaj "Ëngjëjve" (Luke 20:35,36) tregon se nuk ka ndarje të Ëngjëjve si të mirë ose mëkatarë; ka vetëm një kategori të Ëngjëjve.

Në qoftë se Ëngjëjt mund të mëkatojnë, atëhere Zoti mbetet i pafuqishëm të veprojë me drejtësi në jetët tona dhe punët e botës, dukë qenë se Ai ka deklaruar që Ai punon nëpërmjet Ëngjëjve të Tij (Ps.103:19-21). Ata janë 'shpirti i krijuar' nga Zoti në kuptimin që Ai i arrin të gjitha gjërat me shpirtin/fuqinë e Tij, duke vepruar nëpërmjet Ëngjëjve (Ps. 104:4). Të qenurit të pabindur ndaj Tij, pra, është një pamundësi. Kristiani duhet të lutet përditë që të vijë në tokë Mbretëria e Perëndisë, që vullneti i tij të përmbushet këtu siç bëhet tani në qiejt Mt. 6:10). Në qoftë se Ëngjëjve të Zotit do t'u duhej të konkuronin me Ëngjëjt mëkatarë në qiejt, atëhere vullneti i Tij nuk mund të zbatohet plotësisht atje, dhe prandaj e njëjta gjëdoje do të krijohet në Mbretërinë e ardhme të Perëndisë. Ta kalosh përjetësinë në një botë që do të ishte një fushë beteje e përhershme midis mëkatit dhe bindjes nuk është dhe aq e ardhme zemërdhënëse, por, sigurisht, nuk është ashtu.

POR...?

Shumë kisha "Kristiane" kanë idenë që Ëngjëjt mund të mëkatojnë dhe që Ëngjëjt mëkatarë janë përgjegjës për mëkatin dhe problemet në tokë. Ne do të diskutojmë keqkuptimin më plotësisht në mësimin 6. Tani për tani ne do të nxjerrim pikat e mëposhtme:-

- Është e mundur që ka qenë një krijim para të tonit, d.m.th. ai i dhënë në Zanafillën 1. Gjithashtu mendohet që Ëngjëjt e sotëm erdhën që të kenë njohuri të "së mirës dhe së keqes" (Zan. 3:5) nëpërmjet të qenurit në një situatë të ngjashme me atë të jetës sonë. Që disa nga qeniet që jetuan në atë erë mëkatuan, nuk lihet jashtë; po e gjitha kjo është një spekulim, të cilit mendjet e njerëzve duan t'i bëjnë vend. Bibla na thotë çfarë na duhet të dimë për gjendjen e sotme, që është se nuk ka Ëngjëj mëkatarë; të gjithë Ëngjëjt janë plotësisht të bindur ndaj Zotit.

- Nuk mund të ketë qenie mëkatore në Parajsë, duke parë që Zoti është "me sy tepër të pastër për të parë të keqen" (Heb.1:13). Në mënyrë të ngjashme, Psa.5:4,5 shpjegon: "te ti nuk mund të zërë vend e keqja. Ata që lëvdojnë veten nuk do të qendrojnë" në vendbanimin hyjnor të Zotit. Idea e të pasurit kryengritës ndaj Zotit në Parajsë nga Ëngjëj mëkatarë e kundërshton përshtypjen e dhënë nga këto pjesë.

- Fjala greke e përkthyer "Ëngjëll" do të thotë "lajmëtar" dhe mund t'u drejtohet qenieve njerëzore, siç e kemi treguar. "Lajmëtarë" të tillë, sigurisht, mund të mëkatojnë.
- Që ka qenie të këqia, mëkatore, mbi të cilat ngarkohen të gjitha anët negative të jetës, është një nga besimet më të përhapura në paganizëm. Në të njëjtën mënyrë kanë hyrë idetë pagane lidhur me Krishtëlindjet në atë që mbahet për 'Kristianizëm', kështu që, edhe ata kanë këto nocione pagane.
- Ka vetëm një dorë pjesësh biblike që mund të keqkuptohen për të mbështetur këtë ide të të pasurit tani ëngjëj mëkatarë. Këto janë shfrytëzuar në "Në kërkim të Shejtanit", të dhëna nga botuesit. Pjesë të tilla nuk mund të lejohet të kundërshtojnë mësimet e panumërta të Biblës në kundërshtim me atë që është paraqitur.

MËSIMI 1: Pyetje

1. Çfarë do të ndihmojë më tepër të zhvillojë besimin tonë në Zotin?
 - a) Vajtja në kishë
 - b) Studim biblik me lutje
 - c) Bashkëbisedim me kristianë
 - d) Vështrim në natyrë

2. Cili nga të mëposhtmit është përkufizimi më i saktë i Zotit?
 - a) Thjesht një ide në mendjen tonë
 - b) Një copë fryme në atmosferë
 - c) Nuk ka Zot
 - d) Një person i vërtetë, i prekshëm

3. Është Zoti
 - a) Një bashkim
 - b) Një treshe
 - c) Shumë zotër në një
 - d) I pamundur ta përkufizosh në ndonjë mënyrë?

4. Çfarë do të thotë emri i Zotit 'Yahweh Elohim' ?
 - a) Ai që do të jetë
 - b) Ai që do të shpaloset në një grup të plotfuqishmish
 - c) Një i madh
 - d) Forcë

5. Çfarë do të thotë fjala 'Ëngjell' ?
 - a) Si njeri
 - b) I mbuluar me krahë
 - c) Lajmëtar
 - d) Ndimës

6. Mund të mëkatojnë Ëngjëjt?
 - a) Po
 - b) Jo

2.1 Fryma e Zotit: Përkufizim

Meqë Zoti është një qenie vetjake e vërtetë, që pra, ka ndjenja dhe emocione, pritet që Ai të ketë mënyra të ndarjes së dëshirave dhe ndjenjave të Tij me ne, fëmijët e Tij dhe të veprimit në jetët tona në një mënyrë që është në përputhje me karakterin e Tij. Zoti i bën të gjitha këto gjëra me anë të "frymës" së Tij. Në qoftë se ne duam të njohim Zotin dhe të kemi një marrëdhënie të gjallë me Të, ne kemi nevojë të dimë çfarë është kjo "fryma e Zotit" dhe si funksionon.

Nuk është e lehtë të përkufizosh saktësisht çfarë do të thotë fjala "fryma". Në qoftë se ju shkoni në një dasëm, për shembull, ju mund ta komentoni, "mbizotëronte vërtetë një frymë i mirë atje!" Me këtë ju kuptoni që atmosfera ishte e mirë, në një farë mënyre çdo gjë në lidhje me dasmën ishte e mirë; gjithkush ishte veshur mirë, ushqimi ishte i mirë, njerëzit flisnin mirë me njëri-tjetrin, nusja dukej e bukur, etj. Të gjitha këto gjëra të ndryshme formuan "frymën" e dasmës. Në ngjashmëri fryma e Zotit disi përmbledh çdo gjë rreth Tij. Fjala Hebraishte e përkthyer "fryma" në Dhjatën e Vjetër tekstualisht do me thënë "frymë" ose "fuqi"; kështu fryma e Zotit është "frymëmarrja" e Tij, thelbi vetë i Zotit, që pasqyron mendjen e Tij. Ne do të japim shembuj se si është përdorur fjala nga mendja ose prirja e dikujt në kapitullin 4.3 Që fryma nuk i referohet vetëm fuqisë lakuriqe të Zotit është e dukshme nga Rom. 15:19: "fuqia e frymës së Zotit".

Është mësim i zakonshëm i Biblës që ajo që njeriu mendon është e shprehur në veprimet e tij (Prov. 23:7; Mat.12:34); një pasqyrim i vogël mbi veprimet tona e vërteton këtë. Ne mendojmë diçka dhe pastaj e bëjmë. Në një shkallë shumë më të lavdishme, fryma e Zotit është e njëjtë; është fuqia nëpërmjet së cilës Ai shfaq thelbin e qenies së Tij, prirjen dhe qëllimin e Tij. Zoti mendon dhe prandaj ibën gjërat: "Ashtu siç e kam menduar ashtu do të jetë; dhe ashtu si kam vendosur, kështu ka për të ndodhur" (Isa. 14:24).

FUQIA E ZOTIT

Shumë pjesë e njehsojnë qartësisht frymën e Zotit me Fuqinë e Tij. Për të krijuar gjithësinë, "fryma e Zotit fluturonte mbi sipërfaqen e ujrave. Dhe Zoti tha, U bëftë drita: dhe drita u bë" (Zan. 1:2,3).

Fryma e Zotit ishte fuqia nëpërmjet së cilës të gjitha gjërat, p.sh. drita, u bënë. "Me frymën e Tij ka zbuluarur qiejt; dora e Tij ka krijuar gjarprin

dredharak" (Job 26:13). "Qiejt u bënë me anë të fjalës së Zotit; dhe tërë ushtria e tyre me anë të frymës së gojës së tij" (Psa. 33:6). Prandaj fryma e Zotit është përshkruar si:-

Fryma e Tij
Fjala e Tij
Dora e Tij.

Prandaj është fuqia e Tij nëpërmjet së cilës Ai arrin të gjitha gjërat. Kështu besuesit janë lindur përsëri me vullnetin e Zotit (Gjon. 1:13), që është me anë të frymës së Tij (Gjon. 3:3-5). Vullneti i Tij vihet në punë me anë të frymës së Tij. Duke folur për të gjithë krijimin e natyrës ne lexojmë, "Ti dërgon frymën tënde dhe ata krijoheh, kështu ti ripërtërin faqen e dheut" (Psa. 104:30). Kjo frymë/fuqi është gjithashtu mbështetësja e të gjitha gjërave si dhe thelbi i krijimit të tyre. Është e lehtë të mendosh që kjo jetë tragjike vazhdon me pengesa pa këtë ndërhyrje aktive të frymës së Zotit. Një profet tjetër ia kujtoi këtë Jobit, një njeri që u rraskapit nga kjo jetë: "Në qofë se Ai (Zoti) mbledh në vetvete Frymën e tij dhe frymën e tij; çdo mish do të shkatërrohej njëkohësisht dhe njeriu do të kthehej në pluhur" (Job 34:14,15).

Ne do të shikojmë në kapitullin 4.3 se fryma që na është dhënë dhe gjithë krijimi është mbështetësi i jetës sonë. Ne kemi "frymën e Frymës së jetës" brenda nesh (Zan. 7:22 A.V. mg.) që na është dhënë nga Zoti në lindje (Psa. 104:30; Zan. 2:7). Kjo e bën Atë "Zotin e frymëve të çdo mishi" (Num. 27:16 krah. Heb. 12:9). Sepse Zoti është forca e jetës që mbështet të gjithë krijimin, fryma e Tij është e pranishme kudo. Davidi e kuptoi se nëpërmjet frymës së Tij Zoti ishte vazhdimisht i pranishëm me të kudo që shkonte dhe nëpërmjet asaj fryme/fuqie Ai ishte i aftë të dinte çdo cep të mendjes dhe mendimeve të Davidit. Kështu fryma e Zotit është mënyra nëpërmjet së cilës Ai është i pranishëm kudo, edhe pse Ai personalisht ndodhet në Parajsë.

"Ti e di kur ulem dhe kur ngrihem, ti e kupton nga larg mendimin tim... Ku do të mund të shkoja larg Frymës tënde? Ose ku mund të ikja larg pranisë tënde? Nëse marr krahët e agimit dhe shkoj të banoj në skajet e detit; edhe atje... dora jote e djathtë (d.m.th. nëpërmjet frymës) do të më mbajë" (Psa. 139:2,7,9,10).

FRYMA E SHENJTË

Ne kemi parë se Fryma e Zotit është një koncept i gjerë për t'u kuptuar; është mendja dhe prirja e Tij dhe, gjithashtu, fuqia me anë të së cilës Ai vë në jetë veprimet e Tij. "Ashtu si mendon njeriu në zemër të tij, ashtu është ai" (Fja. 23:7); dhe ashtu Zoti është mendimet e Tij, në kuptimin që Ai është fryma e Tij (Gjon. 4:24), megjithatë kjo nuk do të thotë që Zoti nuk është vetvete. Për të na ndihmuar të kapërcejmë vështirësinë e të kuptuarit të kësaj gjerësie të frymës së Zotit, ne nganjëherë lexojmë rreth "Frymës së Shenjtë" të Tij.

Termi "Fryma e Shenjtë" gjendet pothuajse vetëm në Dhjatën e Re. Në A.V. (Versioni Amerikan) përdoret shpesh "Hija e Shenjtë", por gjithmoë duhet të përkthehet si "Fryma e Shenjtë", siç e bëjnë të qartë variantet moderne. Kjo është e njëjtë me shprehjet e Dhjatës së Vjetër "Fryma e Perëndisë" ose "Fryma e Zotit". Kjo është e qartë nga pjesët si Veprat 2, që flet për derdhjen e Frymës së Shenjtë mbi apostujt në ditën Pentakostit. Pjetri shpjegoi se kjo ishte një përmbushje e profecisë së Joelit, në të cilën përshkruhet derdhja e "Frymës sime (e Zotit)" (Vep 2:17). Përsëri, Lk.4:1 shkruan se Jezusi "duke qenë plot me frymën e Shenjtë" u kthye nga Jordani; më vonë në të njëjtin kapitull Jezusi flet për këtë si përmbushje e Isaias 61: "Fryma e Zotit Perëndi është mbi mua". Në të dyja rastet (dhe në shumë të tjerë) Fryma e Shenjtë është barazuar me termin e Dhjatës së Vjetër "Fryma e Zotit".

Vini re, gjithashtu, se si fryma e Shenjtë është paralelizuar me fuqinë e Zotit në pjesët e mëposhtme:

- "Hija e Shenjtë (Fryma) do të vijë mbi ty (Maria), dhe fuqia e më të Lartit do të të mbulojë" (Lk.1:35)
- "Fuqia e Frymës së Shenjtë...shenjave dhe mrekullive të fuqishme, nga fuqia e Frymës së Zotit" (Rom.15:13,19)
- "Ungjilli ynë (duke predikuar) erdhi...në fuqi dhe në Frymën e Shenjtë (1 The. 1:5).
- Për premtimin e Frymës së Shenjtë ndaj dishepujve u fol sikur ata po "visheshin me pushtet nga lart" (Lk. 24:49).
- Jezusi vetë kishte qenë "vajosur...me Frymën e Shenjtë dhe me fuqi" (Vep 10:38).

- Pali mund të mbështeste predikimin e tij me shfaqje të pamohueshme të fuqisë së Zotit: "Fjala ime dhe predikimi im ishin...në paraqitje të frymës dhe fuqisë" (1 Kor. 2:4).

2.2 FRYMËZIMI

Ne e kemi përkufizuar Frymën e Zotit si fuqinë, mendimet dhe prirjen e Tij, të cilat Ai i shpalos nëpërmjet veprimeve që fryma e Tij paraqet. Ne përmendëm në paragrafin e kaluar se si Fryma e Zotit u pa në punë të krijimi: "Me frymën e Tij ka zbukuruar qiajt" (Job 26:13) - fryma e Zotit fluturonte mbi sipërfaqen e ujrave për të sjellë krijimin e sotëm (Zan. 1:2). Për më tepër, ne gjithashtu lexuam se "me fjalën e Zotit" u bë bota (Psa. 33:6), siç është ilustruar nga tregimet e Zanafillës "Zoti tha" duheshin krijuar gjërat dhe ashtu u bë. Prandaj fryma e Zotit pasqyrohet shumë në fjalët e Tij – ashtu si fjalët tona shprehin mendimet dhe dëshirat tona të brendshme - "ne"-në e vërtetë – shumë saktësisht. Jezusi me zgjuarsit theksoi: "Ç'ka zemra (mendja) qet goja" (Mat. 12:34). Kështu sikur ne të kontrollonim fjalët tona, ne duhej së pari të punojmë me mendimet tona. Fjala e Zotit, atëherë, është një pasqyrim i frymës së Tij, ose i menimeve. Është kaq bekim i madh që ne i kemi të shkruara në Bibël fjalët e Zotit që të mund të kuptojmë frymën ose mendjen e Zotit. Zoti e arriti këtë mrekulli të shprehurit të frymës së Tij në fjalë të shkruara me anë të procesit të *FRYMËZIMIT*. Ky term bazohet mbi fjalën "fryma":-

FRYMË-ZIM.

"Frymë" do me thënë "frymë" ose frymëmarrje, "Frymëzim" do të thotë "marrje-fryme". Kjo do të thotë që fjalët që shkruan njerëzit nën "frymëzim" nga Zoti ishin fjalët e frymës së Zotit. Pali e shtyn Timoteun të mos e lërë familiaritetin e tij me Biblën ta bëjë të harrojë mrekullinë e faktit që janë fjalët e frymës së Zotit dhe, prandaj, na jep gjithçka na duhet për të pasur njohuri të vërtetë të Zotit:-

"Që nga fëmijëria i njeh Shkrimet e shenjta, të cilat mund të të bëjnë të ditur për shpëtimin, me anë të besimit që është në Krishtin Jezus. I gjithë Shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për

edukim me drejtësi: që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer (plotësisht) tërësisht i furnizuar ('tërësisht i pajisur', N.I.V. (Versioni i Ri Ndërkombëtar)) për çdo vepër të mirë, " (2 Tim. 3:15-17).

Nëse Shkrimi i frymëzuar mund të na japë një njohje kaq totale, atëherë nuk ka nevojë për ndonjë 'dritë të brendshme' të na tregojë të vërtetën për Zotin. Por sa herë flasim njerëzit për ndjenjat e tyre vetjake dhe përvojat si burim i njohjes së tyre ndaj Zotit! Në qoftë se një pranim në besim i fjalës së frymëzuar të Zotit është e mjaftueshme ta pajisë dikë krejtësisht në jetën Kristiane, nuk është nevoja për ndonjë fuqi tjetër të drejtësisë në jetët tona. Në qoftë se është një nevojë e tillë, atëherë fjala e Zotit nuk na ka pajisur krejtësisht, siç premton Pali. Të mbash Biblën në duar dhe të besosh që është vërtet Fjala e Frymës së Zotit, kërkon besim të madh. Izraelitët ishin mjaft të interesuar në atë që fjala e Zotit kishte për të thënë, siç janë shumë "Kristianë" sot. Ne të gjithë kemi nevojë të kthehemi te Heb. 4:2:-

"Neve si dhe atyre u ishte shpallur lajmi i mirë (Izraeli në shkretëtirë): po fjala e predikimit nuk u dha dobi fare, sepse nuk qe e bashkuar me besimin tek ata që e dëgjuan".

Në vend që të ngriheshin lart me besim të plotë në fuqinë e fjalës/frymës së Zotit që është dëgjuar, është shumë më tepër tërheqëse t'i bien shkurt në frymë: të arsyetojnë se një fuqi e drejtësisë papritur vjen mbi ne, e cila do të na bëjë të pranueshëm nga Zoti, në vend që të përjetojnë dhimbjen e të sjellit me vetëdije të jetëve tona para bindjes së fjalës së Zotit dhe, rrjedhimisht, duke e lënë frymën e Zotit të ndikojë me të vërtetë zemrat tona.

Kjo mungesë vullneti për të pranuar fuqi madhështore frymërore që është në fjalën e Zotit ka drejtuar shumë "Kristianë" tek pyetja nëse të gjitha Shkrimet janë të frymëzuara plotësisht nga Zoti. Ata kanë sugjeruar që shumë prej asaj që ne lexojmë në Bibël ishin thjesht variante vetjake të të parëve të urtë. Por Pjetri hedh poshtë efektivisht arsyetime kaq të leshta:-

"Ne e kemi edhe më të vërtetuar fjalën e profetëve dhe ju bëni mirë t'i kushtoni kujdes... mbi të gjitha ju duhet të kuptoni, (kjo është jetësore!) se asnjë profeci e Shkrimit nuk është objekt i interpretimeve të veçanta. Sepse asnjë profeci nuk ka ardhur nga vullneti i njeriut, por njerëzit e shenjtë të perëndisë kanë folur, të shtyrë nga Fryma e Shenjtë" (2 Pjetri 1:19-21 N.I.V.).

Ne duhet "mbi gjithçka" të besojmë se Bibla është e frymëzuar.

SHKRUESIT E BIBLËS

Një besim solid në frymëzimin total të Shkrimeve është, pra, jetësore; njerëzit që shkruan Biblën ishin pa kushte të shtyrë nga fryma, e cila i frymëzoi, që fjalët e tyre të mos ishin të tyre. Fjala e Zotit duke qenë e vërteta (Gjon. 17:17) dhe duke dhënë kritika dhe korregjime (2 Tim. 3:16,17), nuk është çudi që për shumë njerëz nuk është e mirëpritur – se e vërteta dhemb. Profeti Jeremia vuajti shumë kundërshtime se foli fjalët me të cilat Zoti e frymëzoi dhe kështu vendosi të mos rregjistrojë ose përhapë fjalët që iu dhanë. Por meqë shkrimi i Fjalës së Zotit është rezultat i vullnetit të Zotit dhe jo të dëshirës njerëzore, ai "u shty nga Fryma e Shenjtë", pra nuk pati rrugë tjetër në këtë çështje. "Jam bërë objekt talljesh çdo ditë; kushdo tallet me mua...Atëherë unë thashë, nuk do ta përmend më dhe nuk do të flas më në emër të tij. Por fjala e tij ishte në zemrën time si një zjarr flakërues, i mbyllur në kockat e mia, përpiqesha ta përmbaja po nuk mundesha" (Jer. 20:7,9).

Në qoftë se këta burra ishin të frymëzuar vetëm pjesërisht, ne nuk kemi mundësi njohjeje të Fjalës së vërtetë të frymës së Zotit. Në qoftë se ajo çka shkruan ishte vërtetë fjala e Zotit, atëherë i bie që të jenë rrokur krejtësisht nga Fryma e Zotit gjatë periudhës së frymëzimit – përndryshe prodhimi nuk do të kishte qenë fjala e Zotit në pastërti. Pranimi që Fjala e Zotit është krejtësisht e Tij, na jep më tepër arsye ta lexojmë dhe t'i bindemi. "Fjala jote është e pastër: prandaj shërbëtori yt e do" (Psa. 119:140).

Kështu pra librat e Biblës janë vepër e Zotit me anë të frymës së Tij, dhe jo literaturë e njerëzve. E vërteta e kësaj tregohet nga mënyra se si Dhjata e Re i referohet shkrimeve të Dhjatës së Vjetër:-

- Mat. 2:5 (Versioni i Rishikuar. mg.) flet se si "u shkrua nëpërmjet profetëve" - Zoti shkruante nëpërmjet tyre
- "Fryma e Shenjtë foli me gojën e Davidit..." (Vep 1:16; Ja si e citoi Pjetri nga Psalmet: krah. Heb. 3:7).

Autorët njerëzorë të Biblës ishin, pra, relativisht të parëndësishëm për Kristianët e hershëm; ishte fakti që fjalët e tyre ishin të frymëzuara nga Fryma e Zotit ajo që kishte rëndësi.

FUQIA E FJALËS SË ZOTIT

Fryma e Zotit, duke iu referuar jo vetëm mendjes/prirjes së Tij, por, gjithashtu, edhe fuqisë me të cilën Ai shpreh ato mendime, pritet që fjala e frymës së Tij të jetë jo vetëm një thënie nga mendja e Tij; ka edhe fuqi dinamike në atë fjalë.

Një vlerësim i vërtetë i kësaj fuqie duhet të na bëjë të etur për të; çdo lloj ndrojtje e shoqëruar me të duhet të kalohet duke ditur që bindja ndaj Fjalës së Zotit do të na japë fuqinë për të cilën kemi nevojë të shpejtojmë jashtë gjërave të vogla të kësaj jete, drejt shpëtimit. Sipas përvojës së shumtë në këtë, Pali shkroi:-

"Unë nuk kam turp nga Ungjilli (fjala) i Krishtit: sepse është fuqia e Zotit drejt shpëtimit" (Rom. 1:16).

Lluka 1:37 (V.R.) i bie të njëjtit avaz: "Asnjë fjalë e Zotit nuk do të jetë pa fuqi (frymë)".

Prandaj, studimi i Biblës dhe zbatimi i saj në jetën tonë është një proces dinamik. Është krejt palidhje me interpretimin e ftohtë akademik të teologëve dhe po ashtu me Kristianizmin që "I vjen mirë" të shumë kishave, ku citohen shkurtimisht pak pjesë, por nuk bëhet asnjë përpjekje për t'i kuptuar ose zbatuar ato. "Fjala e Zotit është e shpejtë (e gjallë) dhe e fuqishme"; "fjala e fuqisë së Tij (e Zotit)" (Heb. 4:12; 1:3). "Fjala e Zotit... vepron ndër ju që besoni" (1 Thes. 2:13). Përmes Fjalës, Zoti është aktivisht në punë në mendjet e besimtarëve të vërtetë, çdo orë të ditës.

Mesazhi bazë i Ungjillit, që ju po mësoni, është, pra, fuqia e vërtetë e Zotit; në qoftë se ju e lejoni, mund të punojë në zemrën tënde për të të ndryshuar ty në një fëmijë të Zotit, duke treguar frymën/mendjen e Zotit në njëfarë shkalle në këtë jetë, duke të përgatitur për ndryshimin në natyrën frymërore të Zotit, që do të vijë me kthimin e Krishtit (Pje.1:4). Predikimi i Palit ishte "në shpaltosjen e frymës dhe të fuqisë" (1 Kor. 2:4).

Ne jemi të rrethuar nga ata që kanë gjysmë besimi në Biblën si Fjala e Zotit, pavarësisht nga pretendimet e tyre për përkushtim ndaj Krishtit. Në ngjashmëri ata pretendojnë se besojnë tek Zoti dhe prapë nuk pranojnë dot që Ai është person i vërtetë. Duke mohuar frymëzimin total të Shkrimit dhe epërsinë e tij mbi ndjenjat dhe bindjet tona vetjake, ata mohojnë fuqinë e Zotit. Më vijnë në mendje fjalët e 2 Tim. 3:5 "të perëndishëm në dukje, por mohues të fuqisë së saj", d.m.th. fuqisë së fjalës së Ungjillit.

Bota tallet me besimin tonë të thellë ("Ti nuk beson vërtet ashtu, apo jo?!") dhe po ashtu ishte me atë të Palit dhe bandës së tij të predikuesve: "Predikimi i kryqit është marrëzi për ata që humbin; po për ne që shpëtohem është fuqia e Zotit" (1 Kor. 1:18).

Duke mbajtur këtë në mendje a nuk mundemi ne vallë ta mbajmë Biblën në duar me një masë rrespekti më të madhe dhe ta lexojmë me më tepër se kurrë dëshirë për ta kuptuar dhe iu bindur.

PRIRJA E NJERËZVE TË ZOTIT NDAJ FJALËS SË TIJ

Po të lexosh me ndjeshmëri historinë e Biblës, duket se shkruesit e saj jo vetëm e dinë që janë të frymëzuar, por trajtojnë edhe shkruesit e tjerë të Biblës si të frymëzuar. Zoti Jezus është i shquar në këtë. Kur Jezusi citonte nga Psalmet e Davidit, ai e hapte këtë me fjalët, "Davidi në frymë..." (Mt. 22:43), duke treguar njohjen e tij ndaj faktit që fjalët e Davidit ishin të frymëzuara. Jezusi, gjithashtu foli për "shkrimet" e Moisiut (Gjon. 5:45-47), duke treguar se ai besoi që Moisiu kishte shkruar pesë librat e parë të Biblës. Të ashtuquajturit Kristianët e 'kritikës më të lartë' kanë vënë në dyshim që Moisiu mund të shkruante, por prirja e Krishtit e kundërshton në mënyrë të qartë tentativën e tyre. Ai i quajti shkrimet e Moisiut "urdhërimet e Zotit" (Mark 7:8,9). I njëjti grup i dyshuesve të pandershëm pretendon që shumë nga Dhjata e Vjetër është mith, po Jezusi ose Pali kurrë nuk i trajtoi si të tilla. Jezusi foli për Mbretëreshën e Shebës si një fakt historik i pranuar (Mt. 12:42); ai nuk tha, 'Si thotë historia për Mbretëreshën e Shebës...'. Prirja e Apostujve ishte e njëjtë me atë të Zotit të tyre. Është përmbledhur nga Pjetri, i cili tha se përvoja e tij vetjake e dëgjimit të fjalëve të Krishtit me veshët e vet u eklipsua nga "fjala më e sigurt e profecisë" (2 Pet. 1:19-21). Pjetri besoi se letrat e Palit ishin "Shkrime" aq sa edhe "Shkrimet e tjera", një frazë e përdorur zakonisht për shkrimet e Dhjatës së Vjetër. Kështu Pjetri i pa letrat e Palit si po aq autoritare sa edhe Dhjatwn e Vjetër.

Ka shumë aludime tek Veprat e Apostujve, Letrat dhe Zbulesa ndaj Ungjillit (p.sh. krah. Vep. 13:51; Mt. 10:14), duke treguar jo vetëm se ata ishin të frymëzuar të gjithë nga e njëjta Frymë, por që historitë e Ungjillit u trajtuan si të frymëzuara nga shkruesit e Dhjatës së Re. Pali në 1 Tim. 5:18 citon të dy LiP. 25:4 (në Dhjatën e Vjetër) dhe Lk. 10:7 si "Shkrimi". Pali këmbëngul në atë që porositë e tij ishin nga Krishti, jo nga vetja e tij (Gal. 1:11,12; 1 Kor. 2:13; 11:23; 15:3). Kjo u njoh nga apostujt e tjerë; kështu Jakobi 4:5 citon fjalët e Palit të Gal. 5:17 si "Shkrimi".

Zoti "na ka folur" në Krisht; prandaj nuk ka nevojë për ndonjë zbulim të mëtejshëm (Heb. 1:2). Është e vëzhgueshme që Bibla aludon për shkrime të tjera të frymëzuara, të cilat sot nuk janë më (p.sh. libri i Jasherit, shkrimet e Nathanit, Elias, Palit ndaj Korinthit dhe Letra e tretë e Gjonit lë të kuptojë se Gjoni kishte shkruar një letër të paruahtur kishës, së cilës Diotrefesët refuzuan t'i binden). Pse nuk janë ruajtur këto shkrime për ne? Me sa duket sepse nuk kishin lidhje me ne. Prandaj ne mund të rrimë të qetë se Zoti ka ruajtur gjithçka që ka lidhje me ne.

Nganjëherë pretendohet se librat e Dhjatës së Re u pranuan gradualisht si të frymëzuara, por fakti që Apostujt i trajtuan shkrimet e njëri-tjetrit si të frymëzuara sigurisht që e mohon këtë. Egzistonte një dhunti mrekullie e Frymës për të provuar nëse letrat dhe fjalët që pretendonin të ishin të frymëzuara ishin në të vërtetë të tilla (1 Kor. 14:37; 1Gjon 4:1; Zbu. 2:2). Kjo do të thotë që letrat e frymëzuara u pranuan menjëherë si të frymëzuara. Në qoftë se kishte ndonjë përzgjedhje njerëzore të padrejtuar të asaj që ndodhte në Biblën tonë, atëherë libri nuk do kishte asnjë autoritet.

2.3 DHUNTITË E FRYMËS SË SHENJTË

Në kohëra të ndryshme në marrëdhëniet e Tij me njerëzit, Zoti ka caktuar përdorimin e fuqisë së Tij ("Frymën e Shenjtë") tek njerëzit. Megjithatë, kjo nuk ka qenë kurrë në formën e një "çeku të bardhë", si t'i aftësonte ata të bënin çfarë të dëshironin; gjithmonë përdorimi i kësaj Fryme të Shenjtë ka qenë për një qëllim të caktuar. Kur ishte përfunduar, dhuntia e Frymës së Shenjtë tërhiqej. Ne duhet të kujtojmë që Fryma e Zotit vepron në mënyrë që të paraprijë qëllimin që është në mendjen e Tij. Qëllimi i Tij shpesh lejon vuajtje afatshkurtra në jetët e njerëzve me qëllim që të realizojë qëllimin e Tij afat-gjatë (shih Kapitulli 6.1), kështu duhet të pritët që Fryma e Tij e Shenjtë të mos përdoret me domosdo për të ngritur vuajtjet njerëzore në këtë jetë. Çdo çlirim i tillë që arrin do të jetë për një qëllim më të lartë duke na shprehur mendjen e Zotit.

Kjo është në dallim të shquar midis prirjeve më të përhapura të Kristianëve ndaj Frymës së Shenjtë sot; të jepet përshtypja se besimi në Krisht ia vlen

për shkak të dobive fizike, p.sh. shërimi nga sëmundja, që supozohet të ta japë Fryma e Shenjtë. Kjo shpjegon pse në vende të vuajtura si Uganda ka pasur një shpërthim të dukshëm të njerëzve që pretendojnë se zotërojnë dhunti shëruese të frymës dhe, historikisht, pretendime të tilla shpesh kanë përkuar me kohët e nevojave të mëdha njerëzore. Kjo në vetvete vë në dyshim pretendimet e sotme të zotërimit të frymës; në qoftë se dikush kërkon përvojë që tejkalon hallet njerëzore të sotme, është e lehtë të pretendosh të kesh gjetur diçka që plotëson kushtin.

Shumë 'Kristianë' sot pretendojnë se zotërojnë dhunti të mrekullueshme të frymës, megjithatë, kur pyeten se cili është tamam qëllimi i tyre, duket një pasiguri të konsiderueshme. Zoti e ka dhënë gjithmonë frymën e Tij për të arritur detyra të veçanta të përcaktuara. Për shkak të kësaj, ata që me të vërtetë i zotërojnë dhuntitë e frymës e dinin me saktësi për çfarë duhej t'i përdornin dhe, prandaj, nuk arritën vetëm sukses të pjesshëm në përdorimin e tyre. Kjo dallon nga shumë dështime dhe kurime të pjesshme të provuara nga ata që pretendojnë të kenë dhuntitë shëruese të frymës sot.

Shembujt e mëposhtëm të gjithë tregojnë arsye dhe objektiva të veçanta pas dhënies së dhuntive frymore. Në asnjë nga këto raste nuk kishte ndonjë element subjektiv të shoqëruar me zotërimin e dhuntive dhe as zotëruesit e dhuntive nuk ishin në gjendje t'i përdornin ato sipas mendjes së tyre. Meqë ne po flasim për Frymën e Zotit, është e pakonceptueshme që njerëzit mund ta drejtonin përdorimin e saj, duke parë se u ishte dhënë për të kryer dëshira të caktuara të Zotit, dhe jo ato të njerëzve që kishin përdorimin e përkohshëm të saj (krah. Isa. 40:13).

- Në fillim të historisë së Izraelit, ata u urdhëruan të bënin një tendë të punuar me hollësi ("tabernakulli") në të cilën mund të mbaheshin altari dhe sendet e tjera të shenjta; u dhanë udhëzime të hollësishme se si të bëheshin të gjitha sendet që do të ishin të nevojshme për adhurimin e Zotit. Për të kryer këtë, Zoti u dha frymën e Tij burrave të caktuar. Ata ishin "të mbushur me frymën e diturisë, që ata të bëjnë rrobat e Aaronit..." etj. (Eks. 28:3).

- Një nga këta burra, Bezaleel, ishte "mbushur me frymën e Zotit, me dituri, me zgjuarsi, me njohuri dhe çdo shkathtësi, të...punojë në art dhe...për të gdhendur gurë...në çdo lloj punimesh" (Eks. 31: 3-5).

Num. 11:14-17 tregon se si fryma/fuqia dhënë Moisiut iu morr atij dhe iu dha pleqve të Izraelit, për t'i aftësuar të gjykonin me drejtësi hallet e njerëzve që të lehtësonin barrën e Moisiut. Menjëherë para vdekjes së Moisiut, dhuntia e frymës u kalua nga ai te Joshua që edhe ai të mund të udhëhiqte si duhej popullin e Zotit (LiP. 34:9).

- Nga koha që populli i Izraelit hyri në tokën e tij deri në mbretin e tyre të parë (Saul) ata qeveriseshin nga njerëz që quheshin gjyqtarë. Gjatë kësaj periudhe ata qenë shtypur shpesh nga armiqtë e tyre, por libri i Gjyqtarëve tregon se si fryma e Zotit erdhi mbi disa nga gjyqtarët që mrekullisht të çlironte Izraelin nga pushtuesit e tyre - Othniel (Gjy. 3:10), Gideon (Gjy. 6:34) dhe Jefthah (Gjy. 11:29) e ilustrojnë këtë.

- Një gjyqtari tjetër, Samson, iu dha fryma të vriste një luan (Gjy. 14:5,6); të vriste 30 burra (Gjy. 14:19) dhe të këpuste litarët, me të cilët e kishin lidhur (Gjy. 15: 14). "Frymë e Shenjtë" e tillë nuk ishte, e zotëruar nga Samson vazhdimisht – erdhi mbi të për të arritur gjërat e veçanta dhe pastaj iu tërhoq.

Nga kjo duhet të jetë e qartë që marrja e dhuntisë së përdorimit të Frymës së Zotit për një qëllim të veçantë nuk ishte

- Një garanci e shpëtimit
- Diçka që vazhdoi gjithë jetën e personit
- Një forcë e fshehtë brenda tyre
- Diçka e fituar nga ndonjë 'përvojë vetjake' e dalldisur.

Duhet thënë se ka shumë arsye të turbullta për dhuntinë e Frymës së Shenjtë. Njerëzit pretendojnë t'u ketë 'ardhur Fryma e Shenjtë' dhe në shumë Salla Ungjilli predikuesi josh me 'marrjen e dhuntive të frymës' ata që janë duke menduar 'të pranojnë Jezusin'. Por duhet shtruar pyetja, Cilat dhunti? Është e pakonceptueshme që njerëzit nuk e dinë saktësisht cilën dhunti zotërojnë. Samsonit iu dha dhuntia e frymës për të vlarë një luan (Gjy. 14:5,6); kur ishte përballë kafshës hakërryese ai do ta ketë ditur me saktësi për çfarë iu dha fryma. Nuk mund të ketë pasur dyshim në mendjen e tij. Kjo dallon ashiqare me ata që pretendojnë t'u jetë dhënë Fryma e

Shenjtë, por nuk mund të kryejnë një veprim të veçantë; as që e dinë cilën dhunti(të) supozohet që të kenë.

ARSYET PËR DHUNTITË NË SHEKULLIN E PARË

Urdhërimi i fundit i Krishtit ishte që apostujt të shkonin nëpër botë duke predikuar Ungjillin (Mark 16:15,16). Ata e bënë këtë, me temën e vdekjes së Krishtit dhe ringjalljen mbi të gjitha në lajmin e tyre. Por mbani mend që atëherë nuk ishte Dhjata e Re siç e njohim ne. Siç rrinin në tregje dhe sinagogat duke folur për këtë njeri, Jezusi i Nazaretit, tregimi i tyre mund të dukej dokrra - një karpentier nga Izraeli, që ishte i përkryer, që vdiq dhe pastaj u ringjall në përputhje të saktë me profecinë e Dhjatës së Vjetër dhe që tani u kërkonte të pagëzoheshin dhe të ndiqnin shembullin e Tij.

Në ato ditë, edhe burra të tjerë po përpiqeshin të zhvillonin ndjekje kultu. I duhej provuar botës në ndonjë mënyrë që lajmi i predikuar nga Kristianët ishte nga Zoti Vetë, dhe jo një filozofi e një grupi peshkatarësh nga Izraeli Verior.

Në ditët tona ne i drejtohem shënimeve të Dhjatës së Re mbi veprën dhe doktrinën e Jezusit që të provojmë që lajmi ynë është nga Zoti; por në ato ditë, përpara se të shkruhej dhe të jepej, Zoti lejoi predikuesit të përdornin Frymën e Tij të Shenjtë që të theksonin të vërtetën e asaj që thoshin. Kjo ishte arsya e veçantë për përdorimin e dhuntive në sytë e botës; mungesa e Dhjatës së Re të shkruar , gjithashtu duhet ta ketë bërë të vështirë rritjen në besim të grupeve të reja të besuesve. Problemet e panumërta praktike midis tyre nuk duhet të kenë pasur zgjidhje të qarta; do të kishte pasur vetëm pak mundësi që ata të rriteshin në besim në Krishtin. Kështu për këto arsye dhuntitë e Frymës së Shenjtë u dhanë për udhëzimin e besimtarëve të hershëm nëpërmjet lajmeve të frymëzuara, derisa u shkruan dhe u qarkulluan shënimet e Dhjatës së Re mbi këto lajme dhe mësimet e Jezusit.

Si gjithmonë, këto arsye për aprovimin e Frymës së Shenjtë u bënë më se të qarta:-

- "Kur ai (Jezusi) u ngjit lart (në qiejt), ai...u dha njerëzve dhuntitë (e frymës)... për përsosjen e shenjtorëve, për veprën e (predikimit) shërbimit, dhe për ndërtimin e trupit të Krishtit", d.m.th. besimtarët (Efe. 4:8,12).

- Kështu Pali u shkroi besuesve në Romë, "Unë dëshiroj fort t'ju shoh për t'ju komunikuar ndonjë dhunti frymërore, që të forcoheni" (Rom. 1:11).

Në lidhje me përdorimin e dhuntive për konfirmimin e përhapjes së Ungjillit, ne lexojmë:-

- "Ungjilli ynë nuk erdhi mbi ju vetëm me fjalë, por edhe në fuqi dhe në Frymën e Shenjtë dhe në shumë siguri" përmes punës së mrekullive (1 Thes. 1:5 kra. 1 Kor. 1: 5,6).

- Pali mund të fliste për "ato gjëra që Krishti ka bërë nëpërmjet meje, për t'i sjellë në dëgjësë johebrenjtë me fjalë dhe (mrekulli) vepër, me fuqi shenjash dhe çudirash, me fuqi të Frymës së Peëndisë" (Rom. 15:18,19)).

- Në lidhje me përhapësit e Ungjillit, ne lexojmë, "Zoti gjithashtu dëshmonte për të me anë shenjash dhe mrekullish dhe me vepra të ndryshme të fuqishme... dhuntitë e Frymës së Shenjtë" (Heb. 2:4).

- Një fushatë e përhapjes së Ungjillit në Qipro u mbështet nga mrekullitë, që "deputeti (qeveritari), kur ai pa çfarë u bë, besoi, i mrekulluar nga doktrina" (Vep. 13:12).

Kështu mrekullitë e bënë atë të respektonte vërtetë doktrinat që mësoheshin. Edhe në Ikon, "Zoti...i jepte dëshmi fjalës së hirit të tij dhe lejoi të bëheshin shenja dhe mrekulli" (Vep 14:3).

E gjitha kjo është përmbledhur nga komentet mbi bindjen e apostujve ndaj urdhërimit për të predikuar: "Ata dolën dhe predikuan kudo, Zoti bashkëvepronte me ta dhe e vërtetonte fjalën me shenjat që e shoqëronin" (Mark 16:20).

GJËRA TË CAKTUARA NË KOHË TË CAKTUARA

Këto dhunti të frymës u dhanë, pra, që të kryheshin gjëra të caktuara në kohë të caktuar. Kjo tregon sa gabim është të pretendosh që zotërimi i mrekullueshëm i dhuntisë është një përvojë e përhershme gjatë jetës së një personi. Apostujt, duke përfshirë Pjetrin, ishin "të mbushur me Frymën e Shenjtë" në festën e Pentakostit, shpejt pas ngritjes së Jezusit (Vep. 2:4).

Prandaj ata ishin në gjendje të flisnin në gjuhë të huaja që të fillonin predikimin e Ungjillit Kristian në një mënyrë spektakolare. Kur autoritetet u përpoqën t'i shtrëngonin me kërcënime, "Pjetri, i mbushur me Frymën e Shenjtë" ishte në gjendje t'u përgjigjej në mënyrë bindëse (Vep. 4:8). Me lirim e tyre nga burgu ata u aftësuan nga dhuntitë të vazhdonin predikimin- "ata ishin të gjithë të mbushur me frymën e shenjtë dhe folën fjalën e Zotit me çiltërsi" (Vep. 4:31).

Lexuesi vëzhgues do të dallojë që nuk thotë "ata, duke qenë tahmë plot me frymën", bënë këto gjëra. Ata u mbushën me frymën për të kryer gjëra të caktuara, por duhej të rimbusheshin për të arritur objektivin tjetër në planin e Zotit. Pali, në ngjashmëri, u "mbush me Frymën e Shenjtë" te pagëzimi i tij, por vite më vonë ai përsëri do të "mbushej me Frymën e Shenjtë" që të ndëshkonte me qorrim një burrë të lig (Vep. 9:17: 13:9).

Duke folur për dhuntitë e mrekullueshme, Pali shkroi se besimtarët e hershëm i zotëruan ato "në përputhje me masën e dhuntisë së Krishtit" (Ef 4:7). Fjala Greke për "masën" do të thotë "një pjesë ose shkallë e kufizuar" (Fjalorthi i Strong-ut). Vetëm Jezusi i kishte dhuntitë pa masë, d.m.th. me liri të plotë për t'i përdorur ato siç dëshironte Ai (Gjoni 3:34).

Ne tani do të përkufizojmë dhuntitë e frymës që duket të përmenden më tepër si të zotëruara në shekullin e parë.

DHUNTITË E FRYMËS NË SHEKULLIN E PARË

PROFECIA

Fjala Greke për 'profet' do të thotë dikush që para-thotë Fjalën e Zotit - d.m.th. çdo person i frymëzuar të flasë fjalët e Zotit, të cilat nganjëherë përfshinin parashikimin e ngjarjeve të së ardhmes (shih 2 Pjet. 1:19-21). Kështu "profetët" – ata me dhuntinë e profecisë – erdhën "nga Jeruzalemi në Antioki. Dhe atje u ngrit njëri prej tyre i quajtur Agab dhe nëpërmjet Frymës parathoshte se do të ndodhte në mbarë botën një zi e madhe buke: dhe kjo ndodhi më vonë në kohën e Klaud Cezarit. Atëherë dishepujt secili sipas mundësive të tij, vendosën t'u çojnë një ndihmë vëllezërve që banojnë në Judë" (Vep. 11:27-29). Kjo lloj profecie shumë e specifikuar, që kishte një përmbushje të qartë brenda pak viteve, mungon në ata që pretendojnë të kenë dhuntinë e profecisë; në të vërtetë, kisha e hershme ishte kaq e sigurtë që kjo dhunti vërtetë zotërohej midis tyre, saqë ata dhanë kohën dhe paratë

e tyre për të ndihmuar me vështirësinë që u parashikua. Pak shembuj të këtij lloji mund të gjenden në kishat e sotme të ashtu-quajtura 'të mbushura me frymë'.

SHËRIMI

Duke parë që apostujt përhapnin lajmin e mirë (Ungjillin) të ardhjes së Mbretërisë së Zotit të përkryerjes në tokë, ishte e përshtatëshme që ta vërtetonin lajmin e tyre duke bërë mrekulli që dha një shije parprake se si do të ishin ato kohë kur "sytë e të verbërit do të hapen dhe veshët e shurdhit do të jenë të pandalshme. Atëherë çalamani do të kërcejë..." (Isa. 35:5,6). Për më tepër mbi kushtet në mbretërinë e Zotit, shih kapitullin 5. Kur të vendoset Mbretëria e Zotit në tokë, premtime të tilla si këto nuk do të pëmbushen me gjysmë mase, dhe as do të ketë mëdyshje në është Mbretëria këtu apo jo. Prandaj vërtetimi mrekullor i Zotit mbi lajmin e asaj Mbretërie ishte në një formë përfundimtare, të përcaktuar që nuk mund të mohohet; për këtë arsye shumë nga shërimet e mrekullueshme të shfaqura nga besimtarët e hershëm ishin në publik të hapur.

Një shembull klasik shihet në shërimin që Pjetri i bën një lypësi çalaman që shtrihet çdo mëngjes te porta e tempullit. Vep. 3:2 përmend që ata e shtrinë atje ditë për ditë – që ai të ishte një pamje e njohur. I shëruar nga përdorimi i Pjetrit të dhuntisë së frymës, "me një të hopur u ngrit në këmbë dhe filloi të ecë dhe hyri me ta në tempull, duke ecur dhe duke u hedhur... Dhe të gjithë njerëzit e panë duke ecur dhe lavdëruar Zotin: dhe e njohën se ishte ai që rrinte ulur para derës së Bukur të tempullit: dhe u mbushën me habi dhe çudi për atë që i kishte ndodhur atij. Dhe ndërsa i çali që ishte shëruar rrinte pas Pjetrit...gjithë populli i çuditur rendi drejt tyre te portiku..." (Vep. 3:7-11).

Atëherë Pjetri menjëherë ia filloi një bisede të hapur mbi ringjalljen e Krishtit. Duke parur faktin e padiskutueshëm, e pakundërshtueshëm të shërimin të lypësit mu përpara tyre, ne mund të jemi të sigurtë që ata do t'i kenë marrë fjalët e Pjetrit për të Zotit. Porta e tempullit në "orën e lutjes" (Vep. 3:1) do të ketë qenë plotë me njerëz, si një mapo në mëngjesin e një dite të shtune. Zoti zgjodhi një vend të tillë që të vërtetonte përhapjen e fjalës së Tij me një mrekulli kaq të qartë. Po ashtu lexojmë në Veprat 5:12, se "dhe shumë shenja dhe mrekulli bëheshin në mes të popullit nëpërmjet duarve të apostujve". Shpalljet e zakonshme të bëra nga shëruesit e 'Pentakostit' dhe të tjerë si ata kapen pas gjërave që kanë ndodhur më tepër në kishat e kthinave se sa në rrugë dhe në praninë e 'besuesve' të mprehur

në frymën e pritjes për ndodhinë e një 'mrekullie' dhe jo përpara njerëzve të zakonshëm zemër-gur.

Le të thuhet se shkruesi i sotëm ka patur përvojë të konsiderueshme në diskutimin e këtyre çështjeve me pretendues të sotëm të zotërimit të frymës dhe gjithashtu në dëshminë e shumë pretendimeve të zotërimit të frymës. Prapë 'dëshmia ime vetjake' e të parit shumë 'shërime' të papërfunduara dhe më e shumta kurime të pjesëshme, nuk ka nevojë të jetë veçanërisht e detajuar; çdo anëtar i ndershëm i këtyre kishave do ta pranojë që shumë nga këto ngjasin. Në shumë raste ua kam vënë në dukje shokëve të mi Pentakostal, "unë nuk jam në kundërshtim me besimin që ju mund të keni këto fuqi të mëdha. Por Zoti gjithmonë e ka treguar qartë kush e ka fuqinë e Tij dhe kush nuk e ka; kështu që nuk është e paarsyeshme që të të kërkoj të ma demonstrosh faktin - dhe atëherë unë mund të jem më i hapur për të pranuar pozicionin tënd doktrinal, të cilin tani për tani nuk mund ta ballafaqoj me Shkrimin". Kurrë nuk më është dhënë një demonstrim i frymës dhe i fuqisë".

Në dallim me prirjen time, Izraelitët orthodoks të shekullit të parë kishin mendje të mbyllura ndaj mundësisë që Kristianët zotëronin dhuntitë mrekulluese të frymës së Zotit. Megjithatë edhe ata duhej ta pranonin, "Ky njeri bën shumë mrekulli" (Gjon 11:47) dhe, "sepse në të vërtetë është bërë një mrekulli e dukshme...u është njohur të gjithë banorëve të Jeruzalemit; dhe ne nuk mund ta mohojmë" (Vep. 4:16). Po ashtu ata që dëgjuan Apostujt të flasin në gjuhë ishin "hutuar" (Vep. 2:6). Nuk ndodh e njëjta gjë sot në përgjigje të belbëzimit Pentakostal. Fakti që njerëzit me prirje më të mira ndaj 'Pentakosteve' moderne mund të mohojnë me arsye që ata vërtetë bëjnë mrekulli, sigurisht është një pikë me peshë në këtë debat. Në qoftë se vetëm një mrekulli u botua në gazetë nëpër Jeruzalem, a nuk është e arsyeshme të sugjerohet se sikur të bëhej një mrekulli e vërtetë në Sheshin Trafalgar të Londrës ose në Parkun e Nairobit Nyaharuru, atëherë do të kishte njohje në të gjithë botën se dhuntitë e frymës mrekullibërëse të Zotit zotërohen edhe sot.

'Shërimet' Pentakostale janë më tepër rezultat i kushtëzimit emocional dhe psikologjik, se sa veprim direkt i frymës së Zotit. Në dallim, Pjetri ishte i aftë t'i përdorte dhuntitë e vërteta të mrekullive për të shëruar njerëzit siç ishin shtrirë në rrugë (Vep. 5:15); Dhuntitë mrekulluese të Palit u dëshmuuan nga një Qeveritar mosbesues (Vep. 13:12,13), si edhe nga shumë paganë që banonin në qytetin e Listrës (Vep. 14:8-13). Siç kërkohej nga vetë natyra e dhuntive të frymës, këto gjëra bëheshin në publik të hapur dhe në asnjë

mënyrë nuk mund të vihej në dyshim me ndonjë shpjegim tjetër, përveçse të pranohej që ishte fuqia e Zotit e shpalosur haptas nga Shërbyesit e Tij. Efekti i një prej mrekullive shëruese të Krishtit ishte i ngjashëm "Ata ishin të gjithë të habitur (ata që e panë) dhe lavdëruan Zotin, duke thënë, Ne kurrë nuk e kemi parë në këtë mënyrë" (Mk. 2:12).

GJUHËT

Apostujt, peshkatarë të vrazhdë siç ishin disa prej tyre, iu dha detyra e madhe të shkonin nëpër botë, duke predikuar Ungjillin (Mk. 16:15,16). Ndoshta reagimi i tyre i parë ishte, "Po unë nuk di gjuhët!" Për ta nuk ishte as çështja, "Unë nuk isha dhe aq mirë me gjuhët në shkollë", sepse ata nuk kishin shkollë. Ishte e shkruar gjithandej "që ata ishin burra të pamësuar dhe të paditur" (Vep. 4:13) kur ishte fjala për atë lloj gjëje. Dhe edhe për predikuesit më të shkolluar (p.sh. Pali), hendeku i gjuhës ishte i tmerrshëm. Kur bëheshin këmbime, mbështetja që do të nevojitnin në njëri-tjetrin për ngritjen e tyre intelektuale (në mungesë të Dhjatës së Re të shkruar) do të thoshte që pa kuptuar gjuhën e njëri-tjetrit ishte një problem i madh.

Për të kapërcyer këtë, iu miratua dhuntia e foljes së gjuhëve të huaja ("gjuhët") dhe aftësia për të kuptuar ata. Është e dukshme që ka kundërshtim të qartë midis këtij këndvështrimi të "gjuhëve" dhe atij të Kristianëve të 'ri-lindur', të cilët i përshkruajnë mermëritjet historike të tingujve të tyre të pakuptueshme si "gjuhët". Kjo ngatërresë mund të qartësohet duke treguar se përkufizimi Biblik i "gjuhëve" është "gjuhë të huaja".

Në festën çifute të Pentakosti, menjëherë pas ngritjes së Krishtit në qiejt, Apostujt "u mbushën me Frymën e Shenjtë, dhe filluan të flisnin me gjuhët e tjera...Turmat u mblodhën (përsëri, një shpalosje publike e dhuntive!) dhe ishin të hutuara, sepse secili nga ata i dëgjoji të flisnin gjuhën e vet. Dhe të gjithë habiteshin dhe mrekulloheshin, dhe i thoshin njëri-tjetrit, Ja, a nuk janë të gjithë galileas këta që flasin? Dhe si vallë secili nga ne i dëgjon të flasin në gjuhën (e njëjta fjalë Greke përkthyer 'gjuhët') tonë amtare? Partët dhe Medët...ne i dëgjojmë të flasin në gjuhët tona... Dhe të gjithë habiteshin" (Vep. 2:4-12). Është e vështirë të besosh theksimi i dyfishtë në mahnitjen e njerëzve dhe mrekullimin e tyre do të kishte qenë i nevojshëm po të kishin dëgjuar vetëm llapa-llapa të folur nga ata që pretendojnë të kenë dhuntinë sot; kjo i jep shkas sarkazmës së hollë ose indiferencës më tepër se sa mahnitjes dhe bindjes nga të kuptuarit e fjalëve të folura, të cilat u përjetuan në Vep. 2.

Përveç paralelizmit të qartë midis "gjuhës(anatomike)" dhe "gjuhës (së folur)" në Vep. 2:4-11, "gjuhët (anatomike)" përdoret shumë qartësisht për të kuptuar "gjuhët (e folura)" në pjesë të tjera të Dhjatës së Re; fjalia "popujt, dhe kombet, dhe gjuhët" përdoret pesë herë në Zbulesën për të folur për të gjithë popujt e planetit tokë (Zbu. 7:9; 10:11; 11:9; 13:7; 17:15). Fjala Greke për "gjuhët" përmendet në variantin Grek të Dhjatës së Vjetër (e quajtur 'Septuagint') në kuptimin e gjuhëve (shih Zan. 10:5; LiP. 28:49; Dan. 1:4).

1 Kor. 14 është një listë urdhërimesh lidhur me përdorimin e dhuntisë së gjuhëve; v 21citon Isa. 28:11 se si kjo dhunti do të përdorej kundër Çifutëve: "Në ligj është shkruar, Me njerëz të gjuhëve dhe buzëve të tjera do t'i flas këtij populli...". Is. 28:11 kryesisht e ka fjalën për pushtuesit e Izraelit që u flasin Çifutëve në gjuhët ("gjuhët (anatomike)") që ata nuk do t'i dinin. Paralelizmi midis "gjuhëve" dhe "buzëve" tregon se "gjuhët" ishin gjuhët e huja. Ka shumë tregues të tjerë në 1 Kor. 14 që "gjuhët" i referohet gjuhëve të huaja. Ky kapitull është kritika e frymëzuar e Palit mbi abuzimin e dhuntive që po ndodhnin në kishën e hershme dhe si i tillë hedh shumë dritë mbi natyrën e dhuntive të gjuhëve dhe profecisë. Ne tani do të përpiqemi të bëjmë një koment të shkurtër mbi të. Vargu 37 është një varg kyç:-

"Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror le të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit."

Në qoftë se dikush pretendon të ketë dhunti frymërore, ai duhet të pranojë, pra, se urdhërimet paraardhëse mbi përdorimin e dhuntive janë të frymëzuara nga Zoti. Gjithkush që nuk u bindet atyre urdhërimeve është, pra, duke pranuar hapur se ata mendojnë se është me vend të fyejë fjalët e frymëzuara të Zotit. Vargjet 11-17:-

"Pra, në qoftë se unë nuk e marr vesh kuptimin e zërit, do të jem si një i huaj për atë që flet dhe ai që flet do të jetë një i huaj për mua.

Kështu edhe ju, mbasi doni fort të keni dhunti frymërore, kërkoni që t'i keni të bollshme për ndërtimin e kishës.

Prandaj ai që flet një gjuhë tjetër, le të lutet që të mund ta interpretojë.

Sepse në qoftë se unë lutem në një gjuhë tjetër, fryma im lutet, por mendja ime është e pafrytshme.

Po atëhere? Do të lutem me frymën, por do ta bëj edhe me mendjen: do të këndoj me frymën, por do të këndoj edhe me mendjen.

Me fjalë të tjera, në qoftë se ti e lavdëron Perëndinë me frymën, ai që zë vendin e profanit, si do të thotë Amen për falerimin tënd, kur nuk merr vesh ç'po thua?

Sepse ti edhe mund të falenderosh mirë, por tjetri nuk ndërtohet."

Të flasësh në një gjuhë, të cilën të pranishmit në shërbim nuk e kuptojnë, është, pra, pakuptim. Përdorimi i të folurit 'llapa-llapa' përjashtohet – sepse si mund të thuhet një Amen i vërtetë në fund të "lutjes" së përbërë nga xhebraishte që nuk mund të kuptohet? Kujto që ajo "Amen" do të thotë "Ashtu qoftë", d.m.th. 'unë jam krejtësisht dakort me çfarë është thënë në këtë lutje'. Të folurit në gjuhë që nuk është e kuptueshme nga vëllezërit e tu nuk i ndriçon ata, thotë Pali.

Vargu 19:-

"Por në asamble parapëlqej të them pesë fjalë me mënjurinë time për mësimin e të tjerëve se dhjetë mijë fjalë në gjuhë tjetër."

Kjo është troç. Një fjali e shkurtër mbi Krishtin në Anglisht më ka më tepër dobi se sa orë të tëra predikimi në një gjuhë të huaj – ose 'llapa-llapa'.

Vargu 22:-

"Prandaj gjuhët janë një shenjë jo për ata që besojnë, por për jobesimtarë: kurse profecia nuk është për jobesimtarë, po për besimtarë."

Përdorimi i gjuhëve ishte, pra, për të dalë dhe predikuar Ungjillin. Megjithatë shumica e pretendimeve mbi zotërimin e 'gjuhëve' ndodh në

grupe 'besimtarësh' ose (me sa duket) në përvojën e tyre vetjake, kur janë vetëm. Ka një mungesë kronike shembujsh të njerëzve të tillë të aftë për të folur mrekullisht në gjuhë të huaja për të përhapur Ungjillin. Në fillimet e 1990-tës u hap dera e rastit për të predikuar Krishtin në Evropën Lindore, por kishat e ashtuquajtura 'evangelike' iu desh ta shpërndanin literaturën e tyre në Anglisht, për shkak të hendekut të gjuhës! Sigurisht dhuntia e gjuhëve duhej të ishte përdorur nëse zotërohej?

Vargu 23:-

"Pra, në qoftë se e gjithë kisha është mbledhur në një vend, të gjithë flasin gjuhëra dhe hyjnë profanët ose jobesimtarët, a nuk do të thonë se ju kanë dalë mendtë?"

Tamam kështu ka ndodhur. Muslimanët dhe paganët janë tallur me sjelljen e çuditëshme të atyre që shpallin dhuntinë e gjuhëve nëpër Afrikën Perëndimore. Edhe një Kristian me mend në kokë, po të shikonte një nga këto mbledhjet Pentakostale, do të tundohej të mendonte që anëtarët kanë lajthitur.

Vargu 27:-

"Nëse ndonjë flet në gjuhë tjetër, le të bëhet kjo nga dy a më të shumtën tre vetë dhe njeri pas tjetrit dhe një le të përkthejë."

Vetëm dy ose tre vetë nevojiteshin të flisnin në gjuhët gjatë një shërbimi. Është vështirë të mendosh që të jenë më tepër se tre gjuhë të ndryshme të folura nga dëgjuesit. Shërbimi shumë shpejt do të humbiste të gjithë koherencën nëse çdo fjali e folësit do të përkthehej më tepër se dy herë. Sikur dhuntia e gjuhëve do të zotërohej në një mbledhje në Londrën Qendrore, e ndjekur nga anglezë, me disa turistë francezë dhe gjermanë, folësi mund të fillonte:-

Pastori: *Good evening.*(Mirë mbrëma)

Folësi i gjuhës së parë: *Bon soir* (Frengjisht)

Folësi i gjuhës së dytë: *Guten abend* (Gjermanisht).

Por natyrisht ata duhet të flasin me radhë njeri pas tjetrit. Do të dilte ngatërrim prej tyre nga të folurit në të njëjtën kohë, dhe, për shkak të natyrës thellësisht emocionale të 'të folurit të sotëm në gjuhët', dukuria ndodh nga gojë e shumë njerëzve në të njëjtën kohë. Unë kam vëzhguar që sa fillon një person, të tjerët ndikohen menjëherë të bëjnë po ashtu.

Dhuntia e gjuhëve duhet të jetë përdorur shpesh në lidhje me atë të profecisë, kështu që një lajm i frymëzuar nga Zoti të mund të paraflitej (me dhuntinë e profecisë) në një gjuhë të huaj ndaj folësit (me dhuntinë e gjuhëve). Një shembull i përdorimit të tillë të të dyja dhuntive mund të gjendet në Vep. 19:6. Megjithatë, në qoftë se në një mbledhje në Londër e ndjekur nga anglezë dhe shumë vizitorë francezë, folësi foli në frengjisht, Anglezët “nuk do të ndriqoheshin”. Prandaj duhej të ishte e pranishme dhuntia e përkthimit të gjuhëve (ose gjuhëve), që të gjithë të mund të kuptojnë – në shembullin tonë, e përkthimit nga Frengjishtja në Anglisht. Në ngjashmëri, në qoftë se një folës frëng do të bënte një pyetje, folësi nuk do të ishte në gjendje ta kuptonte pa ndihmë, edhe pse ai ka dhuntinë e të folurit frëngjisht pa e ditur atë vetë. Prandaj dhuntia e përkthimit duhej e pranishme për ndihmë në këtë.

Pa praninë e dikujt me dhuntinë e përkthimit, kur nevojitej, dhuntia e gjuhës nuk do të përdorej: ...njëri le të përkthejë. Po në qoftë se nuk ka përkthyes, le të heshtë në kishë" (1 Kor. 14:27,28). Fakti që shumë pretendues modernë të 'gjuhëve' flasin në 'gjuhë' që nuk mund të kuptohen nga asnjë dhe pa përkthyes, është sigurisht një rast mosbindjeje të hapur ndaj këtyre urdhërimeve.

Vargjet 32,33:-

"Frymërat e profetëve u nënshtrohen profetëve.
Sepse Perëndia nuk është Perëndi trazimi, por
paqtimi, si në të gjitha kishat e shenjtorëve."

Zotërimi i Frymës së Shenjtë, pra, nuk duhet të shoqërohet me një përvojë që nxjerr një person jashtë sferës së ndërgjegjes normale; fryma i nënshtrohet kontrollit të përdoruesit, e nuk është një forcë, së cilës ata i nënshtrohen për të vepruar pa vetëdije. Shpesh pretendohet gabimisht që demonët ose 'frymërat e këqia' zotërojnë 'të pashpëtuarin' (shih Kapitullin 6.3), kurse Fryma e Shenjtë mbush besimtarët. Por fuqia e frymës për të cilën bën fjalë 1 Kor. 14:32 i nënshtrohet zotëruesit për qëllim të caktuar; nuk ishte një forcë gjallëruese e së mirës kundër forcës së keqe të natyrës njerëzore. Përveç kësaj, ne kemi treguar më parë që këto fuqi të Frymës së Shenjtë erdhën mbi apostujt në kohë të caktuara për të kryer gjëra të caktuara dhe jo që të ishin të pranishme me ta gjithmonë.

Vargu 34

"Gratë tuaja të heshtin në kishë: sepse nuk u lejohet të flasin, por duhet të nënshtrihen sikurse thotë edhe ligji."

Në këtë kuptim të përdorimit të dhuntive të frymës, shtrohet në mënyrë të pamohueshme çështja që, një grua, nuk duhet t'i përdorë gjatë shërbimit në kishë. Pritet mospërfillje e plotë për këtë, në qoftë se dukuria e sotme e të folurit në 'llapa-llapa' është e shpjgueshme në terma të eksitimit emocional të kalura nga një person në një tjetër në grup dëgjuesish. Gratë, fëmijët – në të vërtetë kushdo me një mendje të hapur – mund të ndikohet nga stimuj të tillë dhe prandaj lëshojnë mërmëritjet histerike, të cilat njihen si 'gjuhët'.

Spikatja e grave në të ashtuquajturën 'folje në gjuhë' dhe 'profeci' në kishat moderne nuk mund të ballafaqohet me urdhëresën e qartë të këtij vargu. Kundërshtimi qesharak, nga e keqja, që Pali urrente gratë, dërrmohet disa vargje më poshtë: "Në qoftë se dikush mendon se është profet ose frymëror le të njohë se ato që po ju shkruaj janë urdhërime të Zotit" (1 Kor. 14:37) - jo Pali vetë.

2.4 Tërheqja e Dhuntive

Dhuntitë mrekulluse të Frymës së Zotit do të përdoren prapë nga besuesit për të ndryshuar këtë botë të sotme në mbretërinë e Perëndisë pas kthimit të Krishtit. Prandaj dhuntitë janë quajtur "fuqitë e botës (kohës) së ardhme" (Heb. 6:4,5); dhe Joel 2:26-29 përshkruan një derdhje të madhe të dhuntive të frymës pas pendimit të Izraelit. Vetë fakti që këto dhunti do t'u jepen besimtarëve me kthimin e Krishtit është provë e mjaftueshme që ato nuk zotërohen tani – duke parë që çdo Kristiani me sy të hapur ndaj Shkrimeve dhe ngjarjeve të botës, kthimi i Zotit sigurisht duhet të vijë së shpejti (shih Shtojca 3)

Ka profeci Biblike të qarta që dikur, ndërmjet shekullit të parë, kur zotëroheshin dhuntitë, dhe ardhjes së dytë, dhuntitë do të tëhiqeshin:-

"profecitë shfuqizohen; gjuhët pushojnë; dhe (dhuntia e) njohuria, do të shfuqizohet. Sepse ne njohim pjesërisht dhe profetizojmë pjesërisht. Por kur të vijë përsosmëria, atëherë ajo që është e pjesëshme do të shfuqizohet (1 Kor. 13:8-10). Dhuntitë janë "të përkohshme" (G.N.B.).

Dhuntitë e frymës të zotëruara në shekullin e parë duhej të tërhiqeshin "kur të vijë përsosmëria". Kjo nuk mund të jetë ardhja e dytë e Krishtit, duke parë që në atë kohë dhuntitë do të jepen prapë. Fjala Greke e përkthyer "e përkryer" fjalë për fjalë do të thotë 'ajo që është e plotë ose e kryer'; nuk është e thënë të ketë kuptimin e diçkaje pa mëkate.

Kjo gjë e plotë do të zëvendësonte njohurinë e pjesëshme, të cilën Kristianët e hershëm e kishin si rezultat i dhuntisë së profecisë. Kujto që profecia ishte dhuntia e parafoljes së fjalëve të frymëzuara të Zotit; rregjistrimi me shkrim i fjalëve të tilla formon Biblën.

Në shekullin e parë, një besimtar i zakonshëm do të ketë njohur vetëm një fraksion të Dhjatës së Re siç e njohim ne. Ai do të ketë dëgjuar ca fjalë profecie nga pleqtë e kishës së tij rreth çështjeve praktike të ndryshme; ai do të ketë ditur një përmbledhje të jetës së Jezusit dhe mund të ketë dëgjuar të lexohen një ose dy letra të Palit. Por sa u përfundua dhe u qarkullua historia e shkruar e fjalëve të profecisë, nuk pati më nevojë të zotërohej dhuntia e profecisë. Ajo që ishte përfunduar dhe, e cila rrjedhimisht zëvendësoi shërbimin e dhuntive të frymës, ishte pra Dhjata e Re e përfunduar:-

"I gjithë shkrimi është i frymëzuar nga Perëndia dhe është i dobishëm për mësim, bindje, ndreqje dhe për edukim me drejtësi: që njeriu i Perëndisë të jetë i përkryer (i plotë)" (2 Tim. 3:16,17).

Ajo që e bën të përkryer ose të plotë është "I gjithë shkrimi"; kështu sa u shkrua dhe u frymëzua "gjithë shkrimi", "përsosmëria" kishte ardhur dhe dhuntitë mrekulluese ishin tërhequr.

Efesianët 4:8-14 tani plotësojnë vendet bosh për të përfunduar mirë rebusin zigzag:-

"Kur ai (Jezusi) u ngjit lart (në parajsë), ai ...u dha dhunti (në frymë) njerëzve...për ndërtimin e trupit të Krishtit: derisa të arrijmë të gjithë te uniteti i besimit (d.m.th. një besim) dhe të njohjes së Birit të Perëndisë, te një njeri i përsosur... që të mos jemi më foshnja, të lëkundur dhe të transportuar nga çdo erë doktrine."

Dhuntitë e shekullit të parë do të jepeshin derisa të arrihej njeriu i përsosur ose i matur dhe 2 Tim. 3:16,17 thotë se "njeriu i Zotit (është) i përsosur" duke pranuar udhëheqjen e "gjithë shkrimit". Kol. 1:28 gjithashtu mëson se 'përsosja' vjen nga përgjigja ndaj Fjalës së Zotit. Sa të zotërohet i gjithë Shkrimi, nuk ka më ndonjë arsye të vërtetë për t'u hutuar nga shumë doktrina të ofruara nga kisha të ndryshme. Ka vetëm një Bibël dhe meqenëse "Fjala jote është e vërteta" (Gjon 17:17), nëpërmjet studimit të faqeve të saj ne mund të gjejmë "unitetin e besimit", i njëjti besim për të cilin flet Efe. 4:13. Prandaj kristianët e vërtetë e kanë arritur zotërimin e atij besimi; në këtë kuptim ata janë të përsosur ("të përkryer") si rezultat i "përsosmërisë" ose plotësisë – Fjala e përfunduar e shkruar e Zotit.

Si përfundim, vini re se si Efe. 4:14 krahason të qëniet nën shërbimin e dhuntive mrekulluese, me foshnjërinë në frymë; dhe, në përmbajtjen e profecizmit, se si dhuntitë mrekulluese duheshin marrë mbrapsht. 1 Kor. 13:11 thotë të njetën gjë. Prandaj të bësh kaq zhurmë mbi zotërimin e dhuntive të frymës nuk është shenjë e pjekurisë në frymë. Përparimi që do të bëjë tani çdo lexues i këtyre fjalëve është drejt një vlerësimi më të thellë të Fjalës së shkruar të Zotit, për t'u ngazëllyer në përsosmërinë e zbulimit bazë ndaj nesh nga Zoti të Vetvetes nëpërmjet saj dhe për t'iu përgjigjur me bindje të nënshtruar.

KAPITULLI 2: Pyetjet

1. Cilat nga të mëposhtmet është kuptimi i fjalës 'Frymë'?
 - a) Fuqia
 - b) E shenjtë
 - c) Fryma
 - d) Pluhur

2. Çfarë është Fryma e Shenjtë?
 - a) Një person
 - b) Fuqi
 - c) Fuqia e Zotit
 - d) Pjesë e një tresheje.

3. Si u shkrua Bibla?
 - a) Burrat shkruan idetë e tyre
 - b) Burrat shkruan atë që ata menduan se tha Zoti
 - c) Njëpërmjet frymëzimit të burrave, me anë të Frymës së Zotit
 - d) Ca ishin të frymëzuara, ca jo.

4. Cilat prej të mëposhtmeve ishin arsytet që u dhanë dhuntitë e Frymës?
 - a) Për të mbështetur predikimin gojor të Ungjillit
 - b) Për të zhvilluar kishën e hershme
 - c) Për të detyruar njerëzit të ishin të drejtë
 - d) Për të ruajtur apostujt nga vështirësitë vetjake.

5. Nga ku mund ta mësojmë të vërtetën e Zotit?
 - a) Pjesërisht nga Bibla, pjesërisht nga të menduarit tonë
 - b) Nga Fryma e Shenjtë duke na i thënë gjërat drejtpërdrejtë, veçmas nga leximi i Biblës
 - c) Vetëm nga Bibla
 - d) Nga priftërinj/shërbyes fetarë.

3.1 Premtimet e Zotit: Parathënie

Deri tani në studimin tonë ne kemi arritur një kuptim të gjerë se kush është Zoti dhe si punon Ai. Duke bërë kështu ne kemi sqaruar një numër

keqkuptimesh të zakonshme rreth këtyre gjërave. Tani ne duam të shikojmë në mënyrë më pozitive në gjërat që Zoti ka "premtuar atyre që e duan atë" (Jak 1:12; 2:5) duke mbajtur urdhërimet e Tij (Gjo. 14:15).

Premtimet e Zotit në Dhjatën e Vjetër janë ato që përbëjnë shpresën e vërtetë kristiane. Kur ishte para gjyqit për jetën e tij, Pali foli mbi shpërblimin e ardhshëm, për të cilin ai ishte përgatitur t'i humbiste të gjitha: "Dhe tani ndodhem para gjyqit për shpresën e shpëtimit që u ka bërë Perëndia etërve tanë...për këtë shpresë...unë jam akuzuar" Vep. 26:6,7). Ai kishte shpenzuar shumë nga jeta e tij duke predikuar "lajme të gëzuara (Ungjillin), se si premtimin që iu bë të parëve, Zoti e përmbushi... duke ringjallur Jezusin" (Vep. 13:32,33). Pali shpjegoi se besimi në ato premtime dha shpresë në ringjalljen prej të vdekurish (Vep. 26:6-8 krahu. 23:8), njohuri në ardhjen e dytë të Jezusit, në gjykimin dhe të ardhjes së mbretërisë së Zotit (Vep. 24:25; 28:20,31).

E gjithë kjo mbyl mithin që Dhjata e Vjetër është thjesht një histori e Izraelit endacak, që nuk flet për jetën e përjetshme. Perëndia nuk e vendosi papritur 2,000 vjet më parë të na japë jetën e përjetshme nëpërmjet Jezusit. Ai qëllim ishte me të që nga fillimi:-

"Shpresën e jetës së përjetshme, të cilën Zoti, që nuk gënjen, e premtoi para të gjitha kohërave; dhe që në kohë të caktuara e shfaqti fjalën (në lidhje me të) e tij me anë të predikimit " (Tit. 1:2,3).

"Atë jetë të përjetshme, që ishte pranë Atit dhe na u shfaq neve " (1 Gjo. 1:2).

Duke parë që qëllimi i Zotit për dhënien e jetës së përjetshme njerëzve të tij ishte me të që nga fillimi, zor të besosh që Ai nuk do ta përmendte gjatë 4,000 vjetëve të marrëdhënies së Tij me njeriun e rregjistruar në Dhjatën e Vjetër. Në fakt, Dhjata e Vjetër është plot me profeci dhe premtime, të cilat japin më tepër hollësi në këtë shpresë që Zoti e ka përgatitur për njerëzit e Tij. Prandaj kuptimi i premtimeve të Zotit ndaj etërve Judenj është jetësor për shpëtimin tonë: aq shumë, sa Pali ua kujtoi besimtarëve në Efes që përpara se t'i dinin këto gjëra, ata" ishin pa Krisht, duke qenë të huaj në qytetërinë e Izraelit dhe të huaj për besëlidhjen e premtimit, pa pasur shpresë dhe duke qenë pa Perëndi në botë (Efe. 2:12) – megjithëse padyshim ata kishin menduar se besimet e tyre pagane të mëparshme u dhanë ca shpresë dhe njohuri mbi Zotin. Po ky është serioziteti i mosnjohjes premtimet e Zotit

në Dhjatën e Vjetër – në fakt "pa pasur shpresë dhe pa perëndi në botë". Kujto se si Pali e përkufizoi shpresën Kristiane si "shpresën e premtimit që Zoti u dha etërve tanë (Judenj)" (Vep. 26:6).

Është për të ardhur keq që pak kisha e vënë theksin në këto pjesë të Dhjatës së Vjetër, ku në fakt duhej. "Kristianizmi" është shndërruar në fe të bazuar në Dhjatën e Re – dhe edhe atëhere tentojnë të përdorin vetëm pak vargje prej saj. Jezusi e vë theksin qartë dhe si duhet:-

"Nëse ata nuk e dëgjojnë Moisiun (d.m.th. pesë librat e parë të Biblës që shkroi ai) dhe profetët, nuk do të binden edhe nëse dikush ringjallet prej të vdekurish. (Lk. 16:31).

Mendja natyrore mund të arsyetojë që besimi në ringjalljen e Jezusit është i mjaftueshëm (krah. Lk. 16:30), por Jezusi tha se pa një kuptim solid të Dhjatës së Vjetër, kjo nuk do të jetë plotësisht e mundshme.

Shembja e besimit të dishepujve pas kryqëzimit u quajt nga Jezusi mungesë vëmendjes së kujdesshmë të tyre ndaj Dhjatës së Vjetër:-

"Ai u tha atyre, O budallenj dhe zemërngathët për të besuar (si duhet) gjithçka që kanë thënë profetët: por a nuk duhej që Krishti të vuajë gjëra të tilla që të hyjë kështu në lavdinë e tij? Dhe, duke zënë fill nga Moisiu dhe nga gjithë profetët, ai u shpjegoi atyre në të gjitha Shkrimet gjërat që i takonin atij. " (Lk. 24:25-27).

Vini re theksin e Tij se si e gjithë Dhjata e Vjetër foli për Të. Nuk ishte se dishepujt nuk i kishin lexuar kurrë ose dëgjuar fjalët e Dhjatës së Vjetër, por ata nuk i kishin kuptuar si duhet ato dhe prandaj nuk mund t'i besonin me të vërtetë. Kështu që një kuptim i drejtë i Fjalës së Zotit, në vend të thjeshtë, leximit të saj, është i nevojshëm për të zhvilluar besim të vërtetë. Judenj të ishin fanatikë në leximin e Dhjatës së Vjetër (Vep. 15:21), por meqë nuk e kuptonin lidhjen e saj me gjërat e Jezusit dhe Ungjillit të Tij, s'para e besonin vërtet, dhe kështu Jezusi u tha:-

"në qoftë se ju do t'i kishit besuar Moisiut, do të më besonit edhe mua: sepse ai ka shkruar për mua.

Po në qoftë se ju nuk u besoni shkrimeve të tij, si do t'u besoni fjalëve të mia?" (Gjo. 5:46,47).

Pavarësisht nga gjithë leximi i tye i Biblës, ata thjesht nuk e kuptonin lajmin e vërtetë për Jezusin, megjithëse u pëlqente të besonin se ishin të sigurtë për shpëtimin e tyre. Jezusi duhej t'u thoshte:-

"Ju hetoni Shkrimet (d.m.th. si duhet - krah. Vep. 17:11); sepse mendoni (jeni të sigurt) të keni nëpërmjet tyre jetë të përjetshme:dhe ato janë këto që dëshmojnë për mua " (Gjo. 5:39).

Dhe kështu mund të ndodhë me shumë njerëz që kanë njohje sipërfaqësore të disa prej ngjarjeve dhe mësimave të Dhjatës së Vjetër: është vetëm njohuri që ata e kanë kapur rastësisht. Lajmi i mrekullueshëm i Krishtit dhe Ungjilli i Mbretërisë së Perëndisë akoma u shket. Është qëllimi i këtij kapitulli t'ju nxjerrë jashtë kësaj pozite duke iu treguar kuptimin e vërtetë të premtimeve kryesore të Dhjatës së Vjetër:-

- **Në kopshtin e Edenit**
- **Noeut**
- **Abrahamit**
- **Davidit**

Të dhënat mbi ta gjenden në pesë librat e parë të Biblës (Zanafila- Ligji I Përtërirë), të cilët u shkruan nga Moisiu dhe në profetët e Dhjatës së Vjetër. Të gjithë elementët e Ungjillit Kristian gjenden këtu. Pali shpjegoi se predikimi i tij mbi këtë Ungjill tha "duke mos thënë tjetër përveç atyre që profetët dhe Moisiu thanë se duhet të ndodhnin, domethënë që Krishti duhej të vuante dhe që, duke qenë i pari i ringjallur prej së vdekurish, duhej t'i shpallte dritën popullit dhe johebrenjve" (Vep. 26:22,23), dhe në ditët e tij të fundit mesazhi mbeti e njëjtë: "ai (Pali) shtjellonte dhe u dëshmonte atyre mbretërinë e Perëndisë...me anë të ligjit të Moisiut dhe të profetëve, që nga mëngjesi e deri në mbrëmje" (Vep. 28:23).

Shpresa e Palit, që kristiani suprem, duhet të jetë shpresa që na shtyn edhe neve; siç ishte drita e lavdishme në fund të tunelit të jetës së tij, ashtu duhet të jetë për çdo kristian serioz. Të ndezur me këtë shtytje, ne tani mund të "hetojmë Shkrimet".

3.2 Premtimi në Eden

Historia prekëse e rënies së njeriut përshkruhet në Zanafillën, Kapitulli 3. Gjarpri u mallkua për shtrembërimin e fjalës së Zotit dhe tundimin e Evës që të mos i bindej. Burri dhe gruaja u ndëshkuan për mosbindjen e tyre. Por një rreze shprese vjen në këtë pamje të errët kur Zoti i thotë gjarprit:-

"Unë do të shtie armiqsi (urrejtje, kundërshtim) midis teje dhe gruas, midis farës sate dhe farës së saj; ajo (fara e saj) do të shtypë kokën tënde dhe ti do të plagosësh thembrën e farës së saj" (Zan. 3:15).

Ky varg është shumë i përqendruar; ne duhet të ndajmë me kujdes gjërat e përfshira. Një "farë" do të thotë një pasardhës ose fëmijë, por gjithashtu mund të nënkuptojë njerëzit e shoqëruar me "farën" e veçantë. Ne do të shohim më vonë se "fara" e Abrahamit ishte Jezusi (Gal. 3:16), por që nëse jemi "në" Jezusin me pagëzim, atëherë edhe ne jemi fara (Gal. 3:27-29). Kjo fjala "farë" po ashtu i referohet idesë së spermit (1 Pje. 1:23); kështu që një farë e vërtetë do të ketë vetitë e atit të vet.

Fara e gjarprit, pra, duhet t'i referohet asaj që ka ngjashmëri familjare me gjarprin:-

- shtrembërimin e Fjalës së Zotit
- gënjeshtren
- tërheqjen e të tjerëve drejt mëkatit

Ne do të shohim në Kapitullin 6 që s'është një person që e bën këtë, po që brenda nesh është

- "njeriu ynë i vjetër" prej mishi (Rom. 6:6)
- "njeriu prej natyre" (1 Kor. 2:14)
- "njeriu i vjetër i korruptuar, sipas joshjeve mashtruese" (Efe. 4:22)
- "njeriu i vjetër me veprat e veta" (Kol. 3:9).

Ky "njeri" i mëkatit brenda nesh është "djalli" Biblik, fara e gjarprit.

Fara e gruas duhej të ishte një person i caktuar - "ti (fara e gjarprit) do të plagosësh thembrën e *tij*" (Zan. 3:15). Ky person do ta shtypte farën e

gjarprit për fare, d.m.th. mëkatën - "do të shtypë kokën tënde". Të godasësh një gjarpër në kokë është vdekjeprurëse- duke qenë se truri i tij është në kokën e tij. I vetmi person që është kandidat i mundshëm për farën e gruas duhet të jetë Zoti Jezus:-

Jezu Krishti që e prishi (me anë të kryqit) vdekjen (dhe rrjedhimisht fuqinë e mëkatit - Rom. 6:23), dhe nxori në dritë jetën dhe pavdeksinë me anë të Ungjillit " (2 Tim. 1:10).

"Perëndia duke dërguar Birin e Vet në shëmbëllim mishi mëkatar, edhe për mëkat, e dënoi mëkatën në mish", d.m.th. djallin Biblik, farën e gjarprit (Rom. 8:3).

Jezusi "u shfaq për të hequr mëkatet tona"(1 Gjo. 3:5).

"Ti do t'i vësh emrin Jezus (që do të thotë "Shpëtimtar"): sepse ai do të shpëtojë popullin e tij nga mëkatet e tyre " (Mt. 1:21).

Jezus ishte tamam "i bërë nga gruaja" (Gal. 4:4) si djali i Marisë, edhe pse Zoti ishte babai i tij. Kështu edhe në këtë kuptim, ai ishte fara e gruas, megjithëse dhënë nga Zoti në një mënyrë që asnjë burrë nuk ka qenë. Kjo farë e gruas do të plagosej përkohësisht nga mëkati, fara e gjarprit – "ti do të plagosësh thembrën e tij" (Zan. 3:15). Një kafshim gjarpri në thembër zakonisht është një plagë e përkoshme, në krahasim me goditjen e gjarprit në kokë. Shumë shprehje figurative kanë rrënjë Biblike "bjeri kokës" (d.m.th. ndalo krejtësisht ose jepi fund diçkaje) ndoshta bazohet në këtë profeci të Jezusit që qëllon gjarprin në kokë.

Mallkimi i mëkatit, farës së gjarprit, u bë fillimisht nëpërmjet sakrificës së Krishtit në kryq – vini re se si vargjet e cituara më sipër flasin për fitoren e Krishtit mbi mëkatën në kohën e shkuar. Plaga e përkohshme në thembër e vuajtur nga Jezusi është, pra, në lidhje me vdekjen e tij për tre ditë. Ringjallja e tij provoi që kjo ishte vetëm një plagë e përkohshme, në krahasim me goditjen për vdekje që Ai i dha mëkatit. Është interesante që shënimet historike jo-Biblike tregojnë se viktimave të kryqëzimit u gozhdohej thembra te ristela e drurit. Kështu Jezusi u "plagos në thembër" përmes vdekjes së Tij. Is.53:4,5 e përshkruan Krishtin si të 'plagosur' nga Perëndia përmes vdekjes në kryq. Kjo aludon hapur për profecinë e Zan.3:15 që Krishti do të plagosej nga fara e gjarprit. Megjithëse, si

përfundim Zoti veprimi përmes së keqes që Krishti përballoi, Ai përshkruhet këtu sikur bën plagosjen (Is.53:10), nëpërmjet kontrollit të forcës së ligë që plagosi Birin e Tij. Dhe kështu Zoti vepron edhe nëpërmjet përvojave të së keqes të secilit prej fëmijve të Tij.

KONFLIKTI SOT

Por në mendjen tuaj mund të jetë ngritur pyetja: "Në qoftë se Jezusi e ka shkatërruar mëkatit dhe vdekjen (farën e gjarprit), pse janë ato gjëra akoma të pranishme sot?" Përgjigja është se Jezusi shkatërroi në kryq fuqinë e mëkatit në vetvehte: profecia e Zan. 3:15 është kryesisht rreth konfliktit midis Jezusit dhe mëkatit. Tani kjo do të thotë që meqë Ai na ka ftuar ta ndajmë fitoren e Tij së bashku edhe ne mund të mundim mëkatit dhe vdekjen. Ata që nuk janë ftuar ta ndajnë fitoren e Tij, ose mohojnë ofertën, sigurisht do të vazhdojnë të provojnë mëkatit dhe fitoren. Edhe pse mëkati dhe fitorja përjetohej edhe nga besimtarët e vërtetë, nëpërmjet shoqërimit me farën e gruas duke u pagëzuar në Krisht (Gal. 3:27-29), u jepet falja për mëkatet e tyre dhe prandaj, së fundi, shpëtohen nga vdekja, që është rezultat i mëkatit. Kështu që në dukje Jezusi "prishi vdekjen" në kryq (2 Tim. 1:10), megjithëse nuk ka për të ndodhur derisa të plotësohet qëllimi i Zotit me tokën në fund të mijëvjeçarit, kur njerëzit në fakt nuk do të vdesin – kur vdekja nuk do të shihet më mbi tokë: "sepse duhet që ai të mbretërojë (në pjesën e parë të Mbretërisë së Zotit) derisa t'i vërë të gjithë armiqtë e tij nën këmbët e veta. Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja"(1 Kor. 15:25,26).

Në qoftë se ne jemi "pagëzuar në Krisht" atëherë premtimet në lidhje me Jezusin, si ajo te Zan. 3.15, bëhen personale për neve; nuk janë më thjesht pjesë interesante të Biblës, ato janë profeci dhe premtime të bëra drejtpërdrejt për ne! Ashtu si fara e gruas, edhe ne, do të përjetojmë fitoren e mëkatit mbi ne me afat të shkurtër. Në qoftë se Zoti nuk kthehet sa jemi gjallë, edhe ne do të plagosemi në thembër si Jezusi, pra edhe ne do të vdesim. Por në qoftë se ne jemi vërtetë fara e gruas, atëherë kjo "plagë" do të jetë vetëm e përkohshme. Ata që pagëzohen si duhet në Krisht duke u zhytur në ujë, e shoqërojnë veten e tyre me vdekjen dhe ringjalljen – e simbolizuar nga ngritja prej ujit (shih Rom. 6:3-5).

Në qoftë se ne jemi fara e vërtetë e gruas, atëherë jetët tona do të pasqyrojnë fjalët e Zan. 3:15 – do të ketë një sens konflikti ("armiçësi") brenda nesh, midis së drejtës dhe së padrejtës. Apostulli i madh, Pali përshkruante një

konflikt pothuajse skizofrenik midis mëkatit dhe atij vet që ziente brenda tij (Rom. 7:14-25).

Pas pagëzimit në Krisht, ky konflikt me mëkatit që ndodh natyrshëm brenda nesh, duhet të rritet – dhe të vazhdojë kështu gjithë ditët tona. Në njëfarë mënyre është e vështirë, sepse fuqia e mëkatit është e fortë. Po në një mënyrë tjetër nuk është, duke parë që ne jemi *në* Krisht, i cili tashmë e ka luftuar dhe fituar konfliktin. Vini re si besuesit përshkruhen si një grua tek Efe. 5:23-32, sikur duke qenë farë e gruas ne, gjithashtu, jemi gruaja.

Në të njëjtën mënyrë që fara e gruas përfaqson si Jezusin ashtu dhe ata që përpiqen të kenë vetitë e Tij, ashtu edhe fara e gjarprit flet për të dy, mëkatit (“djallin” Biblik) dhe ata që tregojnë lirshëm vetitë e mëkatit dhe të gjarprit. Njerëz të tillë do të përçmojnë ose shtrembërojnë Fjalën e Zotit, që si përfundim do t’i udhëheqë drejt turpit të mëkatit dhe largimit nga Perëndia, që i ndodhi Adamit dhe Evës. Duke parë që Judenjtë ishin populli që në fakt e shtinë Jezusin drejt vdekjes – d.m.th. plagosën farën e gruas në thembër - i bie që ata të jenë shembujt primarë të farës së gjarprit. Kjo është e vërtetuar nga Gjon pagëzori dhe Jezusi:-

"kur ai (Gjoni) pa se shumë farisenj dhe saducenj (grup Judenjsh që ndëshkuan Jezusin) po vinin për t’u pagëzuar tek ai, u tha atyre, O pjellë (d.m.th. të gjinuar prej, të krijuar nga) nepërkash (gjarprinjsh), kush ju ka mësuar t’i arratiseni zemërimit që po vjen?"(Mt. 3:7).

"Jezusi duke i ditur mendimet e tyre (Farisenjve), u tha... O pjellë nepërkash, si mund të flisni mirë, kur jeni të këqij?" (Mt. 12:25,34).

Bota – edhe bota fetare – ka të njëjtat veti të gjarprit. Vetëm ata të pagëzuarit në Krisht janë të shoqëruar me farën e gruas; gjithë të tjerët, në shkallë të ndryshme, janë farë e gjarprit. Mënyra se si i trajtoi Jezusi njerëzit që ishin fara e gjarprit, duhet të jetë shembulli ynë:-

- Ai u predikoi në një shpirt dashurie dhe shqetësimi të vërtetë, megjithatë
- Ai nuk i la sjelljet dhe mendimet e tyre të ndikojnë në Të, dhe

- Ai u tregoi atyre karakterin dashurues të Zotit nga mënyra, në të cilën Ai jetoi.

Dhe prapë për të gjitha këto ata e urryen Atë. Përpjekja e Tij për të qenë i bindur ndaj Zotit i bëri ata xhelozë. Edhe familja (Gjo. 7:5; Mk. 3:21) dhe miq të ngushtë (Gjo. 6:66) u ndanë dhe disa edhe u larguan prej tij fizikisht. Pali provoi të njëjtën gjë kur ai u shprehu keqardhjen atyre që kishin qenë më të mish e thua më parë:-

"A thua u bëra armiku juaj, duke ju thënë të vërtetën?" (Gal. 4:14-16).

E vërteta kurrë nuk mirëpritet; ta dish atë dhe ta jetosh atë si duhet gjithmonë do të krijojë ndonjë lloj problemi për ne, edhe sjelljen e përndjekjes:-

"Po sikurse atëherë, ai që lindi sipas mishit përndiqte atë që kishte lindur sipas Frymës (me anë të njohjes së vërtetë të Fjalës së Perëndisë – (1 Peter 1:23), ashtu është edhe tani" (Gal. 4:29).

Në qoftë se ne jemi vërtetë të bashkuar me Krishtin, ne duhet të provojmë disa nga vuajtjet e Tij, që edhe ne të kemi pjesë në shpërblimin e Tij të lavdishëm. Prapë Pali na jep një shembull të pashoq në këtë

"Kjo fjalë është e vërtetë: sepse, nëse ne vdiqëm me të (Krishtin), me Të edhe do të rrojmë: në qoftë se vuajmë (me Të), do të mbretërojmë bashkë me të...prandaj unë i duroj të gjitha (2 Tim. 2:10-12).

"Nëse më kanë përndjekur mua (Jezusin), do t'ju përndjekin edhe juve ...të gjitha këto gjëra do t'ju bëjnë për shkak të emrit tim" (Gjo. 15:20,21)

- d.m.th. sepse jemi pagëzuar në emër të Jezusit (Vep. 2:38; 8:16).

Përballë vargjeve si këto, është tunduese të arsyetosh, "në qoftë se kjo është gjithë puna e të qenurit i shoqëruar me Jezusin, farën e gruas, më mirë të mos jem". Por sigurisht, ne kurrë nuk do të ngarkohemi me diçka që nuk e mbartim dot. Ndërkohë që patjetër kërkohet sakrifica vetjake për të bashkuar veten tonë plotësisht me Krishtin, shoqërimi ynë me Të do të sjellë një shpërblim kaq të lavdishëm, "saqë vuajtjet e sotme as që ia vlen të

krahasohen me lavdinë që do të na shpaloset". Madje edhe tani, sakrifica e Tij mundëson lutjet tona për ndihmë përmes tronditjeve të jetës për të qenë vëçanërisht të fuqishëm me Zotin. Shtoi kësaj edhe sigurinë e lavdishme pasuese, të theksuara dukshëm në shumë Bibla Kristadelfiane:-

"Zoti është besnik dhe nuk do të lejojë që t'ju tundojnë përtej fuqive tuaja; por me tundimin do t'ju japë dhe rrugë dalje që ju të mund ta përballoni" (1 Kor. 10:13).

"Jua kam thënë këto gjëra që ta keni paqen në mua. Në botë do të keni mundime: por merrni zemër: unë e munda botën" (Gjo. 16:33).

"Çfarë të themi, pra, për këto gjëra? Në qoftë se Perëndia është me ne, kush mund të jetë kundër nesh?" (Rom. 8:31).

3:3 Premtimi ndaj Noeut

Me përparimin e shoqërisë njerëzore mbas kohës së Adamit dhe Evës, njerëzit u bënë gjithnjë e më të këqij. Gjërat arritën në një pikë ku qytetërimi ishte aq poshtë moralisht saqë Zoti vendosi ta shkatërrojë atë sistem gjërash, me përjashtim të Noeut dhe familjes së tij (Zan. 6:5-8). Atij iu tha të bënte një arkë, ku ai dhe mostrat e të gjitha kafshëve do të jetonin gjatë kohës kur bota po shkatërrohej nga përmytjet. Në vazhdim, përveç thënieve të qarta të Shkrimit, ka një mori arsyesh shkencore për të besuar se kjo përmytje gjigande ndodhi me të vërtetë! Siç e vini re (d.m.th. pikërisht ky planet) nuk u shkatërrua, vetëm ndërtimi i keq njerëzor që ishte mbi të: "u shuan të gjitha llojet e mishit që lëviznin mbi tokë" (Zan. 7:21). Jezusi (Mt. 24:37) dhe Pjetri (2 Pje. 3:6-12) të dy e panë gjykimin në botën e Noeut si të kishte ngjashmëri me atë që do të ndodhë me ardhjen e dytë të Krishtit. Kështu, ligësia e pashpresë e njeriut në kohën e Noeut përkon me botën tonë të sotme, që është afër ndëshkimit në kthimin e Krishtit.

Për shkak të gjithmëkatit të njeriut dhe programeve vetë-shkatërruese, mbi të cilat ka hipur ky planet, është ngritur një besim, edhe midis kristianëve, që kjo tokë do të shkatërrohet. Kjo ide paraqet një mungesë të plotë të vlerësimit të lajmit themelor të Biblës – që Zoti ËSHTË aktivisht i shqetësuar për punët e këtij planeti dhe së shpejti Jezu Krishti do të kthehet të vendosë Mbretërinë e Zotit këtu në tokë. Në qoftë se njeriu lejohet ta shkatërrojë këtë planet, atëherë këto premtime thjesht nuk mund të mbahen. Fakte të mjaftueshme që mbretëria e perëndisë *do të jetë* në tokë gjenden në Kapitullin 4.7 dhe Kapitullin 5. Ndërkohë vargjet e mëposhtme duhet të jenë provë e mjaftueshme që toka dhe sistemi diellor nuk do të shkatërrohen:-

- "Toka, që ka krijuar përjetë" (Ps. 78:69).
- "Toka mbetet përjetë" (Pre. 1:4).
- "Diell dhe hënë...yje...qiej...ai i ka vendosur përjetë në përjetësi" (Ps. 148:3-6).
- "Vendi do të mbushet me njohurinë e Zotit, ashtu si ujrat mbulojnë detin" (Is. 11:9; Num. 14:21) – vështirë të ndodhë, po të lërë Zoti botën të shkatërrojë vetveten. Ky premtim nuk është përmbushur akoma.
- "Perëndia që ka formuar tokën dhe ka bërë; ai e ka vendosur nuk e krijuar pa trajtë, por e ka formuar që të banohej" (Isa. 45:18). Në qoftë se Zoti e bëri tokën vetëm që ta shihte të shkatërrohej, atëherë puna e tij ishte pa frute.

Po tamam tek Zanafilla Zoti ia premtoi gjithë këtë Noeut. Kur ai filloi të jetonte përsëri në botën e re të krijuar nga përmbytja, ndoshta Noeu friksohej se mund të vinte një shkatërrim tjetër i përgjithshëm. Sa herë që fillonte të binte shi, këto mendime mund t'i kenë përshkuar mendjen. Kështu që Zoti bëri një besëlidhje (një sërë premtimesh) që kjo nuk do të ndodhte kurrë më:-

"Sa për mua, unë caktoj besëlidhjen time me ju... (vini re theksin në "Unë" - *mrekullia* e Zotit kur vendos t'i premtojë njeriut të vdekshëm!); asnjë lloj mishi nuk do të shfaroset më nga ujrat e

përmbytjes dhe nuk do të ketë më përmbytje për të shkatërruar tokën" (Zan. 9:9-12).

Kjo besëlidhje u vërtetua nga ylberi:-

"Unë e vendos ylberin tim në një re (shiu): dhe unë do të kujtohem për besëlidhjen... midis meje dhe jush... besëlidhjen e përjetshme midis Perëndisë dhe çdo gjallese të çfardo mishi mbi tokë... Kjo (ylberi) është shenja e besëlidhjes" (Zan. 9:13-17).

Meqenëse është një besëlidhje e përjetshme midis Zotit dhe njerëzve dhe kafshëve të tokës, atëherë toka duhet të ketë njerëz dhe kafshë që jetojnë mbi të në përjetësi. Kjo në vetvete vërteton që Mbretëria e Perëndisë do të jetë në tokë dhe jo në parajsë.

Kështu premtimi ndaj Noeut është themeli i Ungjillit të Mbretërisë; tregon se si vëmendja e Zotit përqendrohet mbi këtë planet dhe se si ka një qëllim të përjetshëm me të. Edhe në zemërim Ai kujton mëshirën (Hab. 3:2) dhe e tillë është dashuria e Tij sa që Ai kujdeset edhe për krijimin e Tij të kafshëve (1 Kor. 9:9 kra. Jona 4:11).

3.4 Premtimi ndaj Abrahamit

Ungjilli i mësuar nga Jezusi dhe apostujt nuk ishte në themel i ndryshëm nga ai që u kuptua nga Abrahami. Zoti, përmes Shkrimeve, "ia dha më përpara Abrahamit lajmin e mirë" (Gal. 3:8). Këto premtime janë kaq të rëndësishme sa që Pjetri i filloi dhe mbaroi shpalljet e tij publike të Ungjillit duke iu referuar atyre (Vep. 3: 13,25). Nëse ne mund të kuptojmë çfarë iu mësua Abrahamit, atëherë ne do të kemi një pamje bazë të Ungjillit Kristian. Ka tregime të tjera që "Ungjilli" nuk është diçka që sapo filloi në kohën e Jezusit:-

- "Ne po ju shpallim lajmin e mirë (Ungjillin) të premtimit që u bë bërë etërve (Judenj) duke ju thënë se Perëndia e ka përmbushur" (Vep. 13: 32,33).

- "Ungjillin e Perëndisë, siç i kishte premtuar ai me anë të profetëve (p.sh..Abrahami, Zan. 20:7) në Shkrimet e shenjta" (Rom. 1:1,2).

- "Për këtë në fakt, ungjilli u është predikuar edhe të vdekurve" (1 Pje.4:6) - d.m.th. besimtarëve që jetuan dhe vdiqën para shekullit të parë.

- "Në fakt neve, si edhe atyre, u ishte shpallur lajmi i mirë" (Heb. 4:2)- d.m.th. Izraelit në shkretëtirë.

Premtimet ndaj Abrahamit kanë dy tema bazë:

(1) gjërat rreth farës së Abrahamit (pasardhës të veçantë) dhe

(2) gjërat rreth tokës që iu premtua Abrahamit.

Mbi këto premtime është komentuar në Dhjatën e Re dhe, duke mbajtur marrëveshjen tonë që të lemë Biblën të vet-shpjegohet, ne do të kombinojmë mësimet e të dy Dhjatave për të na dhënë një pamje të plotë të besëlidhjes së bërë me Abrahamin.

Abrahami fillimisht jetoi në Ur, një qytet i begatë që sot njihet si Iraku. Arkeologjia moderne zbulon nivelin e lartë të qytetërimit që kishte arritur deri në kohën e Abrahamit. Kishte sistem bankar, shërbime qytetare dhe infrastrukturë përkatëse. Pa ditur ndryshe, Abrahami jetonte në këtë qytet; me sa dimë, një burrë i botës. Po pastaj thirrja e jashtëzakonshme e Zotit erdhi tek ai – për të lënë jetën e sofistikuar dhe të nisej në rrugë për në tokën e premtuar. Tamam se ku edhe çfarë nuk ishte krejt e qartë. Nga gjithçka u tha, doli që ishte një udhëtim prej 1500 milje. Toka quhej Kanaan -Izraeli i sotëm.

Herë pas here gjatë jetës së tij, Zoti i shfaqej Abrahamit dhe ia përsëriste dhe zgjeronte premtimet. Ato premtime janë baza e Ungjillit Kristian, kështu si kristianë të vërtetë, e njëjta thirrje na vjen edhe ne siç i erdhi Abrahamit, për të lënë gjërat kalimtare të kësaj jete dhe të ecim përpara në një jetë besimi, duke marrë premtimet me vlerë të Zotit, duke jetuar me Fjalën e Tij. Ne mund ta marrim me mend se si Abrahami do të jetë lloisur mbi premtimet gjatë udhëtimeve të tij. "Me anë të besimit Abrahami, kur u thirr (nga Uri), u bind që të shkojë në atë vend që do të merrte për trashëgim; dhe u nis pa ditur se ku po shkonte" (Heb. 11:8).

Kur marrim parasysh premtimet e Zotit për herë të parë, edhe ne e ndjejmë që nuk e dimë tamam se si do të jetë toka e premtuar e Mbretërisë së Zotit. Por besimi ynë në Fjalën e Zotit duhet të jetë i tillë që ne të bindemi me dëshirë.

Abrahami nuk ishte ndonjë endacak që s'kish ç'të bënte tjetër veçse ta provonte njëherë me këto premtime. Ai vinte nga një prejardhje, që në thelb, ishte shumë e ngjashme me tonën. Vendimet e komplikuar, stërmunduese përballë së cilave u vu, ishin të ngjashme me ato përballë të cilave mund të vihemi edhe ne kur themi të pranojmë dhe veprojmë sipas premtimeve të Zotit – vështrimet e çuditura nga kolegët e firmës, pamja tinëzare në sytë e komshinjve("Na u bë fetar ky!")...këto gjëra duhet t'i jenë bërë të njohura Abrahamit. Shtytja që nevojiste Abrahami për të vazhduar këtë duhet të ketë qenë vigane. E vetmja gjë që mbajti gjallë këtë shtytje gjatë gjithë viteve të gjatë të udhëtimit të tij, ishte fjala e premtimit. Ai duhet t'i ketë mësuar për mendësh ato fjalë dhe të jetë menduar çfarë kuptimi kishin në të vërtetë për të.

Duke treguar besim të ngjashëm dhe vepruar mbi të ne mund të kemi të njëjtin nder si Abrahami – të quhemi miqtë e Zotit (Isa. 41:8), të gjejmë njohurinë e Zotit (Zan. 18:17) dhe të kemi shpresë të sigurtë të jetës së përjetshme në Mbretëri. Përsëri theksojmë se Ungjilli i Krishtit është bazuar në këto premtime bërë Abrahamit. Për të besuar vërtet në lajmin kristian, edhe ne duhet të njohim fort premtimet ndaj Abrahamit. Pa to besimi ynë nuk është besim. Me sy të etur, pra ne duhet të lexojmë dhe ri-lexojmë dialogjet ndërmjet Zotit dhe Abrahamit.

TOKA

- 1) "Largohu nga vendi yt...në vendin që do të të tregoj" (Zan. 12:1).
- 2) Abrahami "vazhdoi udhëtimin e tij... në Bethel (në Izraelin Qendror) Dhe Zoti i tha Abramit...Ço tani sytë e tu dhe shiko nga vendi ku je drejt veriut e jugut; drejt lindje dhe perëndimit: tërë vendi që sheh unë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu, përgjithnjë...bjeri rreth e qark vendit...sepse unë do të ta jap ty" (Zan. 13:3,14-17).
- 3) "Zoti bëri një besëlidhje me Abrahamin, duke i thënë, unë u jap pasardhësve të tu këtë vend, nga përroi i Egjiptit deri në lumin e madh, lumin e Eufratit " (Zan. 15:18.)

4) "Ty dhe pasardhësve të tu pas teje, do t'u jap vendin ku ti banon si një i huaj, tërë vendin e Kanaanëve, në pronësi përgjithnjë" (Zan. 17:8).

5) "Premtimi që ai (Abrahami) do të ishte trashëgimtari i botës" (Rom. 4:13).

Ne këtu shikojmë një zbulim përparues të Abrahamit:-

1) 'Ka një tokë ku do të doja të shkoje'.

2) 'Tashmë ke arritur në zonë. Ti dhe fëmijët e tu do të jetojnë këtu përgjithmonë'. Vini re se si ky premtim i jetës së përjetshme është shënuar pa bujë ose theksim; një autor njerëzor pa dyshim do ta kishte fryrë.

3) Zona e tokës së premtuar ishte përcaktuar më në detaje.

4) Abrahami nuk priste përmbushjen e premtimit në këtë jetë – ai do të ishte një "i huaj" në tokë, edhe pse më vonë atje do të jetonte për gjithnjë. Vështirësia e kësaj është se ai do të vdiste dhe më vonë ringjallej që të përmbushej ky premtim.

5) Pali, nën frymëzim, përfundimisht i pa premtimet ndaj Abrahamit si domethënie të trashëgimisë së tij të gjithë tokës.

Shkrimi shtrihet përtej vetvetes për të na kujtuar që Abrahamit nuk iu përmbushën premtimet gjatë jetës së tij:-

"Me anë të besimit ai banoi (nënkupton një jetë të përkohshme) në tokën e premtuar, si në një dhe të huaj dhe ndenji në çadra (tënda)" (Heb. 11:9).

Ai jetoi si i huaj në tokë, ndoshta me të njëjtën ndjenjë vjedharake pasigurie dhe papërshtatje që ndjen një refugjat. Ai as që po jetonte me farën e tij në tokën e tij. Së bashku me pasardhësit e tij, Isakun dhe Jakobin, (të cilëve iu përsëritën premtimet), ai "vdiq në besim, pa marrë premtimet e bëra, por i panë ato për së largu dhe (ata) u bindën dhe i përshëndetën ato me gëzim duke rrëfyer se janë të huaj dhe shtegtarë mbi dhe." (Heb. 11:13). Vini re katër fazat:-

- njohja e premtimeve - siç po bëjmë ne nëpërmjet këtij studimi.

- "bindja prej tyre" – në qoftë se u desh një proces bindjeje me Abrahamin, sa më tepër do të duhet me ne?

- Përshëndetja e tyre – duke qenë të pagëzuar në Krisht (Gal. 3:27-29).

- rrëfimi ndaj botës me anë të mënyrës së jetesës se kjo botë nuk është shtëpia jonë e vërtetë, por ne po jetojmë me shpresën mbi atë kohë të ardhme që të vijë mbi tokë.

Abrahami bëhet heroi dhe shembulli ynë i madh nëse ne i çmojmë këto gjëra. Njohja përfundimtare që përmbushja e premtimeve shtrihet në të ardhmen erdhi për plakun e lodhur kur i vdiq gruaja; atij iu desh ta blinte pjesë të tokës së premtuar që ta varroste (Vep. 7:16). Vërtet Perëndia "nuk i dha kurrfarë trashëgimie në të, as edhe vend për të vënë një këmbë: por i premtoi t'ia japë për pronë" (Vep. 7:5). Fara e sotme e Abrahamit mund të ndjejë të njëjtën mospërputhje kur blejnë ose marrin tokë me qera – në një tokë që u është premtuar për trashëgiminë e tyre vetjake të përjetshme!

Por Zoti i mban premtimet e Tij. Do të vijë një ditë kur Abrahami dhe të gjithë ata që u janë bërë ato premtime do të shpërblehen. Heb. 11:13,39,40 e bën të qartë këtë:-

"Këta të gjithë vdiqën në besim, pa marrë premtimet; Perëndia kishte paraparë diçka më të mirë për ne, që ata të mos arrinin në përsosje pa ne".

Prandaj të gjithë besimtarët e vërtetë do të shpërblehen në të njëjtën kohë, d.m.th. karriken e gjykimit ditën e fundit (2 Tim. 4:1,8; Mat. 25:31-34; 1 Pje. 5:4). Si rrjedhim, të egzistosh që të gjykoresh, Abrahami dhe të tjerët që i dinin këto premtime duhet të ringjallen tamam para gjykimit. Në qoftë se ata tani nuk i kanë marrë premtimet dhe do t'i marrin vetëm pas ringjalljes dhe gjykimit të tyre në kthimin e Krishtit, nuk ka rrugë tjetër vetëm se të pranojmë që të ngjashmit e Abrahamit tashmë janë pa vetëdije, në pritje të ardhjes së Krishtit; prapsepapë mozaikët e xhamave me ngjyra në kishat e Evropës janë të famshme për përshkrimin e Abrahamit sikur është në parajsë, duke përjetuar shpërblimin e premtuar për një jetë besnike. Mijëra njerëz prej qindra vjetësh kanë kaluar pranë atyre pikturave, duke

pranuar në fe ide të tilla. A mund të kesh kurajo me bazë Bible të dalësh jashtë kësaj vije?

FARA

Siç shpjeguam në kapitullin 3:2, premtimi i farës zbatohet së pari mbi Jezusin dhe së dyti mbi ata që janë "në Krisht" dhe, prandaj, edhe ata llogariten si fara e Abrahamit.:-

- 1) "Unë prej teje do të bëj një komb të madh do të të bekoj... dhe te ti do të jenë të bekuara tërë familjet e tokës" (Zan. 12:2,3).
- 2) "Do t'i bëj pasardhësit e tu si pluhurin e tokës: prandaj nëse dikush mund të llogarisë pluhurin e tokës, do të mund të llogarisë edhe pasardhësit e tu...tërë vendin që sheh unë do të ta jap ty dhe pasardhësve të tu për gjithnjë" (Zan. 13:15,16).
- 3) "Vështro me kujdes qiellin dhe numëro yjet, në rast se mund t'i numërosh...Kështu kanë për të qenë pasardhësit e tu...Unë u jap pasardhësve të tu këtë vend" (Zan. 15:5,18).
- 4) "Pasardhësve të tu pas teje do t'u jap...vendin e Kanaanëve, në pronësi për gjithnjë; dhe do të jem Perëndia i tyre" (Zan. 17:8).
- 5) "do të shumoj pasardhësit e tu si yjet e qiellit dhe si rëra që ndodhet në brigjet e detit; dhe trashëgimtarët e tu do të zotërojnë portat e armiqve të tij; dhe tërë kombet e tokës do të bekoen te pasardhësit e tu" (Zan. 22:17,18).

Përsëri, kuptimi i Abrahamit mbi "farën" u zgjerua vazhdimisht:-

- 1) Në fillim iu tha që në njëfarë mënyre ai do të kishte një numër të jashtëzakonshëm trashëgimtarësh dhe që nëpërmjet "farës" së tij i gjithë dheu do të bekohej.
- 2) Më vonë iu tha do të kishte një farë që do të përfshinte shumë popuj. Këta popuj do të kalonin jetën e përjetshme, bashkë me të, në tokën ku ai kishte arritur, d.m.th. Kanaan.
- 3) Iu tha që trashëgimtarët e tij do të bëhen aq sa yjet e qiellit. Kjo mund ta ketë sugjeruar që ai do të kishte shumë trashëgimtarë shpirtërorë (yje në qiej) si edhe shumë natyralë (si "pluhuri i tokës").

4) Premtimet e mëparshme ishin nënvizuar me sigurinë shtesë që shumë popuj që do të bëheshin pjesë e farës mund të kishin një marrëdhënie personale me Zotin.

5) Fara do të kishte fitore ndaj armiqve.

Vini re që fara do t'u sillte "bekime" gjithë popujve të botës. Në Bibël, idea e bekimit shpesh është e lidhur me faljen e mëkateve. Në fund të fundit, ky është bekimi më i madh që mund të dojë një dashës i Zotit. Kështu ne lexojmë gjëra si "lum ai të cilit i kanë falur shkeljen" (Ps. 32:1); "Kupa e bekimeve" (1 Kor. 10:16), që përshkruan kupën e verës që përfaqson gjakun e Krishtit, nëpërmjet të cilit bëhet e mundshme.

I vetmi trashëgimtar i Abrahamit, që i ka sjellë botës faljen e mëkateve, sigurisht është Jezusi dhe komenti i Dhjatës së Re mbi premtimet e Abrahamit jep mbështetje të fortë:-

"Ai (Zoti) nuk thotë, 'edhe pasardhësve', si të ishin shumë (d.m.th. në shumës), por një të vetme (në njëjës), 'Dhe pasardhjes sate', pra Krishti" (Gal. 3:16).

"...besëlidhjes që Perëndia bëri me etërit tanë, duke i thënë Abrahamit, Dhe në pasardhësit e tu do të bekohen të gjitha kombet e dheut. Perëndia më së pari, mbasi e ringjalli birin e tij Jezusin (d.m.th. farën), jua ka dërguar juve që t'ju bekojë, duke larguar secilin nga ju nga paudhësitë e tij" (Vep. 3:25,26).

Vini re këtu se si Pjetri citon dhe interpreton Zan. 22:18:-

Fara = Jezusi

Bekimi = falja e mëkateve.

Premtimi që Jezusi, fara, do të arrijë fitore mbi armiqtë e tij, zë vend më mirë në qoftë se kjo lexohet duke iu referuar fitores së tij ndaj mëkatit – armiku më i madh i popullit të Zotit dhe, pra, edhe i Jezusit.

BASHKIMI ME FARËN

Deri tani duhet të jetë qartësuar që elementet bazë të Ungjillit Kristian ishin kuptuar nga Abrahami. Por këto premtime jetësore iu bënë Abrahamit dhe farës së tij, Jezusit. Po të tjerët? Edhe trashëgimia fizike e drejtpërdrejtë nga

Abrahami nuk e bën dikë automatikisht pjesë të asaj fare të veçantë (Gjo. 8:39; Rom. 9:7). Ne duhet të bëhemi disi pjesë e afërt e Jezusit, që premtimet ndaj farës të ndahen edhe me neve. Kjo është me anë të pagëzimit në Jezusin (Rom. 6:3-5); ne dëgjojmë shpesh për pagëzimin në emrin e tij (Vep. 2:38; 8:16; 10:48; 19:5). Gal. 3:27-29 nuk mund ta bëjë më të qartë se kaq:-

"Aq nga ju (d.m.th. vetëm aq!) sa janë pagëzuar në Krisht, Krishtin keni veshur. Nuk ka as Jude as Grek (Pagan), nuk ka as skllav as të lirë, nuk ka as mashkull as femër: sepse të gjithë jeni një (duke qenë) në Jezus (me pagëzim). Dhe në qoftë se jeni të Krishtit (me pagëzimin në të), atëherë jeni fara e Abrahamit dhe trashëgimtarë sipas premtimit"

- Premtimi i jetës së përvetshme në tokë, nëpërmjet marrjes së "bekimit" të faljes së Jezusit. Vetëm duke u pagëzuar në Krisht, farën, bëhet e mundur të kemi pjesë në premtimet e bëra ndaj tij; dhe kështu Rom. 8:17 na thërret "t'i bashkohemi trashëgimisë më Krishtin".

Kujtoni që bekimi do të vinte mbi njerëzit nga të gjitha pjesët e dheut, përmes farës; dhe fara të bëhej një grup njerëzish nëpër gjithë botën, si rëra e brigjeve dhe yjet e qiellit. I bie që kjo të jetë në saj të marrjes së parë të bekimit të tyre që ata të bëhen fara. Kështu fara (në njëjës) "do t'i flitet për Zotin brezit të ardhshëm" (d.m.th. shumë popujve; Ps.22:30).

Ne mund t'i përmbledhim dy fijet e premtimit dhënë Abrahamit:-

(1) TOKA

Abrahami dhe fara e tij, Jezusi dhe ata në Të do të trashëgojnë tokën e Kanaanit dhe, prej zgjerimit, gjithë dheun dhe jetojnë atje përgjithnjë. Në këtë jetë ata nuk do ta marrin, po do të ndodhë kështu ditën e fundit, kur të kthehet Jezusi.

(2) FARA

Kjo ishte fillimisht Jezusi. Nëpërmjet Tij mëkatet ("armiqtë") e njerëzimit do të munden, kështu që bekimet e faljes do t'i jepeshin gjithë botës.

Me anë të pagëzimit në emrin e Jezusit, ne bëhemi pjesë e farës.

Të njëjtat dy fije ndodhen në predikimin e Dhjatës së Re dhe nuk është aspak çudi që shpesh thuhet se, kur njerëzit i dëgjuan tek mësonin, atëherë ata pagëzoheshin. Kjo ishte dhe është mënyra që këto premtime mund të na bëhen neve. Tani ne mund ta kuptojmë pse, si plak përballë vdekjes, Pali mund ta përkufizonte shpresën e tij si "shpresa e Izraelit" (Vep. 28:20): shpresa e vërtetë Kristiane është shpresa e fillimit të Judejve. Komenti i Krishtit që "shpëtimi është i Judenjve" (Gjo. 4:22) duhet, po ashtu ta ketë fjalën për nevojën për t'u bërë Judenj shpirtërorë, që ne të përfitojmë nga premtimet e shpëtimit nëpërmjet Krishtit, që ishte bërë nga etër Judenj.

Ne lexojmë që Kristianët e hershëm predikuan:-

- 1) "Gjërat në lidhje me Mbretërinë e Zotit .dhe
- 2) emrin e Jezu Krishtit" (Vep. 8:12).

Këto ishin të vetmet dy gjëra shpjeguar Abrahamit nën tituj paksa të ndryshëm:-

- 1) Premtimet për tokën
- 2) Premtimet për farën.

Vini re në vazhdim se "gjërat" (shumës) rreth Mbretërisë dhe Jezusit janë përmbledhur si "predikimi i Krishtit" (Vep. 8:5 krahas v. 12). Shumë shpesh kjo merret si "Jezusi të do! Thjesht të thuash që ti beson që Ai vdiq për ty dhe je i shpëtuar!" Por fjala "Krisht" qartësisht përmbledh të mësuarit e një sërë gjërash rreth tij dhe Mbretërisë së tij të ardhshme. Lajmi i mirë për këtë Mbretëri, që iu predikua Abrahamit lajti një rol të madh në predikimin e hershëm të Ungjillit.

Në Korinth, Pali ishte "tre muaj, duke diskutuar dhe i bindur për gjërat e Mbretërisë së Perëndisë" (Vep. 19:8); në Efes ai shkoi gjithandej "Duke predikuar Mbretërinë e Perëndisë" (Vep. 20:25), dhe mesazhi i tij i fundit në Romë ishte i njëjtë, "Ai shpjegoi dhe dëshmoi Mbretërinë e Perëndisë, duke i bindur për Jezusin...nga ligji...dhe nga profetët" (Vep. 28:23,31). Që kishte kaq shumë për t'u thënë tregon se lajmi bazë i Ungjillit për Mbretërinë dhe Jezusin nuk ishte thjesht një çështje e të thënit "Beso në Jezusin". Zbulimi i Zotit ndaj Abrahamit ishte më i hollësishëm se kaq dhe gjërat premtuar atij janë bazat e Ungjillit Kristian të vërtetë.

Ne kemi treguar se pagëzimi në Jezusin na bën pjesë të farës dhe pra, të aftë të trashëgojmë premtimet (Gal. 3:27-29), por vetëm pagëzimi nuk është i mjaftueshëm të na japë shpëtimin e premtuar. Ne duhet të mbetemi në farë, në Krisht, në qoftë se duam të marrim premtimet e bëra farës. Pagëzimi, pra është vetëm fillimi; ne i kemi hyrë një gare që duhet ta vrapojmë. Mos harroni se thjesht duke qenë fara e Abrahamit teknikisht, nuk do të thotë që jemi të pranueshëm me Zotin. Izraelitët janë fara e Abrahamit në disa mënyra, por kjo nuk do të thotë që ata mund të shpëtohen pa u pagëzuar dhe pa përshtatur jetët e tyre me Krishtin dhe shembullin e Abrahamit (Rom. 9:7,8; 4:13,14). Jezusi u tha Judenjve, "unë e di që ju jeni fara e Abrahamit; po ju kërkoni të më vrisni...nëse ju jeni fëmijët e Abrahamit, ju do të bënit veprat e Abrahamit" (Gjon 8:37,39), i cili jetonte një jetë në besim në Zot dhe Krisht, farën e premtuar (Gjon 6:29).

“Fara” duhet të ketë vetitë e paraardhësit. Në qoftë se jemi fara e vërtetë e Abrahamit, ne duhet, pra, jo vetëm të pagëzohemi, por edhe të kemi një besim shumë të vërtetë në Premtimet e Zotit, siç kishte ai. Prandaj ai është quajtur "ati i gjithë atyre që besuan...që gjithashtu ndjekin gjurmët e besimit të atit tonë Abraham, që ai pati" (Rom. 4:11,12). "Ta dini, pra,(d.m.th. përvetësoheni vërtetë në zemër!) se ata që janë nga besimi, janë bij të Abrahamit" (Gal. 3:7).

Besimi i vërtetë duhet të duket më vepra, përndryshe, në sytë e Zotit, nuk është besim (Jak 2:17). Ne e tregojmë besimin tonë në këto premtime që kemi studiuar, së pari duke u pagëzuar, që ta na zbatohen personalisht (Gal. 3:27-19). Pra, a i besoni vërtet Premtimet e Zotit? Kjo është një pyetje që duhet t'ia bëjme vetes gjithë jetës sonë.

BESËLIDHJA E RE DHE E VJETËR

Duhet të jetë evidente tashmë që premtimet ndaj Abrahamit përmbledhin Ungjillin e Krishtit. Grupi tjetër kryesor i premtimeve, që bëri Zoti, ishte me Judenjët në përmbajtjen e ligjit të Moisiut. Këto pohonin se nëse judenjët do t'i bindeshin këtij ligji, do të ishin fizikisht të bekuar në këtë jetë (Lip. 28). Nuk kishte premtim të drejtpërdrejtë të jetës së përjetshme në këtë sërë premtimesh, ose “besëlidhje”. Kështu që ne shikojmë të jenë bërë dy “besëlidhje”:-

- 1) Abrahamit dhe farës së tij, duke premtuar falje dhe jetë të përjetshme në mbretërinë e perëndisë kur të kthehet Krishti. Ky premtim ishte bërë gjithashtu në Eden dhe Davidit.

2) Popullit jude në kohën e Moisiut, duke u premtuar paqe dhe lumturi në këtë jetë të tanishme, po t'i bindeshin ligjit që Zoti i dha Moisiut.

Zoti i premtoi Abrahamit falje dhe jetë të përjetshme në Mbretëri, por kjo ishte e mundur vetëm përmes sakrificës së Jezusit. Për këtë arsye ne lexojmë që vdekja e Krishtit në kryq vërtetuan premtimet ndaj Abrahamit (Gal. 3:17; Rom. 15:8; Dan. 9:27; 2 Kor. 1:20), prandaj gjaku i tij është quajtur "gjaku i dhjatës së re" (besëlidhja, Mt. 26:28). Për të kujtuar këtë na tha Jezusi të pimë rregullisht këtë kupë vere, simbol i gjakut të tij, për të na kujtuar këto gjëra (shih 1 Cor. 11:25): "Kjo kupë është besëlidhja e re në gjakun tim" (Lk. 22:20). Nuk ka kuptim të "thyesh bukën" në kujtim të Jezusit dhe veprës së tij nëse ne nuk i kuptojmë këto gjëra.

Sakrifica e Jezusit e bëri të mundshme faljen dhe jetën e përjetshme në Mbretërinë e Zotit; prandaj ai i bëri të sigurt premtimet ndaj Abrahamit; ai ishte "garant i një besëlidhjeje shumë më të mirë" (Heb. 7:22). Hebrejve 10:9 flet për Jezusin që "heq të parën (besëlidhjen), për të vënë të dytën". Kjo tregon se kur Jezusi vërtetoi premtimet ndaj Abrahamit, ai e zëvendësoi me një besëlidhje tjetër që ishte besëlidhja e dhënë nëpërmjet Moisiut. Vargjet e cituara tashmë për Jezusin që konfirmojnë një besëlidhje të re me vdekjen e tij, lë të kuptojë që ka qenë një besëlidhje e vjetër, të cilën ai e zëvendësoi. (Heb. 8:13).

Kjo do të thotë që edhe pse besëlidhja lidhur me Krishtin u bë e para, nuk u përmbush plotësisht deri me vdekjen e tij, prandaj është quajtur besëlidhje "e re". Qëllimi i besëlidhjes "së vjetër" nëpërmjet Moisiut ishte të hapte rrugën për veprën e Jezusit dhe të theksonte rëndësinë e besimit në premtimet lidhur me Krishtin (Gal. 3:19,21). Anasjelltas, besimi në Krishtin konfirmon të vërtetën e ligjit dhënë Moisiut (Rom. 3:31). Pali, çuditshëm përmbledh: "ligji që mësuesi ynë për te Krishti, që ne të shfajsohemi me anë të besimit" (Gal. 3:24). Është për këtë qëllim që ligji përmes Moisiut ka qenë mbrojtur dhe akoma është i dobishëm për ne ta studiojmë.

Këto gjëra nuk janë të lehta për t'i kuptuar me leximin e parë; ne mund t'i përmbledhim si më poshtë:-

Premtimet lidhur me Krishtin bërë Abrahamit –
Besëlidhja e Re

Premtimet Izraelit të shoqëruara me ligjin dhënë Moisiut –Besëlidhja e Vjetër.

Vdekja e Krishtit. Besëlidhja e vjetër përfundon (Kol.2:14-17). Besëlidhja e Re vihet në veprim.

Për këtë arsye gjëra si e dhjeta, mbajtja e së shtunës etj., të cilat ishin pjesë e Besëlidhjes së Vjetër, tani nuk janë të nevojshme – shih Kapitullin 9.5. Besëlidhja e Re do të bëhet më Izraelin prej natyre, kur ata të pendohen dhe të pranojnë Krishtin (Jer. 31:31,32; Rom. 9:26,27; Eze. 16:62; 37:26), megjithëse, sigurisht, çdo Jude që e bën atë tani dhe është i pagëzuar në Jezusin, mund të hyjë menjëherë në Besëlidhjen e Re (në të cilën nuk ka dallim Jude/Pagan - Gal. 3:27-29).

Të çmuarit me të vërtetë të këtyre gjërave na bën të kuptojmë sigurinë e Premtimeve të Zotit. Skeptikët pa të drejtë akuzuan predikuesit e hershëm Kristianë se nuk po jepnin lajm pozitiv. Pali u përgjigj duke thënë se për shkak të konfirmimit nga Zoti të premtimeve të Tij për llogari të vdekjes së Krishtit, shpresa për të cilën ata folën nuk ishte një çështje sa për të thënë, po plotësisht një ofertë e sigurtë "Por Perëndia është besnik; fjala jonë (e predikimit) ndaj jush nuk ka qenë edhe po edhe jo. Sepse Biri i Perëndisë, Jezu Krisht, që u predikua ndër ju nga ne...nuk ishte edhe po edhe jo, por ka qenë "po" në atë. Sepse të gjitha premtimet e Perëndisë në të janë po dhe në të, Amen" (2 Cor. 1:17-20).

Kjo, sigurisht që shkatërron prirjen e 'Epo tani, *mbase* dhe ka ndonjë të vërtetë në gjithë këtë'?

3.5 Premtimi Davidit

Davidi, si Abrahami dhe shumë marrës të tjerë të premtimeve të Zotit, nuk pati një jetë të lehtë. Ai u rrit si më i vogli në një familje të madhe, që në Izraelin e vitit 1000 p.e.s., do të thoshte të ruaje delet dhe të bëje punët e vëllezërve më të mëdhenj komandues (1 Sam. 15-17). Gjatë kësaj kohe ai mësoi një nivel besimi në Zotin që pak burra i janë afruar.

Erdhi dita kur Izraeli u vu përballë sfidës vendimtare të fqinjëve të tyre, Filistinët; ata u sfiduan të zgjidhnin njërin nga burrat e tyre të luftonte Goliathin gjigand, kampioni filistinas, me kushtin që kush fitonte atë duel do të sundonte të mundurit. Me ndihmën e Zotit, Davidi mundi Goliathin duke përdorur një hobe, që i dha atij famë më të madhe se mbreti i tyre (Saul). "Xhelozia është mizore si varri" (KiK. 8:6), fjalë që u vërtetuan nga

përndjekja e Saulit ndaj Davidit për 20 vjetët e pasardhëse, duke e ndjekur si lepur nëpër shkretëtirat e Izraelit jugor.

Si përfundim, Davidi u bë mbret dhe, për të treguar falenderimin e tij ndaj dashurisë së Zotit për të giatë jetës së tij në shkretëtirë, ai vendosi t'i ndërtojë Zotit një tempull. Përgjigja nga Zoti ishte që biri i Davidit, Solomoni, do ta ndërtonte tempullin dhe se Zoti donte t'i ndërtonte *Davidit* një shtëpi (2 Sam 7:4-13). Pastaj vazhdoi me një premtim të detajuar që përsërit shumë nga ato që iu thanë Abrahamit dhe që gjithashtu plotësuan disa detaje të tjera:-

"Dhe kur t'i kesh mbushur ditët e tua dhe të jesh duke pushuar bashkë me etërit e tu, unë do të ngras mbas teje pasardhësit e tu, që do të dalin nga barku yt dhe do të vendos mbretërinë tënde. Ai do të ndërtojë një shtëpi në emrin tim dhe unë do ta bëj të qendrueshëm përgjithnjë fronin e mbretërisë së tij. Unë do të jem për të një baba dhe ai një djalë për mua. Kur do të bëjë ndonjë të keqe do ta dënoj me shufra njeriu dhe me goditje të bijve të njerëzve: por mëshira ime nuk do të largohet prej tij, ashtu siç ia kam hequr Saulit, që e kam hequr nga detyra para teje. Dhe shtëpia jote dhe mbretëria jote do të bëhen të qendrueshme për gjithnjë para teje: froni yt do të jetë i qendrueshëm përgjithnjë (v. 12-16).

Nga kapitujt tanë të mëparshëm ne presim që fara të jetë Jezusi. Përshkrimi i tij si bir i Zotit (2 Sam. 7:14) e konfirmon këtë, siç bëjnë dhe shumë referenca të tjera në pjesë të tjera të Biblës:-

- "Unë jam...pasardhja e Davidit", thotë Jezusi (Zbu. 22:16).

- "(Jezusi), i lindur nga fara e Davidit sipas mishit" (Rom. 1:3).

- "prej farës së këtij burri (e Davidit) Perëndia, sipas premtimit të Vet, i ka ngjallur Izraelit shpëtimtarin, Jezus" (Vep. 13:23).

- Ëngjëlli i tha virgjëreshës Mari lidhur me djalin e saj, Jezusin: "Zoti Perëndi do t'i japë fronin e Davidit, atit të tij (paraardhës)...dhe mbretëria e tij

nuk do të ketë kurrë të sosur (Llu 1:32,33). Kjo zbaton premtimin e farës së Davidit, në 2 Sam. 7:13, Jezusit.

Me farën ngurtësisht të njehsuar si Jezusin, një numër hollësish tashmë bëhen të rëndësishme:-

-1) FARA

"Fara jote...që do të dalë nga barku jot...unë do të jem ati i tij dhe ai do të jetë im bir."...unë do të vë mbi fronin tënd një fryt të përbrendshmeve të tua" (Sam. 7:12,14; Ps. 132:10,11). Jezusi, fara, do të ishte një pasardhës i vërtetë trupor i Davidit, dhe përsëri të kishte Zotin për Atë. Kjo mund të arrihej vetëm nga lindja e virgjëreshës siç përshkruhet në Dhjatën e Re; nëna e Jezusit ishte Maria, një pasardhëse e Davidit (Llu. 1:32), por ai nuk kishte baba njerinë. Zoti veprroi mrekullisht në mitrën e Maries me anë të Frymës së Shenjtë që të zinte Jezusin dhe kështu Ëngjëlli komentoi "prandaj i shenjtë që do të lindë prej teje do të quhet bir i Perëndisë" (Llu.1:35). "Lindja e virgjëreshës" ishte e vetmja mënyrë, në të cilën ky premtim ndaj Davidit mund të përmbushej si duhej.

-2) SHTËPIA

"Ai do të ndërtojë një shtëpi për emrin tim" (2 Sam. 7:13) tregon se Jezusi do të ndërtojë një tempull për Zotin – si të vërtetë ashtu dhe në frymë. Ezekiel 40-48 përshkruan se si në mijëvjeçarin (1000 vjetët e parë të Mbretërisë së Zotit pas kthimit të Jezusit në tokë) do të ndërtohet një tempull në Jeruzalem. "Shtëpia" e Zotit është atje ku Ai dëshiron të jetojë dhe Isa. 66:1,2 na thotë se Ai do të vijë të jetojë në zemrat e njerëzve që janë të përlulur ndaj fjalës së Tij. Prandaj Jezusi po ndërton një tempull në frymë për Zotin të jetojë në të, e ndërtuar nga besues të vërtetë. Përshkrimet e Jezusit si guri themel i tempullit të Zotit (1 Pje. 2:4-8) dhe të Kristianëve si gurët e tempullit (1 Peter 2:5) tashmë zënë vend.

-3) FRONI

"Unë do të vendosë fronin e mbretërisë së tij (Krishtit) për gjithnjë...shtëpia (e Davidit) dhe mbretëria jote...froni yt do të jetë i qëndrueshëm për gjithnjë (2 Sam. 7:13,16 kra. Isa. 9:6,7)". Mbretëria e Krishtit, pra, do të jetë e bazuar mbi mbretërinë e Davidit të Izraelit; kjo do të thotë mbretëria e

ardhshme e Zotit do të jetë një ri-vendosje e mbretërisë së Izraelit – shih kapitullin 5.3 për më tepër mbi këtë. Për të përmbushur këtë premtim, Krishti duhet të rrezatojë në “fronin” e Davidit ose vend sundimi. Kjo ishte tamam në Jeruzalem. Kjo është një provë tjetër që mbretëria duhet të vendoset këtu në tokë me qëllim që të përmbushen këto premtime.

-4) MBRETËRIA

"Shtëpia jote dhe mbretëria jote do të vendosen për gjithnjë para teje" (2 Sam. 7:16) sugjeron që Davidi do ta shohë me sytë e tij mbretërinë e përjetshme të Krishtit. Prandaj kjo ishte një premtim indirekt që ai do të ringjallej në kthimin e Krishtit që ai të shikonte me sytë e tij ndërtimin e Mbretërisë në gjithë botën me Jezusin rrezatues nga Jeruzalemi.

Këto gjëra që iu premtuan Davidit janë absolutisht jetësore për t'u kuptuar. Davidi foli me gëzim për këto gjëra si "një besëlidhje e përjetshme...ky është gjithë shpëtimi im dhe gjithë dëshira ime" (2 Sam. 23:5). Këto gjëra lidhen edhe me shpëtimin tonë; ngazëllimi me to duhet të jetë edhe dëshira jonë. Pra theksohet edhe një herë që këto pikëpamje janë të rëndësishme. Është tragjike që Krishtëria mëson doktrina, të cilat janë sheshit në kundërshtim me këto të vërteta të mrekullueshme:-

- Në qoftë se Jezusi "para-egzistoi" fizikisht, d.m.th. ai egzitoi si person para se të lindte, atëhere kjo i bën të pakumtimta këto premtimet që Jezusi do të jetë “fara” e Davidit, ose pasardhësi.
- në qoftë se Mbretëria e Perëndisë do të jetë në parajsë, atëhere jezusi nuk mund të rivendosë mbretërinë e Davidit të Izraelit dhe as nuk mund të rrezatojë nga “froni” ose vendi i sundimit të Davidit. Këto gjëra ndodhën tekstualisht në tokë dhe kështu rivendosja e tyre duhet të jetë në të njëjtin vend.

PËRMBUSHJE NË SOLOMON?

Biri i vërtetë i Davidit, Solomoni, përmbushi ca pjesë të premtimeve ndaj Davidit. Ai ndërtoi një tempull në të vërtetë për Zotin (1 Mbre. 5-8) dhe pati një mbretëri shumë të begatë. Kombet nga gjithandej dërgonin përfaqësues të respektin Solomonin (1 Kings 10) dhe kishte bekime të mëdha nga përdorimi i tempullit. Rrezatimi i Solomonit dha një ide, pra, të një përmbushjeje shumë më të madhe të premtimeve të Davidit, të cilat do të shihen në Mbretërinë e Krishtit.

Disa kanë pretenduar se premtimet ndaj Davidit u përmbushën plotësisht në Solomon, por kjo nuk lejohet nga sa më poshtë:--

- Shumicë faktesh të Dhjatës së Re tregojnë se "fara" ishte Krishti, jo Solomoni.
- Davidi duket t'i ketë lidhur premtimet që Zoti i bëri atij me ato Abrahamit (1 Kro. 17:27 = Zan. 22:17,18).
- Mbretëria e "farës" duhej të ishte e përjetshme – gjë që nuk ishte ajo e Solomonit.
- Davidi e dinte që premtimet ishin në lidhje me jetën e përjetshme, që parandalonte çdo lloj lidhjeje me familjen e afërt: "A nuk është vallë kështu shtëpia ime para perëndisë; Sepse ai ka lidhur me mua një besëlidhje të përjetshme" (2 Sam. 23:5).
- Fara e Davidit është Mesia, Shpëtimtari nga mëkati (Isa. 9:6,7; 22:22; Jer. 33:5,6,15; Gjo. 7:42). Kurse Solomoni më vonë u largua nga Zoti (Kings 11:1-13; Neh. 13:26) për shkak të martesës së tij me të ato jashtë shpresës së Izraelit.

KAPITULLI 3: Pyetje

1. Cili nga Premtimet e Zotit parashikon një luftë konstante midis mëkatit dhe të drejtit?
 - a) Premtimi Noeut
 - b) Premtimi në Eden
 - c) Premtimi Davidit
 - d) Premtimi Abrahamit

2. Cila nga thëniet e mëposhtme janë të vërteta lidhur me premtimin në Eden?
 - a) Fara e gjarprit shtë Luçiferi
 - b) Krishti dhe i drejti janë farë e gruas
 - c) Fara e gjarprit u plagos përkohësisht nga Krishti
 - d) Fara e gruas u plagos nga vdekja e Krishtit.

3. Ku do të jetonte përjetë fara e Abrahamit?
 - a) Në parajsë
 - b) Në qytetin e Jeruzalemit
 - c) Në tokë
 - d) Ca në Parajsë dhe ca në tokë.

4. Cilat nga të mëposhtmet iu premtua Davidit?
 - a) Që pasardhësi tij i madh do të rrezatojë përgjithnjë
 - b) Që “fara” e tij do të ketë një Mbretëri në Parajsë
 - c) Që fara do të jetë biri i Zotit
 - d) Që fara e tij, Jezusi, do të jetonte në parajsë para lindjes në tokë.

4.1 Natyra e njeriut

Shumica e qenieve njerëzore duket se shpenzojnë pak kohë duke menduar për vdekjen, ose për natyrën e tyre, e cila është shkaku themelor i vdekjes. Mungesa e tillë e vet-shqyrtimit të çon në mungesën e dijes dhe prandaj njerëzit i rrëmben jeta me vendime sipas diktatit të dëshirave të tyre natyrale. Ka një refuzim - edhe pse e maskuar rëndshëm - për të pranuar faktin që jeta është aq e shkurtër sa që shumë shpejt finalja e vdekjes do të jetë mbi ne. "Sepse ç'është jeta? Është një avull që duket për pak dhe pastaj humbet". "Ne duhet të vdesim dhe jemi si ujët që derdhet mbi tokë që nuk mund të mbliidhet". "Si bar që gjelbëron; në mëngjes (rinia jonë) lulëzon dhe gjelbëron; në mbrëmje kositet dhe thahet" (Jak. 4:14; 2 Sam. 14:14; Ps. 90:5,6). Moisiu, një njeri vërtetë i urtë, e dinte këtë dhe iu lut Zotit: "Na mëso, pra, të numërojmë ditët tona për të pasur një zemër të urtë." (Ps. 90:12). Prandaj, nga këndvështrimi i shkurtësisë së jetës, ne duhet të kemi përvetësimin tonë mbi urtësinë e vërtetë si prioritet të parë.

Përgjigja e njeriut ndaj finales së vdekjes është e ndryshme. Disa popuj përpiqen ta bëjnë jetën dhe varrimet pjesë të jetës, për të pakësuar ndjesinë e humbjes dhe përfundimit. Shumica e atyre që mbartin emrin 'Kristian' kanë arritur në përfundimin që njeriu ka një 'shpirt të pavdekshëm' ose ndonjë element pavdeksie brenda vetes që e mbijeton vdekjen, duke shkuar në ndonjë vend të shpërblimit ose ndëshkimit paskëtaj. Vdekja, duke qenë problemi dhe tragjedia e përvojës njerëzore, është e pritshme që mendja e njeriut ka qenë shumë e ushtruar për të pakësuar goditjen mendore; prandaj janë ngritur një sërë teorish falso lidhur me vdekjen dhe vetë natyrën e njeriut. Si gjithmonë, këto duhet të ballafaqohen me Biblën për të gjetur të vërtetën ndaj kësaj çështjeje jetike. Duhet mbajtur mend që gënjeshtra më e parë e rregjistruar në Bibël është ajo e gjarprit në kopshtin e Edenit. Në kundërshtim me thënien e qartë të Zotit që njeriu "do të vdesë me siguri" po të mëkatojë (Zan. 2:17), gjarpri pohoi me vetëdije, "Ju s'keni për të vdekur aspak" (Zan. 3:4). Kjo përpjekje për të mospërfillur karakterin përfundues dhe përgjithsues të vdekjes është bërë karakteristike e gjithë feve të rreme. Është evidente që veçanërisht në këtë çështje një doktrinë e rreme të çon në një tjetër e një tjetër e një tjetër. Nga ana tjetër, një pjesë e vërtete të çon në një tjetër, siç tregohet nga 1 Kor. 15:13-17. Këtu pali hidhet nga një e vërtetë në një tjetër (vini re "nëse...nëse...nëse...").

Për të kuptuar natyrën tonë të vërtetë, ne duhet të shikojmë çfarë thotë Bibla mbi krijimin e njeriut. Rregjistrimi është bërë në gjuhë të hapur, e cila, po të

merret fjalë për fjalë, nuk na lë asnjë dyshim se prej çfarë jemi prej natyre (shih Degëzimin (Digression) 18 lidhur me shprehinë e Zanafillës). "Zoti Perëndi formoi njeriun nga pluhuri i tokës...nga ai (dheu) ke dalë (Adami): sepse ti je pluhur dhe në pluhur do të kthehesh" (Zan. 2:7; 3:19). Nuk ka absolutisht asnjë lloj dyshimi këtu që njeriu të ketë ndonjë trashëgim pavdekshmërie; nuk ka asnjë pjesë të tij që do të jetojë pas vdekjes.

Ka një theksim të dukshëm Biblik në faktin që njeriu është në themel i përbërë nga pluhur i mirëfilltë: "Ne jemi argjila" (Isa. 64:8); "njeriu është bërë nga dheu, tokësor" (1 Kor. 15:47); "themeli është në pluhur" i njeriut (Job 4:19); "dhe njeriu do të kthehej në pluhur" (Job 34:14,15). Abrahami e pranoi që ai ishte "veçse pluhur dhe hi" (Zan. 18:27). Menjëherë pas mosbindjes ndaj urdhërimit të Zotit në Eden, Zoti "dëboi njeriun...nuk duhet të lejohet të shtrijë dorën e tij për të marrë edhe nga pema e jetës kështu që, duke ngrënë nga ajo, të jetojë përgjithnjë" (Zan. 3:24,22). Sikur njeriu të kishte ndonjë element pavdeksie brenda tij prej natyre, kjo do të kishte qenë e panevojshme.

PAVDEKSI E KUSHTËZUAR

Lajmi i Ungjillit që përsëritet papushim është që njeriu mund të gjejë një mënyrë për të fituar jetën e përjetshme dhe pavdeksinë nëpërmjet veprës së Krishtit. Kjo, duke qenë e vetmja lloj pavdeksie, për të cilën flet Bibla, sjell që idea e një përjetësie të vuajtjes së ndërgjegjes për keqbërjen është pa asnjë lloj baze Biblike. E vetmja mënyrë për të fituar pavdeksinë është nëpërmjet bindjes ndaj urdhërimeve të Zotit dhe ata që janë kaq të bindur do ta kalojnë pavdeksinë e tyre në një gjendje përkryerje- shpërblimi për drejtësinë.

Pjesët e mëposhtme duhet të jenë provë e mjaftueshme se kjo pavdekasi është e kushtëzuar dhe nuk është diçka që ne e zotërojmë natyrshëm:-

"Krishti...nxori në dritë jetën dhe pavdeksinë me anë të ungjillit" (2 Tim. 1:10; 1 Gjo. 1:2).

- "Po të mos hani mishin e Birit të njeriut dhe të mos pini gjakun e tij, nuk keni jetën në veten tuaj (d.m.th. 'e trashëguar në ju'). Kush ha mishin tim dhe pi gjakun tim, ka jetë të përjetshme; dhe unë do ta ringjall atë në ditën e fundit " – për t'i dhënë atij këtë "jetë të përjetshme" (Gjo. 6:53,54). Arsyeimi i Krishtit gjatë gjithë Gjo. kap. 6 është se ai është "buka e jetës" dhe se vetëm

nëpërmjet përgjigjes së saktë ndaj tij mund të ketë ndonjë shpresë për pavdeksi (Gjo. 6:47,50,51,57,58).

- "Perëndia na dha (besuesve) jetën e përjetshme dhe kjo jetë është në Birin e tij." (1 Gjo. 5:11). Nuk mund të ketë shpresë pavdeksie për ata jo "në Krisht". Vetëm nëpërmjet Krishtit është bërë e mundshme pavdeksia; Ai është "autori i jetës (së përjetshme)" (Vep. 3:15 A.V. mg.) - "autori i shpëtimit të përjetshëm ndër të gjithë ata që i binden" (Heb. 5:9). Pavdeksia për njerëzit, pra, u fillua nëpërmjet veprës së Krishtit.

- Besimtari i vërtetë e kërkon pavdeksinë dhe do të shpërblehet për këtë me dhuratën e jetës së përjetshme – diçka që ai nuk e zotëron natyrshëm (Rom. 2:7; 6:23; Gjo. 10:28). Trupi ynë i vdekshëm "duhet të veshë Pavdeksinë" me kthimin e Krishtit (1 Kor. 15:53); kështu pavdeksia është diçka e premtuar, jo e zotëruar tashmë (1 Gjo. 2:25).

- Vetëm Zoti ka pavdeksi të trashëguar (1 Tim. 6:16).

4.2 Shpirti

Bazuar në sa më sipër duhet të jetë e pakuptueshme që njeriu të ketë 'shpirt të pavdekshëm' ose ndonjë element tjetër natyrisht të pavdekshëm brenda tij. Ne tani do të përpiqemi të qartësojmë ngatërresën që rrethon fjalën 'shpirt'.

Fjalët hebraishte dhe greke, të cilat janë përkthyer 'shpirt' në Bibël ('Nephesh' dhe 'Psuche' përkatësisht) gjithashtu përkthehen në mënyrat e mëposhtme:-

Trup	Frymë
Krijesë	Zemër
Mendje	Person
Vetvehte	

Pra 'shpirti' i referohet personit, trupit ose vetes. E famshme "Shpëtoni shpirtat tanë" ('Save Our Souls' (S.O.S.)) thjesht do të thotë 'Shpëtonani nga vdekja!'. Pra 'shpirti' është 'ju', ose përmbledhja e gjithë gjërave që përbëjnë një person. Është e kuptueshme, pra, që shumë variante moderne të Biblës (p.sh. (N.I.V.) Varianti i Ri Ndërkombëtar) rrallë e përdor fjalën

'shpirt', duke e përkthyer atë si 'ju' ose 'personi'. Kafshët që Zoti krijoi janë quajtur "krijesa lëvizëse... çdo krijesë e gjallë" (Zan. 1:20,21). Fjala hebraishte e përkthyer "krijesë" këtu është 'nephesh', e cila gjithashtu është përkthyer 'shpirt'; për shembull në Zan. 2:7: "...dhe njeriu u bë një shpirt i gjallë". Kështu njeriu është një 'shpirt', ashtu si edhe kafshët janë 'shpirtra'. I vetmi ndryshim midis njeriut dhe kafshëve është që njeriu qëndron mendërisht më lartë se ato; ai është krijuar në imazhin fizik të Zotit (Zan. 1:26; shih Kapitullin 1.2), dhe disa njerëz janë thirrur të njohin Ungjillin, nëpërmjet të cilit u është hapur shpresa e pavdeksisë (2 Tim. 1:10). Sipas natyrës sonë themelore dhe natyrës së vdekjes sonë, nuk ka ndryshim midis ndërmjet njerëzve dhe kafshëve:-

"Të gjitha ato që u ndodhin bijve të njerëzve u ndodhin; të dy palëve u ndodh e njëjta gjë (vini re theksimin e dyfishtë): ashtu si vdes njëri, kështu vdes tjetri...njeriu nuk ka asnjë epërsi mbi kafshën...të gjithë (d.m.th. njeriu dhe kafshët) shkojnë në po atë vend (varri); të gjithë vijnë nga pluhuri dhe kthehen në pluhur " (Pre. 3:19,20). Shkruesi i frymëzuar i Predikuesve u lut që Zoti ta ndihmonte njeriun që ta çmonte këtë fakt të rëndë, "që (njeriu) vetë të kuptojnë që janë si kafshë" (Pre. 3:18). Prandaj është e pritshme që shumë njerëz e kanë të vështirë ta pranojnë këtë fakt; në fakt, mund të jetë poshtëruese të kuptosh që prej natyre ne jemi vetëm kafshë, duke jetuar të njëjtat instinkte të vetë-mbrojtjes, mbijetesës së më të zotit dhe të riprodhimit. Përkthimi i N.I.V. për Pre.3:18 thotë që Zoti 'e vë në provë' njeriun duke e bërë të kuptojë që ai është thjesht një kafshë; d.m.th. ata që janë mjaft të përulur për të qenë populli i tij i vërtetë do të kuptojnë të vërtetën e kësaj, por ata që nuk janë nuk do ta kalojnë këtë 'provë'. Filozofia e humanizmit - idea që qeniet njerëzore janë të një rëndësie dhe vlere kaq supreme – është shpërndarë qetësisht gjithandej nëpër botë gjatë shekullit të njëzetë. Është një detyrë e konsiderueshme të qartësojmë të menduarit tonë nga ndikimi i humanizmit. Fjalët e hapura të Ps. 39:5 janë ndihmë: "Njeriu në gjendjen e tij më të mirë nuk është veçse avull". "Njeriu që ecën nuk ka fuqi të drejtojë hapat e tij" (Jer. 10:23).

Një nga gjërat më themelore që dimë ne është se të gjithë trupat njerëzorë – në fakt të gjithë "qeniet e gjalla" – si përfundim vdesin. Prandaj 'shpirti' vdes; është saktësisht e kundërta e diçkaje që është e pavdekshme. Nuk është aspak për t'u çuditur që një e treta e gjithë përdorimeve të fjalëve të përkthyer 'shpirt' në Bibël janë të shoqëruara me vdekjen dhe shkatërrimin e shpirtit. Vetë fakti që fjala 'shpirt' është përdorur në këtë mënyrë tregon se është diçka që nuk mund të jetë e pashkatërrueshme dhe e pavdekshme:-

- "Shpirti që ka mëkatuar, do të vdesë" (Eze. 18:4).

- Zoti mund ta shkatërrojë shpirtin (Mat. 10:28). Referenca të tjera të shpirtrave të shkatërruara janë: Eze. 22:27; Prov. 6:32; Lev. 23:30.
- të gjithë "shpirtrat" që ishin në qytetin e Hazorit u prenë nga shpata (Josh. 11:11; kra. Josh. 10:30-39).
- "...çdo shpirt i gjallë vdiq" (Zbu. 16:3; kra. Ps. 78:50).
- Shpesh Ligji i Moisiut urdhëroi që çdo "shpirt" që nuk iu bind ligjeve të caktuara duhej të vritej (p.sh. Num. 15:27-31).
- Kur flitet për shpirtin të varet ose mbytet ka kuptim vetëm nëse shpirt është i vdekshëm (Prov. 18:7; 22:25; Job 7:15).
- "Asnjëri nuk mund ta mbajë gjallë shpirtin e tij" (Ps. 22:29).
- Krishti "e ka përkushtuar shpirtin e tij deri në vdekje" që "shpirti" ose jeta e tij, të ofrohej flijim për mëkatin (Isa. 53:10,12).

Që 'shpirti' i referohet personit dhe jo ndonjë shkëndie të pavdekshme brenda nesh tregohet nëpërmjet shumicës së vargjeve ku përmendet fjala. Disa shembuj të dukshëm janë:-

- "Gjaku i shpirtrave" (Jer. 2:34).
- "Nëse një shpirt mëkaton dhe dëgjon zërin e betimit...po të jetë se nuk e kallzon...kur një shpirt prek diçka të papastër...nëse një shpirt betohet, duke e folur me buzët e tij" (Lev. 5:1-4).
- "O shpirti im...gjithçka është brenda meje...beko Zotin, o shpirti im...ai të ngop me të mira gojën tënde" (Ps. 103:1,2,5).
- "ai që don të shpëtojë jetën ('shpirtin') e vet do ta humbasë; por ai që do ta humbasë jetën ('shpirtin')e vet për hirin tim...do ta shpëtojë" (Mark 8:35).

Kjo është provë e mjaftueshme që shpirti nuk i referohet ndonjë elementi shpirtëror brenda njeriut; këtu, 'shpirt' (në Greqisht 'psuche') thjesht do të thotë jeta fizike e dikujt, e cila është siç është përkthyer këtu.

- Num. 21:4 tregojnë se një grup njerëzish mund të kenë një "shpirt". Prandaj "shpirti" nuk mund t'i referohet një shkëndije të pavdeksisë personale brenda secilit prej nesh.

4.3 Fryma e Njeriut

Fatkeqsisht egziston një ngatëresë në shumë mendjet e njerëzve midis shpirtit dhe frymës. Kjo keqësohet edhe më nga fakti që në disa gjuhë dhe përkthime të Biblës fjala anglishte 'soul' dhe 'spirit' kanë vetëm një përkatëse. 'Shpirti' ('soul') që në themel i referohet të gjitha përbërëseve të një personi nganjëherë mund t'i referohen edhe frymës (spirit). Megjithatë, normalisht ka një dallim në kuptim midis 'shpirtit' dhe 'frymës' siç përdoren në Bibël; shpirti dhe fryma mund të 'ndahen veçmas' (Heb. 4:12).

Fjalët hebraishte dhe greke për 'frymën' (përkatësisht 'Ruach' dhe 'Pneuma') gjithashtu përkthehen në mënyrat e mëposhtme:-

Jetë	Frymë
Mendje	Erë
Frymë	

Ne e kemi studiuar idenë e 'frymës' në kpitullin 2.1. Zoti e përdor frymën e Tij për të ruajtur krijimin natyror, përfshirë njeriun. Fryma e Zotit që është brenda njeriut është, pra, forca e jetës brenda tij. "Trupi pa frymën është i vdekur" (Jak. 2:26). "Zoti i fryu (në vrimat e hundës së adomit) një frymë jete (spirit); dhe njeriu u bë një shpirt (qenie) i gjallë [Zan. 2:7]". Jobi flet për "frymën e Zotit" si me qenë "në vrymat e hundës sime" (Job 27:3 krahu. Isa. 2:22). Fryma e jetës brenda nesh na është dhënë, pra, në lindje dhe mbetet për sa kohë trupi ynë është gjallë. Kur fryma e Zotit tërhiqet nga çdo gjë, menjëherë prishet - fryma është forca jetësore. Sikur Zoti "të tërhiqte mbi vete Frymën e Tij dhe frymën e Tij; çdo mish do të shkatërrohej njëkohësisht dhe njeriu do të kthehej në pluhur. Në qoftë se ke mend dëgjoje këtë" (Job 34:14-16). Prapë fjalia e fundit të lë të kuptosh që njeriu e ka shumë të vështirë ta pranojë këtë zbulim të natyrës së tij të vërtetë.

Kur Zoti merr prej nesh në vdekje frymën e Tij, jo vetëm që shpirti ynë vdes, por e gjithë ndërgjegjja jonë shpëputet. Vlerësimi i kësaj prej Davidit e bëri atë që të besojë në Zotin në vend të qenieve të dobëta si njerëzit. Psalmet 146:3-5 është një kundërshtim i vështirë ndaj teorisë së

humanizmit: "Mos kini besim te princat dhe as te ndonjë bir njeriu që nuk mund të shpëtojë. Kur fryma (spirit) e tij ikën ai kthehet përsëri në tokë (pluhuri prej së cilit jemi bërë); dhe po atë ditë mendimet e tij zhduken. Lum ai që ka Perëndinë e Jakobit si ndihmë".

Me vdekjen, "pluhuri (do të) kthehet në tokë siç ishte; dhe fryma do t'i kthehet Zotit që e dha" (Pre. 12:7). Ne treguam qëparë se Zoti është i pranishëm kudo nëpërmjet frymës së Tij. Në këtë kuadër "Zoti është Fryma" (Gjo. 4:24). Kur ne vdesim në 'marrim frymën e fundit' në kuptimin që fryma e Zotit brenda nesh shkëputet nga ne. Ajo frymë thithet në frymën e Zotit që është rreth e rrotull nesh; kështu në vdekje "fryma do të kthehet te Perëndia".

Meqenëse fryma e Zotit mban gjallë gjithë krijimin, i njëjti proces vdekjeje u ndodh kafshëve. Njerëzit dhe kafshët kanë të njëjtën frymë, ose forcë jete brenda tyre. "Ato që u ndodhin bijve të njerëzve u ndodhin kafshëve; të dy palëve u ndodh e njëjta gjë: ashtu si vdes njeri kështu vdes edhe tjetri; po të gjithë kanë po atë (d.m.th. të njëjtën) frymë (spirit); dhe njeriu nuk ka asnjë epërsi mbi kafshën" (Pre. 3:19). Shkruesi vazhdon të thotë që nuk ka dallim të perceptueshëm se ku shkon fryma e njeriut dhe ku ajo e kafshës (Pre. 3:21). Ky përshkrim i njerëzve dhe kafshëve që kanë të njëjtën frymë dhe vdekje, duket se aludon prapë te përshkrimi se si edhe njerëzit edhe kafshët, që patën frymën e jetës nga Perëndia, (Zan. 2:7; 7:15), u shkatërruan me të njëjtën vdekje gjatë përmbytjes: "U shuan të gjitha llojet e mishit që lëviznin mbi tokë, zogjtë, bagëtia, bishat, rrëshqanorët e çdo lloji që zvarriteshin mbi tokë dhe tërë njerëzit: vdiq... çdo gjë që kishte frymë (spirit) jete në vrimat e hundës ...të gjitha gjallesat u shfarosën" (Zan. 7:21-23). Vini re në vazhdim se si Ps. 90:5 krahason vdekjen me përmbytjen. Shkrimi në Zanafillën 7 tregon qartë se në terma themelorë, njeriu është në të njëjtën kategori "të gjithë llojet e mishit... çdo gjallesë". Kjo është për shkak se ai ka brenda tij të njëjtën frymë që kanë edhe ato.

4.4 Vdekja është pa ndjenja

Nga ç'ka kemi mësuar deri tani për shpirtin dhe frymën, i bie që, ndërsa i vdekur, një person është tërësisht pa ndjenja. Ndërkohë veprimet e atyre që janë të përgjegjshëm ndaj Zotit do të mbahen mend prej Tij (Mal. 3:16; Zbu. 20:12; Heb. 6:10), nuk ka asgjë në Bibël që sugjeron se ne kemi ndonjë ndërgjegje gjatë gjendjes së vdekjes. Është e vështirë t'i kundërshtosh thëniet e qarta të mëposhtme lidhur me këtë:-

- "Fryma (e njeriut) ikën, ai kthehet në tokën e tij; në po atë ditë (çast) mendimet e tij shkatërrohen" (Ps. 146:4).
- "Të vdekurit nuk dinë asgjë...dashuria e tyre, urrejtja e tyre dhe smira e tyre janë zhdukur tashmë" (Pre. 9:5,6). Nuk ka "zgjuarsi në varr" (Pre. 9:10) – as të menduar dhe, pra, as ndërgjegje.
- Jobi thotë se në vdekje, ai do të ishte "si të mos kisha egzistuar kurrë" (Job. 10:18); ai e pa vdekjen si braktisje, pandërgjegjisi dhe mungesë totale të egzistencës, të cilën e patëm para se të kishim lindur.
- Njeriu vdes si kafsha (Pre. 3:18); sikur njeriu të mbijetonte në ndërgjegje, po ashtu edhe kafshët, megjithatë edhe Shkrimet edhe shkenca janë të heshtur për këtë.
- Zoti "nuk harron që ne jemi pluhur. Ditët e njeriut janë si bari: ai lulëzon si lulja e fushës...nuk është më; dhe vendi i tij nuk njihet më" (Ps. 103:14-16).

Që vdekja është vërtetë pa ndjenja, edhe për të drejtin, tregohet nga lutjet e përsëritura të shërbyesve të Zotit që t'i zgjasë jetët e tyre, sepse ata e dinin që pas vdekjes ata nuk do të ishin në gjendje të lavdëronin dhe falenderonin Zotin duke parë që vdekja është një gjendje e pandërgjegjshme. Hezekiah (Isa. 38:17-19) dhe Davidi (Ps. 6:4,5; 30:9; 39:13; 115:17) janë shembuj të mirë të kësaj. Për vdekjen flitet herë pas here si për gjumin ose pushimin, si për të drejtin ashtu edhe për të ligun (Job 3:11,13,17; Dan. 12:13).

Tani për ne është prodhuar evidencë e mjaftueshme për ta thënë copë që nocioni i përhapur për të drejtin që shkon në një gjendje ngazëllimi dhe shpërblimi drejt e në parajsë pas vdekjes, thjesht nuk gjendet në Bibël. Teoria e vërtetë e vdekjes dhe e natyrës së njeriut jep një ndjesi të madhe paqeje. Pas gjithë tronditjeve dhe dhimbjeve të jetës së njeriut, varri është një vend i harresës së përgjithshme. Për ata që nuk i kanë njohur kërkesat e Zotit, kjo harresë do të zgjatë përgjithmonë. Pikët e vjetra të kësaj jete natyrore tragjike dhe të papërbushur nuk do të ngrihen kurrë më; shpresat dhe frika e kotë e mendjes natyrore njerëzore nuk do të realizohen dhe kërcënohen.

Në studimin e Biblës ka një sistem të vërtetash për t'u zbuluar; megjithatë, fatkeqsisht është edhe një sistem gabimesh në të menduarit fetar të njeriut, për shkak të mosvëmendjes ndaj Biblës. Përpjekjet e dëshpëruara të njeriut për të zbutur përfundimin e vdekjes e kanë bërë atë të besojë se ai ka një

'shpirt të pavdekshëm'. Sapo pranohet që egziston një element i tillë i pavdekshëm brenda njeriut, vjen domosdoshmëria e të menduarit që duhet të shkojë diku pas vdekjes. Kjo ka çuar në mendimin që në vdekje duhet të ketë ndonjë ndryshim midis fatit të të drejtit dhe të ligut. Për të strehuar këtë, është arritur në përfundimin që duhet të jetë një vend ku shkojnë 'shpirtrat e mirë të pavdekshëm', i quajtur Parajsë, dhe një vend tjetër, ku shkojnë 'shpirtrat e këqinj të pavdekshëm', i quajtur ferr. Ne kemi treguar më parë që një 'shpirt i pavdekshëm' është një pamundësi biblike. Tani do të analizohen idetë e tjera të rreme të përmbytura në arsyetimin e përhapur:-

1. Që shpërblimi për jetët tona jepet në vdekje në trajtën e 'shpirtit tonë të pavdekshëm' që i caktohet një vendi të caktuar.
2. Që ndarja e të drejtëve nga të ligjtë ndodh në vdekje.
3. Që shpërblimi për të drejtin është të shkojë në parajsë.
4. Që nëse të gjithë kanë një 'shpirt të pavdekshëm', atëherë të gjithë duhet të shkojnë ose në parajsë ose në ferr.
5. Që 'shpirtrat' e këqinj do të shkojnë në një vend ndëshkimi të quajtur ferr.

Qëllimi i analizës sonë nuk është vetëm negativ; me shqyrtimin e këtyre pikave me hollësi, ne besojmë që do të shprehim shumë elemente të së vërtetës së Biblës, të cilat janë pjesë jetike të panoramës së vërtetë të natyrës së njeriut.

4.5 Ringjallja

Bibla thekson se shpërblimi i të drejtit do të jetë në ringjalljen, në ardhjen e Krishtit (1 Thes. 4:16). Ringjallja e të vdekurit të përgjegjshëm (kapitulli 4.8) do të jetë gjëja e parë që do të bëjë Krishti; kjo do të pasohet nga gjykimi. Sikur 'shpirti' të shkonte në parajsë pas vdekjes nuk do të kishte nevojë për ringjallje. Pali tha që po të mos ketë nevojë për ringjallje, atëherë gjithë përpyekja për të qenë të bindur ndaj Zotit është e kotë (1 Kor. 15:32). Sigurisht ai nuk do të kishte arsyetuar kështu në qoftë se edhe ai besonte që do të shpërblehej me shpurjen e 'shpirtit' të tij në parajsë pas vdekjes? Vështirësia është se ai besoi ringjalljen e trupit si të vetmen trajtë të shpërblimit. Krishti na dha shtysë me pritjen që shpërblimi për jetesë besnike tani do të jetë tek "ringjallja" (Lluka 14:14).

Përsëri duhet të bëhet e qartë që Bibla nuk na mëson ndonjë trajtë egzistence veçmas nga trajta trupore – kjo ka vend si për Zotin ashtu edhe për Krishtin, ëngjëjt dhe njerëzit. Kur të kthehet Krishti “do ta transformojë trupin tonë të përunjur, që të bëhet i ngjashëm me trupin e tij të lavdishëm” (Fil. 3:20,21). Siç ka ai tani një trajtë trupore, të fuqizuar nga Fryma e pastër dhe jo nga gjaku, edhe ne do të kemi pjesë në të njëjtin shpërblim. Me ardhjen gjykimit ne do të shpërblehemi për mënyrën se si e kemi jetuar këtë jetë në trajtën trupore (2 Kor. 5:10). Ata që kanë jetuar një jetë sipas mishit do të lihen me trupin e tyre të vdekshëm të tanishëm, që pastaj do të kalbet papë në pluhur; ndërsa ata që janë përpjekur të ngrihen mbi mendjen e mishit me atë të frymës “do të korrë nga Fryma jetë të përjetshme” (Gal. 6:8) në trajtën e një trupi të mbushur me frymë.

Ka fakte të tjera të shumta se shpërblimi i të drejtit do të jetë në trajtën trupore. Kur pranohet kjo, del në pah rëndësia jetike e ringjalljes. Është e qartë se trupi ynë i tanishëm pushon së qëni pas vdekjes; në qoftë se ne provojmë jetën e përjetshme dhe pavdeksinë vetëm në një trajtë trupore, atëhere vdekja duhet të jetë gjendje e pandërgjegjshme, derisa të vijë koha kur trupi ynë të riformohet dhe t’i jepet natyra e Zotit.

E gjithë 1 Korintasve 15 flet në hollësi mbi ringjalljen; ka gjithmonë vend për lexim të kujdesshëm. 1 Kor.15:35-44 shpjegon se ashtu si fara mbillet dhe del nga toka për t’u dhënë trupi nga Perëndia, ashtu edhe i vdekuri do të ringjallet, për t’u shpërblyer me një trup. Ashtu si Krishti u ngrit nga varri dhe ndryshoi trupin e tij nga i vdekshëm në trup të pavdekshëm, edhe besuesi i vërtetë do të ketë pjesë në shpërblimin e tij (Fil. 3:21). Nëpërmjet pagëzimit ne e shoqërojmë veten tonë me vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit, duke treguar besimin tonë se edhe ne do të marrim shpërblimin që mori ai nëpërmjet ringjalljes (Rom.6:3-5). Nëpërmjet ndarjes së vuajtjeve me të tani, po ashtu do të ndajmë edhe shpërblimin e tij: “kurdo ne e mbajmë në trupin tonë vdekjen e Zotit Jezus, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në mishin tonë” (2 Kor. 4:10). “ai që e ringjalli Krishtin prej së vdekurish do t’u japë jetë edhe trupave tuaj vdekatarë me anë të Frymës së tij” (Rom. 8:11). Me këtë shpresë, ne, pra, presim për “shpengimin e *trupit* tonë” (Rom. 8:23), përmes bërjes së këtij trupi të pavdekshëm.

Kjo shpresë e shpërblimit tamam trupor ka qenë kuptuar nga njerëzit e Perëndisë që në kohërat e lashta. Abrahamit iu premtua se ai vetë do të trashëgonte tokën e Kanaanit për gjithmonë, siç ishte e sigurtë që po i binte vendit rreth e qark (Zan. 13:17; shih Kapitullin 3.4). Besimi i tij në këto

premtime nevojitte që ai të besonte që trupi i tij, në një ditë të ardhme do të ringjallej disi dhe bëhej i pavdekshëm që të mundësohej kjo.

Jobi e shprehu qartë se si e kuptonte që, edhe pse trupi i tij i ngrënë nga krimbat në varr, ai, në një trajtë trupore, do të shpërblehej: "Shpëtimtari im jeton dhe...në fund do të ngrihet mbi tokë: dhe mbasi krimbat e lëkurës sime shkatërrojnë këtë trup ("mbas shkatërrimit të lëkurës sime", R.A.V.), në mishin tim (ose në trajtë trupore) do të shoh Perëndinë: do ta shoh unë vetë dhe sytë e mi do ta sodisin dhe jo një tjetër: megjithse të përbrendshmet po më shkrihen brenda meje" (Job 19:25-27). Shpresa e Isaias ishte identike: "Trupi im i vdekur do të...ngrihet" (Isa. 26:19).

Fjalë shumë të ngjashme janë gjetur me rastin e vdekjes së Llazarit, një shok i ngushtë i Jezusit. Në vend që të ngushëllonte motrën e tij duke i thënë që shpirti i tij shkoi në parajsë, Zoti Jezus foli për ditën e ringjalljes: "Vëllai jot do të ngrihet përsëri". Përgjigja e menjëhershme e motrës së Llazarit, Marta, tregon sa shumë çmohej kjo nga Kristianët e hershëm: "Marta i tha, E di se do të ringjallet, në ringjallje ditën e fundit" (Gjo. 11:23,24). Si edhe Jobi, ajo nuk e kuptoi vdekjen si rrugën për te një jetë plot ngazëllim në parajsë, por, në vend të saj, shpresonte për një ringjallje "në ditën e fundit" (krah. me "në fund" të Jobit). Zoti premtonte: "Çdo njeri, pra, që ka dëgjuar dhe mësuar nga Ati...unë do ta ringjall atë në ditën e fundit" (Gjo. 6:44,45).

4.6 Gjykimi

Mësimet e Biblës në lidhje me gjykimin është një nga parimet themelore të besimit, i cili duhet të kuptohet qartë përpara pagëzimit (Vep. 24:25; Heb. 6:2). Shkrimet flasin shpesh për "ditën e gjykimit" (p.sh. 2 Pje. 2:9; 3:7; 1 Gjo. 4:17; Jude 6), dita kur ata, të cilëve u është dhënë njohuria e Perëndisë do të marrin shpërblimin e tyre. Të gjithë këta duhet "dalim përpara gjykatës së Krishtit" (Rom. 14:10); ne "dalim përpara gjyqit të Krishtit" (2 Kor. 5:10) për të marrë kompensimin për jetët tona në një trajtë trupore.

Parashikimi i Danielit për ardhjen e dytë të Krishtit, përfshiu një nga këto gjyqe në trajtë froni (Dan. 7:9-14). Shëmbëlltyrat ndihmojnë për të qartësuar në njëfarë mënyre hollësisht. Ajo e talenteve i ngjan asaj të kthimit të zotërisë, që thërret shërbyesit e tij dhe shikon si i kanë përdorur paratë që u kishte lënë kur iku. (Mat. 25:14-29). Shëmbëlltyra e peshkatarëve thekson ngjashmërinë e thirrjes së ungjillit me rrjetën e peshkimit, që mbledh të

gjithë llojet e njerëzve; atëhere njerëzit u ulën (krah. me uljen e gjykimit) dhe ndanë peshkun e mirë nga i keqi (Mat. 13:47-49). Kuptimi është i qartë: "në mbarimin e botës do të vijnë ëngjëjt dhe do t'i ndajnë të mbrapshtit nga të drejtët".

Nga sa kemi parë deri tani, është me vend të themi që mbas kthimit dhe ringjalljes së Zotit, do të bëhet një mbledhje së bashku me të gjithë ata që janë thirrur në ungjill në një kohë dhe vend të caktuar kur ata do të takohen me Krishtin. Do të jepet llogari prej tyre dhe ai do të tregojë nëse ata janë të pranueshëm për t'u shpërblyer me hyrjen në Mbretëri. Vetëm në këtë kohë të drejtët do të marrin shpërblimin e tyre. E gjithë kjo është sjellë prej shëmbëlltyrës së deleve dhe dhive: "Biri i njeriut do të vijë në lavdinë e tij, bashkë me të gjithë ëngjëjt e shenjtë, atëhere do të ulet mbi fronin e lavdisë së vet (fronin e Davidit në Jeruzalem, Lluca 1:32,33): dhe të gjithë kombet do të mblidhen përpara tij (d.m.th. njerëz nga të gjithë kombet, krah. Mat. 28:19): dhe ai do ta ndajë njerin nga tjetri ashtu si ndan bariu delet nga cjeptë. Dhe delet do t'i vërë në të djathtën e tij dhe cjeptë në të majtën. Atëhere Mbreti do t'u thotë atyre që do të jenë në të djathtën e tij, ejani, të bekuar të Atit tim, merrni në trashëgim Mbretërinë që u bë gati për ju" (Mat. 25:31-34).

Trashëgimi i Mbretërisë së Perëndisë, përmbushja e premtimeve ndaj Abrahamit lidhur me të, është shpërblimi i të drejtit. Megjithatë kjo do të ndodhë vetëm pas gjykimit që do të jetë me kthimin e Krishtit. Prandaj është e pamundur të marrësh shpërblimin e premtuar të një trupi të pavdekshëm përpara kthimit të Krishtit; prandaj na duhet të arrijmë në përfundimin se nga vdekja deri në ringjallje besimtari nuk ka fare egzistencë të ndërgjegjshme, duke ditur që është e pamundur të egzistojë ndonjë trajtë pa patur një trup.

Është një parim Biblik që *kur* të kthehet Krishti, *atëhere* do të jepet shpërblimi – dhe jo më përpara:-

- "*Kur* të shfaqet kryebariu (Jezusi), do të merrni kurorën e lavdisë" (1 Pje. 5:4 krah. 1:13).
- "Jezu Krishti...do të gjykojë të gjallë e të vdekur në dukjen e tij dhe në mbretërinë e tij...kurora e drejtësisë, që Perëndia, gjykatësi i drejtë, do të ma japë *atë ditë*" (2 Tim. 4:1,8).

- me kthimin e Mesisë në ditët e fundit, "shumë nga ata që flenë në pluhurin e tokës (krah. Zan. 3:19) do të zgjohen, disa në një jetë të përjetshme dhe të tjerë në turp " (Dan. 12:2).

- Kur të vijë Krishti në gjykim,ata "në varre...do të dalin prej tyre; ata që kanë bërë të mira, në ringjallje të jetës; dhe ata që kanë bërë të liga, në ringjalljen e dënimit " (Gjo. 5:25-29).

- "Unë (Jezusi) vij shpejt; dhe shpërblimi im është me mua, për t'i dhënë gjithsecilit sipas veprave që ai ka bërë" (Zbu. 22:12).
Ne nuk shkojmë në parajsë për të marrë shpërblimin - Krishti na e sjell atë prej parajsës.

Që Jezusi sjell shpërblimin tonë me vete nënkupton që është përgatitur për ne në parajsë, por do të na silltë në tokë me ardhjen e dytë; "trashëgimia" jonë e tokës së premtuar Abrahamit është në këtë kuptim "ruajtur në qiejt për ju, që nga fuqia e Perëndisë me anë të besimit jeni ruajtur për shpëtimin gati për t'u zbuluar në kohët e fundit" të ardhjes së Krishtit (1 Pjetrit 1:4,5).

Vlerësimi i kësaj na aftëson të kuptojmë si duhet një pjesë të shumë keqkuptuar tek Gjo. 14:2,3: "Unë (Jezusi) po shkoj t'ju përgatis një vend. Dhe kur të shkoj e t'ju përgatis vendin (krah. spërblimi "ruajtur në qiejt"), unë do të kthehem dhe do t'ju marr pranë meje, që aty ku jam unë të jeni edhe ju ". Jezusi thotë diku tjetër se ai do të kthehet për të na dhënë shpërblimet (Zbu. 22:12), dhe ne e kemi parë që këto do të jepen në gjykimin e tij. Ai do të rrezatojë në fronin e Davidit në Jeruzalem "për gjithmonë" (Luka 1:32,33). Ai do ta kalojë përjetësinë këtu në tokë dhe atje ku do të jetë ai – në Mbretërinë e Perëndisë në tokë – atje do të jemi edhe ne. Premtimi i tij për "t'ju marr pranë meje" pra, mund të lexohet si një përshkrim i pranimit tonë prej tij në ditën e gjykimit. Shprehja greke, "t'ju marr pranë meje", përsëritet edhe tek Mat. 1:20 kur Jozefi "merr pranë vetes" Marinë për grua. Prandaj nuk e ka fjalën doemos për lëvizje fizike drejt Jezusit.

Meqë shpërblimi do të jepet vetëm në ditën e gjykimit në kthimin e Krishtit, rrjedhimisht i drejti dhe i ligu shkojnë në të njëjtin vend kur vdesin, d.m.th. varri. Nuk bëhet ndonjë dallim midis tyre në vdekje. Të mëposhtmet më se e vërtetojnë këtë:-

- Jonatan ishte i drejtë, por Sauli i lig, megjithatë " nuk u ndanë në vdekjen e tyre" (2 Sam. 1:23).
- Sauli, Jonatani dhe Samueli të gjithë në vdekje shkuan në të njëjtin vend (1 Sam. 28:19).
- Abrahami i drejtë u "bashkua me popullin e tij" , ose paraardhësit në vdekje; ata ishin idhujtarë (Zan. 25:8; Josh. 24:2).
- I urti dhe budallai provojnë të njëjtën vdekje (Pre. 2:15,16).

E gjithë kjo është në kundërshtim të mprehtë me pretendimet e 'Kristianizmit' të përhapur. Mësimet e tyre se i drejti shkon në parajsë menjëherë mbas vdekjes shkatërron nevojën për ringjallje dhe gjykim. Megjithatë ne kemi parë se këto janë ngjarje jetike në planin e Perëndisë për shpëtimin dhe, pra, edhe në lajmin e Ungjillit. Idea e mirëpritur sugjeron që një i drejtë vdes dhe shpërblehet duke u shpënë në parajsë, për t'u pasuar ditën tjetër, muajin tjetër, vitin tjetër nga të tjerë. Kjo bie në kundërshtim të mprehtë me mësimin e Biblës që *të gjithë* të drejtët do të shpërblehen *së bashku*, në të njëjtën kohë:-

- Delet ndahen nga dhitë në ditën e gjykimit, një nga një. Sapo të mbarojë gjykimi, Krishti do t'u thotë *të gjitha* deleve të mbledhura në të djathtën e tij,

"Ejani, të bekuarit e Atit tim, merrni në trashëgim Mbretërinë e përgatitur për ju" (Mat. 25:34). Kështu pra të gjitha delet e trashëgojnë Mbretërinë në të njëjtën kohë (krah. 1 Kor. 15:52).

- Në "të korrat" e kthimit të Krishtit dhe gjykimit, të gjithë ata që kanë punuar në Ungjill do të "ngazëlleshin *së bashku*" (Gjo. 4:35,36 krah. Mat. 13:39).

- Zbu. 11:18 përkufizon "koha që të gjykohen të vdekurit" si kohën Zoti do t'u "jepet paga shërbëtorëve të tu... shenjtoreve... atyre që druajnë emrin tend" - d.m.th. të gjithë besimtarëve *së bashku*.

- Hebrejve 11 është një kapitull që rreshton shumë emra të njerëzve të drejtë të Dhjatës së Vjetër. Vargu 13 komenton: "Këta të gjithë vdiqën në besim, pa i marrë premtimet" e bëra Abrahamit mbi shpëtimin me anë të hyrjes në Mbretërinë e Perëndisë (Heb. 11:8-12). I bie që pas vdekjes, këta njerëz nuk

shkuan në parajsë njëri pas tjetrit për të marrë një shpërblim. Arsya për këtë është dhënë në vargjet 39,40: ata "nuk morën atë që u ishte premtuar: Perëndia kishte paraparë diçka më të mirë për ne, që ata të mos arrinin në përsosje pa ne". Vonesa në dhënien e shpërblimit të premtuar ishte sepse plani i Zotit ishte që të gjithë të "bëheshin të përsosur" së bashku në të njëjtën kohë. Kjo do të jetë në ditën e gjykimit, me kthimin e Krishtit.

4.7 Vendi i shpërblimit: Parajsa apo Toka?

Përveç arsyeve të mësipërme, kushdo që akoma e ndjen se prapë parajsa është vendodhja e Mbretërisë së Perëndisë, d.m.th. shpërblimi i premtuar, ka nevojë që, gjithashtu, të shpjegojë pikat e mëposhtme:-

- 'Lutjet e Zotit' kërkon të vijë Mbretëria e Perëndisë (d.m.th. lutet për kthimin e Krishtit), pra dëshirat e Zotit do të realizohen këtu në tokë siç bëhen tani në parajsë (Mat. 6:10). Prandaj ne tani lutemi për Mbretërinë e Perëndisë që të vijë në tokë. Është një tragjedi që mijëra njerëz luten me këto fjalë pa u menduar, duke besuar Mbretëria e Perëndisë është vendosur plotësisht në qiejt dhe që toka do të shkatërrohet.

- "Lum ata që janë zemërbutë, sepse ata do ta trashëgojnë tokën" (Mat. 5:5) - jo "...sepse shpirtrat e tyre do të shkojnë në parajsë". Kjo aludon ndaj Psalmi 37, tërësia e të cilit thekson se shpagimi përfundimtar i të drejtës do të jetë mbi tokë. Po në atë vend që i ligu shijoi epërsinë e tij të përkohshme, i drejti do të shpërblehet me jetën e përhjetshme dhe të zotërojë po këtë tokë që të ligjtë e mbizotëruan një herë (Ps. 37:34,35). "Zemërbutët do të zotërojnë tokën...të bekuarit nga Zoti do të trashëgojnë tokën...Të drejtët do të trashëgojnë tokën dhe do të banojnë gjithnjë mbi të" (Ps. 37:11,22,29). Të jetosh përgjithnjë në tokë/tokën e premtuar përgjithnjë do të thotë që jeta e përhjetshme në parajsë është një pamundësi.

- "Davidi...vdiq dhe u varros...Davidi nuk është ngritur në qiell" (Vep. 2:29,34). Në vend të saj Pjetri shpjegoi se shpresa e tij ishte ringjallja prej të vekuave me kthimin e Krishtit (Vep. 2:22-36).

- Toka është arena e operacioneve të Zotit me njerëzimin: "Qiejtë janë qiejtë e Zotit, por tokën Ai ua ka dhënë bijve të njerëzve" (Ps. 115:16).
- Zbu. 5:9,10 paraqet një pamje të asaj që i drejti do të thotë kur të pranohen në gjykim: "(Krishti) na bëre mbretër dhe priftër për Perëndinë tonë: dhe do të mbretërojmë mbi dhe". Kjo pikturë e sundimit në Mbretërinë e Perëndisë mbi dhe përjashtohet nga koncepti i turbullt se ne do të shijojmë 'ngazëllimin' gjëkund në qiejt.
- Profecitë e Danielit kapitujt 2 dhe 7 jep konturet e një vazhdimësie të fuqive politike, së cilës më në fund do t'i mbivendoset Mbretëria e Perëndisë me kthimin e Krishtit. Mbizotërimi i kësaj mbretërie do të jetë "*nën* tërë qiejt", dhe do të mbushte "të gjithë tokën" (Dan. 7:27; 2:35 krah. v. 44). Kjo mbretëri e përjetshme "do t'i jepen popullit të shenjtoreve të më të Lartit" (Dan. 7:27); pra, shpërblimi i tyre është jetë e përjetshme në këtë mbretëri, që është e thënë të ndodhet mbi tokë, *nën* qiejt.

4.8 Përgjegjsia ndaj Zotit

Po të kishte njeriu një 'shpirt të pavdekshëm' prej natyre, ai do të detyrohej të kishte një fat të përjetshëm diku – ose në një vend shpërblimi ose ndëshkimi. Kjo sjell që secili është përgjegjës ndaj Zotit. Në dallim me këtë ne kemi treguar se si Bibla na mëson që prej natyre njeriu është si kafshët, pa asnjë trashëgim pavdeksie. Megjithatë, disa njerëzve u është ofruar jetë e ardhshme e përjetshme në Mbretërinë e Perëndisë. Duhet të jetë e dukshme që jo kushdo që ka jetuar do të ringjallet; ashtu si kafshët, njeriu jeton dhe vdes për t'u shpërbërë në pluhur. Por meqenëse do të ketë një gjykim, me disa që mallkohen dhe të tjerë që shpërblehen me jetë të përjetshme, ne duhet të nxjerrim përfundimin se do të ketë një kategori të caktuar midis njerëzve që do të ringjallet për t'u gjykuar dhe shpërblyer.

Ringjallja e dikujt varet nga përgjegjsia e tyre ndaj gjykimit. Baza e gjykimit tonë do të jetë përgjigja ndaj njohurisë sonë mbi fjalën e Perëndisë. Krishti shpjegoi: "Kush më hedh poshtë dhe nuk i pranon fjalët e mia, ka kush e gjykon: fjala që kam shpallur, do të jetë ajo që do ta gjykojë në ditën e

fundit" (Gjo. 12:48). Ata që nuk e kanë njohur ose kuptuar fjalën e Krishtit dhe, pra, nuk iu dha mundësia ta pranojnë ose ta kthejnë, nuk do t'u quhet në gjykim. "Të gjithë ata që kanë mëkatuar pa (njohur ligjin e Zotit) ligjin, do të humbasin gjithashtu pa ligj: dhe të gjithë ata që kanë mëkatuar nën ligjin (d.m.th. duke e ditur atë), do të gjykohen sipas ligjit" (Rom. 2:12). Kështu ata që nuk i kanë njohur kërkesat e Zotit do të zhduken si kafshët; ndërsa ata që e thyejnë me vetëdije ligjin e Zotit duhet të gjykohen dhe prandaj ringjallen për t'u vënë përballë atij gjyqi.

Në sytë e Zotit "mëkati nuk numërohet kur nuk ka ligj"; "mëkati është shkelje e ligjit (të Zotit)"; "me anë të ligjit arrihet njohja e mëkatis" (Rom. 5:13; 1 Gjo. 3:4; Rom. 3:20). Pa njohur ligjet e Zotit siç zbulohen në Fjalën e Tij, "mëkati nuk numërohet" ndaj një personi dhe prandaj ata nuk do të gjykohen ose ringjallen. Ata që nuk e dinë fjalën e Zotit, pra, do të mbeten të vdekur si kafshët dhe bimët, duke qenë se janë në të njëjtën pozitë. "Njeriu që... nuk kupton, është si kafshët që zhduken" (Ps. 49:20). "Shtrihen si delet në varr" (Ps. 49:14).

Njohja e rrugëve të Zotit na bën përgjegjës ndaj Tij për veprimet tona dhe prandaj sjell nevojën e ringjalljes dhe paraqitjes sonë në gjykim. Prandaj duhet kuptuar se nuk janë vetëm të drejtët ose të pagëzuarit që do të ringjallen, por të gjithë ata që janë përgjegjës ndaj Zotit për shkak të njohurisë së tyre mbi Të. Kjo është një temë e përsëritur shpesh në Shkrime:-

- Gjo. 15:22 tregon se njohja e Fjalës sjell përgjegjësi: "Po të mos kisha ardhur (Jezusi) dhe të mos u kisha folur atyre, nuk do të kishin faj: por tani nuk kanë asnjë shfajësim ('pretekst', A.V. mg.) për mëkatin e tyre". Romakëve 1:20-21 në ngjashmëri thotë se duke njohur Zotin njerëzit mbeten "pa shfajësim".
- "Çdo njeri, pra, që ka dëgjuar dhe mësuar për Atin...unë (Krishti) do ta ringjall atë në ditën e fundit" (Gjo. 6:44,45).
- Zoti vetëm "u shkel syrin" veprimeve të atyre që janë të paditur të mirëfilltë të rrugëve të Tij. Ata që i dinë rrugët e Tij, Ai i shikon dhe pret një përgjigje (Vep. 17:30).
- "Shërbëtori që e dinte vullnetin e zotërisë së tij dhe nuk u bë gati dhe nuk e kreu vullnetin e tij, do të rrihet shumë. Por ai që nuk e dinte, po të bëjë gjëra që meritojnë të rrahura, do të rrihet

më pak (p.sh. duke mbetur i vdekur). Kujt iu dha shumë do t'i kërkohej shumë: dhe kujt *njerëzit* i besuan shumë do t'i kërkohej më shumë " (Luka 12:47,48) – kështu sa më tepër *Zoti*?

- "Ai, pra, që di të bëjë të mirë dhe nuk e bën, bën mëkat " (Jak. 4:17).

- Përgjegjësia veçanërisht e Izraelit ndaj Zotit ishte për llogari të zbulimeve të Tij ndaj tyre lidhur me Vetën e Tij (Amos 3:2).

- Për shkak të kësaj doktrine të përgjegjësive, "do të qe më mirë për ta (që më vonë i kthyen shpinën Zotit) të mos e kishin njohur udhën e drejtësisë, sesa pasi e njohën, t'ia kthejnë shpinën urdhërimit të shenjtë që u qe dhënë" (2 Pje. 2:21). Pjesë të tjera lidhur me këtë përfshijnë: Gjo. 9:41; 3:19; 1 Tim. 1:13; Hos. 4:14; LiP. 1:39.

Të njohurit e Zotit që na bën përgjegjës para gjykimit, sjell që ata pa këtë njohje nuk do të ringjallen, duke qenë se ata nuk kanë nevojë të gjykohen dhe se mungesa e diturisë së tyre i bën ata "si kafshët që zhduken" (Ps. 49:20). Ka tregues të shumtë se jo të gjithë ata që kanë jetuar një herë do të ringjallen:-

- Njerëzit e Babilonisë së lashtë "nuk do të ngrihen" pas vdekjes së tyre sepse ata nuk e njihnin Zotin e vërtetë (Jer. 51:39; Is. 43:17).

- Isaia i dha kurajo vetes: "O Zot Perëndia ynë (i Izraelit), zotër të tjerë na kanë sunduar (p.sh. Filistinët dhe Babilonasit)...ata kanë vdekur, ata nuk do të jetojnë (më); ata që shkuan nuk do të ngrihen...ke zhdukur çdo kujtim të tyre". (Is. 26: .13,14). Vini re theksimin e trefishtë këtu që ata nuk do të ringjallen:"Nuk do të jetojnë (përsëri)...nuk do të ngrihen...gjithë kujtimet e tyre të zhduken". Ndërsa, Izraeli kishte shpresën e ringjalljes për llogari të njohurisë së tyre mbi Zotin e vërtetë:"Të vdekurit e tu (e Izraelit) do të rijetojnë, së bashku me kufomën time do të ringjallen" (Is. 26:19).

- Duke folur për popullin e Zotit, Izraelin, ne na është thënë se me kthimin e Krishtit, "shumë prej tyre që flenë në pluhur të tokës do të zgjohen, disa në jetë të përjetshme dhe disa në turpin dhe në poshtërsi të përjetshme"(Dan. 12:2). Kështu "shumë",

por jo të gjithë, prej hebrenjve do të ringjallen sipas përgjegjesisë së tyre ndaj Zotit si të zgjedhurit e Tij. Ata syresh që janë krejtësisht të paditur ndaj njohurisë së Perëndisë së tyre të vërtetë "do të bien dhe nuk do të ngrihen kurrë më", meqenëse nuk janë në gjendje të gjejnë "fjalën e Zotit" (Amos 8:12,14).

PRA, DERI TANI KEMI MËSUAR QË:-

1. Njohja e Fjalës së Zotit sjell përgjegjisi ndaj Tij.

2. Vetëm përgjegjisi do të ringjallet dhe gjykohet.

3. Ata që nuk e njohin Zotin e vërtetë do të mbeten, pra, të vdekur si kafshët.

Implikimet e këtyre përfundimeve i japin një goditje të fortë krenarisë njerëzore dhe asaj që do të donim të besonim natyrshëm: miliona njerëz, si tani ashtu edhe gjatë historisë që nuk e kanë ditur Ungjillin e vërtetë; të sëmurët rëndë mendor, që nuk janë të aftë ta kuptojnë mesazhin e Biblës; bebet dhe fëmijët e vegjël që kanë vdekur përpara se të ishin në moshë për të vlerësuar Ungjillin; të gjitha këto grupe bien në kategorinë e atyre që nuk kanë pasur njohuri të vërtetë ndaj Zotit dhe prandaj nuk janë përgjegjës ndaj Tij. Kjo do të thotë që ata nuk do të ringjallen, pavarësisht nga gjendja shpirtërore e prindërve të tyre. Kjo bie krejt në kundërshtim me humanizmin dhe gjithë ndjenjat dhe dëshirat tona prej natyre; megjithatë një përlulje e vërtetë para Fjalës së Zotit mbi të vërtetën vendimtare, e shoqëruar me një opinion të përlulur të natyrës sonë, do të na udhëheqë të pranojmë të vërtetën e kësaj. Një shqyrtim i hapur i fakteve të përvojës njerëzore, edhe pa udhëheqjen e Shkrimeve, gjithashtu do të udhëheqë në përfundimin se nuk mund të ketë shpresë të jetës së ardhshme për grupet e përmendura më sipër.

Të vësh në pikëpyetje udhët e Perëndisë është gabim i madh: "Po kush je ti, o njeri që i kundërpërgjigjesh Perëndisë?" (Rom. 9:20 A.V. mg.). Ne mund të pranojmë që nuk e kuptojmë, por kurrë nuk duhet të akuzojmë Zotin për padrejtësi. Implikimi që Zoti mund të mos jetë i dashur ose në gabim në ndonjë mënyrë i hap rrugë mundësisë së frikshme të një Krijuesi, Ati dhe Perëndie të gjithfuqishëm që i trajton krijesat në një mënyrë të paarsyeshme dhe të padrejtë. Historia e humbjes së foshnjës së mbretit David është shembull ndihmë; 2 Sam. 12:15-24 tregon se si Davidi u lut shumë për fëmijën kur ishte akoma gjallë, por ai me vërtetësi pranoi përfundimin me vdekje të tij: "Kur fëmija ishte akoma i gjallë, unë agjëronja dhe qaja: sepse

thoja, Kushedi Zotit mund t'i vijë keq për mua dhe e lë fëmijën të jetojë? Por tani ai ka vdekur. Pse duhet të agjëroj? A kam mundësi ta kthej?...ai nuk do të kthehet te unë". Atëhere Davidi ngushëlloi gruan e vet dhe pati një fëmijë tjetër sa më shpejt që të mundte.

Si përfundim duhet thënë se shumë njerëz, në kapjen e këtij parimi përgjegjës ndaj Zotit, mendojnë që nuk dëshirojnë ta njohin Atë më tepër se mos bëhen përgjegjës ndaj Tij dhe gjykimit. Megjithatë ka të ngjarë që njerëz të tillë janë tashmë përgjegjës në një farë mase ndaj Zotit, duke qenë se njohja e Fjalës së Zotit u ka bërë të ditur që Zoti është duke punuar në jetët e tyre, duke u ofruar një marrëdhënie të vërtetë me Të. Duhet mbajtur mend përjetë që "Zoti ËSHTË dashuri", Ai "nuk do që ndonjë të humbasë" dhe "dha birin e Tij të vetëmlindurin, që, kushdo që beson të, të mos humbasë, por të ketë jetë të përjetshme" (1 Gjo. 4:8; 2 Peter 3:9; Gjo. 3:16). Zoti na do në Mbretërinë e Tij.

Një nder dhe privilegj i tillë sjell në mënyrë të paevitueshme përgjegjës. Por prapë ato nuk janë bërë që të jenë shumë të rënda ose shqetësuese për ne; nëse ne vërtet e duam Zotin, ne do ta çmojmë që oferta e tij e shpëtimit nuk është një shpërblim vetvetiu për vepra të caktuara, por një dëshirë e dashur nga ana e Tij për të bërë ç'është e mundur për fëmijët e Tij, për t'u dhënë jetën e përjetshme të lumturisë, me anë të vlerësimit prej tyre të karakterit të mrekullueshëm të Tij.

Siç vijmë të adhurojmë dhe dëgjojmë thirrjen e Perëndisë për ne me anë të fjalës së Tij, ne do të kuptojmë se duke ecur nëpër turma, Zoti është duke na vështruar me një intensitet të veçantë, duke pritur me padurim për shenja të përgjigjes sonë ndaj dashurisë së Tij, se sa të presi kur ne të dështojmë në përmbushjen e përgjegjësisë tona. Kurrë nuk hiqet prej nesh ai sy me dashuri; kurrë nuk mund të harrojmë ose të ç'bëjmë njohurinë tonë për Të me qëllim që t'i jepemi mishit, pa përgjegjës ndaj Perëndisë. Përkundrazi, ne mund dhe duhet të gëzojmë afërsinë e veçantë që kemi me Perëndinë dhe kështu të besojmë në madhësinë e dashurisë së Tij, që të kërkojmë gjithnjë e më tepër ta njohim Atë. Dashuria jonë për udhët e Perëndisë dhe dëshira për t'i njohur ato, që ta kopjojmë me më shumë saktësi, duhet ta mbipeshojë frikën tonë të natyrshme ndaj shenjtërisë së Tij supreme.

4.9 Ferri

Koncepti i përhapur i ferrit është si një vend i dënimit për 'shpirtrat e pavdekshëm' të këqinj menjëherë pas vdekjes, ose si vendi i torturës për ata që nuk pranohen në gjykim. Është bindja jonë që Bibla na mëson se ferri është varri, ku të gjithë njerëzit shkojnë pas vdekjes.

Si fjalë, fjala origjinale hebraishte 'sheol', e përkthyer 'ferr', do të thotë një 'vend i mbuluar'. 'ferri' është versioni i anglishtuar i 'sheol'-it; kështu kur ne lexojmë 'ferr' nuk lexojmë një fjalë që është përkthyer tërësisht. Një 'helmet' ('helmetë') është fjalë për fjalë një 'ferr-met', që do të thotë mbulesë për kokën. Biblikisht, ky 'vend i mbuluar', ose 'ferr', është varri. Ka shumë shembuj ku fjala 'sheol' nga origjinali është përkthyer 'varr'. Në të vërtetë disa versione moderne të Biblës aty këtu e përdorin fjalën 'ferr', duke e përkthyer më tepër si 'varr'. Pak shembuj se ku kjo fjalë 'sheol' është përkthyer 'varr' do të godiste rëndë konceptin shumë të përhapur të ferrit si një vend të zjarrit dhe torturës për të ligjtë:-

- "të pabesët ...rënçin në heshtje në varr" (sheol [Ps. 31:17]) - ata nuk do të jenë duke ulëritur në ankth.
- "Zoti do ta shpengojë shpirtin tim nga pushteti i varrit" (sheol [Ps.49:15]) - d.m.th. shpirti i Davidit ose trupi do të ringjallej nga varri, ose 'ferr'.

Besimi se ferri është një vend i ndëshkimit për të pabesët, të cilit ata nuk mund t'i shpëtojnë, thjesht nuk shkon me këtë; një njeri i drejtë mund të shkojë në ferr (varr) dhe të dali jashtë prapë Ose. 13:14 e konfirmon këtë: "Unë do t'i shpengoj ata (popullin e Perëndisë) nga pushteti i varrit (sheolit); unë do t'i shpëtoj nga vdekja". Kjo citohet në 1 Kor. 15:55 dhe i kushtohet ringjalljes në kthimin e Krishtit. Ashtu si në vizionin e ringjalljes së dytë (shih Kapitullin 5.5), "vdekja dhe ferri dorëzuan të vdekurit që ishin në ta" (Zbu. 20:13). Vini re paralelizmin midis vdekjes, d.m.th. varrit, dhe ferrit (shih gjithashtu Ps. 6:5).

Fjalët e Anës në 1 Sam. 2:6 janë shumë të qarta: "Zoti të bën të vdesësh dhe të bën të jetosh (nëpërmjet ringjalljes): të zbret në varr (sheol), dhe të ngjit që andej".

Duke parë që 'ferr' është varri, duhet të pritët që i drejti të shpëtohet prej tij nëpërmjet ringjalljes në jetën e përjetshme. Kështu është goxha e mundshme të hysh në 'ferr', ose varr dhe më vonë të largohesh prej tij nëpërmjet ringjalljes. Shembulli suprem është ai i Jezusit, i të cilit "shpirt nuk u la në

ferr, as mishi i tij nuk pa prishje" (Vep. 2:31) sepse ai u ringjall. Vini re paralelin midis 'shpirtit' të Krishtit dhe 'mishit' të tij ose trupit. Që trupi i tij "nuk u *la* në ferr" nënkupton që ishte atje për një periudhë, d.m.th. tre ditët në të cilat trupi i tij ishte në varr. Që Krishti shkoi në 'ferr' duhet të jetë provë e mjaftueshme që nuk është vend vetëm ku të ligjtë shkojnë.

Edhe njerëzit e mirë edhe të këqinjët shkojnë në 'ferr', d.m.th. varr. Kështu Jezusi " kishin caktuar ta varrosnin bashkë me të pabesët" (Is. 53:9). Në linjë me këtë, ka dhe shembuj të tjerë të njerëzve të drejtëqë shkojnë në ferr, d.m.th. varr. Jakobi tha se ai do të "zbres në varr (ferr)...për të mbajtur zi" për birin e tij Jozef (Zan. 37:35).

Është një nga parimet e Zotit që ndëshkimi për mëkatin është vdekja (Rom. 6:23; 8:13; Jak. 1:15). Ne e kemi treguar më parë që vdekja është gjëndje e mungesës së plotë të ndërgjegjes. Mëkati të çon në shkatërrim të plotë, jo toturë të përjetshme (Mat. 21:41; 22:7; Mark 12:9; Jak. 4:12), si njerëzit që u shkatërruan nga përmytja (Lluka 17:27,29) dhe siç vdiqën Izraelitët në shkretëtirë (1 Kor. 10:10). Në të dy këto raste mëkatarët *vdiqën* në vend që të torturoheshin përjetsisht. Prandaj është e pamundur që të ligjtë të ndëshkohen me torturë të përjetshme të ndërgjegjes dhe vuajtje.

Ne gjithashtu kemi parë se Zoti nuk e quan mëkatin - ose t'ia shtojë dosjeve tona - nëse ne nuk e njohim fjalën e Tij (Rom. 5:13). Ata në këtë pozicion do të mbeten të vdekur. Ata që i kanë njohur kërkesat e Zotit do të ringjallen dhe gjykohen në kthimin e Krishtit. Nëse janë të këqinj, ndëshkimi i tyre do të jetë vdekje, sepse ky është gjykimi për mëkatin. Prandaj pas ardhjes para gjykimit të Krishtit, ata do të ndëshkohen dhe vdesin prapë për të qendruar të vdekuar përgjithnjë. Kjo do të jetë "vdekja e *dytë*", për të cilën është folur në Zbu. 2:11; 20:6. Këta njerëz do të kenë vdekur një herë, vdekje e plotë e ndërgjegjes. Ata do të ringjallen dhe gjykohen në kthimin e Krishtit dhe pastaj do të ndëshkohen me një vdekje të dytë, e cila si edhe vdekja e parë, do të jetë mungesë e plotë e ndërgjegjes. Kjo do të zgjasë përgjithmonë.

Ky është kuptimi që ndëshkimi për mëkatin është 'i përjetshëm', në atë vdekja e tyre nuk do të ketë mbarim. Të mbetesh i vdekur përgjithmonë është një ndëshkim i përjetshëm. Një shembull i Biblës që përdor këtë lloj shprehjeje gjendet në LiP. 11:4. Kjo përshkruan shkatërrimin e një-hershëm të ushtrisë së Faraonit nga Zoti në Detin e Kuq si një shkatërrim që zgjat në përjetsi në atë që kjo ushtri nuk e shqetësoi Izraelin kurrë më, "Ai derdhi mbi ta ujrat e Detit të Kuq...dhe si i shkatërroi Zoti përgjithnjë".

Edhe në fillimet e Dhjatës së Vjetër besimtarët e dinin se do të kishte një ringjallje në ditën e fundit, pas së cilës të pabesët përgjegjës do të ktheheshin në varr. Job 21:30,32 është shumë i qartë: "I ligu... do të sillet përpara (d.m.th. ringjallet) në ditën e shkatërrimit... megjithatë do të sillet (pastaj) në varr". Një nga shëmbëlltyrat për kthimin e Krishtit dhe gjykimin flet për të ligun që 'vritet' para tij (Luke 19:27). Kjo mezi bën vend në idenë që i ligu egziston përgjithnjë në një gjendje të ndërgjegjshme, duke u torturuar vazhdimisht. Në çdo rast, ky do të ishte një ndëshkim i paarsyeshëm – torturë *e përjetshme* për gjërat e 70 vjetëve. Perëndia nuk ndjen kënaqsi në ndëshkimin e të këqijve; prandaj është e pritshme që Ai të mos zbatojë ndëshkim për ta në përjetësi (Eze. 18:23,32; 33:11 krah. 2 Pjeter 3:9).

Braktisësit e Kristianizmit shpesh e shoqërojnë 'ferrin' me idenë zjarrit dhe të torturës. Kjo është në dallim të mprehtë me mësimet e Biblës për ferrin (varrin). "Si delet ata shtrihen në varr (ferr); vdekja do t'i përpijë" (Ps. 49:14) nënkupton që varri është një vend i harresës së paqtë. Pavarësisht se shpirti ose trupi i Krishtit, ishte në ferr për tre ditë, nuk vuajti prishje (Vep. 2:31). Kjo do të kishte qenë e pamundur po të ishte ferri vend zjarri. Eze. 32:26-30 jep një pamje të luftëtarëve të fuqishëm të kombeve rreth e rrotull të shtrirë të qetë në varret e tyre: "Heronjtë e rënë (në betejë)... që kanë zbritur në ferr me armët e tyre të luftës: dhe që shpatat e tyre janë vënë në kokat e tyre...ata do të shtrihen...me ata që zbresin në gropë". Kjo e ka fjalën për zakonet e varrosjes së luftëtarëve me gjithë armët e tyre dhe mbështesin kokën e kufomave mbi shpatë. Dhe prapë ky është një përshkrim i "ferrit" - varrit. Këta heronj të shtrirë palëvizur në ferr (d.m.th. varret e tyre), s'para e mbështet idenë që ferri është një vend zjarri. Gjëra fizike (p.sh. shpatat) shkojnë në të njëjtin "ferr" si njerëzit, duke treguar se ferri nuk është një arenë e torturës shpirtërore. Kështu Pjetri i tha një të ligu, "Paratë e tua do të zhduken me ty"(Vep. 8:20).

Historia e përvojës së Jonas, gjithashtu bie në kundërshtim me të. Duke qenë i gëlltitur për së gjalli nga një peshk i madh gjigant, "Jona iu lut Zotit Perëndi që nga barku i peshkut dhe tha, unë i thirra ...Zotit...që nga barku i ferrit i thirra unë" (Jonah 2:1,2). Kjo paralelizon "barkun e ferrit" me atë të një balene. Barku i balenës ishte vërtetë një 'vend i mbuluar', që është kuptimi themel i fjalës 'sheol', e përkthyer 'ferr'. Duket qartë që nuk është vend zjarri dhe Jona doli jashtë nga "barku i ferrit" kur balena e vulli përjashta. Kjo tregoi rrugën për te ringjallja e Krishtit nga 'ferri' (varr) - shih Mat. 12:40.

ZJARRI I FIGURSHËM

Megjithatë, Bibla e përdor shpesh imazhin e zjarrit të përjetshëm me qëllim që të përfaqsojë zemërimin e Perëndisë me mëkatin, që do të rezultojë në shkatërrim total të mëkatarit në varr. Sodoma u ndëshkua me "zjarr të përjetshëm" (Jude v. 7), d.m.th. u shkatërrua komplet për shkak të ligësisë së banorëve. Sot ai qytet është gërmadhë, nën ujërat e Detit të Vdekur; në asnjë mënyrë nuk është tani në zjarr, gjë që është e nevojshme nëse duam ta kuptojmë 'zjarr i përjetshëm' fjalë për fjalë. Po ashtu edhe Jeruzalemi u kërcënua me zjarrin e përjetshëm të zemërimit të Zotit, për shkak të mëkateve të Izraelit: "atëhere unë do të ndez një zjarr në portat e tij dhe do të përpijë pallatet e Jeruzalemit dhe nuk do të shuhet" (Jer. 17:27). Jeruzalemi, duke qenë kryeqyteti i parashikuar për Mbretërinë e ardhshme (Is. 2:2-4; Ps. 48:2), Zoti nuk e pati fjalën që ne ta lexojmë këtë tekstualisht kështu. Shtëpitë e mëdha të Jeruzalemit u dogjën me zjarr (2 Kings 25:9), por ai zjarr nuk vazhdoi përjetësisht.

Në ngjashmëri, Perëndia ndëshkoi tokën e Idumesë me zjarr që nuk do të "shuhej as ditën as natën; tymi i tij do të ngjitet përpjetë përgjithnjë: do të mbetet e shkretë brez pas brezi... do të banojnë aty kukuvajka dhe korbi... në pallatet e tij do të rriten gjemba" (Is. 34:9-15). Duke qenë se kafshët dhe bimët do të egzistonin në tokën e Idumesë, gjuha e zjarrit të përjetshëm duhet ta ketë fjalën për zemërimin e Perëndisë dhe shkatërrimit të plotë të vendit prej Tij, se sa të merret tekstualisht.

Frazat hebraishte dhe greke, të cilat përkthehen "përgjithnjë" do të thonë tamam, "për kohën". Nganjëherë kjo nënkupton vërtet pafundësi, për shembull koha e mbretërisë, por jo gjithmonë. Ez. 32:14,15 është një shembull: "Fortesat dhe kullat do të jenë shkatërruar përgjithnjë... derisa fryma të derdhet mbi ne". Kjo është një mënyrë e të kuptuarit të 'përjetësisë' së 'zjarrit të përjetshëm'.

Herë pas here zemërimi i Perëndisë me mëkatin e Jeruzalemit dhe Izraelit është vënë në ngjashmëri me zjarrin: "zemërimi im dhe tërbimi im do të bjerë mbi këtë vend (Jeruzalemin)...do të djegë pa u shuar" (Jer. 7:20; shembuj të tjerë përfshijnë Lam. 4:11 dhe 2 Mbretërit 22:17).

Zjarri shoqërohet gjithashtu me gjykimin e Zotit ndaj mëkatit, veçanërisht me kthimin e Krishtit: "sepse, ja, dita po vjen e zjarrtë si një furrë;dhe të gjithë ata që veprojnë me pabesi do të jenë si kallamishtet: dhe dita që po vjen do t'i djegë" (Mal. 4:1). Kur digjet kashta ose edhe trupi i njeriut, kthehet në pluhur. Është e pamundur që çdo lloj substance, sidomos mishi i njeriut, të digjet përgjithmonë. Prandaj gjuha e 'zjarrit të përjetshëm' nuk

mund ta ketë fjalën për torturë të përjetshme. Një zjarr nuk mund të zgjatë përgjithnjë në qoftë se nuk ka asgjë për të djegur. Duhet të vihet re që "ferri" është "flakur në liqenin e zjarrit" (Zbu. 20:14). Kjo tregon që ferr nuk është njësoj si "liqeni i zjarrit"; kjo përfaqson shkatërrim të plotë. Në kuptimin simbolik të librit të Zbulesës, ne na është thënë që varri do të shkatërrohet krejtësisht, sepse në fund të mijëvjeçarit nuk do të ketë më vdekje.

GEHENA

Në Dhjatën e Re ka dy fjalë greke të përkthyer 'ferr'. 'Hades' është i barabarti i 'sheol' në hebraisht, të cilën e kemi diskutuar më parë. 'Gehenna' emri i një maje plehrash që ishte jashtë Jeruzalemit, ku digjeshin plehrat e qytetit. Maja të tilla janë tipike në shumë qytete në zhvillim sot (p.sh. 'Mali i Tymosur' jashtë Manilës në Filipine.) si emër i duhur - d.m.th. emri i një vendi prej vërteti – duhej të ishte lënë i papërkthyer si 'Gehenna' se sa përkthyer si 'ferr'. 'Gehenna' është aramishtja e së njëjtës fjalë në hebraisht 'Ge-ben-Hinnon'. Kjo ndodhej pranë Jeruzalemit (Josh. 15:8) dhe në kohën e Krishtit ishte vendi i plehërave të qytetit. Kufomat e kriminelëve hidheshin në zjarret që digjeshin gjithmonë atje, kështu Gehena u bë simboli i shkatërrimit dhe i mohimit të plotë.

Pra, duhet bërë e qartë idea që çfarë u hodh në ato zjarre nuk mbeti atje përgjithmonë – trupat u shpërbënë në pluhur. "Perëndia ynë (do të jetë) një zjarr që konsumon" (Heb. 12:29) në ditën e gjykimit; zjarri i zemërimit të tij ndaj mëkatit do të konsumojë mëkatarët deri në shkatërrim se sa t'i lëjë ata në një gjendje të të qenit zhuritur prej tij dhe prapë të mbijetojnë. Në kohët e gjykimit të mëparshëm nga Perëndia të popullit të Tij, Izrael, në duart e Babilonasve, Gehena ishte e mbushur me kufoma të mëkatarëve mes popullit të Zotit (Jer. 7:32,33).

Zoti Jezus i mblodhi bashkë të gjitha këto ide të Dhjatës së Vjetër në përdorimin e fjalës 'Gehenna', sipas mënyrës së tij prej mësuesi. Ai tha shpesh se ata që do të mohohen në ditën e gjykimit me kthimin e Tij do të shkonin "në Gehenë (d.m.th. "ferr"), në zjarrin që nuk do të shuhet kurrë; ku krimbi nuk vdes" (Mark 9:43,44). Gehena do të sillte në mendjet e Izraelitëve idetë e mohimit dhe të shkatërrimit të trupit dhe ne e kemi parë që zjarri i përjetshëm është një shprehje e figurshme që përfaqson zemërimin e Zotit kundër mëkatit dhe shkatërrimin e mëkatarëve nëpërmjet vdekjes.

Në lidhje me "ku krimbi i tyre nuk vdes", është dukshëm pjesë e së njëjtës shprehje për shkatërrim të plotë – është e pakonceptueshme që vërtet mund të ketë krimba që nuk do të ngordhin kurrë. Fakti që Gehena ishte vendodhja e ndëshkimeve të mëparshme për të pabesët ndërmjet popullit të Zotit, tregon më tej përdorimin me vend nga Krishti të figurës së Gehenës.

KAPITULLI 4: Pyetje

1. Çfarë ndodh pas vdekjes?
 - a) Shpirti shkon në Parajsë
 - b) Ne jemi të pandërgjegjshëm
 - c) Shpirti ruhet gjëkund deri në ditën e gjykimit
 - d) Shpirtrat e këqij shkojnë në ferr dhe të mirët në Parajsë.

2. Çfarë është shpirti?
 - a) Një pjesë e pavdekshme e qenies sonë
 - b) Një fjalë që do të thotë 'trup, person, qenie'
 - c) Tamam njësoj si fryma
 - d) Diçka që shkon në Parajsë ose në ferr pas vdekjes.

3. Është vdekja një gjendje e pandërgjegjshme?
 - a) Po
 - b) Jo

4. Çfarë është ferri?
 - a) Një vend për të liqtë
 - b) Vuajtjet e kësaj jete
 - c) Varri

5.1 Përcaktimi i Mbretërisë

Kapitujt tanë të mëparshëm kanë treguar se qëllimi i Perëndisë është të shpërblejë njerëzit e Tij besnikë me kthimin e Krishtit. Kjo jetë e përjetshme do të kalohet këtu në tokë; premtimet e përsëritura të Perëndisë lidhur me këtë kurrë nuk nënkuptojnë që besnikët do të ikin në qiejt. "Ungjilli (lajmi i mirë) i Mbretërisë së Perëndisë" (Mat. 4:23) iu predikua Abrahamit në trajtën e premtimeve të Zotit lidhur me jetën e përjetshme në tokë (Gal. 3:8). "Mbretëria e Perëndisë" është, pra, koha mbas kthimit të Krishtit kur këto premtime do të përmbushen. Ndërsa Zoti është përfundimisht Mbreti i gjithë krijimit të Tij edhe tani, Ai i ka dhënë njeriut vullnetin e lirë të sundojë botën dhe jetën e tij si të dojë. Kështu sot bota përbëhet nga "mbretëria e njerëzve" (Dan. 4:17).

Me kthimin e Krishtit, "Mbretëritë e kësaj bote (do të) bëhen mbretëritë e Zotit tonë dhe Krishtit të tij dhe ai do të mbretërojë në shekuj të shekujve" (Zbu. 11:15). Atëhere dëshirat e Perëndisë do të përmbushen plotësisht dhe hapur mbi këtë tokë. Prandaj urdhërimi i Jezusit që ne të lutemi: "Ardhtë mbretëria jote (që) u bëftë vullneti yt në tokë, siç është (tani) në qiell" (Mat. 6:10). Për shkak të kësaj, "Mbretëria e Perëndisë" është një frazë e ndrrueshme me "Mbretëria e qiejve" (Mat. 13:11 krahu. Mark 4:11). Vini re që ne kurrë nuk lexojmë për 'mbretëria në qiej'; është mbretëria e qiejve, që do të vendoset nga Krishti në tokë me kthimin e tij. Siç i binden plotësisht vullnetit të Zotit ëngjëjt në qiej (Ps. 103:19-21), kështu do të jetë në të ardhmen mbretëria e Perëndisë, kur toka do të banohet vetëm nga të drejtët, që atëhere do të jenë "barabar me ëngjëjt" (Lluka 20:36).

Hyrja në mbretërinë e Perëndisë me kthimin e Krishtit është, pra, rezultati i fundit i gjithë përpjekjeve tona Kristiane në këtë jetë. (Mat. 25:34; Vep. 14:22); si e tillë, është absolutisht jetike të kesh një kuptim të drejtë të saj. Predikimi i Filipit për "Krishtin" është përcaktuar si të mësuarit e "gjërave lidhur me mbretërinë e Perëndisë dhe emrin e Jezu Krishtit" (Vep. 8:5,12). Pjesë pas pjesë na kujtojnë se si "mbretëria e Perëndisë" ishte ngarkesa kryesore e predikimit të Palit (Vep. 19:8; 20:25; 28:23,31). Prandaj është e një rëndësie kryesore që ne të kuptojmë plotësisht doktrinën e Mbretërisë së Perëndisë, duke parë që formon një pjesë jetike të lajmit të Ungjillit. "Ne duhet të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë përmes shumë rrymave" (Vep. 4:22); është drita në fund të tunelit të kësaj jete dhe prandaj shtytja për të bërë sakrificat që përfshin jeta e vërtetë Kristiane.

Nebukadnezari, mbret i Babilonisë, donte të dinte të ardhmen e botës (shih Dan. 2). Atij iu dha një pamje e një statuje të madhe e përbërë nga metale të ndryshme. Danieli e interpretoi kokën e floririt sikur përfaqsonte mbretin e Babilonisë (Dan. 2:38). Pas tij do të vinin me radhë perandori të tjera në zonën rreth e rrotull Izraelit, për t'u mbyllur nga një situatë në të cilën "siç ishin gishtat e këmbëve pjesërisht prej hekuri dhe pjesërisht prej argjile, ashtu edhe mbretëria do të jetë pjesërisht e fortë dhe pjesërisht e prishur" (Dan. 2:42).

Drejtpeshimi i sotëm i fuqisë në botë është ndarë ndërmjet shumë kombeve, disa të fortë dhe disa të dobët. Danieli pastaj pa një gur të vogël të godiste figurën në këmbë, duke e shkatërruar atë dhe duke u rritur vetë në një mal të madh, që mbushi të gjithë tokën (Dan. 2:34,35). Ky gur përfaqsonte Jezusin (Mat. 21:42; Vep. 4:11; Efe. 2:20; 1 Pjetrit 2:4-8). "Mali" që Ai do të krijojë nëpër gjithë botën përfaqson mbretërinë e përjetshme të Perëndisë, e cila do të vendoset në ardhjen e tij të dytë. Kjo profeci është në vetvete provë që mbretëria do të jetë në tokë dhe jo në qiejt.

Që mbretëria do të vendoset plotësisht në realitet me kthimin e Krishtit është tema e pjesëve të tjera. Pali flet për gjykimin e Jezusit ndaj të vdekurve dhe të gjallëve "në shfaqjen e tij dhe mbretërinë e tij" (2 Tim. 4:1). Mikea 4:1 merr idenë e Danielit mbi mbretërinë e Perëndisë si të jetë një mal gjigand: "Në kohët e fundit do të ndodhë që mali i shtëpisë së Zotit do të vendoset"; pastaj vazhdon një përshkrim se si do të jetë kjo mbretëri në tokë (Mik. 4:1-4). Zoti do t'i japë Jezusit fronin e Davidit në Jeruzalem: "Ai do të mbretërojë... përjetë dhe mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur" (Lluka 1:32,33). Kjo sjell që ka një kohë të caktuar, në të cilën Jezusi fillon të mbretërojë në fronin e Davidit dhe mbretëria e tij fillon. Kjo do të jetë me kthimin e Krishtit. "Mbretëria e tij nuk do të ketë kurrë të sosur" lidhet me Dan. 2:44: "Perëndia e qiejve (do të) ndërtojë një mbretëri që kurrë nuk do të shkatërrohet: (ajo) nuk do t'u lihet njerëzve të tjerë". Zbu. 11:15 përdor gjuhë të ngjashme në përshkrimin se si në ardhjen e dytë, "mbretëritë e kësaj bote janë bërë mbretëritë e Zotit tonë dhe Krishtit të tij; dhe ai do të mbretërojë për gjithmonë". Përsëri duhet të ketë një kohë të caktuar kur mbretëria e Krishtit dhe mbretërimi i tij do të fillojë në tokë; kjo do të jetë në kthimin e Tij.

5:2 Mbretëria nuk është vendosur akoma

Ka një nocion gjerësisht të përhapur se Mbretëria e Perëndisë është tashmë në egzistencë të plotë dhe përbëhet nga besimtarët e tanishëm – 'kisha'.

Ndërsa besimtarët e vërtetë janë 'shpëtuar' në prespektivë dhe u janë dhënë vende potenciale në mbretëri, nuk mund të ketë asnjë dyshim që ne tani nuk mund të jemi plotësisht në Mbretëri, duke parë që Krishti nuk është kthyer akoma që ta vendosë atë.

Duhet të jetë e qartë nga ç'kemi studiuar deri tani "që mishi dhe gjaku nuk mund ta *trashëgojë* mbretërinë e Perëndisë" (1 Kor. 15:50). Ne jemi "*trashëgimtarët* e mbretërisë, që ua premtoi atyre që e duan" (Jak. 2:5), meqenëse pagëzimi na bën trashëgues të premtimeve ndaj Abrahamit – premtime, të cilat përbëjnë ungjillin bazë të Mbretërisë (Mat. 4:23; Gal. 3:8,27-29). Prandaj është e zakonshme të ndeshen premtimet e *trashëgimisë* së Mbretërisë me kthimin e Krishtit, kur premtimet ndaj Abrahamit do të përmbushen (Mat. 25:34; 1 Kor. 6:9,10; 15:50; Gal. 5:21; Efe. 5:5). Vetë përdorimi i kësaj gjuhe të trashëgimisë së ardhme tregon se mbretëria nuk është zotërim i sotëm i besimtarëve.

Jezusi tha një shëmbëlltyrë për të korrigjuar ata që mendonin "se mbretëria e Perëndisë duhej të shfaqej menjëherë. Prandaj Ai tha, Një njeri fisnik shkoi në një vend të largët për të marrë në dorëzim një mbretëri e pastaj të kthehej". Ndërkohë u la shërbyesve disa porosi. "Kur u kthye, pasi e mori në dorëzim mbretërinë, urdhëroi t'i thërrasin ata shërbëtorët", dhe i gjykoi (Luka 19:11-27).

Fisniku përfaqson Krishtin që largohet në "vendin e largët" të parajsës për të marrë mbretërinë, me të cilën ai kthehet në kohën e gjykimit, d.m.th. ardhjen e dytë. Prandaj është e pamundur që "shërbëtorët" të zotërojnë mbretërinë tani, gjatë kohës së mungesës së Zotit të tyre.

Të mëposhtmet japin prova të mëtejshme të kësaj:-

- " Mbretëria ime nuk është e kësaj bote (kohe)", tha Jezusi hapur (Gjon 18:36). Megjithatë, edhe në atë kohë Ai mund të kishte thënë, " Unë jam mbret" (Gjon 18:37), duke treguar se 'mbretërimi' i tanishëm i Krishtit nuk do të thotë që Mbretëria e Tij tashmë është vendosur. Edhe besimtarët në shekullin e parë janë përshkruar si DUKE PRITUR për mbretërinë e Perëndisë (Mk.15:43).
- Krishti u tha dishepujve të tij se ai nuk do të pinte kurrë më verë me ta "derisa ta pij të re me ju në mbretërinë e Atit tim" (Mat. 26:29). Kjo tregon qartë se mbretëria do të ishte në të

ardhmen, që bëri të kuptohej nga njerëzit predikimi i Krishtit për "lajmin e mirë (d.m.th. shpalljen paraardhëse) të mbretërisë së Perëndisë" (Lluka 8:1). "Lum kush do të (në të ardhmen) hajë bukë në mbretërinë e Perëndisë", ishte komenti i tyre (Lluka 14:15).

- Lluka 22:29,30 vazhdon këtë temë: "Unë ju *caktoj* mbretërinë. Që ju të hani e të pini në tryezën time, në mbretërinë time".

- Jezusi shpjegoi shenjat që do t'i paraprinin ardhjes së dytë të tij dhe e mbylli me koment, "ju, kur do të shikoni se po ndodhin këto, ta dini se mbretëria e Perëndisë është afër" (Lluka 21:31). Kjo nuk ka kuptim nëse mbretëria është tani në egzistencë përpara ardhjes së dytë.

- "me shumë pikëllime duhet të hyjmë në mbretërinë e Perëndisë" (Vep. 14:22). Prandaj çdo besimtar i vuajtur lutet pa pushim për *ardhjen* e mbretërisë (Mat. 6:10).

- Perëndia ju ka "thirrur në mbretërinë e tij" (1 Thes. 2:12); në përgjigje, ne duhet të *kërkojmë* hyrjen për në atë mbretëri përmes një jete frymërore tani (Mat. 6:33).

5.3 Mbretëria e Perëndisë në të kaluarën

Mbretëria e Perëndisë është shpërblimi i ardhshëm për besimtarët. Si e tillë, është një motiv i tyre për të jetuar një jetë kushtuar imitimit të shembullit të Krishtit – diçka që do të përfshijë vuajtje dhe bezdisje afat shkurtër. Prandaj pritjet që gjatë gjithë ditëve të tyre ata do të konsumohen nga një dëshirë në gjithnjë e në rritje për të çmuar dhe kuptuar mrekullitë e asaj të ardhmeje. Do të jetë përmbledhje e gjithë vuajtjeve të tyre frymërore dhe deklarimi i plotë i Perëndisë, të cilin e duan si Atin e tyre.

Shkrimet janë plot me hollësira se si do të jetë mbretëria dhe do t'ju duhet një jetë e tërë pune të zbuloni vetëm disa prej tyre. Një mënyrë, nëpërmjet së cilës ne kemi kuptuar disa nga parimet bazë të kësaj mbretërie të ardhshme është që të çmojmë që mbretëria e Perëndisë egzistoi në të kaluarën në trajtën e kombit të Izraelit. Kjo mbretëri duhet të ri-vendoset në kthimin e Krishtit. Një pjesë e madhe e Biblës na jep të dhëna lidhur me kombin e Izraelit, me qëllim që ne të kuptojmë, në përgjithësi, si do të organizohet Mbretëria e ardhshme e Perëndisë.

Perëndia shpesh përshkruhet si "mbreti i Izraelit" (Isa. 44:6 krahas Isa. 41:27; 43:15; Ps. 48:2; 89:18; 149:2); rrjedhimisht populli i Izraelit ishin mbretëria e Tij. Ata filluan të jenë mbretëria e Perëndisë nëpërmjet hyrjes në besëlidhje me të te Mali i Sinait, pasi ishin arratisur nga Egjipti nëpër Detin e Kuq. Në përgjigje të tyre për ta mbajtur këtë besëlidhje, ata do të "ishin për mua (Zotin) një mbretëri...dhe një komb i shenjtë" (Eks. 19:5,6). Kështu "Kur Izraeli doli nga Egjipti...Izraeli (ishte) zotërimi i Tij" ose mbretëria (Ps. 114:1,2). Pas hyrjes në këtë besëlidhje, Izraeli udhëtoi përmes shkretëtirës së Sinait dhe u vendos në tokën e premtuar të Kananit. Duke patur Zotin për mbret, ata drejtoheshin nga "gjyqtarët" (p.sh. Gedeon dhe Samson) se sa nga mbretërit. Këta gjyqtarë nuk ishin mbretër, por drejtues të udhëhequr nga Zoti, që qeverisnin pjesë të caktuara të vendit në vend që të drejtonin të gjithë tokën. Ata shpesh ngriheshin nga Zoti për qëllime të caktuara, p.sh. të udhëhiqnin Izraelin drejt pendimit dhe ta çlironin nga armiqtë e tyre. Kur Izraelitët i kërkuan gjykatësit Gedeon të bëhej mbreti i tyre, ai u përgjigj, "Unë nuk do të mbretëroj mbi ju...Zoti do të mbretërojë mbi ju" (Jud. 8:23).

Gjyqtari i fundit ishte Samueli. Në kohën e tij Izraelitët kërkuan një mbret njeri që të ishin si kombet rreth e rrotull tyre (1 Sam. 8:5,6). Gjatë gjithë historisë, populli i vërtetë i Zotit është tunduar të nënvlerësojë afërsinë e marrëdhënies së tij me Zotin dhe të sakrifikojë këtë për një shfaqje të ngjashmërisë me botën përreth tyre. Këto tundime janë më akute në botën tonë të sotme. Zoti iu qa Samuelit: "Ata më kanë hedhur poshtë mua, që unë të mos mbretëroj mbi ta" (1 Sam. 8:7). Megjithatë Zoti u miratoi atyre mbretër, duke filluar me të ligun Saul. Pas tij erdhi Davidi i drejtë dhe një sërë mbretërish rrodhën prej tij. Mbretërit më frymëror në mendime e kuptuan se Izraeli ishte akoma mbretëria e Perëndisë, edhe pse ata e kishin përbuzur mbretërimin e Tij. Prandaj ata e dinin se po mbretëronin mbi Izraelin nga ana e Perëndisë se sa në të drejtën e tyre.

Kuptimi i këtij parimi na aftëson të kuptojmë përshkrimin e Solomonit, birit të Davidit, duke mbretëruar në "fronin (e Perëndisë), si mbret për Zotin, Perëndinë tënd" (2 Kron. 9:8; 1 Kron. 28:5; 29:23). Mbretërimi i paqtë dhe i begatë i Solomonit dha rrugën (ose ishte 'tipik' i) mbretërisë së ardhme të Perëndisë. Prandaj theksohet që ai ishte king mbi Izrael nga ana e Perëndisë, siç do të ulet edhe Jezusi mbi fronin e Perëndisë si mbret i Izraelit për Zotin (Mat. 27:37,42; Gjon 1:49; 12:13).

GJYKIMI I PERËNDISË

Si rezultat i braktisjes së Solomonit, mbretëria e Izraelit u nda në dy; Biri i Solomonit, Rehoboam, mbretëroi mbi fiset e Judës, Benjaminit dhe gjysmën e fisit të Manasehut, ndërsa Jeroboam mbretëroi mbi dhjetë fiset e tjerë. Kjo mbretëri e dhjetë fiseve u quajt Izrael, ose Efraim, ndërsa dy fiset u quajtën Juda. Njerëzit e gjithë këtyre fiseve, në më të shumtën, ndoqën shembullin e keq të Solomonit – ata pretendonin se besonin në Zotin e vërtetë, ndërsa në të njëjtën kohë lavdëronin idhujt e kombeve përqark. Përsëri Zoti iu lut nëpërmjet profetëve, të pendoheshin, por më kot. Për shkak të kësaj, Ai i ndëshkoi ata duke i nxjerrë nga mbretëria e Izraelit në tokat e armiqve të tyre. Kjo u bë nëpërmjet pushtimit dhe kapjes robër të Izraelit nga asirianët dhe babilonasit: "Pate (Perëndia) durim me ta shumë vjet me radhë duke i nxitur me Frymën (fjalën) tënde dhe me gojën e profetëve të tu: por ata nuk deshën të të dëgjojnë: atëhere ti i dhe në duart e popujve të vendeve të ndryshme (rrethuese) " (Neh. 9:30).

Mbretëria dhjetë-fisëshe e Izraelit nuk kishte fare mbretër të mirë. Jeroboam, Ahab, Jehoahaz etj. Janë të gjithë të shënuar në librin e Mbretërve si idhujtare. Mbreti i tyre i fundit ishte Hoshea, gjatë mbretërimit të të cilit Izraeli u mund nga Asiria dhe të dhjetë fiset u kapën robër (2 Mbretërit 17). Nga kjo ata nuk u kthyen kurrë.

Mbretëria dy-fisëshe e Judës kishte ca mbretër të mirë (p.sh. Hezekia dhe Josia), megjithëse shumica ishin të këqinj. Për shkak të mëkateve të përsëritura të njerëzve, Zoti e përmbysi Judën si mbretërinë e Tij gjatë mbretërimit të mbretit të tyre të fundit, Zedekia. Kjo u shkaktua nga pushtimi i tyre prej Babilonasve, që i morën robër në Babiloni (2 Mbretërit 25). Ata mbetën në Babiloni për 70 vjet, pas së cilave disa u kthyen në Izrael nën udhëheqjen e Ezras dhe Nehemias. Ata nuk patën kurrë më mbretin e tyre dhe u sunduan nga Babilonasit, Grekët dhe Romakët. Jezusi lindi gjatë periudhës së sundimit romak. Për shkak të përbuzjes së Jezusit nga Izraeli, Romakët i pushtuan ata në vitin 70 mbas erës sonë dhe i shpërndanë ata nëpër botë. Vetëm në 100 vjetët e kaluar kanë filluar të kthehen, duke paraprirë kështu pritjen e Krishtit (shih Shtojcën 3).

Ezekiel 21:25-27 profetizoi këtë mbarim të mbretërisë së Perëndisë si e parë në kombin e Izraelit: "Ti, o princ i korruptuar dhe i keq i Izraelit (d.m.th. Zedekiah), dita e të cilit erdhi...kështu thotë Zoti, Zoti; Hiqe çallmën, hiqe kurorën (d.m.th. Zedekia do të pushonte së qëni mbret): gjërat nuk do të jenë po ato...unë do ta përmbys, përmbys, përmbys: dhe nuk do të jetë më, *derisa* të vijë ai të cilit i përket gjykimi; dhe të cilit do t'ia jap". Pjesë pas pjesë në

1

profetët përmend fundin e mbretërisë së Perëndisë (Hos. 10:3; Lam. 5:16; Jer. 14:21; Dan. 8:12-14).

'Përmbysja'e trefishtë e Ez. 21:25-27 flet për tre pushtimet e bëra nga Nebukadnezar, mbret i Babilonisë. Studenti i vëmendshëm do të shohë në

këto vargje një shembull tjetër të trajtimit në paralel të mbretërisë së Perëndisë dhe mbretit të saj; përmbysja e Zedekias ishte ajo e mbretërisë së Zotit (shih Seksionin 5:2). Kështu mbretëria e Perëndisë, si të ishte në kombin e Izraelit, mbaroi: "unë...do të bëj të pushojë mbretëria e shtëpisë së Izraelit" (Hos.1:4). "Nuk do të jetë më, *derisa...*" mbart ndërthurjen që mbretëria do të ringjallej kur "vjen ai, të cilit i përket gjykimi; dhe (Zoti) do t'ia japë". Zoti do të "japë (Jezusit) fronin e atit të tij David...dhe mbretëria e tij nuk do të ketë mbarim" (Lluka 1:32,33) - në kthimin e Krishtit. Kjo, pra është kur përmbushet premtimi i mbretërisë.

RESTAURIMI I IZRAELIT

Ka një temë të madhe përmes gjithë profetëve të Dhjatës së Vjetër mbi *restaurimin* e mbretërisë së Zotit me kthimin e Mesisë. Dishepujt e Krishtit ishin të mirë-pregatitur në këtë: "Kështu ata që ishin mbledhur bashkë e pyetën duke thënë, *Zot, a do ta rivendosësh në këtë kohë mbretërinë e Izraelit?*" d.m.th. 'do të përmbushet Ezekieli 21:27 tani?' Jezusi u përgjigj duke thënë se ata kurrë nuk do ta dinin kohën e saktë të ardhjes së dytë, megjithatë ëngjëjt menjëherë më pas i siguruan ata se ai në të vërtetë do të kthehej dikur (Vep. 1:6-11).

Restaurimi i mbretërisë së Perëndisë/Izraelit do të bëhet, pra, me ardhjen e dytë. Kështu Pjetri predikoi se Zoti do të dërgonte "Jezu Krishtin...i cili do të merret në qiej (d.m.th. ai duhet të mbetet atje) *derisa* të vijë koha e *ripërtëritjes* së të gjitha gjërave, për të cilën Zoti ka folur me gojën e gjithë profetëve të tij të shenjtë" (Vep. 3:20,21). Ardhja e dytë do të sjellë rivendosjen e mbretërisë së Perëndisë si një restaurim të mbretërisë së vjetër të Izraelit.

Restaurimi i mbretërisë së Perëndisë është vërtetë tema e "gjithëprofetëve të shenjtë (të Perëndisë)":-

- "në mëshirë do të rivendoset froni: dhe ai (Jezusi) do të ulet mbi të në besnikëri në çadrën e Davidit (në ardhjen e dytë - Lluka 1:32,33), duke gjykuar...dhe siguruar drejtësinë" (Isa. 16:5).
- "Atë ditë unë do të ngre përsëri tabernakullin e Davidit (d.m.th. "fronin" e Davidit të Lluka 1:32,33) që ka rënë dhe ndreq të çarat e tij; dhe do të ngre rrënojat e tij dhe do ta rindërtoj si *në*

ditët e lashta" (Amos 9:11). Shprehja e fundit është qartësisht gjuhë restaurimi.

- "Bijtë e tij (të Izraelit) do të jenë *si më parë*, dhe kuvendi i tij do të bëhet i qendrueshëm para meje" (Jer. 30:20).
- "Zoti do ta zgjedhë Jeruzalemin *përsëri*" (Zah. 2:12), duke e bërë atë kryeqytet të mbretërisë së Tij botërore (krah. Ps. 48:2; Isa. 2:2-4).
- "Do të bëj që të kthehen të mërguarit e Judës dhe të mërguarit e Izraelit dhe do t'i vendos *përsëri si më parë... Përsëri* do të dëgjohen në këtë vend...britma gëzimi...sepse unë do të bëj që të kthehen të mërguarit në vend, *si më parë...përsëri* në këtë vend (Jeruzalem)...do të ketë banesa të barinjve...kopetë (do të) kalojnë *përsëri*" (Jer. 33:7-13).

Kthimi i Krishtit për të vendosur këtë mbretëri është vërtetë "shpresa e Izraelit", me të cilën ne duhet të lidhemi duke u pagëzuar.

5:4 Mbretëria e Perëndisë në të ardhmen

Seksionet 1 dhe 3 të këtij Kapitulli kanë dhënë një sasi të konsiderueshme të dhënash se si do të jetë mbretëria. Ne kemi parë që Abrahamit iu premtua me anë të farës së tij njerëzit nga gjithë pjesët e botës do të bekoheshin; Rom. 4:13 e shtrin këtë në kuptimin që e gjithë toka do të trashëgohej nga ata njerëz që janë 'në' farën e Abrahamit, d.m.th. Krishtin. Profecia e imazhit të Dan. 2 shpjegon se si Krishti do të kthehet si guri i vogël dhe pastaj mbretëria do të shpërhapet gradualisht në të gjithë botën (krah. Ps. 72:8). Kjo do të thotë që mbretëria e Perëndisë nuk do të ndodhet vetëm në Jeruzalem ose tokën e Izraelit, siç pretendojnë disa, megjithëse këto zona do të jenë sigurisht qendra e saj.

Ata që ndjekin Krishtin në këtë jetë do të jenë "mbretërit dhe priftërinjtë; dhe ne do të mbretërojmë në tokë" (Zbu. 5:10). Ne do të sundojmë mbi zona të ndryshme në madhësi dhe numër; një do të sundojë mbi dhjetë qytete, një tjetër mbi pesë (Lluka 19:17). Krishti do ta ndajë sundimin e tij mbi tokë me ne (Zbu. 2:27; 2 Tim. 2:12). "Një mbret (Jezusi) do të mbretërojë në drejtësi, dhe princat (besimtarët) do të sundojnë në gjykim" (Isa. 32:1; Ps. 45:16).

Krishti do të mbretërojë përgjithmonë në fronin e rivendosur të Davidit (Lluka 1:32,33), d.m.th. ai do të ketë vendin dhe pozitën sunduese të Davidit që ishte në Jeruzalem. Meqë Krishti do të mbretërojë nga Jeruzalemi, ky do të jetë kryeqyteti i Mbretërisë së ardhshme. Këtu do të ndërtohet një tempull (Eze. 40-48). Ndërsa popujt do të adhurojnë Zotin në vende të ndryshme të botës (Mal. 1:11), ky tempull do të jetë qendra e adhurimit botëror. Kombet "do të dalë vit për vit për të adhuruar Mbretin, Zotin e ushtrive dhe për të kremtuar festën e kasolleve" rreth tempullit në Jeruzalem (Zah. 14:16).

Ky parakalim vjetor për në Jeruzalem është profetizuar edhe tek Isa. 2:2,3: "Në ditët e fundit, mali (Mbretëria - Dan. 2:35,44) i shtëpisë së Zotit (tempulli) do të vendoset në majën e maleve (d.m.th. Mbretëria e Perëndisë dhe tempulli do të ngrihen mbi mbretëritë e njerëzve)...dhe këtu do të vërshojnë tërë kombet. Dhe shumë popuj do të vijnë duke thënë, ejani të ngjitemi në malin e Zotit, në shtëpinë e Perëndisë së Jakobit; dhe ai do të na mësojë rrugët e tij...sepse nga Sioni do të dalë ligji dhe nga Jeruzalemi fjala e Zotit". Kjo duket si një pikturë e ditëve të hershme të mbretërisë, kur njerëzit shpërhapin lajmin e mbretërimit të Krishtit te tjerët dhe ata shkojnë lart në "malin" e Mbretërisë së Perëndisë, e cila do të shpërhapet ngadalë në gjithë botën. Këtu kemi një pikturë të ngazëllimit të vërtetë në adhurimin fetar.

Një nga tragjeditë më të mëdha njerëzore të ditëve tona është se shumica e njerëzve 'adhurojnë' Perëndinë për arsye politike, shoqërore, kulturore ose emocionale, në vend që të jetë mbi baza të kuptimit të vërtetë të Tij si Ati dhe Krijuesi i tyre. Në mbretërinë do të ketë ngazëllim gjithbotëror për të mësuar rrugët e Zotit; njerëzit do të jenë aq të shtyrë nga kjo dëshirë saqë ata do të udhëtojnë nga gjithë skajet e tokës për në Jeruzalem që të njohin më mirë Perëndinë.

Në vend të ngatërresës dhe padrejtësisë të krijuar nga sistemi ligjor i njeriut dhe drejtimi i gjykimit, do të ketë një kod ligjor universal - "ligji dhe fjala e Zotit", që do të shpallet prej Krishtit nga Jeruzalemi. "gjithë kombet do të vërshojnë në" këto mësim-dhënie, duke nënkuptuar që kjo dëshirë e përbashkët për të gjetur njohurinë e vërtetë të Perëndisë do të pakësojë fërkimin e natyrshëm midis kombeve, siç bën tani ndërmjet individëve që ia përkushtojnë veten e tyre përfuturit të kësaj diturie në këtë jetë.

Ky përshkrim i gjithë kombeve që vërshojnë në Jeruzalem është i ngjashëm me figurën e paraqitur në Isa. 60:5, ku judejtë "vërshojnë së bashku" me

paganët (jo-judejtë) për të adhuruar Zotin në Jeruzalem. Kjo lidhet përkryshëm me profecinë e Mbretërisë të Zah. 8:20-23:-

"Do të vijnë akoma popuj dhe banorë të shumë qyteteve; dhe banorët e një qyteti do të shkojnë te ata të tjetrit, duke thënë, le të shkojmë vazhdimisht (A.V. mg. - krah. Zah. 14:16 'vit pas viti') t'i përgjërohemi fytyrës së Zotit, dhe të kërkojmë Zotin e ushtrive: Edhe unë do të shkoj. Po, shumë popuj dhe kombe të fuqishëm do të vijnë të kërkojnë Zotin e ushtrive në Jeruzalem...dhjetë burra nga të gjitha gjuhët dhe kombet, do të zënë një Jude nga cepi i rrobës, duke i thënë, Ne duam të vijmë me ty: sepse kemi dëgjuar që Perëndia është me ju".

Kjo krijon panoramën e popullit të Judës si "koka dhe jo bishti" i kombeve, në sajë të pendimit dhe bindjes së tyre (LiP 28:13); bazat e Judejve të planit të Perëndisë për shpëtim atëhere do të vlerësohen nga gjithkush. Mosditja e kësaj midis Kristianizmit të sotëm do të ndërpritet papritur. Atëhere njerëzit do të diskutojnë me ngazëllim këto gjëra, që t'u thonë Judejve, "ne kemi dëgjuar që Zoti është me ju". Bisedat atëhere do të zhvillohen rreth gjërave frymërore, sesa fantazmat e kota që mbush të menduarit e botës së sotme.

Me dhënien e këtij përkushtimi më të madh ndaj udhëzimeve të Zotit, nuk është çudi që Krishti "do të gjykojë midis kombeve...ata do të farkëtojnë shpatat e tyre duke i kthyer në plugje dhe heshtat e tyre në drapërinj: kombi nuk do të ngrëjë shpatën kundër kombit dhe nuk do të mësojnë më luftën" (Isa. 2:4). Autoriteti absolut i Krishtit dhe drejtësia totale e drejtimit të tij në mosmarrveshje do të rezultojë në dëshirën e kombeve për të ndryshuar me vullnet të lirë arsenalin ushtarak në makineri bujqësore dhe braktisur gjithë stërvitjen ushtarake. "Në ditët e tij i drejti do të lulëzojë" (Ps. 72:7) – do të ngrihen gjërat e frymës dhe do të respektohen ata që pasqyrojnë karakteristikat e Perëndisë si dashuria, mëshira, drejtësia, etj. Bëni dallimin me ngritjen e sotme të ambicies krenare, arrogante dhe egoiste.

Shndrimi i vullnetshëm i "shpatave në plugje" do të jetë pjesë e një ndryshimi bujqësor shumë më të madh që do të vijë mbi tokë. Si rezultat i mëkatit të Adamit, toka u mallkua për shkak të tij (Zan. 3:17-19), me pasojën që do të duhej mundim i madh tashmë për të nxjerrë ushqim prej saj. Në Mbretëri "do të ketë bollëk misri mbi tokë në majat e maleve (dikur djerra); frutat do të valëviten si (drithrat e) Libanit" (Ps. 72:16). "Ai që lëron do t'i afrohet atij që korr dhe ai që shtrydh rrushin atij që hedh farën; dhe

malet do të kullojnë verë të ëmbël" (Amos 9:13), aq do të përmirësohet pjelloria e tokës dhe pakësimi i mallkimit mbi tokën lëshuar në Eden.

Zhvillim i tillë i gjerë bujqësor do të përfshijë shumë njerëz. Profecitë e Mbretërisë japin përshtypjen se njerëzit do të kthehen në një lloj jete vetëprodhuese, bujqësore:-

"Do të ulet secili nën hardhinë e vet dhe nën fikun e vet; dhe askush nuk do t'i trembë" (Mic. 4:4).

Ky bollëk do t'i kalojë abuzimet që trashëgohen në çdo sistem punësimi për para. Shpenzimi i jetës duke punuar për të bërë të tjerët të pasur, do t'i përkasë së kaluarës.

"Do të ndërtojnë shtëpi dhe do të banojnë në to (vetë); dhe do të mbjellin vreshta dhe do të hanë frutin. Nuk do të ndërtojnë më që të banojë një tjetër; nuk do të mbjellin më që të hajë një tjetër...të zgjedhurit e mi do të gëzojnë për një kohë të gjatë veprën e duarve të tyre. Ata nuk do të lodhen më kot..." (Isa. 65:21-23).

Isaia 35:1-7 përmban një profeci të pasoqe se si do të ndryshohet toka jopjellore, duke rezultuar në rrezatim gëzimi dhe lumturie që pothuajse rrjedh nga toka, në sajë të mënyrave më të lehta dhe më frymërore të jetës së atyre që e punojnë: "Djerrina...do të gëzohet, shkretëtira do të gëzohet dhe lulëzojë si trëndafili. Do të...ngazëllojë me hare dhe këngë...sepse do të dalin ujra në shkretëtirë dhe përrenj në vendin e vetmuar. Vendi i thatë do të bëhet pellg". Edhe sulmi natyral i kafshëve do të hiqet: "ujku dhe qengji do të hanë bashkë" dhe fëmijët do të jenë në gjendje të luajnë me gjarpërinjtë (Isa 65:25; 11:6-8).

Në të njëjtën mënyrë që u pakësua mallkimi mbi krijimin natyror, ashtu edhe ai mbi njerëzimin do të pakësohet. Kështu Zbu. 20:2,3 flet në gjuhë simbolike për djallin (mëkati dhe pasojat e tij) që "lidhet", ose i vihet fre, gjatë mijëvjeçarit. Gjatësia e jetës do të rritet, kështu që nëse dikush vdes 100 vjeç, do të konsiderohet veçse fëmi (Isa. 65:20). Gratë do të kenë më pak dhimbje në lindje (Isa. 65:23). "Atëhere do të hapen sytë e të verbërve dhe veshët e shurdhëve. Atëhere çalamani do të kërcëjë si një dre dhe guha e memecit do të këndojë" (Isa. 35:5,6). Kjo do të ndodhë në sajë të zotërimit përsëri të dhuntive mrekullibërëse në frymë (krah. Heb. 6:5).

Nuk duhet theksuar shumë që mbretëria e Perëndisë nuk duhet të jetë si një ishull parajse tropikal, që do ta gëzojë i drejti në mënyrë të ngjashme me ata që kënaqet me banjo-dielli në lavdinë e natyrës. Qëllimi themelor i mbretërisë së Perëndisë është t'i japë lavdi Perëndisë, deri sa toka të mbushet me lavdinë e Tij "siç mbulojnë ujrat detin" (Hab. 2:14). Ky është qëllimi përfundimtar i Zotit "Siç është e vërtetë që unë jetoj, gjithë toka do të mbushet me lavdinë e Zotit" (Num. 14:21). Lavdi Perëndisë do të thotë që banorët e tokës do të çmojnë, lavdërojnë dhe kopjojnë vetitë e Tij të drejtësisë; sepse bota do të jetë në këtë gjendje, Zoti do të lejojë tokën fizike ta pasqyrojë edhe këtë. Kështu "zemërbutët do të zotërojnë tokën (në Mbretëri) dhe do të gëzojnë një paqe të madhe (në frymë)" (Ps. 37:11), sesa në gëzimin e një jete të lehtë. Ata "të cilët janë të uritur dhe të etur për drejtësi...do të mbushen" me të në Mbretëri (Mat. 5:6).

Vetëm mendimi i marrjes së jetës së përgjeshme në Mbretëri përdoret shpesh si objekt për të joshur njerëzit me interesin në Kristianizëm. Megjithatë, zotërimi i saj prej nesh atëhere, pothuajse do të jetë i rastësishëm ndaj arsyes së vërtetë për të qenë në Mbretëri – që është për të lavdëruar Perëndinë. Në kohën që na mbetet pas pagëzimit, vlerësimi ynë për këtë duhet të zhvillohet vazhdimisht.

Për shkrimtarin, vetëm dhjetë vjetë jetese në gëzim dhe përkryerje absolute dhe ndërgjegjeje të mirë me Perëndinë do t'ia vlente gjithë tronditja e kësaj jete. Që kjo gjendje e lvdishme do të zgjasë përgjithnjë thjesht të mahnit, duke na marrë përtej kufijve të kuptimit njerëzor.

Edhe kur shihet nga këndvështrim paksa më fizik, të qenurit në mbretërinë e Perëndisë duhet të jetë motivi ynë më i lartë për të injoruar avantazhet dhe materializmin e botës. Në vend që të mendojmë gjerësisht për të ardhmen e afërt, Jezusi këshilloi, "kërkoni më parë mbretërinë e Perëndisë, dhe drejtësinë e tij; dhe gjithë këto gjëra do t'ju shtohen" (Mat. 6:30-34). Çdo gjë që mund të marrim me mend tani dhe për të cilën përpiqemi është e pakrahasueshme me përmbushjen përfundimtare të qenies në Mbretërinë e Perëndisë.

Ne na duhet të kërkojmë "drejtësinë (e Perëndisë)", d.m.th. të përpiqemi të zhvillojmë një dashuri për karakterin e Perëndisë, që do të thotë se ne duam të jemi në Mbretërinë e Perëndisë sepse atje do të lavdërohet drejtësia, sepse ne duam të jemi krejtësisht të përkryer moralisht sesa thjesht meqenëse ne,

personalisht, duam t'i shpëtojmë vdekjes dhe të jetojmë një jetë të lehtë përjetësisht.

Shumë shpesh shpresa e Ungjillit përfaqsohet në mënyra që i bëjnë thirrje egoizmit të njeriut. Me sa duket motivi ynë për të qenë në mbretëri ndryshon shumë nga dita në ditë. Kjo që ne sugjerojmë këtu është një ideal; përparësia e parë është të mësojmë Ungjillin dhe të tregojmë nënshtrimin tonë ndaj tij me pagëzimin të shtytur nga bindja me dashuri ndaj Perëndisë. Vlerësimi ynë ndaj shpresës Perëndi është ofruar dhe tamam arsyet tona për dashjen për të qenë në mbretëri, do të rriten dhe pihen mbas pagëzimit tonë.

5.5 Mijëvjeçari

Në këtë moment në studimin tonë të jetës në mbretëri një lexues i vëmendshëm ndoshta pyet, 'nuk duket kjo figura e mbretërisë së Perëndisë një çikë si njerëzore?' Njerëzit në Mbretëri prapë do të prodhojnë bebe (Isa. 65:23) dhe edhe vdesin (Isa. 65:20). Këta popuj akoma do të kenë mosmarrëveshje që do t'i zgjidhë Krishti (Isa. 2:4), dhe prapë do t'u duhet të punojnë tokën që të mbijetojnë, edhe pse kjo do të jetë shumë më e lehtë se tani. Kjo e gjitha duket shumë larg nga premtimet ku i drejti do të marrë jetë të përjetshme dhe një natyrë si kjo e Perëndisë, të bërë njësoj me ëngjëjt, që nuk marrohen për të riprodhuar (Lluka 20:35,36) Përgjigja gjendet në faktin se pjesa e parë e mbretërisë së Perëndisë do të zgjasë 1,000 vjet – një 'Mijëvjeçar' (shih Zbu. 20:2-7). Gjatë këtij Mijëvjeçari do të ketë dy grupe njerëzish mbi tokë:-

- 1** Shenjtët – ata prej nesh që kanë ndjekur Krishtin vullnetshëm në këtë jetë, që do t'u jetë dhënë përjetësia ditën e gjykimit. Vini re: një 'shenjt' do të thotë person 'i thirrur' dhe e ka fjalën për çdo besimtar të vërtetë
- 2** Njerëzit e zakonshëm të vdekshëm që nuk e njihnin Ungjillin në kohën e kthimit të Krishtit - d.m.th. ata nuk ishin përgjegjës ndaj gjykimit.

Kur të vijë Krishti, dy njerëz do të jenë në fushë, një do të merret (në gjykim) dhe tjetri do të lihet (Llk. 17:36); ata që do të "lihen" do të jenë në këtë grupin e dytë.

Duke pas marrë natyrën e Perëndisë në gjykim, shenjtët do të jenë të paaftë të vdesin ose prodhojnë fëmijë. Përshkrimet e njerëzve që provojnë këto gjëra në Mbretëri duhet, pra, të kenë vend për grupin e dytë-ata që janë

gjallë në kthimin e Krishtit, por nuk i dinin kërkesat e Perëndisë. Shpërblimi për të drejtët është të jenë "mbretër dhe priftërinj: dhe ne do të mbretërojmë mbi tokë" (Zbu. 5:10). Mbretërit duhet të mbretërojnë mbi dikë; ata njerëz që nuk e njihnin ungjillin në ardhjen e dytë, pra, do të lihen gjallë, për tu sunduar. Njëpër një të qënit "në Krisht" ne do ta ndajmë shpërblimin e Tij – që është të qënit mbret i botës: "ai që fiton...atij do t'i jap pushtet mbi kombet: dhe ai do t'i qeverisë me një shufër hekuri...sikurse mora edhe *unë* prej Atit tim" (Zbu. 2:26,27).

Shëmbëlltyra e Krishtit mbi paratë ka vend tani – shërbyesit besnikë u shpërbyen me dhjetë ose pesë qytete për t'i qeverisur në Mbretëri (Lluka 19:12-19). Njohuri e udhëve të Perëndisë nuk do të shpërndahet menjëherë. Krishti është shpallur Mbret në Jeruzalem; popujt do të udhëtojnë në Jeruzalem që të gjejnë më tepër dije rreth Zotit (Isa. 2:2,3). Rikujtoni se si mali i Dan. 2:35,44 (që përfaqson mbretërinë e Perëndisë) gradualisht u shpërnda mbi tokë. Do të jetë detyrë e shenjtëve të shpërhapin diturinë e Perëndisë dhe, pra të Mbretërisë së Tij.

Kur Izraeli ishte më parë mbretëria e Perëndisë, detyra e priftërinjve ishte të mësonin diturinë e Perëndisë (Mal. 2:5-7). Për këtë qëllim ata u vendosën në qytete të ndryshme nëpër Izrael. Në rivendosjen më të lavdishme të Mbretërisë, shenjtët do të marrin rolin e priftërinjve (Zbu. 5:10).

Sikur Krishti të vijë sot:

1. Të vdekurit e përgjegjshëm do të ngrihen me gjithë të gjallët e përgjegjshëm, për t'u sjellë para gjyqimit.
2. Të ligjtë e përgjegjshëm do të ndëshkohen me vdekje dhe të drejtëve do t'u jepet përjetësia. Do të gjykohen edhe kombet që i rezistuan Krishtit.
3. Të drejtët pastaj do të sundojnë mbi ata njerëz që atëhere do të jenë të gjallë, por që nuk janë përgjegjës para Zotit: ata do t'u mësojnë atyre ungjillin si "mbretër dhe priftërinj" (Zbu. 5:10).
4. Kjo do të zgjasë për 1,000 vjet. Gjatë kësaj kohe gjithë njerëzit e vdeqshëm do të dëgjojnë Ungjillin dhe prandaj do të bëhen përgjegjës ndaj Perëndisë. Këta njerëz do të jetojnë jetë shumë më të gjata dhe të lumtura.

5. Në fund të Mijëvjeçarit do të ketë një rebelim kundër Krishtit dhe shenjtëve, që Zoti do ta shtypë (Zbu. 20:8,9).
6. Në fund të 1,000 vjetëve të gjithë ata që vdiqën gjatë kësaj kohe do të ringjallen dhe gjykohen (Zbu. 20:5,11-15).
7. Të ligjtë midis tyre do të shkatërrohen dhe të drejtët do të bashkohen me ne në jetën e përjetshme.

Qëllimi i Perëndisë me tokën atëhere do të jetë përmbushur. Do të mbushet me qenie të drejta të pavdekshme. Emri i Zotit 'Yahweh Elohim' (që do të thotë 'Ai që do të shpaloset në një grup të fuqishmish') atëhere do të përmbushet. Kurrë më nuk do të provohen në tokë mëkati dhe, rrjedhimisht, vdekja; premtimi që fara e gjarprit do të shkatërrohet plotësisht duke u goditur në kokë, atëhere do të jetë përmbushur plotësisht (Zan. 3:15). Gjatë Mijëvjeçarit, Krishti do të ketë mbretëruar "derisa t'i ketë vënë nën këmbë gjithë armiqtë e tij. Armiku i fundit që do të shkatërrohet është vdekja...Dhe kur t'i ketë nënshtuar të gjitha (Perëndisë), atëhere Biri vetë do t'i nënshtrohet atij (Perëndisë) që i nënshtroi të gjitha, që Perëndia të jetë gjithçka në të gjithë" (1 Kor. 15:25-28).

Ky është "fundi, kur ai (Krishti) t'ia dorëzoi Mbretërinë Perëndisë Atë" (1 Kor. 15:24). Se çfarë do të ndodhë në këtë kohë kur Perëndia të jetë "gjithë mbi të gjithë" nuk na është thënë; ne dimë vetëm që ne do të kemi përjetësinë, natyrën e Perëndisë dhe do të jetojmë për të lavdëruar dhe kënaqur Perëndinë. Është fyese të guxojmë të kërkojmë më tej se si do të jetë gjendja përtej Mijëvjeçarit.

Kuptimi i "ungjillit të mbretërisë së Perëndisë" është jetik për shpëtimin e çdo lexuesi të këtyre fjalëve. Ne ju lutemi ta rilexonit këtë kapitull dhe të shikoni pjesët e marra nga Bibla.

Perëndia na do të jemi në Mbretërinë e Tij. Gjithë qëllimi i Tij u caktua që ne të kemi pjesë vërtetë, në vend të të shprehurit, në aftësinë e Tij krijuese. Pagëzimi na lidh me premtimet për këtë Mbretëri. Është vështirë të besosh që pagëzimi i ndjekur nga disa vite bindjeje të nënshtuar ndaj fjalës së Perëndisë, të mund të na fitojë hyrje për në atë kohë të lavdishme të përjetshme. Megjithatë besimi ynë në dashurinë madhështore të Perëndisë duhet të jetë i patundur. Çfarëdo që të jenë problemet tona afatshkurtër, ne, sigurisht që nuk kemi arsye të ndjeshme për t'i rezistuar thirrjes së Ungjillit?

"Në qoftë se Perëndia është me ne, kush mund të kundër nesh?"
(Rom. 8:31).

"Vuajtjet e kohës së tanishme nuk vlejnë aspak të krahasohen me lavdinë që do të shfaqet në ne" (Rom. 8:18).

"Trishtimi ynë i lehtë, që është vetëm për një moment, prodhon për ne një peshë të pamasë e të pashoqe të amëshueshme lavdie"
(2 Kor. 4:17).

KAPITULLI 5:Pyetje

1. Cila prej të mëposhtmeve është koha e vendosjes së Mbretërisë së Perëndisë?
 - a) Ka qenë gjithmonë e vendosur
 - b) Në kthimin e Krishtit
 - c) Ditën e Pentakostit në shekullin e parë
 - d) Në zemrat e besimtarëve në konvertimin e tyre.

2. Çfarë është Mijëvjeçari?
 - a) Një mbretërim i mëshirës në zemrat tona
 - b) 1000 vjet mbretërimi të besimtarëve në parajsë
 - c) 1000 vjet mbretërimi të Satanit mbi tokë
 - d) 1000 vjetët e parë të Mbretërisë së ardhme të Perëndisë në tokë

3. Çfarë do të bëjnë besimtarët e sotëm në Mijëvjeçarin?
 - a) jenë sundues mbi njerëzit e vdekshëm
 - b) jenë sundues në Parajsë
 - c) ne nuk e dimë
 - d) jetojnë në një planet tjetër

4. U predikua lajmi për mbretërinë e Perëndisë:
 - a) Vetëm në Dhjatën e Re?
 - b) Vetëm nga Jezusi dhe apostujt?
 - c) Në të dyja Dhjatat, të Vjetër dhe të Re?
 - d) Vetëm në Dhjatën e Vjetër?

6.1 PERËNDIA DHE E KEQJA

Shumë sekte të Kristianizmit së bashku me besime të tjera besojnë se ka një qenie ose përbindësh i quajtur Djall ose Shejtan që është filluesi i problemeve të botës dhe jetëve tona dhe që është përgjegjës për mëkatit që ne bëjmë. Bibla na mëson qartë se Perëndia është i gjithfuqishëm. Ne kemi parë në Kapitullin 1.4 se ëngjëjt nuk mund të mëkatojnë. Në qoftë se vërtet i besojmë këto gjëra, atëherë është e pamundur të ketë ndonjë qenie mbinatyrore në punë në këtë univers që është kundër Perëndisë së gjithfuqishme. Në qoftë se ne besojmë që qenie e tillë *egziston*, atëherë ne vëmë në pikëpyetje epërsinë e Perëndisë së Gjithfuqishëm. Kjo çështje është aq e rëndësishme saqë kuptimi i drejtë i djallit dhe shejtanit duhet të konsiderohet një doktrinë jetike. Ne na është thënë në Heb.2:14 se Jezusi e shkatërroi djallin me vdekjen e tij; prandaj në qoftë se nuk kemi kuptim të saktë mbi djallin, ne nuk mund të kuptojmë veprën ose natyrën e Jezusit.

Në botë në përgjithësi, veçanërisht në të ashtuquajturën botë 'kristiane', është idea që gjërat e mira në jetë vijnë nga Perëndia dhe gjërat e këqia nga Djalli ose Shejtani. Kjo nuk është një ide e re; madje nuk është ide vetëm e Kristianizmit të shndrruar. Babilonasit, për shembull, besonin se kishte dy perëndi, një perëndi e të mirës dhe dritës dhe një perëndi e së keqes dhe errësirës dhe se këto të dyja ishin kapur në betejë të përgjakshme. Edhe Kiri, mbreti i madh i Persisë, këtë besonte. Prandaj Perëndia i tha, "Unë jam Zoti, dhe nuk ka asnjë tjetër; jashtë meje nuk ka Perëndi...Unë formoj dritën dhe krijoj terrin: unë bëj paqe dhe krijoj të keqen (N.I.V. "fatkeqsinë"): unë Zoti i bëj të gjitha këto gjëra" (Is.45:5-7,22). Perëndia krijon paqe dhe Ai krijon të keqen ose gjëmën. Perëndia është autori, krijuesi i "të keqes" në këtë kuptim. Në këtë kuptim ka një dallim midis "të keqes" dhe mëkatit, që është faji i njeriut; hyri në botë si rezultat i njeriut, jo Perëndisë (Rom.5:12).

Perëndia i thotë Kirit dhe popullit të Babilonisë "nuk ka (tjetër) Perëndi jashtë meje". Fjala hebraishte 'el' e përkthyer "Perëndia" në themel do të thotë 'forcë, ose burim fuqie'. Perëndia thotë që nuk ka tjetër burim fuqie në egzistencë përveç Atij. Kjo është arsyeja pse një besimtar i vërtetë në Perëndi nuk mund të pranojë idenë e djallit ose demonëve mbinatyror.

PERËNDIA: KRIJUESI I GJËMËS

Bibla është plot me shembuj ku Perëndia sjell "të keqen" në jetët e njerëzve dhe në këtë botë. Am.3:6 thotë se në qoftë se ka ligësi në qytet, Perëndia e ka bërë. Në qoftë se, për shembull ka një tërmet në qytet, shpesh ndihet që 'djalli' ka projektuar në atë qytet dhe ka sjellë fatkeqsinë. Por besuesi i vërtetë duhet të kuptojë se *Perëndia* është përgjegjës për këtë. Kështu Mik.1:12 thotë se "e keqja ka zbritur nga *Zoti* deri te porta e Jeruzalemit". Në librin e Jobit ne lexojmë se si Jobi, një njeri i drejtë, humbet gjithçka kishte në këtë jetë. Libri mëson se përvoja e 'së keqes' në jetën e një personi nuk është drejtpërdrejt përpjestimore me bindjen e tyre ndaj Perëndisë. Jobi e dinte se "*Zoti* dha dhe *Zoti* mori" (Job 1:21). Ai nuk thotë '*Zoti* dha dhe Shejtani mori'. Ai i komentoi gruas së vet: "në rast se pranojmë të mirën nga Perëndia, pse nuk duhet të pranojmë (edhe) të keqen?" (Job 2:10). Në fund të librit, miqtë e Jobit e ngushëlluan mbi "gjithë e keqja që *Zoti* ka sjellë mbi të" (Job 42:11 krahu. 19:21; 8:4). Kështu Perëndia është burimi "së keqes" në kuptimin e të qenit lejuesi përfundimtar i problemeve që kemi në jetët tona.

"Sepse *Zoti* ndreq atë që do... në qoftë se ju do ta duroni qortimin... më pas u jep një frut drejtësie atyre që janë ushtruar me anë të tij" (Heb.12:6-11), kjo tregon se sprovat që na jep Perëndia udhëheqin në rritjen tonë në frymë. Të thuash që djalli është një qenie që na shtyn në mëkat dhe në padrejtësi është si të vësh fjalën e Perëndisë në kundërshtim me vetveten, ndërsa në të njëjtën kohë ai supozohet që të sjell probleme në jetët tona që çojnë në zhvillimin tonë "frutin e paqtë të drejtësisë". Idea ortodokse e djallit ndesh probleme serioze këtu. Veçanërisht serioze për të janë pjesët që flasin për dorëzimin e një njeriu te shejtani "që t'i shpëtohet fryma", ose "që ai të mësojë të mos blasfemojë" (1 Kor.5:5; 1 Tim.1:20). Nëse Shejtani është vërtetë një qenie e vendosur të shtyjë njeriun në mëkat dhe ka një ndikim frymëror *negativ* mbi njerëzit, pse flasin këto pjesë në një dritë *pozitive* për 'Shejtanin? Përgjigja shtrihet në faktin që një kundërshtar, një "Shejtani" ose vështirësitë në jetë, mund të rezultojnë shpesh në ndikime pozitive në frymë në jetën e një besimtar.

Në qoftë se ne pranojmë që e keqja vjen nga Perëndia, atëhere ne mund t'i lutemi Perëndisë të bëjë diçka për problemet që kemi, p.sh. t'i largojë ato. Në qoftë se Ai nuk i largon, atëhere ne e dimë që ato janë dërguar nga Perëndia për të mirën tonë në frymë. Tani në qoftë se ne besojmë që ka një të lig të quajtur djall ose shejtani që i shkakton problemet tona, atëhere nuk ka mundësi t'i pranojmë. Sakatësia, sëmundja, vdekje e papritur ose dukuritë natyrore janë marrë si thjesht fat i keq. Në qoftë se djalli është ndonjë engjëll mëkatar i fuqishëm, atëhere ai do të jetë shumë më i

fuqishëm se ne dhe ne s'kemi ç'të bëjmë veçse të vuajmë në duart e tij. Në dallim, ne ngushëllohemi që nën kontrollin e Perëndisw, "gjithë gjërat (në jetë) veprojnë së bashku për *mirë*" të besimtarëve (Rom.8:28). Prandaj nuk ka ndonjë gjë të tillë si 'fat' në jetën e një besimtari.

ORIGJINA E MËKATIT

Duhet theksuar se *mëkati* vjen nga brenda nesh. Është faji ynë që ne mëkatojmë. Sigurisht do të ishte mirë të besonim që nuk ishte faji ynë që ne mëkatojmë. Ne mund të mëkatojmë lirisht dhe pastaj t'ia falnim vetes me mendimin që ishte në fakt faji i djallit dhe që faji për mëkatin tonë duhet hedhur tërësisht mbi të. Nuk është e pazakontë që në raste të sjelljes shumë të keqe, fajtori ka kërkuar mëshirë sepse ai thotë që zotërohej nga djalli në atë kohë dhe prandaj nuk ishte përgjegjës për vetveten. Por, me të drejtë, pretekste të tilla nuk pinë ujë në gjykim dhe personi dënohet.

Ne duhet të mbajmë mend që "pagesa për mëkatin është vdekje" (Rom.6:23); mëkati çon në vdekje. Në qoftë se nuk është faji ynë që mëkatojmë, po i djallit, atëhere një Perëndi i drejtë duhet të ndëshkojë djallin dhe jo neve. Por fakti që ne gjykohe mi për mëkatet tona tregon se ne jemi përgjegjës për mëkatet tona. Idea e djallit si person i caktuar jashtë nesh në vend të parimit të mëkatis *brenda* nesh, është një përpjekje për ta hequr nga vetja përgjegjësinë për mëkatin. Ky është një shembull tjetër i njerëzve që refuzojnë të pranojnë atë që mëson Bibla për natyrën e njeriut: që është mëkatore në themel.

"Nuk ka *asgjë* jashtë njeriut, që, duke hyrë në të mund ta ndotë...Sepse nga brenda, domethënë nga zemra e njeriut, dalin mendimet e mbrapshta, shkeljet e kurorës, kurvërimi, vrasjet...krenaria, budallallëku: të gjitha këto të mbrapshta dalin nga brenda dhe e ndotin njeriun" (Mr.7:15-23).

Idea që *ka* diçka prej mëkati jashtë nesh që hyn në ne dhe na bën të mëkatojmë është e pakonceptueshme me mësimin e hapur të Jezusit këtu. Nga *brenda* prej zemrës së njeriut, vijnë të gjitha të këqijat. Prandaj në kohën e përmbytjes, Perëndia mori parasysh që "synimet e zemrës së njeriut janë të këqia qysh në fëmijërinë e tij" (Zan.8:21). Jakob 1:14 na thotë se si tundohe mi: "secili (është i njëjti proces për çdo qenie njerëzore) tundohe mi, kur udhëhiqet dhe mashtrohet nga lakmia e vet ("nga dëshira e vet e ligë", N.I.V.(Versioni i Ri Ndërkombëtar))". Ne tundohe mi nga lakmitë tona, dëshirat tona të këqia; jo nga ndonjë gjë jashtë nesh. "nga vijnë luftërat dhe grindjet te ju?", pyet Jakobi; "nuk vijnë, pra, nga pasionet *tuaja*?" (Jakobi

4:1). Secili prej nesh ka tundime personale të caktuara. Prandaj ato duhet të prodhohen nga dëshirat *tona* të këqia, sepse ato janë vetjake për ne. Me të drejtë thuhet që ne jemi armiq të më të këqinj të vetvetes.

Libri i Romakëve flet shumë për mëkatën, origjinën e tij dhe se si ta kalojmë. Është shumë e rëndësishme që djalli dhe shejtani mezi përmenden në libër; kur është fjala për origjinën e mëkatit, Pali nuk e përmend djallin ose shejtanin. Në të njëjtën mënyrë “djalli” është një koncept i Dhjatës së Re. Nëse është një qenie e jashtme që na shtyn në mëkat, sigurisht që do të qe përmendur gjerësisht në Dhjatën e Vjetër? Por ka një heshtje shumë të thellë dhe të rëndësishme lidhur me këtë. Shënimet e periudhës së Gjyqtarëve ose e Izraelit në shkretëtirë, tregojnë se në ato kohëra Izraeli po mëkatonte me shumicë. Por Perëndia nuk i paralajmëroi për ndonjë qenie apo forcë të fuqishme që mund të futej në ta dhe t’i bënte të mëkatonin. Përkundrazi Ai i inkurajoi t’i kushtoheshin fjalës së Tij, që ata të mos binin në udhët e mishit të tyre (p.sh. LiP. 27:9,10; Josh.22:5).

Pali qahet: "Në mua (domethënë në mishin tim) nuk banon asgjë e mirë...sepse të mirën që unë e dua, nuk e bëj...në qoftë se bëj atë që nuk dua, s'jam më vetë ai që e bëj, por është mëkati që banon në mua" (Rom.7:18-21). Tani ai nuk ia vë fajin e mëkatimit një qenieje të jashtme të quajtur djall. Ai caktoi natyrën e vet keqbërëse si burimin e vërtetë të mëkatit: "S'jam më vetë ai që e bëj, por *mëkati që banon në mua*. Unë, pra, po zbuloj këtë ligj (brenda meje), që duke dashur të bëj të mirën, e keqja gjindet në (d.m.th. brenda) mua". Pra ai thotë që e kundërta e të qënurit frymëror vjen nga diçka që ai e quan "mëkat që banon në mua". Çdo person me mendje të hapur ndaj frymës, do të vinte në të njëjtën lloj njohurie vetjake. Duhet theksuar se edhe një Kristian suprem si Pali nuk pati përvojën e ndryshimit të natyrës pas konvertimit, dhe as u vendos në ndonjë pozicion, prej të cilit ai nuk mëkatoi dhe as nuk mund të mëkatonte. Lëvizja moderne 'evangeliste' pretendon që janë në një pozicion të tillë dhe, prandaj e vendosin Palin në rradhët e 'të pashpëtuarve', për shkak të thënies së tij këtu në Rom.7:15-21. Këto vargje kanë dhënë prova të një vështirësie të madhe ndaj këtyre pretendimeve. Davidi, një tjetër burrë i drejtë padyshim, po ashtu komenton mbi natyrën e vet vazhdimisht mëkatore: "unë jam mbrauajtur në paudhësi dhe nëna ime më ka lindur në mëkat" (Ps.51:5).

Bibla është goxha e qartë për natyrën thelbësisht keqbërëse të njeriut. Në qoftë se kjo çmohet, nuk ka nevojë të shpikët një person imagjinar jashtë natyrave tona njerëzore që është përgjegjës për mëkatet tona. Jer.17:9 thotë

se zemra e njeriut është kaq e keqe dhe mashtruese sa ne nuk mund të çmojmë shtrirjen e madhe të mëkatësisë së saj. Edhe Jezusi e degëzoi natyrën njerëzore si thelbësisht të keqe në Mt.7:11. Pre.9:3 (teksti Hebre) nuk mund të jetë më i qartë: "Zemra e bijve të njerëzve është plot me ligësi". Efe.4:18 jep arsyen e largimit natyral të njeriut nga Perëndia që është "nëpërmjet padijes që është në ta, për shkak të verbimit të zemrës së tyre". Është për shkak të zemrave tona të verbra dhe të paditura në frymë, mënyra e të menduarit që është brenda nesh, që ne jemi të ndarë nga Perëndia. Në po këtë kuadër, Gal.5:19 flet për mëkatet tona si "vepër e mishit"; është mishi ynë, vetë qenia dhe natyra jonë, që na shtyn të mëkatojmë. Asnjë nga këto pjesë nuk e shpjegon origjinën e mëkatit brenda nesh sikur e futi djalli atje; tendencat mëkatore janë diçka që ne të gjithë i kemi natyrshëm nga lindja; është një pjesë themelore e ndërtimit njerëzor.

6.2 DJALLI DHE SHEJTANI

Nganjëherë fjalët origjinale të Biblës lihen të papërkthyer ("Mammon", te Mt. 6:24, është një shembull Aramaik i kësaj). Si një fjalë, 'satan' është një fjalë e papërkthyer hebraishte që do të thotë 'kundërshtar', ndërsa 'djall' është një përkthim i fjalës greke 'diabolos', që do të thotë gënjeshtar, një armik ose akuzues i rremë. Në qoftë se ne besojmë se shejtani dhe djalli janë ndonjë qenie jashtë nesh përgjegjëse për mëkatit, atëherë, sa herë që të ndeshim këto fjalë në Bibël, na duhet të nënkuptojmë këtë person të lig. Përdorimi biblik i këtyre fjalëve tregon se ato mund të përdoren si mbiemra të zakonshëm që përshkruajnë njerëz të zakonshëm. Ky fakt e bën të pamundur të arsyetosh që fjalët djall dhe shejtan siç përdoren në Bibël e kanë fjalën për një person ose qenie të madhe të ligë jashtë nesh.

FJALA 'SHEJTAN' NË BIBËL

1 Mbretërit 11:14 shënon se "Zoti ngriti kundër Solomonit një armik (e njëjta fjalë hebraishte e përkthyer "shejtan" diku tjetër), Hadadin Idumeon". "Dhe Perëndia ngriti kundër Solomonit një armik tjetër (një shejtan tjetër)...Rezonin...ai qe armik (shejtan) i Izraelit" (1 Kings 11:23,25). Kjo nuk do të thotë që Perëndia ngriti një person ose një ëngjëll mbinatyor për të qenë një shejtan/armik i Solomonit; Ai ngriti njerëz të zakonshëm. Mat.16:22,23 jep një shembull tjetër. Pjetri po përpiqej të pengonte Jezusin nga shkuarja në Jeruzalem për të vdekur në kryq. Jezusi iu kthye dhe i tha

Pjetrit “Shporru prej meje, Shejtan...s’ke ndër mend punët e Perëndisë, por punët e njerëzve”. Kështu Pjetri u thirr shejtan. Shkrimi është i qartë si kristali se Krishti nuk po fliste me ndonjë ëngjëll ose demon kur foli ato fjalë; ai po fliste me Pjetrin.

Meqënëse fjala 'shejtan' thjesht nënkupton një kundërshtar, një njeri i mirë, edhe Perëndia Vetë mund të quhet ‘shejtan’. Në thelb nuk ka asgjë prej mëkati me domosdo në fjalën vetë. Përmbajtja mëkatore që ka fjala 'shejtan' është pjesërisht në sajë të faktit që vetë natyra jonë mëkatore është 'shejtani' ose kundërshtari ynë më i madh dhe, gjithashtu, në sajë të përdorimit të fjalës në gjuhën e botës për t’iu referuar diçkaje të shoqëruar me mëkatin. Perëndia Vetë mund të jetë një shejtan kur sjell sprova në jetët tona ose duke na ndaluar nga një drejtim i gabuar veprimi që mund të jemi duke ndërmarrë. Por fakti që Perëndia mund të thirret 'shejtan' nuk do të thotë që Ai vetë është mëkatar.

Librat e Samuelit dhe Kronikave janë paralelizma të të njëjtave ngjarje, siç janë katër ungjillet dëshmi të të njëjtave ngjarje duke përdorur gjuhë tjetër. 2 Sam.24:1 dëshmon: "Zoti...nxiti Davidin kundër Izraelit" që ta bënte të numëronte Izraelin. Ngjarja paralele në 1 Kron.21:1 thotë se "Shejtani u ngrit kundër Izraelit, dhe nxiti Davidin" të bënte numërimin. Në një pjesë nxitjen e bën Perëndia, në tjetrin e bën Shejtani. I vetmi përfundim është që Perëndia veprimi si 'shejtan' ose kundërshtar i Davidit. Ai i bëri të njëjtën gjë Jobit duke i sjellë sfida në jetën e tij, kështu Jobi tha për Perëndinë: "Më përndjek me fuqinë e dorës sate" (Job 30:21); 'po vepron si shejtan kundër meje', ishte ajo që në fakt Jobi po thoshte.

FJALA 'DJALL' NË BIBËL

Dhe po kështu është edhe me fjalën ‘djall’. Jezusi tha, "nuk ju kam zgjedhur ju dymbëdhjetë (dishepuj) dhe një nga ju është një djall? Ai e kishte fjalën për Judë Iskariotin..." që ishte një burrë i zakonshëm i vdekshëm. Ai nuk po fliste për ndonjë qenie personale me brirë, ose i ashtuquajtur ‘qenie në frymë’. Fjala ‘djall’ këtu thjesht nënkupton një njeri të keq. 1 Tim.3:11 jep një shembull tjetër. Gratë e pleqve të kishës të mos ishin "shpifëse"; fjala origjinale greke këtu është ‘diabolos’, që është e njëjta fjalë e përkthyer ‘djall’ diku tjetër. Kështu Pali paralajmëron Titin që gratë e moshuara në asamble nuk duhet të jenë “akuzues të rreme”ose ‘djaj’ (Tit.2:3). Dhe po

ashtu ai i tha Timoteut (2 Tim.3:1,3) se "në ditët e fundit...*burrat* do të jenë...akuzues të rremë (djaj)". Kjo nuk do të thotë që qeniet njerëzore do të kthehen në qenie të mbinatyrshme, por ata do të jenë më të këqinj. Duhet të jetë më se e qartë nga e gjithë kjo që fjalët 'djall' dhe 'shejtan' nuk nënkuptojnë një ëngjell të rënë ose një qenie mëkatore jashtë nesh

MËKATI, SHEJTANI DHE DJALLI

Fjalët 'shejtan' dhe 'djall' janë përdorur në mënyrë figurative për të përshkruar tendencat natyrore mëkatore brenda nesh, për të cilat ne folëm në Kapitullin 6.1. Këto janë 'shejtani' ose kundërshtari ynë kryesor. Ata gjithashtu janë personifikuar dhe, si të tillë, për ta mund të flitet si 'djalli'-armiku ynë, një shtrembërues i së vërtetës. Kështu është 'njeriu' ynë natyror- djalli vetë. Lidhja ndërmjet djallit dhe dëshirave tona të këqia – mëkati brenda nesh - bëhet i qartë në disa pjesë:"ashtu si bijtë (vetë ne) kanë marrë pjesë prej mishi dhe gjaku, po ashtu edhe ai (Jezusi) u bë pjestar në po ato gjëra; që të shkatërronte me anë të vdekjes (së tij) atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin" (Heb.2:14). Djalli këtu përshkruhet si të jetë përgjegjës për vdekjen. Por "pagesa e mëkatit është vdekja" (Rom.6:23). Prandaj mëkati dhe djalli duhet të jenë paralel. Në mënyrë të ngjashme Jakobi 1:14 thotë se dëshirat tonë të mbrapshta na tundojnë duke na çuar në mëkat dhe, pra, në vdekje; por Hebrejve 2:14 thotë se djalli sjell vdekjen. I njëjti varg thotë se Jezusi pati natyrën tonë me qëllim që të shkatërronte djallin. Bëni dallimin e kësaj me Rom. 8:3: "Perëndia, duke dërguar Birin e tij në shëmbëllim mishi mëkatar (domethënë në natyrën tonë njerëzore) e dënoi mëkatin në mish". Kjo tregon se djalli dhe tendencat mëkatore që janë natyrshëm brenda natyrës së njeriut janë efektivisht të njëjta. Është me rëndësi jetike të kuptosh që Jezusi u tundua njësoj si ne. Keqkuptimi i doktrinës së djallit do të thotë që ne nuk mund të çmojmë si duhet natyrën dhe veprën e Jezusit. Vetëm në sajë të Jezusit që kishte natyrën tonë prej njeriu – 'djallin' brenda tij – ne mund të kemi shpresën e shpëtimit (Heb.2:14-18; 4:15). Duke u ngritur mbi dëshirat e natyrës së tij njerëzore, djallin Biblik, Jezusi ishte në gjendje të shkatërrojë djallin në kryq (Heb.2:14). Në qoftë se djalli *është* një qenie personale, atëhere ai nuk duhet të egzistojë më. Heb.9:26 thotë se Krishti u shfaq "për të hequr mëkatin me anë të sakrificës së vetes". Heb. 2:14 ia përshtat këtë thënies që nëpërmjet vdekjes së tij Krishti shkatërroi djallin në vetvete. Nëpërmjet vdekjes së tij Jezusi në prespektivë shkatërroi "trupin e mëkatit" (Rom.6:6), d.m.th. natyrën njerëzore, mëkatin e zbuluar në (trajtën e) vetë trupave tanë.

"Kush kryen mëkat është nga djalli" (1 Gjo.3:8), sepse mëkati është rezultat i lejimit të dëshirave tona natyrore të liga (Jakob 1:14,15), të cilat Bibla i quan 'djall'. "Prandaj u shfaq biri i Perëndisë për të shkatërruar veprat e djallit" (1 Gjo.3:8). Në qoftë se ne e kemi mirë kur themi që djalli është dëshirat tona të liga, atëhere vepra e dëshirave tona të liga d.m.th. rezultati i tyre, janë mëkatet tona. Kjo është konfirmuar nga 1 Gjo. 3:5: "Ai (Jezusi) u shfaq për të marr mëkatet tona". Kjo konfirmon se "mëkatet tona" dhe "vepra e djallit" janë e njëjta gjë. Vep. 5:3 jep një shembull tjetër të kësaj lidhjeje ndërmjet djallit dhe mëkateve tona. Pjetri i thotë Ananias: "Pse Shejtani ta mbushi zemrën tënde?" pastaj në vargun 4 Pjetri thotë "Pse e shtive në zemër tënde këtë gjë?" Të shtish diçka të ligë në zemrën tënde është njësoj si Shejtani të ta mbushë zemrën. Në qoftë se ne vetë fillojmë diçka, p.sh. një plan mëkati, atëhere fillon *brenda nesh*. Në qoftë se një grua zë një fëmijë, nuk është jashtë saj; fillon brenda saj. Jakobi 1:14,15 përdor të njëjtën figurë kur përshkruan se si lakmia jonë fillon dhe sjell mëkatit, i cili sjell vdekje. Ps.109:6 paralelizon një person mëkatar me një 'shejtani': "Vendos një njeri të keq mbi të: dhe Shejtani le të jetë në të djathtë të tij", d.m.th. në pushtet mbi të (Krah. Ps.110:1).

PERSONIFIKIMI

Megjithatë ju, me të drejtë, mund të përgjigjeni: 'por flet sikur djalli të jetë person!' Kjo është e vërtetë; Heb.2:14 flet për "atë që ka pushtetin e vdekjes, domethënë djallin". Edhe një sasi e vogël e leximit të Biblës tregon se shpesh përdor personifikimin- kur flet për një ide abstrakte si të jetë një person. Kështu Prov. 9:1 flet për një grua e quajtur 'Mënçuri' që ndërton një shtëpi, dhe Rom.6:23 e vë mëkatit në ngjashmëri me një pagues që jep pagesën e vdekjes. Kjo karakteristikë diskutohet me tej në Degëzimin 5. Djalli ynë, 'diabulos', shpesh përfaqson dëshirat tona të liga. Po prapë nuk mund të kesh djallëzi abstrakte; dëshirat e liga që janë në zemrën e një njeriu nuk mund të egzistojnë veçmas nga njeriu; prandaj 'djalli' është i personifikuar. Mëkati shpesh personifikohet si një zotëri (p.sh. Rom.5:21; 6:6,17; 7:3). Prandaj, është e kuptueshme që edhe 'djalli' personifikohet duke qenë se 'djalli', gjithashtu i referohet mëkatit. Në të njëjtën mënyrë, Pali flet për ne sikur kemi dy qenie, si të ishin brenda mishit tonë (Rom.7:15-21): njeriu i mishit, 'djalli', lufton me njeriun e Frymës. Megjithatë dihet që nuk ka tamam dy qenie personale që luftojnë brenda nesh. Kjo pjesë mëkatore e natyrës sonë personifikohet si "e keqja" (Mt.6:13 V.R.) – djalli Biblik. E njëjta frazë greke e përkthyer "e keqja" këtu, përkthehet si "person i lig" në 1 Kor.5:13, duke treguar se kur një person i hap rrugë mëkatit, ai është "i keq" – ai vetë- bëhet një "i keq", një 'djall'.

'DJALLI' DHE 'SHEJTANI' NË NJË KUPTIM POLITIK

Këto fjalë 'djall' dhe 'shejtan' përdoren gjithashtu të përshkruajnë rregullin mëkatar dhe të lig të botës, në të cilën jetojmë. Për hierarkitë shoqërore, politike dhe pseudo-fetare të njerëzimit mund të flitet në terma të 'djallit'. Djalli dhe shejtani në Dhjatën e Re shpesh iu referohen pushteteve shoqërore dhe politike të sistemeve romake ose jude. Kështu ne lexojmë se si djalli hedh besimtarët në burg (Zbu.2:10), duke iu referuar autoriteteve të Romës që burgos besimtarët. Në të njëjtën përmbajtje lexojmë për kishën e Pergamos që vendoset atje ku është ndenjësja ose fronti i shejtanit – p.sh. vendi i qeverisë për koloninë romake në Pergamos, ku ishte edhe një grup besimtarësh. Ne nuk mund të themi që Shejtani vetë, nëse egziston, personalisht pati një fron në Pergamos.

Mëkati vetjak përkufizohet si një shkelje e ligjit të Perëndisë (1 Gjo.3:4). Por mëkati i shprehur së bashku si një forcë shoqërore dhe politike kundër Perëndisë është një forcë më e fuqishme se individët; është kjo fuqi kolektive që personifikohet nganjëherë si një qenie e fuqishme e quajtur djall. Në këtë kuptim Irani dhe fuqitë e tjera islamike i kanë quajtur Shtetet e Bashkuara "shejtanin e madh"- d.m.th. kundërshtarin e madh të çështjes së tyre, në terma fetare dhe politike. Kështu janë përdorur shpesh fjalët 'djall' dhe 'shejtan' në Bibël.

Në përfundim, është ndoshta e vërtetë të thuash që, në këtë temë më tepër se në ndonjë tjetër, është jetike të bazojmë kuptimin tonë mbi një pamje të drejtpeshuar të *të gjithë* Biblës, në vend që të ndërtojmë doktrina masive në pak vargje që përmbajnë frazat proverba, të cilat duket se u referohen besimeve të zakonshme lidhur me djallin. Kapitulli 6.1 dhe ky seksion do të rikërkojë rilexim të kujdesshëm dhe me lutje. Është pranuar që pozicioni doktrinal i përshkruar atje, është e vetmja mënyrë për të qënë në gjendje të kemi një kuptim të arsyeshëm të *të gjitha* pjesëve që flasin për djallin dhe shejtanin. Ato fjalë mund të përdoren si mbiemra të zakonshëm ose në disa vende ato i referohen mëkatit që gjendet brenda natyrës sonë njerëzore. Disa nga pjesët më gjerësisht të keqkuptuara, që citohen në mbështetje të ideve të përkrahura, janë marrë parasysh në Degëzimet që shoqërojnë këtë studim.

Ata që e kanë të vështirë të pranojnë përfundimet tona duhet të pyesin veten: (1) është mëkati i personifikuar? Është e qartë që është. (2) Është e vërtetë që 'shejtani' mund të përdoret thejst si një mbiemër? Po, është. Pra, çfarë problemi të vërtetë mund të ketë në pranimin që mëkati është personifikuar

1

si armiku/shejtani ynë? Bota shpesh personifikohet në letrat dhe Ungjillin e Gjonit (shih V.R); çfarë titull më të mirë se 'shejtani' ose 'djalli' mund të ketë për këtë personifikim?

KAPITULLI 6: Pyetje

1. Kush është përfundimisht përgjegjës për problemet dhe vështirësitë tona?

- a) Perëndia
- b) Rastësia
- c) Një qenie mëkatore e quajtur shejtan
- d) Qeniet mëkatore të quajtura demonë

2. Çfarë është përgjegjës për tundimin tonë drejt mëkatit?

- a) Natyra jonë njerëzore
- b) Perëndia
- c) Frymërat e këqia
- d) Një qenie mëkatore e quajtur shejtan

3. Çfarë do të thotë fjala djall?

- a) Mëkat
- b) Gjarpri
- c) Akuzues/shpifës i rremë
- d) Luçiferi

4. Çfarë do të thotë fjala shejtan?

- a) Një mëkatar
- b) Një kundërshtar
- c) Një bishë
- d) Mbreti i demonëve

5. Për kë e kanë fjalën 'shejtani' dhe 'djalli' në mënyrë figurative?

- a) Mëkat dhe tundim
- b) Forca të këqija në atmosferë
- c) Një dragua

7. Si duhet t'i kuptojmë 'demonët' sipas referimit në Dhjatën e Re?

- a) Ëngjëj mëkatarë
- b) Sëmundje
- c) Gjuha e kohës për sëmundjet, të cilat njerëzit mendonin se vinin nga 'demonët'
- d) Qenie Frymërore

7.1 Profecitë e Dhjatës së Vjetër mbi Jezusin

Kapitulli 3 shpjegoi se si qëllimi i Perëndisë për shpëtimin e njeriut përshtjellohet rreth Jezusit. Premtimet që ai i bëri Evës, Abrahamit dhe Davidit të gjitha folën për Jezusin si pasardhësi i tyre. Në të vërtetë gjithë Dhjata e Vjetër shikon drejt Krishtit dhe profetizon atw. Ligji i Moisiut, të cilit Izraeli duhej t'i bindej përpara kohës së Krishtit, vazhdimisht drejtohej nga Jezusi: "Ligji që mësuesi ynë për te Krishti" (Gal. 3:24). Kështu në festën e Pashkëve, duhej të vritej një qengj në gjendje të përkryer (Eks. 12:3-6); kjo përfaqson sakrificën e Jezusit, "Qengji i Perëndisë, që heq mëkatën e botës" (Gjon 1:29; 1 Kor. 5:7). Gjendja pa njolla që kërkohet për të gjitha kafshët e sakrificave paratregonte karakterin e përkryer të Jezusit (Eks. 12:5 kra. 1 Pjetër 1:19).

Gjatë gjithë Psalmeve dhe profetëve të Dhjatës së Vjetër, gjenden profeci të panumërta se si do të ishte Mesia. Veçanërisht ata përqendrohen në përshkrimin e vekjes së tij. Refuzimi i Judizmit për të pranuar idenë e një Mesie që vdes është vetëm për shkak të mungesës së vëmendjes ndaj këtyre profecive, pak prej të cilave praqiten tani:

PROFECI TË DHJATËS SË VJETËR PËRMBUSHJA NË KRISHT

"Perëndia im, Perëndia im,
pse më ke braktisur?" (Ps. 22:1).

Këto ishin vetë fjalët e
Jezusit në kryq (Mat 27:46).

"Unë jam përçmimi i popullit
Tërë ata që më shohin më
përqeshin, zgjatin buzën dhe
tundin kokën duke thënë, Ai
27:43).

Izraeli e përçmoi Jezusin dhe e talli atë
(Lluka 23:35; 8:53); ata tundën
kokat (Mat. 27:39), dhe thanë këtë
kur Ai varej në kryq (Mat

i ka besuar Zotit se do ta çlirojë:
le ta çlirojë" (Ps. 22:6-8).

"Gjuha ime është ngjitur te
Krishtit në
qiellza... më kanë shpuar
duart dhe këmbët" (Ps. 22:15,16)

Kjo u përmbush me etjen e
kryq (Gjon 19:28). Çpuarja e duarve
dhe këmbëve e ka fjalën për metodën
fizike të kryqëzimit të përdorur.

"Ndajnë midis tyre rrobat e mia

Përmbushja e përpiktë e kësaj është

dhe hedhin në short tunikën gjetur në Mat. 27:35.
time" (Ps. 22:18).

Vini re që Ps. 22:22 citohet veçanërisht siç flitet për Jezusin në Heb. 2:12.

"Unë jam bërë një i huaj për Kjo fare mirë përshkruan ndjenjën e
vëllezërit dhe për bijtë e nënës huazimit nga vëllazëria e judenjve dhe
sime. Sepse zelli i shtëpisë sate familjes së tij (Gjo 7:3-5, Mat.12:47- më
ka përpirë"(Ps. 69:8,9). 49). Kjo është cituar në Gjon 2:17

"Ata më dhanë vrer në vend Kjo ndodhi kur Krishti ishte në kryq
të ushqimit; dhe për të ma (Mat. 27:34).
shuar etjen më dhanë për të
pirë uthull" (Ps. 69:21).

Gjithë Isaia 53 është një profeci e pashoqe e vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit, çdo varg i së cilës pati një përmbushje të pagabueshme. Do të jepen vetëm dy shembuj:-

"Si një dele e heshtur përpara Krishti, Qengji i Perëndisë mbeti i
atyre që i qethin, nuk e hapi heshtur gjatë gjyqit të tij (Mat. 27:
gojën" (Isa. 53:7) 12,14).

"Kishin caktuar ta varrosnin Jezusi u kryqëzua bashkë me
me të pabesët, po kur vdiq kriminelët e këqinj (Mat. 27:38),
e vunë me të pasurin" (Isa.53:9), po u varros në varrin e një të pasuri
(Mat. 27:57-60).

Është pak për t'u habitur që Dhjata e Re na kujton që "ligji dhe profetët e Dhjatës se Vjetër është baza për kuptimin e Krishtit (Vep. 26:22; 28:23; Rom.1:2,3;16:25,26). Vetë Jezusi paralajmëroi që në qoftë se ne nuk kuptojmë si duhet "Moisiun dhe profetët", ne nuk mund ta kuptojmë atë (Lluka 16:31; Gjon 5:46,47).

Që ligji i Moisiut paratregoi Krishtin dhe profetët profetizuan atë, duhet të jetë provë e mjaftueshme që Jezusi nuk egzistoi fizikisht përpara lindjes së tij. Doktrina e rreme e 'paraegzistencës' së Krishtit para lindjes i nxjerr pakuptim premtimet e premtuara që ai do të ishte *fara* (pasardhësi) i Evës, Abrahamit dhe Davidit. Në qoftë se ai egzistonte lart në qiej në kohën e këtyre premtimeve, Zoti do të kishte qenë i pasaktë në premtimin e një

pasardhësi këtyre njerëzve, që *do të ishte* Mesia. Gjenealogjitë e Jezusit, të shënuara në Mat. 1 dhe Llukën 3, tregojnë se si Jezusi kishte një listë paraardhësish që shkonte deri te ata njerëz, të cilëve Perëndia u kishte bërë premtimet.

Premtimi ndaj Davidit lidhur me Krishtin nuk i lë vend egzistencës fizike të tij në kohën kur u bë premtimi: "Unë *do të* ngre mbas teje pasardhësit e tu që *do të* dalin nga barku yt...unë *do të jem* babai i tij dhe ai *do të jetë* biri im" (2 Sam. 7:12,14). Vini re kohën e ardhme që përdoret këtu. Duke parë që Perëndia *do të ishte* Ati i Krishtit, është e pamundur që biri i Perëndisë të kishte egzistuar në atë kohë kur premtimi ishte bërë. Që kjo farë "*do të dalin nga barku yt*" tregon se *do të ishte* një pasardhës tamam fizik i Davidit. "Zoti iu betua Davidit në të vërtetë ..do të vë mbi fronin tënd një fryt të përbrendshmeve të tua" (Ps. 132:11).

Solomon ishte përmbushja fillestare e premtimit, po meqë ai ishte në egzistencë në kohën e këtij premtimi (2 Sam. 5:14), përmbushja kryesore e këtij premtimi për Davidin që të kishte një pasardhës fizik që të ishte biri i Perëndisë, duhet ta ketë fjalën për Krishtin (Lluka 1:31-33). "Unë *do të* ngre nga Davidi një filiz të drejtë" (Jer. 23:5) - d.m.th. Mesia.

Kohë të ngjashme të ardhme janë përdorur në profeci të tjera lidhur me Krishtin. "Unë *do të* ngre (Izraelin) një Profet si në (Moisiun) (LiP. 18:18) citohet në Veprat 3:22,23, që përkufizon "Profet" si Jezusin. "Një virgjëreshë(Maria) *do të mbetet* me barrë dhe *do të lindë* një fëmijë dhe *do ta quajë Emanuel*" (Is. 7:14). Kjo u përmbush qartë në lindjen e Krishtit (Mat. 1:23).

7.2 Lindja e Virgjëreshës

Shënimi i lindjes dhe konceptimit të Krishtit nuk lë vend për idenë që ai egzistoi fizikisht paraprakisht. Ata që mbajnë doktrinën e rremë të 'trinitetit' udhëhiqen në përfundimin që në një çast kishte tre persona në parajsë dhe pastaj një prej tyre u zhduk dhe sesi u shndrrua në foshnje në barkun e Marisë duke lënë vetëm dy në parajsë. Ne kemi parë në Shkrimet se gjithë egzistenca – duke përfshirë atë të Perëndisë – është një egzistencë fizike në trajtë trupore. Prandaj na lihet të arrijmë në përfundimin nga besimi i 'para egzistencës' që Krishti disi zbriti fizikisht nga qiejtë dhe hyri në barkun e Marisë. Gjithë kjo teologji komplekse është krejt jashtë mësimit të Shkrimit. Shënimi i fillimit të Krishtit nuk jep absolutisht asnjë arsye të mendosh që ai

la qiejt fizikisht dhe hyri në barkun e Marisë. Mungesa e fakteve për këtë është një 'mungesë hallke' e madhe në mësimin e trinitetit.

Ëngjëlli Gabriel iu shfaq Marisë me lajmin që "ti do të mbetesh shtatëzanë dhe do të lindësh një djalë dhe do t'ia vësh emrin Jezus. Ai do të jetë i madh dhe do të quhet Biri i Shumë të Lartit...Dhe Maria i tha ëngjëllit, Si do të ndodhë kjo përderisa unë nuk njoh burrë? (d.m.th. ajo ishte virgjëreshë). Dhe ëngjëlli duke iu përgjigjur, i tha, Fryma e Shenjtë do të vijë mbi ty dhe pushteti i Shumë të Lartit do të të mbulojë me hijen e vet: prandaj i shenjtë që do të lindë prej teje do të quhet Bir i Perëndisë" (Lluka 1:31-35).

Dy herë është theksuar se Jezusi *do të ishte* Biri i Perëndisë në lindje të tij; është e qartë që Biri i Perëndisë nuk egzistonte para lindjes së tij. Përsëri duhen vënë re shumë kohë të ardhme - p.sh. "ai *do të jetë* i madh". Në qoftë se Jezusi ishte në egzistencë kur ëngjëlli i fliste Marisë këto fjalë, ai do të kishte qenë i madh që atëhere. Jezusi ishte "pasardhja" e Davidit (Zbu. 22:16), 'genos' greke duke nënkuptuar Jezusi kishte 'gjeneruar nga' Davidi.

KONCEPTI I JEZUSIT

Nëpërmjet Frymës së Shenjtë (fuqisë/frymës së Perëndisë) duke vepruar mbi të, Maria që në gjendje të zinte Jezusin pa patur nevojë të kishte marrdhënie me një njeri. Kështu Jozefi nuk ishte babai i vërtetë i Jezusit. Duhet të kuptohet që Fryma e Shenjtë nuk është një person (shih Kapitullin 2); Jezusi ishte Biri i Perëndisë, jo i Frymës së Shenjtë. Nëpërmjet përdorimit nga Perëndia të Frymës së Tij mbi Marinë, "*prandaj* gjithashtu ajo gjë e shenjtë", që u lind prej saj, u "quajt Biri i Perëndisë" (Lluka 1:35). Përdorimi i fjalës "*prandaj*" nënkupton që pa veprimin e Shpirtit të Shenjtë në barkun e Marisë, Jezusi, Biri i Perëndisë, nuk mund të vinte në egzistencë.

Që Jezusi u 'zu' në barkun e Marisë (Lluka 1:31) është gjithashtu provë që ai nuk mund të kishte egzistuar fizikisht paraprakisht. Në qoftë se ne 'zëmë' një ide, fillon brenda nesh. Po ashtu Jezusi u zu brenda barkut të Marisë – ai filloi atje si embrion, tamam si çdo qenie tjetër njerëzore. Gjon 3:16, vargu më i famshëm i Biblës, shënon se Jezusi ishte i "vetëmlinduri Bir" i Perëndisë. Miliona njerëz që e recitojnë këtë varg, nuk mendohen për kuptimin e tij. Nëse Jezusi u "vetëmlind", ai "filloi" (një fjalë lidhur me "vetëmlindur"), kur u zu në mitrën e Marisë. Në qoftë se Jezusi u birësua

nga Perëndia si Atë i tij, kjo është evidencë e qartë që Ati i tij është më i moshuar se ai – Perëndia nuk ka fillim (Ps. 90:2) dhe prandaj Jezusi nuk mund të jetë Perëndia Vetë (Kapitulli 8 zgjerohet në këtë pikë).

Është e rëndësishme që Jezusi u "birësua" nga Perëndia para se të krijohej, si Adami në fillim. Kjo shpjegon afërsinë e shoqërimit të Perëndisë me Jezusin - "Perëndia ishte në Krisht, duke pajtuar botën me veten" (2 Kor. 5:19). Krishti, duke qenë i birësuar nga Perëndia, sesa thjesht i krijuar nga pluhuri, gjithashtu ndihmon në shpjegimin e prirjes së tij natyrale për udhët e Perëndisë, Atit të tij.

Is. 49:5,6 përmban një profeci lidhur me Krishtin si drita e botës, që ai e përmbushi (Gjon 8:12). Ai përshkruhet duke medituar mbi "Zotin që më formoi në bark për të qenë shërbëtori i tij". Krishti, pra, u "formua" nga Perëndia në barkun e Marisë, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Tij të Shenjtë. Barku i Marisë, pra, ishte vendi i fillimit fizik të Krishtit.

Ne kemi parë në Kapitullin 7.1 se Psalmi 22 profetizon mendimet e Krishtit në kryq. Ai pasqyron se Perëndia "më nxori nga barku...unë u braktisa tek ti qysh nga barku: ti je Perëndia im qysh nga barku i nënës sime"(Ps. 22:9,10). Në kohën e vdekjes së tij, Krishti hedh vështrimin mbrapa në fillimin e tij – në barkun e mamasë së tij Mari, formuar nga fuqia e Perëndisë. Vetë përshkrimi i Marisë në ungjill si "*nëna*" e Krishtit, e shkatërron në vetvete idenë që ai egzistoi përpara lindjes së tij nga Maria.

Maria ishte një qenie njerëzore e zakonshme, me prindër normalë njerëzorë. Kjo provohet nga fakti që ajo kishte një kushërirë, që lindi Gjon pagëzorin, një njeri i zakonshëm (Luka 1:36). Idea katolike romake që Maria nuk ishte prej natyre të zakonshme njerëzore, do të thotë që Krishti nuk mund të kishte qenë edhe "bir njeriu" edhe "bir Perëndie". Këto janë titujt e tij të shpeshtë gjatë Dhjatës së Re. Ai ishte "bir njeriu" nga arsya e të pasurit një nëne tërësisht njerëzore dhe "bir Perëndie" për shkak të veprimit të Perëndisë në Marinë nëpërmjet Frymës së Shenjtë (Luka 1:35), domethënë Perëndia ishte Ati i tij. Ky kombinim i bukur zerohet në qoftë se Maria nuk ishte një grua e zakonshme.

"Kush mund të nxjerrë një gjë të pastër nga një gjë e papastër? Askush... ç'është njeriu që të jetë i pastër? Dhe i linduri nga një grua të jetë i drejtë?...si mund të jetë i pastër një i lindur nga një grua?" (Job 14:4; 15:14; 25:4). Kjo fshin çdo ide të një konceptimi të pastër të mundshëm, si për Marinë ashtu edhe për Jezusin.

Maria duke qenë “lindur prej gruaje”, me prindër të zakonshëm njerëzorë, duhet të ketë pasur natyrën tonë njerëzore të papastër, të cilën e trashëgoi te Jezusi, i cili ishte “bërë prej gruaje” (Gal. 4:4). Gjuha që e përshkruan atë si të “bërë” nëpërmjet agjensisë së Marisë është evidencë e mëtejshme që ai nuk mund të kishte egzistuar fizikisht pa u lindur prej saj. Diagloti e paraqet Gal. 4:4: “ka qenë prodhuar nga një grua”.

Shënimet e Biblës shpesh tregojnë natyrën njerëzore të Marisë. Krishtit iu desh ta korigjonte të paktën tre herë për formimin e saj në frymë (Lluka 2:49; Gjon 2:4); ajo nuk arriti të kuptonte të gjitha thëniet e tij (Lluka 2:50). Kjo është tamam çfarë të presim nga një grua me natyrë njerëzore, biri i së cilës ishte Biri i Perëndisë, dhe prandaj më i ngritur në frymë se ajo, megjithatë edhe ai, kishte natyrë njerëzore. Jozefi pati marrëdhënie me Marinë pas lindjes së Krishtit. (Mat 1:25), dhe nuk ka arsye të mendosh që ata nuk patën një marrëdhënie martesore normale që atëhere në vazhdim.

Përmendja e “nënës dhe vëllezërve” të Krishtit në Mat. 12:46,47 do të nënkuptonte, pra, që Maria pati fëmijë të tjerë pas Jezusit. Jezusi ishte vetëm “i parëlinduri i saj”. Mësimet katolike që Maria mbeti virgjëreshë dhe pastaj u ngjiti në qiejt, pra, nuk kanë asnjë mbështetje Biblike. Si qenie njerëzore prej natyre njerëzore, Maria do të jetë plakur dhe ka vdekur; përveç kësaj ne lexojmë në Gjon 3:13, “askush nuk u ngjiti në qiell”. Fakti që Krishti kishte natyrë njerëzore (shih Heb. 2:14-18; Rom. 8:3) do të thotë që edhe nëna e tij duhet ta ketë pasur, duke qenë që Ati i tij nuk e kishte.

7.3 Vendi i Krishtit në planin e Perëndisë

Perëndia nuk vendos në planet e tij minutën e fundit, duke planifikuar pjesë rezervë të qëllimit të Tij me zhvillimin e historisë njerëzore. Perëndia kishte një plan të plotë të formuluar që nga fillimi i krijimit (Gjon 1:1). Dëshira e tij për të patur një Bir, pra, ishte në planin e Tij që në fillim. Gjithë Dhjata e Vjetër shpalos aspekte të ndryshme të planit të Perëndisë për shpëtimin në Krisht.

Ne kemi treguar herë pas here se nëpërmjet premtimeve, profecive të profetëve dhe llojet e Ligjit të Moisiut, Dhjata e Vjetër është vazhdimisht në zbulim të qëllimit të Perëndisë në Krishtin. Ishte në sajë të njohurisë së Perëndisë që Ai do të kishte një Bir që Ai solli krijimin në egzistencë (Heb. 1:1,2, teksti grek “nga” në A.V. është përkthyer më mirë “në sajë të”). Ishte në sajë të Krishtit që kohët e historisë njerëzore u lejuan nga Perëndia (Heb.

1:2 (Greqisht). Si rrjedhim zbulimi i Perëndisë ndaj njeriut përmes viteve, siç është shënuar në Dhjatën e Vjetër, është plot me referenca të Krishtit.

Epërsia e Krishtit dhe rëndësia e tij themelore kolosale të Perëndia është e vështirë të merret me mend. Prandaj është e vërtetë të thuash që Krishti egzistonte në mendjen dhe qëllimin e Perëndisë që nga fillimi, megjithëse erdhi në egzistencë fizikisht nëpërmjet lindjes së tij nga Maria. Heb. 1:4-7, 13,14, shtron se Krishti nuk ishte një ëngjëll; ndërsa në jetën e tij të vdekshme ai ishte më pak se ëngjëjt (Heb. 2:7), ai u ngrit në një nder shumë më të lartë se ata duke qenë se ishte "i *vetëmlinduri Biri*" i Perëndisë (Gjon 3:16). Ne kemi treguar më parë se e vetmja trajtë egzistence e mësuar në Shkrim është egzistenca në trajtë trupore, prandaj Krishti nuk egzistoi si 'frymë' përpara lindjes së tij. 1 Pjetër 1:20 përmbledh pozitën: Krishti "ishte i paranojohur përpara krijimit të botës, po u shfaq kohët e fundit".

Jezusi ishte boshti qendror i Ungjillit, të cilin Perëndia "kishte premtuar më parë me anë të profetëve të tij në Shkrimet e shenjta, lidhur me birin e tij, Jezu Krisht Zotin tonë, që u bë (krijuar me anë birësimi) prej farës së Davidit sipas mishit; dhe shpalli se ishte Biri i Perëndisë në fuqi, sipas frymës së shenjtërisë, me anë të ringjalljes prej së vdekurit" (Rom. 1:1-4).

Kjo përmbledh historinë e Krishtit:-

1. I premtuar në Dhjatën e Vjetër - d.m.th. në planin e Perëndisë
2. I krijuar si person fizik nëpërmjet lindjes së virgjëreshës, si një farë e Davidit;
3. Në sajë të karakterit të tij të përkryer ("fryma e shenjtërisë") treguar gjatë jetës së tij të vdekshme
4. Ai u ringjall dhe, përsëri shpalli publikisht se ishte Biri i Perëndisë nga predikimi i apostujve dhënë në frymëzim.

DIJA PARAPRAKE E PERËNDISË

Ne do të ndihmohemi shumë për të çmuar se sa plotësisht ishte Krishti në mendjen e Perëndisë në fillim, duke mos egzistuar akoma fizikisht, në qoftë se mund të pranojmë faktin që Perëndia i di *të gjitha* gjërat që do të nodhin në 'të ardhmen'; Ai ka 'dijeni paraprake' të plotë. Prandaj Perëndia mund të flasë dhe mendojë për gjëra që nuk egzistojnë, që megjithatë egzistojnë. E tillë është tërësia e njohjes së Tij për të ardhmen. Perëndia "thërret gjërat që

nuk janë sikur të ishin” (Rom. 4:17). Prandaj Ai mund të shpallë "fundin që në fillim dhe shumë kohë më parë gjërat që ende nuk janë bërë, duke thënë, Plani im do të realizohet dhe do të bëj gjithçka më përpara" (Is. 46:10). Për shkak të kësaj, Perëndia mund të flasë për të vdekurit si të jenë të gjallë përpara lindjes.

“Plani”, ose fjala e Perëndisë, e ka profetizuar Krishtin që nga fillimi; ai ishte gjithmonë në qëllimin ose “kënaqësinë” e Perëndisë. Prandaj ishte e sigurtë që dikur Krishti do të lindte fizikisht; Perëndia do të përmbushte qëllimin e tij të deklaruar në Krisht. Siguria e njohurisë paraprake të Perëndisë është, pra, e pasqyruar në sigurinë e fjalës së Tij. Gjuha hebraishte biblike ka një kohë ‘e kryer profetike’, që përdor kohën e shkuar për të përshkruar gjëra të së ardhmes që ka premtuar Perëndia. Kështu Davidi tha, “kjo është shtëpia e Zotit Perëndi” (1 Kron. 22:1), kur tempulli akoma vetëm i ishte premtuar nga Perëndia. I tillë ishte besimi i tij në fjalën e premtimit, sa që ai përdori kohën e tashme për të përshkruar gjëra të së ardhmes. Shkrimi është i mbushur me shembuj të dijenisë paraprake të Perëndisë. Perëndia ishte aq i sigurtë që do t’i përmbushte premtimet ndaj Abrahamit, sa që Ai i tha atij: "Unë ua *kam dhënë* pasardhësve të tu këtë vend..." (Zan. 15:18) në një kohë kur Abrahami as që nuk kishte farë. Gjatë kësaj periudhe të njëjtë përpara farës lindi (Isaku/Krishti), Perëndia premtoi më tej: "*unë të kam bërë* babanë e një shumice kombesh" (Zan. 17:5). Në të vërtetë Perëndia “thërret gjërat që nuk janë sikur të ishin”.

Kështu Krishti foli gjatë shërbimit të tij se si Perëndia “*ia ka dhënë* në duar (të Krishtit) të gjitha gjërat” (Gjon 3:35), edhe pse atëhere kjo nuk ishte ashtu. “Ti i ke vënë të gjitha nën këmbë (të Krishtit)...por tani nuk shohim ende që të gjitha janë nën pushtetin e tij” (Heb. 2:8).

Perëndia foli për planin e Tij të shpëtimit nëpërmjet Jezusit "nëpërmjet gojës së profetëve të tij të shenjtë, të cilët kanë qenë që kur filloi bota" (Lluka 1:70). Meqenëse ata ishin të shoqëruar kaq nga afër me planin e Perëndisë, për këta njerëz flitet sikur ata vërtet të kenë egzistuar që nga fillimi, edhe pse është e evidente që nuk është ashtu. Në vend të saj ne mund të themi që profetët ishin në planin e Perëndisë që nga fillimi. Jeremia është një shembull parësor. Perëndia i tha atij: “Para se unë të të formoja në barkun e nënës sate, të kam njohur; para se ti të dilje nga barku i saj të kam shenjtëruar dhe të kam caktuar profet” (Jer. 1:5). Kështu Perëndia dinte gjithçka për Jereminë edhe përpara krijimit. Në mënyrë të ngjashme Perëndia mund të fliste për mbretin Persian, Kiri përpara kohës së lindjes së tij, duke përdorur gjuhë që nënkupton se ai ishte në egzistencë atëhere (Is.

45:1-5). Hebrejve 7:9,10 është një shembull tjetër i kësaj gjuhe të egzistencës që përdoret për dikë që nuk ka lindur atëhere akoma.

Në të njëjtën mënyrë që flitet për Jereminë dhe profetët si të kenë egzistuar para krijimit, për shkak të pjesës së tyre në planin e Perëndisë, po ashtu flitet edhe për besimtarët e vërtetë sikur egzistonin atëhere. Është e evidente që ne nuk egzistua atëhere përveçse në mendjen e Perëndisë. Perëndia “na shpëtoi dhe na thirri me një thirrje të shenjtë...sipas qëllimit të tij dhe sipas hirit, që na u dha në Krishtin Jezus përpara fillimit të kohëve” (2 Tim. 1:9). Perëndia “na zgjodhi në të (Krisht) përpara se të themelohej bota...duke na paracaktuar... sipas pëlqimit të vullnetit të Vet” (Efe. 1:4,5). Gjithë idea e të paranjohurit të individëve nga Perëndia që nga fillimi dhe të qenit ‘i shënuar’ (‘paracaktuar’) për shpëtim, tregon se ata egzistuan në mendjen e Perëndisë që në fillim (Rom. 8:27; 9:23).

Nën këtë dritë, nuk është çudi që për Krishtin, si përmbledhje e qëllimit të Perëndisë, duhet të flitet si të egzistonte që nga fillimi në mendjen dhe planin e Perëndisë, edhe pse fizikisht nuk mund të bënte ashtu. Ai ishte "qengji i vrarë që nga krijimi i botës" (Rev. 13:8). Jezusi nuk vdiq vërtet atëhere; ai ishte “Qengji i Perëndisë” i sakrifikuar rreth 4,000 vjet më vonë në kryq (Gjon 1:29; 1 Kor. 5:7). Në të njëjtën mënyrë që Jezusi u zgjodh që nga fillimi (1 Pjetër 1:20), po ashtu edhe besimtarët (Efe. 1:4; e njëjta fjalë greke për "zgjedhur" është përdorur në këto vargje). Vështirësia jonë në të kuptuarit gjithë këto është se ne nuk mund të marrim me mend me lehtësi se si vepron Zoti jashtë konceptit kohë. 'Besimi' është aftësia për t'i parë gjërat nga këndvështrimi i Perëndisë, pa kufizimet e kohës.

7.4 "Në fillim ishte fjala", Gjon 1:1-3.

"Në fillim ishte Fjala dhe Fjala ishte me Perëndinë dhe Fjala ishte Perëndi. E njëjta ishte në fillim me Perëndinë. Të gjitha gjërat u bënë me anë të tij" (Gjon 1:1-3).

Këto vargje, kur kuptohen si duhet, konfirmojnë dhe zgjerojnë përfundimet e arritura në pjesën e fundit. Megjithatë kjo pjesë është një nga më të keqkuptuarat për të mësuar se Jezusi egzistoi në qiej para lindjes së tij.

Një kuptim i drejtë i këtyre vargjeve varet në vlerësimin se çfarë do të thotë “Fjala” në këtë kuptim. Nuk mund të bëhet fjalë direkt për një person, sepse një person nuk mund të jetë “me Perëndinë” dhe megjithatë të *jetë* Perëndi në të njëjtën kohë. Fjala greke 'logos' që përkthehet "fjalë" këtu, nuk do të thotë 'Jezusi' në vetvete. Zakonisht përkthehet "fjala", por gjithashtu:-

Llogari	Çështje
Komunikim	Doktrinë
Synim	Predikim
Arsye	Thënie
Lajme	

Për "fjalën" flitet si për “ai”, sepse 'logos' ka gjini mashkullore në greqisht. Por kjo nuk do të thotë që e ka fjalën për njeriun, Jezusin. Varianti gjerman (Luther) flet për "das Wort" (asnjanëse); Varianti francez (Segond) flet për "la parole" si femërore, duke treguar se “fjala” nuk është e thënë të tregojë një person mashkull.

"NË FILLIM"

'Logos' mund ta ketë fjalën saktësisht për mendimin e brendshëm i cili shprehet jashtë në fjalë dhe komunikime të tjera. Në fillim Perëndia kishte këtë 'logos'. Ky qëllim i vetëm u përqendrua në Krishtin. Ne e kemi treguar se Fryma e Perëndisë vë në veprim mendimet e Tij të brendshme, pra lidhjen ndërmjet Frymës së Tij dhe fjalës së Tij (shih Seksionin 2.2). Ndërsa Fryma e Perëndisë realizonte planin e Tij me njerëzit dhe frymëzoi Fjalën e Tij të shkruar që nga fillimi, që aty komunikoi idenë e Krishtit në punën dhe fjalët e saj. Krishti ishte 'logos' i Perëndisë, prandaj Fryma e Perëndisë shprehu planin e Perëndisë për Krishtin në të gjitha veprimet e saj. Kjo shpjegon se pse kaq ndodhi të Dhjatës së Vjetër janë tipike të Krishtit. Megjithatë, nuk mund të mbi-theksohet që Krishti në person nuk ishte “fjala”; ishte plani i Perëndisë për shpëtimin nëpërmjet Krishtit, që ishte "fjala". 'Logos' ("Fjala") shumë shpesh përdoret lidhur me Ungjillin për Krishtin - p.sh. "fjala e Krishtit" (Kol. 3:16; krahu. Mat. 13:19; Gjon 5:24; Vep. 19:10; 1 Thes. 1:8 etj.). Vini re që 'logos' është *rreth* Krishtit se sa ai vetë. Kur lindi Krishti, kjo "fjala" u shndërrua në trajtë mishi dhe gjaku - "fjala u bë mish" (Gjon 1:14). Jezusi personalisht ishte 'fjala e bërë mish' se sa “fjala”; ai vetë u bë “fjala” nëpërmjet lindjes së tij nga Maria, se sa në ndonjë kohë më parë.

Plani ose lajmi, për Krishtin ishte me Perëndinë në fillim, por u zbulua haptas në personin e Krishtit dhe në predikimin e Ungjillit rreth tij në

shekullin e parë. Kështu Perëndia na e foli fjalën e Tij nëpërmjet Krishtit (Heb. 1:1,2). Pra edhe një herë është theksuar se Krishti foli fjalët e Perëndisë dhe bëri mrekulli në fjalën e urdhërimit të Perëndisë me qëllim që të na zbulonte Perëndinë neve (Gjon 2:22; 3:34; 7:16; 10:32,38; 14:10,24).

Pali iu bind urdhërimeve të Krishtit për të predikuar Lajmin e tij "gjithë kombeve": "Predikimi i Jezu Krishtit sipas zbulësës së misterit të mbajtur fshehur që kur filloi bota, por tani u shfaq...u njoh ndër të gjitha kombet" (Rom. 16:25,26 kra. 1 Kor. 2:7). Jeta e përjetshme u bë e mundshme për njeriun vetëm nëpërmjet veprës së Krishtit (Gjon 3:16; 6:53); megjithatë në fillim Perëndia kishte këtë plan t'i ofronte njeriut jetë të përjetshme, duke ditur siç dinte sakrificën që do të bënte Jezusi. Zbulesa e plotë e kësaj oferte erdhi vetëm pas lindjes dhe vdekjes së Jezusit: "jetës së përjetshme, të cilën Perëndia...e premtoi para se të fillonte bota; dhe që në kohë të caktuara e shfaqti fjalën e tij (të jetës) me anë të predikimit" (Titus 1:2,3). Ne kemi parë se si është folur për profetët e Perëndisë si të kenë egzistuar gjithnjë (Luka 1:70) në kuptimin që "fjala", të cilën ata folën egzistoi me Perëndinë që nga fillimi.

Shëmbëlltyrat e Jezusit zbuluan shumë nga këto gjëra; ai pra përmbushi profecinë lidhur me veten e tij, "unë do të hap gojën time në shëmbëlltyra; do të zbuloj gjëra të fshehura që nga themelimi i botës" (Mat. 13:35). Ishte në këtë kuptim që "fjala ishte me Perëndinë...që nga fillimi" për t'u "bërë mish" në lindjen e Krishtit.

"FJALA ISHTE PERËNDI"

Ne tani jemi në pozitën që të marrim parasysh në çfarë kuptimi "Fjala ishte Perëndi". Planet dhe mendimet tona në thelb janë ne. 'Unë po shkoj në Londër' është një 'fjalë' ose komunikim, e cila shpreh qëllimin tim, sepse është qëllimi im. Plani i Perëndisë në Krishtin mund të kuptohet ngjashmërisht. "Ashtu si mendon (një njeri) në zemër të tij, ashtu është ai" (Prov. 23:7), dhe siç mendon Perëndia, ashtu është Ai. Kështu fjala ose mendimi i Perëndisë është Perëndi: "fjala ishte Perëndi". Për shkak të kësaj ka një shoqërim shumë të afërt midis Perëndisë dhe fjalës së Tij: paralelizma si Ps.29:8 janë të zakonshëm: "Zëri i Zotit e bën shkretëtirën të dridhet; Zoti bën të dridhet shkretëtira". Thënie si "Ju nuk më keni dëgjuar, thotë Zoti" (Jer. 25:7) janë të zakonshme te profetët. Në fakt Perëndia do të thotë 'Ju nuk i keni dëgjuar fjalët e Mia thënë profetëve'. Davidi mori fjalën e Perëndisë si llampë dhe dritë (Ps. 119:105), dhe prapë pasqyroi: "Ti je drita ime, O Zot: dhe Zoti ndriçon terrin tim" (2 Sam. 22:29), duke treguar

paralelizmin midis Perëndisë dhe fjalës së Tij. Është e kuptueshme, pra, që fjala e Perëndisë personifikohet si Ai Vetë, d.m.th. për të flitet si për një person edhe pse nuk është (shih Degëzimin 5 'Parimi i personifikimit').

Perëndia është e vërteta vetë (Gjon 3:33; 8:26; 1 Gjon 5:10), dhe pra, edhe fjala e Perëndisë është vërtetësi (Gjon 17:17). Në mënyrë të ngjashme Jezusi njihson vetveten me fjalët e veta kaq afër sa që personifikon fjalën e tij: "Kush më hedh poshtë dhe nuk pranon fjalët e mia, ka kush e gjykon: fjala që kam shpallur, e njëjta do ta gjykojë në ditën e fundit" (Gjon 12:48). Jezusi flet për fjalën e tij si të jetë vërtetë një person d.m.th. vetja e tij. Fjalët e tij janë personifikuar, sepse ato ishin të shoqëruara kaq nga afër me Jezusin.

Fjala e Perëndisë, në ngjashmëri, është personifikuar si një person, d.m.th. Perëndia vetë, në Gjon 1:1-3. Kështu ne na është thënë lidhur me Fjalën, Të gjitha gjërat janë bërë prej Tij" (Gjon 1:3). Megjithatë "Perëndia krijoi" të gjitha gjërat me anë të fjalës së Tij të urdhërimit (Gen. 1:1). Për shkak të kësaj, për Fjalën e Perëndisë flitet si të jetë Perëndia Vetë. Pikëpamja e devotshme për t'u vënë re nga kjo është që duke patur fjalën e Perëndisë në zemrat tona, Perëndia mund të vijë kaq afër nesh.

Është evidente nga Zan. 1 që Perëndia ishte Krijuesi nëpërmjet fjalës së Tij, se sa Krishti vetë. Ishte *fjala*, që është përshkruar sikur bën të gjitha gjërat se sa Krishti vetë (Gjon 1:1-3). "Me anë të fjalës së Zotit u bënë qiejt; dhe tërë ushtria e tyre (d.m.th. yjet) me anë të frymës së gojës së tij...ai foli dhe u bë" (Ps. 33:6,9). Edhe tani krijimi natyror vepron me anë të fjalës së tij: "Ai dërgon mbi tokë urdhërimin e tij: fjala e tij merr dheun. Ai dërgon borën si lesh...Ai dërgon fjalën e tij...dhe ujrë rrjedhin" (Ps. 147:15-18).

Fjala e Perëndisë, duke qenë fuqia e Tij krijuese, Ai e përdori në lindjen e Jezusit në barkun e Maries. Fjala, plani i Perëndisë i vënë në veprim nga Fryma e Tij e Shenjtë (Lluka 1:35), solli konceptin e Krishtit. Maria e njohu këtë në përgjigjen e saj ndaj lajmit për konceptin e ardhshëm të Krishtit: "Ie të më ndodhë sipas *fjalës* sate" (Lluka 1:38).

Ne kemi parë që Fjala/Fryma e Perëndisë pasqyron qëllimin e Tij, që është thënë gjatë gjithë Dhjatës së Vjetër. Deri në çfarë shkalle kjo është e vërtetë, tregohet në Veprat 13:27, ku për Jezusin është folur si paralel ndaj fjalëve të profetëve të Dhjatës së Vjetër: "(Judejtë) nuk e njohën, as zërat e profetëve". Kur lindi Krishti, gjithë Fjala/Fryma e Perëndisë u shpreh në personin e Jezu Krishtit. Nën frymëzim, apostulli Gjon u ngazëllye në planin e Perëndisë për

jetën e përjetshme që ishte shprehur në Krishtin, të cilin dishepujt kishin qenë në gjendje ta preknin dhe shikonin fizikisht. Ai tani e dinte që ata tani kishin në duar Fjalën e Perëndisë, tërë planin e Tij të shpëtimit në Krishtin (1 Gjon 1:1-3). Ndërsa ne nuk mund ta shohim Krishtin fizikisht, edhe ne mund të gëzojmë në të nëpërmjet kuptimit të vërtetë të tij, ne mund të njohim qëllimin e Perëndisë me ne nga kaq afër dhe, pra, të sigurohemi për jetë të përjetshme (1 Pjetër 1:8,9). Ne duhet t'i bëjmë vetes pyetjen: 'E njoh vërtet Krishtin unë?' Vetëm të pranosh që një njeri i mirë që quhej Jezus egzistonte njëherë, nuk është e mjaftueshme. Nëpërmjet studimit të vazhdueshëm në lutje të Biblës, është e mundshme ta kuptosh shpejt atë si Shpëtimtarin tënd personal dhe ofroja atij veten tënde nëpërmjet pagëzimit.

Kapitulli 7: Pyetje

1. Egzistoi Jezusi fizikisht para lindjes së tij?
 - a) Po
 - b) Jo

2. Në çfarë kuptimi mund të thuhet se egzistoi Jezusi para lindjes së tij?
 - a) Si një engjëll
 - b) Si pjesë e një triniteti
 - c) Si një frymë
 - d) Vetëm në mendjen dhe qëllimin e Perëndisë.

3. Cila nga thëniet e mëposhtme janë të vërteta për Marinë?
 - a) Ajo ishte një grua e përkryer, pa mëkate
 - b) Ajo ishte një grua e zakonshme
 - c) Ajo mbeti shtatëzane me Jezusin me anë të Frymës së Shenjtë
 - d) Ajo tani i ofron Jezusit lutjet tona.

4. E krijoi Jezusi tokën?
 - a) Po
 - b) Jo

8:1 Natyra e Jezusit: Parathënie

Duhet të jetë një nga tragjeditë më të mëdha në të menduarit kristian që Zoti Jezu Krisht nuk ka marrë respektin dhe ngritjen që i takon për shkak të fitores së tij mbi mëkatin, nëpërmjet zhvillimit të një karakteri të përkryer. Doktrina e përhapur gjerësisht e 'trinitetit' e bën Jezusin Perëndinë Vetë. Duke parë që Perëndia nuk mund të tundohet (Jakob 1:13) dhe nuk ka mundësi mëkatimi, kjo do të thotë që Krishti, në të vërtetë nuk iu desh të ndeshet me mëkatin. Prandaj jeta e tij në tokë ishte një kotësi, duke jetuar përvojën njerëzore, po pa ndjenjë të vërtetë për mëdyshjen shpirtërore dhe fizike të rracës njerëzore, duke qenë që ai vetë nuk ndikohej nga kjo.

Në ekstremin tjetër, grupe si Mormonët dhe Dëshmitarët e Jehovës nuk mund të çmojnë sa duhet mrekullinë e Krishtit si i vetëmlinduri Bir i Perëndisë. Si i tillë ai nuk mund të ketë qenë një ëngjëll ose biri natyral i Jozefit. Disa sugjerojnë se gjatë jetës së tij, natyra e Krishtit ishte si ajo e Adamit para rënies. Përveç mungesës së fakteve biblike për këtë pikëpamje, nuk është në gjendje të çmojë që Adami u krijua nga Perëndia me dhe, ndërsa Jezusi u 'krijua' duke i lindur Perëndisë në barkun e Maries. Kështu, edhe pse Jezusi nuk kishte baba njerëzor, ai u zu dhe lindi si ne në të gjitha mënyrat e tjera. Shumë njerëz nuk mund të pranojnë që një njeri i natyrës sonë mëkatore, të mund të kishte karakter të përkryer. Ky është fakti që bëhet pengesë për një besim të vërtetë në Krisht.

Të besosh që Jezusi ishte prej natyrës sonë, por ishte pa mëkate në karakterin e tij, duke mposhtur tundimet e tij, nuk është e lehtë. Duhet shumë pasqyrime mbi shënimet e Ungjillit të jetës së tij të përkryer, bashkë me shumë pjesë biblike, të cilat mohojnë që ai ishte Perëndia, për të ardhur në një kuptim dhe besim të qendrueshëm në Krishtin e vërtetë. Është shumë më e lehtë të supozosh që ai ishte Perëndia Vetë, dhe prandaj rrjedhimisht i përkryer. Por prapë kjo pikëpamje ç'vlerëson madhësinë e fitores që Jezusi fitoi kundër mëkatit dhe natyrës njerëzore.

Ai pati natyrë njerëzore; ai pati pjesë nga çdo tendencë mëkatore e jona (Heb. 4:15), megjithatë ai i mposhti ato nëpërmjet përkushtimit ndaj udhëve të Perëndisë dhe duke kërkuar ndihmën e Tij për të mposhtur mëkatin. Kjo Perëndi dha me vullnet, deri në atë që "Perëndia ishte në Krishtin, duke pajtuar botën me Vetveten" nëpërmjet vetë Birit të Tij (2 Kor. 5:19).

8.2 Ndryshimet ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit

Gjendet një drejtpeshim i mirë për t'u mbajtur ndërmjet atyre pjesëve që theksojnë shkallën, në të cilën "Perëndia ishte në Krishtin" dhe atyre, që vënë në dukje natyrën e tij njerëzore. Grupi i fundit i pjesëve e bëjnë të pamundur të justifikosh biblikisht idenë që Jezusi është Perëndia Vetë "vetë Perëndia e vetë Perëndisë", siç e ka gabim doktrina e trinitetit. (Kjo shprehje "vetë Perëndia e vetë Perëndisë" ishte në këshillin e Niçes në 325 M.E.S., ku idea e Perëndisë si 'trinitet' u shpall për herë të parë; ishte e panjohur ndaj kristianëve të hershëm.) Fjala 'trinitet' nuk përmendet kurrë në Bibël. Kapitulli 9 do të shqyrtojë më tej fitoren e Krishtit mbi mëkatat dhe rolin e Perëndisë në të. Kur ne fillojmë këto kapituj, le të mbajmë mend që shpëtimi varet në kuptimin e saktë të Jezu Krishtit të vërtetë (Gjon 3:36; 6:53;17:3). Pasi të kemi ardhur në këtë kuptim të vërtetë të mundjes nga ai të mëkatit dhe vdekjes, ne mund të pagëzohemi në të me qëllim që të ndajmë shpëtimin në këtë.

Një nga përmbledhjet më të qarta të marrëdhënies ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit gjendet në 1 Tim. 2:5: "**Një** është Perëndia, *dhe* një i vetëm është **ndërmjetësi** midis Perëndisë dhe njerëzve, **njeriu** Krishti Jezus". Pasqyrimi mbi fjalët e theksuara të çon në përfundimet e mëposhtme:-

- Duke qenë vetëm *një* Perëndi, është e pamundur që Jezusi mund të jetë Perëndia; në qoftë se Ati është Perëndia dhe gjithashtu Jezusi është Perëndia, atëherë ka dy Perëndi. "për ne s'ka veçse një Perëndi, Ati" (1 Kor. 8:6). 'Perëndia Atë' është, pra, i vetmi Perëndi. Prandaj është e pamundur që të ketë një qenie të veçantë të quajtur 'Perëndia Biri', siç thotë doktrina e rreme e trinitetit. Edhe Dhjata e Vjetër spikat Yahweh, të vetmin Perëndi, si Atin (p.sh. Isa. 63:16; 64:8).
- Përveç këtij një Perëndie, është ndërmjetësi, njeriu Krishti Jezus - "...*dhe* një ndërmjetës...". Ajo fjala "dhe" tregon një dallim ndërmjet Krishtit dhe Perëndisë.
- Krishti duke qenë "ndërmjetësi" do të thotë që ai është një shko-ndërmjet. Një ndërmjetës midis njeriut mëkatar dhe Perëndisë pa mëkate nuk mund të jetë Perëndia pa mëkate Vetë; duhet të jetë një njeri pa mëkate i natyrës mëkatore njerëzore. "**Njeriu** Krishti Jezus" nuk na lë asnjë dyshim për saktësinë e

këtij shpjegimi. Edhe pse ai po shkruante mbas ngritjes së Jezusit, Pali nuk flet për "Perëndinë Krishti Jezus".

Disa herë na është kujtuar që "Perëndia nuk është njeri" (Num. 23:19; Hos. 11:9); megjithatë Krishti ishte qartësisht "biri i njeriut", siç thirret shpesh në Dhjatën e Re, "*njeriu* Krishti Jezus". Ai ishte "Bir i më të Lartit" (Luka 1:32). Perëndia duke qenë "*Më I Larti*" tregon se vetëm Ai ka lartësi përfundimtare; Jezusi, duke qenë "*Biri i më të Lartit*" tregon se ai nuk mund ketë qenë Perëndia Vetë personalisht. Vetë gjuha e Atë dhe Bir, që është përsorur për Perëndinë dhe Jezusin, e bën të dukshme që ata nuk janë njësoj. Ndërsa një bir mund të ketë ngjashmëri të caktuara me atin e tij, ai nuk mund të jetë ai dhe i njëjti person, dhe as të jetë aq i moshuar sa ati i tij.

Si rrjedhim i kësaj, ka një numër dallimesh të dukshme ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit, të cilat tregojnë qartë që Jezusi nuk ishte vetë Perëndia:-

PERËNDIA	JEZUSI
"Perëndia nuk mund të tundohet" (Jakob 1:13).	Krishti"u tundua në të gjitha ashtu si ne" (Heb. 4:15).
Perëndia nuk mund të vdesë – Ai është i pavdekshëm nga natyra (Ps. 90:2; 1 Tim. 6:16).	Krishti vdiq për tre ditë (Mt.12: 40; 16:21).
Perëndia nuk mund të shihet nga njerëzit (1 Tim. 6:16; Eks. 33:20).	Njerëzit e panë Jezusin dhe e prekën atë (1 Gjon 1:1 e thekson këtë).

Kur ne tundohemi, shtyhemi nga një zgjedhje ndërmjet mëkatit dhe bindjes ndaj Perëndisë. Shpesh ne zgjedhim të mos i bindemi Perëndisë; Krishti pati të njëjtat zgjedhje, por gjithmonë zgjodhi të bindej. Prandaj ai pati mundësinë e mëkatimit, megjithëse ai kurrë nuk mëkatoi. Është e pamendueshme që Perëndia ka ndonjë mundësi mëkatimi. Ne kemi treguar që fara e Davidit e premtuar në 2 Sam. 7:12-16 ishte pa diskutim Krishti. Vargu 14 flet për mundësinë e Krishtit për të mëkatuar: "*Kur* do të bëjë ndonjë të keqe, unë do ta dënoj atë.

8:3 Natyra e Jezusit

Fjala 'natyrë' flet për atë që ne jemi prej natyre, në thelb. Ne kemi treguar në Kapitullin 1 se Bibla flet për vetëm dy natyra – atë të Perëndisë dhe atë të njeriut. Prej natyre Perëndia nuk mund të vdesë, tundohet, etj. Është e evidente që Krishti nuk ishte i natyrës së Perëndisë gjatë jetës së tij. Prandaj ai ishte tërësisht prej natyre njerëzore. Nga përkufizimi ynë për fjalën 'natyrë' duhet të jetë e evidente që Krishti nuk mund të ketë pasur dy natyra në të njëjtën kohë. Ishte jetike që Krishti të tundohet si ne (Heb. 4:15), që nëpërmjet mposhtjes së tij të përkryer të tundimit ai të mund të fitonte falje për ne. Dëshirat e gabuara që janë bazat e tundimeve tona vijnë nga brenda nesh (Mark 7:15-23), nga brenda natyrës sonë njerëzore (Jakob 1:13-15). Prandaj, ishte e nevojshme që Krishti të ishte njerëzor prej natyre, që ai të provonte dhe mposhte këto tundime.

Hebrenjve 2:14-18 e vë të tërë këtë në kaq shumë fjalë:-

"Si bijtë (ne) kanë marrë pjesë prej mishi dhe gjaku (natyra njerëzore), po ashtu edhe ai (Krishti) u bë pjestar (d.m.th. "mori pjesë", R.S.V.) në po ato gjëra (natyrë); që të shkatërronte me anë të vdekjes...djallin...Sepse në fakt ai nuk mori mbi vete natyrën e ëngjëjve; por ai mori mbi vete (natyrën e) farën e Abrahamit. Prandaj ai duhej t'u ngjante në çdo gjë vëllezërve, që të mund të ishte i mëshirshëm e kryepriфт besnik... për t'u bërë pajtim për mëkatet e popullit. Sepse duke qenë se ai vetë hoqi kur u tundra, mund t'u vijë në ndihmë atyre që tundohen".

Ky paragraf vë theks të jashtëzakonshëm mbi faktin që Jezusi kishte natyrë njerëzore: "*po ashtu edhe ai*" mori pjesë prej saj (Heb. 2:14). Kjo shprehje përdor tre fjalë të gjitha me të njëjtin kuptim, thjesht për të qartësuar idenë. Ai mori pjesë "nga e njëjta" natyrë; shënimi mund të kishte thënë 'edhe ai mori pjesë nga AJO', por thekson, "ai mori pjesë prej së njëjtës". Heb. 2:16 ngjashmërisht punon idenë që Krishti nuk kishte natyrë ëngjëjsh, duke qenë se ishte fara e Abrahamit, i cili kishte ardhur të sillte shpëtimin për shumicën e besuesve që do të bëheshin fara e Abrahamit. Për shkak të kësaj, ishte e nevojshme që Krishti të kishte natyrë njerëzore. Në *çdo* mënyrë ai duhej "t'u ngjante vëllezërve të tij" (Heb. 2:17) që Perëndia të mund të na jepte faljen nëpërmjet sakrificës së Krishtit. Të thuash që Jezusi nuk ishte tërësisht prej natyre njerëzore është, pra, të jesh i paditur ndaj vetë thelbit të lajmit të mirë të Krishtit.

Kurdo që besimtarët e pagëzuar mëkatojnë, ata mund të vijnë te Perëndia, duke rrefyer mëkatin e tyre në lutje përmes Krishtit (1 Gjon 1:9); Perëndia e di që Krishti u tundua të mëkatonte ashtu si ata, por që ai ishte i përkryer, duke mposhtur vetë atë tundim ku ata dështojnë. Për shkak të kësaj, "Perëndia për hatër të Krishtit" mund të na falë neve (Efe. 4:32). Prandaj është jetike të vlerësojmë se si krishti u tundua tamam si neve dhe nevojitej të kishte natyrën tonë që kjo të ishte e mundur. Heb. 2:14 e thotë qartë se Krishti kishte natyrë "mishi dhe gjaku" ta bënte këtë të mundur. "Perëndia është frymë" (Gjon 4:24) prej natyre dhe, edhe pse Ai ka një trup material, si "Frymë" Ai nuk ka mish dhe gjak. Krishti duke pasur natyrë "mishi" do të thotë se në asnjë mënyrë ai nuk pati natyrën e Perëndisë gjatë jetës së tij.

Përpjekjet e mëparshme për të mbajtur fjalën e Perëndisë, d.m.th. për të mposhtur tundimin tërësisht, të gjitha patën dështuar. Prandaj "Perëndia duke dërguar Birin e tij në shëmbëlltyrën e mishit mëkatar dhe me anë të sakrificës për mëkatin, e dënoi mëkatin në mish" (Rom. 8:3 A.V. mg.).

"Mëkati" i referohet afërisë natyrale drejt mëkatit që ne e kemi prej natyre. Ne i kemi hapur rrugë kësaj tashmë dhe vazhdojmë të bëjmë ashtu dhe "pagesa e mëkatit është vdekja". Për të dalë nga kjo grackë, njeriu nevojiste ndihmë nga jashtë. Ai vetë dukej i paaftë ndaj përkryerjes; nuk ishte dhe as është brenda mishit të shpëtojë mishin. Prandaj Perëndia ndërhyri dhe na dha Birin e Vet, që kishte "mishin mëkatar" tonin, me të gjitha shtysat për të mëkatar, që kemi neve. Në dallim nga çdo njeri tjetër, Krishti mposhti çdo tundim, edhe pse ai kishte mundësinë e dështimit dhe të mëkatimit po aq sa ne. Rom. 8:3 përshkruan natyrën njerëzore të Krishtit "mish mëkatar". Pak vargje përpara, Pali foli se si në mish "nuk banon asgjë e mirë", dhe se si mishi militon natyrshëm kundër bindjes ndaj Perëndisë (Rom. 7:18-23). Në këtë përmbajtje është edhe më e mrekullueshme të lexosh se Krishti kishte "mish mëkatar" në Rom. 8:3. Ishte për shkak të kësaj dhe mposhtjes prej tij të atij mishi, që ne kemi një mënyrë shpëtimi prej mishit tonë; Jezusi e dinte shumë mirë mëkatësinë e natyrës së tij. Atij iu drejtuan një herë si "mësues i mirë", me nëntekstin që ai ishte "i mirë" dhe i përkryer nga natyra. Ai u përgjigj: "Pse më quan të mirë? Asnjë nuk është i mirë përveç një të vetmi, domethënë Perëndisë" (Mark 10:17,18). Në një rast tjetër, njerëzit filluan të dëshmonin për madhësinë e Krishtit për mrekullitë e njëpasnjëshme që kishte bërë. Jezusi nuk përfitoi nga kjo "sepse ai i dinte të gjitha dhe nuk kishte nevojë që ndokush të jepte dëshmi për njeriun: sepse ai e dinte ç'kishte përbrenda njeriut" (Gjon 2:23-25, teksti grek). Për shkak të njohurisë së tij të madhe për natyrën njerëzore ("ai dinte të gjitha" për të),

Krishti nuk donte që njerëzit të lëvdonin atë vetë në të drejtën e tij, duke qenë se ai e dinte sa e keqe ishte natyra e tij njerëzore.

8.4 Natyra njerëzore e Jezusit

Shënimet e Ungjillit japin shumë shembuj se sa e plotë ishte natyra njerëzore e Jezusit. Është shënuar se ai ishte i lodhur, dhe i duhej të ulej të pinte ujë nga një burim (Gjon 4:6). "Jezusi qau" në vdekjen e L Lazarit (Gjon 11:35). Në mënyrën më supreme, shkrimi i vuajtjeve të tij të fundit duhet të jetë provë e mjaftueshme e natyrës së tij njerëzore: "Tani shpirti im është i tronditur", pranoi ai kur po lutej që Perëndia ta shpëtonte nga vdekja në kryq (Gjon 12:27). Ai "lutej duke thënë, O Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë (të vuajtjes dhe vdekjes); megjithatë jo si dua unë, po si do ti" (Mat. 26:39). Kjo tregon se në disa mënyra 'vullneti' ose dëshirat e Krishtit ishin të ndryshme nga ato të Perëndisë.

Gjatë gjithë jetës së tij Krishti ia kishte nënshtruar vullnetin e tij atij të Perëndisë në pregatitjen për këtë provë përfundimtare të kryqit: "Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime: gjykoj sipas asaj që dëgjoj: dhe gjykimi im është i drejtë; sepse nuk kërkoj vullnetin tim, por vullnetin e Atit që më ka dërguar" (Gjon 5:30). Ky ndryshim midis vullnetit të Krishtit dhe atij të Perëndisë është provë e mjaftueshme se Jezusi nuk ishte Perëndia.

Gjatë jetëve tona pritët që ne të rritemi në njohurinë tonë për Perëndinë, duke mësuar nga sprovat që kalojmë në jetë. Në këtë Jezusi ishte shembulli ynë i madh. Ai nuk kishte njohuri të plotë të Perëndisë të ndriçuar në të më tepër se ne. Që nga fëmijëria "Jezusi rritej në dituri dhe shtat (d.m.th. pjekuri në frymë, krah. Efe. 4:13), dhe në hir përpara Perëndisë dhe njerëzve" (Luka 2:52). "Fëmija rritej dhe forcohej në frymë" (Luka 2:40). Këto dy vargje e japin rritjen fizike të Krishtit në paralel me zhvillimin e tij në frymë: procesi i rritjes ndodhi në të si natyrisht ashtu edhe në frymë. Në qoftë se "Biri është Perëndia", siç thotë Besimi Athanasian lidhur me 'Trinitetin', kjo nuk do të kishte qenë e mundur. Edhe në fund të jetës së tij, Krishti pranoi që ai nuk e dinte kohën e saktë të ardhjes së tij të dytë edhe pse Ati e dinte (Mark 13:32).

Bindja ndaj vullnetit të Perëndisë është diçka që ne të gjithë na duhet ta mësojmë gjatë një periudhe kohe. Edhe Krishtit iu desh të kalonte përmes këtij procesi të të mësuarit të bindjes ndaj Atit të tij, siç i duhet çdo biri. "Edhe pse ishte Bir, mësoi të jetë i bindur (d.m.th. bindjen ndaj Perëndisë)

nga ato që pësoi; dhe si u *bë* i përkryer (d.m.th. i pjekur në frymë), u bë vepronjësi i shpëtimit të amshuar" si rezultat i rritjes së tij të plotë dhe tërësore në frymë (Heb. 5:8,9). Fil. 2:7,8 (mbi të cilën komentohet më tej në Degëzimin 27) shënon të njëjtin proces të rritjes në frymë të Jezusit, që arriti kulmin në vdekjen e tij në kryq. Ai "nuk i *dha* vetes lavdi, dhe mori *mbi vete* trajtën (sjelljen) e një shërbëtori...ai e *përfuli veten* dhe u *bë* i bindur deri... në vdekje të kryqit." Gjuha e përdorur këtu ilustron se si Jezusi me vetëdije vazhdoi gdhëndjen në zhvillimin e tij në frymë, duke e bërë vetveten gjithnjë e më të përlur, kështu më në fund "iu bind" dëshirës së Perëndisë që ai të vdiste në kryq. Kështu ai u "*bë* i përkryer" duke iu përgjigjur saktësisht vuajtjeve të tij.

Është evidente nga kjo që Jezusi duhej të bënte një përpjekje vetjake të ndërgjegjshme për të qenë i drejtë; në asnjë mënyrë u detyrua të ishte kështu nga Perëndia, që do të kishte rezultuar në bërjen e tij kukull të mirëfilltë. Jezusi vërtet na deshi, dhe dha jetën e tij në kryq prej këtij motivi. Theksimi i vazhdueshëm mbi dashurinë e Krishtit për ne do të ishte i zbrazët në qoftë se Perëndia e bëri atë të vdiste në kryq (Efe. 5:2,25; Zbu. 1:5; Gal. 2:20). Nëse Jezusi ishte Perëndia, atëherë ai nuk do të kishte patur rrugë tjetër përveç të ishte i përkryer dhe pastaj të vdiste në kryq. Që Jezusi i *pati* këto opsione, na bën ne të aftë të vlerësojmë dashurinë e tij dhe të ndërtojmë një marrëdhënie vetjake me të.

Ishte për shkak të gatishmërisë së Krishtit për të dhënë jetën e tij vullnetarisht, që Perëndia ishte kaq i gëzuar me të: "Prandaj Ati më do, sepse unë e lë jetën time... Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja" (Gjon 10:17,18). Perëndia, duke qenë kaq i kënaqur me bindjen e vullnetshme të Krishtit, është vështirë të kuptohet po të ishte Jezusi Perëndi, duke përjetuar një jetë në trajtë njerëzore si ndonjë lloj shoqërimi imitues me njeriun mëkatar (Mat. 3:17; 12:18; 17:5). Këto shënime të kënaqësisë së Atit në bindjen e Birit, janë provë e mjaftueshme që Krishti kishte mundësinë e mosbindjes, por me ndërgjegje zgjodhi të ishte i bindur.

NEVOJA E SHPËTIMIT TË KRISHTIT

Për shkak të natyrës së tij njerëzore, Jezusi kaloi sëmundje të lehta, lodhje, etj., ashtu si ne. Prandaj, si rrjedhim, në qoftë se nuk do të vdiste në kryq, ai do të kishte vdekur gjithsesi, p.sh. nga pleqëria. Nga kjo pikëpamje, Jezusi kishte nevojë të shpëtohej nga vdekja prej Perëndisë. Duke e ditur mirë këtë, Jezusi "i ofroi lutje dhe urata me klithma të larta dhe me lot atij (Perëndisë)

që mund ta shpëtonte nga vdekja dhe u dëgjua për shkak të frikës së tij (Heb. 5:7 A.V. mg.). Fakti që Krishtit iu desh t'i lutej Perëndisë ta shpëtonte nga vdekja përjashton çdo mundësi të të qënurit Perëndia vetë. Pas ringjalljes së Krishtit, vdekja nuk kishte " *më* pushtet mbi të" (Rom. 6:9), duke nënkuptuar që para saj kishte.

Shumë prej Psalmeve profetizojnë Jezusin; kur disa vargje nga një Psalm janë cituar për Krishtin në Dhjatën e Re, është e arsyeshme të nënkuptosh që shumë prej vargjeve të tjera janë gjithashtu për të. Ka një numër rastesh ku është theksuar nevoja e Krishtit për shpëtim nga Perëndia:-

- **Ps. 91:11,12** është cituar për Jezusin në Mat. 4:6. Ps. 91:16 profetizon se si Perëndia do t'i jepte Jezusit shpëtimin: "Me jetë të gjatë (d.m.th. jetë të përjetshme) do ta kënaq atë dhe do t'i tregoj shpëtimin tim."- Ps. 69:21 flet për kryqëzimin e Krishtit (Mat. 27:34); gjithë Psalmi përshkruan mendimet e Krishtit në kryq: "Më shpëto, O Perëndi...Afroju shpirtit tim dhe më shpëto...Shpëtimi yt, O Perëndi, më lartoftë" (vargjet 1,18,29).
- **Ps. 89** është një koment mbi premtimin e Perëndisë ndaj Davidit lidhur me Krishtin. Lidhur me Jezusin, Ps. 89:26 profetizon:"Ai do të kërkojë ndihmën time (të Perëndisë), Ti je ati im, Perëndia im, dhe kështjella ime e *shpëtimit*."

Lutjet e Krishtit për shpëtim drejtuar Perëndisë u dëgjuan; ai u dëgjua për shkak të ngritjes së tij në frymë, jo për shkak të vendit të tij në 'trinitet' (Heb. 5:7). Që *Perëndia* ringjalli Jezusin dhe e lavdëroi me pavdeksi është një temë kryesore e Dhjatës së Re:-

- "*Perëndia...e ka ringjallur Jezusin...Perëndia e lartësoi me të djathtën e vet dhe e bëri Princ dhe Shpëtimtar*" (Vep. 5:30,31).
- "*Perëndia...e ka përlëvduar Birin e tij Jezusin...që Perëndia e ka ringjallur prej së vdekuri*" (Vep. 3:13,15).
- "*Këtë Jezus Perëndia e ka ringjallur*" (Vep. 2:24,32,33).
- Jezusi vetë e dinte të gjithë këtë kur ai i kërkoi *Perëndisë* ta përlëvdonte atë (Gjon 17:5 krah. 13:32; 8:54).

Po të ishte Jezusi Perëndia Vetë, atëhere i gjithë ky theksim nuk do të kishte vend, duke parë që Perëndia nuk mund të vdesë. Jezusi nuk do të kishte

pasur nevojë për shpëtim po të ishte Perëndia. Fakti që ishte Perëndia ai që e lartoi Jezusin, tregon epërsinë e Perëndisë mbi të dhe veçantinë ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit. Në asnjë mënyrë Krishti nuk do të mund të ishte "Perëndia vetë dhe i përjetshëm (me) dy... natyra...i perëndishëm dhe i njerëzishëm", siç thotë artikulli i parë i 39 artikujve të Kishës së Anglisë. Nga vetë kuptimi i fjalës, një qenie mund të ketë vetëm një natyrë. Ne e paraqesim që faktet janë më se të mjaftueshëm që Krishti ishte prej natyrës sonë njerëzore.

8.5 Marrëdhënia e Perëndisë me Jezusin

Duke marrë parasysh se si Perëndia e ringjalli Jezusin, na bën të mendojmë mbi marrëdhënien ndërmjet Perëndisë dhe Jezusit. Në qoftë se ata janë "të bashkë-barabartë...të bashkë-përjetshëm", siç thotë doktrina e trinitetit, atëhere ne duhet të presim që marrëdhënia e tyre të jetë ajo e dy të barabartëve. Ne deri tani kemi parë plotë shembuj që nuk është ashtu. Marrëdhënia ndërmjet Perëndisë dhe Krishtit është e ngjashme me atë ndërmjet burrit e grua: "Koka e çdo burri është Krishti; dhe koka e gruas është burri; dhe koka e Krishtit është Perëndia" (1 Kor. 11:3). Siç është burri koka e gruas, ashtu edhe Perëndia është koka e Krishtit, megjithëse ata kanë të njëjtin unitet qëllimi siç duhet të egzistojë ndërmjet burrit e gruas. Kështu "Krishti është i Perëndisë" (1 Kor. 3:23), siç i përket gruaja burrit.

Perëndia Atë shpesh thuhet të jetë Perëndia e Krishtit. Fakti që Perëndia përshkruhet si "Perëndia dhe Ati i Zotit tonë Jezus Krisht" (1 Pje. 1:3; Efe. 1:17) edhe pas ngritjes së Krishtit në qiej, tregon se kjo është *tani* marrëdhënia e tyre, siç ishte gjatë jetës së vdekshme të Krishtit. Nganjëherë pretendohet nga trinitarianët se për Krishtin flitet si të jetë më pak se Perëndi vetëm gjatë jetës së tij në tokë. Letrat e Dhjatës së Re u shkruan disa vjet pas ngritjes së Krishtit në parajsë, megjithatë akoma për Perëndinë flitet si Perëndia dhe Ati i Krishtit. Jezusi akoma e trajton Atin si Perëndinë e tij.

Zbulesa, libri i fundit i Dhjatës së Re, u shkrua të paktën 30 vjet pas përlëvdimit dhe ngritjes së Krishtit, megjithatë flet për Perëndinë si "Perëndia dhe Ati i tij (Krishtit)" (Zbu. 1:6 R.V.). Në këtë libër, Krishti i ringjallur dhe i përlëvdur u dha mesazhe besimtarëve. Ai flet për "tempullin e Perëndisë sime... emrin e Perëndisë sime...qytetin e Perëndisë sime" (Zbu. 3:12). Kjo provon se Jezusi edhe tani mendon për të Atin si Perëndia e tij – dhe prandaj ai (Jezusi) nuk është Perëndia.

Gjatë jetës së tij të vdekshme, Jezusi iu drejtua Atit të tij në një mënyrë të ngjashme. Ai foli për ngritjen "tek Ati im, dhe Ati juaj; dhe te Perëndia im, dhe Perëndia juaj" (Gjon 20:17). Në kryq, Jezusi shfaqti deri në plotësi natyrën e tij njerëzore: "Perëndia im, Perëndia im, pse më ke braktisur?" (Mat. 27:46). Fjalë të tilla janë të pamundura për t'u kuptuar po të flitëshin nga Vetë Perëndia. Vetë fakti që Jezusi iu lut Perëndisë "me klithma të larta dhe me lotë" tregon në vetvete natyrën e vërtetë të marrdhënies së tyre (Heb. 5:7; Lluca 6:12). Perëndia sigurisht nuk mund t'i lutet Vetes. Edhe tani, Krishti i lutet Perëndisë nga ana jonë (Rom. 8:26,27 N.I.V. kra. 2 Kor. 3:18 R.V. mg.).

Ne tani kemi treguar që marrëdhënia e Krishtit me Perëndinë gjatë jetës së tij të vdekshme nuk ishte në thelb e ndryshme nga ç'është tani. Krishti iu drejtua Perëndisë si Ati i tij dhe Perëndia i tij dhe iu lut Atij; të njëjtin pozicion merr dhe tani, pas ringjalljes dhe ngritjes së Krishtit. Gjatë jetës së tij në tokë, Krishti ishte shërbëtor i Perëndisë (Vep. 3:13,26 N.I.V.; Is. 42:1; 53:11). Një shërbyes bën vullnetin e zotërisë së tij dhe nuk është i barabartë me të në asnjë mënyrë (Gjon 13:16). Krishti theksoi se fuqia dhe autoriteti që kishte ishte nga Perëndia, se sa nga e drejta e tij: "Unë s'mund të bëj asgjë nga vetja ime...unë kërkoj...vullnetin e Atit që më ka dërguar...Biri nuk mund të bëjë agjë prej vetvetes" (Gjon 5:30,19).

KAPITULLI 8: Pyetje

1. Mëson Bibla që Perëndia është një trinitet?
 - a) Po
 - b) Jo

2. Në cilat nga mënyrat e mëposhtme ishte Jezusi ndryshe prej nesh?
 - a) Ai nuk mëkatoi kurrë
 - b) Ai ishte biri i lindur i vetë Perëndisë
 - c) Ai nuk mund të ketë mëkatuar kurrë
 - d) Ai ishte i detyruar nga Perëndia të ishte i drejtë

3. Në cilat nga mënyrat e mëposhtme Jezusi ishte i ngjashëm me Perëndinë?
 - a) Ai kishte natyrën e Perëndisë në jetën e tij në tokë

- b) Ai kishte një karakter të përkryer si Perëndia
 - c) Ai dinte sa edhe Perëndia
 - d) Ai ishte drejtpërdrejt i barabartë me Perëndinë.
4. Në cilat nga mënyrat e mëposhtme ishte Jezusi si ne?
- a) Ai pati gjithë tundimet tona dhe përvojat njerëzore
 - b) Ai mëkatoi kur ishte fëmijë
 - c) Ai kishte nevojë për shpëtim
 - d) Ai kishte natyrë njerëzore
5. Cilat nga thëniet e mëposhtme janë të vërteta?
- a) Jezusi ishte i një natyrë dhe karakteri të përkryer
 - b) Jezusi ishte prej natyre mëkatore por karakteri të përkryer
 - c) Jezusi ishte edhe vetë Perëndia edhe vetë njeriu
 - d) Jezusi kishte natyrën e Adamit para se të mëkatonte

9.1 RËNDËSIA JETIKE E PAGËZIMIT

Disa herë në kapitujt e mëparshëm ne kemi përmendur rëndësinë jetike të pagëzimit; është hapi i parë i bindjes ndaj lajmit të Ungjillit. Heb. 6:2 flet për pagëzimin si një nga doktrinat më bazë. Ne e kemi lënë pa marrë parasysh deri tani, sepse pagëzimi i vërtetë mund të ndodhë vetëm pas një kuptimi të saktë të të vërtetave bazë, që përbëjnë Ungjillin. Ne tani e kemi përfunduar studimin e këtyre; në qoftë se ti dëshiron bëhesh vërtet i(e) shoqëruar me shpresën e madhe, që ofron bibla nëpërmjet Jezu Krishtit atëherë pagëzimi është një domosdoshmëri absolute.

"Shpëtimi është i Judenjve" (Gjon 4:22) në kuptimin që premtimet lidhur me shpëtimin iu bënë vetëm Abrahamit dhe farës së tij. Ne mund t'i kemi këto premtime të bëra ndaj nesh vetëm në qoftë se bëhemi *në* Farë, duke u pagëzuar *në* Krisht (Gal. 3:22-29).

Prandaj Jezusi i urdhëroi qartë pasuesit e tij: "Dilni në mbarë botën dhe i predikoni ungjillin (që përmbahet në premtimet ndaj Abrahamit - Gal. 3:8) çdo krijese. Ai që beson *dhe* është pagëzuar do të jetë i shpëtuar" (Mark 16:16). Pasqyrimi mbi këtë fjalën "dhe" zbulon se besimi vetëm në ungjillin nuk mund të na shpëtojë; pagëzimi nuk është thjesht një shtesë fakultative

në jetën Kristiane, është një parakërkesë jetike për shpëtimin. Kjo nuk është për të thënë që vetëm veprimi i pagëzimit do të na shpëtojë; duhet të ndiqet nga një bindje jetësore e vazhdueshme ndaj Fjalës së Perëndisë. Jezusi theksoi këtë: "Në të vërtetë, në të vërtetë, po të them se kush nuk ka lindur nga uji dhe nga fryma, nuk mund të hyjë në Mbretërinë e Perëndisë" (Gjon 3:5).

Kjo lindje "e (Greqisht 'nga') ujit" e ka fjalën për një person që del nga ujërat e pagëzimit; pas kësaj, ai duhet të lindë përsëri në frymë. Ky është një proces i vazhdueshëm: "Jeni ringjizur...me anë të Fjalës së Perëndisë" (1 Pjetër 1:23). Pra, është nëpërmjet përgjigjes sonë të vazhdueshme ndaj Fjalës së Frymës, që ne lindemi në frymë (shih Kapitullin 2.2).

Ne jemi "pagëzuar në Krisht" (Gal. 3:27), në emrin e tij (Vep. 19:5; 8:16; Mat. 28:19). Vini re që ne jemi pagëzuar në *Krishtin* – jo në Kristadelfianët ose ndonjë organizatë tjetër njerëzish. Pa pagëzimin ne nuk jemi "në Krisht" dhe prandaj, të pashpëtuar nga vepra e tij shpëtuese (Vep. 4:12). Pjetri thur një shëmbëlltysë të fuqishme rreth këtij fakti: ai vë në ngjashmëri arkën në kohën e Noes me Krishtin, duke treguar se ashtu si arka shpëtoi Noen dhe familjen e tij nga gjykimi që erdhi midis mëkatarëve, ashtu edhe pagëzimi në Krishtin do të shpëtojë besuesit nga vdekja e përrjetshme (1 Pjetër 3:21). Noeu duke hyrë në arkë është si ne duke hyrë në Krishtin nëpërmjet pagëzimit. Të gjithë ata jashtë arkës u shkatërruan nga përmytja; qendrimi pranë arkës ose të qënurit mik i Noeut ishte pa lidhje. E vetmja mënyrë shpëtimi është dhe ishte të jesh brenda Krishtit/arkës. Është evidente që ardhja e dytë, që e tipizon përmytja (Lluka 17:26,27), është pothuajse mbi ne. Prandaj hyrja në Krishtin/arkën me anë të pagëzimit është një urgjencë sipërore. Fjalët njerëzore vërtetë nuk arrijnë ta bëjnë të qartë këtë ndjesi të urgjencës; lloji Biblik i hyrjes në arkë në kohën e Noeut është më i fuqishëm.

Kristianët e hershëm iu bindën urdhërimit të Krishtit për të udhëtuar në mbarë botën që të përhapnin Ungjillin dhe të pagëzonin; libri i Veprave është dokumenti i kësaj. Një provë e rëndësishme jetike të pagëzimit gjendet në mënyrën se si ky dokumentim thekson sa *menjëherë* njerëzit u pagëzuan pasi pranuan Ungjillin (p.sh. Vep. 8:12, 36-39; 9:18; 10:47; 16:15). Ky theksim është i kuptueshëm sapo të vlerësohet që pa pagëzim mësimi ynë i Ungjillit është i kotë; pagëzimi është një fazë jetësisht e nevojshme për t'u kaluar në rrugën për shpëtim. Në disa raste shënimi i frymëzuar duket se thekson se, megjithë shumë arsye njerëzore për të vonuar pagëzimin dhe shumë vështirësi në kryerjen e veprimit, është aq e rëndësishme saqë

njerëzit bënë çdo përpjekje për të mposhtur të gjitha këto me ndihmën e Zotit.

Rojtari i burgut në Filipi ngeci papritur në krizën e jetës së tij nga një tërmet masiv, që shpërtheu tërësisht burgun e tij të një sigurie të lartë. Të burgosurit patën rast me bollëk të arratiseshin – diçka që do t'i kishte kushtuar jetën. Besimi i tij në Ungjillin atëhere u bë i vërtetë, kaq shumë sa që "në të njëjtën orë të natës (ai) u pagëzua...menjëherë" (Vep. 16:33). Në kishte njeri me arsye për të vonuar pagëzimin, ai ishte. Tërmeti më i keq në Greqi në 3,000 vjet, një turmë të burgosurish të eksituar në prag të shënimit në histori të arratisjes më dramatike nga burgu, dhe kërcënimi i egzekutimit për neglizhencë të detyrës së tij që i rrinin mbi kokë, megjithatë ai pa qartësisht cili ishte i vetmi veprim më i rëndësishëm për t'u përmbushur në tërë jetën e tij dhe paracaktimin e përjetshëm. Kështu ai mbikaloi problemet e atypëratyshme të botës së tij rrethuese (d.m.th tërmetin), presionet e punësimit të tij ditor dhe tronditjen intensive në të cilën ndodhej – për t'u pagëzuar. Shumë prej kandidatëve hezitues për pagëzimin mund të marrin frymëzim të vërtetë nga ky burrë. Që ai mundi të bënte një veprim besimi të tillë është provë e mjaftueshme që ai tashmë kishte një dituri të hollësishme të ungjillit, duke qenë se besim i tillë i vërtetë vjen vetëm nga dëgjimi i Fjalës së Perëndisë (Rom. 10:17 kra. Vep. 17:11).

Vep. 8:26-40 shënon se si një zyrtar Etiopas po studionte Biblën e tij ndërsa udhëtonte në karrocë përmes shkretëtirës. Ai takoi Filipin, që ia shpjegoi Ungjillin gjerësisht, duke përfshirë kërkesën e pagëzimit. Po të flisnim prej njeriu, duhet të jetë dukur e pamundur t'i bindesh urdhërimit për t'u pagëzuar në atë shkretëtirë pa ujë. Megjithatë Perëndia nuk do të jepte urdhërime që e dinte se disa njerëz nuk mund t'u binden. "Ndërsa po vazhdonin rrugën, arritën në një vend me ujë", d.m.th një oaz, ku pagëzimi ishte i mundshëm (Vep. 8:36). Kjo ngjarje i përgjigjet sugjerimit pa baza që pagëzimi me zhytje ishte caktuar të bëhej vetëm në zona ku uji ishte me bollëk dhe lehtësisht i arritshëm. Perëndia gjithmonë do të japë një mundësi të vërtetë në të cilën t'u bindemi urdhërimeve të Tij

Apostullit Pal iu dha një pamje dramatike nga Krishti, e cila aq shumë ia çpoi ndërgjegjen sa që sapo u bë e mundur ai "menjëherë...u ngrit dhe u pagëzua" (Vep. 9:18). Përsëri duhet të ketë qenë tunduese për të të vononte pagëzimin e tij, duke menduar pozitën e tij shoqërore në ngritje dhe karrierën e lartë të caktuar për të në Judizëm. Por ky yll në ngritje i botës së Judenjve mori vendimin e drejtë dhe të menjëhershëm për t'u pagëzuar dhe dha dorëheqje të hapur nga mënyra e tij e mëparshme e të jetuarit. Më vonë

ai komentoi në lidhje me vendimin e tij për t'u pagëzuar: "Gjërat që më ishin fitim, i konsiderova humbje për shkak të Krishtit...i humba të gjitha këto (d.m.th gjërat që njëherë i pa si "fitim"), dhe i konsideroj si pleh, që unë të fitoj Krishtin...duke harruar ato që kam lënë pas ("gjërat" e jetës së tij të mëparshme prej Jude), dhe duke u prirur drejt gjërave që janë përpara, po rend drejt shenjës për çmimin" (Fil. 3:7,8,13,14).

Kjo është gjuha e një atleti duke u tërhequr përpara për të arritur shiritin e fundit. Përqendrim i tillë i stërmundimit fizik dhe mendor duhet të karakterizojë jetët tona pas pagëzimit. Duhet të kuptohet që pagëzimi është fillimi i një gare drejt Mbretërisë së Perëndisë; nuk është thjesht një simbol i ndryshimit të kishës ose besimit, as një hyrje pasive në një jetë të rehatshme të përkushtimit të lehtë ndaj disa parimeve Kristiane të thënë turbull. Pagëzimi na shoqëron në një ndjesi të vazhdueshme me kryqëzimin dhe ringjalljen e Jezusit (Rom. 6:3-5) – raste plot dinamizëm vendimtar në çdo mënyrë.

Si një plak i lodhur triumfues në frymë, Pali mundi të kujtonte: "unë nuk isha i pabindur ndaj vegimit qiellor" (Vep. 26:19). Siç ishte e vërtetë për Palin po ashtu është për të gjithë që janë pagëzuar si duhet: pagëzimi është një vendim për të cilin nuk bëhesh kurrë pishman. Gjithë jetën tonë ne do ta dimë që morëm vendimin e duhur. Ka vetëm pak vendime njerëzore për të cilat ne mund të jemi kaq të sigurtë. I duhet përgjigjur seriozisht pyetjes: 'Pse të mos pagëzohem?'

9.2 SI DUHET TË PAGËZOHEMI?

Ka një pikëpamje të përhapur që pagëzimi mund të përmbushet veçanërisht në bebë, duke u spërkatur ujë në ballë (d.m.th 'duke i Krishtëzuar). Kjo është në kontrast të zbatët me kërkesën biblike të pagëzimit.

Fjala greke 'baptizo', e cila është përkthyer 'pagëzoi' në biblën anglisht, *nuk* do të thotë spërkatur; do të thotë të lahesh tërësisht dhe të zhytesh në lëng (shih përkufizimet në përkatëset e Robert Young dhe James Strong). Kjo fjalë është përdorur në klasiken greke lidhur me anijet që mbyteshin dhe 'pagëzoheshin' (d.m.th fundoseshin) në ujë. Gjithashtu përdoret lidhur me një copë rrobe që ngjyroset duke e 'pagëzuar' ose zhytur në bojë. Për të ndryshuar ngjyrën e copës, është evidente që duhet të zhytej tërësisht nën

lëng, në vend që ta spërkatësh me bojë mbi të. Që zhytja është në të vërtetë mënyra e duhur e pagëzimit, mbartet prej këtyre vargjeve:-

- "Edhe Gjoni pagëzonte në Enon afër Salimit, sepse aty kishte shumë ujë: dhe ata vinin dhe pagëzoheshin" (Gjon 3:23). Kjo tregon se kërkohej "shumë ujë" për pagëzimin; po të bëhej duke spërkatur ca pika uji, atëhere vetëm një kovë uji do të kishte mjaftuar për qindra njerëz. Njerëzit erdhën në këtë vend në breg të lumit Jordan për pagëzim, në vend që të shkonte Gjoni tek ata me nganjë shishe uji.
- Edhe Jezusi, u pagëzua nga Gjoni në lumin Jordan: "Jezusi, sapo u pagëzua, doli nga uji" (Mat. 3:13-16). Pagëzimi i tij ishte qartësisht me zhytje - ai "doli...nga uji" pas pagëzimit. Një nga arsytet që Jezusi u pagëzua ishte me qëllim që të vendoste shembullin që asnjë të mos mund të pretendonte seriozisht se ndiqte Jezusin, pa ndjekur shembullin e tij të pagëzimit me zhytje.
- Në mënyrë të ngjashme, Filipi dhe eunuku Etiopas "të dy, zbritën në ujë ... dhe ai e pagëzoi atë. Kur dolën nga uji..." (Vep. 8:38,39). Mbani mend që eunuku kërkoi të pagëzohej kur pa oazin: "Ja, uji: çfarë më pengon të pagëzohem?" (Vep. 8:36). Është pothuajse e sigurt që njeriu nuk do të kishte ndërmarrë një udhëtim shkretëtire pa të paktën ca ujë me vete, p.sh. në një shishe. Sikur pagëzimi të bëhej me spërkatje, mund të ishte bërë, pra, pa nevojën e oazit.
- Pagëzimi është një varrosje (Kol. 2:12), që nënkupton një mbulim tërësor.
- Pagëzimi është quajtur një 'larje' e mëkateve (Vep. 22:16). Qëllimi i shndrrimit të vërtetë krahasohet me një 'larje' në Rev. 1:5; Titus 3:5; 2 Pjetër 2:22; Heb. 10:22 etj. Kjo gjuhë e larjes ka shumë më tepër lidhje me pagëzimin nëpërmjet zhytjes sesa me spërkatjen.

Ka disa tregime të Dhjatës së Vjetër që afrimi i pranueshëm te Perëndia bëhej nëpërmjet ndonjë lloj larjeje.

Prifti duhej të lahej tërësisht në një vaskë që quhej 'laver' para se t'i afroreshin Perëndisë në shërbim (Lev. 8:6; Eks. 40:32). Izraelitët duhej të

laheshin me qëllim që të pastronin veten e tyre nga papastërti të caktuara (p.sh. LiP. 23:11), të cilat ishin përfaqësues të mëkatit.

Një burrë, që quhej Naaman ishte një leproz pagan, që kërkoi të shërohej nga Perëndia e Izraelit. Si i tillë, ai përfaqëson njeriun e qëlluar nga mëkati, efektivisht duke përjetuar një vdekje të gjallë në sajë të mëkatit. Kurimi i tij ishte me anë të zhytjes në lumin e Jordanit. Si fillim ai e kishte të vështirë të pranonte këtë akt të thjeshtë, duke menduar se Perëndia do t'i kërkonte të bënte ndonjë akt dramatik, ose të zhyste veten në ndonjë lum të famshëm të madh, p.sh. Abana. Në ngjashmëri, neve mund të na duket e vështirë të besojmë që një akt kaq i thjeshtë mund të sjellë shpëtimin tonë përfundimisht. Është më joshëse të mendosh që veprat tona dhe shoqërimi publik me një kishë të madhe të famshme (krah. lumi Abana) mund të na shpëtojë, sesa ky akt i thjeshtë shoqërimi me shpresën e vërtetë të Izraelit. Pas zhytjes në Jordan, mishi i Naamanit "u bë përsëri si mishi i një fëmije të vogël dhe ai u pastrua" (2 Mbr. 5:9-14).

Tani duhet të ketë shumë pak vend për të dyshuar që 'pagëzimi' e ka fjalën për zhytje të plotë në ujë pas kuptimit së pari të lajmit bazë të ungjillit. Ky përcaktim i bazuar në Bibël i pagëzimit nuk thotë gjë për gjendjen e personit që bën në fakt pagëzimin fizikisht. Pagëzimi, duke qenë një zhytje në ujë pas besimit të ungjillit, është teorikisht e mundshme të pagëzosh veten. Megjithatë, meqenëse pagëzimi është vetëm pagëzim me anë të arsyes së doktrinës së duhur që dikush mban në kohën e zhytjes, është patjetër e këshillueshme të pagëzohesh nga një besimtar tjetër i doktrinave të vërteta, i cili, para së gjithash, mund të vlerësojë shkallën e njohurisë që ka dikush para se ta zhytë atë.

Prandaj egziston një traditë midis Kristadelfianëve të një diskutimi në thellësi me çdo kandidat për pagëzim përpara zhytjes vetë. Një listë pyetjesh si ato në fund të çdo kapitulli në këtë libër mund të përbëjnë bazat për një diskutim të tillë. Kristadelfianët kanë udhëtuar mijëra milje për të ndihmuar vetëm një person të pagëzohet; e tillë është mrekullia e ardhjes së një personi të vetëm në shpresën e vërtetë të jetës së përjetshme, saqë ne nuk jemi të shqetësuar kryesisht për numrin e shndrrimeve. Cilësia para sasisë është çelësi i përpjekjes sonë.

9.3 KUPTIMI I PAGËZIMIT

Një nga arsyet për pagëzim me anë të zhytjes është se duke u futur nën ujë simbolizon shkuarjen tonë në varr- duke na shoqëruar me vdekjen e Krishtit dhe duke i treguar 'vdekjen' tonë jetës sonë të mëparshme të mëkatit dhe padijes. Dalja nga uji na lidh me ringjalljen e Krishtit dhe me shpresën e ringjalljes në jetë të përjetshme në kthimin e tij, si edhe me përjetimin e një jete të re tani, në frymë fitimtare mbi mëkatin në sajë të fitores së Krishtit arritur nga vdekja dhe ringjallja e tij.

"Kaq shumë prej nesh që u pagëzuam në Jezu Krishtin, u pagëzuam në vdekjen e tij. Ne pra u varrosëm në të me anë të pagëzimit në vdekje: që, ashtu si Krishti u ngjall prej së vdekurish me anë të lavdisë së Atit, kështu edhe ne gjithashtu të ecim (d.m.th jetojmë dita ditës) në risinë e jetës. Sepse nëse u mbollëm së bashku në ngjashmërinë e vdekjes së tij (me anë të pagëzimit), do të jemi edhe në ngjashmërinë e ringjalljes së tij" (Rom. 6:3-5).

Sepse shpëtimi është bërë i mundshëm nëpërmjet vdekjes dhe ringjalljes së Krishtit, është jetike që ne të shoqërojmë veten tonë me këto gjëra, nëse duam të shpëtohem. Vdekja dhe ringjallja simbolike me Krishtin, që jep pagëzimi, është e vetmja mënyrë për ta bërë këtë. Duhet theksuar se spërkatja nuk e përmbush këtë simbol. Në pagëzim, "njeriu ynë i vjetër (mënyra e jetesës) është kryqëzuar" bashkë me Krishtin në kryq (Rom. 6:6); Perëndia "na dha jetë me Krishtin" në pagëzim (Efe. 2:5). Megjithatë ne akoma kemi natyrë njerëzore pas pagëzimit dhe, prandaj, mënyra mishtore e jetës do të vazhdojë të ngrejë kokë. 'Kryqëzimi' i mishit tonë është, pra, një proces në vazhdim, që vetëm *fillon* të pagëzimi, ndërsa Jezusi u tha besuesve të marrin çdo ditë kryqin e tij dhe të ndjekin atë, siç u bë në marshimin drejt Kalvarisë (Lluka 9:23;14:27). Ndërsa një jetë e kryqëzimit të vërtetë me Krishtin nuk është e lehtë, ka një ngushëllim dhe gëzim të patregueshëm duke u bashkuar, po ashtu, me ringjalljen e Krishtit

Krishti solli "paqe nëpërmjet gjakut të kryqit të tij" (Kol. 1:20) - "paqen e Perëndisë që ia tejkalon çdo zgjuarsie" (Fil. 4:7). Lidhur me këtë, Jezusi premtoi, "unë po ju lë paqen, po ju jap paqen time: unë po jua jap, po jo si e jep bota (paqen)" (Gjon 14:27). Kjo paqe dhe gëzimi i vërtetë në frymë e tejpeshon dhimbjen dhe vështirësinë e shoqërimit të hapur të vetes sonë me Krishtin e kryqëzuar: "Sepse ashtu si ndër ne teprojnë vuajtjet e Krishtit, po ashtu, nëpërmjet Krishtit, tepron edhe ngushëllimi ynë" (2 Kor. 1:5).

Ka edhe liri, e cila vjen prej njohjes se vetja jonë natyrore në të vërtetë vdiq dhe, prandaj, Jezusi jeton me ne shumë aktivisht përmes çdo sprove tonën. Apostulli i madh Pal mund të fliste nga përvoja e shumë të me këtë gjatë gjithë viteve plot ngjarje të jetës së tij: "Unë u kryqëzova bashkë me Krishtin, megjithatë unë jetoj; prapë, jo unë, po Krishti jeton në mua: dhe jeta që jetoj tani në mish, e jetoj në besimin e Birit të Perëndisë" (Gal. 2:20).

"Pagëzimi tani na shpëton edhe ne me anë të ringjalljes së Jezu Krishtit" (1 Pjetër 3:21) sepse shoqërimi ynë me ringjalljen e Krishtit në jetë të përjetshme na jep njësoj hyrjen në kthimin e tij. Vetëm nëpërmjet marrjes pjesë në këtë ringjallje atëhere, ne do të shpëtohem në fund. Jezusi e tha këtë në terma shumë të thjeshtë: "Sepse unë jetoj, do të jetoni edhe ju" (Gjon 14:19). Pali gjithashtu: "Ne u pajtuam me Perëndinë me anë të vdekjes së Birit të tij...ne do të shpëtohem nga jeta e tij" (ringjallja; Rom. 5:10).

Përsëri është theksuar se duke shoqëruar veten tonë me vdekjen dhe vuajtjet e Krishtit në pagëzim, dhe mënyrën pasuese të jetesës, ne sigurisht që do të kemi pjesë në ringjalljen e tij të lavdishme:

- "Nëse ne vdiqëm me të (Krishtin), me të edhe do të rrojmë; në qoftë se vuajmë, do të mbretërojmë bashkë me të" (2 Tim. 2:11,12).
- "Kurdo ne e mbajmë në trupin tonë vdekjen e Zotit Jezus, që edhe jeta e Jezusit të shfaqet në trupin tonë...duke ditur se ai që ringjalli Zotin Jezus do të na ringjallë edhe ne nëpërmjet Jezusit" (2 Kor. 4:10,11,14).
- Pali e ndau "pjesmarrjen në mundimet e tij (Krishtit), duke u bërë (nëpërmjet përvojës së rëndë të jetës së tij) i ngjashëm me të në vdekjen e tij; që në ndonjë mënyrë të mund t'ia arrij ringjalljes në jetë të përjetshme siç u provua nga Krishti" (Fil. 3.10,11 kra. Gal 6:14)

9.4 PAGËZIMI DHE SHPËTIMI

Pagëzimi, duke na shoqëruar me vdekjen e Krishtit, do të thotë që vetëm nëpërmjet pagëzimit ne mund të kemi hyrje për te falja. Ne "varrosemi me (Krishtin) në pagëzim, ju edhe u ringjallët bashkë në të... veprimet të Perëndisë, që e ka ringjallur atë prej së vdekurish. Dhe ju, që kishit vdekur në mëkate...bashkë me të ju dha jetë juve, duke jua falur të gjitha mëkatet" (Kol. 2:12,13). Ne jemi "larë... në emër të Zotit Jezus" (1 Kor. 6:11) - d.m.th

pagëzimi në emrin e Jezusit është mënyra me anë të së cilës mëkatet tona janë larë. Kjo ishte bërë tipike tek Num. 19:13, ku ata pa ujin e pastrimit duhej të vdisnin. Ne treguam në kapitullin 10.2 se si pagëzimi është një larje e mëkateve (krah. Vep. 22:16). Përshkrimet e besimtarëve si të larë prej mëkateve të tyre në gjakun e Krishtit, pra, e kanë fjalën që ata e bënë këtë për qëllim pagëzimi (Rev. 1:5; 7:14; Titus 3:5. [N.I.V.] (Varianti i Ri Ndërkombëtar) flet për këtë si "larja e rilindjes", duke kuptuar "lindur prej ujit" në pagëzim [Gjon 3:5]).

Nën dritën e gjithë kësaj, është e kuptueshme që përgjigja e Pjetrit ndaj pyetjes, "çfarë do të bëjmë?" (për t'u shpëtuar) ishte, "Pendohuni dhe pagëzohuni secili nga ju në emër të Jezu Krishtit *për* faljen e mëkateve" (Vep. 2:37,38). Pagëzimi në emrin e Krishtit është *për* faljen e mëkateve; pa të nuk mund të ketë falje mëkatesh dhe prandaj të papagëzuarve duhet t'u jepet pagesa e mëkatit - vdekja (Rom. 6:23). Nuk ka shpëtim përveç se në emër të Jezusit (Vep. 4:12) dhe ne mund të kemi pjesë në atë emër vetëm duke u pagëzuar në të. Ky fakt do të thotë se fetë jo kristiane në asnjë mënyrë nuk mund të udhëheqin në shpëtim. Asnjë besimtar i vërtetë Bible nuk mund ta pranojë që ata udhëheqin në shpëtim; fakti që katolicizmi dhe lëvizjet e tjera më të gjera në mbarë botën e pranojnë këtë, është një pasqyrim i trishtueshëm mbi sjelljen e tyre ndaj Shkrimit të Shenjtë.

Ringjallja e Krishtit në jetë të përjetshme ishte një shenjë e fitores së tij mbi mëkatin. Me anë të pagëzimit ne shoqërojmë veten me këtë dhe, prandaj, për ne flitet si të jemi ringjallur bashkë me Krishtin, mëkati nuk ka më fuqi mbi ne, siç nuk pati më mbi të. Nëpërmjet pagëzimit ne, pra "u bëmë të lirë prej mëkatit...mëkati nuk do të ketë pushtet mbi ju" pas pagëzimit (Rom. 6:18,14). Megjithatë, pas pagëzimit ne prapë mëkatojmë (1 Gjon 1:8,9); mëkati është prapë i aftë të na skllavërojë nëse largohemi nga Krishti. Prandaj ne tani po ndjamë vdekjen dhe vuajtjet e Krishtit, megjithëse pagëzimi demonstroi se si ne jemi gjithashtu të shoqëruar me ringjalljen e Krishtit, që shpresojmë të kemi pjesë në kthimin e tij.

Vetëm në perspektivë jemi të lirë nga mëkati. "Ai që beson dhe është i pagëzuar *do të shpëtohet*" (Mark 16:16) në ardhjen e dytë të Krishtit. Shpëtimi përfundimtar nuk ndodh menjëherë pas pagëzimit, por në ditën e gjykimit (1 Kor. 3:15). Në fakt, nuk ka nevojë për doktrinën e gjykimit, po të marrim shpëtimin në pagëzim, dhe as do të na duhet të vdesim. "Ai që duron deri në fund *do të shpëtohet*" (Mat. 10:22).

Edhe pas pagëzimit të tij, Pali (dhe gjithë Kristianët) iu desh të përpiqej drejt shpëtimit (Fil. 3:10-13; 1 Kor. 9:27); ai foli për shpresën e jetës së përjetshme (Titus 1:2; 3:7; 1 Thes. 5:8; Rom. 8:24) dhe për të qënurit tonë "trashëgimtarë të shpëtimit" (Heb. 1:14). Në ditën e gjykimit, i drejti do hyjë në jetën e përjetshme (Mat. 25:46). Llogjika e mrekullueshme e frymëzuar e Palit shkëlqen përmes Rom. 13:11 – ai arsyeton se pas pagëzimit ne mund të dimë që çdo ditë që jetojmë dhe durojmë është një ditë më afër ardhjes së dytë të Krishtit, që ne ta gëzojmë atë "tani shpëtimi ynë është më afër se kur besuam". Prandaj shpëtimi ynë tani nuk zotërohet. Shpëtimi është i kushtëzuar; ne do të shpëtohem *nëse* mbajmë të patundur besimin e vërtetë (Heb. 3:12-14), *nëse* ne mbajmë mend doktrinën bazë që përbën Ungjillin (1 Tim. 4:16; 1 Kor. 15:1,2), dhe *nëse* bëjmë ato gjëra që janë në mbajtjen e një shprese kaq të madhe (2 Pjetër 1:10).

Prandaj folja greke e përkthyer "i shpëtuar" përdoret nganjëherë në kohën e tashme, duke treguar se shpëtimi është një proces në vazhdim që po ndodh brenda nesh nëpërmjet bindjes sonë të vazhdueshme ndaj ungjillit. Kështu, për besimtarët flitet si "të *jenë* shpëtuar" nga përgjigja e tyre ndaj Ungjillit (1Kor. 1:18 R.S.V.; shembuj të tjerë të kësaj teme të vazhdueshme janë në Vep. 2:47 dhe 2 Kor. 2:15). Kjo fjalë greke për "i shpëtuar" përdoret në kohën e shkuar vetëm lidhur me shpëtimin e madh, që Krishti e bëri të mundur në kryq dhe me të cilin ne mund ta shoqërojmë veten nëpërmjet pagëzimit (2 Tim. 1:9; Titit 3:5).

Kjo e tëra është shëmbëllyer me marrëdhënien e Perëndisë me Izraelin natyral, që formon bazat për marrëdhënien e Tij me Izraelin në frymë, d.m.th. besimtarët. Izraeli iku nga Egjypti, duke përfaqësuar botën e mishit dhe fetë e rreme, me të cilat shoqëroheshim ne para pagëzimit. Ata kaluan përmes Detit të Kuq dhe pastaj udhëtuan nëpër shkretëtirën e Sinait për në tokën e premtuar, ku u vendosën krejtësisht si Mbretëria e Perëndisë. Kalimi i Detit të Kuq është tipik i pagëzimit tonë (1Kor. 10:1,2); udhëtimi në shkretëtirë i jetës sonë të tanishme dhe Kanani i Mbretërisë së Perëndisë. Juda v. 5 përshkruan sa prej tyre u shkatërruan gjatë udhëtimit në shkretëtirë: "Zoti, pasi e shpëtoi popullin e tij nga vendi i Egjyptit, pastaj i shkatërroi ata që nuk besuan". Izraeli, pra, "u shpëtua" nga Egjypti siç janë "shpëtuar" prej mëkatit të gjithë ata që janë pagëzuar. Po të ishte pyetur ndonjë nga ata izraelitë, "je i shpëtuar?" përgjigja e tyre mund të kishte qenë, "Po", po kjo nuk do të thoshte që ata do të shpëtoheshin përfundimisht.

Në të njëjtën mënyrë që Izraeli u kthye prapë te Egypiti në zemrat e tyre (Vep. 7:39) dhe iu kthyen një jete të kënaqsive të mishit dhe doktrinave të rreme, ashtu edhe ata që janë “shpëtuar” prej mëkatit me anë të pagëzimit mund të bjenë në të njëjtën mënyrë nga pozita e bekuar ku qendrojnë. Mundësia që ne të bëjmë siç bëri Izraeli natyral në shkretëtirë është theksuar në 1 Kor. 10:1-12, Heb. 4:1,2 dhe Rom. 11:17-21. Ka shembuj të shumtë në Shkrim të atyre që u “shpëtuan” një herë nga mëkati me pagëzim, duke rënë më vonë në një pozitë që do të thoshte që do të dënoheshin në kthimin e Krishtit (p.sh. Heb. 3:12-14; 6:4-6; 10:20-29). Doktrina e ‘po u shpëtove një herë je shpëtuar për gjithnjë’ e predikuesve ‘evangelistë’ të zellshëm është zbuluar për atë që është nga pjesë të tilla – komplet sofizma mish-kënaqëse.

Si me gjithçka, nevojitet një ndjesi e saktë drejtpeshimi në kërkimin për të zbuluar deri në çfarë pike jemi “shpëtuar” me pagëzimin. Akti nuk duhet parë sikur na jep *shansin* e shpëtimit – një mundësi më mirë e tij sesa pa pagëzimin. Duke u bërë “në Krishtin” me pagëzim, ne jemi shpëtuar në perspektivë; ne vërtetë kemi një shpresë të sigurtë të të qenit në Mbretërinë e Perëndisë, nëse vazhdojmë të mbahemi në Krishtin siç jemi kur ngrihemi nga ujërat e pagëzimit. Në çdo kohë pas pagëzimit tonë ne duhet të jemi në gjendje të kemi besim të përlurur që ne me siguri do të pranojmë në Mbretërinë me kthimin e Krishtit. Ne nuk mund të jemi përfundimisht të sigurtë, sepse ne mund të rrëzohemi ditën tjetër; ne nuk e dimë të ardhmen tonë në frymë në këtë jetë.

Ne duhet të bëjmë ç’është e mundur për të ruajtur ndërgjegjen e mirë, të cilën e kemi me Perëndinë në pagëzim. Pagëzimi është "premtimi i një ndërgjegjeje të mirë" (1 Pje. 3:21, greqisht); kandidati i pagëzimit jep fjalën (premtion) të mbajë atë ndërgjegje të pastër me Perëndinë.

Ndërsa pagëzimi është i një rëndësie jetike për të na dhënë hyrje për në shpëtimin e madh, i cili është i mundshëm në Krisht, ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos japim përshtypjen që nga një veprim ose “vepër” e vetme e pagëzimit, ne do të shpëtohem. Ne kemi treguar më parë se sa e nevojshme është një jetë e shoqërimit të vazhdueshëm me kryqëzimin e Krishtit: “Kush nuk ka lindur nga uji dhe Fryma, nuk mund të hyjë në Mbretërinë e Perëndisë” (Gjon 3:5). Një krahasim i kësaj me 1 Pjetër 1:23 tregon se lindja në Frymë, që ndodh pas pagëzimit, duhet ta ketë fjalën për rigjenerimin tonë gradual me anë të Frymës/Fjalës. Shpëtimi nuk është vetëm në sajë të pagëzimit: është rezultat i mëshirës (Efe. 2:8), besimit (Rom. 1:5) dhe shpresës (Rom. 8:24), ndërmjet gjërave të tjera. Nganjëherë dëgjohet bindja se shpëtimi është vetëm me besim dhe, prandaj, një “vepër”

si pagëzimi s'ka lidhje. Megjithatë, Jakobi 2:17-24 e bën të qartë që arsyetim i tillë bën një dallim të rremë ndërmjet besimit dhe veprave; besimi i vërtetë, p.sh. në Ungjillin, është demonstruar të jetë besim i mirëfilltë me anë të veprave, të cilat rezultojnë në, p.sh. pagëzimin. "Njeriu shfaqsohet nga veprat dhe jo vetëm nga besimi" (Jakob 2:24). Në disa raste të pagëzimit, besimtari pyeti çfarë duhej të "bënte" që të shpëtohej; përgjigja gjithmonë përfshinte pagëzimin (Vep. 2:37; 9:6; 10:6; 16:30). 'Bërja' e 'veprës' së pagëzimit është, pra, një tregim i nevojshëm i besimit tonë të Ungjillit të shpëtimit. Vepra e shpëtimit tonë ka qenë bërë përfundimisht nga Perëndia dhe Krishti, por ne duhet të bëjmë "vepra të denja pendimi" dhe besimi të kësaj (Vep.26:20 kra. Mark 16:15,16).

Ne kemi treguar më parë se gjuha e të larit të mëkateve e ka fjalën për faljen e Perëndisë në sajë të pagëzimit tonë në Krishtin. Në disa pjesë për neve flitet se i lajmë mëkatet tona nëpërmjet besimit dhe pendimit (Vep. 22:16; Zbu. 7:14; Jer. 4:14; Is. 1:16); në të tjera, Perëndia shihet si ai që lan mëkatet tona (Eze. 16:9; Ps. 51:2,7; 1 Kor. 6:11). Kjo shumë mirë tregon se, nëse ne bëjmë pjesën tonë me pagëzim, Perëndia, atëhere do të lajë mëkatet tona. Kështu 'vepra' ose akti i pagëzimit është një hap jetik në mbajtjen e Ungjillit të Perëndisë së hirit ('favor i pamerituar'), që na është ofruar në Fjalën e Tij.

Degëzim: Ri-pagëzimi

Disa njerëz ndjehen shumë të heshtur për t'u pagëzuar pasi e kanë patur njëherë atë që menduan se ishte 'pagëzim' i ndonjë lloji, ose duke u spërkatur si bebe, ose me zhytje të plotë në një kishë tjetër. Megjithatë, përpara pagëzimit duhet të ketë pendesë dhe besim të duhur të ungjillit të vërtetë (Vep. 2:38; Mark 16:15,16). Pagëzimi është vetëm pagëzim në qoftë se këto gjëra janë në rregull përpara zhytjes në ujë. Mt. 28:19,20 shoqëron pagëzimin me dëgjimin e mësimeve të Krishtit të shpjeguara së pari. Një fëmijë i vogël është i paafte për pendim ose kuptim të Ungjillit; gjithsesi, spërkatja nuk është pagëzim. Një notar që hidhet në një pishinë noti mund të fundoset në ujë, por ky nuk është pagëzim, sepse personi nuk po i përgjigjet me vetëdije ungjillit të vërtetë. Njësoj është e vërtetë për ata që zhyten kur besojnë doktrina të rreme; ata janë zhytur por jo pagëzuar.

Ka vetëm "një besim", d.m.th një komplet doktrinash që përbëjnë Ungjillin e vërtetë dhe, prandaj, vetëm "një pagëzim"- pagëzimi që ndodh pas besimit të këtij "një besimi". "Është një trup i vetëm (d.m.th një kishë e

vërtetë)...sikurse ju u thirrët në shpresën e vetme të thirrjes suaj. Një Zot i vetëm, një besim i vetëm, një pagëzim i vetëm, një Perëndi i vetëm” (Efe. 4:4-6). Nuk ka dy shpresa, siç besohet nga ata që thonë se nuk ka rëndësi nëse ne besojmë se shpërblimi ynë do të jetë në qiejt ose në tokë. Ka vetëm “një Perëndi” - Jezusi pra, nuk është Perëndi. Rrjedhimisht, në qoftë se, kur u pagëzuam, ne nuk arritëm të kuptojmë doktrinat bazë si Mbretëria e Perëndisë, natyra e Perëndisë dhe e Jezusit, etj., atëherë ‘pagëzimi’ ynë i parë nuk ishte i vlefshëm.

Gjon pagëzori i zhyti njerëzit, duke i thirrur të pendohen dhe duke u mësuar gjëra të caktuara rreth Jezusit (Mark 1:4; Lluka 1:77). Megjithatë, kjo ishte e pamjaftueshme. Vep. 19:1-5 shënojnë se disa prej atyre që kishte pagëzuar Gjoni iu desh të pagëzoheshin përsëri për shkak të kuptimit të paplotë të doktrinave të caktuara. Si ata që pagëzoi Gjoni, ne mund ta ndjejmë që në zhytjen tonë të parë ne bëmë një pendim të mirëfilltë dhe një fillim të ri. Kjo mund të jetë e vërtetë, por nuk heq nevojën për të marrë “një pagëzim (të vërtetë)”, i cili mund të ndodhë vetëm pas kuptimit të të gjithë elementëve të “një besimi”.

KAPITULLI 9: Pyetje

1. Mund të shpëtohem i ne pa pagëzim?

- a) Po
- b) Jo

2. Çfarë do të thotë fjala 'pagëzim'?

- a) Përkushtim
- b) Spërkatje
- c) Besim
- d) Zhytje/fundosje

3. Kur duhet të pagëzohemi?

- a) Pas mësimit të Ungjillit të vërtetë dhe pendimit
- b) Kur jemi bebe të vogla
- c) Pasi jemi të interesuar në Bibël
- d) Kur duam të bashkohemi me një kishë

4. Në çfarë jemi pagëzuar ?

- a) Kishën që na pagëzon

- b) Fjalën e Perëndisë
- c) Krishtin
- d) Frymën e Shenjtë

5. Cilat nga të mëposhtmet ndodh pas pagëzimit?

- a) Ne jemi pjesë e farës së Abrahamit
- b) Ne nuk do të mëkatojmë kurrë më
- c) Ne jemi shpëtuar përfundimisht për të gjithë kohën
- d) Mëkatet tona janë falur

6. Do të pagëzohesh?

- a) Po
- b) Jo

10 JETA PRAKTIKE KRISTIANE

10.1 STUDIMI I BIBLËS

Pas pagëzimit, ne duhet të nxjerrim "frute në shenjtëri", duke jetuar një jetë të udhëhequr nga Fryma e Shenjtë në vend të mishit (Rom. 6:22; 8:1; Gal. 5:16,25). Është nëpërmjet Fjalës së Perëndisë që qendron në ne, që ne sjellim frute në frymë (Gjon 15:7,8). Ne kemi parë që udhëhiqemi nga Fryma në kuptimin që Fryma e Perëndisë është në Fjalën e Tij. Gjatë jetëve tona ne duhet të qendrojmë pranë kësaj fjale nëpërmjet leximit dhe studimit rregullisht të Biblës.

Një studim i vëmendshëm i Fjalës sjell që personi të kuptojë nevojën për pagëzim dhe, pra, kryerjen e aktit. Ky proces i lejimit të Fjalës të ndikojë në veprimet tona dhe të drejtojë jetët tona duhet të vazhdojë; pagëzimi është vetëm hapi i parë në një bindje jetësore ndaj Fjalës së Perëndisë. Ka një rrezik shumë të vërtetë të njohjes së Biblës dhe doktrinave bazë të Ungjillit, që na udhëheq në një pozicion prej ku Fjala nuk na ndikon më: ne mund të lexojmë fjalët dhe ato praktikisht nuk kanë ndikim mbi ne (shih Shtojcën 2). Për këtë arsye është me mend të thuash një lutje të shkurtër përpara çdo leximi të Shkrimit: "Hapi sytë e mi dhe unë do të sodit mrekullitë e ligjit tënd" (Ps. 119:18).

Fjala e Perëndisë duhet të jetë ushqimi ynë i përditshëm – në të vërtetë, varësia jonë mbi të dhe dëshira e natyrshme për të duhet të jetë edhe më e madhe se oreksi ynë prej instinkti për ushqim fizik: "përfitova prej fjalëve të gojës së tij *më tepër* se nga racioni im i ushqimit" ishte ndjesia e Jobit (Job 23:12). Edhe Jeremia: "Me të gjetur fjalët e tua i përpiva: dhe fjala jote ishte në mua gëzim dhe gazi i zemrës sime" (Jer. 15:16). Të gjesh kohën çdo ditë për lexim të Biblës rregullisht është, pra, një gjë jetike për të brumosur në trajtën e jetës sonë të përditshme. Një studim i Biblës i pandërprerë për 30 minuta që në mëngjes është siguria që ne ta fillojmë çdo ditë në marshin e duhur shpirtëror. Zakone të tilla besim-formuese do të vlejnjë si flori në ditën e gjykimit.

Për të shmangur tendencën e natyrshme të leximit të atyre pjesëve të Shkrimit që na drejtohen neve natyrshëm, Kristadelfianët kanë hartuar një program leximi të quajtur "Shoqërimi i Biblës" (jepet nga botuesit e këtij libri). Ky jep një numër kapitujsh për t'u lexuar çdo ditë që rezulton në leximin e Dhjatës s Re dy herë dhe Dhjatën e Vjetër një herë brenda një viti.

Me leximin e kapitujve ditë për ditë, ne mund të marrim kurajo nga mendimi që mijëra besimtarë të tjerë po lexojnë të njëjtët kapituj. Prandaj kurdo që të takohemi ne kemi një lidhje të menjëhershme; kapituajt që kemi lexuar kohët e fundit duhet të formojnë bazat e bisedave tona.

10.2 LUTJA

Një tjetër praktikë jetike për t'u zhvilluar është ajo e lutjes. Duke na kujtuar që ka "një ndërmjetës midis Perëndisë dhe njerëzve, njeriu Jezu Krisht; i cili e dha veten si çmim për të gjithë", Pali bën të qartë rezultatin praktik të të kuptuarit të veprës së Krishtit: "Dua, *pra*, që burrat të luten në çdo vend...pa mëri dhe dyshim" (1 Tim. 2:5-8). "Sepse ne nuk kemi kryepriфт që nuk mund t'i vijë keq për dobësitë tona; po një që u tundua në të gjitha ashtu si ne, por pa mëkatuar. *Le t'i* afrohemi, *pra*, me guxim frontit të hirit, që të marrim mëshirë dhe të gjejmë hir, për të pasur ndihmë në kohë nevojë" (Heb. 4:15,16).

Duke çmuar vërtetë që Krishti është Kryepriфтi ynë personal që ofron lutjet tona fuqishëm te Perëndia, duhet të na frymëzojë ne që të lutemi rregullisht në besim. Megjithatë, lutjet nuk duhet të jenë vetëm një 'listë dëshirash' paraqitur Perëndisë; falenderimi për ushqimin përpara ngrënies, për ruajtjen tonë gjatë udhëtimeve, etj. Duhet të përbëjnë një pjesë të rëndësishme të lutjeve tona.

Thjesht paraqitja e problemeve tona para Zotit në lutje duhet të na japë, në vetvete, një ndjesi të madhe paqeje: "Në çdo gjë (asgjë nuk është shumë e vogël për t'u lutur) me anë lutjesh...me falenderim ia parashtroni kërkesat tuaja Perëndisë. Dhe paqja e Perëndisë, që ia tejkalon çdo zgjuarsie, do të ruajë zemrat dhe mendjet tuaja" (Fil. 4:6,7).

Nëse lutjet tona janë në përputhje me vullnetin e Perëndisë, atyre me siguri do t'u jepet përgjigje (1 Gjon 5:14). Ne mund ta njohim vullnetin e Perëndisë me anë të studimit të Fjalës së Tij, e cila na zbulon Frymën/mendjen e tij. Prandaj studimi ynë i Biblës duhet të na mësojë edhe si të lutemi edhe për çfarë të lutemi, duke i bërë kështu lutjet tona të fuqishme. Prandaj "Nëse ...fjalët e mia qëndrojnë në ju, kërkon i çfarë të doni dhe do t'ju bëhet" (Gjon 15:7).

Ka shumë shembuj të lutjes së rregullt në Shkrim (Ps. 119:164; Dan. 6:10). Mëngjesi dhe mbrëmja, me ca lutje të shkurtra falenderimi gjatë ditës duhet parë si një minimum bazë.

10.3 PREDIKIMI

Një nga tundimet e mëdha që ngrihet nga njohja e Perëndisë së vërtetë është të bëhesh egoist në frymë. Ne mund të jemi kaq të kënaqur në marrdhënien tonë vetjake me Perëndinë, kaq të përpirë në studimin tonë vetjak të Biblës dhe ngritjen në frymë, saqë mund të lëmë pas dore ndarjen e këtyre gjërave me të tjerët – si me bashkëbesimtarët, ashtu edhe me botën rreth nesh. Fjala e Perëndisë dhe Ungjilli i vërtetë që gjendet në të, është si një dritë ose llampë që digjet në errësi (Ps. 119:105; Fja. 4:18). Jezusi tregoi se askush nga ata që ka një dritë të tillë nuk e ve nën kovë, por e shfaq hapur atë (Mat. 5:15). "Ju jeni drita e botës" sepse jeni pagëzuar në Krishtin, "drita e botës" (Mat. 5:14; Gjon 8:12). "Një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet", vazhdoi Krishti (Mat. 5:14).

Në qoftë se ne vërtetë jetojmë një jetë sipas Ungjillit të vërtetë, të cilin kuptojmë, 'shenjtëria' jonë do të jetë e dukshme ndaj atyre me të cilët jetojmë. Ne nuk do të jemi në gjendje të maskojmë faktin që ne jemi 'të ndarë në' shpresën e Mbretërisë dhe, gjithashtu, 'të ndarë nga' udhët e tyre prej bote.

Në një mënyrë taktike ne duhet të kërkojmë ndarjen e njohurisë sonë të së Vërtetës me të gjithë ata që vijmë në kontakt: duke i sjellë bisedat rreth gjërave frymërore; duke diskutuar doktrinën me anëtarë të kishave të tjera; duke shpërndarë trakte dhe duke vendosur afishe të vogla në median tonë lokale, janë të gjitha mënyra në të cilat ne mund të ndriçojmë dritën tonë. Ne nuk duhet të mendojmë se mund t'ia lëmë punën e dëshmisë besimtarëve të tjerë; secili prej nesh ka një përgjegjësi vetjake. Kristadelfianët kanë relativisht pak inisiativa të mëdha të organizuara predikuese në krahasim me grupe të tjera. Secili prej nesh, në mënyrë individuale, bëjmë ç'të mundim kryesisht me shpenzimet tona personale.

Një nga mënyrat më të suksesshme të predikimit është nëpërmjet shpjegimit të besimeve tona familjeve tona dhe ata me këdo që janë në kontakt të afërt. Ata, partnerët e të cilëve nuk janë në besim, duhet t'u shpjegojnë qartë besimet e tyre, megjithatë sapo të jetë bërë kjo është e papërshtatshme të vazhdosh të ngresh çështjet ose të ushtrosh presion mbi ta. Perëndia nuk do kthime me shtytje. Detyra jonë është të dëshmojmë të Vërtetën pa u shqetësuar shumë për sasinë e përgjigjes ndaj saj. Ne kemi një përgjegjësi të madhe të bëjmë këtë dëshmi (Eze. 3:17-21); nëse Krishti vjen gjatë jetës sonë "dy burra do të jenë në fushë; njëri do të merret dhe tjetri do të lihet"

(Luka 17:36). Do të ishte vërtetë e çuditëshme po të mos kishim folur me familjen ose kolegët e punës për ardhjen e dytë të Zotit tonë kur të ndodhë kjo.

10.4 JETA NË KISHË

Deri tani në këtë kapitull kemi folur për përgjegjësitë tona vetjake në frymë. Megjithatë ne kemi një detyrë të takohemi me të tjerët që kanë pjesë në shpresën tonë. Prapë, kjo duhet të jetë diçka që ne dëshirojmë ta bëjmë natyrshëm. Ne kemi treguar se pas pagëzimit ne hyjmë në një udhëtim shkretëtire drejt Mbretërisë. Vetëm natyrshëm do të dëshironim të takoheshim me bashkë-udhëtarë. Ne jetojmë në ditët e fundit përpara ardhjes së Krishtit; për të mposhtur shumë sprova të komplikuara, të cilat na sulmojnë në këto kohë, ne duhet të bashkohemi me ata që janë në të njëjtën pozitë: “pa hequr dorë nga të mbledhurit bashkë...por të nxisim njëri-tjetrin: aq më tepër se e shihni ditën (ardhjen e dytë) që po afrohet” (Heb. 10:25 kra. Mal. 3:16). Besimtarët, pra, duhet të bëjnë çdo përpjekje kontakti me njëri-tjetrin nëpërmjet letrave dhe udhëtimit për të takuar njëri-tjetrin për të bërë së bashku studimin e Biblës, darkën e Zotit dhe veprimtari predikimi.

Secili prej nesh, në mënyrë individuale, është ‘thirrur nga’ bota në shpresën e madhe të Mbretërisë. Fjala ‘shenjt’ do të thotë ‘një person i thirrur dhe mund të thuhet për të gjithë besimtarët e vërtetë dhe jo vetëm për pak besimtarë të shquar të së kaluarës. Fjala greke e përkthyer ‘kishë’ në biblën anglishte, është ‘ecclesia’, që do të thotë ‘një mbledhje e të thirrurve’, d.m.th. besimtarë. Prandaj ‘kisha’ është për një grup besimtarësh dhe jo ndërtesa fizike ku ata mbledhen. Për të shmangur keqkuptimin në përdorimin e këtij termi, kristadelfianët tentojnë t’u referohen ‘kishave’ të tyre si ‘ecclesias’.

Kudo që të ketë një numër besimtarësh në një qytet ose zonë të caktuar, është llogjike që ata gjejnë një vend për t’u takuar rregullisht. Kjo mund të jetë në shtëpinë e një besimtari ose në një sallë me pagesë. Eklesitë e Kristadelfianëve takohen në mbarë botën në vende si qendrat bashkiake, salla konferencash të hoteleve, salla të ndërtuara vetë ose shtëpi private. Qëllimi i një eklesie është të ndërtojë anëtarët e vet nëpërmjet studimit kolektiv të Biblës dhe, gjithashtu, t’i dëshmojnë botës në grup duke ndriçuar dritën e tyre nëpërmjet predikimit. Një orar tipik për një eklesi kristadelfiane mund të jetë diçka e tillë:-

E DIELË 11 para dite Shërbimi i thyerjes së bukës.

6 mbas dite Veprimtari predikuese në publik**E MËRKURË 8 mbas dite Studim Bible**

Eklesia është pjesë e familjes së Perëndisë. Në çdo komunë të lidhur ngushtë, çdo anëtar duhet të jetë i ndjeshëm dhe i dhënë ndaj të tjerëve; Krishti vetë ishte shembulli suprem në këtë. Pavarësisht nga epërsia e tij në frymë, ai veptoi si "shërbyesi i të gjithëve", duke larë këmbët dishepujve ndërsa ata debatonin me njëri-tjetrin se kush ishte më i madhi ndërmjet tyre. Jezusi na porositi të ndjekim shembullin e tij në këtë (Gjon 13:14,15; Mat. 20:25-28).

Mësimi që jepet në eklesi duhet të bazohet, pa dyshim mbi Fjalën e Perëndisë. Ata që flasin në publik brenda eklesisë pasqyrojnë, pra, Perëndinë, duke folur nga ana e Tij. Meqenëse Perëndia është mashkull, atëhere vetëm vëllezërit duhet të bëjnë punën e udhëzimit publik nga Fjala e Perëndisë. 1 Kor. 14:34 nuk mund të jetë më haptas: "Gratë tuaja të heshtin në kishë: sepse nuk u lejohej të flasin". 1 Tim. 2:11-15 e gjurmon arsyen për këtë deri në kopshtin e Edenit; meqenëse Eva e mësoi Adamin të bëjë mëkat, gruaja nuk duhet të mësojë burrin tani. Fakti që Perëndia formoi Adamin përpara Evës është shenjë që "koka e gruas është burri" (1 Kor. 11:3), dhe prandaj burri duhet të udhëheqë gruan në frymë dhe jo anasjelltas.

Për shkak të gjithë këtyre gjërave, "gruaja le të mësojë në heshtje me çdo nënshtrim. Nuk e lejoj gruan që të mësojë, as të përdorë pushtet mbi burrin, por të rrijë në heshtje. Në fakt së pari u formua Adami, pastaj Eva. Dhe nuk u gënjye Adami, por gruaja u gënjye dhe ra në shkelje. Megjithatë ajo do të shpëtohet duke (greqisht 'nëpërmjet') lindur fëmijë, në qoftë se do të qendrojnë në besim, në dashuri dhe shenjtëri me modesti" (1 Tim. 2:11-15).

Nga kjo është e qartë që Bibla përcakton role të ndara të caktuara për burrat dhe gratë besimtarë. Gratë, duke u urdhëruar në raste të caktuara të "martohen, lindin fëmijë, udhëheqin shtëpinë" (1 Tim. 5:14), tregojnë se sfera e tyre e prirjes në frymë është ajo e shtëpisë. Prandaj puna publike në eklesi i lihet burrit. Kjo është në dallim të mprehtë me teoritë njerëzore të barazisë seksuale, sipas së cilave gruaja e përkushtuar e karrierës mund të pretendojë barazi me burrin e saj në çdo drejtim, që nga drejtimi i buxhetit të familjes deri te veshja e rrobave pa dallim gjinie. Prodhimi i fëmijëve shihet si një pengesë e nevojshme për të ruajtur një farë niveli pjekurie emocionale në një botë krejtësisht materiale dhe egoiste. Besimtarët e vërtetë do t'i

shmangen kësaj fryme të kohës, edhe pse, si gjithmonë, drejtpeshimi është i nevojshëm.

Burri nuk duhet të sundojë gruan, por ta dojë atë siç na deshi Krishti neve. (Efe. 5:25).

"Ju burra, jetoni me to sipas ditorisë (d.m.th trajtoje gruan me ndjeshmëri, sipas ditorisë tënde të Fjalës së Perëndisë), duke e nderuar gruan si një enë më delikate dhe si bashkë trashëgimtare e hirit të jetës" (1 Pjetër 3:7).

Në terma frymërorë pagëzimi në Krisht i bënë burrin dhe gruan të barabartë (Gal. 3:27,28 krahu. 1 Kor. 11:11). Megjithatë kjo nuk ndikon në parimin e qartë që 'burri është koka e gruas' (1 Kor. 11:3) në çështje praktike dhe shpirtërore, si në familje ashtu edhe në klesë.

Me qëllim që të demonstrojnë njohjen e këtij parimi, femra besimtare duhet të veshi një mbulesë koke sa herë që një vëlla mëson nga Fjala e Perëndisë. Në praktikë kjo do të thotë që duhet të vishet një kapele ose shami koke në të gjitha mbledhjet e klesës. Dallimi në role midis burrit dhe gruas duhet të theksohet nga mënyra se si mbajnë flokët burrat dhe gratë (1 Kor. 11:14,15). "Edhe çdo grua që lutet...kokëzbuluar turpëron kryet e saj (d.m.th. burrin e saj v. 3): sepse është njëlloj sikur të ishte e rruar. Sepse në qoftë se gruaja nuk mbulohet, le t'ia presin flokët: por në qoftë se për gruan është turp të qethet a të rruhet, le të mbulojë kryet...prandaj duhet gruaja të mbulohet, si shenjë që ajo është nën pushtetin e burrit të saj" (1Kor. 11:5,6,10 A.V. mg.).

10.5 THYERJA E BUKËS

Së bashku me lutje dhe lexim Bible, është jetike bindja e rregullt ndaj urdhërimit të Krishtit për të thyer bukën dhe pirë verën në kujtim të sakrificës së tij. "Bëni këtë në përkujtimin tim", urdhëroi Jezusi (Lluka 22:19). Ishte dëshira e tij që ndjekësit e tij ta bënin këtë rregullisht deri në ardhjen e tij të dytë, kur Jezusi do të ndajë bukën dhe verën përsëri me ta (1 Kor. 11:26; Lluka 22:16--18).

Buka përfaqson trupin e Krishtit, që u ofrua në kryq dhe vera, gjaku i tij (1Kor. 11:23-27). Besimtarët e hershëm duket se e kanë mbajtur këtë

shërbim shpesh (Vep. 2:42,46), ndoshta një herë në javë (Vep. 20:7). Në qoftë se ne vërtetë e duam Krishtin, ne do t'i bindemi urdhërimeve të tij (Gjon 15:11-14). Në qoftë se ne kemi një marrdhënie të vërtetë me të, ne do të duam të mbajmë mend sakrificën e tij siç na ka kërkuar duke kurajuar, kështu, vetveten në përkujtimin e atij shpëtimit të madh që ai arriti. Një periudhë e përkujtimit të qetë mbi vuajtjet e tij në kryq do t'i bëjë sprovat tona të papërfillshme kur krahasohen me ato të Zotit tonë.

Thyerja e bukës është një shërbim thelbësisht *përkujtimor*; nuk ndodh asgjë magjike si rrjedhim i kryerjes. Është njësoj si festa e Pashkës nën ligjin e Moisiut (Lluka 22:15; 1 Kor. 5:7,8). Kjo ishte një mënyrë për të përkujtuar çlirimin nga Egjypti, që Perëndia e kreu nëpërmjet Moisiut në Detin e Kuq. Shërbimi i thyerjes së bukës na çon deri në shpëtimin prej mëkatit nëpërmjet Krishtit, që u bë i mundur në kryq dhe me të cilin ne u lidhëm duke u pagëzuar. Ruajtja e këtij urdhërimi, pra, duhet të jetë diçka, të cilën ne duam ta bëjmë natyrshëm.

Marrja fizikisht e bukës dhe e verës e bën dashurinë e Krishtit për ne dhe, në fakt, të gjitha gjërat lidhur me shpëtimin tonë vijnë kaq të vërteta edhe një herë. Thyerja e bukës rreth një herë në javë është, pra, një shenjë e një gjendjeje shpirtërore të shëndetshme. Në qoftë se dikush nuk mund ta bëjë me bashkë-besimtarët e Së Vërtetës, duhet bërë vetëm. Asnjë pretext nuk duhet lejuar të na ndalojë të ruajmë këtë urdhërim. Ne duhet të bëjmë çdo përpjekje të mbajmë me vete një sasi buke dhe vere për shërbimin, megjithëse në rrethana ekstreme edhe mungesa e tyre nuk duhet të jetë pengesë për përkujtimin e Krishtit në mënyrën e treguar sa më mirë që të mundemi. Jezusi përdori “frutin e vreshtit” (Lluka 22:18), dhe prandaj ne duhet të përdorim verë rrushi të kuq.

Të marrësh simbolin e vuajtjeve dhe sakrificës së Krishtit është nderi më i madh që mund të ketë një burrë ose grua. Të marrësh pjesë në to pa vëmendjen e duhur se çfarë përfaqsojnë është afër blasfemisë, duke qenë se "sa herë të hani këtë bukë dhe pini këtë kupë, ju shpallni vdekjen e Zotit...Prandaj ai që ha nga kjo bukë dhe pi nga kjo kupë e Zotit padenjësisht, do të jetë fajtor i trupit dhe i gjakut të Zotit" (1 Kor. 11:26,27). Një shërbim i thyerjes së bukës duhet mbajtur, pra, në një vend dhe kohë, ku nuk do të ketë ngatërime dhe ndërprerje të rrjedhës së mendimeve të dikujt. Kjo mund të sjellë bërjen e saj herët në mëngjes ose natën vonë në dhomën e gjumit ose vend tjetër të përshtatshëm. Ne na është këshilluar më tej, “Secili të shqyrtojë vetveten dhe *kështu* (në atë frymë të përlulur të vetë-shqyrimit)

të hajë nga buka e të pijë nga kupa” (1 Kor. 11:28). Prandaj ne duhet të fiksojmë mendjet tona në sakrificën e Krishtit, ndoshta duke u hedhur një sy shënimeve të Ungjillit për kryqëzimin e tij, përpara se të marrim simbolet. Duke bërë ashtu si duhet, ne, gjithashtu, në mënyrë të pashmangshme, do të shqyrtojmë ndërgjegjen tonë ndaj Krishtit.

Një rregull i përshtatshëm për shërbimin e thyerjes së bukës është si vijon:-

1. Lutja – kërkimi i bekimeve të Perëndisë mbi mbledhjen; hapjen prej Tij të syve tona ndaj Fjalës së Tij; mbajtjen mend të nevojave të anëtarëve të tjerë; përlëvdimin e Tij për dashurinë e Tij, veçanërisht siç tregohet në Krisht dhe lutja për ndonjë çështje tjetër të caktuar.
2. Bëj leximin ditor të Biblës siç tregohet në “Shoqërimin e Biblës”.
3. Medito mbi mësimet që duhen mësuar prej tyre ose lexo një 'këshillë' – një studim Bible mbi ata kapituj, që na çojnë drejt qëllimit të shërbimit tonë – përkujtimin e Krishtit.
4. Lexo 1 Kor. 11:23-29
5. Periudhë vetë-shqyrtimi në qetësi.
6. Lutje për bukën.
7. Thyej bukën dhe ha një pjesë të vogël prej saj.
8. Lutje për verën.
9. Pi një gllënjë verë.
10. Lutja e mbylljes.

I gjithë shërbimi duhet të zgjasë vetëm nja një orë.

10.6 MARTESA

Ne do ta fillojmë këtë pjesë duke marrë parasysh pozitën e atyre që janë beqarë në momentin e pagëzimit. Ka disa fragmente, të çiftëzuara me shembullin e Jezusit, Palit dhe të tjerëve, që inkurajojnë ata që janë beqarë të paktën të marrin parasysh opsionin e të mbeturit beqarë që kështu t'ia përkushtojnë veten tërësisht veprës së Zotit (1 Kor. 7:7-9, 32-38 krah. 2 Tim. 2:4; Mat. 19:11,12,29; Pre. 9:9). "Por edhe në qoftë se martohesh, ti nuk mëkaton" (1 Kor. 7:28). Shumë prej apostujve ishin të martuar (1 Kor. 9:5), dhe martesë, siç e ka caktuar Perëndia është bërë që të sjellë shumë përfitime fizike dhe shpirtërore. "Martesa të nderohet nga të gjithë dhe (përdorimi i) shtrati martesor i papërlyer" (Heb. 13:4). "Nuk është mirë që...njeriu të jetë vetëm", përveç kur ai drejton një nivel të lartë përkushtimi në gjërat në frymë dhe prandaj Perëndia krijoi martesën (Zan. 2:18-24). Prandaj, "Kush ka gjetur grua ka gjetur një gjë të mirë dhe ka siguruar një favor nga Zoti...një bashkëshorte e mençur vjen nga Zoti" (Fja. 18:22; 19:14)

Implikimi i këtyre vargjeve është që lejimi i dëshirave gjinore jashtë martesë është kurvëri. Paralajmërimet kundër kurvërisë (marrdhënie gjinore ndërmjet njerëzish të pamartuar), shkeljes së kurorës (marrdhënie gjinore ku një ose të dyja palët janë të martuar me partnerë të tjerë) dhe çdo lloj imoraliteti janë të shpeshta gjatë gjithë Dhjatës së Re; pothuajse çdo letër i përmban ato. Të mëposhtmet janë vetëm disa prej tyre: Vep. 15:20; Rom. 1:29; 1 Kor. 6:9-18; 10:8; 2 Kor. 12:21; Gal. 5:19; Efe. 5:3; Kol. 3:5; 1 Thes. 4:3; Juda 7; 1 Pjetër 4:3; Zbu. 2:21.

Parimi bazë i Zan. 2:24 zbulon mëkatet e homoseksualitetit; është qëllimi i Perëndisë që burri dhe gruaja duhet të martohen dhe bashkohen me njeri-tjetrin. Perëndia e krijoi gruan të jetë ndihmë për Adamin dhe jo një burrë tjetër. Marrdhëniet gjinore ndërmjet burrave janë mallkuar në mënyrë të përsëritur në Bibël. Ky ishte një nga mëkatet, për të cilin Sodoma u shkatërrua (Zan. Kap.18,19); apostulli Pal e bën shumë të qartë se këmbëngulja në praktika të tilla do të shkaktojë zemërim të Perëndisë dhe përjashtim nga Mbretëria e Tij (Rom.1:18-32; 1 Kor.6:9,10).

Fakti që kemi qenë një herë të përfshirë në gjëra të tilla nuk duhet të na bëjë të ndjehemi sikur jemi përtej ndihmës së Perëndisë. *Ka* falje me Perëndinë, që Atij t'i jepet nderim me dashuri nga ata që provuan faljen e Tij (Ps. 130:4). Eklezia në Korinth pati pjesën e saj të të shtururve të penduar: "Të

tillë ishin disa nga ju: por u latë (në pagëzim), por u shenjtëruat, por u shfajsuat (duke u pagëzuar) në emër të Zotit Jezus” (1 Kor. 6:9-11).

10.7 MIQËSIA

Fjalët greke të përkthyer ‘miqësi’ dhe ‘bashkësi’ thjesht përshkruajnë gjendjen e të pasurit diçka të përbashkët: bashkë-njësi. ‘Bashkësi’ është e lidhur me fjalën ‘bashkëbisedoj’. Për shkak të njohjes dhe ushtrimit të udhëve të Perëndisë, ne kemi miqësi me Të dhe me gjithë të tjerët që bëjnë njësoj duke qënë “në Krisht”. Është e lehtë të lësh pas dore përgjegjësitë që kemi për t’u miqësuar me të tjerët: “mos harroni bamirësinë dhe të komunikoni (d.m.th. miqësohuni) me njëri-tjetrin” (Heb. 13:16). Fil. 1:5 flet për “miqësinë tonë në Ungjill”; bazat e miqësisë sonë, pra, janë doktrinat që përbëjnë Ungjillin e vërtetë. Për këtë arsye miqësia e gëzuar nga besimtarët e vërtetë është shumë më e madhe se çdo organizatë tjetër ose kishë. Për shkak të kësaj miqësie ata udhëtojnë largësi të mëdha për të qënë me njëri-tjetrin dhe për t’u bërë vizitë besimtarëve të izoluar dhe duhet të përdorin sa më shumë kontaktet postale dhe telefonike ku është e mundur. Pali flet për “miqësinë e Frymës” (Fil. 2:1), d.m.th. miqësi që është bazuar në ndjekjen tonë të përbashkët të Frymës/mendjes së Perëndisë, siç është zbuluar në Frymën/Fjalën e Tij.

Një nga shprehjet më të mëdha të miqësisë sonë është nëpërmjet mbajtjes së shërbimit të thyerjes së bukës së bashku. Besimtarët e hershëm “vazhduan me këmbëngulje në doktrinën dhe miqësinë e apostujve (në) thyerjen e bukës dhe në lutje...duke thyer bukën...me gëzim dhe thjeshtësi zemre” (Vep. 2:42,46). Simbolet që përfaqsojnë shtyllën qendrore të shpresës sonë, ndarja e tyre së bashku duhet të na lidhë së bashku në “thjeshtësinë e zemrës”. “Kupa e bekimeve që ne bekojmë, a nuk është pjesmarrje (ndarja) në gjakun e Krishtit? Buka që ne thyejmë, a nuk është pjesmarrje në trupin e Krishtit? Sepse ne të shumtit jemi një bukë dhe një trup: sepse ne jemi të gjithë pjesmarrës të së vetmes bukë”, d.m.th. Krishtin (1 Kor. 10:16,17). Prandaj ne e kemi për detyrë të ndajmë simbolet e sakrificës së Krishtit me të gjithë ata që përfitojnë nga vepra e tij, që janë “pjesëmarrës të së vetmes bukë”. Vetëm ata që janë pagëzuar si duhet në Krisht, pas njohjes së të vërtetës, janë në këtë pozitë dhe është tallje e simboleve t’i ndash me çdo njeri tjetër veç tyre.

Miqësia jonë me Perëndinë dhe Krishtin dhe besimtarët e tjerë nuk varet vetëm në pwrputhjen e mendimeve tona të përbashkëta ndaj të vërtetave

doktrinale që përbëjnë “të vetmin besim”. Mënyra jonë e jetesës duhet të jetë në përputhje me parimet e shprehura në to. “ Perëndia është dritë dhe në të nuk ka kurrfarë errësire. Po të themi se kemi bashkësi me Të, dhe të ecim në errësirë, ne gënjejmë dhe nuk e vemë në praktikë të vërtetën: por në qoftë se ne ecim në dritë, sikurse Ai është në dritë, kemi bashkësi njëri me tjetrin dhe gjaku i Jezu Krishtit Birit të Tij na pastron nga gjithë mëkatet” (1 Gjon 1:5-7).

Nga kjo duhet të jetë e qartë që bashkësia përfundon kur një besimtar fillon të mbajë doktrina ose jeton jetën në mënyra që janë hapur kundër mësimet të Biblës: "mos merrni pjesë në punët e pafrytshme të errësirës, por më tepër t'i qortoni" (Efe. 5:11). Duhet të bëhet çdo përpjekje për t'i rifituar si bariu i mirë që kërkon delen e humbur (Lluka 15:1-7).

Një nga pjesët më të qarta lidhur me miqësinë gjendet në 2 Kor. 6:14-18: "Mos hyni në një zgjedhë bashkë me të pabesët: sepse ç'lidhje ka drejtësia me paudhësinë? Dhe çfarë afrie ka drita me terrin...prandaj dilni nga mesi i tyre dhe ndahuni prej tyre, thotë Zoti... dhe unë do t'ju pranoj dhe do të jem Atë për juve dhe ju do të jeni bijtë dhe bijat e mia, thotë Zoti i Plotfuqishëm”.

Ne kemi treguar se si Fjala e Perëndisë është dritë. Këto vargje shpjegojnë pse nuk duhet të bashkohemi me kishat që mësojnë doktrina të rreme; pse nuk duhet të martohemi me ata që nuk dinë të Vërtetën dhe duhet t'u shmangemi udhëve të botës. Në sajë të ndarjes sonë nga bota ne kemi nderin magjepsës të bërjes së bijve dhe bijave të vetë Perëndisë, pjesë e një familjeje mbarëbotërore të të tjerëve që kanë të njëjtën marrëdhënie-vëllezërit dhe motrat tona. Është vetëm “një trup”, d.m.th. një kishë e vërtetë (Efe. 1:23), që bazohet në ata që mbajnë një shpresë- një Perëndi, një pagëzim dhe “një besim”, d.m.th. të vetmin komplet doktrinash që përbëjnë të vetmin besim (Efe. 4:4-6). Nuk është e mundur të jesh pjesë e këtij “një trupi” dhe gjithashtu të bashkohesh me organizata të tjera fetare që nuk mbajnë besimin e vërtetë. Duke parë që drita nuk ka lidhje me errësirën, ne e shpallim veten të jemi në errësirë po të zgjedhim bashkësinë me errësirën.

Po t'i keni ndjekur këto kapituj me kujdes, tashmë duhet të jetë e qartë që nuk mund të ketë pozitë gjysmake në marrëdhënien tonë me Perëndinë. Ne ose jemi në Krisht nëpërmjet pagëzimit në të, ose jashtë tij. Jemi ose në dritë në sajë të kapjes së doktrinës së vërtetë dhe bindjes praktike ndaj saj, ose në errësirë. Nuk mund të kesh një këmbë në dy kampe.

Njohuria jonë për këto gjëra na jep një farë shkalle përgjegjësie drejt Perëndisë. Ne tani nuk ecim nëpër rrugë ose kalojmë jetët tona ditore si njeriu i zakonshëm në botë. Perëndia është vazhdimisht në pritje të përgjigjes sonë. Si Ai, ashtu edhe Zoti Jezus dhe gjithë besimtarët pothuajse mund të të 'bëjnë' që të marrësh vendimin e duhur. Edhe pse Perëndia, Krishti dhe ne do të bëjmë ç'të mundim të të ndihmojmë ty-dhe në rastin e Perëndisë deri në pikën që dha Birin e Tij të vetëm të vdesë për nëpërfundimisht shpëtimi jot varet në vendimin tënd të lirë për të mbajtur fort Shpresën e madhe që tashmë të është ofruar. Pra, të lutem vendos të pagëzohesh dhe të ndjekësh këtë rrugë. Në qoftë se na shkruan te adresa në fillim të këtij libri, ne do ta rregullojmë këtë me kënaqsi.

KAPITULLI 10: Pyetje

1. Çfarë do të thotë 'shenjteri'?
 - a) mospasje kontakt me mosbesues
 - b) ndarje *nga* mëkati dhe qenie *në* gjërat e Perëndisë
 - c) shkuarja në kishë
 - d) bamirësia ndaj të tjerëve

2. Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për thyerjen e bukës?
 - a) ne duhet ta bëjmë pothuajse përjavshëm
 - b) duhet ta bëjmë një herë në vit në kohën e Pashkës
 - c) buka dhe vera kthehen në vetë trupin dhe gjakun e Jezusit
 - d) buka dhe vera përfaqsojnë trupin dhe gjakun e Jezusit.

3. Cila nga thëniet e mëposhtme është e vërtetë për martesën?
 - a) ne duhet të martohemi vetëm me besimtarë të vërtetë
 - b) ndarja është e lejueshme për besimtarët
 - c) një besimtar i(e) martuar, bashkëshorti(ja) i(e) të cilit është mosbesues duhet të përpiqet të mbetet me ta
 - d) në martesë, burri përfaqson Krishtin dhe gruaja besimtarët

BAZAT E BIBLËS

Digresionet

DUNCAN HEASTER

SHTOJË PËR BAZAT E BIBLËS

Këto studime dhe digresione janë pjesë e versionit fillestar të Bazave të Biblës, por qenë lënë jashtë përkthimit të shkurtuar edhe pse janë pjesë e librit fillestar. Për rrjedhojë, duhen lexuar në lidhje me Bazat e Biblës. Në origjinal, secili seksion përfundonte me 'Digresionet' në të cilat shpjegoheshin më me hollësi disa prej temave më të vështira. Do të shikoni që çdo seksion ka një titull që i korrespondon një kapitulli përkatës në Bazat e Biblës dhe do të sugjeroja që të përpiqeni t'i lexoni ato sëbashku me qëllim që të ruhet vazhdimësia. Si botim i parë, këto po botohen veçmas por shpresohet që në rishtypje të Bazave të Biblës, ato të përfshihen dhe kështu, të lexohen sëbashku si kishte qenë edhe synimi fillestar. Lutja ime është që

ju do t'i gjeni këto shtojca të dobishme në rritjen tuaj shpirtërore dhe në të kuptuarit e Fjalës së Perëndisë. *Duncan Heaster*

Shënim: do të shikoni që tani ka dy versione të Studimit 9. Studimi 9 në këtë shtojcë është Studimi 9 fillestar dhe mund të jetë e dobishme ta lexoni në atë radhë meqenëse merret me Veprën e Jezusit. Atëherë, Studimet 9 dhe 10 aktuale do të bëhen 10 dhe 11.

Digresion 1: “Perëndia është Shpirt” (Gjn. 4:24)

Në Studimin 2 do të shohim më saktësisht mësimin e Biblës mbi shpirtin e Perëndisë. Arsyetimin e paraqitur këtu mund ta përmbledhim duke thënë që shpirti i Perëndisë është fuqia ose fryma e Tij, me anë të së cilit, vetja e Tij thelbësore, qenia dhe karakteri i Tij, i shfaqet njeriut me anë të veprimeve që ai shpirt përmbush. Kështu “Perëndia është shpirti,” siç duhet përkthyer Gjn 4:24 (shih R.S.V., N.I.V.), sepse shpirti i Tij pasqyron personalitetin e Tij.. Perëndia përshkruhet si shumë gjëra, p.sh.

- “Perëndia ynë është një zjarr që përpin” (Heb. 12:29)
- “Perëndia është dritë” (1 Gjn. 1:5)
- “Perëndia është dashuri” (1 Gjn. 4:8)
- “Fjala (greqisht ‘logos’ – plan, qëllim, ide) ishte Perëndia” (Gjn. 1:1).

Kështu pra, “Perëndia është” karakteristikat e tij. Është e qartë që është e gabuar të thuhet që cilësia abstrakte e dashurisë është ‘Perëndia,’ thjesht ngaqë lexojmë që “Perëndia është dashuri.” Mund ta quajmë dikë ‘vetë mirësia,’ por kjo nuk do të thotë që ata nuk kanë ekzistencë fizike – është pikërisht mënyra e ekzistencës së tyre faktike që na zbulon mirësi neve. Duke qenë që fryma është fuqia e Perëndisë, lexojmë shpesh që Perëndia dërgon ose drejton frymën e Tij për të arritur gjëra në harmoni me vullnetin dhe karakterin e Tij. Shembujt për këtë janë të shumtë, duke treguar dallimin midis Perëndisë dhe frymës së Tij.

- “Ai (Perëndia) që vuri Shpirtin e Tij të Shenjtë brenda atij” (Jesh. 63:11)
- “Unë (Perëndia) do ta mbush atë (Jezusin) me shpirtin Tim” (Mt. 12:18)
- “Ati e jep Shpirtin e Shenjtë” (Lk. 11:13)
- “Shpirti që zbret nga qielli” (Gjn. 1:32)
- “Unë (Perëndia) do t'i mbush njerëzit me Shpirtin Tim” (Vep. 2:17).

Vërtet, referencat e shpesht ndaj “shpirtit të Perëndisë” duhet të jenë provë e mjaftueshme që shpirti nuk është personalisht Perëndia. Këto dallime midis Perëndisë dhe shpirtit të Tij janë një vështirësi tjetër për ata që besojnë që Perëndia është një ‘trini’ në të cilën Perëndia Ati barazohet me Jezusin dhe me Shpirtin e Shenjtë.

Është e rëndësishme që një Perëndi jo-personal nuk ka logjikë në lutje – deri në atë pikën që lutja është një dialog midis ndërgjegjes sonë dhe një koncepti të Perëndisë që ekziston veçse në mendjen tonë. Shpesh na kujtohet që ne i lutemi Perëndisë që është në qiell (Koh. 5:2; Mt. 6:9; 5:16; 1 Mbretërve 8:30), dhe që Jezusi tani është në krahun e djathtë të Perëndisë atje, për të ofruar lutjet tona (1 Pjt. 3:22; Heb. 9:24). Nëse Perëndia nuk është personal, pasazhe të tilla nuk kanë asnjë kuptim. Por sapo Perëndia kuptohet si një At real, i dashur, lutja para Tij bëhet një gjë shumë reale, e prekshme – në fakt duke i folur një qenieje tjetër që ne besojmë që është shumë i gatshëm dhe i aftë të përgjigjet.

Digresion 2: Përdorimi i Emrit të Perëndisë

Kemi parë që emri i Perëndisë dhe ai i Birit të Tij Jezus ka kuptim shumë të thellë. Kur flasim për ‘Perëndinë’ jemi duke prekur çdo aspekt të qëllimit të tij të mrekullueshëm për dashurinë dhe të vërtetën. Për rrjedhojë, përdorimi i emrit të Perëndisë më kot, si një pasthirmë e lehtë apo si shprehje pakënaqësie, është një prej gjërave më fyese që njeriu mund t’i bëjë Bërësit të tij. Për këtë arsye, cilido që dëshiron ta kënaqë Perëndinë dhe ta nderojë Atë duhet të bëjë çdo përpjekje që të mos e përdorë emrin e Perëndisë pa vend. Në shumë shoqëri në mbarë botën, një blasfemi e tillë është bërë një pjesë standarte e gjuhës moderne; heqja dorë nga ajo që mund të ketë qenë një zakon i një jete të tërë nuk do të jetë i lehtë. Një lutje e ndjerë për ndihmën e Perëndisë për këtë, sigurisht që nuk do të kalojë pa u vënë re nga Ai. Atyre që janë brenda sferës sonë të kontrollit dhe ndikimit, p.sh. fëmijëve, gjithashtu mund t’u kujtohet serioziteti i blasfemisë: “Sepse Zoti do ta ndëshkojë këdo që e përdor keq emrin e Tij” (Br. 5:11).

Nga ana tjetër janë ata që këmbëngulin që kisha kristiane duhet të përdorë fjalët hebraisht Yahweh ose Jehovah në vend të saj. Duke bërë këtë, njerëzit përdorin emrin e shenjtë dhe të mrekullueshëm të Perëndisë për të ushqyer një lloj elitizmi shpirtëror, me anë të të cilit urrejnë njerëz të tjerë thjesht përmes shqiptimit ose përdorimit të një fjale. Kjo nuk do të thotë se përdorimi i emrit të Perëndisë është diçka e gabuar; ai është veçanërisht i përshtatshëm për lutjet tona personale sapo jemi pagëzuar siç duhet në emrin. Megjithatë, Dhiata e Re nuk na jep ndonjë shenjë që një gjë e tillë

është e nevojshme apo qoftë edhe e dëshiruar prej Perëndisë. Ai frymëzoi shkrimin e Dhiatës së Re në mënyrë që të shkruhej në greqisht, duke përdorur vetëm një fjalë për ‘Perëndinë’ - ‘theos’, që do të thotë ‘i madhi.’ Në të nuk bëhet ndonjë dallim midis ‘Perëndisë’ dhe ‘Yahweh,’ dhe as nuk ka ndonjë komandë specifike në lidhje me çfarë besimtarët duhet ta quajnë veten si komunitet. Pjetri flet për një besimtar si një “kristian” dhe jo për një ‘njer-Yahweh’ apo diçka të ngjashme (1 Pjt. 4:16). Mbitheksimi i përdorimit të emrit ‘Yahweh’ çon në zhvlerësimin e punës dhe vendit të Zotit Jezus, në mënyrë të ngjashme si shumë ‘kristianë ungjillorë’ mbitheksojnë emrin dhe postin e Jezusit deri në neglizhimin e pozitës edhe më të pushtetshme të Perëndisë.

Emrat e tjerë me anë të të cilëve bashkësia e hershme e besimtarëve kristianë i drejtoheshin vetes nuk e përfshijnë emrin ‘Yahweh’.

- “Populli i zgjedhur i Izraelit” (Ef. 2:12)
- “Kuvendi i përgjithshëm dhe kisha e të parëlindurve” (Heb. 12:23)
- “Bashkësia e Perëndisë” (Vep. 20:28)
- “Bashkësia e Perëndisë së gjallë, i cili është shtylla dhe dheu i së vërtetës” (1 Tim. 3:15)
- “Shtëpia e Perëndisë” (1 Tim. 3:15).

Si shtojcë, vini re që besimtarët nuk e quanin veten ‘kristianë’; ky ishte një term përulës që desh të thoshte, ‘këta gjindje e Krishtit,’ emërtuar prej armiqve të tyre.

Digresion 3: Manifestimi i Perëndisë

Ajo çka vijon nuk do të jetë e lehtë të kuptohet plotësisht që me leximin e parë, por rëndësia e temës do të bëhet edhe më e dukshme me vazhdimin e studimit tuaj. E përfshijmë në këtë pikë me qëllim që ju ta përfundoni këtë studim pasi të keni shqyrtuar plotësisht zbuluesën bazë të Biblës për Vetë Perëndinë.

Emri i Perëndisë mund të bartet prej kujtdo që Ai zgjedh të ‘manifestojë’ apo shfaqë Vetën. Kështu njerëzit dhe engjëjt ashtu si dhe Jezusi mund ta bartin emrin e Perëndisë. Ky është një parim jetësor i cili zbulon para syve tanë aq shumë nga Bibla. Veçanërisht biri mund ta bartë emrin e atit të tij; ai ka ngjashmëri të caktuar me të atin, mund të ketë edhe të njëjtin emër – po nuk është po ai person si dhe i ati. Po kështu, një përfaqësues i një kompanie mund të flasë në emër të kompanisë; mund t’i telefonojë dikujt për çështje pune dhe të thotë, ‘Alo, këtu kompania Unilever’ ai nuk është Z. Unilever, por ai bart emrin e tyre sepse punon në emër të tyre. Po kështu ishte edhe me Jezusin.

ENGJËJT QË BARTIN EMRIN E PERËNDISË

Në Dal. 23:20,21, na thuhet se Perëndia i tha popullit të Izraelit që një engjëll do të dilte para tyre; “Emri im është në Atë,” iu tha. Emri personal i Perëndisë është ‘Yahweh’. Kështu engjëlli barti emrin Yahweh, dhe, kështu, mund të quhej ‘Yahweh’, ose ‘ZOTI,’ me gërma të vogla kapitale, siç përkthehet fjala ‘Yahweh’ në N.I.V. dhe A.V. Në Dal. 33:20 na thuhet që askush nuk mund ta shohë fytyrën e Perëndisë dhe të jetojë; por në Dal. 33:11, lexojmë që “ZOTI (Yahweh) i foli Moisiut ballë për ballë, siç i flet dikush një shokut të vet” – d.m.th. në mënyrë të drejtpërdrejtë. Nuk mund të kishte qenë ZOTI, Yahweg, Vetë Ai si person, që i foli Moisiut ballë për ballë, sepse askush nuk mund ta shohë Vetë Perëndinë. Ishte engjëlli që bartte emrin e Perëndisë që e bëri këtë; dhe kështu lexojmë që ZOTI foli ballë për ballë me Moisiun kur në fakt ishte një engjëll që e bëri këtë (Veprat 7:30-33).

Ka shumë shembuj të tjerë kur fjalët ‘Perëndi’ dhe ‘ZOT’ i referohen engjëjve dhe jo Vetë Perëndisë. Një shembull i qartë është Zan. 1:26: “Dhe Perëndia (engjëjt) tha, Ta bëjmë njeriun sipas shëmbëllimit tonë.”

NJERËZ ME EMRIN E PERËNDISË

Një prej pasazheve më të dobishme për ta demonstruar të gjithë këtë është Gjoni 10:34-36. Këtu çifutët bënë gabimin që e bëjnë shumë vetë sot. Ata menduan që Jezusi ishte Vetë Perëndia. Jezusi i korrigjoi duke thënë, “A nuk është shkruar në ligjin tuaj, Unë ju thashë, Ju jeni perëndi? Nëse Ai i quajti ata ‘perëndi’ ... si mund të thoni ju që (unë) ... ‘Ti blasfemon’ sepse unë thashë, Unë jam Biri i Perëndisë?” Jezusi në fakt është duke thënë ‘Në Dhiatën e Vjetër njerëzit quhen ‘perëndi’; unë po them që unë jam *Biri* i Perëndisë; atëhere, përse inatoseni kaq shumë?’ Në fakt, Jezusi është duke cituar nga Psalmi 82, ku gjyqtarët e Izraelit quheshin ‘perëndi.’ Siç është treguar, emri i plotë i Perëndisë në hebraisht është ‘Yahweh Elohim’ – që nënkupton “Ai që do të shfaqet në një grup të fuqishmish.” Besimtarët e vërtetë janë ata në të cilët Perëndia shfaqet në një kuptim të kufizuar në këtë jetë. Megjithatë, në Mbretërinë, ata do të jenë ‘të fuqishmit’ në të cilët do të manifestohet plotësisht ZOTI. E gjithë kjo tregohet boll bukur në krahasimin e Jesh. 64:4 dhe 1 Kor. 2:9. “Askush nuk ka parë e nuk ka dëgjuar të flitet, O Perëndi, përveç Teje, atë që bën vepra të tilla për ata që varin shpresat tek ai.” Pali e citon këtë në 1 Kor. 2:9,10: “Është shkruar, atë që Syri nuk e ka parë, as dëgjuar, as që ka hyrë në zemrën e njeriut, atë gjë Perëndia e përgatiti për ata që e duan Atë. Por, Perëndia na ia ka bërë të njohura përmes Shpirtit të Tij.” Pasazhi në Jesh. 64 thotë që asnjë veç

Perëndisë nuk mund t'i kuptojë gjërat që Ai ka përgatitur për besimtarët. Megjithatë, 1 Kor. 2:10 thotë që ato gjëra na janë bërë të njohura.

JEZUSI DHE EMRI I PERËNDISË

Nuk është çudi që Jezusi, Biri i Perëndisë dhe manifestimi i Tij suprem para njerëzve, gjithashtu të mbajë emrin e Perëndisë. Ai mund të thoshte “Unë kam ardhur në emër të Atit tim” (Gjn. 5:43). Për shkak të bindjes së tij, Jezusi u ngjit në qiell dhe Perëndia “i dha atij emrin që qëndron mbi çdo emër.” – emrin e Yahweh, të Vetë Perëndisë (Fil. 2:9). Pra, prandaj ne lexojmë që Jezusi thotë në Ap. 3:12: “Unë do të shkruaj mbi të (besimtarin) emrin e Perëndisë sim... dhe do të shkruaj mbi të emrin tim të ri.” Në kohën e gjykimit, Jezusi do të na japë neve emrin e Perëndisë; paskëtaj, ne do të bartim emrin e Perëndisë. Këtë emër ai e quan “Emri im i ri.” Kujtoni, Jezusi e dha librin e Apokalipsit (zbulesës) disa vjet pas ngjitjes së tij në qiell dhe pasi atij i qe dhënë emri i Perëndisë, siç shpjegohet në Fil. 2:9. Prandaj ai mund ta quajë emrin e Perëndisë “Emri im i ri;” emri që i qe dhënë paradokohësh. Tani ne mund ta kuptojmë siç duhet Jesh. 9:6, ku në lidhje me Jezusin na thuhet, “*Emri* i tij (vëreni) do të quhet I Mrekullueshëm, Këshillues, Perëndia i fuqishëm, Ati i përjetshëm...”. Kjo është një profeci që Jezusi do të bartte *të gjithë* emrin e Perëndisë – që ai do të ishte manifestimi apo zbulesa totale e Perëndisë para nesh. Pikërisht në këtë kuptim, ai quhej ‘Emanuel,’ që do të thotë, ‘Perëndia është me ne,’ megjithëse personalisht Ai nuk ishte Perëndia. Kështu, profecia e Joel 2 që njerëzit do të thërrisnin për ndihmë emrin Yahweh u përmbush me njerëzit që pagëzoheshin në emrin e Jezu Krishtit (Veprat 2:21 krahaso 38). Kjo shpjegon gjithashtu se pse urdhri për pagëzim në emrin e Atit u përmbush, siç jepet me hollësi në shkrimet e Veprave, nga pagëzimi në emrin e Jezusit.

Digresion 4: A është Shpirti i Shenjtë një Person?

Studimet 2.1 dhe 2.2 kanë dhënë fakte të bollshme që shpirti i Perëndisë i referohet fuqisë së Tij, e cila pasqyron “mendjen” e Tij në një mënyrë shumë të gjerë. Meqenëse mënyra në të cilën shpirti i Perëndisë vepron është një pasqyrim aq i saktë i thelbit dhe personalitetit të Perëndisë, disa kanë pohuar se shpirti i Perëndisë është një person që gjithashtu është Perëndi. Një rilexim i kujdesshëm i seksioneve të mëparshme do të tregonte që shpirti i Perëndisë është mendja dhe fuqia e Tij. Elektriciteti është një

fuqi e paparë që mund të prodhojë rezultate për personin që e kontrollon atë, por nuk mund të jetë një person. Dashuria është pjesë e karakterit të dikujt, por nuk mund të jetë një person. Shpirti i Perëndisë përfshin dashurinë e Tij, si pjesë e karakterit të Tij, si dhe i referohet edhe fuqisë së Tij, por në asnjë mënyrë nuk mund t'i referohet një personi që është i veçantë nga Ai.

Megjithëse e qartë dhe e dukshme, kjo pikëpamje e gabuar (që shpirti është një person) besohet nga shumica e 'kristianëve,' duke parë që ata besojnë në doktrinën e 'trinisë.' Kjo doktrinë shpreh qartë që ka tri perëndi që janë çuditshëm edhe të njëjtë – Perëndia Ati, Shpirti i Shenjtë dhe Jezusi.

Ka arsye të bollshme për të besuar që 'trinia' ishte në themel një ide pagane e importuar në kristianizëm – prandaj fjala nuk shfaqet në Bibël. Nëse e pranojmë këtë ide që Perëndia është një trini, atëherë shtyhem të arrijmë përfundimin që disi, fuqia/shpirti i Perëndisë është një person, i cili është gjithashtu Perëndi, megjithëse jo Perëndia Ati. Kur përballen me alogjikshmërinë e pozicionit të tyre, rruga më zakonshme e shpëtimit për njerëz të tillë është që këta pretendojnë që Perëndia është një mister dhe se ne duhet t'i pranojmë gjëra të tilla në besim pa kërkuar shpjegim logjik. Një gjë e tillë neglizhon plotësisht referencat që i bëhen në Dhiatën e Re misterit të Perëndisë që zbulohet përmes fjalës dhe veprës së Krishtit.

- “Nuk do t’ju lija, vëllezër, që të mbeteshit në padije të këtij misteri” (Rom. 11:25).
- “Lajmi për Jezusin...zbulimi i misterit” (Rom. 16:25).
- “Tani ju them (shpjegoj) juve një mister (të fshehtë)...” (1 Kor. 15:51).
- “Pasi na bëri të ditur neve të fshehtën e vullnetit të tij” (Ef. 1:9; 3:3).
- Predikimi i Palit ishte “të bënte të njohur të fshehtën e Ungjillit” (Ef. 6:19; Kol. 4:3).
- “E fshehta...tani i manifestohet shenjtëve të tij” (Kol. 1:26,27).

Me gjithë këtë theksim – dhe vërtet ka të tillë – mbi faktin që tani nuk ka ndonjë mister lidhur me doktrinat themelore, vetëm dikush që është ende në errësirë do të pretendonte se ka. Dhe a nuk e vret mendjen një person i tillë që emri i Biblës për “Babiloninë,” sistemin e fesë së rreme përshkruar në Apokalipsin (Zbulesa), është “Misteri” (Ap. 17:5)? Nënkuptimi i dukshëm është që ky sistem deklaron që besimet e tij janë një mister; por besimtarët e vërtetë e kuptojnë misterin e asaj gruaje Ap. 17:7).

Sigurisht, arsyetim kaq i turbullt duhet pritur prej atyre që e bazojnë të kuptuarit e tyre të Perëndisë mbi gjëra të tilla subjektive si përvoja njerëzore, apo veprimtaria e mjegullt, e papërcaktuar e ndonjë force të jashtme shpirtërore mbi mendjet e tyre. Nëse duhet të jemi vërtet të përlulur para mësimit të Fjalës së Perëndisë, si rrjedhojë del që gjithashtu na

kërkohej të përdorim fuqitë bazë të arsytimit dhe deduksionit me qëllim që të zbulojmë mesazhin e saj.

Kurrë nuk doli ndonjë predikues i Ungjillit, regjistruar në Bibël, që të arrinte të thoshte, ‘Kjo është një mister total, nuk mund të filloni ta kuptoni atë.’

Përkundrazi, lexojmë që ata u bëjnë thirrje këtyre njerëzve përmes arsyes dhe duke nxjerrë përfundime logjike nga Shkrimi i Shenjtë.

Në këtë predikim të llojit të themeleve të Ungjillit që po shqyrtojmë në këto Studime, Pali “u tregoi, në bazë të Shkrimit të Shenjtë, duke treguar e aluduar, se si Krishti duhej të vuante, të vdiste dhe të ngrihej përsëri nga të vdekurit” (Veprat 17:2,3). Këtu kishte një arsytim sistematik, logjik të Biblës par excellence; dhe shkrimet e regjistruara para kësaj fjalie thonë, “Pali, siç e kishte zakon...arsyeto...” Për rrjedhojë, ky ishte stili i tij i zakonshëm (shih gjithashtu edhe Veprat 18:19). Në përputhje me këtë, gjatë fushatës së madhe në Korint, Pali “arsyeto në sinagog çdo të shtunë, dhe i detyroi çifutët...(por) kur ata kundërshtuan veten...” (Veprat 18:4-6). Ata që u konvertuan kaluan një proces detyrimi përmes të arsyetuarit të Palit bazuar tek Bibla; këtu nuk pati asnjë ‘imazh i Jezusit në dhomën time,’ ‘një ndjenjë e papërshkrueshme më mbizotëroi,’ ‘Zotin e takova thjesht një mbrëmje.’

Vëreni, gjithashtu, që shkrimet e frymëzuara i bëjnë thirrje logjikës dhe racionalizmit, duke vënë në dukje që ata “kundërshtuan veten.” Po kështu në Antiok, Pali dhe Barnaba “duke u folur (fjalën) atyre, i bindën...” (Veprat 13:43). Ndajësia tjetër e tyre ishte Ikoni, ku ata “folën aq bindshëm sa një shumicë e madhe...i besuan” (Veprat 14:1).

Tek doli në gjyq për jetën e tij pak më vonë, e njëjta logjikë e lavdishme vazhdoi të frymëzonte shpresën e sigurtë të Palit për të ardhmen: “Ai arsyeto për drejtësinë, vetëkontrollin dhe gjykimin që do të vinin” me qartësi kaq zhbiruese sa edhe gjyqtari i tij cinik, i shkujdesur “u drodh” (Veprat 24:25).

Meqenëse konvertimi ynë duhet të bazohet mbi një proces të tillë arsytimi, duhet të jemi në gjendje të japim një shpjegim logjik biblik të shpresës dhe doktrinës sonë.

“Qëndroni gjithnjë gati t’i jepni përgjigje gjithsecilit që ju kërkon arsyen e shpresës që është brenda jush” (1 Pjt. 3:15).

Të flasësh me zë të kthjellët mbi përvojat personale nuk do të thotë të japësh një arsye për shpresën e Ungjillit. Mbështetja e vazhdueshme në ‘dëshminë personale’ si mjet për t’u predikuar shumë kristianëve ‘evangelistë’, shënon mungesën e “përgjigjes së arsyetuar” për “shpresën” e tyre. Midis kristianëve të tillë ka lindur një fjalor i tërë për t’i dhënë mundësi atyre të

‘ndajnë atë që Zoti ka bërë në jetën time’ etj. Anekdotat të tilla vetjake janë në kundërshti të mprehtë me fjalët e Palit: “Ne nuk predikojmë veten tonë, por Krishtin” (2 Kor. 4:5) – dhe nga një njeri që ‘kishte një marrëdhënie personale me Jezusin’ më shumë se shumica e të tjerëve.

Mënyra logjike, biblikisht e arsyeshme e konvertimit tonë duhet të përcaktojë modelin për marrëdhënien tonë më të gjerë me Perëndinë nëpër ditët që na kanë mbetur. Si gjithmonë, shembujt tanë, janë kristianët e parë që përdorën “arsyen” për të kuptuar zgjidhjet për problemet e tyre të administrimit (Veprat 6:2). Letrat e Dhiatës së Re gjithashtu supozojnë që lexuesit e tyre të pranojnë përdorimin e logjikës biblike. Kështu “sipas arsyes së” asaj se si ishin Priftërinjtë e Lartë nën Ligjin e Moisiut, mund të kuptojmë hollësitë mbi punën e Krishtit (Heb. 5:3). Duke folur për dashurinë zotëruese të Perëndisë në Krishtin, Pali nxit që është “shërbimi juaj i arsyeshëm (greqisht ‘logikos’ – d.m.th. logjik)” që t’ia dedikojmë veten totalisht Atij si përgjigje (Rom. 12:1). Fjala ‘logikos’ rrjedh nga greqishtja ‘logos,’ e cila është fjala e përkthyer normalisht “fjala” duke iu referuar Fjalës së Perëndisë. Përgjigja jonë “logjike” në terma biblikë, për rrjedhje, është ajo që rrjedh nga Fjala e Perëndisë.

Nëse nuk mund të nxjerrim përfundime logjike nga Shkrimi i Shenjtë, atëherë i gjithë studimi i Biblës, është i kotë dhe nuk ka nevojë për Biblën, e cila mund të trajtohet thjesht si banalitet të ëmbla apo si letërsi fantastike. E tillë duket të jetë në raftet e librave të shumë kristianëve.

Megjithatë, për të thënë të vërtetën, disa që besojnë që shpirti i Perëndisë është një person, vërtet përpiqen të japin arsye të bazuara në Bibël. Vargjet e cituara janë ato që flasin për shpirtin e Perëndisë në gjuhë personale, p.sh. si “ngushëlluesi” në Gjn. 14-16, apo referencat që i bëhen shpirtit që “hidhërohet.”

Në studimin 4.3 demonstrojmë që “shpirti” i një njeriu mund të ngacmohet (Veprat 17:16), të bëhet i trazuar (Zan. 41:8) apo i gëzuar (Lk. 10:21). “Shpirti” i tij, pra, pikërisht për thelbin e tij, mendjen e qëllimin e tij, të cilat janë shtytje për veprimet e tij, flitet si për një person të veçantë, por, sigurisht, nuk është fjalëpërfjalë kështu. Edhe për shpirtin e Perëndisë mund të flitet në të njëjtën mënyrë.

Gjithashtu duhet kuptuar që shpesh Bibla përdor gjuhën e personifikimit kur flet për gjëra abstrakte, p.sh., mençurisë i referohet si një gruaje në Prov. 9:1. Kjo bëhet për të na demonstruar ne se si do të ishte në praktikë një person i mençur; ‘mençuria’ nuk mund të ekzistojë veçse në mendjen e dikujt, dhe prandaj përdoret ky mjet i personifikimit. Për më shumë mbi këtë, shihni Digresion 5, “Parimi i Personifikimit.”

Letrat e Palit përmbajnë salutime hyrjeje që i referohen Perëndisë dhe Jezusit, por jo Shpirtit të Shenjtë (Rom. 1:7; 1 Kor. 1:3; 2 Kor. 1:2; Gal. 1:3; Ef. 1:2; Fil. 1:2; Kol. 1:2; 1 Sel. 1:1; 2 Sel. 1:2; 1 Tim. 1:2; 2 Tim. 1:2; Tit. 1:4; Filemon 3). Kjo është e çuditshme nëse e konsideronte Shpirtin e Shenjtë të ishte pjesë e një hyjnie, siç supozon në mënyrë të gabuar doktrina e ‘trinisë.’ *Një pjesë* e Shpirtit të Shenjtë u derdh mbi njerëzit (Veprat 2:17,18; i njëjti ndërtim në greqisht gjendet në Mk. 12:2; Lk. 6:13; Gjn. 21:10 dhe Veprat 5:2). Si mund të na jepet një pjesë e një personi? Na jepet “nga shpirti i Tij [i Perëndisë] (1 Gjn. 4:13). Kjo do të ishte budallallëk nëse Shpirti i Shenjtë është një person. Një tjetër gjë që e fundos fare propozimin se Shpirti i Shenjtë është një person është fakti që Shpirti i Shenjtë është përshkruar në tekstin greqisht me gjini asnjënjë (siç pasqyrohet në AV të 1 Gjn. 2:27, ku quhet “ai/ajo” [*shën. i pëkth. fjala e përdorur në anglisht është një përemër asnjënjës, pa gjini.*]). Kjo do të thotë që kur lexojmë pasazhe që flasin për Shpirtin e Shenjtë si “ai,” ajo që kemi përpara është një personifikim i pushtetit, jo referim ndaj një personi faktik.

Digresion 5: Parimi i Personifikimit

Disa e gjejnë të vështirë të pranojnë shpjegimin e personifikimit të djallit sepse atij i referohet aq shpesh në Bibël sikur të ishte person dhe ndoshta kjo i ngatërron disa njerëz. Kjo shpjegohet lehtësisht duke vënë në dukje që një veçori e pranuar e Biblës është që gjërat e pashpirt apo jo të gjalla si mençuria, pasuria, mëkati, kisha janë të personifikuara, por vetëm në rastin e djallit thuret një teori fantastike. Shembujt e mëposhtëm do ta ilustrojnë këtë fakt.

MENÇURIA ËSHTË E PERSONIFIKUAR

“Sa i lumtur është njeriu që ka gjetur urtësi dhe ka fituar njohuri. Të kesh urtësi është më mirë se të kesh argjend; është më i vlefshëm se të kesh ar të kulluar. Ajo është më e çmueshme se gurët e çmuar; asgjë që mund të dëshirohet nuk mund të krahasohet me të” (Fu. 3:13-15).

“Urtësia ka ndërtuar shtëpinë e saj, ajo ka ngritur shtatë shtyllat e saj” (Fu. 9:1).

Këto vargje, e në të vërtetë, pjesa tjetër e kapitujve ku shfaqen ato, tregojnë që urtësia personifikohet si një grua, por për shkak të kësaj, askush nuk ka idenë që urtësia është një grua e bukur e zakonshme që sillet për qark tokës;

të gjithë pranojnë që është një karakteristikë shumë e dëshirueshme që të gjithë njerëzit duhet të përpiqen ta përftojnë.

PASURITË PERSONIFIKOHEN

“Askush nuk mund t’i shërbejë dy *zotërinjve*: Ose do të do të njërin, ose do të urrejë tjetrin; ose përndryshe, njërit do t’i qëndrojë besnik dhe tjetrin do ta mashtrtojë. Nuk mund t’u shërbeni edhe Perëndisë edhe parasë.” (Mt. 6:24).

Këtu, pasuritë përqasen me një *zotëri*. Shumë njerëz përpiqen shumë fort për të fituar të mira dhe në këtë mënyrë bëhen zotërinjtë e tyre. Këtu Jezusi na thotë se nuk mund ta bëjmë këtë dhe t’i shërbejmë Perëndisë pranueshëm në të njëjtën kohë. Ky mësim është i thjeshtë dhe i efektshëm, por askush nuk supozon nga kjo se të mirat janë një njeri me emrin para.

MËKATI PERSONIFIKOHET

“...Kushdo që kryen mëkat, është shërbëtor i mëkatit” (Gjn. 8:34). “Fuqia e mëkatit *njihet* nga vdekja” (Rom. 5:21). “A nuk e dini që, *atij* të cilit i nënshtroheni si skllëvër, atë duhet edhe ta dëgjoni. Ose viheni në anën e mëkatit dhe vdsini, ose në anën e bindjes dhe bindja ju sjell shpëtim” (Rom. 6:16).

Si në rastin e pasurive, mëkati këtu i përqaset një zotërie dhe ata që kryejnë mëkat janë shërbëtorë të tij. Asnjë të lexuar i arsyeshëm i pasazhit nuk do të justifikonte supozimin se Pali jep mësimin se mëkati është një person.

SHPIRTI PERSONIFIKOHET

“Kur *ai*, shpirti i së vërtetës, të ketë ardhur, *ai* do t’ju udhëheqë drejt gjithë së vërtetës: sepse atë që do t’ju thotë, *ai* nuk do ta marrë prej *vetes së tij*...” (Gjn. 16:13).

Këtu, Jezusi po u thotë dishepujve të tij se do të merrnin fuqinë e Shpirtit të Shenjtë, dhe kjo u përmbush në ditën e Rrëshajëve, siç është regjistruar në Veprat 2:3-4, ku pohohet se “u duk diçka si zjarr që u nda si gjuhë flake. Të gjithë u mbushën me Shpirtin e Shenjtë,” çka u dha atyre fuqi mbresëlënëse për të bërë gjëra të mrekullueshme, për të provuar se autoriteti i tyre ishte nga Perëndia. Shpirti i Shenjtë nuk ishte një person, ishte një fuqi, por kur Jezusi fliste për të, Ai përdori përemrin vetor “ai.”

VDEKJA PERSONIFIKOHET

“Pashë një kalë verdhacak: dhe emri i kalorësit ishte Vdekje”
(Ap. 6:8).

KOMBI I IZRAELIT PERSONIFIKOHET

“Do të të jap një fillim të ri, do të të rindërtoj, *O Izrael i virgjër*; përsëri do të zbkurohesh nga dajret...” (Jir. 31:4).
“Kam dëgjuar mirë se si ankohet *vetë* Efraimi; Ti më ke goditur, dhe u godita si një ka i ri kryeneç; na lejo të kthehemi tek ti sepse ti je Zoti Perëndia im” (Jir. 31:18).

Konteksti i këtyre pasazheve zbulon qartë që profeti nuk i referohet një virgjëreshe në kuptimin e thjeshtë të fjalës apo Efraimit si një person, por kombit të Izraelit, i cili në këtë rast është personifikuar, në të njëjtën mënyrë si personifikohet Britania e Madhe si “Britannia” ose ‘Xhon Bull.’ Persona të tillë si kjo grua e si ky burrë nuk ekzistojnë, por kur u referohet në libra apo kur portretizohen në piktura, kushdo e di që ajo që nënkuptohet është Britania e Madhe.

BESIMTARËT NË KRISHT JANË PERSONIFIKUAR

“Derisa t’ia arrijmë njësisë në fe; kuptimit më të thellë të Birit të Perëndisë, një *njeri i përkryer*, si plotësues i nevojave të bashkësisë dhe pjekurisë që i përket Krishtit” (Ef. 4:13). “Ka vetëm një *trup*” (Ef. 4:4). “Ju të gjithë sëbashku jeni *trupit i Krishtit*, anëtarë të veçantë” (1 Kor. 12:27). “...Krishti është kreu i bashkësisë: Ai është shpëtimtari i *trupit*” (Ef. 5:23). “Ai (Krishti) është kreu i *trupit*, bashkësisë;...që tani jam i gëzuar për vuajtjet e mia për ju, duke plotësuar vuajtjet që duhen vuajtur për shkak të lidhjes me Krishtin për hir të *trupit* të tij, i cili është bashkësia” (Kol. 1:18,24). “Ju fejova me një djalë të vetëm, që t’ju sjell tek Krishti si një I have espoused you to one husband, that I may present you as a *virgjëreshë të paprekur*” (2 Kor. 11:2). “...erdhi dasma e Qingjit, dhe *nusja e tij* është përgatitur” (Ap. 19:7).

Të gjitha këto vargje i referohen qartë bashkësisë së njerëzve që ishin besimtarë të vërtetë në Krisht, të cilëve shpesh u referohet me fjalën “kisha,” megjithëse kjo nuk duhet ngatërruar me asnjërën prej kishave aktuale ortodokse, të cilat kanë shumë e shumë kohë që kanë pushuar së qeni besimtarë të vërtetë në Krisht.

Besimtarët e vërtetë, domethënë, ata që i mbajnë dhe i besojnë doktrinat e vërteta që mësohen në Bibël, u referohet si “virgjëresha të pastra,” duke nënkuptuar pastërtinë e jetës që duhet të bëjnë, dhe si një “trup,” një figurë e përshtatshme sepse ashtu si një trup i natyrshëm ka shumë funksione, ashtu dhe kisha e vërtetë ka shumë përgjegjësi dhe përmbush funksione të ndryshme. Kur kishës i referohet si një “trup,” askush nuk e ngatërro me ndonjë individ, askush nuk do të ngatërronte djallin apo satanain me një monstër groteske apo një engjell të rrëzuar nëse fjalët do të ishin përkthyer siç duhet, apo nëse burrat e gratë nuk do të kishin përfutur ide të gabuara që rrjedhin nga kishat e rreme në kohët që kanë kaluar. Adoptuar nga “*Krishtërimi në Rrugë të Gabuar*” nga Robert Roberts¹.

Digresion 6: Kalvinizmi

Disa qindra vjet më parë, Kalvini theksonte idenë se kishte një paradestininim të jetëve tona. Përmes kësaj, ai nënkuptonte që vendimet tona me vullnet të lirë nuk kanë asnjë ndikim mbi shpëtimin tonë; ose jemi të paradestinuuar për shpëtim ose për refuzim. Ky nocion është rishfaqur në ide të ndryshme moderne:

- Që nuk ka kuptim të bësh një përpjekje të madhe për të studiuar Biblën apo për fenë, sepse nëse është e thënë të shpëtohem, atëherë, pavarësisht, do të shpëtohem.
 - Që ka një qenie të quajtur djall, i cili na detyron të mëkatojmë dhe sjell probleme në jetët tona pavarësisht nga vullneti ynë. Ky nocion i rremë diskutohet në Studimin 6.
 - Që nuk ka nevojë të kërkosh përkujdesjen e Perëndisë në situatat e jetës, p.sh. për siguri gjatë udhëtimit, sepse çdo gjë është, gjithsesi, e paradestinuuar. Bota ka një thënie, që shpesh dëgjohet në sallat e ikjes në aeroporte, ‘Nëse numri yt ka për të dalë, do të dalë.’
 - Kishat evangjeliste mësojnë që është e pamundur të besosh apo kuptosh Biblën nëse Shpirti i Shenjtë nuk na bën ta bëjmë këtë.
- Ka shumë arsye të shëndosha biblike për ta refuzuar këtë lloj filozofie.
- E shndërron në budallallëk tërë konceptin e bindjes para Perëndisë. Në Bibël na thuhet shpesh që duhet të zbatojmë urdhëresat e Perëndisë, dhe duke bërë këtë mund t’i japim Atij kënaqësi apo moskënaqësi. Ky

¹ Megjithëse është shkruar në gjuhën angleze të shekullit të 19të, ky libër është i pashoq, sipas mendimit të autorit, si një deklaratë e qartë e së Vërtetës Biblike bazë, në dallim nga mitet e Krishtërimin. Botuesit vënë në dispozicion kopje.

koncept i urdhëresave është i pakuptimtë nëse na detyron Perëndia të jemi të bindur. Krishti ofron shpëtim “të gjithë atyre që i binden atij” (Heb. 5:9).

- Hebrejve 11 tregon që ndërhyrja e Perëndisë në jetët tona dhe akordimi përfundimtar i shpëtimit ka lidhje me besimin tonë. Shembujt e shumtë biblikë të lutjes ndaj Perëndisë për shpëtim në kohë trazire nuk kanë kurrfarë kuptimi nëse çdo gjë do të ishte e paradestinuuar. Po kështu, shndërrohet në të pakuptimtë edhe ideja që shpëtimi është rezultat i besimit tonë në Krisht.
- Pagëzimi është një parakusht i shpëtimit (Mk. 16:16; Gjn. 3:3-5). Kjo mohohet nga kalvinistët. Megjithatë, shpëtimi u bë i mundur me anë të punës së Krishtit (2 Tim. 1:10), jo përmes konceptit abstrakt të paradestinitimit. Ne duhet të zgjedhim në mënyrë të ndërgjegjshme që të shoqërohemi me Të, çka e bëjmë përmes pagëzimit. Romakëve 6:15-17 na flet për ndërrimin e zotërinjve në pagëzim, nga një jetë mëkatore, në një jetë bindjeje. “Ju jeni shërbëtorë të atij të cilit ia jepni veten si shërbëtorë të bindur.” Kjo gjuhë e dhënies së vetes nënkupton qartë vullnetin e lirë në krahasim me paradestininimin e pakushtëzuar. Dhënia bëhet përmes bindjes nga zemra ndaj doktrinave të Ungjillit (Rom. 6:17).
- Nuk ka kuptim që Perëndia të flasë fjalën e Tij, nëse gjithsesi jemi të paradestinuuar. Gjithashtu nuk ka kuptim të predikohet; megjithatë Bibla, si në urdhëresa ashtu dhe përmes regjistrimit të shembujve të kësaj, tregon se përmes predikimit të fjalës, burrat e gratë arrijnë tek shpëtimi “Lajmi i ... shpëtimit” (Veprat 13:26) duhet të shkojë tek njerëzit.
- Do të gjykohehi sipas veprimeve tona (Ap. 22:12). Pse, nëse veprimet tona me vullnet të lirë janë të parëndësishme në lidhje me shpëtimin? Pali tha se çifutët e gjykonin veten të padenjë për jetën e përjetshme përmes refuzimit të fjalës së Perëndisë (Veprat 13:46). Ata po gjykonin veten – nuk i pengonte Perëndia. Nëse themi që Perëndia paradestinion disa njerëz për shpëtim e të tjerë për dënim, atëherë Perëndia në fakt i detyron njerëzit të jenë mëkatarë, ashtu si supozohet se i detyron njerëzit të jenë të pastër. Për shkak të mëkatit të Adamit, “vdekja u përçoll tek të gjithë njerëzit, sepse të gjithë kanë mëkatuar për këtë shkak” (Rom. 5:12). Prandaj njerëzit vdesin, si ndëshkim për mëkatit (Rom. 6:23), jo ngaqë Perëndia i ka detyruar të jenë mëkatarë në një moment të caktuar kohe përpara mëkatit të Adamit.
- 1 Kor. 10 dhe shumë pasazhe të tjera paraqesin shembullin e atyre në të kaluarën që dikur kishin një marrëdhënie me Perëndinë, por pastaj

mbaruan, duke qenë si paralajmërimet ndaj besimtarëve. Fakti që është e mundur të 'humbësh marrëdhënien' (Gal. 5:4) do të thotë që nuk mund të ekzistojë një sistem shpëtimi si ai që kërkohet nga kalvinizmi, sipas të cilit 'nëse ke shpëtuar një herë, ke shpëtuar gjithmonë.' Vetëm duke zbatuar doktrinën e vërtetë mund të shpëtohem (1 Tim. 4:16).

- Jezusi mësonte qartë se të kuptuarit e fjalës së Perëndisë varet në një farë shkalle nga përpjekja e vullnetit tonë të lirë. "Kush lexon këtë, le të kuptojë" (Mt. 24:15). Kështu, lëmë veten të kuptojë fjalën – nuk detyrohemi. Ekziston një paralele midis kësaj dhe fjalëve të përsëritura shpesh të Jezusit: "Kush ka vesh të dëgjojë...le të dëgjojë," ose të kuptojë. Pasja e veshëve, për rrjedhojë, do të thotë të lexosh fjalën e Perëndisë. Meqenëse shpirti i Perëndisë është manifestuar me atë supremaci përmes fjalës së Tij sa Jezusi mund të thoshte që fjalët e Tij të frymëzuara "janë shpirti" (Gjn. 6:63), atëherë është e pamundur që shpirti i Perëndisë të funksiononte mbi një njeri, veçmas fjalës së Tij, me qëllim që ta detyronte atë njeri t'i bindej fjalës.
- "Kush do të" mund "ta pijë ujin e jetës falas" (Ap. 22:17), duke i dhënë përgjigje fjalës së jetës që gjendet në Ungjill. Sigurisht, këtu kemi të bëjmë me vullnet të lirë se sa me paradestininim pavarësisht nga dëshira jonë personale për shpëtim. Po kështu, Veprat 2:21: "Kushdo që do të marrë anën e Zotit, do të shpëtohet" duke u pagëzuar në atë emër.

Digresion 7: "Do të Merrni Dhuratën e Shpirtit të Shenjtë" (Veprat 2:38)

Pjetri iu drejtua turmës së madhe në festën e Rrëshajëve duke përfunduar me vargun 38 për t'u penduar, pagëzuar dhe për të marrë dhuratën e Shpirtit të Shenjtë. Kjo referencë ndaj një dhurate prej Perëndisë është në kontekstin e përdorimit prej apostujve të dhuratave të shpirtit duke folur para turmës. Ata shpjegojnë se duke bërë këtë, ofronin një përmbushje të profecisë së Joelit mbi dhënien e dhuratave të mrekullueshme (Veprat 2:16-20). Turma përbëhej nga çifutë, jo joçifutë (Veprat 2:5). Profecia e Joelit për dhënien e dhuratave në radhë të parë kishte të bënte me çifutët. Kështu Pjetri argumenton para tyre: "Ky premtim është për ju, dhe për fëmijët tuaj." Këtu mund të ketë një shenjë që premtimi i dhuratave përmes mrekullive ishte vetëm për ato dy breza – ato që po dëgjonin Pjetrin dhe fëmijët e tyre. Kemi treguar që nga fundi i shekullit të parë (d.m.th. rreth 70 vjet pas fjalimit të Pjetrit), dhuratat kishin marrë fund. Kjo konfirmohet edhe nga arkivat e historisë. Gjatë kohës së atyre dy brezave, dhuratat e shpirtit do të kishin qenë edhe në dispozicion të joçifutëve: "Dhe të gjithë ata që janë

tepër larg, të gjithë që Zoti Perëndia ynë do t'i thërrasë" (Veprat 2:39). Vëreni si përshkruhen të pafetë si "ata që janë tepër larg" tek Ef. 2:14-17. Megjithatë, ka boll arsye për të besuar që ajo që ndodhi në Veprat 2 ishte veçse një përmbushje e vogël e atyre fjalëve të Joel 2. Përmbushja madhore do të jetë kur Izraeli të jetë pushtuar dhe ushtria sulmuese të jetë shkatërruar (Joeli 2:20), dhe kur Izraeli të jetë penduar të jetojë në shoqëri të lumtur me Perëndinë (Joel 2:27). "Dhe do të ndodhë më pas (d.m.th. paskëtaj), që unë do të derdh shpirtin tim..." (Joel 2:28). Deri sa të jenë parë ato parakushte ne nuk mund të shohim për ndonjë përmbushje tjetër të fjalëve të Joelit, përveç asaj përmbushjes së vogël që u pa në ditën e Rrëshajëve siç përshkruhet në Veprat 2.

Premtimi për të marrë dhuratën e shpirtit pas pagëzimit, mund të lexohet ende me njëfarë referimi ndaj nesh sot. Ka një shpirt, por mund të shfaqet në rrugë të ndryshme (1 Kor. 12:4-7; Ef. 4:4). Në shekullin e parë, kjo ishte e mundur përmes dhuratave nga mrekullitë; tani që ato janë tërhequr është plotësisht legjitime të shihet një përmbushje e këtij premtimi të "dhuratës së shpirtit" në një mënyrë të ndryshme. "Dhurata e Shpirtit të Shenjtë" mund t'i referohet 'dhuratës që është Shpirti i Shenjtë,' ose 'dhuratës për të cilën flet Shpirti i Shenjtë' – d.m.th. dhurata e faljes dhe shpëtimit që ka premtuar fjala e Perëndisë e frymëzuar nga shpirti. Ka plot shembuj të tjerë të këtij përdorimi të fjalës "i" (për të përmendur termin teknik 'gjinorja e paqartë'). "Dija e Perëndisë" (Kol. 1:10) mund të nënkuptojë dijen që ka Perëndia, ose dijen mbi Perëndinë. "Dashuria e Perëndisë" dhe "dashuria e Krishtit" (1 Gjn. 4:9; 3:17; 2 Kor. 5:14) mund të nënkuptojë dashurinë që Perëndia dhe Jezusi kanë për ne; ose dashurinë që ne kemi për ta. "Fjala e Perëndisë" mund të nënkuptojë fjalë mbi Perëndinë, ose fjala që erdhi nga Perëndia. Dhurata "e" Shpirtit të Shenjtë, për rrjedhojë, mund t'i referohet dhuratës që Shpirti i Shenjtë mundëson dhe për të cilën flet, si dhe dhuratës që përbëhet nga fuqitë e Shpirtit të Shenjtë.

DHURATA E SHPIRTIT: FALJA?

Rom. 5:16 dhe 6:23 e përshkruajnë shpëtimin si "dhurata" – duke ftuar krahasimin me "dhuratën" e shpirtit në Veprat 2:38. Me të vërtetë, Veprat 2:39 duket se citon Joel 2:32 në lidhje me shpëtimin si të ishte pikërisht kjo dhurata e shpirtit. Referimi nga Pjetri ndaj dhuratës së premtuar që ishte për ata "shumë larg" aludon Jesh. 57:19: "Paqe (me Perëndinë përmes faljes) atij që është larg." Ef. 2:8 gjithashtu e përshkruan dhuratën si shpëtim, duke thënë "nëpërmjet një shpirti (kësaj dhurate) ne mund të arrijmë tek Ati" (Ef. 2:18). Kjo bëhet edhe më e vlefshme nga fakti që Ef. 2:13-17 gjithashtu aludon për Jesh. 57:19: "Ju që dikur ishit larg, jeni afruar për shkak të gjakut

të Krishtit. Ai është paqja jonë... (i cili) erdhi dhe shpalli pajtimin edhe për ju që ishit larg.” Jesh. 30:1 i dënon çifutët ngaqë kërkojnë lutje në mënyrën e tyre dhe jo përmes dhuratës nga shpirti i Perëndisë: ata “ndjekin plane që nuk kanë të bëjnë me shpirtin tim, dhe shtojnë (në vend që të pakësojnë) mëkatet.” Jesh. 44:3 përshkruan ditën e mëpasme të faljes për Izraelin me fjalë të ngjashme: “Do të derdh... përrrenjtë në tokën tënde të thatë (shpirtërisht të shkretë – Jesh. 53:2): Do të derdh shpirtin Tim mbi farën tënde, dhe bekimin tim mbi pasardhësit e ty.” Bekimi i farës së Abrahamit është në faljen e tyre përmes Krishtit (Veprat 3:25,26) – çka jepet si paralele me derdhjen e shpirtit mbi çifutët. Është e qartë që kjo është gjuha e Joel 2 dhe Veprat 2. Gal. 3:14 e jep të gjithë këtë në gjithë këto fjalë: “Që bekimi i Abrahamit (falja) të mund t’u vijë joçifutëve përmes Jezu Krishtit; që të mund të marrim premtimin e shpirtit.” Kështu, 1 Kor. 6:11 flet për larjen nga mëkatet tona “nga shpirti i Perëndisë sonë.” Tek Romakëve ka një paralelizëm midis nesh që marrim “mëshirën... lavdërimin... shpirtin” (Rom. 1:5; 5:11; 8:15), çka tregon lidhjen midis dhuratës (“mëshira”) dhe faljes që çon në lavdërim. Është e vështirë të theksohet sa duhet se sa shumë Dhiata e Re mbështetet në gjuhën dhe konceptet e Dhiatës së Vjetër, veçanërisht nga pikëpamja e lexuesve në radhë të parë çifutë dhe ndikimit që do të kishin pasur letrat e apostujve. Herë pas here në Pentateuk (pesë librat e parë) dhe tek Joshua, Perëndia premtonte t’u japë tokën popullit të tij – shprehja “toka që Zoti yt Perëndi ta jep ta zotërosh” është e zakonshme. Sipas marrëveshjes së re, tokës i korrespondon shpëtimi; prandaj, është dhurata e Perëndisë në perspektivë, me gjithë faljen e mëkateve që e shoqëron. Gal. 3:2,5 krahaso 3:8-11, jep një paralele midis marrjes së shpirtit me marrjen e bekimeve abrahamicke të shpëtimit e faljes. “Premtimi i shpirtit” (Gal. 3:14) përmendet në kontekstin e premtimeve bërë Abrahamit. Do të dukej se [ashtu si në vende të tjera] Pali e bazon argumentin e tij mbi predikimin e hershëm të Pjetrit.

PJETRI NË VEPRAT 2	PALI NË GALATASVE 3
pagëzuar në emër të Jezu Krishtit	pagëzuar në Krisht
secili prej jush...aq shumë sa	aq sa ju
ju dhe...të gjithëve që janë larg [joçifutë]	as çifutë as grekë [joçifutë]
të gjithë që besuan [dhe u pagëzuan] ishin sëbashku dhe gjërat i kishin sëbashku...me një	ju jeni të gjithë një [përmes pagëzimit në] Krishtin Jezus

marrëveshje...njëjtësinë e zemrës	
kur ata e <i>dëgjuan</i> këtë [u pagëzuan dhe morën premtimin e shpirtit]	ju morët [premtimin e] shpirtit përmes <i>dëgjimit</i> të besimit
premtimi i Shpirtit të Shenjtë...premtimi ju bëhet juve	Tatëherë ju jeni...trashëgimtarë sipas premtimit [bërë Abrahamit]

Kështu, dhurata e premtuar e Shpirtit të Shenjtë duhet kuptuar si premtimi bërë Abrahamit, për falje mbi bazën e pastërtisë së dhënë dhe shpëtimit në Mbretërinë e farës së Tij Zotit Jezus. Në Veprat 3:19, Pjetri u bën thirrje njerëzve të “pendohen...të konvertohen, në mënyrë që mëkatet të shlyhen;” në Veprat 2:38 ai predikon: “Pendohuni...pagëzohuni [krahaso. ‘konvertohuni’]...merrni dhuratën e Shpirtit të Shenjtë.” Kjo ‘dhuratë’ duket se është shlyerja e mëkateve.

Pjetri u kërkoi çifutëve të pendoheshin para se t’u jepej dhurata; kjo do të nënkuptonte lutjet personale. Duket se ka arsye për të besuar që dhurata e shpirtit është një mënyrë për të përshkruar lutjen që merr përgjigje. Dhënia e “gjërave të mira atyre që i kërkojnë” në lutje është njësoj si dhënia (e dhuratës) së Shpirtit të Shenjtë (Mt. 7:11 krahaso Lk. 11:13). Fil.1:19 paralelizon “Lutjen tënde dhe dhënien e shpirtit të Jezu Krishtit.” Në mënyrë të ngjashme, 1 Gjn. 3:24 thotë se ne na jepet shpirti si rezultat i bindjes sonë ndaj urdhërësive; vargu 22 thotë se bindja ndaj tyre çon në përgjigjen për lutjet tona. Kështu, besimi ynë vjen falë dëgjimit të lutjeve tona (1 Gjn. 5:14) si dhe falë pasjes së shpirtit (1 Gjn. 3:21,24; 4:13), duke parë që këto janë shprehje paralele.

Studimi i fjalës greke ‘charis,’ shpesh përkthyer “hir,” do të tregojë që shpesh përdoret me dhuratën e shpirtit.

“Përmes hirit (dhuratës) së Zotit Jezu Krisht do të shpëtohemi të gjithë” (Veprat 15:11). Megjithatë, ideja e “hirit” shpesh lidhet me lutjen që merr përgjigje (p.sh. Dal. 33:12; 34:9; Rgj. 32:5; Ps. 84:11; 2 Kor. 12:9; Heb. 4:16; Ijv. 4:6 krahaso v.3). Zeh. 12:10 flet për ditën e fundit që derdh “shpirtin e mëshirës dhe vajtimit” mbi çifutët. Kjo përmbledh atë që po sugjerojmë – që lutjet (“vajtimet”) sjellin dhuratën e shpirtit në kuptimin e faljes, dhe se shembulli i kësaj dhënieje të shpirtit në përgjigje të lutjes jepet në pendimin e çifutëve shekullin e parë dhe ditët e fundit. Në të njëjtin kontekst, Pali flet për, “Dhuratat dhe thirrjet e Perëndisë” për pendim dhe falje (Rom. 11:29).

NGUSHËLLUESI

E njëjta përjasje mund të përdoret edhe ndaj premtimit të Ngushëlluesit në kapitujt 14 dhe 16 të Gjonit. Së pari, kjo i referohej fuqive të mrekullueshme

dhënë dishepujve, të cilëve iu bë së pari premtimi, dhe mund të përdoret edhe ndaj nesh jo në kuptimin e mrekullisë. Dhuratat do të “kujtonin gjithçka që ju kam thënë” (Gjn. 14:26), më e mundur do të ishte me qëllim shkrimin e regjistrimit të Ungjillit. Fjala “kujtoj” në vetvete e kufizon elementin e mrekullisë së Ngushëlluesit ndaj dishepujve, të cilët kishin jetuar me Jezusin gjatë shërbimit të tij. Vetëm atyre mund t’u kujtoheshin (silleshin në mend) fjalët e Jezusit nga Ngushëlluesi. Gjuha e premtimeve të “Ngushëlluesit” ka vlerë gjithashtu edhe për fuqinë e Biblës së plotësuar. Prandaj mund të arrijmë në konkluzionin që këto dhe pretime të tjera të shpirtit u përmbushën në një formë të mrekullueshme në shekullin e parë, por tani kanë vlerë për ne në manifestimin e shpirtit përmes Fjalës së shkruar të Perëndisë në Bibël.

Sigurisht që është e vërtetë që shpirti i Perëndisë u shpaloj përmes fjalës së shkruar në të shkruarën, por kjo ishte veçse një shpalojë *të pjesshme* në krahasim me plotësinë (“perfeksionin”) që tani kemi në Fjalën e plotë të Perëndisë (1 Kor. 13:9-13). Nga kjo rrjedh që nuk mund të ketë pasur ndonjë zbulësë tjetër nga Perëndia pas tërheqjes së dhuratave me plotësimin e Dhiatës së Re. Pretendimet e Librit të Mormonit dhe prodhimeve të tjera të ngjashme, nënkuptojnë se Bibla *nuk* është zbulësia e plotë – që mungesa e dhuratave të shpirtit sot provon se është. Nëse duhet ta shfrytëzojmë plotësisht *plotësinë* e zbulësës së Perëndisë në Bibël, duhet të përdorim çdo pjesë të saj, si Dhiatën e Vjetër ashtu dhe atë të Re; vetëm atëherë njeriu i Perëndisë mund të fillojë të jetë aq i plotë sa plotësia e Perëndisë, shpaloj në Fjalën.

Digresion 8: “Këto Shenja do të Pasojnë ata që Besojnë” (Mk 16:17)

Nga kjo është nxjerrë si përfundim se kushdo që beson vërtet do të marrë dhuratat mrekulli. Megjithatë, kjo provon tepër – “ata *do të* prekin gjarpërinjtë; dhe nëse pijnë helmin, nuk do t’u bëjë dëm; ata *do të* vënë duart mbi të sëmurët, dhe këta do të shërohen” (Mk. 16:18). Ky nuk është premtim i gjërave që teorikisht mund të ndodhin nëse besimtari do të kishte aq besim sa duhet; këto ishin pretime të sigurta për çfarë do të bëhej patjetër prej besimtarëve. Nëse mrekulli të një niveli të tillë nuk përmbushen qartë, premtimi i këtij vargu nuk mund të ketë vlerë për ne në kohën e tanishme. Mund të kujtoni se si Pali ishte në gjendje të mbante një gjarpër helmues pa u kafshuar prej tij (Veprat 28:3-7), duke çuar kështu në konfirmimin se predikimi i tij ishte prej Perëndisë.

Nga asnjë prej gjithë kristianëve karizmatikë që kanë pretenduar të zotërojnë dhuratat (dhuntitë) gjatë njëqind vjetëve të shkuar, nuk ka pasur ndonjë fakt realist për ushtrimin e fuqive të tilla.² Nëse *çdo* besimtar nuk mund dhe nuk *përmbush* shenja të një niveli të tillë, atëhere ky premtim nuk mund të ketë vlerë për sot. Kjo na lë me përfundimin që kemi nxjerrë tashmë nga studimi i mësimëve të Biblës mbi shpirtin: këto dhurata zotëroheshin nga besimtarët e hershëm kristianë në shekullin e parë, por zotërimi ndaloi pas përfundimit të Shkrimit të Dhiatës së Re.

Vargu i fundit i 16 sugjeron që mrekullitë “që pasojnë” ata që besonin kishin qëllimin specifik të të konfirmuarit të fjalës së folur të Ungjillit: “Këto shenja do të *pasojnë* ata që besojnë...ata shkuan dhe predikuan kudo, me ndihmën e Zotit, duke vërtetuar fjalën me mrekullitë që *pasuan*” (Mk. 16:17,20). Me t’u shkruar plotësisht fjala e folur, siç e kemi ne tani në Dhiatën e Re, nuk kishte më nevojë që shenjat mrekulli të pasonin ata që besonin.

Digresion 9: Shkatërrimi i Qiellit dhe Tokës (Ap. 21:1; 2 Pjt. 3:6-12)

Meqenëse qëllimi i Perëndisë është të vendosë Mbretërinë e Tij këtu në tokë (shih Studimin 5), atëhere është e paimagjinueshme që Ai të shkatërronte këtë planet dhe Studimi 3.3 ka demonstruar që Ai ka premtuar këmbëngultas se nuk do ta bëjë një gjë të tillë. Referencat e mësipërme ngaj shkatërrimit të qiellit dhe tokës, për pasojë, duhen marrë në mënyrë figurative.

Pasazhi nga Pjetri tregon ngjashmëritë midis gjykimeve mbi tokë në kohën e Noahut dhe asaj që do të ndodhë “në ditën e Zotit” në të ardhmen. “Me anë

² Aq të përhapura janë pretendimet për zotërimin aktual të dhuratave të shpirtit sa në vitin 1989 u zhvilluan dy debate publike midis një pastori kristian karizmatik John Liliakas dhe dy kristadelfëve, Z. John Allfree dhe autorit të këtyre radhëve. Mocioni ishte: “A Zotërohen Sot Dhuratat Mrekulli të Shpirtit të Shenjtë?” Ftesat u dërguan në shumë kisha në mbarë Mbretërinë e Bashkuar, çka çoi në një auditor të të dyjave prej mbi 1,000 vetë. Është e arsyeshme të supozohet që u paraqitën ‘faktet’ më të mira për zotërimin aktual të dhuratave. Një tekst i debateve mund të merret nga: Christadelphian Advancement Trust, PO Box 3034, South Croydon, Surrey CR2 0ZA, England.

të ujit, ujërave të përmytjes, u shkatërrua bota e lashtë; por qielli dhe toka që tani ekzistojnë...mbahen nga zjarri deri në ditën e gjykimit” (2 Pjt. 3:6,7).

Pjetri vë në dukje një kontrast midis ujit si agjenti i shkatërrimit në kohën e Noahut dhe zjarrit që do të përdoret në ardhjen e dytë. “Qiejt dhe toka” e kohës së Noahut nuk u shkatërruan në kuptimin e thjeshtë të fjalës – “gjithë mishi” që ishte mëkatar u shkatërrua (Zan. 7:21 krahaso 6:5,12). Prandaj, ‘Qiejt dhe toka’ i referohen një sistemi gjërash apo organizimit njerëzor. Ata që e keqkuptojnë këtë pasazh tentojnë të injorojnë shkatërrimin e ‘qiejve’ për të cilin flitet. Kjo nuk mund të merret fjalë për fjalë – ato janë vendbanimi i Perëndisë (Ps. 123:1), ku nuk ka mëkatësi (Hav. 1:13; Ps. 65:4,5), dhe që deklaroi lavdinë e Perëndisë (Ps. 19:1). Nëse i referohen diçkaje figurative, atëherë e njëjta ka vlerë edhe për ‘tokën.’

Pasazhet e mëposhtme demonstrojnë si ‘qiejt dhe toka’ nuk duhen kuptuar fjalë për fjalë në pjesë të tjera të Biblës, por në fakt si një sistem gjërash në tokë:

- “Pashë tokën dhe, ja, ishte pa formë dhe e zbrazët, dhe qiejt, nuk kishte më dritë...Sepse Zoti ka thënë, E gjithë toka (e Izraelit) do të shkretohet...Për këtë toka do vajtojë, dhe qiejt lart do nxihen” (Jir. 4:23-28). Kjo është një profeci e gjykimeve që do të vijnë mbi ‘qiejt dhe tokën’ e vendit dhe popullit të Izraelit, për të cilën (jo qiellin dhe tokën e mirëfilltë) do të vajtonin.
- Më parë Moisiu i ishte drejtuar gjithë Izraelit: “Qiellin e thërras për dëshmitar; dhe tokë, dëgjo fjalët e mia” (Br. 32:1). Theksohet se kishte dy kategori njerëzish për të cilët fliste: 1) “Të moshuarit e fisit tuaj” dhe 2) “gjithë bashkësinë e izraelitëve” (Br. 31:28,30). Pleqtë pastaj, do të barazoheshin me ‘qiejt’ dhe njerëzit e zakonshëm me ‘tokën.’
- Jeshaja e hapi profecinë e tij në stil të ngjashëm: “Dëgjoni o qiell e tokë...dëgjoni ç’thotë Zoti, ju sundimtarë...dëgjoni ligjin e Perëndisë sonë, ju njerëz” (Jesh. 1:2,10). Përsëri ka një paralele midis qiellit dhe sundimtarëve; dhe midis tokës dhe njerëzve.
- “Qiellin e tokën i thërret për dëshmitarë, sepse do t’i kërkojë llogari popullit të tij” të Izraelit (Ps. 50:4). Kjo flet vetë.
- “Do t’i tmerroj gjithë popujt...do t’i tund qiejt dhe tokën” (Hag. 2:7,21) po kështu.
- “Zoti e ka përgatitur shpatën e tij në qiell dhe tani do të zbresë mbi Edomin...Shpata e Zotit do mbulohet me gjakun e tyre...sepse Zoti do të bëjë...një masakër të madhe në mbarë Edomin” (Jesh. 34:5,6). ‘Qielli’ këtu barazohet me Edomin; profecia e mëparshme që “dielli,

hëna e yjet do të bëhen pluhur” (Jesh. 34:4), për rrjedhojë, i referohet shkatërrimit të Edomit.

- Qiejt dhe toka që përmenden si në shkatërrim në Jesh. 13 i referohen popullit të Babilonisë. Në një radhë pohimesh mbi Babiloninë, lexojmë që Perëndia “do të shkundë qiejt dhe toka do të dalë nga vendi i saj...si një sorkadhe ndjekur nga gjahtarët...të huajt në Babiloni do të kthehen në vendet e tyre dhe do t’ia mbathi secili në dheun e vet” (Jesh. 13:13,14). Ikja e qiejve dhe tokës paralelizohet me atë të njerëzve. Heb. 9:26 flet për “fundin e botës” sikur ndodh në shekullin e parë A.D. – në kuptimin që bota çifute po mbaronte në atë kohë.

Duke pasur këtë mirë parasys, duhet pritur që referimet e Dhiatës së Re për një qiell dhe tokë të re kur të kthehet Krishti do t’i referohen një sistemi të ri gjërash që do të shihen kur të jetë ngritur Mbretëria e Perëndisë.

Kjo vërtetohet edhe nga shqyrtimi më i hollësishëm i 2 Pjt. 3. Pasi ka përshkruar se si ‘qiejt e toka’ e tanishme do të marrin fund, vargu 13 vazhdon: “Megjithatë, ne, sipas premtimit të tij, kërkojmë qiej të rinj e një tokë të re, në të cilën banon pastërtia.” Kjo citon premtimin e Tij (Perëndisë) në Jesh. 65:17: “Po bëj një qiell të ri dhe një tokë të re.” Pjesa tjetër e Jesh. 65 vazhdon me përshkrimin e këtij sistemi të ri gjërash si të jetë një situatë e përkryer këtu në tokë:

“Shihni, Jeruzalemi i ri që do të krijoj do jetë plot gëzim...Vetëm ata do të jetojnë në shtëpitë që ndërtojnë vetë...fëmijët do të vdesin njëqind vjeç (d.m.th. jetëgjatësia do të rritet)...ujku dhe qingji do të kullotin sëbashku.” (Jesh. 65:18-25).

Është e qartë që këto bekime kanë lidhje me Mbretërinë e ardhshme të Perëndisë në tokë – ‘qiejt e toka’ e re që do të zëvendësojnë organizimin e tanishëm në mizerje.

Digresion 10: Pretendimet e “Izraelizmit Britanik”

Nga të ngjashmit me organizatën ‘E Vërteta e Thjeshtë’ e H.W. Armstrongut ka dalë ideja që premtimet që iu bënë Abrahamit janë përmbushur në popujt britanikë dhe amerikanë, të cilët, sipas pretendimit, janë fiset e Efraimit dhe Manasëhut. Anëtarët e lëvizjes ‘Izraelite Britanike’ besojnë se mbretërit dhe mbretëreshat e Anglisë e kanë prejardhjen nga dega e Judës, e cila filloi me mbretin David. Për të justifikuar teorinë e tyre, atyre

u është dashur të nxjerrin përfundimin se çifutët janë refuzuar si popull i Perëndisë dhe në vend të tyre janë zgjedhur popujt britanikë. Nëse është ndjekur arsyetimi i Studimit 3, duhet të jetë e qartë që këto pretendime, nga pikëpamja biblike, nuk janë në asnjë mënyrë të justifikueshme. Argumentet e mëposhtme janë veçse pak prej atyre që mund të vireshin në dukje:

- *Të gjitha* qeniet njerëzore janë njësoj nën mallkimin e mëkatit (Rom. 3:23), prandaj Krishti vdiq, në mënyrë që t'u jepte mundësinë të gjitha kombeve për të pasur shansin për shpëtim. Pavarësisht se ç'prejardhje kombëtare kemi, ajo është pa rëndësi nëse jemi pagëzuar në Krisht dhe jemi bërë pjesë e Izraelit shpirtëror (Gal. 3:27-29). Jemi urdhëruar të predikojmë Ungjillin në të gjithë kombet, duke pagëzuar individët që e besojnë atë (Mk. 16:15,16); pra, Izraeli i ri përbëhet nga njerëz prej të gjitha kombeve, jo vetëm britanikët.
- Është shumë e vështirë të vërtetosh origjinën e popujve britanikë dhe amerikanë; ata janë një përzierje popujsh nga shumë pjesë të botës. Lindja në një prej këtyre vendeve nuk do të thotë që janë njerëzit e zgjedhur të Perëndisë.
- Izraelitët britanikë pretendojnë që bekimet që iu premtuan farës së Abrahamit janë përmbushur në popujt britanikë, pavarësisht nga bindja e tyre ndaj Perëndisë. Kjo është në kundërshtim me parimin e përsëritur që bekimet e Perëndisë janë të kushtëzuara nga bindja. Gjithë Kp. 26 dhe Br. 28 përvijojnë bekimet që do të vinin mbi Izraelin nëse ata do të ishin të bindur ndaj fjalës së Tij dhe mallkimet që do të vinin si rezultat i mosbindjes së tyre. Të pretendosh se Perëndia ia ka dhënë Britanisë këto bekime pavarësisht nga bindja ndaj fjalës së Tij, dhe shpesh përballë mosbindjes shumë të qartë ndaj saj, sigurisht që do të ishte një dhunim i kushteve nën të cilat Perëndia i ofron këto bekime.
- Implikimi se Perëndia e ka hedhur tej popullin e Tij të Izraelit dhe i ka zëvendësuar ata me britanikët, është në kundërshtim të plotë e të hapur me pasazhe të tilla si Rom. 11:1,2: "A e mohoi Perëndia popullin e Tij? Mos dhëntë Perëndia! Se unë (Pali) jam gjithashtu një izraelit, i farës së Abrahamit...Perëndia nuk e ka mohuar popullin e Tij që e zgjodhi që nga fillimi."
- Mbretëria e Perëndisë ishte Mbretëria e Izraelit në të shkuarën (2 An. 9:8). U çbë për shkak të mosbindjes së tyre, por Mbretëria do të ringrihet (Jhz. 21:25-27). Mbretëria do të kthehet në Jeruzalem (Mih. 4:8) kur Jezusi të mbretërojë atje në fronin e Davidit (Lk. 1:32).
- Populli i tanishëm i shpërndarë i Izraelit do të mblidhet nga pjesët e ndryshme të botës ku janë shpërndarë: "Do t'i nxjerr izraelitët nga

kombet ku u mërguan...do t'i sjell në tokën e tyre; do t'i bëjë një popull të vetëm në malet e Izraelit” (Jhz. 37:21,22). Kjo po përmbushet në formën e kthimit të çifutëve të natyrshëm në atdheun e tyre; përmbushja e plotë do të jetë në Mbretërinë, çka kthimi i tanishëm i Izraelit në atdhe tregon se duhet të ndodhë shpejt.

Digresion 11: Purgatori

Kisha katolike romane mëson se shpirtrat e njerëzve të Perëndisë mund të shkojnë në një vend të quajtur ‘purgator’ pas vdekjes, e cila është një shtëpi e ndërmjetme mes ‘qielit’ dhe ‘ferrit.’ Ata mësojnë se është një vend pastrimi, në të cilin shpirti do të vuajë për njëfarë kohe përpara se të jetë i denjë për të fituar shpëtimin në qiell. Lutjet, djegia e qirinjeve dhe dhuratat financiare për kishën nga një person dhe miqtë e tij supozohet ta shkurtojnë periudhën e kohës në të cilën shpirti vuan në ‘purgator.’ Gafa shumë e madhe e ideve të tilla duhet nxjerrë nga të mëposhtmet.

- Bibla as nuk e përmend ekzistencën e një vendi të tillë.
- Kemi treguar që shpirti i referohet trupit tonë, dhe jo ndonjë elementi të pavdekshëm brenda nesh dhe se ‘ferri’ është varri e jo një vend ndëshkimi.
- Të pastërve kurrë nuk u premtohet shpëtim në qiell. Dhënia e shpëtimit do të ndodhë në karriken e gjykimit kur të kthehet Krishti, dhe jo në ndonjë kohë pas vdekjes kur supozohet të largohemi nga ‘purgatori’ (Mt. 25:31-34; Ap. 22:12).
- Të gjithë të pastrit marrin shpërblimet e veta në të njëjtën kohë, dhe nuk ndodh që një person fiton shpëtimin në kohë të ndryshme (Heb. 11:39,40; 2 Tim. 4:8).
- Vdekja pasohet nga mungesë e plotë e ndërgjegjes, dhe jo nga veprimtaritë e sugjeruara nga doktrina e purgatorit.
- Nga mëkatet tona pastrohemi përmes pagëzimit në Krisht dhe përmes zhvillimit të besimit në punën e tij gjatë jetës sonë të tanishme, e jo gjatë ndonjë periudhe vuajtjeje pas vdekjes. Na thuhet të “pastrohemi nga tharmi i vjetër” i mëkatit në jetët tona (1 Kor. 5:7); të pastrojmë veten nga punërat e mëkatit (2 Tim. 2:21; Heb. 9:14). Prandaj, koha jonë e pastrimit është tani, në këtë jetë, e jo në ndonjë vend pastrimi (‘purgator’) në të cilin hymë pas vdekjes. “Tani është dita e shpëtimit...tani është koha e duhur” (2 Kor. 6:2). Bindja jonë ndaj Perëndisë në pagëzimin dhe zhvillimin e një karakteri shpirtëror në

këtë jetë, do të çojë në shpëtimin tonë (Gal. 6:8) – jo kalimi i një periudhe kohe në ‘purgator.’

- Përpjekjet e të tjerëve për të na shpëtuar përmes djegies së qirinjve apo dhurimeve të tjera për kishën katolike, nuk do ta ndikojnë aspak shpëtimin tonë. “Ata që besojnë në pasuritë e tyre... askush nuk mund ta çlirojë vëllanë e tij, e as ta shlyejë në ndonjë mënyrë Perëndinë për të... njeriu nuk mund të mbetet gjallë për një kohë të pacaktuar” (Ps. 49:6-9).

Digresion 12: Fantazmat dhe Ritrupëzimi

Besimi se njeriu vazhdon të jetojë në formën e një personi tjetër apo një kafshe të zotëruar nga shpirti i tij, ishte një prej mënyrave më të hershme në të cilën njeriu përpjek të bindte veten se vdekja nuk ishte aq përfundimtare sa ç’dukej.

Kemi treguar që shpirti i njeriut i referohet frymës/forcës së jetës brenda tij, e cila i kthehet Perëndisë kur ai vdes (Koh. 12:7). Kjo do të thotë që shpirti i tij nuk sillet vërdallë si ‘fantazmë,’ e as nuk është i lirë të zotërojë një tjetër person apo kafshë në mënyrë që personaliteti i njeriut të vazhdohet përmes tyre. Secili prej nesh do të gjykohet për veprat tona (2 Kor. 5:10). Nëse veprat dhe karakteristikat tona janë funksion i karakterit të një njeriu të mëparshëm, atëherë koncepti i gjykimit dhe shpërblimit tonë nga Perëndia sipas veprave tona (Ap. 22:12) shndërrohet në diça boshe.

Shpirti i kthehet Perëndisë pas vdekjes, dhe ndërgjegjja merr fund. Çdo përpjekje për të kontaktuar të vdekurit, për rrjedhojë, tregon një keqkuptim serioz të mësimave të bollshme të Biblës në lidhje me këtë (shih Jesh. 8:19,20; Kp. 19:31, 20:6). Bibla është mjaft e qartë që njerëzit nuk kthehen në shtëpitë apo qytetet e tyre të mëparshme në ndonjë mënyrë pasi të kenë vdekur; nuk mund të ketë një gjë të tillë si një ‘shpirt’ apo ‘fantazmë’ që ta gjëmojë një vend të tillë pasi personi ka vdekur. Pranimi i përlurur i kësaj do të na çojë në zhvlerësimin e të gjitha pretendimeve se gjoja janë parë ‘fantazma’ (hije) të njerëzve të vdekur, që i vihen pas shtëpive të tyre. Përvoja të tilla, në rastin më të mirë, duhet të jenë truke të imagjinatës.

Digresion 13: Me Çfarë Natyre jemi Ngritur?

Kemi treguar që jeta e përtejme dhe ndryshimi në natyrën e Perëndisë u dhurohen besnikëve pas gjykimit. Së pari, Krishti do të ringjallë të

përgjegjshmit për gjykimin e tij, dhe pastaj do t'i gjykojë pasi të jenë mbledhur tek ai. Pasi pranojmë që shpërblimi i natyrës së pavdekshme jepet në kohën e gjykimit, rrjedh që të gjithë ata që janë ngritur (ringjallur) kanë së pari një natyrë të vdekshme. Nëse janë ngritur me trupa të pavdekshëm, atëhere nuk ka arsye për një karrike gjykimi në të cilën të jepen shpërblimet. Në Mbretërinë e Perëndisë hyjmë menjëherë pas karrikes së gjykimit (Mt. 25:34); prandaj, besnikët nuk janë në Mbretërinë e Perëndisë përpara gjykimit. “Njerëzit prej mishi e gjaku nuk mund të hyjnë në Mbretërinë e Perëndisë (ndaj)... të gjithë ne do të shndërrohemi... Trupi ynë i vdekshëm që jepet pas vdekjes, duhet të shndërrohet në trupin e pavdekshëm” (1 Kor. 15:50,51,53). Që këtu rrjedh që ky ndryshim i natyrës, nga e vdekshme në të pavdekshme, ndodh në karriken e gjykimit, dhe këtu është vendi ku hyjmë në Mbretëri.

Megjithatë, apostulli i frymëzuar Pal shpesh flet për “ringjalljen” në kuptimin e “ringjalljes së jetës” – ringjallja e të pastërve, që pas gjykimit do të marrin jetën e përjetshme. Sigurisht, që me këtë kuptonte “se do të ketë një ringjallje të të vdekurve, si të të drejtëve ashtu dhe të padrejtëve” (Veprat 24:15). Ai do ta kishte ditur që të përgjegjshmit “do të dalin (nga varri); ata që kanë vepruar mirë, do të marrin ringjalljen e jetës; dhe ata që kanë vepruar keq, do të marrin ringjalljen e mallkimit” (Gjn. 5:29).

Në mënyrën e vet pozitive, duket se Pali i është referuar shpesh kësaj “ringjalljeje të jetës” kur ai flet për “ringjalljen.” Të drejtët dalin nga varret e tyre “për në ringjalljen e jetës” – pasi dalin nga toka ata do të gjykoohen dhe do t'u jepet jeta e përjetshme. I gjithë ky proces është “ringjallja e jetës.” Ka një dallim midis “daljes” së tyre nga varri dhe “ringjalljes së jetës.” Pali flet për përpjekjet e tij për të bërë një jetë kristiane, “me bindje të plotë se edhe unë do të ringjallem nga të vdekurit” (Fil. 3:11). Edhe pse ishte i përgjegjshëm ai, gjithsesi, do të ngrihej për të dhënë llogari në kohën e gjykimit; prandaj, përpjekjet për të “fituar ringjalljen” duhet të nënkuptojë që “ringjallja” këtu i referohet “ringjalljes së jetës.”

Shembuj të tjerë ku “ringjallja” nënkupton “ringjalljen e jetës” (krahaso Lk. 14:14) përfshijnë Lk. 20:35; Gjn. 11:24; 1 Kor. 15:21,42; Heb. 11:35; Ap. 20:6. Në Ps. 17:15 Davidi flet për marrjen e shpërblimit të tij në kohë që ai “zgjohet.” Ai kishte të njëjtën pikëpamje për ringjalljen, megjithëse ai e dinte që do të kishte një gjykim. Përdorimi i kësaj fraze, “ringjallja,” si ajo në 1 Kor. 15 ndihmon shpjegimin e 1 Kor. 15:52 - “të vdekurit do të ngjallen të pakorruptueshëm.” Vlen të përmendet që fraza “të vdekurit” hera-herës (dhe veçanërisht në 1 Kor. 15) i referohet të vdekurve të drejtë, të cilët do të ngrihen për të marrë jetën e përjetshme në kohën e gjykimit: 1 Kor. 15:13,21,35,42; 1 Sel. 4:16; Fil. 3:11; Ap. 14:13; 20:5,6.

1 Sel. 4:16,17 radhit ngjarjet që shoqërojnë kthimin e Krishtit.

1. Duket qartë që Krishti kthehet
2. Ngjallen të vdekurit
3. Të përgjegjshmit që janë gjallë në atë kohë do të kapen e do të çohen në gjykim.

Dhënia e jetës së përjetshme vjen *pas* kësaj mbledhjeje sëbashku (Mt. 25:31-34; 13:41-43); për rrjedhojë, pavdekësia nuk mund të jepet në ringjallje, duke qenë se kjo vjen përpara mbledhjes sëbashku. Kemi treguar se të gjithë të drejtët do të shpërblehen në të njëjtin moment (Mt. 25:34; Heb 11:39-40). Kjo do të ishte e pamundur nëse pavdekësia do të jepej në kohën e ringjalljes, meqenëse ringjallja vjen përpara mbledhjes së bashku të të gjallëve të përgjegjshëm.

Megjithatë, duhet vërejtur që koncepti ynë i kohës është shumë njerëzor; Perëndia nuk është i lidhur aspak pas saj. Është e mundur të shkohet tepër larg në përpjekjet për të caktuar një kronologji specifike ngjarjesh që do të ndodhin rreth kohës së kthimit të Krishtit. Ringjallja dhe shndërrimi ynë në pavdekësi në karriken e gjykimit përshkruhen sikur ndodhin “në një moment, sa hap e mbyll sytë” (1 Kor.15:51,52). Është një parim i zakonshëm biblik që secili prej atyre që janë të përgjegjshëm për gjykimin do të tregojnë jetën e tyre në karriken e gjykimit. Bibla mëson që jeta e përjetshme do të jepet në karriken e gjykimit dhe jo në kohën e ringjalljes. Për këtë arsye, 1 Sel. 4:17 flet për besnikët që do të thirren nga gjëmimi i një trumpete, ndërsa 1 Kor. 15:52 thotë se e njëjta trumpetë lidhet me dhënien atyre pavdekësi. Kjo gjithashtu shpjegon pse Pali e mendonte ringjalljen si identike me pranimin në karriken e gjykimit (p.sh. Fil. 1:23).

Digresion 14: ‘Ngazëllimi’

Mes kishave ‘evangeliste’ është përhapur një besim se të drejtët do të rrëmbehen në qiell në kohën e kthimit të Krishtit (ngazëllimi). Ky besim shpesh shoqërohet me idenë se toka atëhere do të shkatërrohet. Në ? Digresion 9 shohim që kjo është e pamundur. Gjithashtu, në Studimin 4.7 kemi treguar që vendi i shpërblimit është toka, jo qielli. Këto besime të gabuara bazohen në një interpretim të gabuar të 1 Sel. 4:16,17: “Vetë Zoti do të zbresë nga qielli... dhe ata që vdiqën besnikë të Krishtit do të ringjallen të parët; pastaj ne që mbetemi gjallë do të rrëmbehemi bashkë me ta në takim me Zotin që vjen në re; kështu do të jemi përgjithmonë me Zotin.” Përveç rrezikut të dukshëm të mbështetjes së një besimi kaq madhor në veçse një pasazh të Shkrimit të Shenjtë, duhet vërejtur që këtu nuk përmenden askund të drejtët që rrëmbehen në *Qiell*. Krishti zbret nga qielli

para se ta takojnë atë besimtarët. Krishti do të mbretërojë përgjithmonë në fronin e Davidit në Jeruzalem dhe ne do të jemi me të, këtu në tokë. Për rrjedhojë, është e pamundur që të kalojmë përjetësinë me të të varur në ajër. ‘Ajri’ që shtrihet pak kilometra mbi sipërfaqen e tokës do të thotë se nuk mund t’i referohet Qiellit, vendit ku qëndron Perëndia.

Fraza greqisht e përkthyer “rrëmbyer” në fakt do të thotë të marrë tutje; nuk bart idenë e ndonjë drejtimi specifik. Ajo shfaqet në Koh. 6:4 dhe Br. 28:31 në Dhiatën e Vjetër Greqisht (Septuagint) për të përshkruar ‘marrjen tutje’ të të mirave në robëri. Shfaqet gjithashtu në Veprat 8:39: “Shpirti i Zotit *e rrëmbeu* Filipin, dhe etiopasi nuk e pa më... Por Filipi u gjend në Ashdod.” Këtu regjistrohet se si Filipi u transportua nga një vend i tokës në një tjetër mrekullisht.

Kur të vijë Krishti, të përgjegjshmit do të mblidhen sëbashku në vendin e gjykimit; ata nuk do të lihen të shkojnë vetë atje. Është e mundur që mjetet tona të transportit për në atë vend do të jenë vërtet përmes ajrit.

Jezusi tha se “në ditën kur Bri i njeriut të vijë... dy veta do të jenë në arë; njëri do të merret e tjetri do të lihet” (Lk. 17:30,36). Edhe kjo jep të njëjtën pamje të një rrëmbimi të beftë. Dishepujt pynenin seriozisht, “Ku, O Zot? Dhe Ai u tha, Korbat mblidhen atje ku ka kërmë” (Lk. 17:37). Ashtu si korbat fluturojnë instiktivisht nëpër ajër dhe pastaj ulen në tokë aty ku janë trupat, ashtu dhe të përgjegjshmit do të sillen në vendin ku do të takojnë Zotin e tyre në gjykim.

Duhet të theksojmë përsëri rëndësinë e doktrinës së karrikes së gjykimit të Krishtit; të përgjegjshmit duhet të shfaqen aty të parët, para se të drejtët mes tyre të shpërblehen. Një lexim sipërfaqësor i 1 Sel. 4:16,17 mund të na çojë në përfundimin se të gjithë të përgjegjshmit do të rrëmbehen lart në ajër dhe do të mbeten atje përgjithmonë me Krishtin. Në fakt, e dimë që të përgjegjshmit do të mblidhen në vendin e gjykimit, ndoshta duke u transportuar nga ajri, dhe *paskëtaj* të marrin shpërblimet e tyre.

Digresion 15: Fjalpërfjalshmëria e Mbretërisë

Përshkrimet fjalpërfjalë të mbretërisë që gjenden në profetët e Dhiatës së Vjetër shpesh tallen nga teologët dhe anëtarët e shumë grupeve. Pretendohet se gjuha është figurative për një vend shpërblimi të ndryshëm nga toka, duke qenë se ky planet do të digjet.

Në përgjigje të kësaj, duhet kuptuar që një rregull bazë i studimit të Biblës është që duhet ta marrim Biblën fjalpërfjalë, përveç rasteve kur ka arsye të mjaftë për të imponuar një interpretim shpirtëror. Për shembull, vargu i parë

i librit të Apokalipsit na informon që vizioni është gjerësisht simbolik (Ap. 1:1), çka duhet të na udhëzojë për ta parë. Ka gjithashtu edhe një ndjenjë të caktuar korrektësie dhe realizmi në përdorimin e gjuhës që mund të tregojë nëse një pasazh duhet lexuar apo jo simbolikisht. Kështu, kur lexojmë se toka lëkundet si një i pirë (Jesh. 24:20), është e qartë nga lloji i gjuhës së përdorur që duhet ta lexojmë atë simbolikisht. Në anën tjetër, gjuha e përdorur për të përshkruar të ardhmen e mbretërisë është shumë e lehtë për t'u kuptuar fjalëpërfjalë; nuk ka asnjë shenjë se duhet ta marrim simbolikisht.

Do të dukej se për shkak të paafësisë së njeriut për të gjetur besim të mjaftueshëm për të besuar që një kohë e tillë do të vijë vërtet mbi tokë, ata kanë shpikur teori që e shpjegojnë tjetërpërtjetër. Alternativa e tyre është një mbretëri shpirtërore ose e bazuar në qiell, është e mjegullt dhe i mungojnë hollësitë, dhe për këtë arsye ka pak gjëra për të besuar dhe besimi i paktë ose kërkohet ose nxitet. Nëse vërtet përshkrimet e njerëzve të çalë që kurohen, apo shndërrimi i shkretëtirave në pjellore, janë veçse simbolike, atëherë i duhet dhënë përgjigje në mënyrë specifike dhe bindëse pyetjes: 'Simbolike për çfarë?' këto pasazhe përshkruajnë mbretërinë e Perëndisë. Nëse nuk jemi të sigurtë se për çfarë janë saktësisht simbolike, atëherë nuk e dimë Ungjillin ('lajmin e mirë') mbi mbretërinë, dhe për rrjedhojë nuk mund të presim të kemi ndonjë vend në të.

Më tej, duhet të jetë boll e qartë nga të gjitha faktet e paraqitura deri më tash që Perëndia ka një qëllim të përjetshëm me njeriun mbi këtë tokë; ai nuk do të shkatërronte planetin të cilin ia kishte premtuar përgjithmonë farës së Abrahamit. Për rrjedhojë, duhet të presim që në Bibël të ketë përshkrime fjalëpërfjalë për mbretërinë që do të vijë në tokë.

Pasazhet e mëposhtme e vërtetojnë këtë.

- "Vetë Perëndia që formoi tokën dhe e krijoi atë; nuk e bëri më kot, e formoi për t'u banuar" (Jesh. 45:18). Krijimi i tokës *do të* jetë më kot nëse Perëndia e shkatërron atë; por, në kontrast me këtë, është qëllimi i Perëndisë që ta bëjë atë të banuar nga njerëz të pavdekshëm.
- "Toka mbetet përgjithmonë" (Koh. 1:4).
- "Ai gjithashtu i ka vendosur ato (elementët e sistemit diellor) përgjithmonë; ai ka caktuar një vendim që nuk do të kapërcehet" (Ps. 148:6).

Kohëzgjatja e Mijëvjeçarit për 1,000 vjet, siç është regjistruar në Ap. 20:4, gjithashtu duhet pranuar fjalëpërfjalë. Më e rëndësishme është që, Mijëvjeçari përshkruhet në Heb. 4:4-9 si dita e Shtatë e pushimit. Me

Perëndinë “një ditë është si njëmijë vjet” (2 Pjt. 3:8). Pas gjashtë ‘ditësh’ prej njëmijë vjetësh në qëllimin e Perëndisë me tokën, do të vijë ‘dita’ e pushimit e Mijëvjeçarit.

Koha është e kufizuar për të gjithë ne. Duke qenë përballë perspektivës së kthimit të shpejtë të Krishtit, nevojitet të përdorim çdo çast të mundshëm tonin në këtë jetë të shkurtër për t’u përgatitur për ardhjen e tij.

Digresion 16: Përmbledhje e Historisë së Izraelit

ABRAHAMI u thirr nga Uri i kaldenjve; çifuti i parë. Perëndia i bëri premtime atij në lidhje me tokën e Kënaanit, dhe farën e tij. Ai vdiq duke mos i marrë këto premtime të përmbushura.

ISAKU u ofrua nga babai i tij, Abrahami për sakrificë (kurban). Ngaqë Abrahami ishte besnik, Perëndia e konfirmoi premtimin e Tij Abrahamit përmes një betimi. Gatishmëria e Isakut për të vdekur duke iu bindur urdhrat të babait të tij është një lloj Krishti. Premtimet iu ripërtëritën Isakut (Zan. 26:3-5).

JAKOBI ishte i biri i Isakut. Premtimet iu ripërsëritën edhe atij. Ai kishte dymbëdhjetë djem – Rubeni ishte më i madhi, Benjamini ishte më i riu. Levi ishte ai nga i cili patën prejardhjen priftërinjtë. Jozefi ishte i preferuari.

JOZEFI pa dy ëndrra, kur ishte djalë i ri, sikur ishte sundimtar mbi vëllezërit e tij. Ata u bënë xhelozë dhe e shitën si skllav në Egjipt. Atje ai u bë sundimtar dhe organizoi ruajtjen e grurit për t’u përdorur gjatë shtatë vjetëve të urisë që pllakosi rajonin. Gjatë kësaj kohe, Jakovi dhe djemtë e tij erdhën të jetonin me Jozefin në Egjipt. Ata dhe pasardhësit e tyre jetuan në Goshen, pjesë e Egjiptit. Një Faraon i mëvonshëm e persekutoi popullin e Izraelit, duke i shndërruar ata në skllavë.

MOISIU u lind në këtë kohë; u fsheh në xunkthe kur ishte foshnje dhe u gjet nga e bija e faraonit dhe u adoptua prej saj. Kur ishte djalë i ri, vrau një egjiptian që po rrihte një izraelit. Moisiu më pas u arratis në Midjan, ku punoi për 40 vjet si bari me Jitron. Më pas, atij iu shfaq Perëndia i fshehur në një kaçubë që digjej. Iu tha të shkonte te faraoni dhe të kërkonte çlirimin e Izraelit. Ai bëri shenja mrekullish për të vërtetuar që vërtet ishte dërguar prej Perëndisë. Por faraoni nuk i linte izraelitët të iknin dhe prandaj mbi Egjiptin u dërguan dhjetë murtaja, p.sh. bretkocat, errësira, breshëri dhe së fundi vrasja e meshkujve të parëlindur izraelitëve u duhej të vrisnin një qingj dhe ta spërkasin gjakun mbi dyert e shtëpive të tyre. Kjo ishte shenjë se si gjaku i Jezusit mund të na shpëtojë ne nga vdekja. Kjo festë u njoh më pas si Pashka.

DALJA (EKSODI) Më në fund, izraelitëve iu lejua të largoheshin nga Egjipti. Udhëtuan të drejtuar nga Engjëlli i Perëndisë në një shtyllë reje në mes të ditës dhe nga një shtyllë zjarri në mes të natës. Ushtria e faraonit i ndoqi deri në Detin e Kuq. Ujrat u hapën mrekullisht për t'i lejuar njerëzit të kalonin përmes dhe pastaj ujrat u kthyen për të mbytur egjiptianët. Izraelitët udhëtuan nëpër shkretëtirë drejt tokës së premtuar të Kënaanit. Perëndia u dha ujë për të pirë nga një shkëmb dhe çdo mëngjes u jepej bukë në formë mana. Kur arritën në malin e Sinait, Perëndia u dha dhjetë urdhëresat dhe Ligjin e Moisiut. Më pas përbënë mbretërinë e Perëndisë. U urdhëruan të bënin një tendë të veçantë, të quajtur mbulesë, në të cilën do të adhurohej Perëndia. Atyre iu dha një Prift të Lartë dhe priftërinj që mund t'i ofronin sakrificat e tyre Perëndisë. Të gjithë elementët e tendës dhe priftërisë shenjonin për nga Jezusi.

TOKA E PREMTUAR më në fund iu afruan asaj. U dërguan dymbëdhjetë zbulues, nga të cilët dhjetë u kthyen duke thënë se ishte tepër e vështirë të zotërohej. Dy zbuluesit e tjerë, Joshua dhe Kalebi, thanë të vërtetën – që toka *mund* të zotërohej prej tyre, nëse ata do të kishin besim në premtimet e Perëndisë. Ngaqë njerëzit ishin me mendimin e dhjetë zbuluesve, izraelitëve iu desh të silleshin rrotull nëpër shkretëtirë për 40 vjet derisa të gjithë ata që ishin mbi 20 vjeç kur u larguan nga Egjipti, kishin vdekur.

JOSHUA ishte pasardhësi i Moisiut dhe i udhëhoqi izraelitët në tokën e Kënaanit. Qyteti i parë që u mor ishte Jeriko, ku jetonte Rahabi, dhe pastaj Ai. Me t'u vendosur në atë tokë, u sunduan kohë pas kohe nga **GJYQTARËT**, edhe pse mbreti i tyre i vërtetë ishte Perëndia. Këta përfshinin burra si Gideoni, Jiftahu dhe Samsoni. Të gjithë i shpëtuan izraelitët nga armiqtë e tyre, kur u penduan për mëkatet e bëra kundër Perëndisë. Historia e izraelitëve është e mbushur me shembuj ku izraelitët nuk i binden Perëndisë, ndëshkohen nga pushtimet prej vendeve fqinje, pendohen për mëkatet e tyre dhe Perëndia i shpëton – dhe pastaj mëkatojnë përsëri. Gjyqtari i fundit ishte Shëmueli. Në kohën e tij, populli i Izraelit e refuzonte Perëndinë si Mbretin për ta duke kërkuar një mbret njerëzor, si kombet përreth tyre.

MBRETËRIT Mbreti i tyre i parë ishte Shauli, i cili, megjithëse e nisi mirë, doli se ishte një burrë i lig, që nuk i bindej urdhëresave të Perëndisë dhe persekutoi Davidin. Pas vdekjes së tij, Davidi u bë mbreti tjetër dhe ishte një prej më të mirëve të Izraelit. Perëndia i dha atij premtime. Pas tij erdhi i biri i tij Sholomo, i cili, pas një fillimi të mirë, u largua nga besimi i vërtetë nga gratë e tij të shumta që kishte marrë nga kombet fqinje. Pas vdekjes së tij, mbretëria u nda më dysh – dhjetë fise formuan mbretërinë e Izraelit, në fillim nën Jeravamin; dy fiset e tjera, Juda dhe Benjamin, formuan mbretërinë e Judës, në fillim nën Rehovamin, birin e Sholomos.

Mbretëria e Izraelit (dhjetë fiset) nuk kishte asnjë mbret të mirë. Ata rebeloheshin shpesh kundër Perëndisë. Ai u dërgoi shumë profetë për t'u lutur për pendesë, por ata nuk e bënë. Prandaj i pushtuan asirët dhe i zunë rob. Ata u shpërndanë anembanë botës.

Mbretëria e Judës (dy fiset) kishte disa mbretër të mirë (p.sh. Asai, Hizkija), por edhe ata, ishin në përgjithësi të pabindur ndaj Perëndisë. Prandaj u dërguan babilonasit që t'i pushtonin, dhe i morën rob në Babiloni për 70 vjet. Paskëta nuk patën më kurrë mbret. Pas 70 vjetësh, disa u kthyen në tokën e Izraelit nën udhëheqjen e Ezrës, Nehemjës, Joshuas (Prifti i Lartë në atë kohë) dhe guvernatorit Zerubavel. Në fillim ata u sunduan nga Persia, pastaj nga Greqia dhe në fund nga Roma. Ishin nën sundimin e Romës kur u lind Jezusi. Si rezultat i refuzimit të Jezusit nga çifutët, Perëndia dërgoi romakët ta shkatërronin Jeruzalemin në vitin 70 A.D. dhe në fund të gjithë çifutët ishin dëbuar nga toka e Izraelit.

Vitet e fundit, çifutët kanë filluar të kthehen në tokën e tyre, në përmbushje të pjeshme të profecive të Dhiatës së Vjetër. Ringjallja e Shtetit të Izraelit është një shenjë e sigurt që shpejt Jezusi do të kthehet për të rivendosur mbretërinë e Izraelit si Mbretëri të Perëndisë.

Digresion 17: Magjia

Ky digresion është shkruar gjerësisht për t'u shërbyer nevojave të atyre në Afrikë dhe në pjesë të tjera të botës ku magjia është një veti e zakonshme e jetës së përditshme. Njihet nga të gjithë studentët e vërtetë të Biblës se shpëtimi nga magjistarët, doktorët afrikanë dhe të ngjashmit me ta nuk mund të përshtatet me mbajtjen e së vërtetës. Megjithatë, e vlerësoj që doktorët magjistarë janë më pak të kushtueshëm dhe shpesh më kollaj për t'u gjetur sesa mjekët, dhe se kjo, kombinuar me suksesin e tyre të dukshëm, i bën ata tërheqës. Këtë problem duhet ta shohim në mënyrë logjike, sipas Biblës. Kjo është e vetmja mënyrë që ju të gjeni forcën për t'i rezistuar tundimit për t'i përdorur këta njerëz.

PRETENDIMET E MAGJISË

Së pari, pretendimet për suksesin që këta magjistarë arrijnë nevojitet të analizohen. Mund të jemi të sigurtë që në pretendimet për suksesin e tyre ka shumë ekzagjerime. Kurat e tyre kurrë nuk bëhen haptas, për t'i parë të gjithë. Nëse vërtet do të ishin të suksesshëm, atëherë me siguri do të punonin nëpër spitale dhe do të mund të gjendeshin në mbarë botën. Gjendja

e saktë e atyre që pretendojnë se i shërojnë, gjithashtu nuk dihet kurrë – nuk është e qartë se sa përmirësohen vërtet.

Ata nga ju që përballen me këtë tundim duhet të pyesni veten nëse keni prova të përcaktuara të fuqisë së tyre – p.sh. a keni parë (jo thjesht dëgjuar) një njeri të cilit t’i jetë prerë krahu në një fabrikë sharrash të shkojë tek një magjistar dhe të kthehet me krahun që funksionon për mrekulli? Ky është lloji i fakteve që na nevojiten përpara se t’u japim ndopak kredibilitet. Br. 13:1-3 është edhe më e fuqishme: Izraelitëve iu mësua se nëse një magjistar do të bënte një shenjë a magji që të dukej sikur ishte një mrekulli, propësepropë ata nuk duhet ta besonin nëse nuk flisnin doktrinën e vërtetë sipas fjalës së Perëndisë. Është e qartë që doktorët magjistarë nuk besojnë të vërtetën siç zbulohet në Bibël – prandaj nuk duhet të tundohemi t’u njohim fuqi të vërtetë, duke qenë se gjithë pushteti vjen nga Perëndia (Rom. 13:1; 1 Kor. 8:4-6).

Së dyti, lloji i ankesave me të cilat ata merren është domethënës. Tashmë pranohet që ne përdorim veçse 1% të fuqisë së trurit tonë. Pjesa tjetër duket sikur është tej fuqisë sonë për ta përdorur në mënyrë të ndëgjegjshme (pa dyshim këtë do ta bëjmë në Mbretërinë). Pa e kuptuar ne, mendjet tona mund të kenë një efekt thuajse fizik mbi trupat tanë. kështu, psikologët (ata që studiojnë mendjen) dihet se kanë kuruar njerëz nga sëmundjet e gjakut duke i bërë ata të imagjinojnë në mënyrë intensive konstituimin e duhur të gjakut dhe funksionimit normal të tij. Doktorët pranojnë se me raste, ndodhin kura të tilla që nuk varen nga mjekësia tradicionale. Në mënyrë të ngjashme, niveli i lartë i stresit në mendjet tona mund të shkaktojnë ulçera të stomakut dhe dhimbje koke. Qetësimi i mendjes ose stërvitja e saj në një mënyrë të caktuar mund t’i bëjë këto të pushojnë. Por nëse, për shembull, na pritët krahu në një fabrikë sharrash nuk ka ushtrime mendore që të mund ta bëjnë atë të kthehet ku ishte. Magjistarët duket se janë në gjendje të ndikojnë vetëm sëmundjet që kontrollohen nga mendjet tona. Ngaqë nuk e kuptojmë plotësisht se si funksionojnë mendjet tona, kjo duket sikur vjen për shkak të ndonjë fuqie fizike që zotërojnë këta magjistarë. Por nuk është kështu; ata e shkaktojnë këtë efekt vetëm përmes ndikimit të tyre mbi mendjet e njerëzve.

BURIMI I FUQISË

Megjithatë, e gjithë fuqia është e Perëndisë. Edhe gjërat e mira edhe ato të këqia sillen prej *Tij* – jo prej magjistarëve. Kjo është një temë shumë e zakonshme në Shkrimin e Shenjtë: Jesh. 45:5-7; Mih. 1:12; Am. 3:6; Dal. 4:11; Br. 32:39; Ijv. 5:18. Të gjitha këto meritojnë lexim të kujdesshëm. Përfundimi është që *Atij* duhet t’i drejtohem për lutje nëse jemi sëmurë,

ndërkohë që bëhet çdo gjë që është e mundur nga njeriu përmes përdorimit të të mjekësisë tradicionale për të korrigjuar problemin. Nëse u kthehemi mjekëve magjistarë, atëhere u jemi kthyer njerëzve që pretendojnë të kenë kontroll mbi 'fuqitë e errësirës' që gjoja u jep mundësi atyre të na bëjnë më mirë. Por ne e dimë që ato fuqi që besojnë ata nuk ekzistojnë. Burimi i fuqisë është Perëndia. T'u drejtohesh magjistarëve është si të thuash se Perëndia nuk është i gjithëfuqishëm dhe se fuqi të tjera, në të cilat magjistarët pretendojnë të kenë fuqi, janë ato që na shkaktojnë sëmundjet. Të mendosh në këtë mënyrë do të thotë të ofendosh Perëndinë. Izraelitët zgjodhën të besonin në Perëndinë, por gjithashtu besonin se kishte edhe fuqi të tjera që vepronin në jetët e tyre, me të cilat duhet të merreshin duke adhuruar idhujt e bërë për ato fuqi. Kjo e inatosi aq shumë Perëndinë sa Ai i dënoi të mos ishin më populli i Tij (Br. 32:16-24). Përpara Perëndisë, nëse nuk kemi besim të plotë në Atë, në fakt nuk e besojmë fare. Të pretendosh besim në Perëndinë e vërtetë të Izraelit, por edhe të pranosh ekzistencën së fuqive të tjera të veçanta nga Perëndia, dhe të lejosh një doktor të përpiqet t'i ndikojë ato fuqi që të na lënë rehat, do të thotë të veprosh saktësisht ashtu siç vepruan izraelitët në të kaluarën. Historia e gjatë, e dëshpërueshme e idhujtarisë së izraelitëve është "shkruar që ta mësojmë ne." Nuk duhet të kemi asnjë lloj shoqërimi me ata që besojnë në këto fuqi.

“Çfarë harmonie ka drita me errësirën? Çfarë kanë të përbashkët idhujt me Tempullin e Perëndisë? Ju jeni tempulli i Perëndisë... Prandaj dilni nga rrethi i tyre dhe rrini më vete, tha Zoti, dhe unë do të jem Ati juaj dhe ju do të jeni bijtë e bijat e Mi” (2 Kor. 6:14-17).

Nëse bëjmë vërtet përpjekje dhe sakrificë për t'u ndarë nga këto gjëra, atëhere do të kemi sigurinë e lavdishme që vërtet jemi fëmijët e Vetë Perëndisë. Një prind i natyryshëm kujdeset instinktivisht për fëmijën e vet kur është sëmurë. A është vërtet aq e vështirë të besojmë që Ati ynë Qiellor do ta bëjë këtë edhe më shumë?

Është fakt që magjistarët kanë ndikim vetëm mbi ata që i besojnë atyre. Në mënyrë të ngjashme, dikush që ka humbur një njeri të shtrenjtë mund të shkojë tek një medium apo magjistar dhe të kërkojë të shohë njeriun që ka vdekur. Mediumi do t'u thotë të mbyllin sytë dhe të imagjinojnë fytyrën e personit në mënyrë shumë të qartë. Klienti mund ta fiksojë mendjen tek një fotografi e personit që mund ta kujtojnë lehtësisht. Atëhere, mediumi mund të lexojë mendjen e klientit dhe me pak ekzagjerim të flasë mbi personin me fjalë realiste, në mënyrë të tillë që klienti të jetë i bindur që mediumi e ka parë personin e vdekur të gjallë. Vëreni që asnjë provë e qendrueshme nuk

jepet ndonjëherë që personi është gjallë. Por nëse klienti refuzon t'i bindet mediumit, atëherë nuk ka kurrfarë rezultati.

'Magjistarët' që normalisht u tregonin Faraonit dhe Nebukadnezarit ëndrrat e tyre nuk do të kishin ato pozita përgjegjësie që kishin nëse nuk ishin arsyeshëm të suksesshëm. Pa dyshim, ata e përdornin shumë këtë teknikë të leximit të mendjes. Megjithatë, kur Perëndia përfshihej në jetën e personit me të cilin merreshin, siç ndërhyri në jetët e Faraonit dhe Nebukadnezarit, atëherë ato e humbnin këtë fuqi. Në mënyrë të ngjashme, Balaku u zinte besë fuqive të Balamit për mallkimin e njerëzve – i ofroi shpërblime shumë të mëdha financiare për shërbimet e tij, duke thënë se ai e dinte nga përvoja e kaluar që "ai që ti mallkon, shkon drejt fundit" (Regj. 22:6). Por Balami, i cili në disa drejtime ishte ekuivalenti i një doktori magjistar, zbuloi që aftësia e tij normale e kishte lënë kur po merrej me popullin e Izraelit. Është e qartë që njerëz të tillë nuk kanë aspak pushtet kur merren me njerëz që janë të shoqëruar me Perëndinë e vërtetë, pavarësisht çfarë fame mund të kenë fituar për sukseset kur merren me njerëzit.

MAGJITË NË BIBËL

Kuptimi praktik i kësaj është se nëse tundohehi të shkojmë në një doktor magjistar, atëherë duhet të kemi besim total tek ai. Nuk ka kuptim të përdorim magjistarë nëse thjesht shpresojmë për më të mirën; dhe ndoshta edhe ata vetë do të përmendin të njëjtin argument. Të vendosësh besim total në njerëz të tillë dhe në ekzistencën e fuqive që pretendojnë të kontrollojnë, do të thotë se kemi një mungesë totale të besimit në gjithfuqishmërinë e Perëndisë së vërtetë. Nëse besojmë vërtet në shkrimet e Faraonit, Balak dhe Nebukadnezar përmendur më sipër, atëherë ne nuk do të jemi në gjendje të vijmë tek një magjistar me besimin se do të kenë ndonjë efekt mbi ne. Shembujt e shqyrtuar më poshtë tregojnë që magjistarët nuk kanë pushtet mbi njerëzit e Perëndisë – që ne dimë se jemi, për arsye të lutjeve tona dhe pagëzimit.

Magjia etiketohet qartë nga Pali si një "punë e mishit," në të njëjtën kategori si "herezia" (doktrina false), tradhëtia bashkëshortore dhe pornografia (Gal. 5:19-21). Ai komenton: "Po ju paralajmëroj, siç kam bërë në kohëra të kaluara (d.m.th. kjo ishte një pjesë shumë e theksuar e mësimin të Palit), se ata që bëjnë gjëra të tilla nuk do të ketë vend në Mbretërinë e Perëndisë." Ekuivalenti i kësaj sipas Ligjit të Moisiut ishte komanda që të gjithë magjistarët, ata që përdornin "hyjnizimin" (një tjetër emër për magjinë) dhe ata që i bënin fëmijët e tyre të kalonin përmes zjarrit, duheshin vrarë menjëherë (Br. 18:10,11; Dal. 22:18). Ata që i vendosin fëmijët e tyre përmes zjarrit nuk ishin magjistarët e vërtetë – magjistarët dhe idhujtarët

kryesorë jepnin mësimin se për të siguruar mbrojtjen kundër forcave të së keqes, fëmijët e atyre që donin mbrojtje duheshin detyruar të kalonin përmes zjarrit. Kështu shohim se si magjistarët ashtu dhe ata që i përdornin ata duheshin vvarë; dhe sipas besëlidhjes së re, ndëshkimi për kryerjen e së njëjtës gjë është përjashtimi nga Mbretëria e Perëndisë.

Përdorimi i magjisë si mjet i përmirësimit të vetes është diçka që Perëndia nuk do të donte ta bënim. Në çdo vendim me të cilin përballemi në jetën tonë në Krisht, duhet të pyesim seriozisht: ‘A do Perëndia vërtet që unë ta bëj këtë? A do ta bëja këtë nëse Jezusi do të ishte këtu në krah tim?’ Mendoj se nën dritën e dënimit të qartë të magjisë nga Perëndia, përgjigja duhet të jetë e qartë – jo, Perëndia nuk do që ta përdorim. Magjia përkufizohet nga Shëmueli sikur ka lidhje me “rebelimin” (teksti hebraisht nënkupton ‘provokim’) kundër Fjalës së Perëndisë (1 Shëm. 15:23). Të provokosh të Gjithfuqishmin, siç bëjnë izraelitët përmes besimit të tyre në idhuj e magji (Br. 32:16-19), sigurisht as që mund të mendohet. Perëndia jep argumentin se Ai i kishte urdhëruar izraelitët të dëbonin kënaanasit për shkak të besimit të tyre në magji, e cila ishte aq e urryer për Atë; megjithatë, ata u bashkuan me ta për ta praktikuar atë (Br. 18:9-14). Kështu, për Izraelin e ri të besimtarëve të pagëzuar, ne nuk duhet t’i bëjmë gjërat e kësaj bote së keqe përreth, përndryshe nuk do të jemi në gjendje të trashëgojmë përjetësisht tokën e Mbretërisë. Të arsyetosh se vetëm magjistari e përdor atë, por jo ne, nuk ka të bëjë fare. Nëse shpresojmë që efektet e magjisë do të ndihen mbi ne, atëherë në fakt jemi duke e përdorur.

Perëndia na bekoftë të gjithëve ndërkohë që ecim nëpër këto ditë të fundit të botës së errët, May God bless us all as we walk through these closing days of the dark, jobesimtare drejt Mbretërisë së Tij të dritës, së vërtetës dhe lavdisë.

“Sepse nuk morën dashurinë e së vërtetës, që të mund të ishin shpëtuar...Perëndia do t’u dërgojë një fuqi që i bën të gabojnë, e që t’i besojnë gënjeshtres...Por ne duhet ta falënderojmë Perëndinë për ju, vëllezër të dashur nga Zoti...Prandaj, vëllezër, rrini të patundur dhe mbështetuni tek traditat që ju mësuam, me fjalë apo me letër. I lutemi tani vetë Zotit tonë Jezu Krisht, dhe Perëndisë, vetë Atit tonë, që na ka dashur dhe na ka dhënë ngushëllim të pafund dhe shpresë të mirë përmes mirësisë, t’ju japë zemër dhe forcë për të kryer do të mirë në fjalë e në vepra” (2 Sel. 2:10-17).

Digresion 18: Çfarë Ndodhi në Eden?

Zan. 3:4-5: “Dhe gjarpri i tha gruas, Nuk do të vdesësh aspak: Por Perëndia e di mirë se, sapo t’i hani ato fruta, do t’ju happen sytë dhe do të bëheni të gjithë perëndi, duke njohur të mirën dhe të keqen.”

INTERPRETIMI POPULLOR

Gabimisht supozohet se gjarpri këtu është një engjëll që kishte mëkatuar, quajtur “satan.” Duke qenë dëbuar nga qielli për mëkatin e tij, ai erdhi në tokë dhe tundoi Evën të mëkatonte.

KOMENTE

1. Pasazhi flet mbi “gjarprin.” Fjalët ‘satan’ dhe ‘djall’ nuk shfaqen askund në gjithë librin e Zanafillës.
2. Gjarpri nuk përshkruhet kurrë si engjëll.
3. Prandaj, nuk është për t’u çuditur që tek Zanafilla nuk ka asnjë fjalë për ndonjë të dëbuar jashtë qiellit.
4. Mëkati sjell vdekje (Rom. 6:23). Engjëjt nuk mund të vdesin (Lk. 20:35-36), prandaj, engjëjt nuk mund të mëkatojnë. Shpërblimi i të pastrit është të bëhet si engjëjt për të mos vdekur kurrë (Lk. 20:35-36). Nëse engjëjt do të mund të mëkatonin, atëhere edhe të pastrit do të ishin në gjendje të mëkatonin dhe prandaj do të kishin mundësinë për të vdekur, çka do të thotë se në të vërtetë nuk do të kishin jetën e përhershme.
5. Personazhet e përfshirë në librin e Zanafillës për rënien e njeriut janë: Perëndia, Adami, Eva dhe gjarpri. Nuk përmendet askush tjetër. Nuk ka fakte se dikush mund të ketë hyrë brenda gjarprit dhe ta ketë detyruar të bënte atë që bëri. Pali thotë se gjarpri “e mashtroi Evën përmes dinakërisë së vet” (2 Kor. 11,3). Perëndia i tha gjarprit: “Meqë ti e bërë këtë...” (Zan. 3:14). Nëse ‘satani’ po e përdorte gjarprin, pse nuk përmendet ai dhe pse nuk u ndëshkua edhe ai?
6. Adami fajësoi Evën për mëkatin e tij: “Ajo më dha frut nga pema” (Zan. 3:12). Eva fajësoi gjarprin: “Gjarpri më mashtroi të haja frutin” (Zan. 3:13). Gjarpri nuk fajësoi djallin – nuk bëri ndonjë shfajësim.
7. Nëse argumentohet se gjarpërinjtë sot nuk kanë fuqinë e fjalës apo arsyes si gjarpri në Eden, mbajeni mend;
 - (a) Një gomar u bë një herë të fliste e arsyetonte me një njeri (Bilami): “Një shtazë (normalisht) pa gojë i foli me zë njerëzo dhe kështu e pengoi profetin ta zbatonte planin e tij të marrë” (2 Pjt. 2:16)
 - (b) Gjarpri ishte më dinaku ndër të gjitha kafshët (Zan. 3:1). Mallkimi mbi të do t’ia kishte marrë aftësinë për të folur me Adamin dhe Evën.

8. Perëndia krijoi gjarprin (Zan. 3:1); nuk pati ndonjë qenie tjetër të quajtur ‘satan’ që u shndërrua në gjarpër; nëse e besojmë këtë, në fakt jemi duke thënë se një person mund të hyjë në jetën e dikujt tjetër dhe ta kontrollojë atë. Kjo është një ide pagane, jo ide biblike. Nëse argumentohet se Perëndia nuk do ta kishte krijuar gjarprin për shkak të mëkatit të madh që shtyu të bënin Adami dhe Eva, kujtoni që mëkati hyri në botë nga njeriu (Rom. 5:12); prandaj, gjarpri ishte amoral, fliste nga vëzhgimet e veta të natyrshme dhe nuk ishte, si i tillë, përgjegjës para Perëndisë dhe për këtë arsye nuk kreu mëkat.

Disa sugjerojnë që gjarpri i Zan. 3 lidhet me serafin. Megjithatë, fjala normale hebraisht për “gjarpër,” e cila përdoret në Zan. 3, është totalisht pa lidhje me fjalën për “seraf.” Fjala hebraisht përkthyer “seraf” do të thotë thjeshtë “një i zjarrtë” dhe përkthehet “nepërkë” në Regj. 21:8, por kjo nuk është fjala e përkthyer “gjarpër” në Zan. 3.

SHPJEGIME TË SUGJERUARA

1. Duket se nuk ka arsye për të dyshuar se ajo që na thuhet mbi krijimin dhe rënien në kapitujt e hershëm të Zanafillës duhet marrë fjalëpërfjalë. “Gjarpri” ishte fjalëpërfjalë një gjarpër. Fakti që mund të shohim gjarpërinj sot duke u zvarritur mbi barqet e tyre në përmbushje të mallkimit të vënë mbi gjarprin fillestar (Zan. 3:14), e mbështet këtë. Në të njëjtën mënyrë, shohim gra e burra të vuajnë nga mallkimet që u vunë mbi ta në të njëjtën kohë. Mund të vlerësojmë që Adami dhe Eva ishin thjesht një burrë dhe një grua siç i njohim sot, por që gëzonin një formë më të mirë të ekzistencës, prandaj gjarpri fillestar ishte një kafshë e vërtetë, megjithëse në një formë shumë më tepër inteligjente se sa gjarpërinjtë që shohim sot.

2. Të mëposhtmet janë shenja të mëtejshme që kapitujt e hershëm të Zanafillës duhen lexuar fjalëpërfjalë.

- Jezusi i referohej regjistrimit të krijimit të Adamit dhe Evës si baza e mësimin të tij mbi martesën dhe divorcin (Mt. 19:5-6); nuk ka asnjë shenjë që ta ketë lexuar në mënyrë figurative.
- “I pari u krijua Adami, dhe pastaj Eva. Dhe nuk ishte Adami që u mashtrua nga (nga gjarpri), por gruaja u gënjye dhe nuk u bind” (1 Tim. 2:13-14) – pra edhe Pali, e lexonte Zanafillën fjalëpërfjalë. Edhe më me rëndësi, ai shkroi më herët mbi mënyrën “Eva u mashtrua me gënjeshtrenë dinake të gjarprit” (2 Kor. 11:3) – vëreni që Pali nuk përmend “djallin” të ketë mashtruar Evën.

3. Ngaqë gjarpri u mallkua me detyrimin për t’u zvarritur mbi bark (Zan. 3:14), kjo mund të nënkuptojë që më parë kishte pasur këmbë;

bashkuar me fuqinë e dukshme të arsytimit, ndoshta ishte forma e jetës shtazore më pranë njeriut, megjithëse ishte prapëseprapë një kafshë – një tjetër prej “bishave të fushës që Zoti Perëndi kishte bërë” (Zan. 3:1,14).

Digresion 19: Luciferi

Jesh. 14:12-14: “Ti ke rënë nga qielli, O Lucifer, biri i mëngjesit! Ke rënë përtokë, ti që në të kaluarën munde kombe të tjera! Ti ishe i vendosur të ngriheshe gjer në qiell për ta vendosur fronin tënd mbi yjet më të larta të Perëndisë; ti mendove se do të rrije ulur si mbreti në malin në veri ku mbliidhen perënditë; the se do të ngriheshe gjer në majat e reve për të qenë si i Gjithpushtetshmi.”

INTERPRETIMI POPULLOR

Supozohet se Luciferi kishte qenë dikur një engjëll i fuqishëm që kishte mëkatuar në kohën e Adamit dhe për këtë arsye ishte hedhur poshtë në tokë, ku shkaktonte trazira për popullin e Perëndisë.

KOMENTE.

1. Fjalët “djall”, “satan” dhe “engjëll” nuk shfaqen kurrë në këtë kapitull. Ky është i vetmi vend në Shkrimin e Shenjtë ku shfaqet fjala “Lucifer.”
2. Nuk ka fakte që Jesh. 14 përshkruan diçka që ka ndodhur në kopshtin e Edenit; nëse është, atëhere, pse jemi lënë 3,000 vjet qysh nga koha e Zanafillës përpara se të na thuhet se çfarë ka ndodhur vërtet atje?
3. Luciferi përshkruhet si i mbuluar me krimba (v. 11) dhe i tallur prej njerëzve (v. 16) sepse ai nuk ka më pushtet pasi është dëbuar nga qielli (v. 508); prandaj, nuk ka justifikim për të menduar që Luciferi tani është në tokë duke çuar besimtarët në rrugë të gabuar.
4. Pse është dënuar Luciferi sepse paska thënë, “Do të ngjitem në qiell” (v. 13), nëse ai kishte qenë tashmë atje?
5. Luciferi nuk është për t’u krimbur në varr: “Tani je në botën e të vdekurve, ... dhe të mbulojnë krimbat” (v. 11). Duke parë që engjëjt nuk mund të vdesin (Lk. 20:35-36), atëhere Luciferi nuk mund të jetë një engjëll; gjuha i përshtatet më shumë një njeriu.
6. Vargjet 13 dhe 14 kanë lidhje me 2 Sel. 2:3-4, të cilat janë për “njeriun e mëkatit” – kështu Luciferi drejtohet kah një tjetër njeri – jo një engjëll.

SHPJEGIME TË SUGJERUARA.

1. V.R.N. dhe versione të tjera moderne kanë shpjeguar tekstin e kapitujve 13-23 të Jeshajës si një seri “barrash” mbi vende të ndryshme, p.sh. Babilonia, Suri dhe Egjipti. Jesh. 14:4 jep kontekstin e vargjeve që po shqyrtojmë: “Do të përqeshni mbretin e Babilonisë me këtë proverbë (histori)...”. Prandaj, profecia është për mbretin njerëzor të Babilonisë, i cili përshkruhet si “Luciferi.” Me rënien e tij: “ata që të shohin do të... të quajnë, duke thënë, Ky është ai që tundi tokën...?” (v. 16). Kështu, Luciferi përkufizohet qartë si njeri.
2. Ngaqë Luciferi ishte një mbret njerëzor, “Të gjithë mbretërit e kombeve... do të të thërrasin, Edhe ti je bërë i dobët si ne? A je bërë si një prej nesh?” (v. 9-10). Prandaj, Luciferi ishte një mbret si çdo mbret tjetër.
3. Vargu 20 thotë se e gjithë fara e Luciferit do të shkatërrohet. Vargu 22 thotë se fara e Babilonisë do të shkatërrohet, dhe kështu barazohen të dyja. ‘Luciferi’ dëshironte të ngrihej lart në qiell, dhe po kështu edhe Babilonia (Jir. 51:53); “gjykimi i saj [d.m.th. mëkati që i sjell gjykim] arrin deri në qiell” (Jir. 51:9).
4. Kujtoni që kjo është një “proverbë (histori) kundër mbretit të Babilonisë (v. 4). “Lucifer” do të thotë “ylli i mëngjesit,” i cili është më i shndritshmi ndër yje, dhe në fakt është planeti Venus. Në histori, ky yll vendos me krenari të “ngrihet (më lart) në qiell... të lartësoj fronin tim mbi yjet (e tjerë) të Perëndisë” (v. 13). Për shkak të kësaj, ylli zbritet në tokë. Ylli përfaqëson mbretin e Babilonisë. Kapitulli 4 i Danielit shpjegon se si Nebukadnezari, mbreti i Babilonisë shihte me krenari mbretërinë e madhe që kishte ndërtuar, duke menduar se kishte pushtuar vende të tjera me forcën e tij, në vend që të pranonte që ishte Perëndia që i kishte dhënë sukses. “Madhështia (krenaria) jote është rritur dhe arrin deri në qiell” (v. 22). Për shkak të kësaj “ai u dëbua nga njerëzit, dhe vërtet hëngri bar si bagëti dhe trupi iu lag me vesën e qiellit, deri sa flokët iu rritën si pendë shqiponjash dhe thonjtë si kthetrat e zogjve” (v. 33). Kjo ulje e papritur e njërit prej njerëzve më të fuqishëm të botës në një të shkarë nga trutë, ishte një ngjarje aq dramatike sa të kërkonte historinë e rënies së yllit të mëngjesit nga qielli në tokë. Yjet janë shpesh simbole për njerëz të fuqishëm, p.sh. Zan. 37:9; Jesh. 13:10 (në lidhje me udhëheqësit e Babilonisë); Ez. 32:7 (në lidhje me udhëheqësin e Egjiptit); Dan. 8:10 deri v.24. Ngjytja në qiell dhe rënia nga qielli janë idioma biblike që shpesh përdoren për të rritur krenarinë dhe përuljen respektivisht – shih Ijovi 20:6; Jir. 51:53 (mbi Babiloninë); Vaj. 2:1; Mt. 11:23 (mbi Kafarnaumin): “Ti, O Kafarnaum, që je ngjitur në qiell, do të plandosesh në ferr” (varri).

5. Vargu 17 e akuzon Luciferin se e ka bërë “botën si shkretëtirë, (duke shkatërruar) qytetet e saj; dhe kurrë nuk i çliroi të burgosurit e tij... (që mbushi faqen e botës me qytete”... “nxjerrës i arit” (v. 17,21, V.R.; v.4 V.M. anë faqes). Këto janë të gjitha përshkrime të politikës ushtarake babilonase – duke rrafshuar zona të tëra (siç bënë me Jeruzalemin), duke transportuar robërit në zona të tjera e mos i lënë për t’u kthyer në atdhe (siç bënë me çifutët), duke ndërtuar qytete e duke marrë detyrime në ar prej vendeve që shtypnin. Pra, vihet theksi mbi faktin që Luciferi nuk do të merrte as varrimin që kishin pasur mbretërit e tjerë (v. 18-19), duke nënkuptuar se ishte veçse një mbret njerëzor si ata, meqenëse trupi i tij kishte nevojë të varrosej.
6. Vargu 12 thotë se Luciferi “duhej plandosur përdhe” – duke nënkuptuar se ishte një pemë. Kjo ofron një lidhje të mëtejshme me Dan. 4:8-16, ku Nebukadnezari dhe Babilonia përqasen me një pemë që pritet.
7. Babilonia dhe Asiria shpesh janë fraza të zëvendësueshme me njëra tjetrën tek profetët; kështu, duke folur për rënien e mbretit të Babilonisë, v. 25 thotë, “Do t’i shkatërroj asirianët...”. Profecitë mbi Babiloninë në Jesh. 47 përsëriten në lidhje me Asirinë në Nah. 3:3-5,18 dhe Zeh. 2:13,15; dhe 2 Analeve 33:11 thotë që mbreti i Asirisë zuri rob Mënasehun në Babiloni – duke treguar që termat mund të zëvendësojnë njëri-tjetrin. Am. 5:27 thotë se izraelitët do të çoheshin robër “matanë Damaskut,” pra në Asiri, por Shtjefni thotë se kjo ishte “matanë Babilonisë” (Veprat 7:43). Ezra 6:1 përshkruan se si Dariusi, mbret i Babilonisë, nxjerr një dekret në lidhje me rindërtimin e tempullit. Çifutët lëvduan Perëndinë që i ktheu “zembrën mbretit të Asirisë” (Ezra 6:22), duke treguar edhe një herë që termat mund të përdoren për të zëvendësuar njëri-tjetrin. Profecia e Jeshajës, kap. 14, përkrah shumë të tjerave në Jeshaja, përshtatet mirë në kontekstin e pushtimit asirian nga Sinaheribi në kohën e Hizkijës, pra v. 25 përshkruan shkatërrimin e asirëve. Vargu 13 është më i lehtë për t’u kuptuar nëse flet për asirët profanë që rrethojnë Jeruzalemin, duke dashur të hyjnë në Jeruzalem dhe të marrin tempullin për perënditë e tyre. Më parë, mbreti asir Tilgat-Pilnezeri, ndoshta kishte dashur të bënte të njëjtën gjë (2 Analeve 28:20,21); Jesh. 14:13: “Se në zembrën tënde ke thënë, do të ngrihem gjer në qiell... (simbolikë për tempullin dhe harkun – 1 Mbretërve 8:30; 2 Analeve 30:27; Ps. 20: 2,6; 11:4; Heb. 7:26). Do të ulem edhe mbi malin ku mblidhen mbretërit (mali Cion ku ishte tempulli) në veri” (Jeruzalem - Ps. 48:1,2).
8. Prandaj, është e nevojshme të kuptohet “Do të ngjitem në qiell” si një hiperbolë, si tek 1 Shëm. 5:12; 2 An. 28:9; Ezra 9:6; Ps. 107:26.

Digresion 20: Tundimet e Jezusit

Mt. 4:1-11: “Pask kësaj, Jezusi u çua në shkretëtirë nga shpirti për t’u tunduar nga djalli. Jezusi, pasi kishte agjëruar dyzet ditë e dyzet netë, kishte uri të madhe. Dhe kur djalli i tha, Nëse ti je Biri i Perëndisë, urhdëro që këta gurë të shndërrohen në bukë. Por ai iu përgjigj, Është shkruar që, Njeriu nuk jeton vetëm nga buka, por nga çdo fjalë që flet Perëndia. Pastaj djalli e çoi në qytetin e shenjtë dhe e vendosi lart në tempull, dhe i tha, Nëse ti je Biri i Perëndisë, hidhu poshtë: sepse është shkruar, Ai do t’i urdhërojë engjëjt të të presin në duar, që të mos vritesh në ndonjë gur. Jezusi i tha, Gjithashtu është shkruar, Mos e tundo Zotin, Perëndinë tënd. Pastaj, djalli e çoi në një mal shumë të lartë, dhe i tregoi të gjitha mbretëritë e botës, me madhësitë e tyre; dhe i tha, Të gjitha këto do të t’i jap ty, nëse bie përmbys para meje dhe më adhuron. Por Jezusi iu përgjigj, Largohu o satan: sepse është shkruar, Para Zotit, Perëndisë tënd, përmbysu, veç tij asnjë tjetër nuk do të adhurosh. Pastaj, djalli u largua dhe, engjëjt u afruan për t’u kujdesur për të.”

INTERPRETIMI POPULLOR

Ky pasazh lexohet me kuptimin që një qenie e quajtur “djall” e tundoi Jezusin të mëkatonte duke i sugjeruar gjëra të ndryshme dhe duke e çuar drejt situatave tunduese

KOMENT

1. Jezusi “u tundua në çdo drejtim ashtu si dhe ne” (Heb. 4:15), dhe: “janë dëshirat egoiste ato që e joshin dhe e lidhin çdo njeri” (Jak. 1:14). Nëse tundohemi nga “djalli” për joshjet tona apo dëshirat e liga, edhe Jezusit kështu i ndodhi. Nuk tundohemi nga një qenie e keqe që papritmas rri pranë nesh dhe na shtyn në mëkat – mëkati dhe tundimi vijnë “nga brenda, prej zemrës së njeriut” (Mk. 7:21).

2. Është e qartë që tundimet nuk mund të merren fjalëpërfjalë.

Mt. 4:8 nënkupton që Jezusi u çua në një mal të lartë për të parë të gjitha mbretëritë e botës në lavdinë e tyre të ardhshme “në një çast kohe” (Lk. 4:5). Nuk ka mal aq të lartë nga i cili të shohësh të gjithë botën. Dhe, pse do t’i jepte Jezusit lartësia e malit mundësinë për të parë se si do të ishte bota në të ardhmen? Meqenëse bota është një sferë, nuk ka asnjë pikë në sipërfaqen e saj, nga e cila të mund të shihen të gjitha pjesët e botës në të njëjtën kohë.

Një krahasim i Mt. 4 dhe Lk. 4 tregon që tundimet përshkruhen në radhë të ndryshme. Mk. 1:13 thotë se Jezusi ishte “në shkretëtirë për dyzet ditë, tunduar nga satani,” ndërkohë që Mt. 4:2-3 thotë se “pas agjëroi për dyzetë ditë... tunduesi (satani) erdhi tek Ai...” Lk. 4:13 thotë që djalli e la Jezusin pas tundimit për t’u hedhur nga tempulli; Mt. 4:11 thotë se djalli u largua pas tundimit në malin e lartë. Meqenëse Shkrimi nuk mund të kundërshtojë veten, mund të nxjerrim përfundimin që po të njëjtat tundime përsëriteshin në radhë të ndryshme. Tundimi për të kthyer gurët në bukë është një shembull i qartë. Kjo do të përshtatej mirë nëse tundimet vinin nga brenda mendjes së Jezusit. Duke pasur natyrën tonë, mungesa e ushqimit do ta kishte ndikuar atë si mendërisht ashtu dhe fizikisht, dhe kështu mendja e tij do kishte filluar kollaj të imagjinonte gjëra të ndryshme. Lënia pak ditë pa ushqim mund t’i çojë disa njerëz në delir (1 Shëm. 30:12). Ngjashmëria midis bukëve dhe gurëve përmendet nga Jezusi tek Mt. 7:9, dhe padyshim, ato imazhe shpesh bashkoheshin në mendjen e tij të torturuar – megjithëse gjithnjë vireshin shpejt nën kontroll kur kujtonte Fjalën.

Duket e pamundur që djalli ta ketë çuar Jezusin në shkretëtirë dhe në rrugët e Jeruzalemit dhe pastaj u ngjitën në tempull sëbashku, të gjitha këto nën vështrimin e çifutëve kureshtarë. Tundimet e tij ndodhën të gjitha në shkretëtirë – ai ishte aty për dyzet ditë, tunduar gjithë kohën prej djallit (i cili u largua veçse në fund - Mt. 4:11). Nëse Jezusi tundohej nga djalli çdo ditë, dhe tundimet ndodhën vetëm në shkretëtirë, atëhere rrjedh që Jezusi nuk mund të jetë larguar nga shkretëtira për të shkuar në Jeruzalem apo të ketë udhëtuar majë një mali të lartë. Për pasojë, këto gjëra nuk mund të kenë ndodhur fjalëpërfjalë.

Nëse djalli është një person fizik që nuk ka respekt për Fjalën e Perëndisë dhe i intereson t’i bëjë njerëzit të mëkatojnë, atëhere pse do t’ia citonte Shkrimin Jezusi atij për ta mundur? Sipas pikëpamjes popullore, kjo nuk do ta kishte larguar djallin. Vëreni që Jezusi citonte një pasazh të Biblës çdo herë. Nëse djalli ishte dëshirat e liga brenda zemrës së Jezusit, atëhere është e kuptueshme që duke pasur Fjalën në zemër dhe duke ia kujtuar atë vetes, ai mund t’i mundte ato dëshira të liga. Ps. 119:11 është aq e përshtatshme sa ndoshta profetizon në mënyrë specifike përvojat e Krishtit në shkretëtirë: “Atë që the ti e ngul në mendje, që të mos mëkatoj kundër Teje.”

Mt. 4:1 thotë se Jezusi “Jezusi u çua në shkretëtirë nga shpirti për t’u tunduar nga djalli.” Ky ishte Shpirti i Perëndisë që sapo i ishte zbritur mbi të (3.:16). Do të ishte diçka e jashtëzakonshme që Shpirti i Perëndisë ta çonte Jezusin në shkretëtirë që të mund të tundohej nga një qenie mbinjerëzore që kundërshtonte Perëndinë.

SHPJEGIME TË SUGJERUARA.

1. Kur Jezusi u pagëzua në lumin Jordan nga Gjoni, atij iu dha fuqia e Shpirtit të Shenjtë (Mt. 3:16). Sapo doli nga uji, ai u çua në shkretëtirë për t'u tunduar. Duke ditur që ai kishte fuqinë e shpirtit për t'i shndërruar gurët në bukë, të hidhej nga ndërtesat pa u vlarë, etj., këto tundime duhet të kenë qenë të zjarrta brenda mendjes së tij. Nëse një person ia sugjeronte këto gjëra Jezusit dhe Jezusi e dinte që ky njeri ishte mëkatar, atëhere tundimet ishin shumë më pak dinake sesa po të vinin nga mendja e vetë Jezusit.
2. Tundimi për të marrë mbretëritë për vete do të kishte qenë shumë më i fuqishëm nëse do të kishte ardhur nga brenda Krishtit. Mendja e Jezusit do të kishte qenë e mbushur me Shkrimin e Shenjtë, dhe në gjendjen e mjeruar të mendjes, shkaktuar nga agjërimi, do të kishte qenë tunduese të keqinterpretonte mesazhe që i jepnin mundësi t'i përdorte për të justifikuar zgjedhjen e rrugës më të lehtë për të dalë nga situata ku ndodhej. Qëndrimi majë një mali të lartë kujton Jehezekelin të cilit i tregohet se si do të ishte Mbretëria nga një mal i lartë (Jhz. 40:2), dhe të kujton Gjoni që shihte "Jeruzalemin e shenjtë" nga maja e "një mali të madh të lartë" (Ap. 21:10). Jezusi i pa mbretëritë e botës se si do të ishin në të ardhmen (Lk. 4:5), d.m.th. në Mbretërinë, kur "mbretëritë e kësaj bote të jenë bërë mbretëritë e Zotit tonë dhe Krishtit të Tij" (Ap. 11:15). Ndoshta do të kishte menduar për Mosheun në fund të 40 viteve endje në shkretëtirë (krahaso 40 ditët e Tij) që shihte Tokën e Premtuar (Mbretërinë) nga Mali Nebo. Tek libri i Danielit (4:17,25,32; 5:21) theksohet se "Perëndia më i Lartë është i vetmi sundimtar mbi të gjithë njerëzit dhe se ia jep sundimin kujt të dojë;" Jezusi do ta kishte ditur që vetëm Perëndia, askush tjetër, mund t'ia jepte atij Mbretërinë. Prandaj, nuk do të kishte qenë ndonjë tundim kushedi çfarë nëse një djall i jashtëm pretendonte të mundte t'ia jepte Jezusit Mbretërinë, kur ai e dinte që vetëm Perëndia e kishte atë fuqi. Megjithatë, Jezusi e dinte që kishte qenë kënaqësia e mirë e Tij (e Atit) për t'ia dhënë Jezusit Mbretërinë, dhe duhet të jetë sugjeruar nga 'djalli' brenda Jezusit se mund ta merrte mbretërinë menjëherë. Tekefundit, mund të kishte arsyetuar, Perëndia më ka deleguar mua të gjithë autoritetin në perspektivë (Gjn. 5:26,27), deri në masën që kishte pushtetin si për t'ia dhënë jetën ashtu dhe për ta marrë përsëri (Gjn. 10:18), megjithëse, tekefundit, gjithë pushteti iu dha atij vetëm pas vdekjes dhe ringjalljes së tij (Mt. 28:18).
3. Duke qenë i familjarizuar me Shkrimin e Shenjtë, Krishti do t'ia kishte parë ngjashmëritë midis vetes dhe Elijes, morali i të cilit u shemb pas 40 ditësh në shkretëtirë (1 Mbretërve 19:8) dhe Mosheut, i cili braktisi trashëgiminë e tij të menjëhershme të tokës në fund të 40 vjetëve në

shkretëtirë. Jezusi, në fund të 40 ditëve, ishte në një pozitë të ngjashme me ta – duke pasur përballë mundësinë e vërtetë për dështim. Mosheu dhe Elija dështuan për shkak të dobësisë njerëzore – jo për shkak të ndonjë personi të quajtur ‘djalli.’ Ishte pikërisht kjo dobësi njerëzore, ‘satani,’ ose kundërshtari, që po e tundonte Jezusin.

4. “Dhe djalli i tha, Nëse ti je Biri i Perëndisë...” (Lk. 4:3). Duhet të ketë qenë një tundim i përhershëm brenda mendjes së Krishtit për të dyshuar nëse ishte vërtet Biri i Perëndisë, duke parë që çdokush tjetër mendonte se ai ishte biri i Jozefit (Lk. 3:23; Gjn. 6:42) ose i paligjshëm (kështu nënkupton Gjn. 9:29), dhe se regjistrimet zyrtare të tempullit e përkruanin atë si birin e Jozefit (Mt. 1:1,16; Lk.3:23, ku “i supozuar” do të thotë ‘vlerësuar sipas ligjit’)...

5. Pasazhet e cituara nga Jezusi për t’i dhënë forcë vetes kundër dëshirave të tij të liga (“djallit”) janë të gjitha nga e njëjta pjesë e Besëlidhjes së Ripërtërirë, në lidhje me përvojat e Izraelit në shkretëtirë. Jezusi shihte në mënyrë të qartë një paralele midis përvojave të veta dhe të tyre.

Besëlidhja e Ripërtërirë 8	Mateu 4 / Luka 4
<p>“Zoti, Perëndia juaj, ju bëri të endeshit për dyzet vjet në shkretëtirë, për t’ju thyer kokëfortësinë, për t’ju vënë në provë, për të parë zemrën tuaj, për të parë nëse do të zbatonit urdhërimet (fjalën) e Tij apo jo.” (v.2)</p>	<p>“Jezusi u çua nga shpirti” “dyzet ditë” “në shkretëtirë.” Jezusi u vu në provë nga tundimet. Jezusi triumfoi duke cituar Shkrimin e Shenjtë që ishte në zemrën e tij (Ps. 119:11).</p>
<p>“Dhe ju poshtëroi, ju bëri të vuanit nga uria dhe ju ushqeu me mana...për t’ju treguar se njeriu nuk jeton vetëm nga buka, por nga çdo fjalë...e Zotit...” (v.3)</p>	<p>“Pas kësaj kishte uri të madhe.” Në Gjoni 6 mana interpretohet nga Jezusi se përfaqëson Fjalën e Perëndisë – të cilën Jezusi e zbatoi në shkretëtirë. Jezusi mësoi se shpirtërisht ai jetonte përmes Fjalës së Perëndisë. “Ai u përgjigj...është shkruar që njeriu nuk rron vetëm nga buka, por nga çdo fjalë...e Perëndisë.”</p>
<p>“Duhet të kuptoni në zemrën tuaj që, Zoti, Perëndia juaj dëshiron t’ju çojë në rrugën e drejtë, si ati</p>	<p>Pa dyshim, Jezusi reflektoi mbi përvojat e tij. Perëndia e ndëshkoi Birin e Tij, Jezusin – 2</p>

fëmijën e tij.” (v.5)

Shëm. 7:14; Ps. 89:32

Kështu, Jezusi na tregoi se si ta lexojmë dhe studiojmë Fjalën – ai e mendonte veten si izraelitët në shkretëtirë, dhe për rrjedhëj mori tek vetja mësimet që mund të nxirren nga përvojat e tyre, në provat e tij në shkretëtirë.

Digresion 21: Luftë në Qiell

Ap. 12:7-9: “Pastaj në qiell shpërtheu luftë: Mihaeli dhe engjëjt e tij luftuan kundër kuçedrës; kuçedra me engjëjt e saj kundërsulmuan por u mundën. Bashkë me engjëjt e saj nuk i lejohej më të qëndronte në qiell. Kuçedra e madhe u hodh poshtë. Ajo është gjarpri i lashtë, quajtur djall dhe satan, mashtruesi i mbarë botës; ai dhe të gjithë engjëjt e tij u dëbuan bashkë me të.”

INTERPRETIMI POPULLOR

Ky është një prej pasazheve më popullore të përdorura për të sugjeruar që në qiell ndodhi një rebelim mes engjëjve, çka solli që djalli dhe engjëjt e tij të hidheshin poshtë në tokë, ku, në formën e gjarprit, filluan të krijonin trazira e mëkate mbi tokë.

KOMENTE

1. Gjithçka kemi mësuar deri tani në këtë studim duhet zbatuar në këtë pasazh. Kemi parë që engjëjt nuk mund të mëkatojnë dhe se nuk mund të ketë rebelim në qiell. Kështu, ky pasazh – i cili është i vetmi i llojit të vet – duhet interpretuar në një mënyrë që nuk ka të bëjë me mëkatimin e engjëjve apo ekzistencën e engjëjve mëkatarë që i bëjnë njerëzit të mëkatojnë, duke parë që mëkati vjen nga brenda nesh, jo nga jashtë nesh (Mk. 7:20-23).
2. Gjarpri është dëbuar nga qielli, duke nënkuptuar se në fillim ka qenë atje. Por, gjarpri si i tillë në Eden u krijua nga Perëndia prej pluhurit të tokës (Zan. 1:24-25). Nuk ka asnjë shenjë se djalli zbriti nga qielli dhe hyri brenda gjarprit.
3. Vëreni me kujdes që këtu nuk ka ndonjë referencë ndaj engjëjve që mëkatojnë apo që rebelohen kundër Perëndisë, veçse një luftë në qiell. Nuk ka mundësi që ndokush të luftojë Perëndinë në Qiell: “Askush nuk mund të kundërshtojë atë që bëj Unë” (Br. 32:39 G.N.B.).
4. Pas dramës së vargjeve 7-9, v.10 thotë se “një zë i lartë tha në qiell, *Tani* u tregua shpëtimi dhe forca, dhe mbretëria e Perëndisë sonë, dhe pushteti i Krishtit të Tij: se akuzuesi i vëllezërve tanë, që i akuzonte ditë e natë para

Perëndisë, është dëbuar.” Nëse vargjet 7-9 ndodhi në fillimin e botës, përpara kohës së Adamit dhe Evës, si mund të thuhet që pas rënies së satanit erdhi shpëtimi dhe mbretëria e Perëndisë? Pas mëkatit të Adamit, njerëzimi filloi historinë e vet të dëshpëruar të skllavërisë para mëkatit dhe dështimit – një gjendje që zor të mund të përshkruhet si “shpëtim” dhe si mbretëria e Perëndisë. Ka gëzim që djalli – akuzuesi – është dëbuar nga qielli. Atëhere, pse duhet të ketë gëzim nëse ardhja e tij në tokë ishte fillimi i mëkatit dhe shkatërrimit për njeriun? Nëse rënia nga qielli kuptohet figurativisht dhe jo fjalëpërfjalë, si rënie nga autoriteti (si Jesh. 14:12; Jir. 51:53; Vaj. 2:1; Mt. 11:23), atëhere e gjithë kjo ka më shumë logjikë. Nëse e gjithë kjo ndodhi përpara kohës së Adamit, ose të paktën përpara rënies së njeriut, si mundet që djalli të ketë akuzuar “vëllezërit tanë,” nëse ata as që ekzistonin atëherë?

5. Nuk ka asgjë që të tregojë se e gjithë kjo ndodhi në Kopshtin e Edenit apo përpara kohës së tij. Një argument jetësor jepet në Ap. 1:1 dhe 4:1 – se Zbulesa (Apokalipsi) është një profeci e “gjërave që duhet të ndodhin së shpejti.” Prandaj, nuk është përshkrim i asaj që ndodhi në Eden, por një profeci e gjërave që do të ndodhnin dikur pas shekullit të parë, kur u dha Zbulesa nga Jezusi. Kushdo që vërtet e respektoon Fjalën do të shohë që ky argument i vetëm zhvlerëson të gjitha përpjekjet për t’ia referuar Ap. 12 kopshtit të Edenit. Gjithashtu, i duhet dhënë përgjigje pyetjes se pse identiteti i djallit dhe informacioni mbi atë që ndodhi në Eden duhet rezervuar deri në fund të Biblës përpara se të zbulohet.

6. “Kuçedra e madhe ishte...ai gjarpri i vjetër” (Ap. 12:9.) kuçedra kishte “shtatë koka dhe dhjetë brirë” (v. 3), dhe prandaj nuk ishte fjalëpërfjalë një gjarpër. Fakti që quhet “ai gjarpri i vjetër” tregon se kishte karakteristikat e gjarprit në Eden, në kuptimin e të qenit mashtrues, siç ishte gjarpri. Në mënyrë të ngjashme, “kafshimi i vdekjes është mëkati” (1 Kor. 15:56), por kjo nuk do të thotë që kjo vdekje është një gjarpër fjalëpërfjalë. Ka karakteristikat e gjarprit, përmes shoqërizimit me mëkatin.

7. Djalli u hodh poshtë në tokë dhe ishte jashtëzakonisht agresiv “sepse e di që ka veç pak kohë” (v. 12). Nëse djalli u hodh poshtë në Eden, ai ka pasur shansin ta torturojë njeriun gjatë gjithë historisë së tij të gjatë – e cila zor të quhet dot veç “pak kohë” gjatë së cilës të shkatërrojë.

8. Si mund të kishte vendosur djalli “të gjithë botën” (v. 9) përpara se të ishte dëbuar nga qielli, kur shohim se në botë nuk qe askush përpara Adamit?

9. V. 4 thotë se kuçedra ngriti një të tretën e yjeve të qiellit me bishtin e saj. Nëse kjo lexohet fjalëpërfjalë – dhe Ap. 12 duhet lexuar fjalëpërfjalë që të mbështesë interpretimin popullor – vetë përmasat e kuçedrës janë të pamata – një e treta e gjithë gjithësisë (ose të paktën e sistemit diellor) mund të

mbahej veçse në bishtin e saj. Nuk ka asnjë mundësi që planeti tokë të mund të ishte aq i madh sa të mbante një krijesë të tillë gjigande shtrirë mbi të. Shumica e yjeve janë më të mëdhenj se toka jonë – atëhere, si mund të ulëshin mbi tokë një e treta e tyre? Është vlerësuar se një e treta e yjeve do të shtrihet në afro pesë trilionë milje. Kaq do të duhej të ishte bishti i kuçedrës! Dhe mbani mend, që gjithë kjo ka ndodhur, ose do të ndodhë, pas shekullit të parë A.D. kur u dha kjo profeci.

10. Nën dritën e kësaj dhe shumë gjërave të tjera në Ap. 12 (dhe gjithë profecisë) të cilat nuk kanë mundësi të qëndrojnë nëse lexohen fjalëpërfjalë, nuk është për t'u çuditur që pikë së pari na thuhet (Ap. 1:1) që ky është një mesazh që është “shënjuar” – d.m.th. dhënë në gjuhën e shenjave, ose simboleve. Si për ta theksuar këtë në kontekstin e Ap. 12, Ap. 12:1 përshkruan veprimet pasuese si një “shenjë të madhe” (A.V. anë faqes).

11. Duke lexuar për atë që bën djalli kur është mbi tokë, nuk ka ndonjë përshkrim të tij tek u shkakton njerëzve të mëkatojnë; vërtetë, vargjet 12-16 tregojnë që djalli ishte i pasuksesshëm në përpjekjet e tij për të shkaktuar trazira në tokë sapo arriti aty. Kjo është në kundërshtim me interpretimin popullor.

12. Një prej pyetjeve kyçe për të kuptuari nëse ky pasazh e mbështet idenë e një lufte fjalëpërfjalë në qiell, është nëse “qielli” për të cilin flitet këtu është fjalëpërfjalë apo figurativ. Më parë shpjeguar që “qiell” mund t'i referohet figurativisht një vendi autoriteti. Është me vend të mendojmë që përderisa Zbulesa (Apokalipsi) është një libër aq simbolik, edhe në këtë rast duhet të jetë e njëjta gjë.

Gruaja e v. 1 është “veshur me diell, me hënën në këmbët e saj dhe një kurorë me dymbëdhjetë yje në kokë.” Këto trupa qiellorë, si dhe gruaja, të gjithë të cilët qëndrojnë pezull në ajër, nuk mund të qëndrojnë fjalëpërfjalë. Dhe, fjalëpërfjalë, ajo nuk mund të jetë e veshur me diell, apo të ketë yje të mëdhenj sa toka mbi kokën e saj (sa të njeriut).

Një tjetër shenjë paraqitet në qiell në v. 3 – një kuçedër e kuqe. Shpesh kjo merret si qielli fjalëpërfjalë, por pse duhet të jetë kështu, kur shohim se të njëjtit qiell i referohet në v. 1 dhe është qartësisht figurativ? V. 4 e tregon kuçedrën të hedhë një të tretën e yjeve të qiellit mbi tokë. Pamë që për shkak të përmasave të yjeve dhe të tokës, kjo nuk mund ta ketë fjalën për yjet apo qiellin fjalëpërfjalë. Mbretëria e Perëndisë do të vendoset mbi tokë (Dan. 2:44; Mt. 5:5), çka nuk do të jetë e mundur nëse toka është shkatërruar (gjë që do të ndodhte) nga yje gjigandë që bien mbi të.

Gruaja në “qiell” pastaj lindi fëmijën e saj, i cili “u rrëmbye në qiell, drejt fronit të Perëndisë” (v. 5). Froni i Perëndisë është në qiell. Nëse gruaja ishte tashmë në qiell, pse duhej që fëmija i saj “të rrëmbehej” në qiell? Ajo duhet

të ketë qenë simbol i diçkaje mbi tokë, megjithëse në një “qiell” figurativ. Pastaj ajo iku “në shkretëtirë” (v. 6). Nëse ishte në qiellin fjalëpërfjalë, kjo do të thotë që në qiell ka një shkretëtirë. Është shumë më me vend që ajo të jetë në një vend figurativ qiellor, dhe të ikë në një shkretëtirë tamam ose figurative mbi tokë.

Pastaj vijmë tek v. 7 – “në qiell shpërtheu një luftë.” Duke qenë se të gjitha referimet ndaj “qiellit” në Ap. 12 kanë qenë figurative, është veçse konsekuente që kjo të ketë qenë luftë në një qiell figurativ. Duhet të jetë kështu, sepse nuk mund të ketë rebelim apo mëkat në qiellin fjalëpërfjalë (Mt. 6:10; Ps. 5:4,5; Hav. 1:13). Pikëpamja e zakonshme thotë se engjëjt e liq janë mbyllur në ferr; ndërsa këtu qenkan në qiell. Prandaj, nuk janë engjëjt të mirëfilltë.

Shkrimtari i pranishëm hera-herës pyet ata që besojnë në idenë ortodokse të djallit: *‘A mund të më jepni një histori të shkurtër biblike të djallit, sipas interpretimit tuaj të pasazheve të Biblës?’* Përgjigja është shumë kontradiktore. Sipas arsyetimit ‘ortodoks’, përgjigja duhet të jetë diçka e këtillë.

- a) Djalli ishte një engjëll në qiell që u dëbua dhe u hodh në kopshtin e Edenit. Ai u hodh në tokë në Zan. 1.
- b) Ai supozohet të ketë ardhur në tokë dhe të jetë martuar në Zan. 6.
- c) Në kohën e Ijovit, thuhet se ai kishte akses si ndaj qiellit ashtu dhe ndaj tokës.
- d) Në kohën e Jesh. 14, ai dëbohet nga qielli dhe hidhet mbi tokë.
- e) Në Zeh. 3, ai është përsëri në qiell.
- f) Ai është mbi tokë në Mt. 4.
1. Ai “dëbohet” në kohën e vdekjes së Jezusit, sipas idesë popullore për “princin e kësaj bote” që u “dëbua” në atë kohë.
- g) Ka një profeci për ‘dëbimin’ e djallit në Ap. 12.
- h) Djalli “lidhet në zinxhirë” në Ap. 20, por ai dhe engjëjt ishin lidhur me zinxhirë tek Zanafilla, sipas pikëpamjes së zakonshme të Juda v. 6. Nëse ka qenë lidhur me ‘zinxhirë të përjetshëm’ atëhere, si është lidhur përsëri me zinxhirë në Rev. 20?

Nga kjo duhet të jetë e qartë që pikëpamja popullore se djalli u dëbua nga qielli për shkak të mëkatit nuk mund të jetë e vërtetë, përderisa ai është

përshkruar sikur është ende në qiell pas çdo rasti ‘dëbimi.’ Është jetësore të kuptohet si qielli ashtu dhe djalli në kuptimin figurativ.

SHPJEGIME TË SUGJERUARA.

1. Përpjekja për ta shpjeguar këtë kapitull plotësisht është përtej fushës së shënimeve tona të tanishme. Një shpjegim i plotë i këtyre vargjeve kërkon të kuptuarit e të gjithë librit të Apokalipsit (Zbulesës) me qëllim që të vendosen në kontekst.
2. Konflikti në qiellin figurativ – d.m.th. një vend autoriteti – për rrjedhojë, ishte midis dy grupeve të fuqisë, secili me pasuesit, ose engjëjt, e vet. Kujtoni që kemi treguar se djalli dhe satani shpesh shoqërizohen me sistemet romake apo çifute.
3. Që djalli-kuçedra përfaqëson një lloj pushteti politik e tregon fakti që kishte “kurora mbi kokat e tij” (v. 3). Ap. 17:9,10 gjithashtu komenton mbi këtë kuçedër: “Këtu kërkohet mendja që mund ta shpjegojë (ka mençuri)” – d.m.th. mes u përpiqni ta kuptoni këtë kafshë si një qenie të mirëfilltë – “Shtatë kokat janë shtatë male... këta janë shtatë mbretërit.” Shprehja se një prej mbretërve vazhdon “për pak kohë,” ndoshta lidhet me përshkrimin që djalli-dragon ka “veç pak kohë” në Ap. 12:12.

Digresion 22: Jezusi Historik

Nëse, siç pretendojnë ca, nuk ka fakte që Jezusi nga Nazareti ka ekzistuar ndonjëherë, atëherë është e vështirë të shpjegohet edhe vetë ekzistenca e krishtërit. Do të thotë të kërkosh tepër shumë nëse pret që dikush të besojë që miliona njerëz gjatë 2,000 vjetëve të fundit i kanë bazuar besimet e tyre mbi dikë që nuk ka ekzistuar kurrë dhe të kenë një besim kaq të fortë në atë sa të kenë qenë të motivuar të përhapin besimin e tyre tek ai në mbarë botën, shpesh duke rrezikuar të persekutohen dhe të vdesin. Kristianët dhe çifutët në përgjithësi nuk kanë vështirësi të pranojnë që Muhamedi ka ekzistuar dikur, ndërkohë që kundërshtojnë pretendimet dhe mësimet e tij. Vërtet, ne pranojmë që shumica e personazheve të famshme historike kanë ekzistuar, pa kërkuar një rishikim kritik të fakteve. Shpesh, janë bërë analiza të ngjarjeve historike të pranuar gjerësisht, p.sh. që beteja në Hastings ka ndodhur në vitin 1066, dhe faktet konkrete kanë qenë relativisht të vështira të gjenden.

Fakti që disa e mohojnë aq fort vetë ekzistencën e Jezusit nga Nazareti sigurisht tregon një mbireagim, një dëshirë për të gjetur një shfajësim komod për të mos përballuar arsyet për të pranuar qenien e tij si Mesia. Kjo

duket veçanërisht e vërtetë kur vlerësohet se vetë çifutët e hershëm pranonin që një person i quajtur Jezus kishte ekzistuar në shekullin e parë. Faktet e mëposhtme historike për ekzistencën e Jezusit nga Nazareti tregojnë që ai nuk mund të injorohet në asnjë mënyrë si një shpikje teologjike e njerëzve. Informacion shumë i dobishëm në këtë seksion është mbledhur nga Gary Habermas, 'Fakte të Lashta për Jetën e Jezusit.'

1. Taciti ishte një historian romak, dy librat kryesorë të të cilit ("Analet" dhe "Historitë") e përmendin të dy Jezusin dhe Krishtërimin. Ai shkruante në "Analet" (afro 115 AD):

"Një klasë e urryer për neveritë e tyre, të quajtur kristianë nga popullata. Krishti (Christus), nga i cili emri kishte prejardhjen, vuajti dënimin ekstrem gjatë sundimit të Tiberit në duart e një prej prokuratorëve tanë, Ponc Pilatit." Perandori Tiber sundoi nga 14-37AD, periudhë gjatë së cilës u vra Krishti, sipas këtij shkrimi. Taciti përshkruan gjithashtu se si besimet e këtij grupi (u përhapën jo vetëm në Jude, burimi i parë i (këtyre ideve), por edhe në Romë," dhe vazhdon të përshkruajë se si kristianët urreheshin gjerësisht, dhe shumë u dënuan me vdekje në Romë. E gjithë kjo përputhet me shkrimet e Dhiatës së Re për Jezusin, dishepujt dhe apostujt, të cilët në fillim i përhapën mesimet e tyre në Jude, dhe pastaj në mbarë botën romake, përfshi edhe Romën, duke hasur kundërshti të madhe.

2. Suetoni, një tjetër historian romak, komentonte mbi sundimin e Klaudit (41-54 AD): "Ngaqë çifutët në Romë shkaktuan trazira të vazhdueshme me fillimin e Chrestus (Krishtit), ai (Klaudi) i dëboi ata nga qyteti." "Chrestus" është një tjetër mënyrë të shkruari e emrit "Krisht." Aksidentalisht, Veprat 18:2 përshkruan se si një çift çifut quajtur Akuila dhe Prishila u detyruan të linin Romën për shkak të persekutimit të çifutëve.

Më pas, Suetoni komenton mbi persekutimin e kristianëve në kohën e Neronit: "Pas zjarrit të madh në Romë...Ndëshkime ranë edhe mbi kristianët, një sekt që kishte një besim të ri dhe të dëmshëm fetar." Ky referim ndaj ekzistencës së një grupi të quajtur "kristianë" në shekullin e parë sugjeron se një person i quajtur "Krisht" kishte ekzistuar më parë në atë shekull.

3. F.F.Bruce ("Origjinat Kristiane" f.29,30) tërheq vëmendjen ndaj faktit që ekzistojnë referime ndaj një historie të Mesdheut Lindor shkruar nga një historian i quajtur Talus rreth vitit 52AD. Bruce tregon tjetërkund ("Dokumentet e Dhiatës së Re," f. 113) se një studiues i quajtur Jul Afrikanus, citon nga Talus, duke u tallur me përshkrimin e errësirës në kohën e kryqëzimit të Jezusit sikur ishte shkaktuar nga eklipsi i diellit. Kjo sugjeron që Talus ka shkruar një histori të kryqëzimit të Jezusit që kishte ngjarë disa vjet përpara se ai të shkruante historinë e tij në vitin 52AD.

4. Pliny, një zyrtar qeveritar romak, përmend gjerë e gjatë ekzistencën e një grupi aktiv njerëzish quajtur kristianë, në vitet e pasme të shekullit të parë. Ai i referohet mënyrës se si kryenin shërbesat përkujtuuese: “Ata kishin zakon të takoheshin në një ditë të caktuar përpara se të errësohej, kohë kur këndonin me vargje të alternuara një himn për Krishtin” (“Letra për Pliny,” përkthyer nga W.Melmoth, Vëll.2, X:96). Perandorët romakë Trajani dhe Adriani të dy e përmendnin problemin e trajtimit të kristianëve. Për referencat ndaj kësaj, shih “Letra për Pliny” Vëll.2, X:97 dhe Historinë Kishtare të Eusebiusit, respektivisht IV:IX. Ekzistenca e këtij grupi qysh nga shekulli i parë dhe vendosmëria e tyre e jashtëzakonshme gjatë persekutimit tregojnë se ishin pasues të një personazhi real historik që kishte jetuar në shekullin e parë.

5. Talmudi, një libër i shenjtë çifut, në Sanhedrin 43a i referohet vdekjes së Jezusit. Është diçka e pranuar që kjo pjesë e Talmudit daton qysh nga periudha e hershme e shkrimit të librit (d.m.th. 70-200 AD).

“Në prag të Pashkës, Jeshui (Jezusi) u var. Për dyzetë ditë përpara se të kryhej ekzekutimi, një lajmës sillej rrotull dhe bërtiste, ‘Ai do të qëllohet me gurë sepse ka praktikuar magji dhe e ka shtyrë Izraelin në braktisje. Cilido që mund të thotë diçka në favor të tij, le të dalë përpara në emër të tij.’ Por meqenëse asgjë nuk doli në favor të tij, ai u var në prag të Pashkës.”

“Varur” mund të jetë një idiomë për kryqëzimin – kështu përdoret në Dhiatën e Re (Gal. 3:13; Lk. 23:39). Ky pasazh përshkruan çifutët që duan që Jezusi të goditet me gurë (në përputhje me ligjin e Moisiut, ndoshta?), por përmend që në fakt ai u var. Shpjegimi për këtë jepet nga përshkrimi që Dhiata e Re jep për mënyrën se si çifutëve iu desh të përdornin ligjin romak për të zbatuar vdekjen e Jezusit – çka do të ishte përmes varjes.

Sanhedrin 43a gjithashtu përshkruan se si pesë dishepuj të Jezusit u gjykuan dhe u dënuan me vdekje, çka tregon përsëri që çifutët kanë besuar tradicionalisht në ekzistencën e Jezusit historik. Madje, Sanhedrin 106b thotë edhe që Jezusi ishte 33 vjeç kur vdiq; saktësisht aq sa thuhet nga dhiata e Re. Maieri (“Pashka e Parë”, f.117,118) citon nga dokumenti çifut i shekullit të pestë “Toledoth Jesu”, i cili thotë se dishepujt u përpoqën ta vidhnin trupin e Jezusit pas vdekjes së tij, por një kopshtar i quajtur Judë, i dëgjoi planet e tyre dhe e çoi trupin e Jezusit tjetërkund, duke ia dhënë çifutëve më pas. Justin Martyr që shkruan në vitin 150AD regjistron se çifutët dërguan lajmëtarë specialë për të thënë që trupi i Jezusit ishte vjedhur

(“Dialog me Trifon,” 108), dhe Tertulian (“Mbi Vizionet”, 30) jep një histori të ngjashme kur shkruante në vitin 200AD.

Mes tyre, këto elementë faktesh tregojnë se çifutët e shekujve të hershëm AD besonin në ekzistencën dhe vdekjen e dhunshme të Jezusit historik.

6. Dramaturgu grek Lucian, i cili shkroi në shekullin e dytë, tallet me kristianët që “adhurojnë edhe sot e kësaj dite një njeri (i cili) u kryqëzua” (Luciani, Vdekja e Shtegtarit, 11-13, në “Veprat e Lucianit,” vëll. 4, përkthyer nga Fowler dhe Fowler).

7. Jozefusi është historiani më i mirënjohur i shekullit të parë. Në librin e tij “Lashtësitë,” shkruar në 90-95AD, ai përmend Jakobin, “vëllai i Jezusit, i cili quhej Krisht.” Ai flet edhe në një pjesë tjetër të të njëjtit libër me fjalë që e mbështesin qartë figurën e Jezusit në Dhiatën e Re.

“Rreth kësaj kohe, ishte Jezusi, një burrë i mençur...Sepse ishte i tillë që bënte punëra që të çudisnin...Ishte Krishti...ai iu shfaq atyre i gjallë ditën e tretë, siç kishin parathënë profetët hyjnorë këto dhe dhjetë mijë gjëra të tjera të mrekullueshme në lidhje me të.”

Aq i mprehtë është ky pasazh sa disa kanë thënë se është një shpërthim.

Shqyrtimet e mëposhtme ofrojnë fakte që ka ende arsye për ta përdorur këtë pasazh në mbështetje të argumentit se ka qenë një burrë i quajtur Jezusi nga Nazareti që ka jetuar në shekullin e parë:

- Eusebiusi (Historia Kishtare, 1:XI) e citon këtë pjesë nga Jozefusi.
- Studiues të respektuar e mbështesin këtë lexim të parë si origjinal dhe mund të tregojnë që ky seksion është shkruar në të njëjtin stil si pjesa tjetër e punës së Jozefusit (Shih Daniel Rops, “Heshtja e Bashkëkohësve të Jezusit”, f.21; J.N.D. Anderson, “Krishtërimi: Dëshmia e Historisë” f. 20; F.F.Bruce, “Dokumentet e Dhiatës së Re” f. 108,109).
- Nuk ka fakte tekstuale që kjo të jetë një shpërthim.
- Profesori Schlomo Pines pohon që ishte gjetur botimi arabisht i veprave të Jozefusit dhe ishte pothuajse e sigurtë të ishte origjinali. Pasazhi të cilit i referohet më sipër shfaqet atje, por pa pohimet e dukshme doktrinale në lidhje me ringjalljen dhe qenien Mesia të Jezusit, të cilat bëhen në pjesëzën e dhënë lart. Kjo duket e arsyeshme, duke pasur parasysh që Jozefusi ishte çifut. Në fillim, Pines i bëri zbulimet e tij publike në artikuj në gazetën “The New York Times”, 12 Shkurt 1972, në të cilat citon pasazhin e përfolur të Jozefusit mbi Jezusin, nga versioni arabisht: “Në këtë kohë ishte një burrë i mençur që quhej

Jezus. Dhe sjellja e tij ishte e mirë dhe njihej të ishte i virtytshëm. Shumë njerëz mes çifutëve dhe popujve të tjerë u bënë dishepujt e tij. Pilati e dënoi me kryqëzim dhe vdekje. Ata që ishin bërë dishepujt e tij nuk e braktisën dishepullinë e tij. Ata raportuan se ai u ishte shfaqur tri ditë pas kryqëzimit dhe se ishte i gjallë; prandaj, ai ndoshta ishte Mesia për të cilin profetët kanë treguar mrekullira.”

Kjo histori përshtatet në mënyrë të admirueshme me atë të Dhiatës së Re.

Digresion 23: “Unë zbrita nga Qielli”

Buka e Perëndisë që zbret nga qielli, dhe i jep jetë botës... Unë erdha nga qielli” (Gjn. 6:33,38).

Këto fjalë, dhe të tjera si ato, keqpërdoren për të mbështetur idenë e gabuar se Jezusi ekzistonte në Qiell përpara se të lindte. Megjithatë, duhen vërejtur pikat e mëposhtme.

1. Ata që besojnë në trininë i kuptojnë këto fraza fjalëpërfjalë me qëllim që të vërtetojnë argumentin e tyre. Megjithatë, nëse i marrim fjalëpërfjalë, kjo do të thotë që në një farë mënyre, Jezusi zbriti fizikisht si person. Jo vetëm që në lidhje me këtë Bibla nuk shprehet asfare, por gjuha e Jezusit që *ngjizet* si foshnje në mitrën e Marisë shndërrohet në të pakuptimtë. Gjn. 6:60 përshkruan mësimin mbi manan se ka kuptimin “nuk dëgjohet” (Përkthimi i Moffatt); d.m.th. duhet të kuptojmë që gjuha që përdoret është figurative.
2. Në Gjn. 6, Jezusi shpjegon se si mana ishte një lloji i tij. Mana u dërgua nga Perëndia në kuptimin që Perëndia ishte përgjegjës për krijimin e saj mbi tokë; nuk se zbriti fizikisht nga froni i Perëndisë në Qiell. Kështu, ardhja e Krishtit nga Qielli duhet kuptuar në këtë mënyrë; ai u krijua në tokë, nga Shpirti i Shenjtë që veprroi mbi mitrën e Marisë (Lk.1:35).
3. Jezusi thotë se “Buka që do të jap unë është *trup i im*” (Gjn. 6:51). Mbështetësit e trinisë pretendojnë se ishte pjesa ‘Perëndi’ e Jezusit që erdhi nga Qielli. Por Jezusi thotë se “trup i” i tij ishte buka që erdhi nga Qielli. Po kështu, Jezusi e shoqëron bukën nga Qielli me veten si “*Bir i Njeriut*” (Gjn. 6:62), jo si ‘Perëndia Bir’.
4. Në po këtë pasazh në Gjn. 6, ka fakte të bollshme që Jezusi nuk ishte i barabartë me Perëndinë. “Mua më ka *dërguar* Ati prej të cilit vjen jeta” (Gjn. 6:57) tregon që Jezusi dhe Perëndia nuk janë të bashkë-barabartë; dhe si zor që fakti “Unë jetoj me anën e Atit” (Gjn. 6:57) të jetë ‘bashkë-përjetësia’ për të cilën flasin mbështetësit e trinisë.
5. Duhet pyetur, Kur dhe si ‘zbriti’ Jezusi nga Qielli? Trinitarët përdorin këto vargje në Gjn. 6 për të ‘provuar’ që Jezusi zbriti nga Qielli kur lindi.

“Por Jezusi flet për veten si “ai që zbret nga qielli” (v. 33, 50) si të jetë një proces në vazhdim. Duke folur për dhuratën Jezus të Perëndisë, Krishti tha “Ati im *po ju jep* bukën” nga Qielli (v.32 Weymouth). Në kohën që Jezusi po fliste këto fjalë, ai tashmë kishte ‘zbritur’ në një kuptim, në atë që ishte dërguar nga Perëndia. Për shkak të kësaj, ai mund të fliste edhe në kohën e shkuar: “Unë jam buka e gjallë që *erdhi* nga Qielli” (v.51). Por ai flet edhe për ‘zbritjen’ si buka nga Qielli në formën e vdekjes së tij mbi kryq: “Buka që *do të* jap unë është trupi im, të cilën e jap që bota të jetojë” (v. 51). Pra këtu Jezusi flet se ka ardhur tashmë nga Qielli, është në procesin e ‘ardhjes’ (zbritjes) dhe që prapë ‘ka për të ardhur’ në vdekjen e tij mbi kryq. Vetëm ky fakt duhet të provojë që ‘zbritja’ i referohet Perëndisë që manifeston Vetën, në vend që vetëm t’i referohet lindjes së Krishtit. Kjo vërtetohet bindshëm nga të gjitha referencat e Dhiatës së Vjetër ndaj Perëndisë, ku ‘zbritja’ ka pikërisht këtë kuptim. Kështu, Perëndia pa vuajtjen e popullit të Tij në Egjipt dhe ‘zbriti’ t’i shpëtonte përmes Moisiut. Ai ka parë lidhjen tonë me mëkatën, dhe ka ‘zbritur’ ose është manifestuar, duke dërguar Jezusin si ekuivalent i Moisiut për të na nxjerrë nga ajo lidhje (me mëkatën).

Digresion 24: A e krijoi Jezusi Tokën?

“I parëlinduri i çdo krijese: sepse përmes (Jezusit) u krijuan të gjitha gjërat që janë në qiell, dhe që janë në tokë, gjithçka e dukshme dhe e padukshme, qofshin frone, sundime, principata apo fuqi; të gjitha u krijuan prej tij dhe për të: ai ekzistonte para të gjithave dhe të gjitha qëndrojnë me anë të tij. Ai është kreu i trupit, bashkësisë: ai është fillimi, i pari i ringjallur nga të vdekurit...” (Kol. 1:15-18). Ky është tipik i atyre pasazheve që mund të japin përshtypjen sikur në fakt ishte Jezusi që e krijoi tokën.

1. Po të ishte e vërtetë kjo, atëhere kundërshtohen shumë pasazhe të tjera që japin mësimin që Jezusi nuk ekzistonte para se të lindte. Kjo histori në Zanafilla jep qartë mësimin se krijuesi ishte Perëndia. Krijuesi ishte ose Jezusi ose Perëndia; nëse themi se krijuesi ishte Jezusi ndërkohë që Zanafilla thotë se ishte Perëndia, atëhere jemi duke thënë se Jezusi ishte drejtpërdrejt i barabartë me Perëndinë. Në këtë rast, është e pamundur të shpjegohen vargjet e shumta që tregojnë dallimet mes Perëndisë dhe Jezusit (shih Studimin 8.2 për shembuj të kësaj).
2. Jezusi ishte “*i parëlinduri*,” çka nënkupton një fillim. Nuk ka prova që Jezusi ishte “i parëlinduri” i Perëndisë përpara krijimit të tokës fizike. Pasazhe si 2 Shëm. 7:14 dhe Ps. 89:27 parashikonin se një pasardhës fizik i

Davidit do të bëhej i parëlinduri i Perëndisë. Është e qartë që ai nuk ekzistonte në kohën kur u shkruan këtë pasazhë dhe për rrjedhojë as në kohën e krijimit të Zanafillës. Jezusi u bë “Biri i Perëndisë me pushtet” përmes ringjalljes së tij nga të vdekurit (Rom. 1:4). Perëndia “e ka ngritur përsëri Jezusin; siç shkruhet edhe në psalmin e dytë, Ti je Biri Im, *këtë ditë të kam emëruar*” (Veprat 13:32,33). Kështu, Jezusi u bë i parëlinduri i Perëndisë përmes ringjalljes së tij. Vëreni gjithashtu që biri që qëndron në krahun e djathtë të atit të tij shoqërizohet me të qenit i parëlinduri (Zan. 48:13-16), dhe Krishti u lartësua në krahun e djathtë të Perëndisë pas ringjalljes së tij (Veprat 2:32 V.R.mg.; Heb. 1:3).

3. Në këtë sens Jezusi përshkruhet si i parëlinduri nga të vdekurit (Col. 1:18), një frazë që është paralele me “të parëlindurin e çdo krijese” apo krijimi (Col. 1:15 V.R.). Prandaj, ai flet për veten e tij si “i linduri i parë nga të vdekurit... fillimi i krijimit të Perëndisë” (Ap. 1:5; 3:14). Jezusi ishte i pari i një krijimi të ri burrash e grash të pavdekshëm, ringjallja dhe lindja e plotë e të cilëve si bijtë e pavdekshëm të Perëndisë është bërë e mundur përmes vdekjes dhe ringjalljes së Jezusit (Ef. 2:10; 4:23,24; 2 Kor. 5:17). “Në qoftë se ata (besimtarët e vërtetë) lidhen me Krishtin, ata do të marrin jetën e re. por, çdokush sipas radhës së vet: Si i pari, u ngjall Krishti, pas kthimit të tij, do të ringjallen ata që i takojnë atij” (1 Kor. 15:22,23). Kjo është pikërisht e njëjta ide si në Kol. 1. Jezusi ishte personi i parë që u ngjall nga të vdekurit dhe që iu dha pavdekësia, ai ishte i pari i një krijimi të ri, dhe besimtarët e vërtetë do të ndjekin shembullin e tij kur ai të kthehet.

4. Krijimi për të cilin flitet tek Kol. 1, për rrjedhojë, i referohet krijimit të ri, dhe jo atij të Zanafillës. Përmes punës së Jezusit, “u krijuan të gjitha...fronet...sundimtarët” etj. Pali nuk thotë që Jezusi i krijoi të gjitha dhe pastaj të japë shembuj lumenjsh, malesh, zogjsh, etj. Elementët e këtij krijimi të ri i referohen atyre shpërblimeve që ne do t'i kemi në Mbretërinë e Perëndisë. “Fronet...sundimet” etj., i referohet asaj se si besimtarët e ngjallur do të jenë “mbretër e priftërinj, dhe ne do të sundojmë në tokë” (Ap. 5:10). Këto gjëra u bënë të mundura përmes veprës së Jezusit. “Me anë të tij u krijua çdo gjë *në qiell*” (Kol. 1:16 V.R.). Në Ef. 2:6 leoxjmë për besimtarët që janë *në Krisht* dhe të ulur në “vende hyjnore.” Nëse ndonjë njeri është *në Krisht* përmes pagëzimit, ai është një krijim i ri (2 Kor. 5:17). Duke qenë *në Krisht*, ne shpëtohem përmes vdekjes së Tij (Kol. 1:22). Planeti fizikisht nuk mund të krijohej duke qenë *në Krisht*. Pra, këto vargje japin mësimin se pozita e lartësuar shpirtërore që mund të kemi tani, si dhe ajo çka do të përjetojmë në të ardhmen, është bërë e mundur nga Krishti. “Qiejt dhe toka” përmbajnë “të gjitha gjërat që kishin nevojë për pajtim përmes gjakut të kryqit (të Krishtit)” (Kol. 1:16,20), çka tregon që “të gjitha

gjërat...në qiell” i referohen besimtarëve që tani janë ulur në “vende hyjnore...në Krishtin Jezus”, dhe jo të gjitha gjërave fizike përreth nesh.

5. Nëse krijuesi ishte Jezusi, është e çuditshme se si Ai duhet të thotë: “...nga fillimi i krijimit Perëndia i bëri...” (Mk. 10:6). Kjo sigurisht tingëllon me kuptimin që Ai kuptonte Perëndinë si krijues, jo Ai Vetë. Dhe nëse Ai fizikisht krijoi çdo gjë në Qiell, kjo do të përfshinte edhe Perëndinë.

Digresion 25: “Para se të ishte Abrahami, Unë jam” ***(Gjn. 8:58)***

Këto fjalë shpesh keqpërdoren për të dhënë mësimin se Jezusi ekzistonte përpara se të ekzistonte Abrahami. Megjithatë, një shqyrtim më nga afër zbulon se e kundërta është e vërtetë:

1. Jezusi nuk thotë ‘Përpara se të ishte Abrahami, *isha* Unë.’ Ai ishte pasardhësi i premtuar i Abrahamit; ne i shndërrojmë në budallallëk premtimet e Perëndisë para Abrahamit, nëse themi se Jezusi ekzistonte fizikisht përpara kohës së Abrahamit.
2. Konteksti i Gjn. 8:58 është biseda e Krishtit me çifutët në lidhje me Abrahamin. Për sa i përkiste atyre, Abrahami ishte njeriu më i madh që do të jetonte ndonjëherë. Jezusi thotë “Unë jam *tani*, tek qëndroj këtu, më i rëndësishëm se Abrahami.” Tek ata qëndronin aty, Jezusi ishte ai që duhej nderuar dhe jo Abrahami. Ai thotë ‘Unë jam *tani*, më i rëndësishëm se ç’ka qenë ndonjëherë Abrahami.’ Është e mundur që fjala “përpara” tek Gjn. 8:58 të kuptohet sikur i referohet kohës, në kuptimin që përpara se të ekzistonte Abrahami, Krishti kishte qenë në planin e Perëndisë qysh nga fillimi i botës. Ngaqë Jezusi ishte “përpara” Abrahamit në këtë kuptim, ai ishte “përpara” tij për nga rëndësia.
3. Provë për këtë gjendet tek Gjn. 8:56: “Ati yt Abrahami kërceu nga gëzimi kur duhej të parashikonte mbretërinë time; e parashikoi dhe u gëzua.” E vetmja kohë kur Abrahami regjistrohet të ketë qeshur dhe të ketë qenë i lumtur ishte kur iu dha premtimi se do të kishte pasardhës; ai kuptoi që tekefundit ai premtim i referohej Jezusit (Zan. 17:17). Abrahami “shikoi” drejt Krishtit përmes premtimeve që iu bënë në lidhje me Jezusin. Në mënyrë kriptike, ai komentoi mbi sakrificën e ardhshme të Jezusit: “Në malin e Zotit do të *shihet*” (Zan. 22:14). Pikërisht në këtë kuptim, Jezusi flet për Abrahamin sikur ta ketë *parë*. Pikërisht në këtë kontekst të folurit mbi premtimet, Jezusi mund të thoshte “Përpara se të ishte Abrahami, Unë jam.” Ai vlerësonte, siç kemi shpjeguar në Seksionin 3.1 që premtimet e Perëndisë

para Abrahamit po zbulonin planin për Jezusin, çka Perëndia e kishte ditur qysh nga fillimi i botës. Ai qëllim, i cili kishte qenë “para se të ishte Abrahami,” i qe zbuluar Abrahamit në premtimet që iu bënë dhe tani po përmbushej në sytë e çifutëve të shekullit të parë, tek qëndronin në formë rrethi përreth Jezusit, “fjala (e premtimit) e bërë trup.”

Digresion 26: Melkicedek

Shumë studentë të Biblës kanë thënë nga zemra ‘Amen’ për fjalët e apostullit Pjetër kur ai shkruante: “Vëllai ynë i dashur Pali... në të gjitha letrat e tij... në to ka fragmente të vështira për t’u kutptuar, të cilat i shtrembërojnë njerëzit e pamend dhe të lëkundshëm. Kështu veprojnë edhe me pjesët e tjera të shkrimit të shenjtë, duke i bërë të zezën vetes” (2 Pjt. 3:15,16). Në komentin mbi Melkicedekun në Hebrenjve; shkruesi pranonte se ai hynte thellë, fliste për gjëra që mund të kuptoheshin veçse prej besimtarëve shumë të pjekur (Heb. 5:10,11,14). Prandaj, nuk është fort e mençur të bazosh doktrinën themelore mbi mësimet e vargjeve të tilla; as nuk duhet që pasazhet e Melkicedekut të shihen lehtë në mendjet e atyre që vazhdojnë të mësojnë doktrinën bazë të Shkrimit të Shenjtë.

Për “Ky Melkicedeku, Mbret i (Jeru)salemit, dhe prift i më të lartit Perëndi, që e takoi Abrahamin kur kthehej nga beteja ku kishte mundur mbretërit, dhe e bekoj” flitet si “pa baba, pa nënë, pa prejardhje (gjenealogji), nuk ka as fillim të ditëve, as fund të jetës; ai i ngjan Birit të Perëndisë” (Heb. 7:1,3). Nga kjo, disa nxjerrin se Jezusi ekzistonte fizikisht përpara lindjes së tij, dhe për pasojë, nuk kishte prindër njerëzorë.

Jezusi ka një At (Perëndinë) dhe një nënë (Marinë) dhe gjenealogji (shih Mt. 1, Lk. 3 dhe krahaso Gjn. 7:27). Prandaj, ‘Melkicedek’ nuk mund t’i referohet atij personalisht. Për më tepër, Melkicedeku ishte “bërë SI Biri i Perëndisë” (Heb. 7:3); ai nuk ishte vetë Jezusi, por kishte ngjashmëri të caktuara me të që po përdoren nga autori për qëllime mësimi. “emëroi një prift tjetër,” Jezusi (Heb. 7:15), i cili u bë prift “sipas rendit të Melkicedekut” (Heb. 5:5,6).

Gjuha e Hebrenjve mbi Melkicedekun thjesht nuk mund të merret fjalëpërfjalë. Nëse Melkicedeku nuk kishte vërtet as baba as nënë, atëhere i vetmi person që mund të kishte qenë, ishte Vetë Perëndia; Ai është i vetmi person pa fillim (1 Tim. 6:16; Ps. 90:2). Por kësaj i vihet vetoja nga Heb. 7:4: “Mendoni sa i madh ishte ky njeri,” si dhe nga fakti që ai ishte parë nga njerëzit (Perëndia nuk mund të shihet) dhe ofroi sakrifica për Perëndinë. Nëse ai quhet njeri, atëhere ai duhet të ketë pasur prindër fizikë. Qenia e tij

“pa baba, pa nënë, pa prejardhje,” për pasojë, duhet t’i referohet faktit që prejardhja dhe prindërit e tij nuk janë regjistruar. Prindërit e Mbretëreshës Estera nuk janë regjistruar dhe prejardhja e saj përshkruhet në mënyrë të ngjashme. Mordekai “e rriti... Esterën, bijën e xhaxhait të tij; se ajo s’kish as baba as nënë... të cilën Mordekai, pas vdekjes së prindërve të saj, e adoptoi si bijën e tij” (Estera 2:7).

Libri i Zanafillës shpesh flet me hollësi të mëdha për të dhënë prejardhjet e familjeve të të gjithë personazheve që na paraqet. Por Melkicedeku shfaqet në skenë i pashpallur, pa të dhëna për prindërit e tij, dhe zhduket nga historia po aq papritur. E megjithatë, nuk mund të ketë dyshim që ai ishte i denjë për t’u respektuar; edhe vetë Abrahami i madh i paguante të dhjetat dhe u bekua prej tij, duke treguar qartë superioritetin e Melkicedekut mbi Abrahamin (Heb. 7:2,7).

Autori nuk po bën thjesht gjimnastikë mendore me Shkrimin e Shenjtë. Në shekullin e parë ishte një problem shumë real që argumenti i Melkicedekut mund ta zgjidhte. Çifutët arsyetonin:

‘Ju kristianët na thoni që ky Jezus mund të jetë tani prifti ynë i lartë, që i çon lutjet e veprat tona para Perëndisë. Por një prift duhet të ketë një prejardhje të njohur, që të provojë se është nga fisi Levi. Ndërsa ju, ju vetë pranoni që Jezusi ishte nga fisi i Judës (Heb. 7:14). Na vjen keq, për ne Abrahami është udhëheqësi dhe shembulli ynë më i lartë (Gjn. 8:33,39), dhe këtë Jezus nuk do ta respektojmë.’

Së cilës i përgjigjet;

‘Por mba mend Melkicedek. Historia e Zanafillës është shkruar për të treguar që një prift kaq i madh nuk kishte ndonjë prejardhje, dhe Mesia duhet të jetë edhe mbret edhe prift, sipas urdhrit të Melkicedekut (Heb. 5:6 krahaso Ps. 110:4). Abrahami ishte inferior para Melkicedekut, ndaj duhet ta zhvendosni theksin nga Abrahami tek Jezusi, dhe të ndaloni së dhëni kaq rëndësi çështjes së prejardhjeve (shih 1 Tim. 1:4). Nëse meditonin se sa shumë Melkicedeku është një lloj Jezusi (d.m.th. hollësitë e jetës së tij tregonin përpara drejt tij), atëherë do të kuptoni më mirë veprën e Krishtit.’

Dhe këtë mësim mund ta marrim për veten tonë.

Digresion 27: “Qenia në Formën e Perëndisë”

“Jezusi...meqenëse kishte formën e Perëndisë, nuk e mendonte robëri qenien i barabartë me Perëndinë; nuk u kap pas privilegjeve hyjnore, dhe u bë si një skllav” (Fil. 2:5-11).

Këto vargje merren me kuptimin që Jezusi ishte Perëndi, por kur lindi u bë njeri. Nëse kjo është e vërtetë, atëherë edhe argumenti në Studimet 7 dhe 8 duhet shpjeguar. Është thënë që një varg nuk mund të lejohet të kundërshtojë kuptimin e mësimin të Biblës. Është domethënëse që ky është thujtja *i vetmi* pasazh që mund të sillet për të shpjeguar ‘hallkën që mungon’ në të arsyetuarit e trinisë – si Jezusi u transferua nga të qenit Perëndi në Qiell në qenien një foshnje në mitrën e Marisë. Analiza e mëposhtme kërkon të demonstrojë se çfarë do të thotë në fakt ky pasazh.

1. Ekzistojnë një numër frazash thujtja identike brenda këtij pasazhi që e kundërshtojnë drejtpërdrejt idenë e trinisë.

- a) “Gjithashtu *Perëndia* e ka lartësuar” Jezusin “dhe *i ka dhënë* atij një emër” (v.9) tregon që Jezusi nuk lartësoi veten – e bëri Perëndia. Rrjedh që ai nuk ishte në gjendje të të qenit i lartësuar përpara se këtë ta bënte Perëndia, në kohën e ringjalljes.
- b) I gjithë procesi i përlules së Krishtit dhe lartësimi më pas nga Perëndia do të ishte “për lavdinë e *Perëndisë At*” (v.11). Prandaj, Perëndia At nuk është i bashkëbarabartë me Birin.

2. Konteksti i këtij pasazhi duhet shqyrtuar me kujdes. Pali nuk fillon të flasë për Jezusin ‘nga hiçi.’ Ai i referohet mendjes së Jezusit në Fil. 2:5. Më parë në Fil. 1:27 Pali fillon të flasë për rëndësinë e gjendjes sonë të *mendjes*. Kjo zhvillohet në vargjet e hershme të kapitullit 2: “Duke qenë në një ide, të një *mendjeje*...në egoizëm...çdo njeri të mos shohë gjërat e tij, por çdo njeri të kujdeset për gjërat e të tjerëve. Kjo *mendje* le të jetë në ju, ashtu siç ishte edhe në Krishtin Jezus...” (Fil 2:2-5). Për rrjedhojë, Pali po flet për rëndësinë e pasjes së një *mendjeje* si ajo e Jezusit, e cila i kushtohet shërbimit të përlulur të tjerëve. Vargjet që vijojnë, për pasojë, komentojnë përluljen e mendjes që demonstroi Jezusi, në vend që të flasë për ndonjë ndryshim të natyrës.

3. Jezus ishte “në formën e Perëndisë.” Në Studimin 8.3 kemi treguar që Jezusi kishte natyrë njerëzore dhe prandaj nuk mund t’i referohet pasjes nga Krishti të një natyre Hyjnore. Përkthimi sipas V.R.N. i këtij pasazhi është shumë i gabuar këtu. Kalimthi, duhet vërejtur që disa përkthime moderne që synojnë ‘të lexuarit e thjeshtë,’ tentojnë të shpjegojnë tepër shkurt kuptimin e saktë të tekstit greqisht dhe tentojnë të japin një perifrëzim në vend të një përkthimi të pasazheve të caktuara. Fil. 2:5-8 është një shembull klasik i kësaj. megjithatë, kjo nuk do të thotë kritikimi i përdorimit të tyre në mënyra të tjera.

Që “forma” (greqisht ‘morphe’) nuk mund t’i referohet natyrës thelbësore vërtetohet nga Fil. 2:7 që thotë se Krishti mori “formën e një shërbyesi.” Ai kishte formën e Perëndisë, por mori formën e një shërbëtori. Natyra

thelbësore e një shërbëtori nuk është aspak e ndryshme nga ajo e ndonjë njeriu tjetër. Në harmoni me kontekstin, do të ishim të sigurtë ta interpretonim këtë sikur ka kuptimin që megjithëse Jezusi ishte i përkryer, kishte një mendje plotësisht si të Perëndisë, ai ishte i gatshëm të sipërmerre sjelljen e një shërbëtori. Disa vargje më pas, Pali na nxit të bëhemi “konform me vdekjen (e Krishtit)” (Fil. 3:10). Duhet të ndajmë ‘morphe,’ formën që Krishti tregoi në vdekjen e tij. Kjo nuk mund të ketë kuptimin se duhet të ndajmë natyrën që ai kishte atëhere, sepse ne tashmë kemi natyrë njerëzore. Nuk na duhet të ndryshojmë veten për të pasur natyrë njerëzore, por na duhet të ndryshojmë mënyrën e të menduarit, me qëllim që të kemi ‘morphe’ ose imazhin mendor që Krishti kishte në vdekjen e tij. Fjala greqisht ‘morphe’ do të thotë një imazh, përshtypje ose ngjashmëri. Për qeniet njerëzore thuhet se kanë “një *formë* (‘morphe’) përshpirtshmërie” (2 Tim 3:5). Gal. 4:19 flet për “Krishtin që *formohet* në” besimtarët. Meqenëse kishte një karakter të përkryer, një mënyrë të menduari saktësisht si të Perëndisë, Jezusi ishte “në formën e Perëndisë.” Për shkak të kësaj, për të nuk ishte “robëri” të mendonte apo të dinte që në këtë kuptim ai ishte një me Perëndinë. V.R.N. jep një përkthim të ndryshëm të kësaj fraze, duke thënë se Jezusi nuk e quante barazinë me Perëndinë “diçka që duhet kapur.” Nëse ky përkthim është i saktë, (çka mbështetet edhe nga V.S.R.) atëhere kjo hedh poshtë totalisht teorinë se Jezusi ishte Perëndi. Sipas përkthimit të V.R.N., Jezusi as për një minutë nuk mendonte se ishte i barabartë me Perëndinë; ai e dinte që ishte i nënshtruar ndaj Perëndisë, jo i bashkë-barabartë me Atë.

4. Krishti “nuk u kap pas privilegjeve,” apo “zbrazi veten” (V.R.), duke aluduar profecinë e kryqëzimit të tij në Jesh. 53:12: “Derdhi frymën e tij në vdekje.” Ai “mori mbi vete formën (sjelljen) e një shërbëtori” përmes qëndrimit si prej shërbëtori ndaj pasuesve të tij (Gjn. 13:14), demonstruar plotësisht nga vdekja e tij mbi kryq (Mt. 20:28). Jesh. 52:14 profetizoi në lidhje me vuajtjet e Krishtit se mbi kryq “pamja e tij ishte shumë më e shpërftyruar se e çdo njeriu, dhe *forma* e tij më shumë se e bijve të njeriut.” Kjo përlulje e vetes “deri në vdekje, madje edhe në vdekjen mbi kryq” ishte diçka që ndodhi gjatë jetës dhe vdekjes së tij, jo në lindjen e tij. Kemi treguar se konteksti i këtij pasazhi lidhet me *mendjen* e Jezusit, përlulësia e së cilës mbahet para nesh si një shembull që duhet kopjuar. Prandaj, këto vargje duhet të flasin për jetën e Jezusit në tokë, në natyrën tonë njerëzore, dhe për atë se si ai e përluli veten, pavarësisht se kishte një mendje totalisht të sinkronizuar me Perëndinë, për të shqyrtuar nevojat tona.

5. Nëse Krishti ishte Perëndi në natyrë dhe e la këtë pas për të marrë natyrën njerëzore, siç përpiqen ta interpretojnë këtë pasazh ata të trinisë,

atëhere Jezusi nuk ishte “shumë Perëndi” kur ishte mbi tokë; megjithatë, ata të trinisë besojnë se ishte. E gjithë kjo demonstroi kontradiktat që krijohen kur jepesh pas një përkufizimi të bërë nga njeriu si ai i trinisë.

6. Së fundi, një argument në lidhje me frazën “*të qenit* në formën e Perëndisë.” Fjala greqisht e përkthyer “*të qenit*” nuk do të thotë ‘*të qenit* në origjinë, nga përjetësia.’ Veprat 7:55 flet për Shtjefnin me “*të qenit* i mbushur me Shpirtin e Shenjtë.” Ai ishte i mbushur me Shpirtin e Shenjtë në atë kohë dhe se kishte qenë kështu për ca kohë përpara; por nuk kishte qenë *gjithmonë* i mbushur me të. Shembuj të tjerë gjenden në Lk. 16:23; Veprat 2:30; Gal. 2:14. Prandaj “*të qenit* në formën e Perëndisë” e Krishtit thjesht do të thotë se ishte në formën e Perëndisë (mendërisht); nuk do të thotë se ai ishte në atë formë që nga fillimi i kohës.

9.1 Fitorja e Jezusit

Studimi i mëparshëm tregoi se si Jezusi kishte natyrën tonë njerëzore dhe u tundua ashtu si dhe ne përpara mëkateve. Dallimi midis tij dhe nesh është që ai e kapërceu plotësisht mëkatën; ndërkohë që kishte një *natyrë* mëkatëtare, ai gjithnjë demonstroi një *karakter* të përkryer. Mrekullia e kësaj gjëje duhet të na frymëzojë ndërkohë që e vlerësojmë gjithnjë e më shumë. Në Dhiatën e Re, karakteri i përkryer i Krishtit theksohet në mënyrë të përsëritur.

- Ai “u vu në provë në çdo drejtim ashtu si dhe ne, e megjithatë mbeti pa mëkat” (Heb. 4:15).
- Ai “nuk njihnte mëkat.” “Tek ai nuk ka mëkat” (2 Kor. 5:21; 1 Gjn. 3:5)
- “Nuk kishte bërë asnjë mëkat, dhe nuk kishte thënë asnjë gënjeshtëri” (Pjt. 2:22)
- “I shenjtë, nuk ka asgjë të dënueshme, dhe është pa të meta, veçmas mëkatarëve” (Heb. 7:26)

Shkrimet e Ungjillit demonstrojnë se si kolegët e tij e njihnin përsosmërinë e karakterit të tij, të treguar në fjalët dhe në veprat e tij. Gruaja e Pilatit pranonte që ai ishte një “njeri i pafajshëm” (Mt. 27:19), i cili nuk meritonte ndëshkim; ushtarit romak që vëzhgonte sjelljen e Krishtit kur ky varej mbi kryq iu desh të komentonte, “Sigurisht, ky njeri ishte i pafajshëm” (Lk. 23:47). Më herët në jetën e tij, Jezusi i sfidoi çifutët me pyetjen: “Cili prej jush mund të provojë se kam bërë ndonjëherë mëkat?” (Gjn. 8:46). Për këtë nuk pati përgjigje.

Si rezultat i përsosmërisë së tij fitimtare në çdo mënyrë, Jezusi nga Nazareti u *bë* më i lartë se engjëjt (Heb. 1:3-5). Atij iu lartësua emri (Fil. 2:8), çka përfshinte të gjithë titujt engjëllorë. “Emri i tij *do të* quhet I Mrekullueshëm [krahaso Jud. 13:18 AV, anëfaqe], këshilltar [përdorur për engjëjt në 1 Mbret. 22:20 teksti hebraisht]...” (Jesh. 9:6). Është e qartë që Jezusi nuk e zotëronte këtë pozitë të lartë përpara lindjes dhe vdekjes së tij; ideja që ai u lartësua *deri* në këtë pozitë e përjashton këtë.

Për shkak të karakterit të tij të përkryer, Jezusi ishte manifestimi i Perëndisë në mish (1 Tim. 3:16); Ai vepronte dhe fliste ashtu si do kishte bërë Perëndia nëse Ai do të kishte qenë njeri. Prandaj, ai ishte pasqyrimi i përkryer i Perëndisë - “*shëmbëlltyra* e Perëndisë së padukshëm” (Kol. 1:15). Për këtë arsye, nuk ka nevojë që njerëzit e vdekshëm ta shohin Perëndinë. Siç e shpjegonte Jezusi, “Kush më sheh mua, sheh edhe Atin; si mund të thuash atëherë, na e trego (fizikisht) Atin?” (Gjn. 14:9). Theksi i përsëritur biblik është që Perëndia Ati ishte i manifestuar në Krishtin Jezus Birin e Tij (2 Kor. 5:19; Gj. 14:10; Veprat 2:22). Doktrina e trinisë meson se Biri ishte i manifestuar ose ‘i mishëruar’ në Jezusin; por Bibla mëson që Perëndia ishte i manifestuar [‘i mishëruar’ nëse duhet të përdorim termin] në Jezusin. Fjala *u shndërrua* në mish (Gjn. 1:14), dhe jo se Fjala hyri në një formë të mishtë.

Duke qenë se jetojmë në një botë mëkatore, dhe duke qenë të pllakosur me mëkate në vetë natyrën tonë, për ne është e vështirë të vlerësojmë tërësinë dhe gjerësinë e supremacisë shpirtërore të Krishtit; që një njeri me natyrën tonë do të zbulonte pastërtinë e Perëndisë në karakterin e tij. Të besuarit e kësaj kërkon një besim më real se sa thjesht pranimi i idesë teologjike se Krishti ishte Vetë Perëndia.

Ngaqë kishte natyrën tonë, Krishti duhej të vdiste. Ai ishte një pasardhës i Adamit përmes Marisë, dhe të gjithë pasardhësit e Adamit duhet të vdesin (1 Kor. 15:22). Të gjithë pasardhësit e Adamit duhej të vdisnin për shkak të mëkatit të tij, të Adamit, pavarësisht nga situata e tyre personale. “Vdekja sundonte...përmes kundravajtjes së njërit (Adamit) shumë duhet të vdesin...gjykimi ishte (për hir të) njërit (Adamit) dënimi (me vdekje)...nga mosbindja e njërit u *bënë* mëkatarë shumë njerëz,” dhe prandaj duhej të vdisnin (Rom. 5:14-19 krahas. 6:23). Si pasardhës i Adamit, Jezusi duhej të vdiste, ai trashëgoi natyrën e vdekshme nga Adami përmes Marisë, nënës së tij.

Me përjashtim të Jezusit, të gjithë pasardhësit e Adamit e meritojnë këtë ndëshkim, sepse ne kemi mëkatuar personalisht. Jezusi duhej të vdiste sepse ai kishte natyrën tonë, duke ndarë mallkimin që u vendos mbi pasardhësit e Adamit. Megjithatë, ngaqë personalisht nuk kishte bërë asgjë për të merituar

vdekjen “Perëndia e ngjalli nga të vdekurit, duke e çliruar nga agonia e vdekjes, sepse vdekja nuk mund ta mbante më nën pushtetin e saj” (Veprat 2:24 V.R.N.). Krishti u “deklarua të ishte Biri i Perëndisë me fuqi, sipas shpirtit të shenjtë, përmes ringjalljes nga të vdekurit” (Rom. 1:4). Për shkak të karakterit të përkryer të Krishtit, “shpirtit hyjnor” të tij, ai u ngjall. Krishti nuk vdiq mbi kryq *vetëm* sepse kishte natyrë njerëzore. Ai dha jetën e tij të përkryer vullnetarisht si dhuratë për ne; ai tregoi dashurinë e tij për ne duke vdekur “për mëkatet tona” (1 Kor. 15:3), duke ditur që përmes vdekjes së tij ai do të fitonte shpëtimin nga mëkati dhe vdekja për ne (Ef. 5:2,25; Ap. 1:5; Gal. 2:20). Ngaqë Jezusi ishte i përkryer në karakter, ai ishte i aftë të kapërcente rezultatin e mëkatisht duke qenë personi i parë që u ngjall nga të vdekurit dhe iu dha jeta e përjetshme. Të gjithë ata që e identifikojnë veten me Krishtin përmes pagëzimit dhe jetës së ngjashme me të Krishtit, për rrjedhojë, kanë shpresë për ringjallje dhe shpërblim të ngjashëm.

Këtu gjendet dhe rëndësia e lavdishme e ringjalljes së Krishtit. Është “siguria” që ne do të ringjallemi dhe do të gjykohe mi (Veprat 17:31), dhe nëse e kemi ndjekur atë vërtet në këtë jetë, ne do të ndajmë shpërblimin e tij për jetën e përjetshme, “*duke ditur* (me besim) që ai që ringjalli Zotin Jezus, do të na ngjallë edhe ne, gjithashtu përmes Jezusit” (2 Kor. 4:14; 1 Kor. 6:14; Rom. 6:3-5). Si mëkatarë, ne meritojmë vdekjen e përjetshme (Rom. 6:23). Megjithatë, për shkak të jetës së përkryer të Krishtit, të vdekjes së bindur dhe ringjalljes së tij, Perëndia na ofroi ne *dhuratën* e jetës së përjetshme, plotësisht në përputhje me të gjitha parimet e Tij. Për të zhvendosur ndikimet e mëkateve tona, Perëndia na “shpall të pafajshëm” (Rom. 4:6) përmes besimit tonë në premtimet e Tij për shpëtim. E dimë që mëkati sjell vdekje, prandaj, nëse besojmë vërtet që Perëndia do të na shpëtojë prej tij, duhet të besojmë edhe që Ai do të na llogarisë si të pafajshëm, megjithëse nuk jemi. Krishti ishte i përkryer; duke qenë vërtet *në* Krisht, Perëndia do të na llogarisë sikur jemi të përkryer, megjithëse personalisht nuk jemi të tillë. Perëndia e bëri Krishtin “të ishte mëkatar për ne, megjithëse ai nuk njihet mëkat; që ne të marrim pafajësinë e Perëndisë në *atë*” (2 Kor. 5:21), d.m.th. të qenit *në* Krisht përmes pagëzimit dhe jetës së ngjashme me të Krishtit. Kështu, për ata që janë “në Krishtin Jezus,” ai “u bë pafajësia, hyjnizimi dhe çlirimi ynë” (1 Kor. 1:30,31); prandaj, vargu i mëposhtëm na nxit të lëvdojmë Krishtin për gjërat e mëdha që ka arritur. “Në Shkrimin e Shenjtë tregohet pafajësia prej Perëndisë, pafajësi që arrihet përmes besimit” (Rom. 1:17, V.R.N.). Për pasojë, të kuptuarit e këtyre gjërave është një pjesë e nevojshme e njohjes së Ungjillit të vërtetë.

E gjitha kjo u bë e mundur përmes ringjalljes së Krishtit. Ai ishte “i parëlinduri” i një numri të madh njerëzish që do të bëhen të pavdekshëm përmes arritjes së tij (1 Kor. 15:20), “i parëlinduri” i një familjeje të re shpirtërore, së cilës do t’i jepet natyra e Perëndisë (Kol. 1:18 kra. Ef. 3:15). Prandaj, ringjallja e Krishtit bëri të mundur që Perëndia t’i llogariste besimtarët në Krisht sikur të jenë të pafajshëm, meqenëse janë të mbuluar prej pafajësisë së tij. Krishti “u bë të vdiste për të shlyer mëkatet tona, dhe u ringjall që ne të marrim justifikimin (fjala do të thotë “me qenë i pafajshëm”)” (Rom. 4:25).

Nevojitet një besim i ndërgjegjshëm dhe i medituar mirë në këto gjëra që të bindemi vërtet se mund të llogaritemi prej Perëndisë sikur jemi të përkryer. Krishti mund të na paraqesë ne në fronin e gjykimit “*të panjollë* përpara pranisë së lavdisë së tij,” “të shenjtë, të pafajësueshëm dhe të padënueshëm përpara tij” (Juda v. 24; Kol. 1:22 kra. Ef. 5:27). Duke pasur parasysh natyrën tonë mëkatore dhe dështimet e përhershme shpirtërore, nevojitet një besim i qëndrueshëm që kjo të besohet me të vërtetë. Thjesht ngritja e dorës lart në një ‘kryqëzatë’ apo miratimi akademik i një aradhe doktrinash nuk lidhen me këtë lloj besimi. Ajo që duhet të motivojë besimin tonë është të kuptuarit siç duhet i ringjalljes së Krishtit: “Perëndia... e ngjalli nga të vdekurit... *me qëllim që* besimi dhe shpresa (për një ringjallje të ngjashme) juaj të mund të jetë tek Perëndia” (1 Pjt. 1:21).

Vetëm përmes pagëzimit siç duhet në Krisht, pasuar nga një jetë e tërë dishepullie të vërtetë, ne mund të jemi “në Krisht” dhe për pasojë të jemi të mbuluar prej pafajësisë së tij. Përmes pagëzimit, ne shoqërizohemi me vdekjen e tij dhe ringjalljen e tij (Rom. 6:3-5), të cilat janë mjetet e çlirimit tonë nga mëkatet tona, duke qenë ‘të justifikuar’, ose të llogaritur si të pafajshëm (Rom. 4:25).

Gjërat e mrekullueshme që kemi shqyrtuar në këtë seksion as që mund t’i kuptojmë nëse nuk jemi pagëzuar. Në pagëzim, ne shoqërizojmë veten tonë me gjakun e Krishtit derdhur mbi kryq; besimtarët “lajnë petkat dhe (i bëjnë) të bardha me anë të gjakut të qingjit” (Ap. 7:14). Figurativisht, ata janë për pasojë, të veshur me të bardha, duke përfaqësuar pafajësinë e Krishtit që është llogaritur (‘dhënë’) atyre (Ap. 19:8). Është e mundur që këto rroba të bardha t’i ndymë si pasojë e mëkatit tonë (Juda v. 23); kur e bëjmë këtë pas pagëzimit, duhet të kërkojmë faljen e Perëndisë përmes Krishtit.

Për rrjedhojë, pas pagëzimit prapë duhet të përpiqemi të qëndrojmë në pozicionin e bekuar në të cilin kemi hyrë. Ka nevojë për vetë-shqyrtim të rregullt, të përditshëm, për pak minuta çdo ditë, përmes lutjeve të përhershme dhe të kërkuarit të faljes. Duke bërë këtë, ne do të jemi gjithnjë

përlshëm të bindur që, për shkak të mbulimit tonë nga pafajësia e Krishtit, ne do të jemi vërtet në Mbretërinë e Perëndisë. Duhet të përpiqemi që të gjendemi të palëkundur në Krisht në ditën e vdekjes sonë apo të kthimit të Krishtit “jo përmes vetë bindjes (sonë)...por me anë të besimit (në) Krisht, pafajësisë që jepet nga Perëndia përmes besimit” (Fil. 3:9).

Theksimi i përsëritur mbi faktin që *besimin* çon në pafajësinë e dhënë, tregon që ne nuk mund të përftojme shpëtimin në asnjë mënyrë përmes veprave tona; shpëtimi vjen nga mëshira: “Sepse shpëtoheni nga mëshira përmes besimit; jo vetvetiu; shpëtimi është dhuratë e Perëndisë; jo e veprave që bëni” (Ef. 2:8,9). Ashtu si justifikimi dhe pafajësia janë ‘dhurata’ (Rom. 5:17), po kështu, është edhe shpëtimi. Motivimi ynë për të bërë çfarëdo veprë të shërbimit kristian, për rrjedhojë, duhet të jetë mirënjohja për atë që Perëndia ka bërë për ne – duke na quajtur të pafajshëm përmes Krishtit, dhe përmes kësaj, duke na dhënë rrugën për në shpëtim. Është fatale të arsyetohet se nëse bëjmë vepra, atëherë ato do të na shpëtojnë. Thjesht nuk do t’ia dalim të fitojmë shpëtimin nëse mendojmë kështu; ai është një *dhuratë* të cilën nuk mund ta përfitojmë, por vetëm t’i përgjigjemi me dashuri dhe mirënjohje të thellë, e cila pastaj do të pasqyrohet në veprat tona. Besimi i vërtetë prodhon vepra si një nën-produkt i paevitueshëm (Jakobi 2:17).

9.2 Gjaku i Jezusit

Shumë shpesh në Dhiatën e Re deklarohet se justifikimi dhe shpëtimi ynë janë përmes gjakut të Jezusit (p.sh. 1 Gjoni 1:7; Ap. 5:9; 12:11; Rom. 5:9). Për të vlerësuar rëndësinë e gjakut të Krishtit, duhet të kuptojmë që është parim biblik se “në gjak është jeta” (Kp. 17:14). Pa gjakun, një trup nuk mund të jetojë; për rrjedhojë, simbolizon jetën. Kjo shpjegon korrektësinë e fjalëve të Krishtit, “Ju nuk keni asnjë pjesë në jetën, nëse nuk hani trupin e Birit të njeriut, dhe nuk pini gjakun e tij” (Gjn. 6:53).

Rezultati i mëkatit është vdekja (Rom. 6:23), d.mth. derdhja e gjakut, i cili bart jetën. Për këtë arsye, nga izraelitët pritej që të derdhnin gjak çdo herë që mëkatonin, për t’i kujtuar atyre që mëkati çonte në vdekje. “Sipas ligjit (të Moisiut) gjithçka pastrohet me gjak; pa derdhje gjaku nuk ka falje (të mëkateve - Heb. 9:22). Për shkak të kësaj, mbulimi i vetes me gjethe fiku që bënë Adami dhe Eva nuk ishte i pranueshëm; në vend të tyre, Perëndia vrau një qingj për t’u dhënë lëkura që të mbulonin mëkatet e tyre (Zan. 3:7,21). Në mënyrë të ngjashme, sakrifica e kafshëve që bëri Abeli u pranua, por jo ofrimi që bëri Kaini me perime, sepse ai e vlerësonte këtë parim që pa

derdhje gjaku nuk mund të kishte falje dhe afrim të pranueshëm tek Perëndia (Zan. 4:3-5).

Këto incidente tregojnë përpara drejt rëndësisë së gjakut të Krishtit. Kjo ishte veçanërisht e parashikuar në ngjarjet e Pashkës, në të cilën populli i Perëndisë duhej të vinte gjakun e një qingji mbi dyert e tyre për të fituar shpëtimin nga vdekja. Ky gjak tregonte përpara drejt gjakut të Jezusit, me të cilin ne duhet të mbulojmë mëkatet tona. Përpara kohës së Krishtit, sipas ligjit të Perëndisë përmes Moisiut, çifutët duhet të ofronin sakrifica në kafshë për mëkatet e tyre. Megjithatë, kjo derdhje e gjakut të kafshëve duhet t'u kishte mësuar atyre një mësim të madh. Shpagimi i mëkatit është vdekja (Rom. 6:23); nuk ishte e mundur që një qenie njerëzore të mund të vriste një kafshë dhe ta shihte atë të pranohej nga Perëndia në vend të vetes së tij. Kafsha që ai ofroi nuk mund të vlerësonte të mirën apo të keqen; nuk ishte përfaqësuese e plotë e tij: "Gjaku i mëzetërve dhe i cjepërve nuk mund t'i shlyejë mëkatet" (Heb. 10:4).

Prandaj, lind pyetja, Pse duhej që çifutët të sakrifikonin kafshë kur mëkatonin? Pali i përmbledh përgjigjet e ndryshme për këtë pyetje tek Gal. 3:24: "Ligji ishte mbikqyrësi ynë për të na sjellë tek Krishti." Kafshët që vrisnin ata si shpagim për mëkatet duhet të ishin pa të meta – pa njolla (Dal. 12:5; Kp. 1:3,10 etj.). Këto tregonin përpara drejt Krishtit, "një qingj pa njollë" (1 Pjt. 1:19). Prandaj, gjaku i atyre kafshëve *përfaqësonte* atë të Krishtit. Ato pranoheshin si sakrifica për mëkatet për aq sa tregonin drejt sakrificës së përkryer të Krishtit, të cilën Perëndia e dinte se do ta bënte. Për shkak të kësaj, Perëndia i fali mëkatet e popullit të Tij, të cilët jetonin përpara kohës së Krishtit. Vdekja e tij ishte "për t'i çliruar nga pasojat e mosbindjes së tyre nën besëlidhjen e parë" (Heb. 9:15), d.m.th. ligji i Moisiut (Heb. 8:5-9). Të gjitha sakrificat e ofruara sipas ligjit tregonin përpara drejt Krishtit, ofrimit të përkryer për mëkatet, i cili "e shleu mëkatet përmes sakrificës së vetes" (Heb. 9:26; 13:11,12; Rom. 8:3 [V.R.N.] krahas 2 Kor. 5:21).

Në Seksionin 7.3 shpjegojmë se si e gjithë Dhiata e Vjetër, veçanërisht Ligji i Moisiut, tregonte përpara drejt Krishtit. Sipas atij ligji, mënyra e afrimit tek Perëndia ishte përmes Priftit të Lartë; ai ishte ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve sipas Besëlidhjes së Vjetër ashtu siç është Krishti sipas Besëlidhjes së Re (Heb. 9:15). "Në bazë të ligjit, kryeprihtërinj u bënë njerëzit me të meta; por sipas betimit hyjnor... u bë Biri, i cili e përfundoi punën një herë e përgjithmonë" (Heb. 7:28). Ngaqë vetë ishin mëkatarë, këta njerëz nuk ishin në gjendje të fitonin faljen e vërtetë për njerëzit. Kafshët që sakrifikonin ata nuk ishin vërtet përfaqësuese të mëkatarëve. Ajo që kërkohet ishte një qenie e përkryer njerëzore, një që të ishte në çdo

mënyrë përfaqësuese e njeriut mëkatar, por prapëseprapë një që mund të bënte një sakrificë të pranueshme për mëkatet. Paskëtaj, njerëzit mund të përfitonin duke u shoqëruar me atë sakrificë. Në mënyrë të ngjashme, kërkohej një Kryepriфт që të mund të identifikohet me njerëzit mëkatarë për të cilët ndërmjetësoi, duke qenë i tunduar ashtu si ata (Heb. 2:14-18).

Jezusi përshtatet me këtë kërkesë në mënyrë të përkryer – “Një i tillë kryepriфт që na duhet, që është i shenjtë, nuk ka asgjë të dënueshme dhe pa të meta” (Heb. 7:26). Ai nuk ka nevojë të kushtojë çdo ditë flijim për fajet e tij dhe as nuk ka pse t’i japë llogari vdekjes (Heb. 7:23,27). Nën dritën e kësaj, Shkrimi i Shenjtë komenton mbi Krishtin si priфtin tonë: “Për këtë arsye ai mund t’i shpëtojë përgjithmonë të gjithë ata që i afrohen Perëndisë me anë të tij. Ai jeton përgjithmonë për të ndërhyrë për ta tek Perëndia” (Heb. 7:25). Meqenëse ai kishte natyrë njerëzore, Krishti, si Kryepriфti ynë ideal, “ka mëshirë për ata që nuk dinë, dhe për ata që janë jashtë udhës; sepse *edhe ai vetë* kishte dobësitë e veta” (Heb. 5:2). Kjo sjell në mend pohimin në lidhje me Krishtin, “*edhe ai vetë po ashtu*” mori natyrën tonë (Heb. 2:14).

Ashtu si kryepriфtërinjtë çifutë ndërmjetësonin vetëm për njerëzit e Perëndisë, izraelitët, edhe Krishti është vetëm priфт për izraelitët shpirtërorë – ata që janë pagëzuar në Krisht, duke kuptuar Ungjillin e vërtetë. Ai është “një kryepriфт që kryeson *mbarë popullin e Perëndisë*” (Heb. 10:21), i cili përbëhet prej atyre që janë lindur sërish përmes pagëzimit (1 Pjt. 2:2-5), duke pasur shpresën e vërtetë të Ungjillit (Heb. 3:6). Prandaj, vlerësimi i përfitimeve të mrekullueshme të priфтërisë së Krishtit duhet të na nxisë të pagëzohemi në të; pa këtë, ai nuk mund të ndërmjetësojë për ne.

Duke qenë të pagëzuar në Krisht, ne duhet ta përdorim me zell plotësisht priфтërinë e Krishtit; vërtet, kemi përgjegjësi të caktuara në lidhje me këtë dhe të cilat duhet t’i përmbushim. “Me anë të tij, t’i kushtojmë vazhdimisht flijim gojor Perëndisë” (Heb. 13:15). Plani i Perëndisë për të dhënë Krishtin si priфtin tonë ishte që ne ta lartësojmë Atë; prandaj, duhet ta përdorim vazhdimisht aksesin tonë tek Perëndia përmes Krishtit në mënyrë që ta lëvdojmë Atë. Heb. 10:21-25 radhit një numër përgjegjësish që i kemi për shkak të qenies së Krishtit Kryepriфti ynë: “Duke pasur një kryepriфт në krye të popullit të Perëndisë:

1. Let us draw near (to God) with a true heart in full assurance of faith, having our hearts sprinkled from an evil conscience, and our bodies washed with pure water”. Understanding Christ’s priesthood means that we should be baptised into him (“our bodies washed”), and we should never let a bad conscience develop in our minds. If we believe in Christ’s atonement, we are made at one with God (‘AT-ONE-MENT’) by his sacrifice.

2. “Le të mbajmë me forcë punën e besimit tonë pa u lëkundur.” Nuk duhet të devijojmë nga doktrinat e vërteta që kanë sjellë të kuptuarit tonë të priftërisë së Krishtit.

3. “Le të shqyrtojmë njëri-tjetrin për të provokuar dashuri... pa braktisur mbledhjen tonë sëbashku.” Duhet të jemi të lidhur me dashur bashkë me të tjerët që kuptojnë priftërinë e Krishtit dhe përfitojnë prej saj; kjo arrihet veçanërisht duke u mbledhur sëbashku për shërbesën e bashkësisë, përmes së cilës kujtojmë sakrificën e Krishtit (shih Seksionin 11.3.5).

Të vlerësuarit e këtyre gjërave duhet të na mbushë me besim të përlurur që ne vërtet do ta arrijmë shpëtimin, nëse pagëzohemi dhe sillemi sipas Krishtit: “*Prandaj le t’i afrohemi guximshëm frontit të mirësisë, që të mund të marrim mëshirë, dhe të gjejmë ndihmë kur të kemi nevojë për ndihmë*” (Heb. 4:16).

9.3 Flijimi për Ne dhe për Vetën e Tij

Është e rëndësishme të kujtojmë se si Jezu Krishti u përfshi në flijimin e vetes. Që ai përfitoi nga flijimi për ne, nuk ka dyshim. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme, duhet të mbajmë në mend që megjithëse Jezusi nuk mëkatoi, ai bartte të njëjtën natyrë që është e njëjtë për të gjithë njerëzimin. Ai ndante, me ata që erdhi të shpëtonte, atë vdekshmëri dhe tendencë ndaj mëkatit që është e zakonshme për të gjithë ne. Siç është theksuar në këto mësimë, ai “u tundua në të gjitha drejtimet” ashtu si dhe ne. kemi parë që ai e kapërceu tendencën e vet për mëkat me anë të bindjes së përkryer para Atit të tij, megjithëse kjo e çoi në vdekjen mbi kryq. Megjithatë, edhe ai kishte nevojë për “çlirim” apo “shpëtim” nga vdekshmëria e tij. Kjo është e paraqitur qartë në profecitë që parathanë vdekjen e tij.

- “Po e dorëzoj shpirtin tim në duart e tua: ti do më shpëtosh *mua*, O Zot, Perëndi i së vërtetës” (Ps. 31:5). Kujtojmë që këto ishin pjesë e fjalëve që u folën tek Jezusi vdiq mbi kryq (Lk. 23:46). Ai e shihte Atin e tij si Shpëtimtarin e tij që do të “çlirojë shpirtin tim nga fuqia e varrit” (Ps. 49:15).
- “Ai do të më thërrasë, Ti je ati im, Perëndia im, dhe shkëmbi i shpëtimit tim. Unë do ta bëj të parëlindurin tim, më të lartë se mbretërit e tokës” (Ps. 89:26-27). Shohim se përmes kësaj lutjeje para Atit të Tij, Perëndia do ta shpëtonte të dilte nga vdekja dhe do ta lartësonte në pozitën e “Të Parëlindurit.”

Nga këto shkrime kujtohem që Jezusi vetë kishte nevojë për çlirim nga vdekshmëria që erdhi mbi të gjithë njerëzit përmes mëkatit të Adamit. Në këtë pikëpamje, ai nuk ishte veçmas atyre të cilët erdhi t'i shpëtonte. Duke folur për vdekjen dhe ringjalljen e tij, Pjetri thotë: “Atë, që u dorëzua nga këshilla dhe paradija e Perëndisë, e keni marrë, dhe e keni kryqëzuar e vlarë përmes të pafeve: Atë që Perëndia e shpëtoi nga pushteti i vdekjes dhe e ringjalli; vdekja nuk mund ta mbante të burgosur” (Veprat 2:23-24). *Nuk ishte e mundur* që varri ta mbante sepse “shpagimi për *mëkat*in është vdekja,” por Jezusi, megjithëse u vu në provë, *kurrë nuk i hapi rrugë këtij tundimi e të mëkatonte*. Prandaj, nuk ishte e mundur që një njeri i pafajshëm të mbetej në varr. Perëndia është i pafajshëm në çdo drejtim. Prandaj, përmes kësaj bindjeje të përkryer, Jezusi theu zinxhirët e mëkatit dhe vdekshmërisë, si për veten e tij ashtu dhe për ata që janë pagëzuar në të. Përmes tij, mëkatet tona falen dhe ne mund të kemi shpresë për ta ndarë atë pavdekshmëri që ka fituar ai.

- “E dimë që Krishti u ngjall nga të vdekurit dhe nuk vdes më; *vdekja nuk ka më asnjë pushtet mbi të*. Sepse vdiq një herë e mirë për mëkatin; tani jeton dhe jeton për Perëndinë” (Rom. 6:9-10). Ai vdiq për shkak të gjërave që vinin nga mëkati, megjithatë u ngrit në jetë sepse nuk ishte e drejtë që një njeri i pamëkat të mbetej në varr.
- “Në kohën e jetës së tij në tokë, ai u lut dhe lypi me ofshame të mëdha e me lot para atij që ishte në gjendje ta shpëtonte nga (greqisht = jashtë nga) vdekja, dhe lutja u plotësua sepse ai kishte frikë; Duke qenë i përkryer, ai u bë autori i shpëtimit të përvetshëm për të gjithë ata që i binden atij” (Heb. 5:7-8). Vetëm përmes lutjeve dhe një jete bindshmërie, Ati i tij e çliroi atë *jashtë nga varri*.
- “Ai hyri në vendin e shenjtë, jo përmes gjakut të cjepve e mëzetërve, por përmes gjakut të tij, duke fituar çlirimin e përvetshëm” (Heb. 9:12). Këtu Pali krahason hyrjen e Kryepriutit në Vendin e Shenjtë me hyrjen e Krishtit në vetë qiellin (v24). Ndërsa prifti hyri me gjakun e flijimeve të caktuara, këto flijime tregonin përpara drejt flijimit të madh të Birit të Perëndisë - vetë atij. Këtu shohim që përmes këtij flijimi sakrifikues ai fitoi “çlirimin e përvetshëm” – ai u çlirua nga zinxhirët e vdekshmërisë. Vdekshmëria, me dobësinë dhe mëkatësinë e vet të brendshme shihet si një padron lidhës, por përmes bindjes së Krishtit deri në vdekjen mbi kryq, ai e ka thyer atë zinxhir si për ashtu dhe për ata që janë në të. Përmes vdekjes së tij ai “shfuqizoi atë që e kishte pushtetin e vdekjes, d.m.th. djallin” (Heb. 2:14). Prandaj, ai fitoi “çlirimin e përvetshëm” për atë barrë që mbajti.

- “Perëndia që na sjell paqe, që ringjalli nga të vdekurit Zotin Jezus, atë që u bë Bariu i madh i deleve, dhe me anë të gjakut të besëlidhjes së përjetshme, Ju ndihmoftë të bëni vepra të mira sipas vullnetit të tij, për të realizuar në ju atë që i pëlqen atij, përmes Jezu Krishtit; Për këtë qoftë lavdëruar përgjithmonë. Amen.” (Heb. 13:20-21). Pali e mbyll këtë letër me faktin që Jezusi u soll *nga të vdekurit* prej Perëndisë përmes gjakut të besëlidhjes së përjetshme. Atij *gjaku* i referohej në dhomën e sipërme me dishepujt kur thoshte: “Ky është *gjaku im* i besëlidhjes së re, që derdhet si flijim që të falen mëkatet” (Mt. 26:28). Ishte *gjaku* i tij, i cili siç kemi parë më herët, i referohet *jetës* së tij. Ai dha jetën e tij me dëshirë (Mt. 20:28) për të çliruar të gjithë njerëzimin nga zinxhirët e mëkatit dhe vdekshmërisë nëse ata do të besonin e do të vinin tek Perëndia përmes atij.

Në kryqëzimin e tij, ai tregoi publikisht se ajo që kishte bërë gjatë gjithë jetës së tij për të refuzuar tundimet e trupit, tani e shpallte në kryqëzimin e trupit me gjithë dëshirat e pasionet, dhe lejoi me përlulje që vullneti i Perëndisë të bëhej. Pali shkroi: “Duke qenë si njerëzit, ai u përlul, dhe u bind deri në vdekje, madje edhe deri në vdekjen mbi kryq.” Ai iu përlul me dëshirë vullnetit të Perëndisë për këtë. “Prandaj (për shkak të kësaj bindjeje befasuese në gjithçka) Perëndia e lartësoi dhe i dha një emër që është mbi të gjithë emrat e tjerë: që para Jezusit të gjithë të bien në gjunjë – të gjithë ata që janë në qiell, në tokë dhe në nëntokë; Dhe që çdo gjuhë ta pranojnë që Jezu Krishti është Zoti; kështu nderohet edhe Perëndia Ati” (Fil. 2:8-11). Përmes atij akti të fundit bindjeje, Perëndia u glorifikua dhe më pas Ati përbushoi lutjen e Krishtit: “O Atë, tani ma kthe këtë madhësi që kisha tek ti përpara krijimit të botës” (Gjn. 17:5). Ai u lartësua në pavdekësi, apo në natyrë hyjnore, për t’u ulur në krahun e djathtë të Atit.

Duke zbatuar me besnikëri vullnetin e Atit gjatë gjithë jetës së tij, duke arritur deri tek vdekja mbi kryq, ai hapi rrugën që të gjithë ata që do të pagëzohen në të, të mund të ndajnë atë jetë që tani ka fituar ai. Aty, ai përfundimisht i dha fund asaj natyre të dobët njerëzore, e cila kishte fituar supremaci dhe zotërim në të gjithë të tjerët duke nxjerrë përpara mëkatit. Në mrekulli dhe besim, ne e shohim atë “të gjitha mëkatet tona i mbajti në trupin e tij në kryq, që ne, duke qenë të vdekur nga mëkatet, të mund të fitojmë pafajësinë: me anë të plagëve të tij ne jemi shëruar” (1 Pjt. 2:24). Ne i shohim këto gjëra duke kuptuar që përmes atij akti përfundimtar bindjeje ai “ia hoqi vdekjes pushtetin dhe solli në dritë jetën dhe pavdekësinë përmes ungjillit” (2 Tim. 1:10).

9.4 Jezusi si Përfaqësuesi ynë

Kemi parë që flijimet e kafshëve nuk përfaqësonin plotësisht njerëzit mëkatarë. Megjithatë, Jezusi *ishte* përfaqësuesi ynë, duke qenë në çdo drejtim “i ngjashëm me vëllezërit e tij” (Heb. 2:17). “Ai shijoi vdekjen për çdo njeri” (Heb. 2:9). Kur kryejmë një mëkat – p.sh. jemi të inatosur – Perëndia mund të na falë “për hir të Krishtit” (Ef. 4:32). Është kështu sepse Perëndia mund të na krahasojë me Krishtin, një njeri ashtu si ne, i cili u tundua të mëkatonte – p.sh. të ishte i inatosur – por që kapërceu çdo tundim. Prandaj, Perëndia mund të na i falë mëkatet – e inatit – sepse ne jemi në Krisht, të mbuluar prej pafajësisë së tij. Qenia e Krishtit përfaqësuesi ynë shërben, për pasojë, si mjete përmes të cilit Perëndia mund të na tregojë mëshirën e Tij, ndërkohë që zbaton parimet e Tij të drejta.

Nëse Jezusi do të kishte qenë Perëndi në vend që të ishte me natyrë njerëzore, atëhere nuk do të mund të kishte qenë përfaqësuesi ynë. Ky është një tjetër shembull ku një ide e gabuar çon në një tjetër. Për shkak të kësaj, teologët kanë zhvilluar shumë mënyra komplekse për të shpjeguar vdekjen e Krishtit. Pikëpamja popullore e Krishtëritit renegat është që mëkatet e njeriut e bënë atë borxhli para Perëndisë, borxh të cilin ai vetë nuk mund ta paguante. Kështu, Krishti shpagoi borxhin e çdo besimtari përmes gjakut të tij, të derdhur mbi kryq. Shumë predikues e kanë shprehur kështu: “Ishte sikur të gjithë ne ishim të rreshtuar para një muri, gati për t’u ekzekutuar nga djalli. Në atë kohë, rendi Jezusi dhe djalli vrau atë në vend që të na vriste ne; kështu, ne tani jemi të lirë.”

Këto teori të stërholluara nuk kanë kurrfarë mbështetjeje biblike. Ekziston kontradikta e dukshme se nëse Krishti vdiq në *vendin* tonë, d.m.th. si zëvendësuesi ynë, atëhere ne nuk kemi nevojë të vdesim. Duke pasur ende natyrë njerëzore, ne duhet të vdesim; shpëtimi nga mëkati dhe vdekja do të zbulohen përfundimisht në ditën e gjykimit (kur të na falet pavdekësia nga mëshira e Perëndisë). Nuk e fituam këtë në kohën kur vdiq Krishti.

Bibla mëson që shpëtimi është i mundur përmes vdekjes DHE ringjalljes së Krishtit, jo thjesht përmes vdekjes së tij. Krishti “vdiq për ne” një herë. Teoria e zëvendësimit do të nënkuptonte që ai duhej të vdiste personalisht për secilin prej nesh.

Nëse Krishti pagoi një borxh me gjakun e tij, shpëtimi ynë bëhet diçka që e presim si një të drejtë. Fakti që shpëtimi është dhuratë, sjellë nga mëshira dhe falja e Perëndisë, humbet nëse e kuptojmë sakrificën e Krishtit si pagim të një borxhi. Gjithashtu, ajo sugjeron që një Perëndi i inatosur u qetësua sapo pa gjakun e Jezusit. Megjithatë ajo që sheh Perëndia kur ne pendo kemi,

është Biri i Tij si përfaqësuesi ynë; ai që ne përpiqemi fort ta kopjojmë. Shumë himne e këngë kristiane përmbajnë një sasi të pabesueshme doktrine false në këtë fushë. Shumica e doktrinës false futet në mendjet e njerëzve përmes muzikës, dhe jo përmes udhëzimeve racionale biblike. Duhet të jemi gjithmonë syhapur përpara kësaj lloj shplarje truri.

Tragjikisht, fjalët e thjeshta “Krishti vdiq për ne” (Rom. 5:8) janë keqkuptuar shumë rëndë sikur duan të thonë se Krishti vdiq në vendin tonë. Ka disa pika lidhjeje midis Rom. 5 dhe 1 Kor. 15 (p.sh. Rom. 5:12 = 1 Kor. 15:21; Rom. 5:17 = 1 Kor. 15:22). “Krishti vdiq për ne” (Rom. 5:8) përshtatet me “Krishti vdiq për *mëkatet* tona” (1 Kor. 15:3). Vdekja e tij ofroi një mënyrë përmes së cilës ne mund të fitojmë faljen për mëkatet tona; në këtë kuptim shkruhet se “Krishti vdiq për ne.” Fjala “për” nuk është e thënë të ketë kuptimin ‘në vend të;’ Krishti vdiq “për mëkatet tona,” jo ‘në vend të’ tyre. Për shkak të kësaj, Krishti mund “të ndërmjetësojë” për ne (Heb. 7:25) – jo ‘në vend të’ neve. As “për” në Heb. 10:12 dhe Gal. 1:4 nuk do të thotë ‘në vend të.’ Nëse Krishti vdiq ‘në vendin tonë’ atëhere nuk ka nevojë të bartet kryqi i tij, si na kërkon ai. Dhe nuk do të kishte logjikë të pagëzohesh në vdekjen dhe ringjalljen e tij, duke identifikuar me dëshirë veten tonë me atë si përfaqësuesin tonë fitimtar. Ideja e zëvendësimit nënkupton një rrugë të shkurtër për në lartësimin me të, çka thjesht nuk ka vlerë. Kuptimi i tij si përfaqësuesi ynë na përkushton ne ndaj pagëzimit në vdekjen dhe ringjalljen e tij, në jetën e bartjes së kryqit me të, dhe në mënyrë realiste, ndarja e ringjalljes së tij. Ringjallja e tij është jona; ne na u dha shpresa e ringjalljes sepse ne jemi në Krisht, i cili u ngjall (1 Pjt. 1:3). Zoti Jezus jetoi dhe vdiq me natyrën tonë, në të gjithë mosbindjen e saj, me qëllim që të mund të vinte pranë nesh dhe të na jepte mundësi të identifikoheshim me të. Duke vlerësuar këtë në mënyrë doktrinale, ne i japim atij mundësinë të shohë rezultatit e vuajtjes së shpirtit të tij dhe të jetë i kënaqur.

9.5 Jezusi dhe Ligji i Moisiut

Jezusi ishte flijimi i përkryer për mëkatet dhe Kryepriifti ideal që mund të fitonte vërtet faljen për ne. Prandaj, sistemi i vjetër i flijimit të kafshëve dhe kryepriiftërinjve u braktis pas vdekjes së tij (Heb. 10:5-14). “Kur ndryshohet priiftëria (nga Levitët në Krisht), atëhere do të ndërrohet edhe ligji” (Heb. 7:12). Krishti “u bë priift jo në bazë të ndonjë rregulli në lidhje me prejardhjen e tij (d.m.th. thjesht ngaqë dikush ishte levit, nuk desh të thoshte se mund të ishte priift), por mbi bazën e një jete të pashkatërrueshme,” e cila

iu dha për hir të sakrificës së tij të përkryer (Heb. 7:16 V.R.N.). Prandaj, “rregullorja e mëparshme shfuqizohet (d.m.th. ligji i Moisiut) sepse ishte e dobët dhe e padobishme. Sepse ligji nuk çonte në një marrëdhënie të përsosur, ndërsa sjellja e një shprese më të mirë (përmes Krishtit) po” (Heb. 7:18,19 A.V. me V.R.N.).

Nga kjo është e dukshme që ligji i Moisiut u superua ose zëvendësua nga sakrifica e Krishtit. Të besosh në një priftëri njerëzore apo të ofrosh flijime kafshësh do të thotë se nuk pranohet plotësinë e fitores së Krishtit. Besime të tilla do të thonë që ne nuk e pranohet sakrificën e Krishtit si plotësisht të suksesshme, dhe se ndjejmë që për justifikimin tonë nevojiten veprat, jo vetëm besimi në Krisht. “Askush nuk mund ta marrë pafajësinë përpara Perëndisë me anë të ligjit...sepse, Të drejtët (justifikuarit) do të jetojnë përmes *besimit*” (Gal. 3:11 kra. Hav. 2:4). Përpjekja jonë për të qenë të bindur para shkrimeve të ligjit të Perëndisë, sado e vendosur, do të dështojë dhe nuk do të na japë justifikim; sigurisht, çdo lexues i këtyre fjalëve e di këtë tashmë.

Nëse shikojmë ligjin e Moisiut, duhet të përqijemi ta zbatojmë *të gjithë* atë. Mosbindja ndaj vetëm një pjese do të thotë se ata që janë nën të (ligjin) janë të dënuar. “Kush mbështetet në veprat e ligjit është i mallkuar: sepse është shkruar, Mallkuar qoftë secili që nuk mban dhe nuk zbaton *gjithçka* që është shkruar në Librin e ligjit” (Gal. 3:10). Dobësia e natyrës sonë njerëzore do të thotë se e kemi të pamundur ta zbatojmë ligjin e Moisiut, por për hir të bindjes së plotë të Krishtit para tij, çlirohemi nga çdo detyrim për ta zbatuar atë. Shpëtimi ynë vjen si pasojë e dhuratës së Perëndisë përmes Krishtit, dhe jo si pasojë e veprave tona me bindje. “Atë që ligji nuk mund ta arrijë, sepse ne njerëzit jemi të dobët, atë e arriti Perëndia, duke dërguar Birin e vet atje ku shfaqet mëkati, në trupin e njeriut, që ta mposhtë atje tërë pushtetin e mëkati” (Rom. 8:3). Kështu “Krishti na çliroi nga mallkimi që sjell ligji duke e paguar me jetën e vet” (Gal. 3:13).

Për shkak të kësaj, nuk na kërkohet më të zbatojmë ndonjë prej urdhëresave të ligjit të Moisiut. Pamë në Studimin 3.4 që Besëlidhja e Re në Krisht zëvendësoi Besëlidhjen e Vjetër të ligjit të Moisiut (Heb. 8:13). Përmes vdekjes së tij, Krishti e anuloi “dokumentin që na padiste me kërkesat e tij, që ishte kundër nesh (për shkak të paaftësisë sonë për ta zbatuar plotësisht ligjin), dhe e largoi atë, duke e gozhduar në kryq...Prandaj, askush të mos ju japë urdhra në çështje ushqimi e pijeje, në çështje festash, hëne të re ose të shtunash: sepse këto janë vetëm hije e gjërave që do të vijnë; realiteti është Krishti” (Col. 2:14-17 A.V. me V.R.N.). Kjo është mjaft e qartë – për shkak të vdekjes së Krishtit mbi kryq, ligji u hoq “nga udha” që t’i rezistojmë çfarëdo presioni që na vihet për të zbatuar pjesë të tij, p.sh. festat e të

shtunat. Si pjesa tjetër e ligjit, qëllimi i këtyre gjërave ishte të tregonin përpara drejt Krishtit. Pas vdekjes së tij, rëndësia e tyre tipike u përmbush dhe prandaj nuk kishte më nevojë për t'i zbatuar.

Kisha e hershme kristiane e shekullit të parë ishte nën presion të vazhdueshëm nga çifutët ortodoksë për të zbatuar pjesë të ligjit. Në të gjithë Dhiatën e Re, ka paralajmërim të vazhdueshëm për t'u rezistuar këtyre sugjerimeve. Përballë të gjitha këtyre, është e jashtëzakonshme që sot ka disa degë që mbrojnë bindjen e pjesshme ndaj ligjit. Më parë kemi treguar që çdo përpjekje për të fituar shpëtimin përmes bindjes ndaj ligjit duhet të synojë zbatimin e *tërë* ligjit, përndryshe dënohemi për mosbindje ndaj tij (Gal. 3:10).

Ka një element brenda natyrës njerëzore që anon nga ideja e justifikimit përmes veprave; na pëlqen të ndjejmë se *po bëjmë* diçka drejt shpëtimit tonë. Për këtë arsye, detyrimet e të dhjetave, varja e kryqit, recitimi i lutjeve të përcaktuara, lutja në një pozicion të caktuar, etj., janë të gjitha pjesë popullore të shumicës së feve, kristiane e të tjera. Shpëtimi *vetëm* përmes besimit në Krisht është një doktrinë thuajse unike për krishtërimin e bazuar mbi Biblën.

Paralajmërimet kundër zbatimit të ndonjë pjese të Ligjit të Moisiut për të fituar shpëtimin, janë të përhapura në të gjithë Dhiatën e Re. Disa mësonin se kristianët duhen rrethprerë sipas ligjit të Moisiut, “dhe të zbatojnë ligjin.” Jakobi e dënonte prerazi këtë ide në emër të besimtarëve të vërtetë: “*ne* nuk kemi dhënë urdhëresë të tillë” (Veprat 15:24). Pjetri i përshkroi ata që mësonin nevojën për bindje ndaj ligjit si “një zgjedhë mbi qafën e dishepujve, të cilën as etërit tanë e as ne nuk ishim në gjendje ta mbanim. Por ne besojmë se përmes mëshirës së Zotit Jezu Krisht (jo përmes veprave të tyre të bindjes ndaj ligjit) ne do të shpëtohemi” (Veprat 15:10,11). Në frymëzim, Pali flet po kaq fort, duke theksuar herë pas here të njëjtën pikë. “Askush nuk merr pafajësinë përmes veprave të ligjit, por përmes besimit në Jezu Krisht. ...që të justifikohemi përmes besimit në Krisht, dhe jo përmes punërave të ligjit; sepse asnjë njeri nuk do të justifikohet përmes punërave të ligjit. ...askush nuk justifikohet nga ligji...përmes (Krishtit) të gjithë që besojnë shpëtohen nga çdo gjë, nga të cilat nuk shpëtoheshit dot përmes ligjit të Moisiut” (Gal. 2:16; 3:11; Veprat 13:39).

Fakti që shumica e praktikave të krishtërimin popullor janë të bazuara mbi elementë të Ligjit të Moisiut, është shenjë e sigurt e shtrembërimit prej tij – pavarësisht nga mësimi i qartë dhe i vështirë i shqyrtuar më sipër që kristianët nuk duhet ta zbatojnë këtë ligj, meqenëse është përmbushur në Krishtin (Mt. 5:17). Tani do të marrim në konsideratë shenjat më të

dukshme që tregojnë se Ligji i Moisiut është baza e praktikës aktuale kristiane.

PRIFTËRINJTË

Kishat katolike dhe anglikane përdorin haptas një sistem priftërie njerëzore. Katolikët romakë e shohin Papën si ekuivalentin e tyre të kryepriftit çifut. Ka “*një* ndërmjetës midis Perëndisë dhe njerëzve, njeriu Jezu Krisht” (1 Tim. 2:5). Prandaj, është e pamundur që Papa apo priftërinjtë të jenë ndërmjetësit tanë siç ishin priftërinjtë nën Besëlidhjen e Vjetër. Krishti është tani Kryeprifti ynë në qiell, që i ofron Perëndisë lutjet tona.

Nuk ka absolutisht asnjë fakt biblik që autoriteti i zotëruar nga kryepleqtë të cilëve u qe dhuruar shpirti në shekullin e parë – p.sh. Pjetri – u përcoll në brezat pasardhës apo tek Papa në veçanti. Edhe nëse pranohet mundësia e kësaj, nuk ka asnjë mënyrë për të provuar që Papa dhe priftërinjtë personalisht janë ata mbi të cilët ka rënë manteli shpirtëror i kryepleqve të shekullit të parë.

Dhuratat e shpirtit janë marrë mbrapsht, të gjithë besimtarët kanë akses të barabartë ndaj Shpirtit-Fjalës në Bibël (shih Studimet 2.2 dhe 2.4). Prandaj, ata janë të gjithë vëllezër, ku askush nuk ka një pozitë më të lartësuar shpirtërisht se një tjetër. Vërtet, *të gjithë* besimtarët e vërtetë janë anëtarë të një priftërie të re për shkak të pagëzimit të tyre në Krisht, në kuptimin që hedhin dritën e Perëndisë në një botë të errët (1 Pjt. 2:9). Prandaj, ata do të bëhen mbretër-priftërinjtë e Mbretërisë, kur ajo të vendoset mbi tokë kur të kthehet Krishti (Ap. 5:10).

Praktika katolike për t’i thirrur priftërinjtë e tyre ‘At’ë (‘Papë’ do të thotë gjithashtu ‘at’) është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me fjalët e qarta të Krishtit “Këtu në tokë mos quani asnjërin atë; sepse keni vetëm një At, atë që është në qiell” (Mt. 23:9). Vërtet, Jezusi paralajmëronte kundër dhënies ndokujt atë lloj respekti shpirtëror që kërkohet nga priftërinjtë modernë: “Mos lejoni t’ju quajnë Rabi (mësues): sepse vetëm një udhëheqës keni, Krishtin; dhe ju të gjithë jeni vëllezër” (Mt. 23:8).

Rrobot e komplikuar të veshura nga priftërinjtë, peshkopët e kishtarë të tjerë e kanë bazën në veshjen e veçantë veshur nga priftërinjtë dhe kryeprifti sipas Moisiut. Kjo veshje tregonte përpara drejt karakterit të përkryer të Krishtit dhe, si i gjithë ligji, qëllimi i saj është përmbushur. Vërtet të thyhet zemra që veshjet që synonin të adhuroar lavdinë e Krishtit, tani përdoret për të çuar përpara lavdinë e njerëzve që i veshin ato – disa prej të cilëve pranojnë që nuk e pranojnë ringjalljen e Krishtit madje as ekzistencën e Perëndisë.

Ideja katolike se Maria është një priftëreshë është rëndshëm e gabuar. Kërkesat tona janë në emër të *Krishtit*, jo të Marisë (Gjn. 14:13,14; 15:16; 16:23-26). Krishti është Kryepriifti ynë i vetëm, jo Maria. Jezusi e qortoi Marinë kur ajo u përpoq ta detyronte të bënte gjëra për të tjerët (Gjn. 2:2-4). Perëndia, jo Maria, i sjell njerëzit tek Krishti (Gjn. 6:44).

E DHJETA

Edhe kjo ishte pjesë e Ligjit të Moisiut (Regj. 18:21), sipas të cilës, çifutët duhej t'i dhuronin një të dhjetën e të korrave të tyre fisit priftëror të levitëve. Meqenëse nuk ka priftëri njerëzore, nuk mund të jetë më e detyrueshme që t'i paguhet ndonjë e dhjetë ndonjë kryekishtari. Përsëri, një ide e rreme (në këtë rast në lidhje me priftërinjtë) ka çuar në një tjetër (d.m.th. e dhjeta). Vetë Perëndia nuk ka *nevojë* që t'i japim ne, meqenëse të gjitha i përkasin Atij (Ps. 50:8-13). Veçse po i kthejmë Perëndisë atë që Ai na ka dhënë neve (1 An. 29:14). Është e pamundur që ne të fitojmë shpëtim si rezultat i dhuratave tona materiale, p.sh. nga pikëpamja financiare. Si mirënjohje për dhuratën e madhe të Perëndisë për ne, duhet jo vetëm t'i ofrojmë një të dhjetën e parave tona, por gjithë jetët tona. Pali dha një shembull të kësaj, duke praktikuar vërtet atë që predikonte: “Kushtojani Perëndisë veten tuaj si një flijim të gjallë, të shenjtë, që do t'i pëlqejë; ky është një shërbim i arsyeshëm i juaji” (Rom. 12:1).

MISHI

Ligji çifut kategorizonte mishra të caktuara si të papastra – një praktikë e adoptuar nga disa sekte sot, veçanërisht në lidhje me mishin e derrit. Ngaqë Krishti e shfuqizoi ligjin në kryq, “Mos lejoni askënd t'ju japë urdhra në çështje të mishit apo të pijes” (Kol. 2:14-16). Kështu, urdhrat sipas Moisiut në lidhje me këto gjëra janë hequr tej, meqenëse tani ka ardhur Krishti. Përpara drejt atij tregonin edhe ushqimet ‘e pastra.’ Jezusi shpjegoi qartë që asgjë që ha një njeri nuk mund ta ndotë atë shpirtërisht; ajo që e bën këtë është ajo që del nga zemra e tij (Mk. 7:15-23). “Kështu, Jezusi deklaroi se të gjitha ushqimet janë të pastra” (Mk. 7:19 V.R.N.). Pjetrit iu dha i njëjti mësim (Veprat 10:14,15), ashtu si dhe Pali: “E di dhe jam i bindur nga Zoti Jezus që asgjë nuk është e papastër në vetvete” (Rom. 14:14). Më parë, Pali kishte arsyetuar se refuzimi i mishrave të caktuara ishte shenjë dobësie shpirtërore (Rom. 14:2). Qëndrimi ynë ndaj mishit “nuk kushtëzon marrëdhënien me Perëndinë” (1 Kor. 8:8). Më inkriminuese nga të tëra është paralajmërimi që kristianët renegatë do të jepnin si mësim që “të mos hajë ushqime të veçanta, që i ka krijuar Perëndia

dhe që merren nga ata që falënderojnë Perëndinë dhe besojnë dhe dinë të vërtetën” (1 Tim. 4:3).

9.6 Dita e Shtatë (Shabat)

Një prej vazhdimësive më të përhapura midis praktikave aktuale kristiane dhe ligjit të Moisiut shihet në idenë që duhet të zbatohet ditën e Shtatë. Disa grupe pretendojnë se duhet të zbatohet të Shtatën Çifute saktësisht siç përcaktohet në ligj; shumë të tjerë ndjejnë që kristianët duhet të kenë një ditë të veçantë të javës në të cilën të adhurojnë, të cilën shpesh e përkufizojnë si të Dielën. Gjëja e parë që duhet sqaruar është që e Shtata ishte dita e fundit e javës, kur Perëndia pushoi pas gjashtë ditëve të krijimit (Dal. 20:10,11). Meqenëse e diela është dita e parë e javës, do të ishte e pasaktë nëse mbahej si e Shtata. Shabati ishte specifikisht “një shenjë midis meje (Perëndisë) dhe atyre (izraelitëve), që të mund të dinin se unë jam Zoti që i veçoj ata si popullin tim të shenjtë” (Jhz. 20:12). Si e tillë, ajo s’është synuar kurrë të jetë detyruese për joçifutët. “Zoti ju ka dhënë *juve* [jo gjithë njerëzimit] shabatin (Dal. 16:29); “ti [Perëndia] u bërë të njohur atyre [izraelitëve] Shabatin tënd të Shenjtë” (Neh. 9:14).

Një herë Jezusi komentoi një problem teologjik: një fëmijë mashkull duhej rrethprerë në ditën e tetë të jetës së tij. Nëse kjo binte në Shabat, atëhere duhej punuar. Atëhere, cili ligj duhej zbatuar, rrethprerja apo Shabati? Jezusi u përgjigj se duhej nderuar rrethprerja, sepse kjo vinte prej Abrahamit, ndërsa ligji i Shabatit kishte ardhur më pas, nga Moisiu: “Moisiu ju dha rrethprerjen [jo sepse është nga Moisiu, por nga etërit – *d.m.th.* *Abrahami*]....”. Nëse ligji i rrethprerjes kishte përparësi para atij të Shabatit, si mund të argumentohet nga disa se ligji i Shabatit është detyrues ndërsa ai i rrethprerjes nuk është? Rrethprerja ishte shenja e besëlidhjes me Abrahamin, ndërsa Shabati ishte shenja e ligjit të Moisiut (Dal. 31:17), dhe Jezusi gjykoi se besëlidhja me Abrahamin ishte më e rëndësishme. I njëjti argument përdoret nga Pali, kur ai arsyeton se besëlidhja e re që iu dha Abrahamit [e cila nuk përfshinte ndonjë urdhër mbi Shabatin] është diçka që nuk mund t’i shtosh apo ta çanulosh. Ai pyet, për rrjedhojë, pse ndodhi që “ligji ... u shtua” (Gal. 3:15,19)? Ai përgjigjet se ligji u shtua, përkohësisht, duke parë që besëlidhjes së re nuk mund t’i shtosh, për t’u mësuar njerëzve mbi mëkatet dhe t’i drejtosh drejt kuptimit të Krishtit, pasardhësit të premtuar të Abrahamit. Tani që Krishti ka ardhur, nuk jemi më nën ligjin. Prandaj, përmes vdekjes së Krishtit mbi kryq, Ligji i Moisiut u hoq tutje, dhe nuk ka nevojë të zbatohet Shabati apo, vërtet, ndonjë festival, p.sh., dita

e vdekjes së Krishtit (Kol. 2:14-17). Kristianët e hershëm që iu kthyen zbatimit të disa pjesëve të ligjit të Moisiut, p.sh. Shabatit, përshkruhen nga Pali sikur kthehen tek “parimet e dobëta e të varfra (V.R.N.), doni t’u nënshtroheni përsëri atyre. Ju kremtoni ditë (p.sh. Shabati), dhe muaj, kohëra, e vite (p.sh. festivalet çifute). Kam frikë se do të shkojnë kot të gjitha mundimet e mia për ju” (Gal. 4:9-11). Ky është serioziteti i përpjekjes për ta zbatuar Shabatin si një mjet për shpëtim. Është e qartë që zbatimi i Shabatit nuk ka lidhje me shpëtimin: “Për njërin, ditët e veçanta kanë kuptim të veçantë (d.m.th. për domethënien shpirtërore): kurse për tjetrin të gjitha ditët janë njësoj. Secili le të veprojë me bindjen e vet. Kush çmon një ditë (A.V. fundfaqe), bën kështu për nder të Zotit; dhe kush nuk çmon një ditë, nuk e çmon për Zotin” (Rom. 14:5,6).

Për shkak të kësaj, është e kuptueshme që nuk lexojmë ndokund që besimtarët e hershëm të kenë zbatuar Shabatin. Vërtet, është regjistruar se ata takoheshin “ditën e parë të javës,” d.m.th. të dielën: “Ditën e parë të javës, të dielën, dishepujt u mbledhën për të festuar darkën e Zotit...” (Veprat 20:7). Fakti që kjo ishte një praktikë e përhapur gjerësisht, tregohet nga Pali kur këshillon besimtarët në Korint që të mbledhin “ditën e parë të javës” (1 Kor. 16:2), d.m.th. në takimet e tyre të rregullta atë ditë. Të gjithë besimtarët përshkruhen të jenë priftërinj (1 Pjt. 2:9) – të cilët përjashtoheshin nga zbatimi i Shabatit (Mt. 12:5).

Nëse do ta zbatojmë Shabatin, këtë duhet ta bëjmë siç duhet; më parë kemi treguar se është fatale nëse ligji i Moisiut zbatohet pjesërisht, sepse kjo çon në dënimin tonë (Gal. 3:10; Jakobi 2:10). Shpëtimi vjen përmes ligjit të Krishtit jo atij të Moisiut. Izraelitët nuk lejoheshin të punonin ditën e Shabatit: “Kushdo që punon atë ditë do të dënohet me vdekje.” Atyre gjithashtu iu dha urdhri: “Ditën e Shabatit nuk do të ndizni zjarr në shtëpitë tuaja”, prandaj, atë ditë u ndalohej të përgatishnin ushqim (Dal. 35:2,3; 16:23). Dikush që po mblidhte shkopinj ditën e Shabatit, supozohet për të ndezur një zjarr, u ndëshkua me vdekje për këtë (Regj. 15:32-36).

Ato sekte që mësojnë se zbatimi i Shabatit është i detyrueshëm për anëtarët e tyre, duhet t’i ndëshkojnë me vdekje kur ata e shkelin detyrimin. Atë ditë nuk duhet të ketë gatim për ushqim apo përdorim zjarri në ndonjë formë – p.sh. ngarja e makinave, përdorimi i sistemeve të ngrohjes, etj. Çifutët ortodoksë sot japin një shembull për llojin e sjelljes që pritet ditën e Shabatit: ata mbeten brenda shtëpisë gjithë ditën me përjashtim të arsyeve fetare, dhe nuk janë personalisht të përfshirë në gatim, transport, etj. Shumica e atyre ‘kristianëve’ që pretendojnë të zbatojnë Shabatin janë shumë larg kësaj.

- Shpesh thuhet se zbatimi i Shabatit ishte një prej dhjetë urdhëresave që iu dhanë Moisiut, dhe që, pas shfuqizimit të Ligjit të Moisiut, prapëseprapë mbetet detyrimi që të gjitha dhjetë urdhëresat të zbatohen. Adventistët e Ditës së Shtatë bëjnë një dallim midis një ‘ligji moral’ të dhjetë urdhëresave, ‘ligjit të Perëndisë,’ dhe një të ashtuquajtur ‘ligj ceremonial,’ ‘ligjit të Moisiut’ i cili sipas tyre u hoq nga Krishti. Ky dallim nuk mësohet në Shkrimin e Shenjtë. Bibla i përdor termat ‘ligj i Moisiut’ dhe ‘ligj i Perëndisë’ në vend të njëri-tjetrit (Regj. 31:21; Josh. 23:6; 2 An. 31:3). Më parë demonstruam që Besëlidhja e Vjetër i referohet Ligjit të Moisiut, i cili u zëvendësua në kryq nga Besëlidhja e Re. Perëndia “Perëndia ju deklaroi juve (izraelitëve) besëlidhjen e tij, të cilën ju (izraelitët) urdhëroi ta zbatonit, dhjetë urdhëresat; dhe i shkroi mbi dy rrasa guri” (Br. 4:13). Edhe njëherë, duhet vërejtur që kjo besëlidhje, bazuar mbi dhjetë urdhëresat, u bë midis Perëndisë dhe izraelitëve, jo joçfutëve të ditëve të sotme.
- Moisiu u ngjiti në Malin Horev për të marrë rrasat e gurit mbi të cilat Perëndia kishte shkruar dhjetë urdhëresat. Më pas, në lidhje me këtë, Moisiu komentoi, “Zoti, Perëndia ynë ka bërë një besëlidhje me ne në Horev” (Br. 5:2), d.m.th. përmes atyre dhjetë urdhëresave.
- Në këtë kohë, Perëndia “shkroi mbi rrasat e gurit fjalët e besëlidhjes, dhjetë urdhëresat” (Dal. 34:28). Kjo besëlidhje përfshin hollësi për të ashtuquajturin ‘ligj ceremonial’ (Dal. 34:27). Nëse pohojmë se zbatimi i besëlidhjes së bërë në dhjetë urdhëresat është i nevojshëm, atëherë duhet të zbatojmë çdo hollësi të të gjithë ligjit, meqenëse do të ishte pjesë e së njëjtës besëlidhje. Është e dukshme që kjo është e pamundur të bëhet.
- “Në arkë ishin vetëm dy rrasat e gurit që Moisiu i kishte futur aty në Horev...arak, ku ndodhet besëlidhja e Zotit” (1 Mbr. 8:9,21). Ato rrasa, mbi të cilat ishin dhjetë urdhëresat, ishin besëlidhja.
- Heb. 9:4 flet për “rrasat e besëlidhjes.” Dhjetë urdhëresat ishin shkruar në rrasa guri, të cilat përbënin “besëlidhjen (e vjetër).”
- Pali i referohet kësaj besëlidhjeje si “e shkruar dhe gdhendur në gurë,” d.m.th. në rrasat e gurit. Ai i quan “shërbimi që sillte vdekjen...shërbimi u sillte njerëzve dënimin...ajo që është kalimtare” (2 Kor. 3:7-11). Besëlidhja e shoqëruar me dhjetë urdhëresat sigurisht që nuk mund të japë ndonjë shpresë për shpëtim.

- Krishti e shfuqizoi “dokumentin e urdhrave që ishte kundër nesh” (Kol. 2:14) mbi kryq. Kjo aludon për dorëshkrimin e Perëndisë të dhjetë urdhëresave mbi rrasat e gurit. Po kështu, Pali flet për “ligjin...duke qenë të vdekur...sipas mënyrës së vjetër të *shkrimit*” (Rom. 7:6), ndoshta duke iu referuar shkrimit të dhjetë urdhëresave që ishin shkruar në rrasat e gurit.
- Vetëm një prej dhjetë urdhëresave quhet “ligji” në Rom. 7:8: “Në ligj...thuhej, Mos lakmo.” Vargjet pararendëse në Rom. 7:1-7 theksojnë se si “ligji” është shfuqizuar nga vdekja e Krishtit; prandaj “ligji” i përfshin dhjetë urdhëresat.

E gjithë kjo bën të qartë që Besëlidhja e Vjetër dhe “ligji” përfshinin dhjetë urdhëresat. Pasi u shfuqizuan nga Besëlidhja e Re, dhjetë urdhëresat janë hequr. Megjithatë, nëntë prej dhjetë urdhëresave janë riafirmuar, të paktën në shpirt, në Dhiatën e Re. Numrat 3, 5, 6, 7, 8 dhe 9 mund të gjenden tek 1 Tim. 1 vetëm, dhe numrat 1, 2 dhe 10 tek 1 Kor. 5. Por, urdhëresa e katërt, në lidhje me Shabatit, nuk përsëritet kurrë në Dhiatën e Re, për të qenë detyruese për ne.

Lista e mëposhtme e pasazheve dokumenton më tej se si nëntë të tjerat janë riafirmuar në Dhiatën e Re.

E 1ra	Ef. 4:6; 1 Gjn. 5:21; Mt. 4:10
E 2ta	1 Kor. 10:14; Rom. 1:25
E 3ta	Jakobi 5:12; Mt. 5:34, 35
E 5ta	Ef. 6:1, 2; Kol. 3:20
E 6ta	1 Gjn. 3:15; Mt. 5:21, 22
E 7ta	Heb. 13:4; Mt. 5:27, 28
E 8ta	Rom. 2:21; Ef. 4:28
E 9ta	Kol. 3:9; Ef. 4:25; 2 Tim. 3:3
E 10ta	Ef. 5:3; Kol. 3:5

Zoti Jezus i fton ata që e ndjekin Atë të pranojnë “pushimin” që jep Ai (Mt. 11:28). Ai përdor një fjalë greqisht që përdoret në Septuagint, përkthimi greqisht i Dhiatës së Vjetër, për pushimin e Shabatit. Jezusi po ofronte një jetë Shabati, pushimi nga besimi në veprat tona (krah. Heb. 4:3,10). Prandaj, nuk duhet ta zbatojmë Shabatit për një ditë në javë, por në fakt të jetojmë të gjithë jetët tona në shpirtin e Shabatit.

Digression 28: Kryqëzimi

Besohet gjerësisht në krishtërim që Jezu Krishti u vra në një kryq. Megjithatë, fjala greqisht ‘*stauros*’, e cila normalisht përkthehet ‘*kryq*’ në

biblat anglisht, në fakt do të thotë shtyllë. Vërtet, simboli i kryqëzimit ndoshta ka origjinë pagane. Është korrekte që Krishti vdiq me duart e krahët ngritur mbi kokë, dhe jo shtrirë në formë kryqëzimi, meqenëse duart e ngritura janë simbol i konfirmimit të premtimeve të Perëndisë (Jhz. 20:5,6,15; 36:7; 47:14), si dhe i lutjes së dendur (Vaj. 2:19; 1 Tim. 2:8; 2 An. 6:12,13; Ps. 28:2), në të cilat Krishti që përfshirë kur ishte mbi kryq (Heb. 5:7). Ai tha se ashtu si nepërka e bronxtë u ngjit mbi një *shtyllë* kur izraelitët ishin në shkretëtirë, ashtu dhe ai do të ngrihej publikisht në kohën e vdekjes së tij; kështu, ai e përqasi 'kryqin' me *shtyllën* (Gjn. 3:14). Kisha Katolike Romake i ka dhënë domethënie të madhe mistike kryqit. Kjo nuk ka asfare mbështetje biblike; kjo ka sjellë që kryqëzimi të bëhet një hajmali, një shenjë fizike se Perëndia është me ne. Njerëzit kanë arritur të ndjejnë që duke mbajtur një kryq apo duke bërë shpesh shenjën e kryqit, Perëndia do të jetë me ta. Kjo është hajmalizëm i pastër; fuqia e vërtetë e kryqit është përmes përqasjes sonë me vdekjen e Krishtit përmes besimit dhe pagëzimit, dhe jo përmes duke kujtuar formën fizike të kryqit. Sigurisht, është më e lehtë të bëhet kjo e dyta sesa e para. Nuk mungojnë faktet që kryqi ishte një simbol pagan i njohur dhe i përdorur shumë kohë përpara kohës së Krishtit. Edhe ai është një pjesë tjetër e paganizmit, si pemët e krishtlindjeve, të cilat janë përzier me 'krishtërimin' nga kishat devijuese.

Digression 29: A u lind Jezusi më 25 Dhjetor?

Një tjetër gabim madhor i krishtërimin është ai në lidhje me ditëlindjen e Jezusit. Barinjët po flinin në fushë me batëtitë në kohën e lindjes së Krishtit (Lk. 2:8); ata nuk do ta kishin bërë këtë në kohën e krishtlindjeve, gjatë dimrit. *The Jerusalem Post* dhe gazeta të tjera izraelite shpesh kanë kryetituj në dhjetor që tregojnë se si dëbora ka paralizuar Jeruzalemin. 25 dhjetori në origjinë ishte data e festës pagane në Europën para-kristiane. Veprat e Apostujve regjistrojnë se si kristianët e vërtetë u persekutuan keq nga paganët për hir të besimeve të tyre. Herë pas here apostujt paralajmëronin se për shkak të kësaj, kristianët do të adoptonin besime pagane, për t'u dhënë atyre mundësi që ta bënin fenë e tyre më të pranueshme për paganët rreth tyre (p.sh. Veprat 20:30; 1 Gjn. 2:18; 2 Sel. 2:3; 2 Pjt. 2:1-3). Adoptimi i 25 dhjetorit si një festë kristiane është një shembull parësor i kësaj. Pemët e krishtlindjeve, veshullat, etj. mund të datojnë të gjitha tek ritet pagane të praktikuara më 25 dhjetor. Nga kjo rrjedh që kristianët e vërtetë nuk duhet të festojnë ditëlindjen e Krishtit më 25 dhjetor. Në praktikë, besimtarët e vërtetë, do të përdorin

ZOTI 392

festat më publike, p.sh. krishtlindjet, për të ndarë miqësinë sëbashku kudo të jetë e mundur.

STUDIMI 9: Pyetje

1. Pse ishte vdekja e Jezusit, jo e ndonjë njeriu tjetër, e nevojshme për shpëtimin tonë?
2. Pse nuk mjaftonin flijimet e kafshëve të Ligjit të Moisiut për të larguar mëkatet?
3. A ishte Jezusi përfaqësuesi ynë apo zëvendësuesi ynë kur vdiq?
4. Cili prej pohimeve të mëposhtme është i vërtetë?
 - a) Krishti vdiq në vend që të vdisnim ne
 - b) Krishti na përfaqësoi ne, në mënyrë që Perëndia të na falë për hir të tij nëse besojmë dhe pendohe mi
 - c) Krishti ishte si ne por nuk na përfaqëson ne
 - d) Vdekja e Krishtit do të thoshte se Perëndia nuk do të quajë më ndonjë qenie njerëzore fajtor për mëkat
5. A përfitoi Jezusi nga vdekja e vet?
6. Kur Krishti vdiq mbi kryq:
 - a) Ai superoi urdhrat e vegjël të Ligjit të Moisiut por jo dhjetë urdhëresat
 - b) Ai superoi të gjithë Ligjin e Moisiut duke përfshirë dhjetë urdhëresat
 - c) Ai superoi Ligjin e Moisiut me përjashtim të festave çifute
 - d) Nuk pati ndikim mbi pozitën e Ligjit të Moisiut
7. A duhet ta zbatojmë Shabatit tani?
8. Jepni arsye për përgjigjen tuaj për pyetjen 7.

9.1 Fitorja e Jezusit

Studimi i mëparshëm tregoi se si Jezusi kishte natyrën tonë njerëzore dhe u tundua ashtu si dhe ne përpara mëkateve. Dallimi midis tij dhe nesh është që ai e kapërceu plotësisht mëkatit; ndërkohë që kishte një *natyrë* mëkatore, ai gjithnjë demonstroi një *karakter* të përkryer. Mrekullia e kësaj gjëje duhet të na frymëzojë ndërkohë që e vlerësojmë gjithnjë e më shumë. Në Dhiatën e Re, karakteri i përkryer i Krishtit theksohet në mënyrë të përsëritur.

- Ai “u vu në provë në çdo drejtim ashtu si dhe ne, e megjithatë mbeti pa mëkat” (Heb. 4:15).
- Ai “nuk njihnte mëkat.” “Tek ai nuk ka mëkat” (2 Kor. 5:21; 1 Gjn. 3:5)

- “Nuk kishte bërë asnjë mëkat, dhe nuk kishte thënë asnjë gënjeshtër” (Pjt. 2:22)
- “I shenjtë, nuk ka asgjë të dënueshme, dhe është pa të meta, veçmas mëkatarëve” (Heb. 7:26)

Shkrimet e Ungjillit demonstrojnë se si kolegët e tij e njihnin përsosmërinë e karakterit të tij, të treguar në fjalët dhe në veprat e tij. Gruaja e Pilatit pranonte që ai ishte një “njeri i pafajshëm” (Mt. 27:19), i cili nuk meritonte ndëshkim; ushtarit romak që vëzhgonte sjelljen e Krishtit kur ky varej mbi kryq iu desh të komentonte, “Sigurisht, ky njeri ishte i pafajshëm” (Lk. 23:47). Më herët në jetën e tij, Jezusi i sfidoi çifutët me pyetjen: “Cili prej jush mund të provojë se kam bërë ndonjëherë mëkat?” (Gjn. 8:46). Për këtë nuk pati përgjigje.

Si rezultat i përsosmërisë së tij fitimtare në çdo mënyrë, Jezusi nga Nazareti u *bë* më i lartë se engjëjt (Heb. 1:3-5). Atij iu lartësua emri (Fil. 2:8), çka përfshinte të gjithë titujt engjëllorë. “Emri i tij *do të* quhet I Mrekullueshëm [krahaso Jud. 13:18 AV, anëfaqe], këshilltar [përdorur për engjëjt në 1 Mbret. 22:20 teksti hebraisht]...” (Jesh. 9:6). Është e qartë që Jezusi nuk e zotëronte këtë pozitë të lartë përpara lindjes dhe vdekjes së tij; ideja që ai u lartësua *deri* në këtë pozitë e përjashton këtë.

Për shkak të karakterit të tij të përkryer, Jezusi ishte manifestimi i Perëndisë në mish (1 Tim. 3:16); Ai vepronte dhe fliste ashtu si do kishte bërë Perëndia nëse Ai do të kishte qenë njeri. Prandaj, ai ishte pasqyrimi i përkryer i Perëndisë - “*shëmbëlltyra* e Perëndisë së padukshëm” (Kol. 1:15). Për këtë arsye, nuk ka nevojë që njerëzit e vdekshëm ta shohin Perëndinë. Siç e shpjegonte Jezusi, “Kush më sheh mua, sheh edhe Atin; si mund të thuash atëherë, na e trego (fizikisht) Atin?” (Gjn. 14:9). Theksi i përsëritur biblik është që Perëndia Ati ishte i manifestuar në Krishtin Jezus Birin e Tij (2 Kor. 5:19; Gjnj. 14:10; Veprat 2:22). Doktrina e trinisë meson se Biri ishte i manifestuar ose ‘i mishëruar’ në Jezusin; por Bibla mëson që Perëndia ishte i manifestuar [‘i mishëruar’ nëse duhet të përdorim termin] në Jezusin. Fjala *u shndërrua* në mish (Gjn. 1:14), dhe jo se Fjala hyri në një formë të mishtë.

Duke qenë se jetojmë në një botë mëkatore, dhe duke qenë të pllakosur me mëkate në vetë natyrën tonë, për ne është e vështirë të vlerësojmë tërësinë dhe gjerësinë e supremacisë shpirtërore të Krishtit; që një njeri me natyrën tonë do të zbulonte pastërtinë e Perëndisë në karakterin e tij. Të besuarit e kësaj kërkon një besim më real se sa thjesht pranimi i idesë teologjike se Krishti ishte Vetë Perëndia.

Ngaqë kishte natyrën tonë, Krishti duhej të vdiste. Ai ishte një pasardhës i Adamit përmes Marisë, dhe të gjithë pasardhësit e Adamit duhet të vdesin (1 Kor. 15:22). Të gjithë pasardhësit e Adamit duhej të vdisnin për shkak të mëkatit të tij, të Adamit, pavarësisht nga situata e tyre personale. “Vdekja sundonte...përmes kundravajtjes së njërit (Adamit) shumë duhet të vdesin...grykimi ishte (për hir të) njërit (Adamit) dënimi (me vdekje)...nga mosbindja e njërit u *bënë* mëkatarë shumë njerëz,” dhe prandaj duhej të vdisnin (Rom. 5:14-19 krahu. 6:23). Si pasardhës i Adamit, Jezusi duhej të vdiste, ai trashëgoi natyrën e vdekshme nga Adami përmes Marisë, nënës së tij.

Me përjashtim të Jezusit, të gjithë pasardhësit e Adamit e meritojnë këtë ndëshkim, sepse ne kemi mëkatar personalisht. Jezusi duhej të vdiste sepse ai kishte natyrën tonë, duke ndarë mallkimin që u vendos mbi pasardhësit e Adamit. Megjithatë, ngaqë personalisht nuk kishte bërë asgjë për të merituar vdekjen “Perëndia e ngjalli nga të vdekurit, duke e çliruar nga agonja e vdekjes, sepse vdekja nuk mund ta mbante më nën pushtetin e saj” (Veprat 2:24 V.R.N.). Krishti u “deklarua të ishte Biri i Perëndisë me fuqi, sipas shpirtit të shenjtë, përmes ringjalljes nga të vdekurit” (Rom. 1:4). Për shkak të karakterit të përkryer të Krishtit, “shpirtit hyjnor” të tij, ai u ngjall.

Krishti nuk vdiq mbi kryq *vetëm* sepse kishte natyrë njerëzore. Ai dha jetën e tij të përkryer vullnetarisht si dhuratë për ne; ai tregoi dashurinë e tij për ne duke vdekur “për mëkatet tona” (1 Kor. 15:3), duke ditur që përmes vdekjes së tij ai do të fitonte shpëtimin nga mëkati dhe vdekja për ne (Ef. 5:2,25; Ap. 1:5; Gal. 2:20). Ngaqë Jezusi ishte i përkryer në karakter, ai ishte i aftë të kapërcente rezultatin e mëkatit duke qenë personi i parë që u ngjall nga të vdekurit dhe iu dha jeta e përjetshme. Të gjithë ata që e identifikojnë veten me Krishtin përmes pagëzimit dhe jetës së ngjashme me të Krishtit, për rrjedhojë, kanë shpresë për ringjallje dhe shpërblim të ngjashëm.

Këtu gjendet dhe rëndësia e lavdishme e ringjalljes së Krishtit. Është “siguria” që ne do të ringjallemi dhe do të grykohemi (Veprat 17:31), dhe nëse e kemi ndjekur atë vërtet në këtë jetë, ne do të ndajmë shpërblimin e tij për jetën e përjetshme, “*duke ditur* (me besim) që ai që ringjalli Zotin Jezus, do të na ngjallë edhe ne, gjithashtu përmes Jezusit” (2 Kor. 4:14; 1 Kor. 6:14; Rom. 6:3-5). Si mëkatarë, ne meritojmë vdekjen e përjetshme (Rom. 6:23). Megjithatë, për shkak të jetës së përkryer të Krishtit, të vdekjes së bindur dhe ringjalljes së tij, Perëndia na ofroi ne *dhuratën* e jetës së përjetshme, plotësisht në përputhje me të gjitha parimet e Tij. Për të zhvendosur ndikimet e mëkateve tona, Perëndia na “shpall të pafajshëm” (Rom. 4:6) përmes besimit tonë në premtimet e Tij për shpëtim.

E dimë që mëkati sjell vdekje, prandaj, nëse besojmë vërtet që Perëndia do të na shpëtojë prej tij, duhet të besojmë edhe që Ai do të na llogarisë si të pafajshëm, megjithëse nuk jemi. Krishti ishte i përkryer; duke qenë vërtet në Krisht, Perëndia do të na llogarisë sikur jemi të përkryer, megjithëse personalisht nuk jemi të tillë. Perëndia e bëri Krishtin “të ishte mëkatar për ne, megjithëse ai nuk njihte mëkat; që ne të marrim pafajësinë e Perëndisë në atë” (2 Kor. 5:21), d.m.th. të qenit në Krisht përmes pagëzimit dhe jetës së ngjashme me të Krishtit. Kështu, për ata që janë “në Krishtin Jezus,” ai “u bë pafajësia, hyjnizimi dhe çlirimi ynë” (1 Kor. 1:30,31); prandaj, vargu i mëposhtëm na nxit të lëvdojmë Krishtin për gjërat e mëdha që ka arritur. “Në Shkrimin e Shenjtë tregohet pafajësia prej Perëndisë, pafajësi që arrihet përmes besimit” (Rom. 1:17, V.R.N.). Për pasojë, të kuptuarit e këtyre gjërave është një pjesë e nevojshme e njohjes së Ungjillit të vërtetë. E gjitha kjo u bë e mundur përmes ringjalljes së Krishtit. Ai ishte “i parëlinduri” i një numri të madh njerëzish që do të bëhen të pavdekshëm përmes arritjes së tij (1 Kor. 15:20), “i parëlinduri” i një familjeje të re shpirtërore, së cilës do t’i jepet natyra e Perëndisë (Kol. 1:18 krah. Ef. 3:15). Prandaj, ringjallja e Krishtit bëri të mundur që Perëndia t’i llogariste besimtarët në Krisht sikur të jenë të pafajshëm, meqenëse janë të mbuluar prej pafajësisë së tij. Krishti “u bë të vdiste për të shlyer mëkatet tona, dhe u ringjall që ne të marrim justifikimin (fjala do të thotë “me qenë i pafajshëm”)” (Rom. 4:25).

Nevojitet një besim i ndërgjegjshëm dhe i medituar mirë në këto gjëra që të bindemi vërtet se mund të llogaritemi prej Perëndisë sikur jemi të përkryer. Krishti mund të na paraqesë ne në fronin e gjykimit “të panjollë përpara pranisë së lavdisë së tij,” “të shenjtë, të pafajësueshëm dhe të padënueshëm përpara tij” (Juda v. 24; Kol. 1:22 krah. Ef. 5:27). Duke pasur parasysh natyrën tonë mëkatore dhe dështimet e përhershme shpirtërore, nevojitet një besim i qëndrueshëm që kjo të besohet me të vërtetë. Thjesht ngritja e dorës lart në një ‘kryqëzatë’ apo miratimi akademik i një aradhe doktrinash nuk lidhen me këtë lloj besimi. Ajo që duhet të motivojë besimin tonë është të kuptuarit siç duhet i ringjalljes së Krishtit: “Perëndia... e ngjalli nga të vdekurit. ...me qëllim që besimi dhe shpresa (për një ringjallje të ngjashme) juaj të mund të jetë tek Perëndia” (1 Pjt. 1:21).

Vetëm përmes pagëzimit siç duhet në Krisht, pasuar nga një jetë e tërë dishepullie të vërtetë, ne mund të jemi “në Krisht” dhe për pasojë të jemi të mbuluar prej pafajësisë së tij. Përmes pagëzimit, ne shoqërizohemi me vdekjen e tij dhe ringjalljen e tij (Rom. 6:3-5), të cilat janë mjetet e çlirimit tonë nga mëkatet tona, duke qenë “të justifikuar”, ose të llogaritur si të pafajshëm (Rom. 4:25).

Gjërat e mrekullueshme që kemi shqyrtuar në këtë seksion as që mund t'i kuptojmë nëse nuk jemi pagëzuar. Në pagëzim, ne shoqërimin tonë me gjakun e Krishtit derdhur mbi kryq; besimtarët "lajnë petkat dhe (i bëjnë) të bardha me anë të gjakut të qingjit" (Ap. 7:14). Figurativisht, ata janë për pasojë, të veshur me të bardha, duke përfaqësuar pafajësinë e Krishtit që është llogaritur ('dhënë') atyre (Ap. 19:8). Është e mundur që këto rroba të bardha t'i ndryshojnë si pasojë e mëkatit tonë (Juda v. 23); kur e bëjmë këtë pas pagëzimit, duhet të kërkojmë faljen e Perëndisë përmes Krishtit.

Për rrjedhojë, pas pagëzimit prapë duhet të përpiqemi të qëndrojmë në pozicionin e bekuar në të cilin kemi hyrë. Ka nevojë për vetë-shqyrtim të rregullt, të përditshëm, për pak minuta çdo ditë, përmes lutjeve të përhershme dhe të kërkuarit të faljes. Duke bërë këtë, ne do të jemi gjithnjë përditshëm të bindur që, për shkak të mbulimit tonë nga pafajësia e Krishtit, ne do të jemi vërtet në Mbretërinë e Perëndisë. Duhet të përpiqemi që të gjendemi të palëkundur në Krisht në ditën e vdekjes sonë apo të kthimit të Krishtit "jo përmes vetë bindjes (sonë)...por me anë të besimit (në) Krisht, pafajësisë që jepet nga Perëndia përmes besimit" (Fil. 3:9).

Theksimi i përsëritur mbi faktin që *besimin* çon në pafajësinë e dhënë, tregon që ne nuk mund të përfitojmë shpëtimin në asnjë mënyrë përmes veprave tona; shpëtimi vjen nga mëshira: "Sepse shpëtoheni nga mëshira përmes besimit; jo vetvetiu; shpëtimi është dhuratë e Perëndisë; jo e veprave që bëni" (Ef. 2:8,9). Ashtu si justifikimi dhe pafajësia janë 'dhurata' (Rom. 5:17), po kështu, është edhe shpëtimi. Motivimi ynë për të bërë çfarëdo veprë të shërbimit kristian, për rrjedhojë, duhet të jetë mirënjohja për atë që Perëndia ka bërë për ne – duke na quajtur të pafajshëm përmes Krishtit, dhe përmes kësaj, duke na dhënë rrugën për në shpëtim. Është fatale të arsyetohet se nëse bëjmë vepra, atëherë ato do të na shpëtojnë. Thjesht nuk do t'ia dalim të fitojmë shpëtimin nëse mendojmë kështu; ai është një *dhuratë* të cilën nuk mund ta përfitojmë, por vetëm t'i përgjigjemi me dashuri dhe mirënjohje të thellë, e cila pastaj do të pasqyrohet në veprat tona. Besimi i vërtetë prodhon vepra si një nën-produkt i paevitueshëm (Jakobi 2:17).

9.2 Gjaku i Jezusit

Shumë shpesh në Dhiatën e Re deklarohet se justifikimi dhe shpëtimi ynë janë përmes gjakut të Jezusit (p.sh. 1 Gjoni 1:7; Ap. 5:9; 12:11; Rom. 5:9). Për të vlerësuar rëndësinë e gjakut të Krishtit, duhet të kuptojmë që është

parim biblik se “në gjak është jeta” (Kp. 17:14). Pa gjakun, një trup nuk mund të jetojë; për rrjedhojë, simbolizon jetën. Kjo shpjegon korrektësinë e fjalëve të Krishtit, “Ju nuk keni asnjë pjesë në jetën, nëse nuk hani trupin e Birit të njeriut, dhe nuk pini gjakun e tij” (Gjn. 6:53).

Rezultati i mëkatit është vdekja (Rom. 6:23), d.m.th. derdhja e gjakut, i cili bart jetën. Për këtë arsye, nga izraelitët pritej që të derdhnin gjak çdo herë që mëkatonin, për t’i kujtuar atyre që mëkati çonte në vdekje. “Sipas ligjit (të Moisiut) gjithçka pastrohet me gjak; pa derdhje gjaku nuk ka falje (të mëkateve - Heb. 9:22). Për shkak të kësaj, mbulimi i vetes me gjethe fiku që bënë Adami dhe Eva nuk ishte i pranueshëm; në vend të tyre, Perëndia vrau një qingj për t’u dhënë lëkura që të mbulonin mëkatet e tyre (Zan. 3:7,21). Në mënyrë të ngjashme, sakrifica e kafshëve që bëri Abeli u pranua, por jo ofrimi që bëri Kaini me perime, sepse ai e vlerësonte këtë parim që pa derdhje gjaku nuk mund të kishte falje dhe afrim të pranueshëm tek Perëndia (Zan. 4:3-5).

Këto incidente tregojnë përpara drejt rëndësisë së gjakut të Krishtit. Kjo ishte veçanërisht e parashikuar në ngjarjet e Pashkës, në të cilën populli i Perëndisë duhej të vinte gjakun e një qingji mbi dyert e tyre për të fituar shpëtimin nga vdekja. Ky gjak tregonte përpara drejt gjakut të Jezusit, me të cilin ne duhet të mbulojmë mëkatet tona. Përpara kohës së Krishtit, sipas ligjit të Perëndisë përmes Moisiut, çifutët duhet të ofronin sakrifica në kafshë për mëkatet e tyre. Megjithatë, kjo derdhje e gjakut të kafshëve duhet t’u kishte mësuar atyre një mësim të madh. Shpagimi i mëkatit është vdekja (Rom. 6:23); nuk ishte e mundur që një qenie njerëzore të mund të vriste një kafshë dhe ta shihte atë të pranohej nga Perëndia në vend të vetes së tij. Kafsha që ai ofroi nuk mund të vlerësonte të mirën apo të keqen; nuk ishte përfaqësuese e plotë e tij: “Gjaku i mëzetërve dhe i cjepërve nuk mund t’i shlyejë mëkatet” (Heb. 10:4).

Prandaj, lind pyetja, Pse duhej që çifutët të sakrifikonin kafshë kur mëkatonin? Pali i përmbledh përgjigjet e ndryshme për këtë pyetje tek Gal. 3:24: “Ligji ishte mbikqyrësi ynë për të na sjellë tek Krishti.” Kafshët që vrisnin ata si shpagim për mëkatet duhet të ishin pa të meta – pa njolla (Dal. 12:5; Kp. 1:3,10 etj.). Këto tregonin përpara drejt Krishtit, “një qingj pa njollë” (1 Pjt. 1:19). Prandaj, gjaku i atyre kafshëve *përfaqësonte* atë të Krishtit. Ato pranoheshin si sakrifica për mëkatet për aq sa tregonin drejt sakrificës së përkryer të Krishtit, të cilën Perëndia e dinte se do ta bënte. Për shkak të kësaj, Perëndia i fali mëkatet e popullit të Tij, të cilët jetonin përpara kohës së Krishtit. Vdekja e tij ishte “për t’i çliruar nga pasojat e mosbindjes së tyre nën besëlidhjen e parë” (Heb. 9:15), d.m.th. ligji i Moisiut (Heb. 8:5-9). Të gjitha sakrificat e ofruara sipas ligjit tregonin

përpara drejt Krishtit, ofrimit të përkryer për mëkatin, i cili “e shleu mëkatin pëmres sakrificës së vetes” (Heb. 9:26; 13:11,12; Rom. 8:3 [V.R.N.] krah. 2 Kor. 5:21).

Në Seksionin 7.3 shpjeguam se si e gjithë Dhiata e Vjetër, veçanërisht Ligji i Moisiut, tregonte përpara drejt Krishtit. Sipas atij ligji, mënyra e afrimit tek Perëndia ishte përmes Priftit të Lartë; ai ishte ndërmjetësi midis Perëndisë dhe njerëzve sipas Besëlidhjes së Vjetër ashtu siç është Krishti sipas Besëlidhjes së Re (Heb. 9:15). “Në bazë të ligjit, kryepriftërinj u bënë njerëzit me të meta; por sipas betimit hyjnor... u bë Biri, i cili e përfundoi punën një herë e përgjithmonë” (Heb. 7:28). Ngaqë vetë ishin mëkatarë, këta njerëz nuk ishin në gjendje të fitonin faljen e vërtetë për njerëzit. Kafshët që sakrifikonin ata nuk ishin vërtet përfaqësuese të mëkatarëve. Ajo që kërkohej ishte një qenie e përkryer njerëzore, një që të ishte në çdo mënyrë përfaqësuese e njeriut mëkatar, por prapëseprapë një që mund të bënte një sakrificë të pranueshme për mëkatarët. Paskëtaj, njerëzit mund të përfitonin duke u shoqëruar me atë sakrificë. Në mënyrë të ngjashme, kërkohej një Kryeprift që të mund të identifikohet me njerëzit mëkatarë për të cilët ndërmjetësoi, duke qenë i tunduar ashtu si ata (Heb. 2:14-18). Jezusi përshtatet me këtë kërkesë në mënyrë të përkryer – “Një i tillë kryeprift që na duhet, që është i shenjtë, nuk ka asgjë të dënueshme dhe pa të meta” (Heb. 7:26). Ai nuk ka nevojë të kushtojë çdo ditë flijim për fajet e tij dhe as nuk ka pse t’i japë llogari vdekjes (Heb. 7:23,27). Nën dritën e kësaj, Shkrimi i Shenjtë komenton mbi Krishtin si priftin tonë: “Për këtë arsye ai mund t’i shpëtojë përgjithmonë të gjithë ata që i afrohen Perëndisë me anë të tij. Ai jeton përgjithmonë për të ndërhyrë për ta tek Perëndia” (Heb. 7:25). Meqenëse ai kishte natyrë njerëzore, Krishti, si Kryeprifti ynë ideal, “ka mëshirë për ata që nuk dinë, dhe për ata që janë jashtë udhës; sepse *edhe ai vetë* kishte dobësitë e veta” (Heb. 5:2). Kjo sjell në mend pohimin në lidhje me Krishtin, “*edhe ai vetë po ashtu*” mori natyrën tonë (Heb. 2:14).

Ashtu si kryepriftërinjtë çifutë ndërmjetësonin vetëm për njerëzit e Perëndisë, izraelitët, edhe Krishti është vetëm prift për izraelitët shpirtërorë – ata që janë pagëzuar në Krisht, duke kuptuar Ungjillin e vërtetë. Ai është “një kryeprift që kryeson *mbarë popullin e Perëndisë*” (Heb. 10:21), i cili përbëhet prej atyre që janë lindur sërish përmes pagëzimit (1 Pjt. 2:2-5), duke pasur shpresën e vërtetë të Ungjillit (Heb. 3:6). Prandaj, vlerësimi i përfitimeve të mrekullueshme të priftërisë së Krishtit duhet të na nxisë të pagëzohemi në të; pa këtë, ai nuk mund të ndërmjetësojë për ne. Duke qenë të pagëzuar në Krisht, ne duhet ta përdorim me zell plotësisht priftërinë e Krishtit; vërtet, kemi përgjegjësi të caktuara në lidhje me këtë

dhe të cilat duhet t'i përmbushim. "Me anë të tij, t'i kushtojmë vazhdimisht flijim gojor Perëndisë" (Heb. 13:15). Plani i Perëndisë për të dhënë Krishtin si priftin tonë ishte që ne ta lartësojmë Atë; prandaj, duhet ta përdorim vazhdimisht aksesin tonë tek Perëndia përmes Krishtit në mënyrë që ta lëvdojmë Atë. Heb. 10:21-25 radhit një numër përgjegjësish që i kemi për shkak të qenies së Krishtit Kryepriifti ynë: "Duke pasur një kryepriift në krye të popullit të Perëndisë:

1. "Le të afrohemi (tek Perëndia) me një zemër të vërtetë dhe me siguri të plotë tek besimi, me zemrat tona të njollosura nga një ndërgjegje e së ligës dhe trupat tanë të larë me ujë të kulluar." Të kuptuarit e priftërisë së Krishtit do të thotë që ne duhet të pagëzohemi në të ("trupat tanë të larë"), dhe nuk duhet të lejojmë kurrë që në mendjet tona të zhvillohet një ndërgjegje e ligë. Nëse besojmë në çlirimin e Krishtit, atëhere, nëpërmjet sakrificës së tij, ne bëhemi një me Perëndinë.

2. "Le të mbajmë me forcë punën e besimit tonë pa u lëkundur." Nuk duhet të devijojmë nga doktrinat e vërteta që kanë sjellë të kuptuarit tonë të priftërisë së Krishtit.

3. "Le të shqyrtojmë njëri-tjetrin për të provokuar dashuri... pa braktisur mbledhjen tonë sëbashku." Duhet të jemi të lidhur me dashur bashkë me të tjerët që kuptojnë priftërinë e Krishtit dhe përfitojnë prej saj; kjo arrihet veçanërisht duke u mbledhur sëbashku për shërbesën e bashkësisë, përmes së cilës kujtojmë sakrificën e Krishtit (shih Seksionin 11.3.5).

Të vlerësuarit e këtyre gjërave duhet të na mbushë me besim të përlulur që ne vërtet do ta arrijmë shpëtimin, nëse pagëzohemi dhe sillemi sipas Krishtit: "*Prandaj le t'i afrohemi guximshëm* fronit të mirësisë, që të mund të marrim mëshirë, dhe të gjejmë ndihmë kur të kemi nevojë për ndihmë" (Heb. 4:16).

9.3 Flijimi për Ne dhe për Vetën e Tij

Është e rëndësishme të kujtojmë se si Jezu Krishti u përfshi në flijimin e vetes. Që ai përfitoi nga flijimi për ne, nuk ka dyshim. Gjatë shqyrtimit të kësaj teme, duhet të mbajmë në mend që megjithëse Jezusi nuk mëkatoi, ai bartte të njëjtën natyrë që është e njëjtë për të gjithë njerëzimin. Ai ndante, me ata që erdhi të shpëtonte, atë vdekshmëri dhe tendencë ndaj mëkatit që është e zakonshme për të gjithë ne. Siç është theksuar në këto mësimë, ai "u tundua në të gjitha drejtimet" ashtu si dhe ne. kemi parë që ai e kapërceu tendencën e vet për mëkat me anë të bindjes së përkryer para Atit të tij, megjithëse kjo e çoi në vdekjen mbi kryq. Megjithatë, edhe ai kishte nevojë

për “çlirim” apo “shpëtim” nga vdekshmëria e tij. Kjo është e paraqitur qartë në profecitë që parathanë vdekjen e tij.

- “Po e dorëzoj shpirtin tim në duart e tua: ti do më shpëtosh *mua*, O Zot, Perëndi i së vërtetës” (Ps. 31:5). Kujtojmë që këto ishin pjesë e fjalëve që u folën tek Jezusi vdiq mbi kryq (Lk. 23:46). Ai e shihte Atin e tij si Shpëtimtarin e tij që do të “çlirojë shpirtin tim nga fuqia e varrit” (Ps. 49:15).
- “Ai do të më thërrasë, Ti je ati im, Perëndia im, dhe shkëmbi i shpëtimit tim. Unë do ta bëj të parëlindurin tim, më të lartë se mbretërit e tokës” (Ps. 89:26-27). Shohim se përmes kësaj lutjeje para Atit të Tij, Perëndia do ta shpëtonte të dilte nga vdekja dhe do ta lartësonte në pozitë të “Të Parëlindurit.”

Nga këto shkrime kujtohem që Jezusi vetë kishte nevojë për çlirim nga vdekshmëria që erdhi mbi të gjithë njerëzit përmes mëkatit të Adamit. Në këtë pikëpamje, ai nuk ishte veçmas atyre të cilët erdhi t’i shpëtonte. Duke folur për vdekjen dhe ringjalljen e tij, Pjetri thotë: “Atë, që u dorëzua nga këshilla dhe paradija e Perëndisë, e keni marrë, dhe e keni kryqëzuar e vlarë përmes të pafeve: Atë që Perëndia e shpëtoi nga pushteti i vdekjes dhe e ringjalli; vdekja nuk mund ta mbante të burgosur” (Veprat 2:23-24). *Nuk ishte e mundur* që varri ta mbante sepse “shpagimi për *mëkat*in është vdekja,” por Jezusi, megjithëse u vu në provë, *kurrë nuk i hapi rrugë këtij tundimi e të mëkatonte*. Prandaj, nuk ishte e mundur që një njeri i pafajshëm të mbetej në varr. Perëndia është i pafajshëm në çdo drejtim. Prandaj, përmes kësaj bindjeje të përkryer, Jezusi theu zinxhirët e mëkatit dhe vdekshmërisë, si për veten e tij ashtu dhe për ata që janë pagëzuar në të. Përmes tij, mëkatet tona falen dhe ne mund të kemi shpresë për ta ndarë atë pavdekshmëri që ka fituar ai.

- “E dimë që Krishti u ngjall nga të vdekurit dhe nuk vdes më; *vdekja nuk ka më asnjë pushtet mbi të*. Sepse vdiq një herë e mirë për mëkatin; tani jeton dhe jeton për Perëndinë” (Rom. 6:9-10). Ai vdiq për shkak të gjërave që vinin nga mëkati, megjithatë u ngrit në jetë sepse nuk ishte e drejtë që një njeri i pamëkat të mbetej në varr.
- “Në kohën e jetës së tij në tokë, ai u lut dhe lypi me ofshame të mëdha e me lot para atij që ishte në gjendje ta shpëtonte nga (greqisht = jashtë nga) vdekja, dhe lutja u plotësua sepse ai kishte frikë; Duke qenë i përkryer, ai u bë autori i shpëtimit të përjetshëm për të gjithë ata që i binden atij” (Heb. 5:7-8). Vetëm përmes lutjeve dhe një jete bindshmërie, Ati i tij e çliroi atë *jashtë nga varri*.

- “Ai hyri në vendin e shenjtë, jo përmes gjakut të cjepve e mëzetërve, por përmes gjakut të tij, duke fituar çlirimin e përjetshëm” (Heb. 9:12). Këtu Pali krahason hyrjen e Kryepriutit në Vendin e Shenjtë me hyrjen e Krishtit në vetë qiellin (v24). Ndërsa prifti hyri me gjakun e flijimeve të caktuara, këto flijime tregonin përpara drejt flijimit të madh të Birit të Perëndisë - vetë atij. Këtu shohim që përmes këtij flijimi sakrifikes ai fitoi “çlirimin e përjetshëm” – ai u çlirua nga zinxhirët e vdekshmërisë. Vdekshmëria, me dobësinë dhe mëkatësinë e vet të brendshme shihet si një padron lidhës, por përmes bindjes së Krishtit deri në vdekjen mbi kryq, ai e ka thyer atë zinxhir si për ashtu dhe për ata që janë në të. Përmes vdekjes së tij ai “shfuqizoi atë që e kishte pushtetin e vdekjes, d.m.th. djallin” (Heb. 2:14). Prandaj, ai fitoi “çlirimin e përjetshëm” për atë barrë që mbajti.
- “Perëndia që na sjell paqe, që ringjalli nga të vdekurit Zotin Jezus, atë që u bë Bariu i madh i deleve, dhe me anë të gjakut të besëlidhjes së përjetshme, Ju ndihmoftë të bëni vepra të mira sipas vullnetit të tij, për të realizuar në ju atë që i pëlqen atij, përmes Jezu Krishtit; Për këtë qoftë lavdëruar përgjithmonë. Amen.” (Heb. 13:20-21). Pali e mbyll këtë letër me faktin që Jezusi u soll nga të vdekurit prej Perëndisë përmes gjakut të besëlidhjes së përjetshme. Atij *gjaku* i referohej në dhomën e sipërme me dishepujt kur thoshte: “Ky është *gjaku im* i besëlidhjes së re, që derdhet si flijim që të falen mëkatet” (Mt. 26:28). Ishte *gjaku* i tij, i cili siç kemi parë më herët, i referohet *jetës* së tij. Ai dha jetën e tij me dëshirë (Mt. 20:28) për të çliruar të gjithë njerëzimin nga zinxhirët e mëkatit dhe vdekshmërisë nëse ata do të besonin e do të vinin tek Perëndia përmes atij.

Në kryqëzimin e tij, ai tregoi publikisht se ajo që kishte bërë gjatë gjithë jetës së tij për të refuzuar tundimet e trupit, tani e shpallte në kryqëzimin e trupit me gjithë dëshirat e pasionet, dhe lejoi me përrulje që vullneti i Perëndisë të bëhej. Pali shkroi: “Duke qenë si njerëzit, ai u përrul, dhe u bind deri në vdekje, madje edhe deri në vdekjen mbi kryq.” Ai iu përrul me dëshirë vullnetit të Perëndisë për këtë. “Prandaj (për shkak të kësaj bindjeje befasuese në gjithçka) Perëndia e lartësoi dhe i dha një emër që është mbi të gjithë emrat e tjerë: që para Jezusit të gjithë të bien në gjuhë – të gjithë ata që janë në qiell, në tokë dhe në nëntokë; Dhe që çdo gjuhë ta pranojnë që Jezu Krishti është Zoti; kështu nderohet edhe Perëndia Ati” (Fil. 2:8-11). Përmes atij akti të fundit bindjeje, Perëndia u glorifikua dhe më pas Ati përmbushi lutjen e Krishtit: “O Atë, tani ma kthe këtë madhësi që kisha

tek ti përpara krijimit të botës” (Gjn. 17:5). Ai u lartësua në pavdekësi, apo në natyrë hyjnore, për t’u ulur në krahun e djathtë të Atit.

Duke zbatuar me besnikëri vullnetin e Atit gjatë gjithë jetë së tij, duke arritur deri tek vdekja mbi kryq, ai hapi rrugën që të gjithë ata që do të pagëzohen në të, të mund të ndajnë atë jetë që tani ka fituar ai. Aty, ai përfundimisht i dha fund asaj natyre të dobët njerëzore, e cila kishte fituar supremaci dhe zotërim në të gjithë të tjerët duke nxjerrë përpara mëkatit. Në mrekulli dhe besim, ne e shohim atë “të gjitha mëkatet tona i mbajti në trupin e tij në kryq, që ne, duke qenë të vdekur nga mëkatet, të mund të fitojmë pafajësinë: me anë të plagëve të tij ne jemi shëruar” (1 Pjt. 2:24). Ne i shohim këto gjëra duke kuptuar që përmes atij akti përfundimtar bindjeje ai “ia hoqi vdekjes pushtetin dhe solli në dritë jetën dhe pavdekësinë përmes ungjillit” (2 Tim. 1:10).

9.4 Jezusi si Përfaqësuesi ynë

Kemi parë që flijimet e kafshëve nuk përfaqësonin plotësisht njerëzit mëkatarë. Megjithatë, Jezusi ishte përfaqësuesi ynë, duke qenë në çdo drejtim “i ngjashëm me vëllezërit e tij” (Heb. 2:17). “Ai shijoi vdekjen për çdo njeri” (Heb. 2:9). Kur kryejmë një mëkat – p.sh. jemi të inatosur – Perëndia mund të na falë “për hir të Krishtit” (Ef. 4:32). Është kështu sepse Perëndia mund të na krahasojë me Krishtin, një njeri ashtu si ne, i cili u tundua të mëkatonte – p.sh. të ishte i inatosur – por që kapërceu çdo tundim. Prandaj, Perëndia mund të na i falë mëkatet – e inatit – sepse ne jemi në Krisht, të mbuluar prej pafajësisë së tij. Qenia e Krishtit përfaqësuesi ynë shërben, për pasojë, si mjete përmes të cilit Perëndia mund të na tregojë mëshirën e Tij, ndërkohë që zbaton parimet e Tij të drejta.

Nëse Jezusi do të kishte qenë Perëndi në vend që të ishte me natyrë njerëzore, atëherë nuk do të mund të kishte qenë përfaqësuesi ynë. Ky është një tjetër shembull ku një ide e gabuar çon në një tjetër. Për shkak të kësaj, teologët kanë zhvilluar shumë mënyra komplekse për të shpjeguar vdekjen e Krishtit. Pikëpamja popullore e Krishtëritit renegat është që mëkatet e njeriut e bënë atë borxhli para Perëndisë, borxh të cilin ai vetë nuk mund ta paguante. Kështu, Krishti shpagoi borxhin e çdo besimtari përmes gjakut të tij, të derdhur mbi kryq. Shumë predikues e kanë shprehur kështu: “Ishte sikur të gjithë ne ishim të rreshtuar para një muri, gati për t’u ekzekutuar nga djalli. Në atë kohë, rendi Jezusi dhe djalli vrau atë në vend që të na vriste ne; kështu, ne tani jemi të lirë.”

Këto teori të stërholluara nuk kanë kurrfarë mbështetjeje biblike. Ekziston kontradikta e dukshme se nëse Krishti vdiq në *vendin* tonë, d.m.th. si zëvendësuesi ynë, atëhere ne nuk kemi nevojë të vdesim. Duke pasur ende natyrë njerëzore, ne duhet të vdesim; shpëtimi nga mëkati dhe vdekja do të zbulohen përfundimisht në ditën e gjykimit (kur të na falet pavdekësia nga mëshira e Perëndisë). Nuk e fituam këtë në kohën kur vdiq Krishti. Bibla mëson që shpëtimi është i mundur përmes vdekjes DHE ringjalljes së Krishtit, jo thjesht përmes vdekjes së tij. Krishti “vdiq për ne” një herë. Teoria e zëvendësimit do të nënkuptonte që ai duhej të vdiste personalisht për secilin prej nesh.

Nëse Krishti pagoi një borxh me gjakun e tij, shpëtimi ynë bëhet diçka që e presim si një të drejtë. Fakti që shpëtimi është dhuratë, sjellë nga mëshira dhe falja e Perëndisë, humbet nëse e kuptojmë sakrificën e Krishtit si pagim të një borxhi. Gjithashtu, ajo sugjeron që një Perëndi i inatosur u qetësua sapo pa gjakun e Jezusit. Megjithatë ajo që sheh Perëndia kur ne pendohe mi, është Biri i Tij si përfaqësuesi ynë; ai që ne përpiqemi fort ta kopjojmë. Shumë himne e këngë kristiane përmbajnë një sasi të pabesueshme doktrine false në këtë fushë. Shumica e doktrinës false futet në mendjet e njerëzve përmes muzikës, dhe jo përmes udhëzimeve racionale biblike. Duhet të jemi gjithmonë syhapur përpara kësaj lloj shplarje truri.

Tragjikisht, fjalët e thjeshta “Krishti vdiq për ne” (Rom. 5:8) janë keqkuptuar shumë rëndë sikur duan të thonë se Krishti vdiq në vendin tonë. Ka disa pika lidhjeje midis Rom. 5 dhe 1 Kor. 15 (p.sh. Rom. 5:12 = 1 Kor. 15:21; Rom. 5:17 = 1 Kor. 15:22). “Krishti vdiq për ne” (Rom. 5:8) përshtatet me “Krishti vdiq për *mëkatet* tona” (1 Kor. 15:3). Vdekja e tij ofroi një mënyrë përmes së cilës ne mund të fitojmë faljen për mëkatet tona; në këtë kuptim shkruhet se “Krishti vdiq për ne.” Fjala “për” nuk është e thënë të ketë kuptimin ‘në vend të;’ Krishti vdiq “për mëkatet tona,” jo ‘në vend të’ tyre. Për shkak të kësaj, Krishti mund “të ndërmjetësojë” për ne (Heb. 7:25) – jo ‘në vend të’ neve. As “për” në Heb. 10:12 dhe Gal. 1:4 nuk do të thotë ‘në vend të.’ Nëse Krishti vdiq ‘në vendin tonë’ atëhere nuk ka nevojë të bartet kryqi i tij, si na kërkon ai. Dhe nuk do të kishte logjikë të pagëzohesh në vdekjen dhe ringjalljen e tij, duke identifikuar me dëshirë veten tonë me atë si përfaqësuesin tonë fitimtar. Ideja e zëvendësimit nënkupton një rrugë të shkurtër për në lartësimin me të, çka thjesht nuk ka vlerë. Kuptimi i tij si përfaqësuesi ynë na përkushton ne ndaj pagëzimit në vdekjen dhe ringjalljen e tij, në jetën e bartjes së kryqit me të, dhe në mënyrë realiste, ndarja e ringjalljes së tij. Ringjallja e tij është jona; ne na u dha shpresa e ringjalljes sepse ne jemi në Krisht, i cili u ngjall (1 Pjt. 1:3). Zoti Jezus jetoi dhe vdiq me natyrën tonë, në të gjithë mosbindjen e saj, me

qëllim që të mund të vinte pranë nesh dhe të na jepte mundësi të identifikoheshim me të. Duke vlerësuar këtë në mënyrë doktrinale, ne i japim atij mundësinë të shohë rezultatin e vuajtjes së shpirtit të tij dhe të jetë i kënaqur.

9.5 Jezusi dhe Ligji i Moisiut

Jezusi ishte flijimi i përkryer për mëkatin dhe Kryepriifti ideal që mund të fitonte vërtet faljen për ne. Prandaj, sistemi i vjetër i flijimit të kafshëve dhe kryepriiftërinjve u braktis pas vdekjes së tij (Heb. 10:5-14). “Kur ndryshohet priiftëria (nga Levitet në Krisht), atëhere do të ndërrohet edhe ligji” (Heb. 7:12). Krishti “u bë priift jo në bazë të ndonjë rregulli në lidhje me prejardhjen e tij (d.m.th. thjesht ngaqë dikush ishte levit, nuk desh të thoshte se mund të ishte priift), por mbi bazën e një jete të pashkatërrueshme,” e cila iu dha për hir të sakrificës së tij të përkryer (Heb. 7:16 V.R.N.). Prandaj, “rregullorja e mëparshme shfuqizohet (d.m.th. ligji i Moisiut) sepse ishte e dobët dhe e padobishme. Sepse ligji nuk çonte në një marrëdhënie të përsosur, ndërsa sjellja e një shprese më të mirë (përmes Krishtit) po” (Heb. 7:18,19 A.V. me V.R.N.).

Nga kjo është e dukshme që ligji i Moisiut u superua ose zëvendësua nga sakrifica e Krishtit. Të besosh në një priiftëri njerëzore apo të ofrosh flijime kafshësh do të thotë se nuk pranohet plotësinë e fitores së Krishtit. Besime të tilla do të thonë që ne nuk e pranohet sakrificën e Krishtit si plotësisht të suksesshme, dhe se ndjejmë që për justifikimin tonë nevojiten veprat, jo vetëm besimi në Krisht. “Askush nuk mund ta marrë pafajësinë përpara Perëndisë me anë të ligjit...sepse, Të drejtët (justifikuarit) do të jetojnë përmes *besimit*” (Gal. 3:11 krahas Hav. 2:4). Përpjekja jonë për të qenë të bindur para shkrimeve të ligjit të Perëndisë, sado e vendosur, do të dështojë dhe nuk do të na japë justifikim; sigurisht, çdo lexues i këtyre fjalëve e di këtë tashmë.

Nëse shikojmë ligjin e Moisiut, duhet të përqijemi ta zbatojmë të gjithë atë. Mosbindja ndaj vetëm një pjese do të thotë se ata që janë nën të (ligjin) janë të dënuar. “Kush mbështetet në veprat e ligjit është i mallkuar: sepse është shkruar, Mallkuar qoftë secili që nuk mban dhe nuk zbaton *gjithçka* që është shkruar në Librin e ligjit” (Gal. 3:10). Dobësia e natyrës sonë njerëzore do të thotë se e kemi të pamundur ta zbatojmë ligjin e Moisiut, por për hir të bindjes së plotë të Krishtit para tij, çlirohemi nga çdo detyrim për ta zbatuar atë. Shpëtimi ynë vjen si pasojë e dhuratës së Perëndisë përmes Krishtit, dhe jo si pasojë e veprave tona me bindje. “Atë që ligji nuk mund ta arrijë, sepse

ne njerëzit jemi të dobët, atë e arriti Perëndia, duke dërguar Birin e vet atje ku shfaqet mëkati, në trupin e njeriut, që ta mposhtë atje tërë pushtetin e mëkatit” (Rom. 8:3). Kështu “Krishti na çliroi nga mallkimi që sjell ligji duke e paguar me jetën e vet” (Gal. 3:13).

Për shkak të kësaj, nuk na kërkohet më të zbatojmë ndonjë prej urdhëresave të ligjit të Moisiut. Pamë në Studimin 3.4 që Besëlidhja e Re në Krisht zëvendësoi Besëlidhjen e Vjetër të ligjit të Moisiut (Heb. 8:13). Përmes vdekjes së tij, Krishti e anuloi “dokumentin që na padiste me kërkesat e tij, që ishte kundër nesh (për shkak të paaftësisë sonë për ta zbatuar plotësisht ligjin), dhe e largoi atë, duke e gozhduar në kryq...Prandaj, askush të mos ju japë urdhra në çështje ushqimi e pijeje, në çështje festash, hëne të re ose të shtunash: sepse këto janë vetëm hija e gjërave që do të vijnë; realiteti është Krishti” (Col. 2:14-17 A.V. me V.R.N.). Kjo është mjaft e qartë – për shkak të vdekjes së Krishtit mbi kryq, ligji u hoq “nga udha” që t’i rezistojmë çfarëdo presioni që na vihet për të zbatuar pjesë të tij, p.sh. festat e të shtunat. Si pjesa tjetër e ligjit, qëllimi i këtyre gjërave ishte të tregonin përpara drejt Krishtit. Pas vdekjes së tij, rëndësia e tyre tipike u përmbush dhe prandaj nuk kishte më nevojë për t’i zbatuar.

Kisha e hershme kristiane e shekullit të parë ishte nën presion të vazhdueshëm nga çifutët ortodoksë për të zbatuar pjesë të ligjit. Në të gjithë Dhiatën e Re, ka paralajmërim të vazhdueshëm për t’u rezistuar këtyre sugjerimeve. Përballë të gjitha këtyre, është e jashtëzakonshme që sot ka disa degë që mbrojnë bindjen e pjesshme ndaj ligjit. Më parë kemi treguar që çdo përpjekje për të fituar shpëtimin përmes bindjes ndaj ligjit duhet të synojë zbatimin e *tërë* ligjit, përndryshe dënohemi për mosbindje ndaj tij (Gal. 3:10).

Ka një element brenda natyrës njerëzore që anon nga ideja e justifikimit përmes veprave; na pëlqen të ndjejmë se *po bëjmë* diçka drejt shpëtimit tonë. Për këtë arsye, detyrimet e të dhjetave, varja e kryqit, recitimi i lutjeve të përcaktuara, lutja në një pozicion të caktuar, etj., janë të gjitha pjesë popullore të shumicës së feve, kristiane e të tjera. Shpëtimi *vetëm* përmes besimit në Krisht është një doktrinë thujse unike për krishtërimin e bazuar mbi Biblën.

Paralajmërimet kundër zbatimit të ndonjë pjese të Ligjit të Moisiut për të fituar shpëtimin, janë të përhapura në të gjithë Dhiatën e Re. Disa mësonin se kristianët duhen rrethprerë sipas ligjit të Moisiut, “dhe të zbatojnë ligjin.” Jakobi e dënonte prerazi këtë ide në emër të besimtarëve të vërtetë: “*ne* nuk kemi dhënë urdhëresë të tillë” (Veprat 15:24). Pjetri i përshkroi ata që mësonin nevojën për bindje ndaj ligjit si “një zgjedhë mbi qafën e dishepujve, të cilën as etërit tanë e as ne nuk ishim në gjendje ta mbanim.

Por ne besojmë se përmes mëshirës së Zotit Jezu Krisht (jo përmes veprave të tyre të bindjes ndaj ligjit) ne do të shpëtohemi” (Veprat 15:10,11). Nën frymëzim, Pali flet po kaq fort, duke theksuar herë pas here të njëjtën pikë. “Askush nuk merr pafajësinë përmes veprave të ligjit, por përmes besimit në Jezu Krisht...që të justifikohemi përmes besimit në Krisht, dhe jo përmes punërave të ligjit; sepse asnjë njeri nuk do të justifikohet përmes punërave të ligjit...askush nuk justifikohet nga ligji...përmes (Krishtit) të gjithë që besojnë shpëtohen nga çdo gjë, nga të cilat nuk shpëtoheshit dot përmes ligjit të Moisiut” (Gal. 2:16; 3:11; Veprat 13:39).

Fakti që shumica e praktikave të krishtërit popullor janë të bazuara mbi elementë të Ligjit të Moisiut, është shenjë e sigurt e shtrembërimit prej tij – pavarësisht nga mësimi i qartë dhe i vështirë i shqyrtuar më sipër që kristianët nuk duhet ta zbatojnë këtë ligj, meqenëse është përmbushur në Krishtin (Mt. 5:17). Tani do të marrim në konsideratë shenjat më të dukshme që tregojnë se Ligji i Moisiut është baza e praktikës aktuale kristiane.

PRIFTËRINJTË

Kishat katolike dhe anglikane përdorin haptas një sistem priftërie njerëzore. Katolikët romakë e shohin Papën si ekuivalentin e tyre të kryepriftit çifut. Ka “një ndërmjetës midis Perëndisë dhe njerëzve, njeriu Jezu Krisht” (1 Tim. 2:5). Prandaj, është e pamundur që Papa apo priftërinjtë të jenë ndërmjetësit tanë siç ishin priftërinjtë nën Besëlidhjen e Vjetër. Krishti është tani Kryeprifti ynë në qiell, që i ofron Perëndisë lutjet tona.

Nuk ka absolutisht asnjë fakt biblik që autoriteti i zotëruar nga kryepleqtë të cilëve u qe dhuruar shpirti në shekullin e parë – p.sh. Pjetri – u përcoll në brezat pasardhës apo tek Papa në veçanti. Edhe nëse pranohet mundësia e kësaj, nuk ka asnjë mënyrë për të provuar që Papa dhe priftërinjtë personalisht janë ata mbi të cilët ka rënë manteli shpirtëror i kryepleqve të shekullit të parë.

Dhuratat e shpirtit janë marrë mbrapsht, të gjithë besimtarët kanë akses të barabartë ndaj Shpirtit-Fjalës në Bibël (shih Studimet 2.2 dhe 2.4). Prandaj, ata janë të gjithë vëllezër, ku askush nuk ka një pozitë më të lartësuar shpirtërisht se një tjetër. Vërtet, *të gjithë* besimtarët e vërtetë janë anëtarë të një priftërie të re për shkak të pagëzimit të tyre në Krisht, në kuptimin që hedhin dritën e Perëndisë në një botë të errët (1 Pjt. 2:9). Prandaj, ata do të bëhen mbretër-priftërinjtë e Mbretërisë, kur ajo të vendoset mbi tokë kur të kthehet Krishti (Ap. 5:10).

Praktika katolike për t’i thirrur priftërinjtë e tyre ‘At’ë (‘Papë’ do të thotë gjithashtu ‘at’) është në kundërshtim të drejtpërdrejtë me fjalët e qarta të

Krishtit “Këtu në tokë mos quani asnjërin atë; sepse keni vetëm një At, atë që është në qiell” (Mt. 23:9). Vërtet, Jezusi paralajmëronte kundër dhënies ndokujt atë lloj respekti shpirtëror që kërkohet nga priftërinjtë modernë: “Mos lejoni t’ju quajnë Rabi (mësues): sepse vetëm një udhëheqës keni, Krishtin; dhe ju të gjithë jeni vëllezër” (Mt. 23:8).

Rrobot e komplikuar të veshura nga priftërinjtë, peshkopët e kishtarë të tjerë e kanë bazën në veshjen e veçantë veshur nga priftërinjtë dhe kryepriifti sipas Moisiut. Kjo veshje tregonte përpara drejt karakterit të përkryer të Krishtit dhe, si i gjithë ligji, qëllimi i saj është përmbushur. Vërtet të thyhet zemra që veshjet që synonin të adhuroar lavdinë e Krishtit, tani përdoret për të çuar përpara lavdinë e njerëzve që i veshin ato – disa prej të cilëve pranojnë që nuk e pranojnë ringjalljen e Krishtit madje as ekzistencën e Perëndisë.

Idea katolike se Maria është një priftëreshë është rëndshëm e gabuar. Kërkesat tona janë në emër të *Krishtit*, jo të Marisë (Gjn. 14:13,14; 15:16; 16:23-26). Krishti është Kryepriifti ynë i vetëm, jo Maria. Jezusi e qortoi Marinë kur ajo u përpoq ta detyronte të bënte gjëra për të tjerët (Gjn. 2:2-4). Perëndia, jo Maria, i sjell njerëzit tek Krishti (Gjn. 6:44).

E DHJETA

Edhe kjo ishte pjesë e Ligjit të Moisiut (Regj. 18:21), sipas të cilës, çifutët duhej t’i dhuronin një të dhjetën e të korrave të tyre fisit priftëror të levitëve. Meqenëse nuk ka priftëri njerëzore, nuk mund të jetë më e detyrueshme që t’i paguhet ndonjë e dhjetë ndonjë kryekishtari. Përsëri, një ide e rreme (në këtë rast në lidhje me priftërinjtë) ka çuar në një tjetër (d.m.th. e dhjeta). Vetë Perëndia nuk ka *nevojë* që t’i japim ne, meqenëse të gjitha i përkasin Atij (Ps. 50:8-13). Veçse po i kthejmë Perëndisë atë që Ai na ka dhënë neve (1 An. 29:14). Është e pamundur që ne të fitojmë shpëtim si rezultat i dhuratave tona materiale, p.sh. nga pikëpamja financiare. Si mirënjohje për dhuratën e madhe të Perëndisë për ne, duhet jo vetëm t’i ofrojmë një të dhjetën e parave tona, por gjithë jetët tona. Pali dha një shembull të kësaj, duke praktikuar vërtet atë që predikonte: “Kushtojani Perëndisë veten tuaj si një flijim të gjallë, të shenjtë, që do t’i pëlqejë; ky është një shërbim i arsyeshëm i juaji” (Rom. 12:1).

MISHI

Ligji çifut kategorizonte mishra të caktuara si të papastrat – një praktikë e adoptuar nga disa sekte sot, veçanërisht në lidhje me mishin e derrit. Ngaqë Krishti e shfuqizoi ligjin në kryq, “Mos lejoni askënd t’ju japë urdhra në çështje të mishit apo të pijes” (Kol. 2:14-16). Kështu, urdhrat sipas Moisiut

në lidhje me këto gjëra janë hequr tej, meqenëse tani ka ardhur Krishti. Përpara drejt atij tregonin edhe ushqimet ‘e pastra.’ Jezusi shpjegoi qartë që asgjë që ha një njeri nuk mund ta ndotë atë shpirtërisht; ajo që e bën këtë është ajo që del nga zemra e tij (Mk. 7:15-23). “Kështu, Jezusi deklaroi se të gjitha ushqimet janë të pastra” (Mk. 7:19 V.R.N.). Pjetrit iu dha i njëjti mësim (Veprat 10:14,15), ashtu si dhe Pali: “E di dhe jam i bindur nga Zoti Jezus që asgjë nuk është e papastër në vetvete” (Rom. 14:14). Më parë, Pali kishte arsyetuar se refuzimi i mishrave të caktuara ishte shenjë dobësie shpirtërore (Rom. 14:2). Qëndrimi ynë ndaj mishit “nuk kushtëzon marrëdhënien me Perëndinë” (1 Kor. 8:8). Më inkriminuese nga të tëra është paralajmërimi që kristianët renegatë do të jepnin si mësim që “të mos hajë ushqime të veçanta, që i ka krijuar Perëndia dhe që merren nga ata që falënderojnë Perëndinë dhe besojnë dhe dinë të vërtetën” (1 Tim. 4:3).

9.6 Dita e Shtatë (Shabat)

Një prej vazhdimësive më të përhapura midis praktikave aktuale kristiane dhe ligjit të Moisiut shihet në idenë që duhet të zbatohet ditën e Shtatë. Disa grupe pretendojnë se duhet të zbatohet të Shtatën Çifute saktësisht siç përcaktohet në ligj; shumë të tjerë ndjejnë që kristianët duhet të kenë një ditë të veçantë të javës në të cilën të adhurojnë, të cilën shpesh e përkufizojnë si të Dielën. Gjëja e parë që duhet sqaruar është që e Shtata ishte dita e fundit e javës, kur Perëndia pushoi pas gjashtë ditëve të krijimit (Dal. 20:10,11). Meqenëse e diela është dita e parë e javës, do të ishte e pasaktë nëse mbahej si e Shtata. Shabati ishte specifikisht “një shenjë midis meje (Perëndisë) dhe atyre (izraelitëve), që të mund të dinin se unë jam Zoti që i veçoj ata si popullin tim të shenjtë” (Jhz. 20:12). Si e tillë, ajo s’është synuar kurrë të jetë detyruese për joçifutët. “Zoti ju ka dhënë *juve* [jo gjithë njerëzimit] shabatin (Dal. 16:29); “ti [Perëndia] u bërë të njohur atyre [izraelitëve] Shabatin tënd të Shenjtë” (Neh. 9:14).

Një herë Jezusi komentoi një problem teologjik: një fëmijë mashkull duhej rrethprerë në ditën e tetë të jetës së tij. Nëse kjo binte në Shabat, atëhere duhej punuar. Atëhere, cili ligj duhej zbatuar, rrethprerja apo Shabati? Jezusi u përgjigj se duhej nderuar rrethprerja, sepse kjo vinte prej Abrahamit, ndërsa ligji i Shabatit kishte ardhur më pas, nga Moisiu: “Moisiu ju dha rrethprerjen [jo sepse është nga Moisiu, por nga etërit – *d.m.th.* *Abrahami*]....”. Nëse ligji i rrethprerjes kishte përparësi para atij të Shabatit, si mund të argumentohet nga disa se ligji i Shabatit është detyrues ndërsa ai

i rrethprerjes nuk është? Rrethprerja ishte shenja e besëlidhjes me Abrahamin, ndërsa Shabati ishte shenja e ligjit të Moisiut (Dal. 31:17), dhe Jezusi gjykoi se besëlidhja me Abrahamin ishte më e rëndësishme. I njëjti argument përdoret nga Pali, kur ai arsyeton se besëlidhja e re që iu dha Abrahamit [e cila nuk përfshinte ndonjë urdhër mbi Shabatin] është diçka që nuk mund t'i shtosh apo ta çanulosh. Ai pyet, për rrjedhojë, pse ndodhi që “ligji ... u shtua” (Gal. 3:15,19)? Ai përgjigjet se ligji u shtua, përkohësisht, duke parë që besëlidhjes së re nuk mund t'i shtosh, për t'u mësuar njerëzve mbi mëkatet dhe t'i drejtosh drejt kuptimit të Krishtit, pasardhësit të premtuar të Abrahamit. Tani që Krishti ka ardhur, nuk jemi më nën ligjin. Prandaj, përmes vdekjes së Krishtit mbi kryq, Ligji i Moisiut u hoq tutje, dhe nuk ka nevojë të zbatohet Shabati apo, vërtet, ndonjë festival, p.sh., dita e vdekjes së Krishtit (Kol. 2:14-17). Kristianët e hershëm që iu kthyen zbatimit të disa pjesëve të ligjit të Moisiut, p.sh. Shabatit, përshkruhen nga Pali sikur kthehen tek “parimet e dobëta e të varfra (V.R.N.), doni t'u nënshtroni përsëri atyre. Ju kremtoni ditë (p.sh. Shabati), dhe muaj, kohëra, e vite (p.sh. festivalet çifute). Kam frikë se do të shkojnë kot të gjitha mundimet e mia për ju” (Gal. 4:9-11). Ky është serioziteti i përpjekjes për ta zbatuar Shabatin si një mjet për shpëtim. Është e qartë që zbatimi i Shabatit nuk ka lidhje me shpëtimin: “Për njërin, ditët e veçanta kanë kuptim të veçantë (d.m.th. për domethënien shpirtërore): kurse për tjetrin të gjitha ditët janë njësoj. Secili le të veprojë me bindjen e vet. Kush çmon një ditë (A.V. fundfaqe), bën kështu për nder të Zotit; dhe kush nuk çmon një ditë, nuk e çmon për Zotin” (Rom. 14:5,6).

Për shkak të kësaj, është e kuptueshme që nuk lexojmë ndokund që besimtarët e hershëm të kenë zbatuar Shabatin. Vërtet, është regjistruar se ata takoheshin “ditën e parë të javës,” d.m.th. të dielën: “Ditën e parë të javës, të dielën, dishepujt u mbledhën për të festuar darkën e Zotit...” (Veprat 20:7). Fakti që kjo ishte një praktikë e përhapur gjerësisht, tregohet nga Pali kur këshillon besimtarët në Korint që të mbledhin “ditën e parë të javës” (1 Kor. 16:2), d.m.th. në takimet e tyre të rregullta atë ditë. Të gjithë besimtarët përshkruhen të jenë priftërinj (1 Pjt. 2:9) – të cilët përjashtoheshin nga zbatimi i Shabatit (Mt. 12:5).

Nëse do ta zbatojmë Shabatin, këtë duhet ta bëjmë siç duhet; më parë kemi treguar se është fatale nëse ligji i Moisiut zbatohet pjesërisht, sepse kjo çon në dënimin tonë (Gal. 3:10; Jakobi 2:10). Shpëtimi vjen përmes ligjit të Krishtit jo atij të Moisiut. Izraelitët nuk lejoheshin të punonin ditën e Shabatit: “Kushdo që punon atë ditë do të dënohet me vdekje.” Atyre gjithashtu iu dha urdhri: “Ditën e Shabatit nuk do të ndizni zjarr në shtëpitë tuaja”, prandaj, atë ditë u ndalohej të përgatishnin ushqim (Dal. 35:2,3;

16:23). Dikush që po mblidhte shkopinj ditën e Shabatit, supozohet për të ndezur një zjarr, u ndëshkua me vdekje për këtë (Regj. 15:32-36). Ato sekte që mësojnë se zbatimi i Shabatit është i detyrueshëm për anëtarët e tyre, duhet t'i ndëshkojnë me vdekje kur ata e shkelin detyrimin. Atë ditë nuk duhet të ketë gatim për ushqim apo përdorim zjarri në ndonjë formë – p.sh. ngarja e makinave, përdorimi i sistemeve të ngrohjes, etj. Çifutët ortodoksë sot japin një shembull për llojin e sjelljes që pritet ditën e Shabatit: ata mbeten brenda shtëpisë gjithë ditën me përjashtim të arsyeve fetare, dhe nuk janë personalisht të përfshirë në gatim, transport, etj. Shumica e atyre 'kristianëve' që pretendojnë të zbatojnë Shabatit janë shumë larg kësaj.

- Shpesh thuhet se zbatimi i Shabatit ishte një prej dhjetë urdhëresave që iu dhanë Moisiut, dhe që, pas shfuqizimit të Ligjit të Moisiut, prapëseprapë mbetet detyrimi që të gjitha dhjetë urdhëresat të zbatohen. Adventistët e Ditës së Shtatë bëjnë një dallim midis një 'ligji moral' të dhjetë urdhëresave, "ligjit të Perëndisë," dhe një të ashtuquajturit 'ligj ceremonial,' "ligjit të Moisiut" i cili sipas tyre u hoq nga Krishti. Ky dallim nuk mësohet në Shkrimin e Shenjtë. Bibla i përdor termat "ligj i Moisiut" dhe "ligj i Perëndisë" në vend të njëri-tjetrit (Regj. 31:21; Josh. 23:6; 2 An. 31:3). Më parë demonstruam që Besëlidhja e Vjetër i referohet Ligjit të Moisiut, i cili u zëvendësua në kryq nga Besëlidhja e Re. Perëndia "Perëndia ju deklaroi juve (izraelitëve) besëlidhjen e tij, të cilën ju (izraelitët) urdhëroi ta zbatonit, dhjetë urdhëresat; dhe i shkroi mbi dy rrasa guri" (Br. 4:13). Edhe njëherë, duhet vërejtur që kjo besëlidhje, bazuar mbi dhjetë urdhëresat, u bë midis Perëndisë dhe izraelitëve, jo joçifutëve të ditëve të sotme.
- Moisiu u ngjiti në Malin Horev për të marrë rrasat e gurit mbi të cilat Perëndia kishte shkruar dhjetë urdhëresat. Më pas, në lidhje me këtë, Moisiu komentoi, "Zoti, Perëndia ynë ka bërë një besëlidhje me ne në Horev" (Br. 5:2), d.m.th. përmes atyre dhjetë urdhëresave.
- Në këtë kohë, Perëndia "shkroi mbi rrasat e gurit fjalët e besëlidhjes, dhjetë urdhëresat" (Dal. 34:28). Kjo besëlidhje përfshin hollësi për të ashtuquajturin 'ligj ceremonial' (Dal. 34:27). Nëse pohojmë se zbatimi i besëlidhjes së bërë në dhjetë urdhëresat është i nevojshëm, atëherë duhet të zbatojmë çdo hollësi të të gjithë ligjit, meqenëse do të ishte pjesë e së njëjtës besëlidhje. Është e dukshme që kjo është e pamundur të bëhet.

- “Në arkë ishin vetëm dy rrasat e gurit që Moisiu i kishte futur aty në Horev...arak, ku ndodhet besëlidhja e Zotit” (1 Mbr. 8:9,21). Ato rrasa, mbi të cilat ishin dhjetë urdhëresat, ishin besëlidhja.
- Heb. 9:4 flet për “rrasat e besëlidhjes.” Dhjetë urdhëresat ishin shkruar në rrasa guri, të cilat përbënin “besëlidhjen (e vjetër).”
- Pali i referohet kësaj besëlidhjeje si “e shkruar dhe gdhendur në gurë,” d.m.th. në rrasat e gurit. Ai i quan “shërbimi që sillte vdekjen...shërbimi u sillte njerëzve dënimin...ajo që është kalimtare” (2 Kor. 3:7-11). Besëlidhja e shoqëruar me dhjetë urdhëresat sigurisht që nuk mund të japë ndonjë shpresë për shpëtim.
- Krishti e shfuqizoi “dokumentin e urdhërave që ishte kundër nesh” (Kol. 2:14) mbi kryq. Kjo aludon për dorëshkrimin e Perëndisë të dhjetë urdhëresave mbi rrasat e gurit. Po kështu, Pali flet për “ligjin...duke qenë të vdekur...sipas mënyrës së vjetër të *shkrimit*” (Rom. 7:6), ndoshta duke i referuar shkrimit të dhjetë urdhëresave që ishin shkruar në rrasat e gurit.
- Vetëm një prej dhjetë urdhëresave quhet “ligji” në Rom. 7:8: “Në ligj...thuhej, Mos lakmo.” Vargjet pararendëse në Rom. 7:1-7 theksojnë se si “ligji” është shfuqizuar nga vdekja e Krishtit; prandaj “ligji” i përfshin dhjetë urdhëresat.

E gjithë kjo bën të qartë që Besëlidhja e Vjetër dhe “ligji” përfshinin dhjetë urdhëresat. Pasi u shfuqizuan nga Besëlidhja e Re, dhjetë urdhëresat janë hequr. Megjithatë, nëntë prej dhjetë urdhëresave janë riafirmuar, të paktën në shpirt, në Dhiatën e Re. Numrat 3, 5, 6, 7, 8 dhe 9 mund të gjenden tek 1 Tim. 1 vetëm, dhe numrat 1, 2 dhe 10 tek 1 Kor. 5. Por, urdhëresa e katërt, në lidhje me Shabatin, nuk përsëritet kurrë në Dhiatën e Re, për të qenë detyruese për ne.

Lista e mëposhtme e pasazheve dokumenton më tej se si nëntë të tjerat janë riafirmuar në Dhiatën e Re.

E 1ra	Ef. 4:6; 1 Gjn. 5:21; Mt. 4:10
E 2ta	1 Kor. 10:14; Rom. 1:25
E 3ta	Jakobi 5:12; Mt. 5:34, 35
E 5ta	Ef. 6:1, 2; Kol. 3:20
E 6ta	1 Gjn. 3:15; Mt. 5:21, 22
E 7ta	Heb. 13:4; Mt. 5:27, 28
E 8ta	Rom. 2:21; Ef. 4:28
E 9ta	Kol. 3:9; Ef. 4:25; 2 Tim. 3:3

E 10ta Ef. 5:3; Kol. 3:5

Zoti Jezus i fton ata që e ndjekin Atë të pranojnë “pushimin” që jep Ai (Mt. 11:28). Ai përdor një fjalë greqisht që përdoret në Septuagint, përkthimi greqisht i Dhiatës së Vjetër, për pushimin e Shabatit. Jezusi po ofronte një jetë Shabati, pushimi nga besimi në veprat tona (krah. Heb. 4:3,10). Prandaj, nuk duhet ta zbatojmë Shabatit për një ditë në javë, por në fakt të jetojmë të gjithë jetët tona në shpirtin e Shabatit.

Digression 28: Kryqëzimi

Besohet gjerësisht në krishtërim që Jezu Krishti u vra në një kryq. Megjithatë, fjala greqisht ‘stauros’, e cila normalisht përkthehet ‘kryq’ në biblat anglisht, në fakt do të thotë shtyllë. Vërtet, simboli i kryqëzimit ndoshta ka origjinë pagane. Është korrekte që Krishti vdiq me duart e krahët ngritur mbi kokë, dhe jo shtrirë në formë kryqëzimi, meqenëse duart e ngritura janë simbol i konfirmimit të premtimeve të Perëndisë (Jhz. 20:5,6,15; 36:7; 47:14), si dhe i lutjes së dendur (Vaj. 2:19; 1 Tim. 2:8; 2 An. 6:12,13; Ps. 28:2), në të cilat Krishti qe përfshirë kur ishte mbi kryq (Heb. 5:7). Ai tha se ashtu si nepërka e bronxtë u ngjit mbi një *shtyllë* kur izraelitët ishin në shkretëtirë, ashtu dhe ai do të ngrihej publikisht në kohën e vdekjes së tij; kështu, ai e përqasi ‘kryqin’ me *shtyllën* (Gjn. 3:14). Kisha Katolike Romake i ka dhënë domethënie të madhe mistike kryqit. Kjo nuk ka asfare mbështetje biblike; kjo ka sjellë që kryqëzimi të bëhet një hajmali, një shenjë fizike se Perëndia është me ne. Njerëzit kanë arritur të ndjejnë që duke mbajtur një kryq apo duke bërë shpesh shenjën e kryqit, Perëndia do të jetë me ta. Kjo është hajmalizëm i pastër; fuqia e vërtetë e kryqit është përmes përqasjes sonë me vdekjen e Krishtit përmes besimit dhe pagëzimit, dhe jo përmes duke kujtuar formën fizike të kryqit. Sigurisht, është më e lehtë të bëhet kjo e dyta sesa e para. Nuk mungojnë faktet që kryqi ishte një simbol pagan i njohur dhe i përdorur shumë kohë përpara kohës së Krishtit. Edhe ai është një pjesë tjetër e paganizmit, si pemët e krishtlindjeve, të cilat janë përzier me ‘krishtërimin’ nga kishat devijuese.

Digression 29: A u lind Jezusi më 25 Dhjetor?

Një tjetër gabim madhor i krishtërimin është ai në lidhje me ditëlindjen e Jezusit. Barinjtë po flinin në fushë me batëtitë në kohën e lindjes së Krishtit (Lk. 2:8); ata nuk do ta kishin bërë këtë në kohën e krishtlindjeve, gjatë dimrit. *The Jerusalem Post* dhe gazeta të tjera izraelite shpesh kanë kryetituj në dhjetor që tregojnë se si dëborë ka paralizuar Jeruzalemin.

25 dhjetori në origjinë ishte data e festës pagane në Europën para-kristiane. Veprat e Apostujve regjistrojnë se si kristianët e vërtetë u persekutuan keq nga paganët për hir të besimeve të tyre. Herë pas here apostujt paralajmëronin se për shkak të kësaj, kristianët do të adoptonin besime pagane, për t'u dhënë atyre mundësi që ta bënin fenë e tyre më të pranueshme për paganët rreth tyre (p.sh. Veprat 20:30; 1 Gjn. 2:18; 2 Sel. 2:3; 2 Pjt. 2:1-3). Adoptimi i 25 dhjetorit si një festë kristiane është një shembull parësor i kësaj. Pemët e krishtlindjeve, veshtullat, etj. mund të datojnë të gjitha tek ritet pagane të praktikuara më 25 dhjetor. Nga kjo rrjedh që kristianët e vërtetë nuk duhet të festojnë ditëlindjen e Krishtit më 25 dhjetor. Në praktikë, besimtarët e vërtetë, do të përdorin festat më publike, p.sh. krishtlindjet, për të ndarë miqësinë sëbashku kudo të jetë e mundur.

STUDIMI 9: Pyetje

1. Pse ishte vdekja e Jezusit, jo e ndonjë njeriu tjetër, e nevojshme për shpëtimin tonë?
2. Pse nuk mjaftonin flijimet e kafshëve të Ligjit të Moisiut për të larguar mëkatet?
3. A ishte Jezusi përfaqësuesi ynë apo zëvendësuesi ynë kur vdiq?
4. Cili prej pohimeve të mëposhtme është i vërtetë?
 - a) Krishti vdiq në vend që të vdisnim ne
 - b) Krishti na përfaqësoi ne, në mënyrë që Perëndia të na falë për hir të tij nëse besojmë dhe pendohe mi
 - c) Krishti ishte si ne por nuk na përfaqëson ne
 - d) Vdekja e Krishtit do të thoshte se Perëndia nuk do të quajë më ndonjë qenie njerëzore fajtor për mëkat
5. A përfitoi Jezusi nga vdekja e vet?
6. Kur Krishti vdiq mbi kryq:
 - a) Ai superoi urdhrat e vegjël të Ligjit të Moisiut por jo dhjetë urdhëresat
 - b) Ai superoi të gjithë Ligjin e Moisiut duke përfshirë dhjetë urdhëresat
 - c) Ai superoi Ligjin e Moisiut me përjashtim të festave çifute
 - d) Nuk pati ndikim mbi pozitën e Ligjit të Moisiut
7. A duhet ta zbatojmë Shabatit tani?
8. Jepni arsye për përgjigjen tuaj për pyetjen 7.

Digresion 31: Niveli i Dijeve që kërkohen para Pagëzimit

Shumë lexues duhet të jenë ballafaquar me ata të kishave 'Ungjillore' që arsyetojnë se doktrina nuk ka rëndësi për shpëtimin dhe se një pranim i thjeshtë gojoj se 'Unë besoj që Jezu Krishti është Biri i Perëndisë' është parakushti bazë për shpëtimin. Në sipërfaqe, kjo tingëllon e mundshme për shkak të mënyrës se si janë regjistruar konvertimet në Veprat, ndërkohë që i bëjnë thirrje ideve të 'dashurisë' dhe 'tolerancës' që janë fryma e epokës sonë. Ky studim bën një analizë më të hollësishme të rëndësisë së doktrinës.

PSE KAQ SHPEJT?

Nuk mund të ketë dyshim që një lexim i shpejt i Veprat jep përshtypjen që shumë pagëzime u kryen vetëm me pak udhëzime mbi bazat e Ungjillit, dhe vetëm me një pranim të shkurtër të besimit në Krishtin si Biri i Perëndisë. Thjesht thënia e fjalëve ‘Unë besoj në Krishtin’ është e qartë që nuk ka kuptim si rrugë për shpëtimin – dhe shumica e ‘Ungjillorëve’ do pranonin që duhet të ketë më shumë dijeni apo vlerësim në mendjen e personit që i thotë ato fjalë me kusht që ato të kenë kuptim. Ky argument nuk duhet të jetë i vështirë për t’u provuar. Është e vështirë të argumentosh që pasazhet që regjistrojnë rrefimin e besimit në Krisht si Biri i Perëndisë, provojnë që mjafton vetëm që ato fjalë të thuhën. Është thuajse logjikë e pranuar nga të gjithë që thjesht thënia e një fjalie të shkurtër, pavarësisht nga ndjenjat dhe besimet e personit, nuk mund ta vendosë dikë në rrugën e shpëtimin. Pikat e mëposhtme mund të jenë të dobishme në shpjegimin e këtyre konvertimeve dukshëm të shpejta:

- Shkrimi në Veprat – si në pjesën më të madhe të Shkrimit të Shenjtë – është shumë i kondensuar nga nevoja. Do të ishte ushtrim interesant të lexoje me zë të lartë disa prej fjalimeve të regjistruara në Veprat dhe të vëshkohësh kohën që kërkon kjo; është mjaft e sigurtë që në realitet, duhet të kenë marrë shumë më tepër kohë, duke përfshirë edhe shumë që nuk është regjistruar. Ca shembuj:
- Mbrojtja e Palit në Jeruzalem kërkon katër minuta për t’u lexuar (Veprat 22); ajo përpara Feliksit do një minutë; përpara Agripës do katër minuta; Fjalimi i Pjetrit në Rrëshajat kërkon vetëm katër minuta; ajo përpara Kornelit kërkon tri minuta; fjalimi i Zotit pasi ushqen 5,000 (Gjn. 6) kërkon gjashtë minuta; shërbesa në mal 18 minuta. Predikimi i Pjetrit në Veprat 3:12-26 kërkon afro dy minuta për t’u lexuar me zë të lartë; por në realitet, ishte e bollshme që të dilte lajmi mbi përmbajtjen e predikimit të tij, të çohet tek “priftërinjtë, kreu i faltores dhe tek saducenjtë” dhe që këta të vinin në vendngjarje (Veprat 4:1). Përmbajtja e predikimit të Palit në Efes është regjistruar shkurt; më vonë, njerëzit e qytetit u ankuan se mësimi i tij kish qenë “që ata të mos ishin perëndi, të cilët bëhen me duar” (Veprat 19:26); por kjo pjesë e mesazhit të tij nuk është regjistruar në përmbledhjen e shkurtër që përshkruan predikimin e tij “gjërat në lidhje me Mbretërinë e Perëndisë...fjala e Zotit Jezus” (Veprat 19:8,10). Por, predikimi i Mbretërisë së *Perëndisë* dhe lartësia e Zotit Jezus të lartësuar kërkonte që njerëzve t’u mësohej të hiqnin dorë nga bestytnitë e rreme të njerëzve. Prandaj, Deklarata Kristadelfiane e Besimit i përmban të dyja

propozimet pozitive të doktrinës, si dhe doktrinat që, për pasojë, duhen refuzuar nëse këto besohen vërtet.

- Kështu, fakti që nuk përmenden ‘udhëzime’ më të gjata për kandidatët për pagëzim nuk përbën provë që ai nuk ndodhi. Një argument nga heshtja është shumë i dyshimtë në këtë rast.
- Ka arsye për të besuar që pagëzimi në masë i çifutëve në Jeruzalem në fillimin e krishtërit ishte një rast i veçantë. Kur Pjetri u bën thirrje që të pendohen e të pagëzohen, turmat, tha ai, tashmë e kishin dëgjuar predikimin e Jezusit (Veprat 3:20). Ai po u kërkonte të pranonin në praktikë një mesazh të e kishin dëgjuar më parë. Nuk ka fakte që metoda të tilla dhe pagëzime në masë të jenë kryer më vonë në shekullin e parë. Nëse shndërrimet do të kishin vazhduar në atë ritëm atëherë i gjithë Jeruzalemi do të kishte qenë kristian brenda pak vjetësh. Fakti që këta njerëz ishin çifutë do të nënkuptonte që ata kishin dije të mjaftë për Dhiatën e Vjetër dhe për mënyrat e Perëndisë. Thellësia e Letrës Hebrenjve dhe letrat e Pjetrit tregojnë që lexuesit e tyre ishin në gjendje të kuptonin aludimet e shumta që bëjnë ato për Dhiatën e Vjetër. Është për t’u habitur që në Hebrenjve, Melkicedeku përshkruhet si qumështi i fjalës. Shkruesit i vjen keq që nuk mund të hynte në më shumë hollësi mbi të për shkak të papjekurisë së tyre shpirtërore (Heb. 5:11,12). Kjo tregon nivelin e dijes së tyre në kohën e shndërrimit të tyre, ndërkohë që Pali i akuzon se nuk janë rritur shumë qysh nga ajo kohë. Duket se ato letra ishin shkruar së pari për klerikët e Jeruzalemit, shumica e të cilëve do të qenë pagëzuar në ditët e para të regjistruara në fillim të Veprat.
- Shpresojmë të tregojmë që predikimi i emrit të Krishtit dhe pranimi i tij siç përshkruhet në Veprat ishte ekuivalent me të kuptuarit e një masë shumë të hollësishme doktrine.
- Nga 1 Kor. 1:17 do të dukej se Pali (dhe apostuj të tjerë?) operonin me një ekip të efektshëm udhëzuesish dhe pagëzuesish, me qëllim që ai të harxhonte një kohë relativisht të shkurtër në çdo vend ku predikonte.
- 1 Kor. 15:24-28 paraqet informacionin tonë të vetëm solid mbi ngjarjet në fund të Mijëvjeçarit, megjithatë për këto fakte Pali flet si të përbënin dije të zakonshme bazë midis lexuesve të tij. Ndërkohë që doktrinat bazë të besimit janë regjistruar të gjitha në Bibël, ka gjasa që të jetë dhënë më shumë mësim për to në kishën e hershme dhe në dëshminë e tyre para Ungjillit në krahasim me sa është regjistruar.

EMRI I JEZUSIT

Emri i Perëndisë përfshin shumë mësim për Atë dhe mënyrat e Tij – Emrat dhe titujt e Perëndisë shprehin karakterin dhe qëllimin e Tij. Emri i Jezu Krishtit gjithashtu nuk është thjesht një thirrje, por një pohim më i thellë i doktrinës.

Besimi në emrin e Jezusit paralelizohet me të qenit i pagëzuar (Gjn. 3:5,18,23). Gal. 3:26,27 e bën besimin në Krisht të lidhur pandashmërisht me pagëzimin në të: “Ju jeni të gjithë fëmijë të Perëndisë përmes besimit në Krishtin Jezus. SEPSE ju u bashkuat me Krishtin, kur u pagëzuat në emrin e Krishtit.” Shembuj të mëtejshëm të kësaj lidhjeje midis besimit dhe pagëzimit gjendet në Veprat 19:4; 10:42 kra. 48; 2:37,38; Lk. 24:47. Apoloni “e njihte” pagëzimin e Gjonit (Veprat 18:25), çka tregon se pagëzimi nuk është thjesht një akt, por ka të bëjë me njohjen e një mësimi të caktuar.

“Filipi... u predikoi Krishtin atyre” (Veprat 8:5) tingëllon sikur ai thjesht u tha ‘Besoni në Jezusin;’ por “Krishti” përkufizohet në Veprat 8:12: “Kur e besuan Filipin tek u predikonte gjërat në lidhje me Mbretërinë e Perëndisë dhe emrin e Jezu Krishtit, ata u pagëzuan.” Vëreni që “gjërat” është në shumës; jo thjesht një pohim i shkurtër mbi Krishtin; dhe të ‘predikosh Krishtin’ përfshinte edhe doktrinën e pagëzimit. Gjn. 6:40 na tregon se është vullneti i Perëndisë “që e shohin (kuptojnë) Birin dhe besojnë në të, të kenë jetën e përjetshme;” ndërsa më pas Jezusi thotë që “Kush është gati ta dëgjojë Perëndinë, do të njohë doktrinën” (Gjn. 7:17). Kështu, njohja e doktrinës është e njëjtë me ‘shikimin’ e Birit. Fjalët e Krishtit “I ndoqet udhëzimet e mia, dhe u treguat besnikë ndaj emrit tim” (Ap. 3:8) gjithashtu tregojnë që fjala e Krishtit është paralel me emrin e tij. Pra, besimi në Krisht është një proces i të kuptuarit pasuar nga bindja, dhe jo një pranim i shpejtë gojor ‘Unë besoj në Krishtin.’ Kjo mbështetet nga Gjn. 6:35: “Kush vjen tek unë, nuk do të ketë më uri; dhe kush beson në mua, nuk do të ketë më etje”, e cila e barazon besimin në Krisht me *ardhjen* tek ai – çka tregon që besimi është një proces.

Prandaj predikimi i “Krishtit” kërkonte një seri doktrinash. “Krishti” është dhënë për doktrinën mbi Atë (2 Kor. 11:4; Gal. 1:8; 2 Gjn. 7-12), dhe për gjërat e Mbretërisë së Tij (Mk. 10:29 kra. Lk. 18:29 dhe Mt. 16:28 kra. Mk. 9:1). Lk. 9:11 përshkruan Krishtin tek predikon Ungjillin e Mbretërisë së Perëndisë (kra. Mt. 4:23), ndërsa rrëfimi paralel në Mk. 6:34 i referohet Atij tek u mëson atyre “shumë gjëra.” Ungjilli përfshin “shumë gjëra” – jo thjesht një pohim të shkurtër mbi Krishtin që mund të bëhet brenda një minute. Kështu, lexojmë fraza si, “Kur ia kishin predikuar ungjillin qytetit, u

kishin mësuar shumë njerëzve” (Veprat 14:21), duke barazuar predikimin dhe mësimin. Një gjuhë e tillë do të ishte e panevojshme, nëse Ungjilli ishte veçse pak pohime të thjeshta. Predikimi i Palit në Berea bëri që njerëzit t’i kërkonin Shkrimet e Shenjta çdo ditë (kopjet e Dhiatës së Vjetër në sinagoga?) për të kontrolluar atë që u kishte mësuar Pali (Veprat 17:11). Ungjilli i mësuar nga Pali, për rrjedhojë, bazohej tërësisht mbi Dhiatën e Vjetër, dhe njerëzit besonin vetëm pas procesit të studimit të Biblës pasi dëgjonin Palin – “Prandaj shumë prej tyre besuan” (Veprat 17:12). Kur merremi me njerëz që kanë pak dije për Biblën dhe shpesh nuk e shfletojnë çdo ditë pas një diskutimi, nuk është për t’u çuditur që koha e udhëzimit është shumë më e gjatë se në shekullin e parë. “Kush beson që Jezusi është Krishti, është fëmijë i Perëndisë” (1 Gjn. 5:1) korrespondon qartas me vargje si “Me vullnetin e Tij të mirë, na e dha jetën e re nëpërmjet fjalës të së vërtetës” (Jakobi 1:18), “Ju u bëtë njerëz të rilindur...përmes fjalës së Perëndisë... fjala që ju predikohet përmes Ungjillit” (1 Pet. 1:23,25). Kjo tregon se për të besuar që Krishti është Biri i Perëndisë është esenca e faktit që dikush e ka kuptuar Ungjillin që gjendet në fjalën e Perëndisë.

MBRETI I MBRETËRISË

Theksi mbi ‘besimin në Krisht’ bëhet më kuptimplotë sapo vlerësohet që titulli ‘Krisht’ mund të lexohet si fjalë sinonime me Mbretërinë e Krishtit në disa pasazhe. Kështu, Zoti ynë u tha farisejve se nuk kishin pse silleshin rrotull duke kërkuar që të vinte Krishti, sepse ai tashmë qëndronte në mes tyre. Këtë e shpreh në fjalët “...Mbretëria e Perëndisë është (A.V. anëfaqe) mes jush” (Lk. 17:21), çka tregon “Mbretërinë” të barazohet me mbretin e Mbretërisë. Predikimi i Gjonit se Mbretëria e Perëndisë ishte pranë, për rrjedhojë, i referohet sinjalizimit të tij për shfaqjen e Krishtit. Frazja “Mbretëria e qiellit” në Mt. 3:2 jepet nga Diaglott “Madhëria mbretërore e qiejve,” d.m.th. Krishti. Po kështu, në Lk. 17:21 “Mbretëria e Perëndisë” është “Madhështia Mbretërore e Perëndisë” në personin e Jezu Krishtit. Guri që goditi imazhin e Nebukadnecarit përfaqëson Mbretërinë e Perëndisë (Dan. 2:44); është guri/Mbretëria ajo që “do të bëjë copa dhe do shkatërrojë të gjitha këto mbretëri (të tjera,” duke treguar që guri është Mbretëria kur e copëton imazhin, por edhe pas shkatërrimit. Në të njëjtën linjë, historia e Jehezkelit për vreshtin përshkruan një bisk “të butë” nga maja që këputet dhe mbillet, që të bëhet një pemë e madhe, “dhe në të do të banojnë gjithfarë zogjsh” (Jhz. 17:22,23). Kjo duhet t’i referohet Krishtit, “bima e butë” e Jesh. 53:2; megjithatë, ka lidhje të dukshme me historinë e Tij për farën e mustardës, në të cilën Mbretëria e perëndisë përqsaset me një farë të vogël që u rrit e u bë një pemë e madhe, nën të cilën erdhën të jetonin të gjitha llojet e

zogjve. Kjo lidhje midis fjalës së Mbretërisë dhe Vetë Jezusit personalisht tregon se Ai e shihte Vetën si fjalën e gjallë të Mbretërisë. Në dritën e kësaj, është e kuptueshme që ‘të besuarit në Krisht’ dhe të besuarit në Ungjillin e plotë të Mbretërisë së Perëndisë janë identike.

ÇFARË ËSHTË UNGJILLI?

Tani vijmë të diskutojmë më me hollësi se çfarë quhej doktrinë esenciale mes besimtarëve të shekullit të parë. Duhet pranuar që në kohët e Dhiatës së Re ekzistonte një trup doktrine që ishte pak a shumë ekuivalent me “Deklaratën e Besimit” tonën. Një tjetër faktor i rëndësishëm për t’u mbajtur mend ishte ekzistenca e vëllezërve me dhuntinë e profecisë – ‘para-tregimit’ të zbulësës së drejtpërdrejtë nga Perëndia nën frymëzimin. Ka arsye për të besuar që me kalimin e kohës disa prej këtyre deklarimeve të frymëzuara iu shtuan këtij trupi doktrine.

NJË TRUP DOKTRINE

Pali mund të thoshte që ata në klerikët e Romës të paktën “dëgjuan nga zemra atë formë doktrine që iu mësua” (Rom. 6:17) përpara pagëzimit të tyre. Fjala greqisht për “formë” është e njëjta e përkthyer si “shembull” dhe “model” – si t’i referohej një trupi mësimesh që ishte kopjuar tjetërkund. Referimi nga Pali ndaj kësaj tregon rëndësinë të kuptuarit të një trupi të përcaktuar mësimesh përpara pagëzimit, dhe gjithashtu se nuk ishin thjesht ca pohime të shkurtra që përmendeshin përpara pagëzimit. Disa brenda tyre do të kishin “një formë përshpirtshmërie, por do ta mohonin fuqinë e saj” (2 Tim. 3:5), ndoshta duke sugjeruar që ata mund të zbatonin doktrinat bazë të besimit, por nuk do të njihnin fuqinë reale të së Vërtetës në jetët e tyre të përditshme. Pali mund t’u kujtonte Galatasve se “Jezu Krishti u ishte paraqitur fare qartë, ishte kryqëzuar mes jush” (Gal. 3:1). Fjala greqisht për “paraqitur” do të thotë fjalëpërfjalë ‘përshkruar në fjalë të shkruara,’ sikur udhëzimi fillestar i Galatasve ishte bërë përmes ndonjë forme të shkruar apo udhëzuesi.

Kur përkufizonte doktrinën e ringjalljes, Pali mund të thoshte: “Unë ju kam përcjellë...atë që kam marrë edhe vetë, si vdiq Krishti...” (1 Kor. 15:3), duke treguar se i qe bërë një zbulësë mbi këto gjëra, dhe ua kishte përcjellë atyre si doktrinë që duhej pranuar si themelore. 2 Pjt. 2:21,22 përshtatet mjaft mirë këtu: “Për ta do të kishte qenë më mirë që të mos e kishin njohur udhën e drejtë sesa...t’i kthenin shpinën mësimit të shenjtë që u qe përcjellë. Por...derri që u la (në pagëzim) (i është kthyer) zhgërryhet përsëri.” Këtu “udha” dhe “mësimi i shenjtë” që iu “përcollën” atyre shoqërohen me larjen e pagëzimit, sikur udha dhe mësimi të njiheshin përpara pagëzimit. Kemi

treguar që përpara pagëzimit nuk ishte vetëm një mësim që duhej kuptuar; prandaj “mësimi” në njëjës mund të sugjerojë se ekzistonte një trup mësimesh të përcaktuara shumë qartë që duhej kuptuar përpara pagëzimit. Ka disa pasazhe që flasin mbi ‘marrjen’ e mësimet mbi doktrinën dhe “Ungjillin.”: Gal. 1:9,12; Fil. 4:9; Kol. 2:6; 1 Sel. 1:6; 2:13; 4:1. Kjo konfirmon që ‘ungjilli’ përbëhet nga një trup specifik mësimesh që ishin ‘marrë’ fillimisht nga apostujt dhe pastaj nga ata që mësonin.

“BESIMI/FEJA”

Juda flet gjithashtu për “besimin e transmetuar një herë (e mirë) popullit të Perëndisë” (Juda 3). Kështu, “Besimi” është paralel me “formën e doktrinës” që iu përcoll përpara pagëzimit dhe do të kishte qenë një tjetër frazë në fjalorin e shekullit të parë që i referohej këtij trupi doktrine. Këshilla e Palit për të “qëndruar në shpresën që besuam” (Heb. 10:23) mund t’i aludojë punës së tyre në publik për besimin në “fenë” përpara pagëzimit. Ruajtja e “fjalës besnike” (Tit. 1:9) do t’i referohej së pari mbështetjes së kësaj “Deklarate besimi” që u ishte mësuar në fillim. “Besimi i përbashkët” (Tit. 1:4) tregon se si ky trup doktrine ndahej nga të gjithë besimtarët; kishte vetëm “një fe” (Ef. 4:5). “Feja” dhe emri i Krishtit lidhen në Veprat 3:16. Kemi parë që emri i Krishtit është një tjetër emër për të njëjtin mësim që përmbahet në “fenë.” Si nga ana praktike (1 Tim. 6:10) ashtu dhe nga doktrina (1 Tim. 4:1) Pali paralajmëronte se disa do “të largoheshin nga feja.” Faza e parë në atë largim do të ishte thënia se “feja” ishte e pamundur të përkufizohej.

ÇËSHTJE TË PRAKTIKËS

Çështjet e praktikës ishin gjithashtu pjesë e këtij trupi doktrine. “Besimi në Krisht” përfshinte arsyetimin mbi “pafajësinë, vetëpërmbytjen dhe gjykimin e ardhshëm” (Veprat 24:24,25). Pali flet në udhëzimet mbi thyerjen e bukës siç bën për mësimin në lidhje me Paul ringjalljen: “Kam marrë nga Zoti atë që ju përcjell edhe juve” (1 Cor. 11:23). Duket se ka pasur një grup i këtyre gjërave praktike, të cilat Pali më pas i zgjeroi për të përfshirë mësimin mbi vendin e motrave në bashkësi: “Ju...u bindeni udhëzimeve që ju përcolla. Por duhet t’ju them që...kreu i gruas është burri...” (1 Kor. 11:2,3). Kjo tregon që shpjegimi i këtyre gjërave duhet të ndodhë përpara pagëzimit, dhe se ishin pjesë e trupit të doktrinës mbi të cilin këmbëngulej në shekullin e parë. Fjala greqisht për “udhëzime” përkthehet edhe “traditë” në 2 Sel. 3:6 dhe 2:15: “Shmanguni...nga çdo bashkëbesimtar që jeton...jo sipas udhëzimit që mori nga ne...rrini të patundur, dhe mbështetuni tek traditat që ju janë mësuar, qoftë me fjalë (të frymëzuar, profetike), qoftë me letër.”

Këto tregojnë rëndësinë jetësore të qëndrimit pas këtij trupi mësimesh, dhe nevojës për t'u ndarë nga ata që nuk i binden atij: “Duke ruajtur fjalën besnike (një tjetër përshkrim i po këtij korpusi doktrine) siç i është dhënë, që të jetë në gjendje edhe të shtyjë e të bindë kundërshtarët” (Tit. 1:9).

E dimë që kishte “profetë falsë” në bashkësitë e hershme, që pretendonin të kishin zbulësia nga Perëndia mbi doktrinën që u duhej shtuar trupit të pranuar të mësimëve. Kështu Pali thekson se çfarë janë “fjalët besnike” të zbulësës së frymëzuar të doktrinës (Tit. 1:9; 3:8; 2 Tim. 2:11; 1 Tim. 4:9), të cilat “janë të denja për t'u pranuar plotësisht” (1 Tim. 1:15; 4:9) – d.m.th. në trupin e doktrinës që përmban “fenë.” Prandaj Gjoni paralajmëronte që të mos “Besojnë... çdo shpirt” që pretendonte frymëzim (1 Gjn. 4:1).

HOLLËSI SPECIFIKE

Të mëposhtmet janë shembuj të qartë ku mësoheshin doktrina përveç ‘besimit në Krisht’ si pjesë e Ungjillit që duhej kuptuar përpara pagëzimit:

- “Perëndia do t’i gjykojë sekretet e njerëzve përmes Jezu Krishtit sipas Ungjillit tim” (d.m.th. atij që predikoi Pali; Rom. 2:16). Doktrina e karrikes së gjykimit dhe përgjegjësisë konsiderohet të jetë një ‘parim i parë’ – shih edhe Veprat 24:25; Heb. 6:1,2.
- Ideja që rrethprerja ishte e nevojshme për shpëtim u përshkrua nga Pali si “një tjetër Ungjill” (Gal. 1:6). Pra, dijenia se nuk duhet ta zbatojmë Ligjin e Moisiut, p.sh. Shabatin, është pjesë e të kuptuarit të Ungjillit të Vërtetë.
- “Ungjilli i Mbretërisë” nuk është vetëm mbi Krishtin por edhe mbi Mbretërinë e tij të ardhshme; Jesh. 52:7 (krah. Rom. 10:15) përshkruan predikuesin e Ungjillit që flet për kohën kur Cionit mund t’i thuhet “Perëndia yt mbretëron” – d.m.th. në Mbretërinë.
- Të kuptuarit e duhur të ‘pikave më të holla’ të natyrës së Krishtit ishte një çështje shoqërimi (2 Gjn. 7-10); për shkak të kësaj Ungjilli përfshinte “gjërat,” shumë, mbi Krishtin (Veprat 8:12). Edhe një herë, thjesht të thënit se besojmë në Krisht nuk mjafton.
- Rëndësia e premtimeve mbi Mbretërinë është pjesë jetësore e Ungjillit; përmes premtimeve Ungjilli iu predikua Abrahamit (Gal. 3:8) dhe Izraelitëve (Heb. 4:2). Kështu, Pali fliste mbi predikimin e tij mbi premtimet që iu bënë Davidit si “fjala e këtij shpëtimit” (Veprat 13:23,26). Prandaj, ato ishin pjesë jetësore e mesazhit të shpëtimit. Kështu, ai thotë: “Ne ju deklarojmë (e njëjta fjalë e përkthyer ‘predikojmë’ tjetërkund) juve lajmin e mirë (Ungjillin) të premtimit që iu bë edhe të parëve” (Veprat 13:32 V.R.). Në mënyrë të ngjashme,

Rom. 1:1-4: “Ungjilli i Perëndisë...në lidhje me Birin e Tij Jezu Krisht, i cili është pasardhës i Davidit”.

Për të kuptuar premtimet kërkohet një dije e caktuar mbi historinë e Izraelit. Një studim i predikimit të Palit në Antioki në Veprat 13 e tregon atë tek përvijon historinë e Izraelit duke vënë theks të veçantë mbi premtimet, duke theksuar se si u përmbushën në Jezusin. Kështu, predikimi i tij bazohet mbi historinë e Izraelit, dhe ishte ajo që mund të quanim ‘shpjegues,’ duke u mbyllur me një paralajmërim të pasojave në kohën e gjykimit për mospërgjigjen ndaj fjalës që ai predikonte (Veprat 13:40,41). Edhe përmbajtja e predikimit tonë duhet të jetë e ngjashme.

PËRFUNDIME

Sado ta theksojmë rëndësinë e kësaj, prapë nuk është tepër. “Kujdes për jetën tënde dhe për mësimin (doktrinën); kontrolloji vazhdimisht: sepse duke bërë këtë ke shpëtuar veten, por edhe ata që të dëgjojnë ty” (1 Tim. 4:13-16). Është e qartë që listat e doktrinave të rëndësishme si ato të dhëna në Shtojcën 1 të këtij libri nuk janë të frymëzuara, por sipas mendimit të autorit, duket një përmbledhje e ndershme e shumë çështjeve specifike të përmendura në pasazhet e Biblës që flasin për gjëra që janë pjesë e “besimit,” “traditave,” etj. Shpresojmë që ky studim të ketë treguar që ka nevojë patjetër për trup doktrine që të gjithë e pranojmë dhe nuk hezitojmë të afirmojmë besnikërinë tonë ndaj tij. Përmbajtja e këtij trupi doktrine duhet të përmbajë udhëzimet tona për kandidatët për pagëzim, dhe do të ishte e ndershme para tyre që të kontrollohej përmes diskutimit përpara zhytjes së tyre nëse e kuptojnë plotësisht atë që u është mësuar. Shpesh besimtarët nxiteshin të mbaheshin pas “besimit” (fesë) në kohë problemesh. “Themeli i Perëndisë është i sigurtë.” Familjariteti ynë me parimet e para, me mënyrën se si qëllimi i plotë i Perëndisë qëndron, duhet të jetë një nxitje në vetvete për ne. Vetëm me anë të predikimit apo ristudimit të rregullt të këtyre gjërave, ky përfitim dhe ndjenjë e thellë sigurie do të jenë tonat, në mënyrë që ashtu si Pali në orën e tij të errësirës dhe vetmisë, të mund të themi: “Përshkova gjithë largësinë, qëndrova besnik deri në fund...E di kujt i besova, dhe jam i bindur se atë që më besoi (jetën tonë, gjithçka tonën) deri në atë ditë” (2 Tim. 4:7; 1:12).

PRANIMI I ZOTIT JEZUS

“Nëse ti pranon me gojë Zotin Jezus, dhe beson në zemrën tënde se Perëndia e ka ringjallur nga të vdekurit, atëhere do të shpëtohesh” (Rom. 10:9).

Duhen vënë në dukje sa më poshtë:

- Për të kuptuar ringjalljen e Krishtit duhet njohuri për mësimet e Biblës mbi ferrin dhe natyrën e njeriut.
- Rom. 10:8,9 duken se janë paralel me v.13: “Kushdo që do ta thërrasë (mbi vete, greqisht) emrin e Zotit do të shpëtohet.” Pali përshkruhet si në pagëzim dhe thërret mbi vete emrin e Zotit (Veprat 22:16); vetëm pagëzimi na jep hyrjen në emrin e Zotit (Mt. 28:19).
- Pasi është theksuar rëndësia e pagëzimit disa kapituj më parë në Romakëve 6, është e pamundur që Pali tani të predikonte se ishte i panevojshëm për shpëtimin në kapitullin 10.
- Rom. 10:9 ka përpara v.6-8: “Nuk ka nevojë të pyesësh, Kush do ngjitet në qiell...Kush do të zbresë në botën e të vdekurve?...por çfarë thotë? Fjala është pranë teje, në gojën tënde, në zemrën tënde: është fjala për lajmin e besimit që ne predikojmë”. Prandaj “Fjala e besimit” ishte ajo që duhej pranuar, dhe është paralel me “Zotin Jezus” në v.9. Kemi parë se “besimi” përshkruan të gjithë trupin e doktrinës që përbënte Ungjillin. Pali citon nga Br. 30:11-14: “Ligji që po ju jap sot...nuk është në qiell, as në skaj të botës (‘në thellësi’)...por fjala është shumë pranë jush.” Ai duket se e interpreton “fjala...ky ligj” si t’i referohet Krishtit. Në të njëjtën mënyrë që nëse izraelitët e mbanin fjalën do të bekoheshin (Br. 30:16), ndaj nëse izraelitët e rinj e besonin fjalën mbi Krishtin, edhe ata do të shpëtoheshin. Pranimi i Krishtit me gojë, për rrjedhojë, i korrespondon qenies dakort me këtë mësim mbi Krishtin. “Nëse e dëgjoni zërin e Zotit” (Br. 30:10) përputhet me Rom. 10:9: “Nëse pranon me gojën tënde Zotin Jezus.” Përsëri, kjo paralele tregon që “Zoti Jezus” është një titull që përmbledh mësimin bazë të fjalës së Perëndisë.

Digresion 32: Hajduti mbi Kryq

Hajduti i tha Jezusit:

“Zot, kujtomë mua kur të vish në Mbretërinë tënde. Dhe Jezusi i tha, Unë po të them, Sot do të jesh me mua në parajsë” (Lk. 23:42,43).

Këto vargje kuptohen sikur pagëzimi nuk është thelbësor për shpëtimin dhe se pas vdekjes shkojmë menjëherë në qiell. Përveç të gjitha fakteve të tjera që provojnë të kundërtën, një lexim më nga afër i pasazhit zbulon si më poshtë:

1. Udhëzimi për t'u pagëzuar në vdekjen dhe ringjalljen e Krishtit u dha *pas* ringjalljes së Krishtit (Mk. 16:15,16). Hajduti vazhdonte të jetonte sipas Ligjit të Moisiut kur Krishti i foli.
2. Pagëzimi i vërtetë është në vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit. Duke parë që kur Jezusi i foli hajdutit, asnjë nga ato të dyja nuk kishte ngjarë, pagëzimi në Krisht nuk ishte i mundur.
3. Pagëzimi simbolizon vdekjen tonë me Krishtin (Rom. 6:3-5). Hajduti ishte i vetmi person që e bëri këtë në kuptimin e vërtetë të fjalës.
4. Është shumë e mundur që hajduti të ishte një prej atyre që qenë pagëzuar nga Gjon Pagëzori. Shumë prej të shndërruarve të tij kishin qenë më parë personazhe të pandershëm (Mt. 21:32). Të thuash që hajduti nuk ishte pagëzuar do të thotë të argumentosh duke përdorur atë që nuk thuhet; dhe kjo si zor të jetë parim i shëndoshë me të cilin të shfajësojmë veten për moszbatimin e udhëzimit për t'u pagëzuar. Po kështu, pasazhi nuk flet mbi fjalët 'shpirt' dhe 'qiell.'
5. Hajduti i kërkoi Jezusit ta kujtonte për mirë, kur Jezusi të kthehej "në" Mbretërinë e tij (R.S.V.). Prandaj, hajduti ishte në dijeni të Ungjillit të Mbretërisë së Perëndisë që Jezusi kishte predikuar (Mt. 4:23). Ai e dinte që do të kishte një ditë gjykimi kur të vendosej ajo Mbretëri dhe prandaj i kërkoi Jezusit, të cilin e dinte se do ngrihej nga të vdekurit për të qenë në fund gjykatës në atë ditë, që ta kujtonte për mirë. Sigurisht hajduti nuk ishte i paditur; ai pranoi që shpëtimi në ditën e ringjalljes dhe gjykimin do të shpallej nga goja e Krishtit.
6. Jezusi u përgjigj që hajduti *do të* ishte me të në "Parajsë." Kjo fjalë greqisht i referohet gjithmonë një situatë ideale mbi *tokë*. Përdoret në lidhje me Kopshtin e Edenit, të rivendosur, që do të shihet në Mbretërinë e ardhshme të Perëndisë mbi tokë (Ap. 2:7). Gjatë Mbretërisë së Perëndisë, bota do t'i kthehet kushteve të ngjashme me të parajsës të Kopshtit të Edenit (Jesh. 51:3; Jhz. 36:35), për shkak të largimit të mallkimit (Ap. 22:3). Dhiata e Vjetër greqisht (Septuaginti) përdor të njëjtën fjalë greqisht për "parajsë" në lidhje me një situatë idilike mbi tokë në Koh. 2:5; Neh. 2:8; Kk 4:13; Zan. 13:10. 'Parajsa' është shoqëruar me qiellin përmes përdorimit në letërsi si p.sh. 'Parajsa e Humbur' e Miltonit. Premtimi i Jezusit për një vend për hajdutin në parajsë ishte në përgjigje të dëshirës së tij për të qenë në Mbretërinë e Krishtit. Në Studimin 5 kemi treguar se Mbretëria do të jetë në tokë; prandaj, edhe 'parajsa' do të jetë aty.
7. Mënyra se si vargu 43 përkthehet normalisht e bën të duket sikur Krishti dhe hajduti do të ishin sëbashku pikërisht atë ditë në 'parajsë.' Por, është e qartë, që Mbretëria nuk ishte vendosur ende mbi tokë. Ata nuk shkuan në Mbretërinë atë ditë. Jezusi shkoi në varr (Veprat 2:32); siç kishte

profetizuar, ai ishte “tri ditë e tri netë në zemër të tokës” (Mt. 12:40 krahas 16:21) pas vdekjes së tij mbi kryq. Edhe pas ringjalljes ai tha: “Mos më prek; sepse *ende nuk* jam ngjitur tek Ati im” (Gjn. 20:17). Kështu, Jezusi nuk shkoi në qiell ditën që vdiq.

Megjithatë, Jezusi duke se i premton hajdutin “*Sot* do të jesh me mua në parajsë.” Përgjigja për këtë kontradiktë të dukshme duhet gjetur në faktin që në tekstet origjinale hebraisht dhe greqisht të Biblës, nuk ka shenja pikësimi apo gërma të mëdha. Është e mundur të rivihen shenjat e pikësimit që të lexojmë: “Jezusi i tha atij, unë të them ty *sot*, ti *do të* jesh me mua në parajsë” (Lk. 23:43). Në fakt, Përkthimi i Rotherham e vendos presjen pas “*sot*.” Kjo përputhet për mrekulli me kontekstin. Hajduti po i kërkonte Jezusit ta mbante mend për mirë ditën e gjykimit; ai ishte i ndërgjegjshëm që ishte i përgjegjshëm dhe do të ishte atje. Por Jezusi i dha sigurinë e mrekullueshme – ‘Mund të ta them pikërisht *tani!* Nuk ke pse pret deri atëhere për të zbuluar vendimin tim mbi ty – ti *do të* jesh me mua në Mbretërinë!’.

8. Nga pikat e vërejtura më lart, është e mundur të radhiten doktrinat që hajduti ishte e qartë se i kuptonte:

- Mbretëria e Perëndisë
- Ardhja e dytë e Krishtit
- Ringjallja dhe gjykimi
- Përgjegjshmëria
- Shpëtimi përmes besimit në Krisht
- Ringjallja e Krishtit
- Përsosmëria e Krishtit (“ky njeri s’ka bërë asgjë gabim”)
- Nevoja për të ndjekur Krishtin (e quajti “Zot”)
- Mëkatshmëria e njeriut (“Po vuajmë atë që meritojmë”)

Prandaj është pa vend që ky person të përdoret si shfajësim për të menduar që kushdo mund të shpëtohet nëse tregon sadopak interes në kristianizëm; duhet të ketë një llojë baze doktrinale që ai e kishte. Pa këtë, ai nuk do të kishte qenë në gjendje të ngrihej në atë nivel besimi siç bëri. Krishti nuk i bëri ndonjë ofertë shpëtimi hajdutin tjetër, qëndrimi i të cilit ishte, “Nëse ti je Krishti, shpëto veten dhe neve.” Ky ishte njeriu që thotë, ‘Nëse ky muhabeti i Jezusit ka gjë brenda, nuk e kuptoj pse unë s’duhet të fitoj diçka.’ Ngaqë i mungonte të kuptuarit doktrinor ai nuk ishte në gjendje të gjente shpëtimin e vërtetë në fund të ditëve të tij, pavarësisht nga interesi i tij kalimtar në Krishtin.

Digresion 33: Një Shërbim Pagëzimi për Shembull

Për të dhënë një ide se si mund të kryhet siç duhet një pagëzim, më poshtë vijon një rrëfim i një shërbimi pagëzimi kryer nga kristadelfët në Hartlepool të Anglisë një pasdite të shtune në nëntor 1990. Megjithatë, duhet vërejtur që pagëzimi është në themel një zhytje në ujë që pason një pendim të vërtetë dhe besim në Ungjill. ‘Shërbimi’ është një diçka ekstra opsionale për t’i dhënë një ndjenjë të përshtatshme rëndësie rastit. Radha e procedurave ishte si më poshtë:

- Lutja e hapjes
- Leximi i Romakëve kapitulli 6
- Fjalë e shkurtër mbi pagëzimin (dhënë më poshtë; emrat e vërtetë janë ndryshuar)
- Lutja
- Zhytja e personit në një pishinë
- Lutje

FJALA E PAGËZIMIT

Nuk mund të ketë dyshim që sot është dita më e rëndësishme në jetën e Dejvit; pas pak çastesh ai do të futet në ujë dhe do të ngrihet plotësisht “në Krisht,” një pasardhës i Abrahamit, të cilit i bëhen premtimet e lavdishme që përbëjnë Ungjillin.

Thjeshtësia ekstreme e këtij akti mund të mashtrrojë, megjithatë Dejvi dhe të gjithë ne këtu besojmë plotësisht se kjo zhytje në ujë do ta shoqërizojë atë me vdekjen dhe ringjalljen e Jezusit, siç kemi lexuar në Romakëve 6 v. 3-5.

“A nuk e dini çfarë do të thotë kjo? Pagëzimi në Jezu Krishtin na lidh me vdekjen e tij. Prandaj, kur ne u pagëzuam, u varrosëm bashkë me të. Por, ashtu siç u ringjall ai nga të vdekurit me anë të fuqisë së Atit, edhe ne duhet të bëjmë një jetë të re. ashtu siç ishim të lidhur me vdekjen me anë tij, ashtu dhe duhet të ringjallemi bashkë me të.”

Për pak çaste le të përpiqemi të imagjinojmë skenën kur u ringjall Jezusi, sepse kemi parë që kur Dejvi të dalë nga uji, ai do të shoqërizohet me ngritjen e Jezusit nga vdekja.

Mund të imagjinojmë freskinë dhe heshtjen e ajrit të natës, dhe ndjenjën e lavdishme të jetës së re brenda Jezusit. Ai do të kishte qenë në gjendje të shihte dritat e Jeruzalemit tek ndriçonin tej larg; njerëzit atje as që ia kishin

idenë asaj gjëje të mrekullueshme që po ndodhte aq pranë tyre – që një njeri po ngjallej nga të vdekurit për në jetën e re.

Dhe kështu tek Dejvi ngrihet nga uji, bota përreth nesh nuk e vlerëson gjënë e lavdishme që po ndodh; gjithçka shohin, nëse e vrasin mendjen të shohin, është një grup i vogël burrash e grash që ecin drejt një pishine dhe një njeri që zhyt një tjetër. Por siç u gëzuan Engjëjt në ringjalljen e Jezusit, po ashtu, pa u parë nga ne, Engjëjt gëzohen nga një mëkatar që pendohet.

Kemi lexuar në Romakëve 6 që duhet “*të ecim në jetën e re*” – gëzimi që do të ketë Dejvi tani do të jetë me të tek ecën përpara përmes jetës. Siç kemi lexuar, ai nuk do të jetë më një skllav i mëkatit, por i Perëndisë, duke bërë vullnetin e Tij siç zbulohet në Bibël. Është tunduese të arsyetosh që do të donim lirinë për veten tonë, por duke i shërbyer vetes nuk jemi të lirë, jemi skllavër të mëkatit. Dejvi tani po ndërron të zotin, për t’i shërbyer Perëndisë. Hera-herës do të duke sikur kufizimet e dukshme që na imponon të jetuarit e jetës së re janë tepër të mëdha për t’u përballuar, dhe tundohemi të përpiqemi për të qenë të lirë prej tyre. Por nëse bëjmë këtë, nuk do të jemi të lirë, por do t’i shërbejmë mëkatit përsëri.

Pali shpjegon në 1 Kor. 10:1,2, se kalimi ynë nëpër ujrat e pagëzimit është si izraelitët që kalonin mes ujrave të Detit të Kuq. Ata u pagëzuan “në re dhe në det” – në të dyja anët kishin ujë dhe sipër kishin retë. Tek kalonin, “retë lëshuan ujë” (Ps. 77:17) – ata ndoshta u qullën nga rrebeshi. Një lloj historie mund të dalë prej kësaj, me shumë mësim për ne. Izraelitët kishin qenë skllavër në Egjipt, duke jetuar një jetë pa kuptim, duke punuar shumë në skllavërinë e tyre dhe duke u shërbyer idhujve të Egjiptit. Përmes përvojës së tyre të jetës, i thirrën Perëndisë për të gjetur një rrugë shpëtimi, megjithëse nuk ia kishin idenë se si mund t’u përgjigjej Ai.

Në përgjigje, Perëndia dërgoi Moisiun që t’i udhëhiqte për të dalë nga Egjipti, përmes Detit të Kuq dhe nëpër shkretëtirë, për të hyrë në Tokën e Premtuar. Izraelitët në Egjipt ishin si Dejvi dhe të gjithë që vijnë në pagëzim; tani Dejvi është udhëhequr, ashtu, në brigjet e Detit të Kuq. Me të kaluar ujin, ai do të jetë menjëherë në Tokën e Premtuar të Mbretërisë, do të bashkohet me ne të tjerët këtu duke ecur përmes shkretëtirës. Perëndia i udhëhoqi izraelitët përmes shkretëtirës me anë të një Engjëlli, i cili ishte vazhdimisht me ta ditë e natë. Po kështu, secili prej nesh ka një Engjëll përreth, që na drejton nëpër jetët drejt shpëtimit (Ps. 34:7; Heb. 1:14). Izraelitët u ushqyen çdo ditë me mëna, të cilën Jezusi e interpreton në Gjoni 6 edhe si Vetën, edhe si Fjalën e Perëndisë. Nëse ata nuk do ta kishin ngrënë, do kishin vdekur shpejt në shkretëtirë – nuk kishte ushqim tjetër për të ngrënë atje. Për këtë arsye, nuk gjejmë dot fjalët për të të drejtuar tek tabelat e leximit të “Mikut të Biblës”, ku lexoni Biblën çdo ditë, duke marrë

gjithë kontekstin e pasazheve tek i lexoni, dhe sidomos, duke u ushqyer *me Krishtin*, të cilin do ta gjeni “në të gjitha shkrimet.” Është jetësore që në rutinën tonë të përditshme të bëjmë vend, mundësisht në të njëjtën kohë çdo ditë, për të lexuar ato kapituj e për të reflektuar mbi ta.

Kalimthi, izraelitëve iu tha të mos përpiqeshin të mblidhnin mëna për disa ditë brenda një dite, por të bënin përpjekje për të dalë e për ta mbledhur çdo ditë. Ushqimi ynë nga Fjala duhet të jetë i përditshëm. Ashtu siç nuk do të harronim të hanim ushqimin tonë të natyrshëm, po ashtu, instinktivisht duhet të bëjmë përpjekjen e përditshme prë t’u ushqyer me Fjalën e Perëndisë; vërtet, Ijovi mund të thoshte që vlerësonte fjalët e Perëndisë “*më shumë* sesa ushqimi imi nevojshëm.” Izraelitët pinë nga kroi që rridhte prej shkëmbit të goditur; 1 Kor. 10 na tregon se kjo përfaqëson “Krishtin.” Kështu, duhet të hamë e të pijmë sipas shembullit të Jezusit, çka mund ta bëjmë përmes shërbimit memorial çdo javë. Me që ra fjala për takimet, duhet të jetë dëshira jonë e natyrshme që të takohemi me të tjerët që ndajnë Shpresën tonë. Një udhëtar në një shkretëtirë të vërtetë do të hidhej përjetë për të takuar një udhëtar tjetër për të diskutuar problemet e mundshme përpara, për të ndarë përvoja. Kështu, ne në shkretëtirën e jetës në këtë botë të ligë duhet të bëjmë çdo përpjekje për të mbajtur lidhje me njëri-tjetrin. Shpesh, takime të tilla nuk janë të mundura fizikisht aq sa do të donim, por duhet të shfrytëzojmë shansin për të mbajtur lidhje duke shkruar letra, duke lexuar revista, etj.

Kemi folur mbi përgjegjësitë e jetës së re, por do të ishte e gabuar të jepnim përshtypjen se nëse bëjmë disa gjëra të caktuara, si për shembull leximi i përditshëm i Biblës, atëherë Perëndia duhet të na shpërblejë. Është kënaqësia e mirë e Perëndisë, vullneti i Tij, që të na japë neve Mbretërinë si dhuratë, jo si shpagim për veprat tona (Rom. 6:23). Do të ishte e gabuar që ne të ndjenim se pagëzimi është një ide e emirë sepse tani kemi një shans të madh për të hyrë në Mbretërinë. E Vërteta dhe dashuria për Perëndinë, fitorja e Krishtit, e bëjnë të gjithën shumë më pozitive se aq. Perëndia vërtet *e do* Dejvin dhe të gjithë ne këtu që të jemi në Mbretërinë. Ky fakt është aq i lavdishëm sa duhet t’i kujtojmë vetes herë pas here që është vërtet i vërtetë dhe se në dritën e tij duhet të bëjmë një lloj përgjigjeje për dashurinë e Perëndisë.

Kur izraelitët dolën nga Deti i Kuq, gëzimi ishte i pamatë; Moisiu këndoi këngën e tij dhe të gjithë u gëzuan. Psalmi 105:35-41 e shpreh mirë këtë, duke treguar se si Perëndia ofroi çdo gjë që ishte e nevojshme për udhëtimin e tyre:-

“Dhe (Zoti) nukla në këmbë asnjë fije bari në tokën e tyre (Egjipt), dhe shkretoi fushat anekënd. Në fund bëri të vdisnin

të parëlindurit, goditi krenarinë e familjeve egjiptiane. Pastaj bëri të tijët (izraelitët) të dilnin nga vendi, të ngarkuar me pasuri prej ari dhe argjendi; në fiset e tyre askush nuk mbeti prapa. Mbarë Egjipti u gëzua për nisjen e tyre; kaq e madhe ishte frika prej izraelitëve. Me një re, Zoti mbrojti popullin e tij dhe zjarri ia ndriti natën. Kur iu lutën, Zoti u dërgoi shkurtë; me bukë prej qiellit i ngopi. Hapi shkëmbin dhe buroi ujë; si një lumë rrodhi nëpër shkretëtirë.”

Ai gëzim është gëzimi ynë, vëllezërve e motrave tuaja të ardhshme, që janë këtu për të dëshmuar pagëzimin tënd. Është gëzimi i Perëndisë, i Jezusit dhe i Engjëjve që po na vështrojnë fort në këtë kohë. E ruajtshim këtë Shpresë dhe këtë gëzim “të palëkundur deri në fund,” që të mund të ecim sëbashku në Mbretërinë.

Tani do të ecim për në dhomat e zhveshjes, dhe pastaj në pishinë...